



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I DREJTËSISË  
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS CIVILE**



**DISERTACION**

**PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR”**

**“MASAT E SIGURIMIT TË PADISË NË PROCESET  
GJYQËSORE DHE TË ARBITRAZHIT”**

**Kandidati  
MA. Silvana ÇINARI**

**Udhëheqës shkencor  
Prof.As. Dr. Argita MALLTEZI**

**Tiranë, 2015**

© E drejta e autorit: Silvana Çinari, 2015

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje, dhe çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdolloj mjeti dhe forme pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

## ***Falënderim dhe mirënjohje***

*Kjo punë disavjeçare u bë e mundur falë angazhimit dhe mbështetjes së disa personave, të cilëve dëshiroj tu kushtoj përzemërsisht këtë falënderim si edhe mirënjohjen time.*

*Falënderim dhe mirënjohje e thellë shkon për udhëheqësen shkencore Prof. As. Dr. Argita Malltezi, e cila ka qenë gjithmonë e gatshme për të më ndihmuar dhe më ka mbështetur me këshillat e saj profesionale gjatë gjithë rrugëtimit të gjatë drejt finalizimit të këtij punimi.*

*Një falënderim dhe mirënjohje e veçantë është për Prof. As. Dr. Flutura Kola Tafaj, pa mbështetjen jo vetëm profesionale të të cilës rrugëtimi për përmbylljen e këtij punimi do të kishte qenë edhe më i mundimshëm.*

*Gjithashtu, gjej rastin të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për Institutin Max Planck për të Drejtën e Krahasuar dhe Ndërkombëtare Private, Hamburg pranë të cilit pata fatin të kryej kërkim dhe punoj për dy muaj, dhe veçanërisht për Dr. Christa Jessel-Holst, pa mbështetjen e së cilës nuk do të kishte qenë e mundur pranimi pranë Institutit. Mirënjohje edhe për Konrad Adenauer Stiftung, i cili mbështeti financiarisht kërkimin shkencor në Bibliotekën e Institutit Max Planck.*

*Falënderime shkojnë gjithashtu për shumë kolegë të Fakultetit të Drejtësisë, nga të cilët do të përmendja veçanërisht Armela Kromiçin, Petrina Brokën, Eniana Qarrin dhe Xhensila Kadin, për nxitjen, mbështetjen dhe ndihmën e pakursyer në disa momente të vështira të finalizimit të këtij rrugëtimi të gjatë. Mirënjohje e thellë edhe për kolegen time Av. Alda Sadiku.*

*Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, mirënjohje pafund për familjen time, besimi dhe mbështetja e të cilës ka qenë burim force dhe motivimi.*

*Faleminderit!*

*Silvana Çinari*

*Tiranë, Prill 2015*

## TABELA E PËRMBAJTJES

Falënderim dhe mirënjohje .....	ii
Tabela e përmbajtjes.....	iii
Parathënie .....	viii
Metodologjia.....	x
Struktura e punimit.....	xi

### PJESA I

#### MASAT E SIGURIMIT TË PADISË NË PROCESET GJYQËSORE CIVILE

<b>HYRJE</b> .....	2
--------------------	---

#### KAPITULLI I

##### VEÇORITË, QËLLIMI DHE KUSHTET E ZBATIMIT TË MASAVE TË SIGURIMIT TË PADISË

1. Karakteristikat e mbrojtjes së përkohshme të të drejtave .....	3
2. Evoluimi i institutit të sigurimit të padisë në legjislacionin shqiptar .....	7
2.1.Rregullimi ligjor i institutit të sigurimit të padisë pas shpalljes së pavarësisë (1912-1924) .....	7
2.2.Rregullimi ligjor i institutit të sigurimit të padisë gjatë regjimit të Ahmet Zogut (1924-1939) .....	9
2.3.Rregullimi ligjor i institutit të sigurimit të padisë pas çlirimit të Shqipërisë (1944-1990) .....	10
2.4.Rregullimi ligjor i institutit të sigurimit të padisë pas viteve '90 dhe aktualisht .....	12
3. Kushtet për dhënien e masave të sigurimit të padisë .....	12
3.1. <i>Fumus boni juris</i> .....	13
3.2. <i>Periculum in mora</i> .....	19
3.3. <i>Garancia</i> .....	24

#### KAPITULLI II

##### PROCEDURA DHE LLOJET E MASAVE TË SIGURIMIT TË PADISË

1. Kërkesa për marrjen e masave të sigurimit të padisë.....	33
2. Gjykata kompetente për marrjen e masave të sigurimit të padisë .....	37
2.1. <i>Kompetenca ante causam dhe gjatë gjykimit të padisë së themelit</i> .....	38
2.2. <i>Kompetenca në rastin e padisë civile në procesin penal</i> .....	39
2.3. <i>Kompetenca në rastin e gjykimit në apel</i> .....	40
2.4. <i>Kompetenca në rastin e gjykimit të themelit nga juridiksioni gjyqësor i huaj</i> .....	41
2.5. <i>Kompetenca në rastin e gjykimit të themelit nga juridiksioni i arbitrazhit</i> .....	42
3. Procedura e gjykimit të kërkesës për marrjen e masave të sigurimit të padisë.....	43
3.1. <i>Shpejtësia e gjykimit</i> .....	43
3.2. <i>Kontradiktoriteti dhe masat ex parte</i> .....	45
3.3. <i>Mosparagjykimi i themelit të padisë</i> .....	46
3.4. <i>Ndërhyrja e të tretit</i> .....	46
3.5. <i>Natyra e vendimeve për sigurim padie</i> .....	46
3.5.1. <i>Vendimi për moskompetencë</i> .....	47
3.5.2. <i>Vendimi i rrëzimit të kërkesës për masë sigurimi</i> .....	47
3.5.3. <i>Vendimi i pranimit të sigurimit të padisë dhe shuarja e masës së sigurimit</i> .....	48

4. Llojet e masave të sigurimit të padisë .....	52
---	----

**KAPITULLI III**  
**REVOKIMI, NDRYSHIMI, ANKIMI DHE EKZEKUTIMI I MASAVE TË**  
**SIGURIMIT TË PADISË**

1. Revokimi dhe ndryshimi i masave të sigurimit të padisë .....	56
1.1. Shkaqet për të cilat lejohet revokimi dhe ndryshimi .....	56
1.2. Gjykata kompetente për të vendosur mbi revokimin dhe ndryshimin e masës së sigurimit .....	57
2. Kundërshtimi i vendimit të gjykatës për masat e sigurimit të padisë .....	59
2.1. Vendime ndaj të cilave mund të ushtrohet ankim .....	59
2.2. Shkaqet për të cilat mund të ushtrohet ankim .....	62
2.3. Gjykata kompetente dhe procedura e shqyrtimit të ankimit .....	62
2.4. Efektet e ankimit dhe lloji i vendimeve të gjykatës së apelit .....	63
2.5. Kundërshtimi i vendimit të Gjykatës së Apelit mbi ankimin ndaj masës së sigurimit .....	65
3. Ekzekutimi i vendimeve për sigurimin e padisë .....	66
3.1. Përmbaruesi kompetent .....	67
3.2. Mënyra e ekzekutimit të masave të sigurimit .....	67
3.2.1 Ekzekutimi mbi sende të luajtshme .....	67
3.2.2. Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme .....	69

**PJESA II**  
**MASAT E SIGURIMIT TË PADISË NË PROCESET E ARBITRAZHIT**

<b>HYRJE</b> .....	71
--------------------	----

**KAPITULLI I**  
**KOMPETENCA E ARBITRAVE PËR TË DHËNË MASA SIGURIMI**

1. E drejta e gjykatës së arbitrazhit për dhënien e masave të sigurimit. Burimet e kësaj të drejte .....	75
2. Përcaktimi i ligjit që i jep gjykatës së arbitrazhit kompetencën për të marrë masa sigurimi .....	80
3. Kufizime të kompetencës së arbitrave për të dhënë masa sigurimi .....	83
4. Arbitri i urgjencës, formimi i përshpejtuar i gjykatës së arbitrazhit dhe mekanizma të tjerë për dhënien e masave të sigurimit para formimit të gjykatës së arbitrazhit .....	88
4.1. Arbitri i urgjencës .....	88
4.2. Formimi i përshpejtuar i gjykatës së arbitrazhit .....	90
4.3. Mekanizma të tjerë për marrjen e masave të sigurimit para formimit të gjykatës së arbitrazhit .....	91
4.4. Përparësitë dhe të metat e arbitrit të urgjencës .....	91

**KAPITULLI II**  
**PROCEDURA DHE STANDARDET PËR DHËNIEN E MASAVE TË**  
**SIGURIMIT**

1. Fillimi i procedurës për masë sigurimi para gjykatës së arbitrazhit .....	95
1.1. Subjektet që mund të iniciojnë procedurën për marrjen e masës së sigurimit .....	95
1.2. Elementet e kërkesës për masë sigurimi .....	96

2. Ligji që përcakton procedurën dhe standardet e marrjes së masave të sigurimit nga gjykata e arbitrazhit.....	96
3. Standardet për dhënie të masave të sigurimit në arbitrazhin ndërkombëtar .....	98
3.1. Kriteret pozitive .....	99
3.1.1. Juridiksioni <i>prima facie</i> i gjykatës së arbitrazhit .....	100
3.1.2. Sukses <i>prima facie</i> mbi themelin e padisë.....	101
3.1.3. Urgjenca.....	103
3.1.4. Dëm i riparueshëm ose thelbësor .....	105
3.1.5. Proporcionaliteti ose “balanca e interesave” .....	107
3.2. Kriteret negative .....	108
3.2.1. Mosparagjyksi i themelit të padisë.....	108
3.2.2. Gjykata e arbitrazhit nuk mund të japë si masë sigurimi atë që kërkohet me padinë e themelit.....	109
3.2.3. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur pala kërkuese nuk i ka “duart e pastra” (vepron në keqbesim).....	110
3.2.4. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa nuk mund të zbatohet ..	110
3.2.5. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa e kërkuar nuk mund të parandalojë dëmin e pretenduar.....	110
3.2.6. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa që kërkohet nuk ka më vlerë.....	111
3.3. Garancia .....	111
4. Forma e masave të sigurimit: Urdhër apo Vendim?.....	113
5. Ndryshimi ose revokimi i masave të sigurimit dhe efekti i masave të dhëna më parë nga gjykatat shtetërore.....	115
6. Llojet e masave të sigurimit .....	117
6.1. Masa për sigurimin e provës.....	119
6.2. Masa për ruajtjen e status-quo.....	120
6.3. Masa që synojnë të garantojnë ekzekutimin e vendimit përfundimtar .....	122
6.4. Masa sigurimi për garantimin e kostove .....	124
6.5. Masa për pagesa të përkohshme .....	125
6.6. Masa që kanë për qëllim të parandalojnë ose të pushojnë se kryeri veprime që mund të dëmtojnë procesin e arbitrazhit (Masa anti-padi).....	126
7. Masat e sigurimit <i>ex parte</i> .....	128

### **KAPITULLI III**

#### **EKZEKUTIMI I MASAVE TË SIGURIMIT TË PADISË TË DHËNA NGA GJYKATAT E ARBITRAZHIT**

1. Sanksionet për moszbatimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit.....	132
1.1. Konkluzion i pafavorshëm për palën që refuzon zbatimin.....	132
1.2. Dëmet dhe kostot nga moszbatimi i masës së dhënë .....	133
2. Ekzekutimi i masave të sigurimit në vendin e arbitrazhit.....	133
2.1. Ekzekutimi i masave të sigurimit si vendime përfundimtare të arbitrazhit.....	134
2.2. Ndihma e gjykatës shtetërore në ekzekutimin e masës .....	135
3. Ekzekutimi i masave të sigurimit në një shtet të ndryshëm nga vendi i arbitrazhit ....	137
3.1. Ekzekutimi nëpërmjet legjislacionit të brendshëm .....	138
3.2. Ekzekutimi nëpërmjet akteve ndërkombëtare.....	139

**KAPITULLI IV**  
**MASAT E SIGURIMIT TË DHËNA NGA GJYKATA SHTETËRORE NË**  
**NDIHMË TË PROCESIT TË ARBITRAZHIT**

1. E drejta e gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit ...	142
1.1. <i>Kompetenca e gjykatave shtetërore sipas Konventave Ndërkombëtare</i> .....	143
1.2. <i>Kompetenca e gjykatave shtetërore sipas Ligjeve Kombëtare</i> .....	147
1.3. <i>Kompetenca e gjykatave shtetërore sipas Rregullave të Institucioneve të Arbitrazhit</i> .....	150
2. Raporti ndërmjet juridiksionit gjyqësor dhe të arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi.....	151
2.1. <i>Modeli i zgjedhjes së lirë</i> .....	152
2.2. <i>Modeli i juridiksionit plotësues dhe ndihmues</i> .....	153
3. Autonomia e palëve për të përjashtuar juridiksionin gjyqësor për dhënien e masave të sigurimit .....	155
4. Konflikti i juridiksioneve .....	157
5. Ligji që aplikon gjykata shtetërore në dhënien e masave të sigurimit .....	159
6. Ndihma e gjykatave ndaj arbitrazhit të huaj .....	160
7. Ekzekutimi i masave të sigurimit të dhëna nga gjykatat shtetërore në ndihmë të arbitrazhit të huaj .....	163
<b>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME</b> .....	165
<b>BIBLIOGRAFI</b> .....	184
<b>Abstrakt</b> .....	201

## LISTA E SHKURTIMEVE

AAA	American Arbitration Association
ACICA	Australian Center for International Commercial Law
Arb.	Arbitration
CEPANI	Belgian Centre for Arbitration and Mediation
CIETAC	China International Economic and Trade Arbitration Commission
DIS	Instituti Gjerman i Arbitrazhit
ECJ	European Court of Justice
Ed.	Edition
Eds.	Botuesit (Editors)
Et. Seq.	Dhe në vazhdim
Fq.	Faqe
Id.	Idem
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
HKIAC	Hong Kong International Arbitration Centre
ICC	International Chamber of Commerce
ICDR	International Centre for Dispute Resolution
ICJ	International Court of Justice
ICSID	International Centre for Settlement of Investment Disputes
Int'l	International
JCAA	Japan Commercial Arbitration Association
KPrC	Kodi i Procedurës Civile
Konventa e Brukselit	Konventa e Brukselit mbi Juridiksionin dhe Ekzekutimin e Vendimeve në çështjet Civile dhe Tregtare
Konventa e Gjenevës	Konventa Europiane e Arbitrazhit Tregtar Ndërkombëtar
Konventa e New York	Konventa për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj
Konventa e ICSID	Konventa për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve Ndërmjet Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të tjerë kontraktues
LCIA	London Court of International Arbitration
Ligji Model	Ligji i UNCITRAL “Për Arbitrazhin tregtar ndërkombëtar”
MEDART	Qendra Shqiptare për Ndërmjetësim dhe Arbitrazh
NAI	Netherlands Arbitration Institute
Nr.	Numër
Op. Cit.	Opera citato
Para.	Paragraf
Rev.	Review
SCAI	Swiss Chambers' Arbitration Institution
SCC	Stockholm Chamber of Commerce
SIAC	Singapore International Arbitration Centre
UNCITRAL	United Nations Commission on International Trade Law
Vol.	Vëllimi



## PARATHËNIE

Ky punim është një trajtim sa doktrinar aq edhe praktik i institutit procedural të sigurimit të padisë si në proceset gjyqësore civile ashtu dhe në ato të arbitrazhit. Sigurimi i padisë në procesin civil ka gjetur rregullim që në aktet e para të legjislacionit shqiptar, me ndryshime të herëpashershme ndër vite, të cilat reflektonin dhe zhvillimet politike dhe social-ekonomike të vendit. Në pjesën e parë të këtij punimi kemi tentuar të analizojmë dhe të interpretojmë legjislacionin shqiptar mbi masat e sigurimit të padisë në procesin civil, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë praktikës gjyqësore shqiptare ndër vite.

Interpretimi i dispozitave ligjore që rregullojnë masat e sigurimit të padisë nuk ka qenë aspak i lehtë në kushtet kur ato mbartin një sërë paqartësish ligjore në aspektin e teknikës legjislative, kur ka mungesë rregullimi ligjor të aspekteve të veçanta, kur praktika gjyqësore është e pa unifikuar shpesh herë edhe në raste kur rregullimi ligjor është i qartë dhe nuk lë vend për ekuivoqe dhe kur doktrina juridike shqiptare nuk ofron shumë në lehtësimin e kësaj detyre.

Për këto arsye gjatë gjithë punimit bëhet referim në doktrinën juridike dhe praktikën gjyqësore ndërkombëtare, me qëllimin e vetëm për t'i dhënë përgjigje një sërë problemesh që lindin nga rregullimi aktual i institutit të sigurimit të padisë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile shqiptar.

Gjithashtu, një pjesë e veçantë e këtij punimi i është dedikuar institutit të sigurimit të padisë në proceset e arbitrazhit. Dekadat e fundit arbitrazhit po gëzon një njohje gjithnjë e më të gjerë në Shqipëri, sidoqoftë praktika shqiptare e arbitrazhit mund të quhet ende në faza embrionale. Mosnjohja e duhur e mënyrës së funksionimit të kësaj metode alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rrethin e praktikuesve të të drejtës dhe komunitetit të biznesit, e kompetencave që u janë njohur arbitrave, e rolit që duhet të luajnë gjykatat shtetërore në procesin e arbitrazhit, por mbi të gjitha një rregullim ligjor plot vakume dhe paqartësi për arbitrazhin e brendshëm dhe mungesa totale e rregullimit ligjor me një akt kombëtar për arbitrazhin ndërkombëtar, ka bërë që zgjidhja e mosmarrëveshjeve me arbitrazh në Shqipëri jo rrallë të kthehet në një maratonë të gjatë e të mundimshme.

Një nga çështjet më problematike në fushën e arbitrazhit dhe kjo jo vetëm në realitetin shqiptar është marrja e masave të sigurimit të padisë nga gjykata e arbitrazhit dhe roli i gjykatës shtetërore në lidhje me marrjen e këtyre masave në rastet kur gjykimi i themelit të padisë është në juridiksionin e arbitrazhit. Kjo është në fokus të trajtimit të pjesës së dytë të këtij punimi. Për të realizuar këtë punim janë marrë në analizë akte ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit, legjislacione kombëtare dhe rregullore arbitrazhi të institucioneve të ndryshme, por veçanërisht i është kushtuar rëndësi doktrinës juridike dhe jurisprudencës së arbitrazhit tregtar ndërkombëtar. Qëllimi i kësaj analize të gjerë nuk është krahasimi në vetvete i instrumenteve të marrë në shqyrtim, por paraqitja e një tabloje të gjerë dhe të plotë e rregullimit të institutit të sigurimit të padisë në arbitrazhin ndërkombëtar, për të evidentuar problematikat dhe praktikat më të mira të cilat duhet të adoptohen dhe për të përcaktuar çështjet për të cilat nevojitet harmonizim i legjislacioneve kombëtare, veçanërisht atij shqiptar, në funksion të efektivitetit të marrjes së masave të sigurimit të padisë nga gjykata e arbitrazhit dhe procesit të arbitrazhit në tërësi.

Shpresojmë që me anë të këtij punimi të kemi sjellë një kontribut sado modest në doktrinën juridike, në trajtimin e një instituti kaq të rëndësishëm procedural, si ai i sigurimit të padisë, pa ekzistencën e të cilit drejtësia nuk do të përmbushte nevojat sociale për zgjidhjen e shpejtë të llojeve të ndryshme të kërkesave urgjente civile.

**Objektivat e studimit.** Në këtë punim synohet të analizohen dhe paraqiten zgjidhjet më të mira të sugjeruara nga doktrina dhe jurisprudenca vendase dhe ndërkombëtare për problematikat lidhur me çështje të tilla si:

- Kushtet për dhënien e masave të sigurimit të padisë në procesin civil;
- Veçori të procedurës së gjykimit të masave të sigurimit të padisë, duke u ndalur veçanërisht tek elementet e përmbajtjes së kërkesës për masë sigurimi, përcaktimi i gjykatës kompetente dhe mënyra e gjykimit dhe vlerësimit të kushteve për dhënien e masave të sigurimit të padisë nga ana e gjykatave;
- Llojet e vendimeve të gjykatës dhe efektet e tyre, si dhe llojet e masave të sigurimit që mund të jepen;
- Kushtet e revokimit dhe kundërshtimit të vendimit për masa sigurimi;
- E drejta e arbitrave për të marrë masa sigurimi, përcaktimi i burimeve të një të drejte të tillë, kufizimet e kompetencës së tyre dhe instrumentet e krijuar për të minimizuar efektet e këtyre kufizimeve;
- Përcaktimi i ligjit që rregullon procedurën dhe standardet për dhënien e masave të sigurimit në arbitrazhin ndërkombëtar, identifikimi i këtyre standardeve;
- Forma e vendimeve të arbitrave për masa sigurimi dhe identifikimi i llojeve të masave të sigurimit që mund të jepen nga gjykata e arbitrazhit;
- Ekzekutimi e masave të sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit;
- Juridiksioni i gjykatave shtetërore për dhënien e masave të sigurimit në ndihmë të arbitrazhit vendor dhe të huaj.
- Ekzekutimi i masave të dhëna nga gjykata në ndihmë të arbitrazhit të huaj.

## METODOLOGJIA

Me qëllim arritjen e objektivave të këtij punimi, si më sipër cituar, realizimi i tij është bërë duke ndjekur disa metoda të kërkimit shkencor.

**Kërkimi doktrinar.** Kjo metodë konsiston në identifikimin dhe gjetjen e literaturës në lidhje me objektin e studimit, ku përfshihen libra, monografi, artikuj shkencorë, kumtesa të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare. Zgjedhja e literaturës është shtrirë mbi një numër të gjerë autorësh të huaj si edhe disa autorë vendas, me qëllim identifikimin mundësisht të të gjitha pikëpamjeve që ekzistojnë mbi një çështje të caktuar dhe për të evidentuar edhe pikëpamjen më të mirë. Në këtë drejtim, një ndihmë të madhe ka dhënë kërkimi shkencor i realizuar në Bibliotekën e Institutit Max Planck për të Drejtën e Krahasuar dhe Ndërkombëtare Private, Hamburg, Gjermani, ku u mundësua konsultimi me literaturën më bashkëkohore si në fushën e procedurës civile ashtu dhe të arbitrazhit ndërkombëtar.

**Metoda e analizës së legjislacionit.** Përdorimi i kësaj metode ishte i pashmangshëm dhe esencial për arritjen e objektivave të këtij punimi. Kjo metodë konsiston në formulimin e problemeve ligjore nëpërmjet analizës së legjislacionit. Në sistemin tonë juridik, normat ligjore gjenden në kode, ligje dhe akte të tjera. Duke qenë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Gjithashtu, kjo metodë shërben për të sqaruar paqartësinë e normave, vendosjen e tyre në një rend logjik dhe koherent dhe për të analizuar ndërveprimin e tyre më të tjera norma.

**Metoda krahasuese.** Për të realizuar këtë punim janë marrë në analizë akte ligjore të shteteve të ndryshme që rregullojnë masat e sigurimit në procesin civil, vëmendje e veçantë i është kushtuar veçanërisht legjislacionit italian, por pa lënë mënjanë edhe legjislacionin francez, gjerman dhe atë anglez. Gjithashtu për pjesën e dytë të punimit janë analizuar, akte ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit, legjislacione kombëtare dhe rregullore arbitrazhi të institucioneve të ndryshme. Gjithsesi duhet të theksojmë se qëllimi i kësaj analize të gjerë nuk është krahasimi në vetvete akteve ligjore të marra në shqyrtim, por paraqitja e një tabloje të gjerë dhe të plotë e rregullimit të institutit të sigurimit të padisë si në procesin civil dhe atë të arbitrazhit ndërkombëtar, për të evidentuar problematikat dhe praktikat më të mira të cilat duhet të adoptohen.

**Metoda e analizës së praktikës gjyqësore** është përdorur gjerësisht gjatë gjithë punimit. Me anë të kësaj metode arrijmë të shohim mënyrën e interpretimit dhe zbatimit praktik të normave mbi sigurimin e padisë si nga gjykatat shqiptare dhe ato të huaja. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh faktin që praktika gjyqësore shqiptare, lidhur masat e sigurimit në procesin civil në disa raste është e paunifikuar, referimi në praktikën gjyqësore të huaj, veçanërisht atë italiane ka qenë shumë e rëndësishme. Gjithashtu praktika shqiptare në fushën e arbitrazhit është akoma shumë e varfër, ndaj në punim i bëhet referim praktikës së pasur ndërkombëtare.

## STRUKTURA E PUNIMIT

Disertacioni është strukturuar në dy pjesë, ku pjesa e parë është ndarë në tre kapituj dhe pjesa e dytë në katër të tillë.

**Pjesa e I**, trajton masat e sigurimit të padisë në proceset gjyqësore civile.

**Kapitulli i parë**, trajton konceptin e masave të sigurimit të padisë, si një institut shumë i rëndësishëm i së drejtës procedurale për mbrojtjen e përshpejtuar të interesave të paditësit, pa ekzistencën e të cilit drejtësia nuk do të përmbushte nevojat sociale për zgjidhjen e shpejtë të llojeve të ndryshme të kërkesave urgjente civile. Në këtë kapitull një hapësirë e veçantë i është lejuar një historiku të shkurtër të institutit të sigurimit të padisë në legjislacionin shqiptar, i cili ka ndryshuar ndër vite duke reflektuar dhe zhvillimet social-ekonomike dhe politike të vendit. Pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli është analiza e kushteve për dhënien e masave të sigurimit të padisë, duke u ndalur tek kushtet kryesore si *periculum in mora* dhe *fumus bonis juris*, si dhe roli dhe rëndësia e garancisë, si një masë kundërsiguruese që mbron të drejtën e shpërblimit të dëmit që mund të pësojë personi kundër të cilit është marrë një masë sigurimi në rast e drejta për të cilën është marrë dhe ekzekutuar kjo masë nuk ekziston.

**Kapitulli i dytë**, i kushtohet procedurës dhe llojeve të masave të sigurimit të padisë. Analizohen fillimisht elementet e kërkesës për sigurimin e padisë duke u ndalur në diskutime të tilla si përcaktimi i llojit të masës së sigurimit, përfshirja apo jo e *petitum* dhe *causa petendi* të padisë së themelit në kërkesën për sigurimin e padisë, nëse gjykata mund të vendosë për një masë të ndryshme nga ajo që është kërkuar etj. Një trajtim të veçantë zë përcaktimi i gjykatës kompetente për sigurimin e padisë, si kur kërkesa paraqitet përpara ngritjes së padisë ashtu edhe pas ngritjes së saj. Trajtohet gjithashtu procedura e shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë, duke u ndalur edhe tek kërkesat e parimit të kontradiktoritetit dhe gjykimi *inaudita altera parte*. Ndër të tjera trajtohen dhe llojet e masave të sigurimit të padisë që mund të urdhërojnë gjykata, natyra e vendimit që mund të japë gjykata dhe efektet e tyre.

**Kapitulli i tretë**, trajton çështje të tilla si revokimi, ndryshimi, kundërshtimi dhe ekzekutimi i masave të sigurimit të padisë. Trajtim i veçantë i kushtohet kushteve të revokimit dhe përcaktimit të gjykatës kompetente, problematikës së ankimit kundër vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie, si dhe veçori të ekzekutimit të masave të sigurimit.

**Pjesa e II**, trajton masat e sigurimit të padisë në proceset e arbitrazhit.

Në kapitullin e parë, trajtohet kompetenca e arbitrave për të dhënë masa për sigurimin e padisë, evoluimi i së drejtës së arbitrave për dhënien e masave të sigurimit të padisë nga mosnjohja e kësaj të drejte deri tek njohja e plotë e saj dhe kufizimet përkatëse të kësaj të drejte. Një hapësirë e veçantë i është kushtuar mekanizmave të rinj të krijuar së fundmi për dhënien e masave të sigurimit të padisë veçanërisht në rastet kur marrja e masave të sigurimit të padisë paraqitet e nevojshme për tu bërë përpara se të formohet gjykata e arbitrazhit, sikurse është arbitri i urgjencës.

**Kapitulli i dytë**, i kushtohet procedurës dhe standardeve për dhënien e masave të sigurimit. Ndër çështjet që trajtohen janë përcaktimi i ligjit në bazë të të cilit do të përcaktohen standardet për dhënien e masave të sigurimit të padisë, cilat janë përkatësisht standardet që marrin për bazë gjykatat e arbitrazhit për dhënien e masave të sigurimit të padisë, elementi i garancisë dhe gjykimi *ex parte* i kërkesës për sigurimin e padisë. I kushtohet vëmendje gjithashtu edhe formës në të cilën paraqitet vendimi i gjykatës së arbitrazhit për dhënien e masave të sigurimit të padisë, e cila në disa raste ka efekt të drejtpërdrejtë në ekzekutimin e kësaj mase.

**Kapitulli i tretë**, trajton një aspekt shumë të rëndësishëm dhe jo pak të debatueshëm lidhur me ekzekutimin e masave të sigurimit të padisë të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit, veçanërisht në një shtetet të ndryshëm nga vendi i arbitrazhit. Analiza fokusohet mbi parashikimet që kanë legjislacionet kombëtare dhe dispozitat e Konventës së New York-ut “Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendime të arbitrazhit të huaj”, diskutimet mbi zbatimin apo jo të tyre për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit për masat e sigurimit të padisë dhe alternativat e mundshme për të garantuar ekzekutimin e masave të sigurimit të padisë të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit.

**Kapitulli i katërt**, i kushtohet kompetencës së gjykatave shtetërore për të dhënë masa për sigurimin e padisë në favor të procesit të arbitrazhit. Në këtë kapitull trajtohet veçanërisht e drejta e gjykatave shtetërore për marrjen e masave të sigurimit të padisë kur padia e themelit është për tu gjykuar me arbitrazh. Kufizimi i kësaj kompetence nga vullneti i palëve, rregullimi që i bëhet asaj nga legjislacione të ndryshme dhe akte ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit. Një hapësirë e veçantë i është kushtuar ekzekutimit të masave të sigurimit të padisë të dhëna nga gjykatat shtetërore.

Në mbyllje të këtij punimi, janë pasqyruar **përfundimet dhe rekomandimet** në lidhje me çështjet e trajtuara. Është evidentuar gjendja aktuale e rregullimit ligjor dhe praktikës gjyqësore të institutit të sigurimit të padisë në procesin civil dhe të arbitrazhit në vendin tonë dhe më gjerë, problematikat si edhe janë paraqitur disa sugjerime modeste në lidhje me mangësitë apo paqartësitë e legjislacionit për situata të caktuara.

## PJESA I

### MASAT E SIGURIMIT TË PADISË NË PROCESAT GJYQËSORE CIVILE

#### HYRJJE

Çdo person, i cili pretendon se i është cenuar një e drejtë e tij, legjitimohet të investojë organet gjyqësore për rivendosjen e kësaj të drejte të cenuar. Por, realizimi i të drejtave nëpërmjet gjykatës, për efekt të garantimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, kërkon kohë të konsiderueshme. Gjatë kësaj kohe debitori mund të përdorë mënyra të ndryshme për ta bërë të vështirë apo të pamundur ekzekutimin e vendimit përfundimtar me anë të të cilit rivendoset e drejta e cenuar. Për shembull, debitori mund të përpiqet që të fshehë pasurinë e tij mbi të cilën do të ekzekutohet vendimi përfundimtar, qoftë duke ua kaluar personave të tretë, ose duke e transferuar jashtë shtetit, në vende ku do të ishte vështirë ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të huaj. Gjithashtu, gjatë kohëzgjatjes së nevojshme për të siguruar një vendim të formës së prerë, të drejtave të paditësit mund t'i shkaktohet një dëm shumë i madh dhe urgjent. Për këtë arsye, në mënyrë që e drejta e palës e fituar nga një gjykim të mos mbetet një e drejtë boshe, marrja e masave të sigurimit është një mjet shumë i rëndësishëm në dispozicion të palëve ndërgjyqëse në çështjet civile.

Procesi i dhënies së masave të sigurimit për shkak të kërkesave urgjente ka një natyrë të përsheptuar, qëllimi i të cilit është mbrojtja e interesave të paditësit. Kjo mbrojtje e përsheptuar e interesave të paditësit realizohet nëpërmjet dy formave kryesore: *së pari*, nëpërmjet sigurimit të padisë dhe *së dyti*, nëpërmjet sigurimit të provës. Nga dy mënyrat kryesore të dhënies së drejtësisë së përsheptuar, objekt i këtij kësaj pjese të punimit do të jetë mbrojtja e interesave të paditësit nëpërmjet masave të sigurimit të padisë.

Masa e sigurimit të padisë i përgjigjet nevojës efektive dhe aktuale për të hequr frikën ose dyshimin e një dëmi të caktuar që mund t'i shkaktohet të drejtave të paditësit nga bërja e pamundur ose e vështirë e ekzekutimit të vendimit të gjykatës.<sup>1</sup> Qëllimi i tyre është që të mbrohen të drejtat dhe interesat e palëve në çështjet gjyqësore, duke parandaluar që të ndodhin humbje apo dëme të pariparueshme, para se gjykata të marrë vendim përfundimtar mbi themelin e padisë.

Instituti i sigurimit të padisë është një ndër institutet më të vjetra të së drejtës procedurale dhe gjerësisht i njohur në legjislacionet kombëtare të sistemeve të ndryshme ligjore. Ky institut i mbrojtjes së përkohshme dhe të përsheptuar të të drejtave, i cili është shumë i rëndësishëm për dhënien e një drejtësie efektive, ka tipare të veçanta që e bëjnë atë të ndryshëm nga procesi i zakonshëm gjyqësor. Veçoritë e tij lidhen jo vetëm me qëllimin që kërkon të realizojë, por edhe me mënyrën e gjyqimit.

Në fokus të kësaj pjese të punimit është mënyra e rregullimit të këtij instituti sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, por i parë në çështje specifike edhe në aspekt krahasues me rregullimin e tij në sisteme të ndryshme ligjore. Kjo jo me qëllimin e mirëfilltë krahasimor, por për të sjellë praktikën më të mira në përgjigje të problematikave që mbart legjislacioni ynë dhe praktika jonë gjyqësore. Një vëmendje e veçantë i kushtohet doktrinës dhe praktikës gjyqësore qoftë shqiptare dhe të huaj në mënyrë që të arrihet qëllimi i këtij punimi trajtimi i plotë dhe gjithëpërfshirës, teorik dhe praktik i institutit të sigurimit të padisë në proceset gjyqësore civile.

---

<sup>1</sup> F.Kola, A.Vokshi, "Procedurë Civile" Pjesa I, Botimi i I, Maj 2013, fq. 214

## KAPITULLI I

### VEÇORITË, QËLLIMI DHE KUSHTET E ZBATIMIT TË MASAVE TË SIGURIMIT TË PADISË

#### 1. Karakteristikat e mbrojtjes së përkohshme të të drejtave

Parashikimi i afateve proceduralë është një nga aspektet më të rëndësishëm në dhënien e drejtësisë efektive. Dhënia e drejtësisë tej afateve të arsyeshme është konsideruar si mohim i saj.<sup>2</sup> Pavarësisht se zgjidhja e mosmarrëveshjeve në afate sa më të shkurtra është në interesin e gjithsecilit, sistemet ligjore, për shkak se duhet të garantojnë një procedurë ligjore sa më të drejtë, parashikojnë për një sërë formalitetesh, të cilat kërkojnë një kohë të konsiderueshme. Megjithatë, jo rrallë herë, me qëllim garantimin e të drejtës, lind nevoja që për shkak të kushteve të urgjencës të kërkohej marrja e disa masave me një procedurë të përsheptuar, pa respektuar disa nga formalitetet e një procesi të zakonshëm gjyqësor. Për rrjedhojë, shumica e juridiksioneve parashikojnë marrjen e masave të sigurimit paralelisht, ose përpara një procesi të zakonshëm gjyqësor me qëllim që t'i përgjigjen kërkesave urgjente të palëve.<sup>3</sup> Parimi sipas të cilit kohëzgjatja e procesit nuk duhet të jetë në dëm të palës që ka të drejtë bën që të besosh se mbrojtja gjyqësore e përsheptuar dhe e përkohshme përbën një komponent thelbësor dhe të pashmangshëm të mbrojtjes gjyqësore.<sup>4</sup> Mbrojtja e përkohshme e të drejtave është padyshim një nga parimet e përgjithshme të së drejtës në të gjitha sistemet e zhvilluara ligjore, qëllimi i së cilës është të realizojë objektivin thelbësor të çdo sistemi ligjor, efektivitetin e mbrojtjes gjyqësore.<sup>5</sup> Pa ekzistencën e saj drejtësia nuk do të përmbushte nevojat sociale për zgjidhjen e shpejtë të llojeve të ndryshme të kërkesave urgjente.<sup>6</sup>

Duke qenë se mbrojtja përfundimtare e së drejtës me një proces të zakonshëm gjyqësor nuk mund të jepet menjëherë, sepse procedurat kërkojnë një kohë të gjatë, detyra e masave të sigurimit është të kapërcejë një hapësirë të tillë kohore. Në çdo rast qëllimi i masave siguruese i kushtohet rregullimit të ndërmjetëm.<sup>7</sup> Mbrojtja e përsheptuar e interesave të paditësit nuk synon të parashikojë dhe as të përsheptojë njohjen përfundimtare të të drejtës. Ajo është thjesht ndihmëse e padisë së themelit.<sup>8</sup> Kjo mbrojtje karakterizohet nga *përkohshmëria*, domethënë nga pamundësia për të garantuar në mënyrë përfundimtare njohjen e të drejtës objekt mosmarrëveshje dhe *të qënurit në dobi apo funksion* të vendimit përfundimtar të dhënë sipas një procesi të

---

<sup>2</sup> *Justitia dilata est justitia negata.*

<sup>3</sup> Masanori Kawano, "Provisional Measures for prohibition of actions-New tendencies in Japan", botuar në Current Topics of International Litigation, Vëllimi I, Problems of Transnational Civil Procedure, redaktuar nga Rolf Stürner dhe Masanori Kawano, 2009, fq. 7.

<sup>4</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane, nr. 190, datë 28 qershor 1985

<sup>5</sup> Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Tesaro në çështjen 213/89 R. v. Secretary of State or Transport, ex parte Factortame Ltd., botuar në European Court Reports, 1990, I, 2433

<sup>6</sup> Masanori Kawano, "Provisional Measures for prohibition of actions-New tendencies in Japan", botuar në Current Topics of International Litigation, Vëllimi I, Problems of Transnational Civil Procedure, redaktuar nga Rolf Stürner dhe Masanori Kawano, 2009, fq. 7.

<sup>7</sup> Leipold, "Grundlagen des einstweiligen Rechtsschutzes", 1971, fq.83 referuar në Masanori Kawano, Provisional Measures for prohibition of actions-New tendencies in Japan, botuar në Current Topics of International Litigation, Vëllimi I, Problems of Transnational Civil Procedure, redaktuar nga Rolf Stürner dhe Masanori Kawano, 2009, fq. 14.

<sup>8</sup> Shiko Neil Andrews, The Modern Civil Process, Judicial and Alternative forms of Dispute Resolution in England, Mohr Siebeck 2008, fq. 54, para 4.01.

zakonshëm,<sup>9</sup> që nënkupton se ajo nuk synon të arrijë të njëjtin rezultat si gjykimi i themelit, por të garantojë që rezultati i këtij gjykimi të mos dëmtohet ndërkohë,<sup>10</sup> dhe se është gjithmonë e lidhur me padinë e themelit në kuptimin që masat e sigurimit janë gjithmonë të destinuara të humbasin efektin në rast se rrëzohet padia e themelit, ose të bëhet pjesë e vendimit që pranon padinë. Pra, përveçse të një karakteri të përkohshëm, karakteristikë thelbësore e masave të sigurimit është varësia apo nënshtrimi i tyre ndaj procesit kryesor.<sup>11</sup> Kjo ndërvarësi del qartë edhe nga përkufizimi që i kanë bërë gjykatat shqiptare masave të sigurimit të padisë, si masa të përkohshme në mbrojtje të interesave të paditësit lidhur me objektin e padisë që ka paraqitur në gjykim, ose lidhur me objektin e padisë, të cilën duhet ta paraqesë në gjykim brenda një afati të caktuar nga gjykata.<sup>12</sup> Sigurimi i padisë është gjithmonë i ndërvarur nga kërkimi i themelit të paditësit, pasi individualizimi i masës nga gjykata synon të sigurojë të drejtën e pretenduar.<sup>13</sup> Kërkesa për sigurimin e padisë është e lidhur me një marrëdhënie funksionale dhe plotësueshmërie me padinë e ngritur ose që do të ngrihet së shpejti. Kjo marrëdhënie përcaktohet nga fakti se masa që kërkohet ka për qëllim që të garantojë rezultatin e padisë. Pra, kërkesa për sigurimin e padisë është në funksion të padisë. Kur nuk ka mosmarrëveshje në shqyrtim gjyqësor, mbi bazën e së cilës është ngritur dhe një kërkim tjetër dytësor, nuk mund të ekzistojë as ky i dyti, sikurse është sigurimi i padisë. Pa padi nuk ka as masë sigurimi padie.<sup>14</sup> Kufijtë e vendosjes së këtyre masave do të duhet të kërkohen në marrëdhënien mes këtyre masave dhe vendimit gjyqësor të themelit që do të jepet, që do të thotë se ato varen nga objekti i mosmarrëveshjes së gjykimit, duke nënkuptuar vetë të drejtën që pretendohet në gjykim.<sup>15</sup>

Disa autorë argumentojnë se dhënia e masave të sigurimit bazohet në tre parime themelore:<sup>16</sup>

1. Masat e sigurimit janë të disponueshme vetëm për mbrojtjen e të drejtave të njohura ligjërish, për të cilat kërkuesi zakonisht kërkon mbrojtjen me anë të padive të themelit. Nuk ka vend për masa sigurimi nëse nuk ekziston mundësia për dëmtimin e një të drejte ligjore që i përket kërkuesit, e cila do të rivendoset nëpërmjet një vendimi të formës së prerë.
2. Parimi i dytë është ai i përkohshmërisë. Funksioni i masave të sigurimit nuk është të zgjidhë përfundimisht mosmarrëveshjen ndërmjet palëve, por vetëm të mbrojë të drejtat nga dëme të riparueshme që mund të vijnë gjatë zhvillimit të gjykimit.
3. Parimi i tretë, *kompensimi rivendosës*, nënkupton që nëse gjykata vendos me vendimin përfundimtar se njëra palë është penguar nga masa siguroese në

<sup>9</sup> S. Satta, C. Punzi, "Diritto Processuale Civile", Botimi i XI, Cedam 1992, fq. 855, para 475. Shiko gjithashtu, L. Montesano, "La tutela giurisdizionale dei diritti", botuar në "Trattato di diritto civile Italiano", da Vassalli, XI, Vëllimi 4, Torino 1985, fq. 264; L. Montesano, "Relazione sulle misure provvisorie in Italia", botuar në "Atti del Colloquio internazionale su "Les mesures provisoires en procedure civile", Milano 12-13 Ottobre 1984, fq. 113-118.

<sup>10</sup> Paolo Biavati, "Argomenti di diritto processuale civile", Bologna University Press, 2011, fq. 659.

<sup>11</sup> Masanori Kawano, "Provisional Measures for prohibition of actions-New tendencies in Japan", botuar në Current Topics of International Litigation, Vëllimi I, Problems of Transnational Civil Procedure, redaktuar nga Rolf Stürner dhe Masanori Kawano, 2009, fq. 14.

<sup>12</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 479 datë 27.10.2011

<sup>13</sup> Vendim i Gjykatës së Tiranës Nr. Akti 590, datë 25.06.2015

<sup>14</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 148, datë 17.04.2014

<sup>15</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 534, datë 22.10.2014

<sup>16</sup> Adrian Zuckerman, "Zuckerman on Civil Procedure, Principles of Practice", Botimi i III, Sweet & Maxwell 2013, fq. 396



ushtrimin e të drejtave të saj, ajo mund të kërkojë ta rikthejë atë në gjendjen që do të kishte qenë, nëse nuk do t'i ishte nënshtruar masës së sigurimit.

Një palë që ka një arsye legjitime për tu shqetësuar se koha ose një ngjarje mund të bëhen pengesë për ekzekutimin e suksesshëm të një vendimi gjyqësor të ardhshëm mund të iniciojnë një proces të veçantë për marrjen e masave të përkohshme për të siguruar garanci për vendimin e ardhshëm ose për të rregulluar përkohësisht marrëdhënien juridike të palëve deri në dhënien e një vendimi të formës së prerë.<sup>17</sup> Pra, masat e sigurimit të padisë janë një instrument ligjor që garanton dhe mbron ekzekutimin e vendimeve që jepen nga gjykatat sipas një procedure të zakonshme.<sup>18</sup> Ato kryejnë dy funksione kryesore në proceset gjyqësore civile:

- a. ruajnë *status quo* deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes me vendim të formës së prerë;
- b. sigurojnë asetet me të cilat do të realizohet ekzekutimi i vendimit përfundimtar.<sup>19</sup>

Gjykata Evropiane e Drejtësisë i ka përkufizuar masat e sigurimit të padisë si masa që synojnë të ruajnë një situatë fakti ose ligji me qëllim mbrojtjen e të drejtave, njohja e të cilave është kërkuar pranë gjykatës që ka juridiksion për çështjen.<sup>20</sup> Kurse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në çështjen *Aegean Sea Continental Shelf* të vitit 1976 është shprehur:

“Qëllimi thelbësor i masave të sigurimit është të sigurojnë që ekzekutimi i vendimit të ardhshëm mbi themelin e padisë nuk do të pengohet nga veprimet e njëres palë *pendente lite*... Sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës ... justifikimi thelbësor për padurimin e gjykatës në dhënien e një vendimi të përkohshëm përpara se të japë atë përfundimtar ... është se veprimet e njëres palë “*pendente lite*” dëmtojnë ose rrezikojnë të dëmtojnë të drejtat e palës tjetër në atë masë sa do të ishte e pamundur rivendosja e plotë e atyre të drejtave thjesht duke pasur në favor një vendim përfundimtar.”<sup>21</sup>

Gjykata në dhënien e masave të sigurimit ndeshet gjithmonë me konfliktin ndërmjet dy kërkesave të kundërta, nga njëra anë me kërkesën për respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe nga ana tjetër me nevojën për mbrojtur të drejtat nga dëmi i mundshëm deri në dhënien e një vendimi përfundimtar. E drejta për

<sup>17</sup> Peter L. Murray, Rolf Sturmer, “German Civil Justice”, Carolina Academic Press, 2004, fq. 433.

<sup>18</sup> Paolo Biavati, “Argomenti di diritto processuale civile”, Bononia University Press, Bologna 2011, fq. 658; Xandra E. Kramer, “Harmonization of provisional and protective measures in Europe”, botuar në “Procedural laws in Europe. Towards harmonization”, redaktuar nga Marcel Storme, Malku 2003, fq. 306; shiko gjithashtu: Barona Vilar, S., “Medidas cautelares en el Arbitraje”, Cizus Menor, Civitas, 2006, fq.75.

<sup>19</sup> Xandra E. Kramer, “Harmonization of provisional and protective measures in Europe”, botuar në “Procedural laws in Europe. Towards harmonization”, redaktuar nga Marcel Storme, Malku 2003, fq. 310. Shiko gjithashtu: L. Collins, “Provisional and Protective Measures in International Litigation”, botuar në *Recueil des Cours* 234 (1992-III), fq. 17, 25.

<sup>20</sup> *Reichert v Dresdner Bank*, ECJ 26 March 1992, Case C-261/90, ECR I-2149; Shiko gjithashtu: Layton dhe Mercer, “European Civil Practice”, Botimi i II, Vëllimi 3, Thomson Sweet & Maxwell, Londër 2004, para. 23. 006-23.008.

<sup>21</sup> Vendim i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në çështjen *Aegean Sea Continental Shelf*, ICJ Reports 1976, 3. Shiko gjithashtu, vendimin e GJND në çështjen *United States Diplomatic and Consular Staff in Tehran*, datë 15 dhjetor 1979 botuar në ICJ Reports 1979, 7 ff., 19, para 36; Vendimin e GJND në çështjen *Frontier Dispute (Burkina Faso c. Mali)* datë 10 janar 1986 botuar në ICJ Reports 1986, 3 ff., 8, para 13; vendimi i GJND në çështjen *Passage Through the Great Belt (Finland v. Denmark)* botuar në ICJ Reports 1991, 12 fq., 17, para 22.

një proces të rregullt ligjor nënkupton që gjykata mund të kufizojë lirinë e veprimit të një personi vetëm nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor. Falë kësaj të drejte, i padituri ndaj të cilit kërkohet të merret masa siguruese, ka të drejtë të kërkojë që paditësi së pari të provojë të drejtën e tij për vendosjen e një kufizimi të tillë. Megjithatë gjatë kohës që duhet të plotësohen kërkesat e një procesi të rregullt ligjor, të drejtat objekt i mosmarrëveshjes mund të dëmtohen aq sa në momentin kur gjykata do të japë vendimin përfundimtar nuk ka më se çfarë të mbrohet. Në një situatë të tillë gjykata si me pranimin apo refuzimin e kërkesës për sigurim padie mbart rrezikun e dëmtimit të të drejtave. Nëse pranohet kërkesa e paditësit për sigurim padie ka mundësi që nëse padia e paditësit nuk pranohet, gjykata të ketë dëmtuar të drejtat e të paditurit. Dhe anasjellas, nëse gjykata refuzon kërkesën e paditësit për sigurim padie dhe padia e tij pranohet me vendimin përfundimtar, ekziston mundësia që gjykata të ketë dëmtuar të drejtat e paditësit.<sup>22</sup>

Për të gjetur një zgjidhje përballë një dileme të tillë gjykatës i është dhënë diskrecion në dhënien e masave të sigurimit. Kështu në çështjen *Munro k. Wivehoe and Brightlingsea Rly Co*<sup>23</sup> gjykata u shpreh: “Kjo gjykatë, kur i kërkohet dhënia e një mase sigurimi, do të veprojë me drejtësi në bazë të provave dhe sipas analizës së dëmit që mund të lindë nga dhënia apo mos dhënia e masës së sigurimit.” Kurse në çështjen *R k. Secretary of State or Transport Ex. P. Factortame Ltd*<sup>24</sup> gjykata u shpreh: “Çështja e dhënies së masave të sigurimit është në diskrecion të gjykatës e cila merr parasysh të gjitha rrethanat e çështjes.” Të njëjtin qëndrim e gjejmë edhe në çështjen *Managment Publications Ltd. k. Blenheim Exhibitions Group Plc*<sup>25</sup> ku gjykata u shpreh se: “Dhënia apo refuzimi i një mase sigurimi është çështje në diskrecion të gjykatës. Një analizë e ngjashme gjendet edhe në praktikën e gjykatave shqiptare. Përmendim këtu Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 479 datë 27.10.2011, në të cilin gjykata shprehet: “...Gjykata zgjedh atë masë sigurimi të objektit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të paditurit. Në konfliktin në gjykim, në kundërshtim me arsyetimin e Gjykatës se Apelit Korçë në vendimin e saj, kërkesa e paditësit nuk plotëson kushtet që parashikon nenit 202 i K.Pr.Civile, pasi gjykata duhej të trajtonte palët në proces në barazi të plotë, pra duhej të merrte masa që jo vetëm që paditësi të mos pësonte dëm, por njëkohësisht të evitonte dëmin e pritshëm që dukshëm i shkaktohej palës së paditur; për këtë duhej të vendoste që paditësi të depozitonte garanci pasurore afërsisht me dëmin e mundshëm që mund të pësonte pala e paditur për pezullimin e ekzekutimit të detyrimit doganor për kohën që do të vazhdojë gjykimi.”

Masa e sigurimit varet nga një tërësi rrethanash dhe është krejtësisht e pamundur të vendoset ndonjë rregull i përgjithshëm me anë të të cilit të rregullohet diskrecioni i gjykatës në të gjitha rastet.<sup>26</sup> Dhënia e masave të sigurimit është kaq e dobishme sa ajo duhet të mbetet fleksible dhe diskrecionare. Ajo nuk duhet të jetë subjekt i rregullave strikte.<sup>27</sup> Por pavarësisht se gjykata ka diskrecion në dhënien e masave të sigurimit të padisë, ky diskrecion nuk është i pakufizuar. Parimi është që gjykata duhet të përpiqet të reduktojë rrezikun e dëmit të pariparueshëm të të drejtave. Ajo

<sup>22</sup> Zuckerman, Op. cit. fq. 397-398.

<sup>23</sup> *Munro kundër Wivehoe and Brightlingsea Rly Co* (1865) 46 ER 1100, 4 De G.J.& S

<sup>24</sup> *R kundër Secretary of State or Transport Ex. P. Factortame Ltd* (no.2) [1991] 1 All ER 70

<sup>25</sup> *Managment Publications Ltd. k. Blenheim Exhibitions Group Plc.* [1991] 1 All ER 70

<sup>26</sup> *Sander kundër Smith* (1838) 3 My. & Cr 711, 40 ER 1100

<sup>27</sup> *Hubard kundër Vosper* (1972) 2 QB 84; *Hill kundër C A Parsons & Co Ltd* (1972) Ch 305; *Evans Marshall & Co Ltd kundër Distos Cia Naviera SA, The Siskina* (1973) 1 All ER 992

duhet të përpiqet në gjetjen e një zgjidhjeje të drejtë, që do të thotë se duhet më tepër të mbrojë sesa të dëmtojë të drejtat.<sup>28</sup>

Në Evropën kontinentale mendohet se ka **dy sisteme të mbrojtjes së përkohshme** të të drejtave: *i pari*, sistemi tërësisht atipik, dhe *i dyti*, sistemi tipik, por i zbutur nga një masë sigurimi atipike me karakter dytësor.

Sistemi *tërësisht atipik* parashikon një proces të vetëm të mbrojtjes së përkohshme të të drejtave për të gjitha llojet e rrezikut (*periculum in mora*) që arrijnë në ekstremet e dëmit të pariparueshëm të të drejtës, proces, i cili është i destinuar të përfundojë me dhënien e masave të sigurimit që nuk janë përcaktuar nga legjislatori, por që individualizohen rast pas rasti nga gjyqtari në bazë të rrezikut që kërkohet të shmanget. Si sisteme tërësisht tipike janë cilësuar sistemi francez dhe pjesërisht ai gjerman. Një sistem tërësisht atipik paraqet rrezikun që pranimit i masës siguroese të varet tërësisht nga vlerësimi diskrecional i një gjyqtari të vetëm.<sup>29</sup>

Në sistemin tipik të zbutur nga një masë sigurimi atipike me karakter dytësor, legjislatori përcakton nëpërmjet normave të përgjithshme dhe abstrakte lloje të veçanta të rrezikut (*periculum in mora*) dhe të masave të sigurimit dhe si rrjedhojë gjyqtari do të japë masën e sigurimit vetëm nëse bindet për ekzistencën e rrezikut (*periculum*) të parashikuar shprehimisht nga legjislatori, pa u varur aspak nga vlerësimi nëse ky rrezik arrin në ekstremet e dëmit të pariparueshëm. Sistemi italian është pikërisht një sistem i tillë. Në sistemet tipike të mbrojtjes së përkohshme të të drejtave parashikimi i një mase atipike ka për qëllim të shmangë të gjitha rreziqet (*periculum in mora*) që nuk janë parashikuar nga masat siguroese tipike dhe që arrijnë në kufijtë e dëmit të pariparueshëm. Parashikimi i një mase të tillë atipike ka për qëllim tu përgjigjet nevojave të reja për masa sigurimi.<sup>30</sup>

Gjykojmë se sistemi shqiptar bën pjesë në kategorinë e parë, atë të sistemit atipik, sepse parashikon një proces të vetëm për të gjitha rastet ku mund të jetë e nevojshme marrja një mase sigurimi dhe e lë në diskrecion të gjykatës të japë çdo masë që e konsideron të përshtatshme.

## **2. Evoluimi i institutit të sigurimit të padisë në legjislacionin shqiptar**

Sigurimi i padisë është një nga institutet më të rëndësishëm të së drejtës procedurale civile dhe njëkohësisht një nga institutet më të vjetër të saj. Legjislacioni procedural parashikon një sërë rregullimesh në lidhje me këtë institut, si për shembull kushtet në cilat lejohet sigurimi i padisë, llojet e masave të sigurimit të padisë etj. Por këto rregullime ligjore sigurojnë që nuk kanë qenë statike, por kanë pësuar ndryshime të herëpashershme, duke reflektuar dhe zhvillimet sociale, ekonomike dhe politike të vendit.

### **2.1. Rregullimi ligjor i institutit të sigurimit të padisë pas shpalljes së pavarësisë (1912-1924)**

Shteti shqiptar e fitoi pavarësinë pas rreth 500 vitesh nën sundimin osman në vitin 1912. Përgjatë periudhës së pushtimit osman dhe deri në vitin 1912 në Shqipëri ka qenë në fuqi dhe është zbatuar legjislacioni turk (*osman*). Por gjithashtu ky

<sup>28</sup> Zuckerman, Op. Cit. Fq. 398

<sup>29</sup> Andrea Proto Pisani, "Lezioni di diritto processuale civile", Botimi i V, Jovene Editore, Napoli 2006, fq. 603.

<sup>30</sup> Andrea Proto Pisani, "Lezioni di diritto processuale civile", Botimi i V, Jovene Editore, Napoli 2006, fq. 604

legjislacion vazhdoi të zbatohet edhe pas shpalljes së pavarësisë pasi miratimi i ligjeve të reja shqiptare kërkonte kohën e tij. Ndaj Qeveria e Vlorës (1912-1914) e la në fuqi këtë legjislacion derisa të hartoheshin akte të reja ligjore. Kjo evidentohet qartazi në botimin e Komisionit të Kremtimeve të 25 vjetorit të vet-qeverimit 1912-1937 sipas të cilit “Në kongresin e Vlorës u vendos që gjer sa të kompiloheshin ligjet e ndryshme q’i nevojiteshin situatës së krijuar, të mbeteshin në fuqi legjislacioni otoman në tërësinë e vet duke u respektuar, në sa ishte e mundur, edhe zakonet e vendit. Kështu, mbetën në fuqi Kodet otomane dhe legjislacioni tjetër q’ish në aplikim gjer n’atë vit”.<sup>31</sup>

Burimi kryesor i së drejtës procedurale civile të kësaj periudhe ka qënë “Procedura Civile Otomane” me shtojcat e saj, të datës 19 Qershor 1296, e zbatueme me 8 prill, 26 mars 1327, dhe shtojca e datës 11 Prill dhe 6 Prill 1327, pasuar nga Shtojca e Parë e Proçedurës Civile ose “Ligjë e shtueme mbi ligjin e përkohshëm të procedurës civile” hyrë në fuqi në datën 8 Prill 1329.

Ajo që konstatojmë në këto akte ligjore është njohja e institutit të sigurimit të padisë, ndonëse jo i rregulluar me një grup të veçantë dispozitash dhe shprehimisht i referuar si i tillë. Thënë kjo, sepse nëse i referohemi Pjesës B të Kreut III të “Procedurës Civile Otomane” në fuqi në perandorinë Otomane deri në nëntor të vitit 1912 dhe e adoptuar nga shteti shqiptar,<sup>32</sup> ndonëse kjo pjesë titullohet “Mbi mënyrën e ftimit dhe thirrjes të ndërgjyqësve”, nga paragrafi 33 i kësaj pjese qartazi kuptohet se bëhet fjalë për institutin e sigurimit të padisë. Konkretisht në të parashikohet se:

“Kur një padië është prej çështjeve të ngutëshme, i padituni, mbi kërkimin e veçantë të paditësit, munt të thirret në gjykatë me të shpejtë ose të nesërmen e kërkesës. Në qoftë se ndodhen prova të fuqishme, si dokumenta zyrtare, pasi paditësit i merret garantië dhe sigurime të afta për të shpërblyem dëmin që mund t’i ngjasin të paditunit, munt t’i sikvesrohet dhe pasunia e të paditunit vetëm për të ruajtur të drejtat e paditësit.”

Pra, nga kjo dispozitë dalin qartazi në pah disa nga elementët esenciale të institutit të sigurimit të padisë, sikurse është urgjenca, ekzistenca e provave shkresore, garancia dhe mbi të gjitha qëllimi i masave siguruese, që është ruajtja e të drejtave të paditësit. Kuptohet gjithashtu se masa që mund të merret për sigurimin e padisë është sekuestroja. Vendosja e sekuestros si një lloj mase për sigurimin e padisë del qartë dhe nga shtojca e procedurës civile e datës 11 Prill dhe 6 Prill 1327 në të cilën parashikohet se: “Në padina për vetëgjëna ç’do paditës munt të kërkojë, gjer në përfundimin e gjyqit, sekuestrën konservative të sendit të kontestueshëm të luftshëm a të paluftshëm të të paditunit ase të ndodhun në duar të personit të tretë, tue u rispektuem kushtet e përmbajtun në pjesën e sekuestrës.”

Rregullimi i kushteve të vendosjes së sekuestros, sendet që përjashtohen nga sekuestroja etj. bëhet në Kapitullin IX të “Procedurës Civile Otomane” në paragrafët 271-296. Përveç këtyre përcaktimeve dhe një përkufizimi të dhënë në paragrafin 66 të “Procedurës Civile Otomane” mbi vendimet e përkohshme të cilat konsiderohen ato vendime që përmbajnë një masë të nevojshme përkohësisht para zgjidhjes dhe vendimit të përfundëm të një padie, nuk ndeshim rregullime të tjera lidhur me institutin e sigurimit të padisë.

<sup>31</sup> “Shqipënia më 1937, Veprimi Shtetnor gjat njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverimit”. Botimet e Komisionit të Kremtimeve të 25 vjetorit të vet-qeverimit 1912-1937, Vëllimi i I/ faqe 85.

<sup>32</sup> “Proçedura Civile” botim i Ministrisë së Drejtësisë, shypur në Shtypshkronjën “Mbrothësija” Kristo P. Luarasi 1923

## 2.2. Rregullimi ligjor i institutit të sigurimit të padisë gjatë regjimit të Ahmet Zogut (1924-1939)

Gjatë viteve të para të regjimit të Zogut filloi një reformë për përmirësimin e legjislacionit. Një ndër aktet më të rëndësishëm në fushën e procedurës civile gjatë këtij regjimi ishte Shtojca e Dytë e Proçedurës Civile, e cila hyri në fuqi më 1 Prill 1929. Kjo Shtojcë II plotësoi disa të meta të Proçedurës Civile dhe të Shtojcës së I. Ky akt normativ u përgatit dhe u miratua me qëllim që përmbajtja e instituteve themelore të procedurës civile t'iu përshtatej sidomos atyre normave të Kodit Civil me të cilat nuk pajtoheshin dispozitat përkatëse të procedurës civile otomane që vazhdonte të ishte në veprim.<sup>33</sup> “Komisioni Ligjëpërgatitës hartoi Shtojcën II të Proçedurës Civile, në të cilën duke u ndjekur në disa pika procedura austriake dhe ajo gjermane, u vunë rregulla më të gjera mbi kompetencën e gjyqeve, mbi provat dhe administrimin e tyre dhe mbi zotësinë procedimore.”<sup>34</sup>

Në dallim nga aktet e mëparshme ligjore, në Shtojcën e Dytë e Proçedurës Civile vihet re një përmirësim i rregullimit të institutit të sigurimit të padisë. Përkatësisht në Titullin XIX, nga nenet 388 deri në 398, gjen rregullim sekuestroja, denoncimet e veprës së re dhe damit të kërcënuem dhe masa provizore të tjera. Përcaktimet ligjore lidhur me këto masa provizore mund të konsiderohen se janë pothuajse njësoj me rregullimin aktual të institutit të sigurimit të padisë.

Kështu, Shtojca e Dytë e Proçedurës Civile parashikon sekuestron gjyqësore<sup>35</sup> dhe atë konservative. Kjo e fundit rregullohet prej 5 nenesh nga të cilët kuptohet se kërkesa për sekuestron konservative mund të paraqitet si para dhe pas ngritjes së padisë së themelit. Në rastin e parë kompetente do të ishte gjykata e vendit ku do të ekzekutohet sekuestroja dhe që jo domosdoshmërisht mund të jetë gjykata që do jetë kompetente për gjykimin e themelit, kurse në rastin e dytë, kompetente do të ishte gjykata që po gjykon themelin. Si rregull vendosja e sekuestros konservative bëhet *ex parte* dhe vetëm në rrethana të jashtëzakonshme mund të thirret debitori.<sup>36</sup> Megjithëse sekuestroja konservative vendoset mbi baza *ex parte*, ligji i ka njohur të drejtën debitorit të parashtrijë kundërshtimet e tij lidhur me të dhe si rezultat mund të vendoset revokimi i sekuestros.<sup>37</sup> Ndryshe nga vendosja e sekuestros, revokimi i saj duhet të zhvillohet gjithmonë në prani të palëve.<sup>38</sup> Në këto dispozita parashikohet gjithashtu se sekuestrimi konservativ mund të vendoset edhe për një kredi që ende nuk është bërë e kërkueshme në rast se debitori nuk ka banim në Shqipëri ose është duke fshehur pasurinë e tij, ka ikur apo është duke u përgatitur për të ikur. Në një rast të tillë, kur padia nuk mund të fillohet për shkak se kredia është ende e pakërkueshme, debitori mund të parashtrijë kundërshtimet e tij lidhur me sekuestron e vendosur duke ngritur një padi ndaj kreditorit në gjykatën që ka vendosur sekuestron brenda njëzet ditëve nga komunikimi i sekuestros. Revokimi i sekuestros së vendosur mund të passjellë dhe dënimin me një shumë fikse si zhdëmtim për personin kundër të cilit është vënë sekuestroja.

Shtojca e Dytë e Proçedurës Civile, përveç sekuestros si masë provizore sigurimi, parashikon edhe disa lloje të tjera masash, sikurse është denoncimi i veprës së re dhe

<sup>33</sup> “Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri.” Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë 2007, fq. 405.

<sup>34</sup> “Shqipënia më 1937, Veprimi Shtetnor gjat njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverimit”. Botimet e Komisionit të Kremtimeve të 25 vjetorit të vet-qeverimit 1912-1937, Vëllimi i I, fq. 96.

<sup>35</sup> Neni 388 i Shtojcës së Dytë të Proçedurës Civile

<sup>36</sup> Neni 390 i Shtojcës së Dytë të Proçedurës Civile

<sup>37</sup> Neni 391 dhe 392 i Shtojcës së Dytë të Proçedurës Civile

<sup>38</sup> Neni 393 i Shtojcës së Dytë të Proçedurës Civile

damit të kërcënuem, e cila mund të vendoset edhe pa u thirrur i padituri, me apo pa garanci. Gjykata mbi bazë të kërkesës së paditësit mund të vendosë ndalimin e vazhdimit të veprës, ose ndonjë masë tjetër që mund të ndryshohet ose revokohet gjatë gjykimit të themelit të padisë.

Si masa të tjera ligji rendit vendosjen e detyrimi ushqimor në favor të kërkuesit apo rente jetore dhe çdo masë tjetër që gjykata çmon se sjell më pak vështirësi dhe mund të ekzekutohet më lehtë. Pra, ligji ka renditur disa nga llojet e masave provizore që mund të merren, por nuk është ndalur në përcaktimin në mënyrë shteruese të tyre duke ia lënë në diskrecion gjykatës të vendosë edhe masa të tjera që i konsideron të përshtatshme. Ajo që konstatohet në këtë akt ligjor është mungesa e së drejtës për të ankimuar vendimin e gjykatës për marrjen e një mase provizore në një gjykatë të një shkalle më të lartë, por vetëm mundësia e parashtrimit të kundërshtimeve lidhur me të në gjykatën që e ka dhënë masën.

### **2.3. Rregullimi ligjor i institutit të sigurimit të padisë pas çlirimit të Shqipërisë (1944-1990)**

Në periudhën e pas çlirimit të shtetit shqiptar dy janë aktet më të rëndësishëm në fushën e procedurës civile. Këto akte ishin Ligji nr. 2625, datë 17 Mars 1958 “Mbi Kodin e Procedurës Civile të Republikës Popullore të Shqipërisë”,<sup>39</sup> i cili ishte dhe Kodi i parë shqiptar i procedurës civile në kuptimin e mirëfilltë dhe vazhdoi të ishte në fuqi deri në 1 Janar 1982, kur u zëvendësua nga Kodi i Procedurës Civile të miratuar me ligjin Nr. 6341, datë 27.06.1981.

Nëse shohim dispozitat e KPrC të vitit 1958 konstatojmë se rregullimi që i bëhet institutit të sigurimit të padisë është pothuajse identik me rregullimin e tij nga dispozitat e Kodit aktual të Procedurës Civile. Kështu, sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive, për gjithë apo një pjesë të saj, përpara ose pas ngritjes së padisë së themelit dhe në çdo fazë të gjykimit dhe derisa vendimi të marrë formën e prerë. Në rast se është paraqitur padia e themelit paditësi mund të kërkojë sigurimin e padisë nga gjykata, në të cilën është ngritur padia, kurse kur kërkohet para ngritjes së padisë, përpara gjykatës së vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia. Në këto raste, gjyqtari, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se dhjetë ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia Kërkesa për sigurimin e padisë shqyrtohet nga gjykata edhe pa u thirrur pala tjetër.<sup>40</sup>

Lidhur me kushtet për dhënien e masave të sigurimit, KPrC<sup>41</sup> parashikon se sigurimi i padisë lejohet, kur gjykata çmon se paditësi ka arsye të dyshojë se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e tij mund të bëhet i pamundur ose i vështirë, dhe me kusht që:

- a) padia të mbështetet në prova me shkresë, ose
- b) paditësi të japë garanci, në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

KPrC parashikon dhe një përjashtim nga këto kushte lidhur me paditë për ushqim, ku sigurimi i padisë lejohet edhe kur nuk janë kushtet e përcaktuara më sipër. Madje në këto lloj padish sigurimi i padisë vendoset nga gjykata edhe kryesisht. Një tjetër përjashtim nga kushtet për vendosjen e masave siguruuese është për institucionet shtetërore, të cilat përjashtohen nga dhënia e garancisë, ndërkohë që në paditë për

<sup>39</sup> Botuar në Gazetën Zyrtare Nr.4, datë: 15 Maj 1958.

<sup>40</sup> Nenet 157, 158, 162 dhe 163 të KPrC të vitit 1958

<sup>41</sup> Neni 159 i KPrC të vitit 1958

kërkim të hollash kundër institucioneve dhe ndërmarrjeve shtetërore nuk lejohet sigurimi i padisë, përveç kur paditë rrjedhin nga veprime krediti të Bankës kundër ndërmarrjeve shtetërore.<sup>42</sup> Këto përjashtime nuk gjejnë më zbatim në rregullimin aktual të institutit të sigurimit të padisë.

Përsa i përket llojeve të masave të sigurimit të padisë neni 164 i KPrC parashikon sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit (të paditurit) dhe çdo lloj mase tjetër të përshtatshme që mund të marrë gjykata, duke përfshirë edhe pezullimin e ekzekutimit. Me ndryshimet e fundit që i janë bërë KPrC është parashikuar se në rastet e ngritjes së padive gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, nuk mund të kërkohet pezullimi i ekzekutimit si masë e sigurimit të padisë.

Ndërkohë që në raport me rregullimet e mëparshme ligjore, shohim që KPrC i vitit 1958 nuk parashikon më si masa të veçanta për sigurimin e padisë denoncimi i veprës së re dhe i dëmit të kërcënuar. Megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk mund të merret një masë sigurimi për ndalimin e një dëmi që mund të vijë nga kryerja e një vepre të re ose nga ndonjë godinë apo pemë që ekziston. Këto masa gjykata mund t'i marrë si çdo masë tjetër sigurimi të përshtatshme kur shfaqet nevoja e marrjes së tyre.<sup>43</sup>

Sipas KPrC masa e marrë mund të revokohet ose ndryshohet dhe në këtë rast duhet domosdoshmërisht të dëgjohet pala tjetër, dhe kundër vendimit të gjykatës në lidhje me sigurimin e padisë, të ndryshimit ose të heqjes së sigurimit të padisë mund të bëhet ankim i veçante brenda afatit të caktuar, që nga dita e dhënies së vendimit, kur palët kanë qenë të pranishme ose, që nga dita e komunikimit të vendimit palës, që nuk ka qenë e pranishme. Paraqitja e ankesës nuk pezullon ekzekutimin e vendimit, të dhënë në lidhje me masën e sigurimit. Paraqitja e ankesës kundër vendimit, me të cilin zëvendësohet ose hiqet masa e sigurimit, pezullon ekzekutimin e këtij vendimi.<sup>44</sup>

Kur padia për të cilën është lejuar masa e sigurimit, nuk është ngritur brenda afatit të caktuar nga gjyqtari popullor si dhe kur është vendosur refuzimi i padisë ose pushimi i gjykimit të saj, gjyqtari popullor ose, sipas rastit, gjykata, mbi kërkimin e palës së interesuar ose kryesisht, vendos heqjen e sigurimit të padisë. Heqja e sigurimit të padisë ekzekutohet kur vendimi të marrë formën e prerë. Në këto raste, garancia e dhënë për sigurimin e padisë çlirohet me kërkesë të paraqitur nga pala e interesuar, në qoftë se pala tjetër nuk ngre padi për shpërblimin e dëmit, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga komunikimi i kërkesës. Kur me vendimin përfundimtar padia pranohet, gjykata vendos edhe vërtetimin e sigurimit të padisë. Sekuestrimi, i vendosur si masë sigurimi i padisë, kthehet në sekuestrim ekzekutiv, kur vendimi përfundimtar merr formën e prerë. Vendimet e gjykatës në lidhje me sigurimin e padisë përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutohen dhe kanë efekt sipas rregullave të caktuara për ekzekutimin e vendimeve mbi sendet e luejtëshme dhe të paluejtëshme.<sup>45</sup>

Nëse do të shohim rregullimin e institutit të sigurimit të padisë sipas Kodit të Procedurës Civile të vitit 1981<sup>46</sup> vihet re një regres. Me këtë Kod instituti i sigurimit të padisë rregullohet vetëm me tre dispozita (nenet 128-130) që parashikojnë se gjykata, në çdo fazë të gjykimit, me kërkesën e paditësit, mund të vendosë masa të përkohshme kur objekti i padisë është për kërkim ushqimi, për lënien e fëmijëve të mitur për rritje dhe edukim, për banesën bashkëshortore, si dhe për sigurimin e objektit të padisë ose sigurimin e ekzekutimit të vendimit. Sipas KPrC gjykata mund

<sup>42</sup> Neni 159, 160 dhe 161 të KPrC të vitit 1958

<sup>43</sup> Alqiviadh Lamani, "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë", Tiranë 1962, fq. 116, 117

<sup>44</sup> Nenet 165, 167, 168 të KPrC të vitit 1958

<sup>45</sup> Nenet 166, 169, 170 të KPrC të vitit 1958

<sup>46</sup> Ligji Nr.6343, datë 27.6.1981

të vendosë për masat e përkohshme edhe pa kërkesë të paditësit, kur çështja paraqet interes shoqëror, ndërkohë që kundër ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave bujqësore dhe organizatave shoqërore nuk merren masa të përkohshme. Si rregull, gjykata vendos për marrjen e masave të përkohshme mbasi dëgjon paditësin dhe të paditurin, por, kur çmohet se çështja ka karakter të ngutshëm, mund të vendosë edhe pa e thirrur të paditurin. Edhe sipas këtij Kodi gjatë gjykimit të çështjes, masa e përkohshme mund të ndryshohet ose të hiqet me vendim të gjykatës dhe kur vendimi merr formë të prerë, masa e përkohshme bie në rastet kur padia rrëzohet dhe kthehet në masë përmbarimore, në rast se padia pranohet. Vihet re që e drejta e ankimit ndaj vendimit për marrjen, revokimin apo ndryshimin e masës siguruese nuk gjen më rregullim.

#### **2.4. Rregullimi ligjor i institutit të sigurimit të padisë pas viteve '90 dhe aktualisht**

Pas viteve '90, u ndërmor një reformë e thellë ndaj legjislacionit në përgjithësi dhe atij procedural civil në veçanti. Kështu, Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8116, datë: 29.03.1996, miratoi "Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", i cili hyri në fuqi më 1 Qershor 1996. Për realizimin e këtij Kodi u mor eksperiencia e vendeve evropiane, si Italia dhe Franca, por edhe tipare të sistemit Anglo-Amerikan. Kodit të Procedurës Civile në fuqi i janë bërë shumë ndryshime, të cilët kanë pasur për qëllim të përmirësojnë mjaft dispozita të Kodit, të cilat shkaktonin përplasje me njëra-tjetrën. Ndryshimet më thelbësore janë ato të vitit 2001,<sup>47</sup> si dhe ndryshimet e vitit 2008.<sup>48</sup> Ndërkohë që ndryshimet e fundit janë bërë më Ligjin Nr. 122/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8116, Datë 29.3.1996 Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" hyrë në fuqi më 1 shtator 2013, të cilat kanë prekur edhe disa dispozita që rregullojnë sigurimin e padisë. Instituti i sigurimit të padisë sipas Kodit aktual të Procedurës Civile ka pothuajse një rregullim identik me atë të Kodit të vitit 1958, me ndryshimet e vetme të trajtuara më sipër.

### **3. Kushtet për dhënien e masave të sigurimit të padisë**

Sikurse u evidentua më sipër masat e sigurimit nuk synojnë arritjen e një rezultati përfundimtar apo arritjen e të njëjtit rezultat si gjykimi i themelit, por të garantojnë që rezultati i këtij gjykimi të mos dëmtohet ndërkohë. Që gjykata të vendosë në dhënien apo jo të masave të sigurimit duhet të gjejë një balancë ndërmjet interesave të paditësit dhe të të paditurit në mënyrë që të dëmtojë sa më pak të jetë e mundur të drejtat e tyre. U evidentua gjithashtu që gjykata ka diskrecion në vlerësimin e rrethanave të rastit për dhënien apo jo të një mase sigurimi, por në çdo rast ky diskrecion nuk është i palimituar. Pavarësisht se nuk ka rregulla strikte që ta kufizojnë gjykatën gjatë vlerësimit të saj për marrjen apo jo të masave të sigurimit, ekzistojnë disa kushte thelbësore, të cilat gjykata duhet t'i vlerësojë së bashku me rrethanat e çështjes në mënyrë që të vendosë për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

---

<sup>47</sup> Ligji Nr. Nr. 8812, datë 17.5.2001 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" Këto ndryshime prekën një numër të konsiderueshëm dispozitash, si p.sh. dispozitat mbi kompetencën dhe juridiksionin, mbi përfaqësuesit e palëve, mbi ngarkimin e shpenzimeve, mbi veprimet përgatitore dhe të pajtimit, ekspertin dhe thëniet e dëshmitarëve, arbitrazhin, gjykimin në apel, rekursin dhe shkaqet e rishikimit etj.

<sup>48</sup> Ligji Nr.10 052, datë 29.12.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.



Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë i ka përcaktuar këto kushte në nenin 202, i cili parashikon se: “Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur:

- a. padia mbështetet në prova me shkresë;
- b. paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni.”

Praktika gjyqësore shqiptare,<sup>49</sup> në interpretim të nenit 202 të KPrC, ka vlerësuar se në gjykimin e kërkesave për sigurimin e padisë, në mënyrë që gjykata të vendosë për marrjen e një mase sigurimi padie, të parashikuara këto të fundit në nenin 206 të K.Pr.Civile, duhet të hetojë ekzistencën e dy kushteve themelore:

- a. Ekzistenca e mundshme e një të drejtë për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë; (e njohur nga doktrina si *fumus boni juris*);
- b. Ekzistenca e frikës që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë (e njohur nga doktrina si *periculum in mora*)

### 3.1. *Fumus boni juris*

Përsa i përket kushtit të parë, *fumus boni juris*, është mëse e kuptueshme se pa ekzistencën e një të drejte nuk mund të mendohet mbrojtja e përkohshme e saj. Megjithatë, gjatë gjykimit të kërkesës për sigurim padie kërkuesi nuk ka detyrimin të provojë ekzistencën konkrete të të drejtës, kjo i takon themelit të padisë, por vetëm mundësinë e ekzistencës së saj dhe gjykatës i kërkohet vetëm verifikimi i një probabiliteti të arsyeshëm.<sup>50</sup> Gjykata e Kasacionit Italiane në një vendim të saj in vitit 1983 shprehet se: “Me qëllim vendosjen e sekuestros konservative...duhet të përmbushet kushti i *fumus boni juris*, ku verifikohet, pas një hetimi të përsheptuar, ekzistenca e mundshme e kredisë, duke ia lënë gjykimit të themelit çdo verifikim tjetër rreth ekzistencës aktuale të kredisë dhe shumës së saj...”<sup>51</sup> Edhe Gjykata e Lartë,<sup>52</sup> në lidhje me këtë kusht, ka vlerësuar se në gjykimin e kërkesës për sigurimin e padisë, nuk është e domosdoshme që të jetë vërtetuar plotësisht ekzistenca e së drejtës që është edhe objekti i shqyrtimit gjyqësor dhe që ka lidhje me themelin e çështjes, por vetëm të ekzistojë mundësia e të drejtës që kërkohet të rivendoset.

Ky vlerësim i ekzistencës së mundshme të të drejtës mund të bëhet vetëm në bazë të provave të cilat duhet të paraqiten nga kërkuesi dhe duhet të vlerësohen në mënyrë sipërfaqësore nga gjykata, sepse vlerësimi përfundimtar i tyre, në bazë të të cilave gjykata do të krijojë bindjen për themelin e padisë, duhet t’i lihet gjykimit të themelit.

<sup>49</sup> Shiko: Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 479 datë 27.10.2011; Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.370, datë 05.10.2010; Vendim i Gjykatës së Tiranës Nr. Akti 590, datë 25.06.2015; Shiko gjithashtu: Paolo Biavati, Argomenti di diritto processuale civile, Bononia University Press, Bologna 2011, fq. 660; Crisanto Mandrioli, Diritto Processuale Civile, Vol IV, Torino 2011, fq. 246.

<sup>50</sup> Paolo Biavati, Op. Cit. fq. 661.

<sup>51</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit të Italisë nr. 2672, datë 19 prill 1983 referuar në Giovanni Verde, Luigi F. Di Nanni, Codice di Procedura Civile annotato con la giurisprudenza, Vëllimi III, UTET, Torino 1990, fq. 2006.

<sup>52</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 479 datë 27.10.2011

Pikërisht ky është qëllimi i nenit 202 (a) të KPrC kur parashikon se sigurimi i padisë lejohet kur padia mbështetet në prova me shkresë. Në mungesë të tyre do të ishte e vështirë që të provohet mundësia e ekzistencës së të drejtës. Pra, ekzistenca e provave është një kusht pa të cilin nuk do të mund të lejohej marrja e masave të sigurimit, sepse nuk do të mund të vlerësohej dot përmbushja e dy kushteve: i) *fumus boni juris*, dhe ii) *periculum in mora*. Sikurse shprehet një gjykatë: “Gjykata thekson se sigurimi i padisë si institut juridik procedural civil nënkupton një vlerësim paraprak dhe sipërfaqësor të fakteve të çështjes nga gjykata, e cila nëse arrin në përfundimin se ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit të themelit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë, vendos për marrjen e masave të përshtatshme për sigurimin e padisë, sipas nevojave të rastit konkret.”<sup>53</sup>

Megjithatë konstatojmë se neni 202 i KPrC nuk është shumë qartazi i formuluar nga pikëpamja e teknikës legjislative, në pjesën që parashikon se: “Sigurimi i padisë lejohet kur:

- a. padia mbështetet në prova me shkresë;
- b. paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni.”

Nga mënyra e formulimit të kësaj dispozite natyrshëm lind pyetja nëse kërkesat e parashtruara në pikën a dhe b janë kumulative, apo mjafton plotësimi i njërës prej tyre? Thënë ndryshe, a mund të jepet masa e sigurimit vetëm nëse ka prova shkresore, ose vetëm nëse jepet garanci për dëmin që mund të vijë nga dhënia e masës së sigurimit, apo duhet që ekzistenca e provave dhe dhënia e garancisë të plotësohen njëkohësisht? Ndërmjet parashikimit të pikës (a) dhe (b) nuk është vendosur asnjë lidhëz si “dhe” apo “ose” që do të ndihmonte disi për t’i dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme. Megjithatë fakti që në fund të dispozitës është parashikuar se garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni, lë të kuptohet që si rregull paragrafi (a) dhe (b) janë parashikuar si kushte alternative dhe jo kumulative dhe përjashtimisht mund të kërkohet zbatimi kumulativ i tyre. Por në fakt gjykojmë se nëse masa e sigurimit mund të merret nëse plotësohet vetëm kushti i parë, pra ekzistenca e provave shkresore, nuk mund të themi që ajo mund të merret vetëm nëse jepet garanci për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit nga dhënia e masës së sigurimit. Kjo, sepse sikurse u shprehëm më sipër ekzistenca e provave shkresore është shumë e rëndësishme për të individualizuar objektin e mosmarrëveshjes dhe për të bërë vlerësimin e ekzistencës së mundshme të të drejtës (*fumus boni juris*) dhe rrezikut të dëmit nga vonesa në dhënien e vendimit përfundimtar (*periculum in mora*). Nëse do të pranohet që mjafton dhënia e garancisë për dëmin e mundshëm që mund të shkaktohet nga masa e sigurimit për dhënien e kësaj mase, do të na duhej të mohonim rëndësinë që kanë dy kushtet, *fumus boni juris* dhe *periculum in mora* për dhënien e masës së sigurimit, sepse vlerësimi i tyre nuk mund të bëhet pa u paraqitur që paku disa prova.

Rëndësia e paraqitjes së provave shkresore në gjykimin e kërkesës për sigurim padie reflektohet qartë edhe praktikën gjyqësore shqiptare. Në një çështje,<sup>54</sup> gjykata shprehet: “Në këtë kontekst vlerësimi gjyqësor i mundësisë së sigurimit të objektit të

<sup>53</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 509, datë 09. 07. 2013

<sup>54</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. akti 590, datë 25.06.2015; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 535, datë 08. 06. 2015; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 57, datë 15.01.2014

padisë duhet të mbështetet në analizën e **provave shkresore** të cilat: *1. parashtrojnë fakte në lidhje me marrëdhënien juridike objekt konflikti mes palëve. 2. mundësojnë vlerësimin nga gjykata të ekzistencës së rrezikut të pamundësisë apo vështirësisë së ekzekutimit të ardhshëm të të drejtave të paditësit.*” Gjithashtu gjykatat janë shprehur se gjykata përjashton çmimin dhe cilësimin e fakteve në drejtim të themelit të mosmarrëveshjes, duke u kufizuar në krijimin e perceptimit të përgjithshëm të mosmarrëveshjes së pretenduar, në funksion të sigurimit të objektit të padisë, sepse sikurse janë shprehur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim.<sup>55</sup>

Jo të pakta kanë qenë rastet kur kërkesat për sigurimin e padisë janë rrëzuar për shkak se kërkuesi nuk ka paraqitur prova të cilat do e mundësonin gjykatën të vlerësonte ekzistencën e *fumus boni juris* dhe *periculum in mora*. Për shembull, në një vendim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur:

“Gjykata pa u ndalur në analizën e të gjitha kritereve të mësipërme procedurale në lidhje me sigurimin e objektit të padisë çmon se kërkesa objekt gjykimi nuk mbështetet në prova shkresore që i mundësojnë gjykatës vërtetimin e ekzistencës së të drejtës që do të mbrohet në gjykimin e padisë së themelit.

Paditësi paraqiti si provë në mbështetje të kërkesës për sigurimin e padisë vetëm vërtetimin e pronësisë së apartamentit të tij, por gjatë gjykimit nuk u administrua asnjë provë në lidhje me realizimin e punimeve ndërtimore pa lejë nga personi i tretë në tarracën e pallatit dhe mbi apartamentin ku banon kërkuesi.

Masa e sigurimit objekt gjykimi synon të sigurojë padinë e ardhshme gjyqësore në lidhje me pushimin e cenimit të pronësisë së kërkuetit nga personi i tretë. Në këtë kontekst çmohet e nevojshme të provuarit përpara gjykatës të veprimeve cenuese të ndërmarra nga personi i tretë, që në rastin objekt gjykimi lidhen me realizimin e një ndërtimi pa leje mbi apartamentin, pronësi e kërkuetit. Gjatë gjykimit kërkuesi nuk paraqiti asnjë provë për të provuar kryerjen e punimeve ndërtimore nga personi i tretë mbi apartamentin e tij të banimit, mungesën e lejes nga organet kompetente administrative apo ndonjë provë në lidhje me cenimin e pronësisë të ardhur si pasojë e veprimeve të paligjshme të personit të tretë.

Për më tepër që masa e sigurimit e kërkuar në këtë gjykim lidhet me pezullimin e punimeve ndërtimore, të cilat nuk provohen se janë duke u kryer nga personi i tretë.

Mungesa e provave në drejtim të veprimeve cenuese të pronësisë nga personi i tretë e bën të pamundur vlerësimin gjyqësisht të nevojës së marrjes së masës së sigurimit për garantimin e ekzekutimit të vendimit të ardhshëm gjyqësor, në kushtet kur nuk vërtetohet me prova ekzistenca e së drejtës së cenuar që kërkohet të rivendoset në padinë e themelit.”<sup>56</sup>

Po ashtu në të tjera çështje, gjykata është shprehur se: “Në rastin konkret objekt gjykimi, gjykata çmon se kërkimi i kërkuetit është i pambështetur në prova të tilla të paanshme, që të mundësojnë që gjykata të vlerësojë mbi rrezikun e shkaktimit të një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për paditësit. ... Fakt tjetër që mbahet në konsideratë nga gjykata është edhe mos paraqitja e provave për regjistrimin në ZVRPP Tiranë të sendit të paluajtshëm për të cilin kërkohet vendimmarrja e

<sup>55</sup> Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.10, datë 24.10.2004

<sup>56</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 57, datë 15.01.2014

gjykatës.”;<sup>57</sup> ose se: “Gjatë gjykimit të kërkesës asnjëra nga shoqëritë nuk paraqiti prova që të provojë në gjykatë faktin se shoqëria “Eco Beton” Shpk ka ndonjë detyrim të qartë dhe konkret ndaj tyre. Jo vetëm kjo, por asnjëri nga kërkuesit nuk arriti të specifikonte cili është detyrimi, sa është vlëra e tij dhe si ka lindur ky detyrim. Gjithashtu asnjëri nga kërkuesit nuk arriti të vërtetonte shkakun e lindjes së këtij detyrimi. Në kushtet e mësipërme, kërkesa e paraqitur nga kërkuesit është tërësisht konfuze, e pamotivuar dhe e pabazuar në prova. Nga njëra anë kërkues është shoqëria “Rei Energji” Shpk ndërkohë dhe në përmbajtje të kërkesës parashtrohet se teprica monetare është krijuar nga shitja e saj në ankand gjatë zhvillimit të një procedurë përmbartimore. Në gjykim kërkuesit nuk arritën të shpjegojnë dhe as të vërtetojnë pretendimet potenciale të tyre në padinë e ardhshme si dhe nuk paraqitën dokumentet e nevojshme shkresore referuar këtyre parashtrimeve.

Kërkesa për sigurimin e padisë ka si parakusht të saj argumentimin ligjor dhe faktik se ekziston një e drejtë e ligjshme e pretenduar si e cenuar dhe që eventualisht mund të pranohet si e tillë nga gjykata në vendimin e saj përfundimtar, por realizimi i kësaj të drejte nëpërmjet ekzekutimit mund të rrezikohet dhe të mos sjellë për pasojë rivendosjen realisht në vend të drejtave të cenuara.

Bazuar në sa më lart, gjykata, konkludon se kërkesa e paraqitur është haptazi e pabazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të rrëzohet.”<sup>58</sup>

Në vendet e *common law*, si p.sh. në Angli parimit të *fumus boni juris* i referohen me ermin “*çështja prima facie*”<sup>59</sup>. Praktika ka qenë e dyzuar në lidhje me standardin e vlerësimit të këtij kushti. Kështu, një linjë e çështjeve tregon që kërkuesit i kërkohe vetëm të provojë se ka një çështje për tu gjykuar.<sup>60</sup> Ndërkohë që një linjë tjetër çështjesh duket se kërkon zbatimin e një testi më kërkues, të tillë si probabiliteti se pretendimi i paditësit i ngritur në padinë e themelit është i bazuar.<sup>61</sup> Një variant tjetër ka qenë kërkesa për vlerësimin *prima facie* se e drejta që kërkon të mbrohet ekziston faktikisht,<sup>62</sup> e njohur ndryshe dhe si “*çështja prima facie*”. Një shpjegim të këtij koncepti e ndeshim në vendimin e çështjes *Challender k. Royle*<sup>63</sup> ku gjykata është shprehur se: “*çështja prima facie* është kur nëse provat mbeten ato që janë, ka mundësi që gjatë gjykimit të padisë, të merret një vendim në favor të paditësit.” Kriteri i “*çështjes prima facie*” u konsiderua se vendoste një barrë më të rëndë për kërkuesin sesa kriteri për të provuar se ekziston një çështje për tu gjykuar.<sup>64</sup> Megjithatë, pati përpjekje për të bashkërenduar këto dy kritere. U sugjerua që ndërkohë që paditësi duhet të provonte *prima facie* të drejtën e pretenduar, ai mund ta bënte këtë duke dhënë argumente për shkeljen e kësaj të drejte.<sup>65</sup> Nuk ka arsye të bëhet dallim ndërmjet standardit për të provuar të drejtën dhe standardit për të provuar shkeljen e së drejtës. Dhe në fakt dallimi ishte jetëshkurtër.<sup>66</sup> Por ky standard - masa e sigurimit do të jepej vetëm nëse kërkuesi do të provonte *prima facie* suksesin mbi

<sup>57</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 240, datë 07.03.2014

<sup>58</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 403, datë 21.04.2015

<sup>59</sup> *Prima facie* case

<sup>60</sup> Jones kundër Pacaya Rubber and Produce Co Ltd [1911] 1 KB fq. 455-457 në të cilën thuhej se paditësi duhet të provojë që ekziston një çështje për tu gjykuar.

<sup>61</sup> Preston v Luck (1884) 27 Ch D fq. 497-506.

<sup>62</sup> Smith kundër Grigg Ltd [1924]1 KB fq. 655-659; Canvedish House (Cheltenham) Ltd kundër Cavendish –Woodhouse Ld [1970] RPC fq. 234.

<sup>63</sup> Challender kundër Royle (1887) 36 CH D fq. 425

<sup>64</sup> Zuckerman, op. Cit. Fq. 406

<sup>65</sup> Donmar Productions kundër Bart [1967] 2 All ER 324.

<sup>66</sup> Hubbard kundër Vosper [1972] 2 QB 84 cituar në Zuckerman, op. Cit. footnote 61, fq 406.

themelin e çështjes- vazhdoi të aplikohet deri në vitin 1974,<sup>67</sup> pasi kjo praktikë ndryshoi pas vendimit të Dhomës së Lordëve në çështjen *American Cyanamid Ltd k. Ethicon Ltd*.<sup>68</sup> Pas këtij vendimi, mundësia e suksesit të themelit të padisë nuk luante pothuajse asnjë rol. Pra, standardi që u vendos pas këtij vendimi ishte se gjykata në shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë nuk duhet të merrte aspak në shqyrtim themelin e çështjes, qoftë edhe *prima facie*. Megjithëse pati shumë kritika ndaj këtij vendimi<sup>69</sup> gjykatat nuk e kundërshtuan pikëpamjen që themeli nuk luan asnjë rol.<sup>70</sup> Megjithatë gjyqtarët vazhduan të influencoheshin nga vlerësimi i tyre mbi mundësitë e suksesit që mund të kishin palët mbi themelin e çështjes<sup>71</sup> dhe shumë shpejt filluan të nxjerrin dhe përjashtimet nga parimi i vendosur pas çështjes *American Cyanamid*.<sup>72</sup> Standardi i vendosur nga kjo çështje vazhdoi të zbatohet deri vonë, madje në çështjen *Series 5 Software Ltd kundër Clarke*<sup>73</sup> gjykatësi Laddie u shpreh:

“Lord Diplock [në *American Cyanamid*] nuk donte ...të përjashtonte shqyrtimin e mundësisë së suksesit të themelit të padisë në të gjitha rastet e kërkesave për masa sigurimi. Mua më duket se ajo çka ai kishte për qëllim është që gjykata nuk duhet të përpiqet të zgjidhë çështje të vështira fakti ose ligji gjatë procesit të gjykimit të kërkesave për sigurim padie. Nga ana tjetër, nëse gjykata mund të vlerësojë në bazë të provave të besueshme mundësinë e suksesit të palëve mbi themelin e çështjes, atëherë ajo mund ta bëjë këtë....”

Tashmë, pas interpretimit të Këshillit të *American Cyanamid* në çështjen *National Commercial Bank Jamaica k. Olint Corp*.<sup>74</sup> nuk ka më dyshime se mundësia e palëve për të pasur sukses mbi themelin e çështjes është një element i rëndësishëm në

---

<sup>67</sup> Neil H. Andrews, “Accelerated Justice: Protective, Interim and Summary Procedures in English Law”, botuar në “Current Topics of International Litigation”, redaktuar nga Rolf Sturmer dhe Masanori Kawano, Vëllimi I, Mohr Siebeck, 2009.

<sup>68</sup> *American Cyanamid Ltd k. Ethicon Ltd* [1975] AC 396, [1975] 1 All ER 504 HL. Cyanamid patentoi dhe filloi të tregtojë një material të ri të shpikur për qepjet kirurgjikale. Ethicon, i cili kishte dominuar tregun me një produkt të bërë nga zorrët, u përgjigj duke tregtuar fijet e saj artificiale. Cyanamid ngriti padi për shkelje të të drejtave të patentës dhe kërkoi masë për sigurim padie përpara se të fillonte gjykimi i themelit. Gjyqtari, çmoi se Cyanamid provoi *prima facie* ekzistencën e të drejtës dhe shkeljen e saj prandaj e dha masën e sigurimit. Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin duke argumentuar se nuk kishte shumë mundësi që produkti i të paditurit të cenonte patentën e Cyanamid dhe për rrjedhojë paditësi nuk kishte arritur të provonte *prima facie* shkeljen e të drejtës. Pra, nga kjo nënkuptohet që me qëllim që të plotësohet kriteri i “çështjes *prima facie*” paditësi duhet të provonte që kishte mundësi që të fitonte padinë. Në ankimin që u bë në Dhomën e Lordëve, Lordi Diplock shpjegoi se, ajo çka duhet të provonte kërkuesi ishte që “padia e tij nuk ishte e pavlerë apo e parëndësishme, me fjalë të tjera që ekzistonte një çështje serioze për tu gjykuar.”

<sup>69</sup> Shiko Gore, “Interlocutory Injunctions – A final judgement” (1975) 38 M.L.R. fq., 672. P. Elias, “Pickets and Inerlocutory Injunctions”, (1975) C.L.J. 191; Wallington, “Injunctions and the right to demonstrate” (1976) 35 C.L.J. fq. 82.

<sup>70</sup> *Fellowes kundër Fisher* [1976] QB fq. 122; *Hubbard kundër Pitt* [1976] QB fq. 142

<sup>71</sup> C. Grey “Interlocutory Injunctions since *Cyanamid*” (1981) 40 C.L.J. fq. 307, cituar në Zuckerman op.cit fq. 409.

<sup>72</sup> Shkurtime, përjashtim bëjnë çështjet shumë urgjente, çështjet e transparencës, lirisë së shprehjes, çështje të rëndësishme publike etj. Për më shumë rreth përjashtimeve shiko: Neil H. Andrews, “Accelerated Justice: Protective, Interim and Summary Procedures in English Law”, botuar në “Current Topics of International Litigation”, redaktuar nga Rolf Sturmer dhe Masanori Kawano, Vëllimi I, Mohr Siebeck, 2009, fq. 42-44.; Zuckerman op. Cit. Fq. 409-414.; Neil Andrews, “The modern civil process, Judicial and alternative forms of dispute resolution in England”, Mohr siebeck, 2008, fq. 81-83; O’Hare and Browne, “Civil Litigation”, Botimi i 15-të, Sweet & Maxwell, 2011, fq. 429-433.

<sup>73</sup> *Series 5 Software Ltd kundër Clarke*

<sup>74</sup> *National Commercial Bank Jamaica kundër Olint Corp*, [2009] UKPC fq. 16

vlerësimin e kërkesave për marrjen e masave të sigurimit të padisë. Në këtë çështje Këshilli u shpreh:

“Midis çështjeve që gjykata duhet të marrë në konsideratë janë dëmi që mund të pësojë paditësi nëse nuk jepet një masë siguroese, ose i padituri nëse jepet një masë e tillë; mundësia që një dëm i tillë të shkaktohet faktikisht, masa në të cilën ai dëm mund të kompensohet nëpërmjet një vendimi për shpërblim dëmi; mundësia që ka secila palë për të përmbushur detyrimet e ngarkuara me një vendim të tillë dhe mundësia që masa siguroese të jetë dhënë ose refuzuar gabimisht, që do të thotë, opinioni i gjykatës për forcën relative të argumenteve të palëve për çështjen.”

Mundësinë e suksesit të themelit të padisë e ndeshim si kusht për marrjen e masave të sigurimit edhe në praktikën gjermane.<sup>75</sup> Megjithëse ka pasur edhe argumente se ky nuk duhet të jetë një kusht thelbësor për marrjen e masave të përkohshme, veçanërisht për ato që synojnë të ruajnë *status quo*.<sup>76</sup> Edhe qëndrimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë deri vonë ka qenë i tillë që nuk vlerësonte suksesin *prima facie* të çështjes si një nga kriteret për vendosjen e masës së sigurimit. Në një opinion të ndarë në çështjen *Pulp Mills*<sup>77</sup> të kësaj Gjykate në vitin 2006, Gjyqtari Abraham i rekomandoi Gjykatës t’i kërkojë palës që kërkonte vendosjen e masës së sigurimit, që kjo e fundit të tregonte një “çështje bindëse”. Për Gjyqtarin Abraham “pikëpamja e përhapur” që ka një “vizë të qartë ndarëse” mes (a) ekzistencës dhe shtrirjes së të drejtave të mosmarrëveshjes, një çështje që nuk mund të konsiderohet, edhe në baza *prima facie* përpara fazës së themelit të çështjes dhe (b) nevojës për masa sigurimi, që duhet të vlerësojë gjykata “pa ndonjë mendim mbi themelin e argumenteve të parashtruara në procedurën kryesore” ishte vetëm virtuale. Gjyqtari Abraham arsyetoi se gjykata shtetërore ose gjykata e arbitrazhit nuk duhet të vendosin detyrime ndonjëherë nga palët, pa pasur një ide që ka “disa arsye për tu besuar” që pala kërkuese ka një ngritur një padi të vlefshme.<sup>78</sup>

Së fundmi, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (ICJ) ka pranuar si kriter për vlerësimin në vendosjen e masës së sigurimit edhe një sukses *prima facie* të çështjes, sipas propozimit të gjyqtarit Abraham. Në çështjen *Belgium vs. Senegal* në vitin 2009, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në vendimin e saj, ndër të tjera arsyetoi se : “Tagri i Gjykatës për të vendosur masa sigurimi do të ushtrohet vetëm nëse gjykata do të krijojë bindjen se të drejtat e pretenduara nga pala janë të paktën bindëse.”<sup>79</sup> Gjykata mund të vendosë dhënien e masave të sigurimit nëse dispozitat në të cilat mbështetet pala kërkuese duken, *prima facie*, se përbëjnë bazën ku do të mbështetet juridiksioni i gjykatës” Ndërsa në çështjen *Costa Rica vs Nicaragua*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë u shpreh se: “Tagri i Gjykatës për të vendosur masa sigurimi do të ushtrohet vetëm nëse Gjykata do të krijojë bindjen se të drejtat e pretenduara nga pala

<sup>75</sup> Petter L. Murray, Rolf Sturmer, German Civil Justice, Carolina Academic Press, 2004, fq.434; Baur, Sturmer, Einzelvollstreckungsrecht mn. 53.23

<sup>76</sup> Leipold, Op. Cit. Fq.88

<sup>77</sup> <http://www.icj-cij.org/docket/files/135/11240.pdf>

<sup>78</sup> Donald Francis Donovan “Provisional Measures in the ICJ and ICSID: Further dialogue and development”, botuar në Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation, The Fordham Papers 2012, fq. 106, para. 4.

<sup>79</sup> Belgium vs. Senegal, International Court of Justice, Request for the indication of provisional measures, datë 28 Maj 2009, fq. 12, para. 40  
<http://www.icj-cij.org/docket/files/144/15149.pdf>

janë të paktën bindëse dhe se ekziston një lidhje midis të drejtave objekt gjykimi dhe masave të sigurimit të kërkuara.”<sup>80</sup>

### 3.2. *Periculum in mora*

Kodi i Procedurës Civile parashikon se me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.<sup>81</sup> Pra, ekzistenca e frikës që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë është kushti i dytë që duhet të plotësohet për dhënien e masave të sigurimit, e cila njihet nga doktrina si *periculum in mora*.

Në doktrinën italiane, kur flitet për *periculum in mora*, si kushti i dytë për marrjen e masave të sigurimit, bëhet dallimi i tij në dy kategori.<sup>82</sup>

- a. Rreziku i mosekzekutimit të vendimit të themelit;
- b. Rreziku nga vonesa në dhënien e vendimit të themelit.

Me rrezikun e mosekzekutimit të vendimit të themelit nënkuptohet rreziku që gjatë kohës së nevojshme për zhvillimin e procesit të themelit, mund të ndodhin fakte të tilla që e bëjnë të pamundur ose të vështirë mundësinë e ekzekutimit konkret të vendimit të themelit. Si shembull tipik i rrezikut të mosekzekutimit të vendimit të themelit mendohet se është rreziku që synohet të eliminohet me anë të masave të tilla të sigurimit si sekuestroja konservative. Calamandrei<sup>83</sup> shkruante se në këto raste masa e sigurimit nuk synon të përshpejtojë rivendosjen e të drejtës objekt konflikti, por vetëm të sigurojë para kohe mjetet në mënyrë që ekzekutimi i detyrueshëm i asaj të drejte (pagimi i një shume apo dorëzimi i një sendi) të jetë i mundur të realizohet në mënyrë të frytshme. Pra, me fjalë të tjera, ajo që është urgjente nuk është rivendosja e të drejtës, por siguri i përkohshëm i mjeteve të tilla që do të bëjnë të mundur ekzekutimin efektiv të të drejtës së njohur me një vendim përfundimtar.

Me rrezikun nga vonesa e vendimit të themelit nënkuptohet rreziku që mund t'i vijë rivendosjes së të drejtës thjesht nga zgjatja e procesit. Shembull tipik i llojit të masave që synon të shmangë këtë rrezik është pezullimi i ekzekutimit. Në këto raste, masa e sigurimit synon rivendosjen e parakohshme të të drejtës në mënyrë të përkohshme, për shkak se *periculum in mora* nuk vjen nga ndryshimi i rrethanave të faktit apo të të drejtës në të cilat do të bazohet vendimi i themelit, por pikërisht nga zgjatja, gjatë vonesave të procesit të zakonshëm, e gjendjes së mospërmbushjes së të drejtës, e cila pretendohet gjatë gjykimit të themelit në një proces të zakonshëm.<sup>84</sup>

Pra, nëse në prezencë të rrezikut të mosekzekutimit të vendimit të themelit, masa e sigurimit synon të parandalojë dëmin që mund të vijë gjatë vonesave të procesit nga ndryshimi i fakteve që mund të pengojnë realizimin e të drejtës objekt konflikti, në prezencë të rrezikut nga vonesa, masa e sigurimit duhet të pengojë, përmes teknikës

---

<sup>80</sup> Costa Rica v. Nicaragua, Request for the indication of provisional measures, international court of justice, date 8 Mars 2011, faqe 2, paragrafi 5, <http://www.icj-cij.org/docket/files/150/16322.pdf>

<sup>81</sup> Neni 202 i KPrC

<sup>82</sup> Andrea Proto Pisani, “Lezioni di diritto processuale civile”, Botimi i V, Jovene Editore, Napoli 2006, fq. 600.

<sup>83</sup> P. Calamandrei, “Introduzione allo studio sistematico dei provvedimenti cautelari”, Padova 1936 dhe në Opere giuridiche, IX, Napoli 1983

<sup>84</sup> Idem

së rivendosjes së parakohshme të të drejtës objekt konflikti, dëmin që vazhdimi i një situatë antiligjore mund t'i shkaktojë të drejtës.<sup>85</sup>

Ndërsa në Shqipëri, referuar nenit 202 të KPrC, i cili parashikon se gjykata lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë, duket se i vetmi *periculum* për të cilin mund të lejohet masa e sigurimit është ai që përfshihet në kategorinë e parë, pra rreziku i mosekzekutimit të vendimit të themelit. Kjo madje përforcohet edhe nga fakti që me ndryshimet e fundit që i janë bërë dispozitave të KPrC në vitin 2013 nuk lejohet më marrja e masave të sigurimit të padive që ngrihen në fazën e ekzekutimit,<sup>86</sup> çfarë do të thotë se nuk mund të kërkohet si masë sigurimi pezullimi i ekzekutimit të një titulli ekzekutiv p.sh. në rastin kur do të ngrihet një padi për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, e cila ishte një masë tipike që binte në kategorinë e dytë të *periculum*, si dhe është ndryshuar dispozita që parashikonte edhe pezullimin e ekzekutimit si një nga llojet e masave që mund të japë gjykata.<sup>87</sup>

Së fundmi, praktika gjyqësore në zbatim të këtyre ndryshimeve të KPrC ka rrëzuar kërkesat për sigurimin e padive që ngrihen në fazën e ekzekutimit.<sup>88</sup> Megjithatë kjo nuk do të thotë se pezullimi i ekzekutimit të një titulli ekzekutiv nuk lejohet, por vetëm se ai nuk mund të kërkohet në bazë të dispozitave të posaçme për masat e sigurimit. Si rrjedhojë e kësaj për shembull pezullimi i ekzekutimit të një titulli ekzekutiv mund të kërkohet vetëm së bashku me ngritjen e padisë gjatë fazës së ekzekutimit, dhe jo përpara ngritjes së saj referuar nenit 204 të KPrC. Theksojmë se neni 609 dhe 610 i KPrC parashikon shprehimisht mundësinë e pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv në rastet kur është ngritur një padi për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, ose padi për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit. Konkretisht nenit 609 parashikon se: “Në këto raste, gjykata mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit, vetëm me garanci dhe për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, përveç rasteve kur gjykata, brenda këtij afati, vendos me vendim përfundimtar pranimin e padisë. Me kalimin e afatit 3-mujor, ose kur gjykata, brenda këtij afati, vendos refuzimin e padisë ose pushimin e gjykimit të saj, masa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit konsiderohet e rënë nga fuqia.” Kurse neni 610 përcakton se: “Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit.”

Në lidhje me pezullimin e ekzekutimit si një nga llojet e masave që parashikoheshin në nenin 206 të KPrC, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 10, datë 24.03.2004 janë shprehur se: “Kjo dispozitë përmban në vetvete

<sup>85</sup> Tommaso, “I provvedimenti d’urgenza”, Padova, 1983.

<sup>86</sup> Neni 23 i ligjit nr.122 /2013 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile” Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij kodi.

<sup>87</sup> Neni 24 i ligjit nr.122 /2013 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile” Në nenin 206 paragrafi i parë, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë: “b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata.”

<sup>88</sup> Shiko: Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti, 106, datë 06.01.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti, 107, datë 12.01. 2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti, 559, datë 16.06.2014



një paqartësi lidhur me aktin apo veprimin, ekzekutimi i të cilit kërkohet të pezullohet. Në këto raste kemi të bëjmë, si rregull, me padi në të cilat paditësi kërkon detyrimin e të paditurit të mos verë në ekzekutim një akt nëpërmjet të cilit tërheq përfitime. Në këto raste marrja e masave të përkohshme të sigurimit të padisë synon “ta mbajë gjendjen ashtu siç është”, apo “të ngrirë”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila, për vetë natyrën e çështjes, duhet të realizohet nëpërmjet një procedure të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithsesi, që të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor.”

Pra, referuar analizës së mësipërme të Gjykatës së Lartë duket se në fakt mund jepen edhe masa sigurimi që bien në kategorinë e dytë të *periculum in mora*, atë të rrezikut të dëmit të riparueshëm që mund t’i shkaktohet të drejtës nga vonesa në dhënien e vendimit, për shmangien e të cilit zakonisht jepen masa që synojnë të ruajnë *status quo*, sikurse mund të jenë për shembull ndalimi i shitjes së kuotave, ndalimi i kryerjes së punimeve etj., të cilat jo në pak raste janë dhënë nga gjykatat shqiptare.<sup>89</sup> Por në këtë kategori të *periculum* shpesh bien edhe ato masa që bëjnë të mundur rivendosjen e parakohshme të të drejtës objekt konflikti, pra objekti i të cilave shpesh është i njëjtë me objektin e padisë së themelit, sikurse mund të jetë për shembull detyrimi për vazhdimin e një kontrate. Gjykatat shqiptare janë shumë të ngurta në dhënien e këtyre masave duke marrë shkas nga Vendimi Unifikues i GJL, i përmendur më sipër, i cili parashikon se: “Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohshme të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri. E thënë ndryshe, masa e përkohshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërimit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë.” Më gjerësisht llojet e masave të sigurimit që mund të japin gjykatat shqiptare do të trajtohen në kapitullin vijues.

Sikurse u përmend më sipër, gjykata si me pranimin apo refuzimin e kërkesës për sigurim padie mbart riskun e dëmtimit të të drejtave. Nëse pranohet kërkesa e paditësit për sigurim padie ka mundësi që nëse padia e paditësit nuk pranohet, gjykata të ketë dëmtuar të drejtat e të paditurit. Dhe anasjelltas, nëse gjykata refuzon kërkesën e paditësit për sigurim padie dhe padia e tij pranohet me vendimin përfundimtar, ekziston mundësia që gjykata të ketë dëmtuar të drejtat e paditësit. Ndaj vlerësimi i *periculum* dhe i urgjencës kryesisht lidhet me gjetjen e ekuilibrit midis interesave të kundërta të palëve.<sup>90</sup>

Për fat të keq praktika gjyqësore shqiptare nuk na ofron ndonjë analizë të pasur të mënyrës se si vlerësohet rreziku. Por nëse i referohemi praktikës gjyqësore italiane do të shohim se ka një sërë elementesh që duhet të merren për bazë në vlerësimin e *periculum*. Kështu, për kategorinë e parë të *periculum*, atë të *rrezikut të mosekzekutimit të vendimit themelit*, rreziku nuk duhet të konsistojë vetëm në frikën subjektive të kreditorit se do të humbasë kredinë e tij, por duhet t’i korrespondojë një situatë rreziku konkret dhe objektiv, ku konkretizohet mundësia që pasuria e debitorit të zhduket apo të pakësohet<sup>91</sup> dhe jo domosdoshmërisht në një situatë aktuale të humbjes së pasurisë së debitorit; është e mjaftueshme edhe që humbja të jetë thjesht e mundshme, me kusht që të justifikonte frikën se garancia do të pakësohej. Vlerësimi

<sup>89</sup> Shiko për shembull: Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 276, datë 13.03.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 955, datë 26.11.2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 283, ddatë 03.04. 2013

<sup>90</sup> Biavati, op. cit. fq. 662

<sup>91</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 1448, datë 15 shtator 1970; Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 1973, datë 30 maj 1969

mund të realizohet duke iu referuar qëndrueshmërisë së pasurisë së debitorit, ose duke iu referuar elementeve subjektivë, të tilla si sjellja gjyqësore dhe jashtëgjyqësore e debitorit, e cila krijon tek kreditori dyshimin e arsyeshëm se pretendimi i tij nuk do të përmbushet.<sup>92</sup> Frika për humbjen e garancisë së kredisë vlerësohet edhe në bazë të qëllimit të shprehur të debitorit, apo deklaratave dhe pohimeve të tij që janë tregues të qëllimit për t'iu shmangur pagesës së detyrimi, kështu që frika nuk është vetëm për shkak të mungesës së pasurisë së debitorit, por mbi të gjitha edhe nga mundësia – dhe kjo për tu vlerësuar me shumë kujdes - që edhe duke pasur pasurinë e mjaftueshme debitori do të pengojë kreditorin të realizojë të drejtën e tij.<sup>93</sup> Pra, ekzistenca e *periculum in mora* mund të vlerësohet si nga elementet objektivë, që lidhen me qëndrueshmërinë sasiore dhe cilësore të pasurisë së debitorit, ashtu dhe nga elemente subjektivë, që lidhen me sjelljen e debitorit, të cilët e bëjnë të besueshëm mundësinë e pakësimit të pasurisë dhe shprehin qëllimin e tij për t'iu shmangur përmbushjes së detyrimeve, në mënyrë të tillë që krijon tek kreditori dyshimin e arsyeshëm se pretendimi i tij nuk do të përmbushet.<sup>94</sup>

Gjykatat angleze kanë shkuar edhe më tej në interpretimin e *periculum in mora*, duke përcaktuar se për dhënien e masës së sigurimit duhet të ketë një rrezik real dhe për këtë duhet të ketë prova të qarta dhe të forta.<sup>95</sup> Pandershmëria e pretenduar apo e provuar e të paditurit në vetvete nuk është e mjaftueshme për të justifikuar konkluzionin se ekziston një rrezik real për zhdukjen e pasurisë. Për të justifikuar një konkluzion të tillë duhet të merren në konsideratë të gjitha rrethanat.<sup>96</sup> Megjithatë kur paditësi mund të provojë se i padituri ka një histori shmangiesh nga detyrimet kontraktuale, gjykata do të kishte më shumë gjasa të konkludonte se ekziston rreziku i zhdukjes së pasurisë.<sup>97</sup>

Ndërkohë që për kategorinë e dytë të *periculum*, atë nga vonesa në dhënien e vendimit mbi themelin, gjykata justifikohet në dhënien e një mase sigurimi vetëm nëse është e nevojshme për të shmangur një dëm të pariparueshëm. Kërkuesi, i cili nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut për ndonjë dëm të pariparueshëm duhet të presë dhënien e vendimit përfundimtar përpara se të rivendosë të drejtën e tij. Por përcaktimi i dëmit të pariparueshëm është pak i vështirë. Ndonjëherë dëmi konsiderohet i pariparueshëm, sepse pala që është e ekspozuar ndaj tij nuk do të ketë mundësi të dëmshpërblehet nga pala tjetër, pasi nuk ka asete të mjaftueshme. I tillë konsiderohet dhe rasti kur dëmi nuk do të mund të llogaritej. Pasiguria në vlerësimin e dëmit zakonisht jepet si arsye për dhënien ose jo të masave të sigurimit në çështjet që lidhen me markat tregtare.<sup>98</sup> Dëmi mund të jetë gjithashtu i pariparueshëm, sepse ligji nuk parashikon dëmshpërblim për të.<sup>99</sup> Por ndonjëherë dëmi konsiderohet i pariparueshëm, sepse kompensimi, megjithëse është praktikisht i mundshëm, gjykohet

<sup>92</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 200, datë 22 janar 1976

<sup>93</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 2251, datë 22 maj 1987

<sup>94</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 69, datë 9 janar 1987; Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 4906, datë 10 gusht 1998; Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 2172, datë 8 prill 1982

<sup>95</sup> Laemthong International Lines Co Ld kundër ARTIS [2005]1 Lloyd's Rep 100.

<sup>96</sup> Irish Response Ltd kundër Direct Beauty Products [2011] EWHC 37 (QB)

<sup>97</sup> Linsen International kundër Humpuss Sea Transport PTE LTD [2010] EWHC 303 (Com)

<sup>98</sup> Shiko për shembull: Kay kundër Robertson[1991] F.S.R 62; Entec (Pollution Control)Ltd kundër Abacus Mouldings [1992] F.S.R. 332; Waterlow Directoies Ltd kundër Reed Information Services Ltd [1992] F.S.R. 409 cituar në Zuckerman, op.cit. fq. 416.

<sup>99</sup> Për shembull nëse gjykata refuzon të urdhërojë një shoqëri të shtyjë mbledhjen vjetore të Asamblesë së Përgjithshme, aksionarët që do të kishin nevojë për më tepër kohë për të lobuar do të humbisnin mundësinë për të gjetur mbështetje për propozimin e tyre (Cayne kundër Global Natural Resources Plc [1984] 1 All ER 225 CA) dhe nëse shtyrja do të ishte urdhëruar shoqëria do të humbiste mundësinë e zhvillimit të mbledhjes në një moment më të hershëm.

se nuk është i përshtatshëm.<sup>100</sup> Konsiderohet si kompensim i papërshtatshëm në çdo rast kur e drejta objekt konflikti zakonisht nuk mund të ketë një vlerësim ekonomik. Për shembull, paditësit që i cenohet liria e shprehjes në një rast të caktuar mund të mos ketë asnjë interes monetar në ushtrimin e saj dhe për rrjedhojë mund të mos e konsiderojë shpërblimin e dëmit si një shpërblim të drejtë për mohimin e saj.<sup>101</sup> Por ka pasur edhe raste ku kompensimi është konsideruar i papërshtatshëm edhe pse e drejta e cenuar mund të kishte një vlerësim ekonomik. Kështu për shembull, është gjykuar se dëmshpërblimi nuk është i përshtatshëm për dëmin e të qënurit i papunë edhe pse një nga përfitimet kryesore që rrjedh nga puna është ai ekonomik. Kjo sepse punësimi nuk jep vetëm përfitimin material, por gjithashtu edhe një ndjenjë kënaqësie, arritjeje dhe mirëqenieje, të cilat e tejkalojnë vlerën ekonomike të punësimit.<sup>102</sup>

Doktrina italiane ka zhvilluar tri teza kryesore lidhur me individualizimin e kritereve të nevojshëm për të përcaktuar se kur dëmi është në kufijtë e të qënurit i pariparueshëm.<sup>103</sup>

Sipas tezës së parë, asaj më kufizuese, të mbështetur nga Satta, vetëm të drejtat absolute mund të pësojnë një dëm të pariparueshëm në rast shkelje. Sot kjo teori përdoret për tu dhënë mbrojtje të drejtave absolute të reja të tilla si të drejtat e personalitetit dhe liritë personale, të cilat duke u karakterizuar nga gëzimi i menjëhershëm i të drejtës nga titullari i saj, mund të konsiderohet se pësojnë një dëm të pariparueshëm nëse nuk gëzohen gjatë gjithë kohës së nevojshme.

Sipas tezës së dytë, e mbështetur nga Montesano, do të ishim në kushtet e një dëmi të pariparueshëm “sa herë që gjatë vonesave të pashmangshme të procesit të themelit, paditësi nuk mund të ketë asnjë kompensim efikas kundër situatës së inferioritetit që i vjen nga rreziku i kërcënuar.” Kjo situatë nuk ka të bëjë aspak me mungesën e dëmshpërblimit të dëmit në kuptimin absolut, apo me pamundësinë për të shmangur pasojat e shkeljes në kuptimin absolut. Një përkufizim i tillë i dëmit të pariparueshëm mbron vetëm ato të drejta që kanë për objekt një të mirë të pazëvendësueshme, domethënë që mund të gëzohen vetëm nëpërmjet përmbushjes së detyrimit: ne fakt “kur e mira është e zëvendësueshme nuk mund të shmanget kurrë mundësia që të sigurohet një tjetër mjet ekuivalent për të përmbushur interesin e kërcënuar.”

Teza e fundit është ajo e mbështetur nga Andrioli. Në bazë të kësaj teze, dëmi është i pariparueshëm:

- a. nëse nuk mund të kompensohet, qoftë sepse nuk është i vlerësueshëm ekonomikisht, ashtu dhe për shkak të mungesës së parashikimit të një dëmshpërblimi;
- b. sa herë që për shkak të zgjatjes së procesit mund të shkaktohet një diferencë ndërmjet efekteve të vendimit të themelit dhe përmbushjes së plotë apo dhe ekuivalente të detyrimit dhe kjo diferencë (e shkaktuar nga vështirësia në përcaktimin e dëmit efektiv që ndodh gjatë kohëzgjatjes së shkeljes dhe pastaj nga gjendja e mospërmbushjes së detyrimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së gjykimit të themelit) tejkalon çdo limit të tolerancës normale lidhur me një të drejtë;
- c. sa herë që nga vetë natyra e të drejtës së kredisë apo qëllimi specifik saj është t'i përgjigjet nevojave të kreditorit.

<sup>100</sup> Zuckerman, op.cit. fq. 415

<sup>101</sup> Cambridge Nutrition kundër BBC [1990] 3 All ER 523 CA.

<sup>102</sup> Zuckerbeg, op.cit. fq. 419, para. 10.55.

<sup>103</sup> Pisani, op.cit. fq. 633-635

Megjithëse, *periculum in mora*, është një nga kushtet bazë për dhënien e masave të sigurimit të padisë, ka raste në të cilat gjykata nuk e vlerëson aspak një kusht të tillë. Pra, në disa raste specifike gjykata mund të vendosë për marrjen e masave siguruese vetëm pasi verifikon plotësimin e kushtit të parë, atë të *fumus boni juris*.<sup>104</sup> Sidoqoftë masa e sigurimit duhet të jetë një përgjigje e nevojshme dhe e drejtë ndaj fakteve.<sup>105</sup> “Gjykata duhet të bindet se çdo dëm që mund të pësojë i padituri për shkak të ekzekutimit të masës së sigurimit është i kompensueshëm me garancinë e dhënë nga kërkuesi, ose se rreziku i padrejtësisë që mund t’i bëhet kërkuesit nëse nuk merret masa e sigurimit e tejkalon rrezikun e mungesës së kompensimit të dëmit që mund të pësojë i padituri.”<sup>106</sup>

Në sistemin anglez një kriter i tillë vlerësimi është aq i rëndësishëm sa gjykata mund të refuzojë dhënien e sekuestros, si masë sigurimi, pavarësisht se kërkuesi ka plotësuar kushtet bazë, nëse gjykon se ajo do të ishte e padrejtë dhe shumë e rëndë.<sup>107</sup> Këtë qëndrim e ndeshim në një mori vendimesh, përmendim këtu gjyqtarin Gibson, i cili është shprehur se: “Për autoritet është e qartë se ajo për çfarë duhet të bindet gjykata përpara se të marrë një masë siguruese është nëse kërkuesi ka një çështje të mirëargumentuar, nëse ka një rrezik real se vendimi nuk do të përmbushet për shkak të fshehjes së pasurisë nga i padituri... dhe nëse dhënia e sekuestros do të ishte e drejtë dhe e përshtatshme në të gjitha rrethanat.”<sup>108</sup>

Ndërkohë që jo të pakta kanë qenë dhe rastet kur vlerësimi i gjykatës për rrezikun e fshehjes së pasurisë dhe nëse masa e sigurimit është e drejtë dhe e përshtatshme është ndikuar nga vonesa e në paraqitjen e kërkesës për sigurimin e padisë.<sup>109</sup> Pra, si rregull nga momenti që zbulohen faktet, të cilat justifikojnë marrjen e një mase sigurimi nuk duhet të ketë vonesa të konsiderueshme në kërkimin e tyre, sepse vonesa mund të shihet si provë që nevoja për masën e sigurimit nuk është urgjente.

### 3.3. *Garancia*

Është mëse e kuptueshme që marrja e masave të sigurimit mbart në vetvete një rrezik për aq kohë sa nuk bazohet në gjykim të plotë, por mbi probabilitetin dhe ekzekutimi i masave të sigurimit mund të jetë burim i një dëmi të padrejtë ndaj personit kundër të cilit është marrë një masë e tillë, prandaj është parashikuar instituti i garancisë. Për të zbutur të metat që mund të vijnë nga gabimet në parashikim, instituti i garancisë i jep gjyqtarit mundësinë të japë një masë kundërsiguruese e destinuar të funksionojë në rast se vendimi i themelit nuk është në favor të paditësit.<sup>110</sup> Pra, garancia është një masë kundërsiguruese që mbron të drejtën e shpërblimit të dëmit që mund të pësojë personi kundër të cilit është marrë një masë

<sup>104</sup> Pisani, op.cit. fq. 605-606. Si shembuj të padive ku merret për bazë vetëm *fumus boni juris* autori sjell në vëmendje rikthimin e menjëhershëm në vendin e punës të sindikalistëve, sekuestrot e parashikuara nga legjislacioni mbi pronësinë industriale etj. Edhe në Shqipëri nëse shohim ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 për “Pronësinë Industriale në Republikën e Shqipërisë”, neni 187 që parashikon për marrjen e masave të përkohshme qartazi kuptohet se *periculum in mora* nuk kërkohet si kusht i domosdoshëm për dhënien e masës së sigurimit.

<sup>105</sup> Neil Andrews, “Andrews on Civil Processes”, Volumi I, Court Proceedings, Intersitia, 2013, fq. 593.

<sup>106</sup> First Express Ltd, The Time 8 Tetor 1991.

<sup>107</sup> Zuckerman, op. cit. fq. 485, para 10214

<sup>108</sup> Ninemia Maritime Corp kundër Trave Schiffahrtsgesellschaft mbH & Co KG (The Niedersachsen) [1984] 1 All ER 398; Mercedes-Benz AG kundër Leiduck [1996] AC 284

<sup>109</sup> Antonio Gramsci Shipping Corporation kundër Reoletos Ltd [2011] EWCH2242 (Comm) fq.5-20

<sup>110</sup> Calamandrei, op.cit. referuar në Pisani, op. Cit. fq. 608.

sigurimi në rast se e drejta, për të cilën është marrë dhe ekzekutuar kjo masë, nuk ekziston.<sup>111</sup>

Gjykata duhet të zgjedhë atë masë sigurimi të objektit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të paditurit.<sup>112</sup> Në këtë mënyrë instrumenti i garancisë është i përshtatshëm për të rivendosur barazinë ndërmjet palëve, të cilat kërcënohen nga një rrezik i mundshëm nga marrja e masës së sigurimit.

Neni 202 i KPrC parashikon shprehimisht mundësinë e dhënies së garancisë për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga masa e sigurimit të padisë. Konkretisht në të përcaktohet se: "Sigurimi i padisë lejohet kur:

- a) padia mbështetet në prova me shkresë;
  - b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë
- Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni."

Sikurse u parashtrua edhe më sipër, për shkak të paqartësisë në formulimin e kësaj dispozite, në praktikën gjyqësore shqiptare ka pasur qëndrime të ndryshme lidhur me faktin nëse dhënia e garancisë është një kusht kumulativ me dy kushtet e tjera atë të *fumus boni juris* dhe *periculum in mora*, ekzistenca e të cilave vlerësohet në bazë të shqyrtimit sipërfaqësor të provave të paraqitura sipas kërkesës së paragrafit a) të nenit 202, apo jo.<sup>113</sup>

Në interpretim të dispozitës në fjalë, nëse do të pranohet që dy kushtet e parashikuara në paragrafin a) dhe b) do të ishin kumulative nuk do të do të kishte kuptim fjalia e fundit e nenit 202 që parashikon se garancia mund të kërkohet edhe në rastin kur padia mbështetet në prova me shkresë.

Ndaj parë në tërësinë e tij në mënyrën sesi është hartuar neni 202 lë të kuptohet se sigurimi i padisë do të lejohej kur:

---

<sup>111</sup> Pisani, op.cit. fq. 608.

<sup>112</sup> Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 10, datë 24.03.2010; Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 479, datë 27.10.2011

<sup>113</sup> Shiko: Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 334, datë 21.03.2007 "Gjykata mund ta marrë atë [masën e sigurimit] mjafton të ketë dyshime për pamundësi apo vështirësi në ekzekutimin e vendimit, si dhe të plotësohen dy kushtet e nenit 202 të K.Pr.Civile (*Sigurimi i padisë lejohet kur: a - padia mbështetet në prova me shkresë; b - paditësi jep garanci në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë*); Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 838, datë 23.10.2014: "Nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur ndonjë garanci bankare për sigurimin e padisë çfarë do të thotë se nuk plotësohet dhe një kërkesë tjetër e ligjit kur kërkohet marrja e një mase të tillë."; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti. 249, datë 02.03.2015 "Caktimi i një garancie të natyrës së lartpërmendur përbën në kuptim të ligjit, një nga parakushtet për vendosjen e masave të sigurimit të padisë, krahas pranisë së provave që mbështesin kërkimin për sigurim padie."; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 674, datë 28.07.2015; "Neni 202 i K.Pr. Civile kërkon që pala kërkuese të paraqesë para gjykatës dhe garanci bankare të cilën nuk rezultoi ta kishte bërë."; Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 849, datë 29.06.2006 "Lidhur me faktin nëse duhej vënë garanci pasurore ose jo, ligji është fakultativ dhe e lë në vlerësimin e gjykatës"; Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 370, datë 05.10.2010 "[Garancia]...nuk është kushti thelbësor që ligji kërkon në mënyrë të domosdoshme për marrjen e masës së sigurisë."; Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 475, datë 27.10.2011 "Ndonëse gjykata e apelit gabon kur pranon se për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative të dy kushtet e parashikuara nga geramat "a" dhe "b" të nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile, ky Kolegj e gjen të drejtë përfundimin e arritur nga kjo gjykatë në ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës së palës paditëse për masën e sigurimit të padisë".

- a. padia mbështet në prova shkresore, të cilat lejojnë gjykatën të vlerësojë: i) ekzistencën e mundshme të një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë dhe ii) ekzistencën e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Nëse plotësohet ky kusht, gjykata ka diskrecion të kërkojë ose jo edhe vendosjen e një garancie sikurse mund ta çmojë rast pas rasti.
- b. jepet një garanci për dëmin që mund të shkaktohet nga dhënia e masës, edhe pse nuk ka prova shkresore të mjaftueshme për të vlerësuar i) ekzistencën e mundshme të një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë dhe ii) ekzistencën e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Në fakt ndonëse një interpretim i tillë është logjik, nisur nga mënyra e hartimit të nenit 202 të KPrC, duket qartazi që praktika gjyqësore shqiptare, nuk e ka bërë në asnjë rast të vetëm një interpretim të tillë. Në praktikën gjyqësore nuk është shtruar për diskutim dhe interpretim asnjëherë mundësia e dhënies së masave të sigurimit vetëm nëse jepet një garanci për dëmin që mund të shkaktohet nga dhënia e masës së sigurimit, sikurse është bërë interpretimi në pikën b) më sipër. I gjithë diskutimi ka qenë nëse garancia duhet të kërkohet domosdoshmërisht, në mënyrë kumulative, edhe në rast se ka prova shkresore, apo ajo duhet të lihet në diskrecion të gjykatës për ta çmuar në varësi të rrethanave të çështjes.

Sikurse rezulton nga tërësia e praktikës gjyqësore të konsultuar, me të drejtë, qëndrimi prevalues është që nëse ka prova të mjaftueshme që tregojnë për i) ekzistencën e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë dhe ii) ekzistencën e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë, vendosja e garancisë është një kërkesë alternative, që vlerësohet në mënyrë diskrecionale nga gjykata në varësi të rrethanave të çështjes me qëllim për të mbrojtur edhe të drejtat dhe interesat e ligjshme të të paditurit.

Sipas një gjykate: “Është e qartë që në nenin 202, paragrafi b) të K.Pr.Civile është bërë edhe një parashikim tjetër që gjykata të mund të marrë apo të lejojë masën për sigurimin e padisë, siç është dhënia e një garancie nga ana e palës paditëse për zhdëmtimin e dëmeve eventuale që mund t’i vijnë anës së paditur nga kjo lloj mase; por, në interpretim dhe analizë të dispozitës së mësipërme (neni 202 duhet interpretuar në tërësinë e tij), rezulton që nuk është e domosdoshme plotësimi në mënyrë të menjëhershme dhe të kondicionuar i të dyja kushteve të parashikuara në këtë normë procedurale. Është pikërisht gjykata, ajo e cila në respektim të kësaj norme procedurale, *pasi konstaton se plotësohen kushtet themelore për marrjen e kësaj mase, [i) ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë dhe ii) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë]* vendos nëse është e domosdoshme të vihet edhe garanci pasurore apo jo nga ana e palës paditëse, vlerësim i cili është bërë drejt nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.”<sup>114</sup>

Po këtë qëndrim e gjejmë edhe në vendime të tjera ku gjykata shprehet se: “Gjykata thekson se instituti i sigurimit të padisë rregullohet nga neni 202 i Kodit të Procedurës Civile, i cili ka përcaktuar edhe kushtet që duhet të ekzistojnë për t’u ndodhur përpara këtij instituti. Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, për marrjen e

<sup>114</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.370, datë 05.10.2010

masës së sigurimit nga ana e Gjykatës duhet të bashkekzistojnë domosdoshmërisht 2 kushte kumulative:

1. Të ketë arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë nëse nuk merret masa (paragrafi i parë i nenit 202 të K.Pr.C.);
2. Padia mbështetet në prova me shkresë (gërma a) e nenit 202/2 të K.Pr.C).

Ndërkohë kushti i tretë i parashikuar nga gërma b) e paragrafit të dytë të dispozitës, dhënia e garancisë nga ana e paditësit në llojin dhe masën e caktuar nga gjykata, është një kusht alternativ, i cili duhet të plotësohet në ato raste, kur Gjykata, referuar rrethanave të rastit konkret, vlerëson se paditësi duhet të lërë garanci për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit.”;<sup>115</sup> ose ku shprehet se: “Në referim të nenit 202 të KPrC, paragrafi i dytë pikat a) dhe b), ligjvënësi nuk kërkon që kushtet e përcaktuara në to të konkurrojnë së bashku, gjë e cila do të thotë se nëse kemi prova me shkresë vënia dhe e një e garancie nuk është kusht për sigurimin e padisë.”<sup>116</sup>

Në këto kushte për të shmangur keqinterpretimet sugjerojmë që neni 202 i KPrC duhet të riformulohet duke parashikuar se: “Sigurimi i padisë lejohet kur padia është e bazuar në prova me shkresë. Gjykata mund të kërkojë dhënien e një garancie, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.”

Në formën në të cilën është hartuar neni 202 i KPrC, dhe interpretimi që propozuam më sipër, por që duket se nuk ka gjetur ndonjëherë trajtim nga praktika gjyqësore, është shumë i ngjashëm më Kodin gjerman të Procedurës Civile,<sup>117</sup> i cili parashikon shumë qartazi se për aq sa kërkesa për vendosjen e sekuestros nuk plotëson kushtet për vendosjen e saj, gjykata mund ta urdhërojë vendosjen e saj me kusht që të jepet një garanci për dëmet që mund të pësojë pala kundërshtarë. Gjykata mund ta kushtëzojë dhënien e sekuestros me dhënien e garancisë edhe kur kërkesa dhe arsyet për marrjen e masës së sekuestros provohen në mënyrë të kënaqshme. Nga sa kuptohet nga dispozitat e KPrC gjerman, gjykata mund ta kushtëzojë dhënien e sekuestros me dhënien e garancisë nga kreditori nëse gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë suksesin e themelit të çështjes, apo rrethanat që justifikojnë marrjen e masës. Nëse masa e sigurimit e marrë provohet se është e pabazuar, pala në favor të të cilës është një masë e tillë ka detyrimin të kompensojë palën kundërshtarë për dëmet që mund të ketë pësuar si rezultat i ekzekutimit të masës siguruuese, ose si rezultat i dhënies së garancisë nga pala kundërshtarë me qëllim për të shmangur ekzekutimin.<sup>118</sup>

Kodi francez i Procedurës Civile parashikon se urdhrat e dhënë sipas një procedure të përsheptuar ekzekutohen në mënyrë të përkohshme. Gjithsesi, gjyqtari mundet që ta kushtëzojë ekzekutimin e tyre me dhënien e një garancie,<sup>119</sup> e cila mund të jetë një e drejtë reale ose personale, e mjaftueshme për të mbuluar dëmet.<sup>120</sup> Është parashikuar gjithashtu se përcaktimi i natyrës, masës dhe kushteve të dhënies së

<sup>115</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 415, datë 05.05.2015

<sup>116</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 242, datë 06.03.2015

<sup>117</sup>Neni 921 i Kodit Gjerman të Procedurës Civile. Code of Civil Procedure as promulgated on 5 December 2005 (Bundesgesetzblatt (BGBl., Federal Law Gazette) I page 3202; 2006 I page 431; 2007 I page 1781), last amended by Article 1 of the Act dated 31 August 2013 (Federal Law Gazette I page 3533) gjendet në: [http://www.gesetze-im-internet.de/englisch\\_zpo/englisch\\_zpo.html](http://www.gesetze-im-internet.de/englisch_zpo/englisch_zpo.html)

<sup>118</sup> Neni 945 i KPrC gjerman

<sup>119</sup> Neni 489 i Kodit të Procedurës Civile së Republikës së Francës, gjendet në:

[www.legifrance.gouv.fr/content/download/1962/13735/.../Code\\_39.pdf](http://www.legifrance.gouv.fr/content/download/1962/13735/.../Code_39.pdf)

<sup>120</sup> Neni 517 i KPrC francez

garancisë është në diskrecion të gjykatës dhe përcaktohet në vendimin e saj për dhënien e garancisë.<sup>121</sup> Kur vlera nuk mund të përcaktohet menjëherë, gjyqtari fton palët të paraqiten para tij me prova në një datë që ai do të caktojë për të bërë përcaktimin e vlerës së garancisë.<sup>122</sup> Kur garancia është një shumë parash ajo depozitohet ose në Fondin e Ngarkesave dhe Kredive, ose tek një person i tretë nëse një nga palët e kërkon. Nëse personi i tretë nuk është dakord për ruajtjen e garancisë, atëherë ajo i kalon Fondit të Ngarkesave dhe Kredive.<sup>123</sup> Garancia e dhënë mund të zëvendësohet me një tjetër të së njëjtës vlerë në çdo kohë me urdhër të gjykatës.<sup>124</sup>

Edhe Kodi italian i Procedurës Civile<sup>125</sup> parashikon se me vendimin e dhënies, konfirmimit, apo ndryshimit të masës së sigurimit, gjyqtari, duke vlerësuar çdo rrethanë, mund të kërkojë dhënien e një garancie për shpërblimin e dëmeve të mundshme që mund të vijnë nga ekzekutimi i kësaj mase. Pra, shohim që dhënia apo jo e garancisë është në diskrecion të gjykatës, në varësi të rrethanave të çështjes.

Në Angli, instituti i garancisë është disi më i veçantë, sepse kodi i procedurës civile parashikon si kusht për marrjen e masave të sigurimit premtimin e dhënë nga paditësi gjykatës, që ai do të paguajë dëmet që mund të pësojë i padituri nga ekzekutimi i masës së sigurimit, nëse ajo gjendet e pabazuar dhe vetëm nëse ka një rrezik të qartë për dëm të mundshëm dhe ka dyshime se kërkuesi (paditësi) nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimin e tij, gjykata mund të kërkojë dhënien e një garancie.<sup>126</sup> Pra, në Angli garancia apo pagesa e saj gjykatës mund të kërkohej kur vetëm dhënia e premtimit nuk konsiderohet i mjaftueshëm.<sup>127</sup> Dikur në Angli është mbajtur qëndrimi se premtimi kishte për qëllim vetëm të mbulonte shpërblimin kur kërkuesi kishte marrë një masë sigurimi nëpërmjet mjeteve të papërshtatshme, por jo kur dëmi shkaktohej si rezultat i masës së sigurimit, e cila ishte dhënë si rezultat i gabimit në ligj.<sup>128</sup> Por kjo pikëpamje u kundërshtua dhe u braktis.<sup>129</sup>

Premtimi për shpërblimin e dëmit i jepet gjykatës dhe jo palës kundër të cilës është marrë masa e sigurimit.<sup>130</sup> Por, nuk ka asnjë pengesë që palët të bien dakord vetë për termat e premtimit, ose të lidhin një kontratë në vend të premtimit. Në rastin e parë vendimi për shpërblimin e dëmit do të jetë në atë vlerë që gjykata çmon se kërkuesi duhet të paguajë, kurse kur palët kanë lidhur kontratë për dëmin, atëherë kushtet e kësaj kontrate prevalojnë dhe nëse vendimi i themelit është në favor të të paditurit, atëherë shumica e rënë dakord me marrëveshje të palëve do të bëhet e pagueshme.<sup>131</sup> Zakonisht premtimi për shpërblimin e dëmit nuk përcakton ndonjë kufi për vlerën, megjithatë në disa rrethana ajo mund të kufizohet në një vlerë të

---

<sup>121</sup> Neni 518 i KPrC francez

<sup>122</sup> Neni 520 i KPrC francez

<sup>123</sup> Neni 519 i KPrC francez

<sup>124</sup> Neni 522 i KPrC francez.

<sup>125</sup> Neni 669-11 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Italisë, Giovanni Noveli, Stefano Petiti, Codice di Procedura Civile, Annotato con la giurisprudenza, Giuffrè Editore, Botimi IV, 2008, fq. 2208.

<sup>126</sup> Bhimji kundër Chatwant (no.2) [1992] 4 All ER 912; Harley Street Capital Ltd kundër Tchigirinski (no. 1) [2005] EWHC 2471 (Ch.)

<sup>127</sup> DPR Futures Ltd[1989] B.C.L.C. fq. 634-640 cituar në Zuckerman, op.cit. fq. 451

<sup>128</sup> Smith kundër Day (1882) 21 Ch D 421-423.

<sup>129</sup> Metzger, Friedlander, "The preliminary injunction: Injury without reedy?" [1974] 29, The Business Lawyer 913; Spry, Equitable remedies, (6<sup>th</sup> edn. 2001), fq. 659.

<sup>130</sup> F. Hoffman –La Roche & Co AG kundër Secretary of State for Trade and Industry [1974] 2 All ER 1128, 1150; Smithkline Beecham Plc kundër Apotex Europe Ltd [2006] EWCACiv 658.

<sup>131</sup> Zuckerman, op.cit. fq.447, para. 10.121.



caktuar.<sup>132</sup> Gjykata nuk mund të detyrojë një palë të bëjë një premtim të tillë, ajo vetëm mund të refuzojë dhënien e masës në mungesë të premtimit.<sup>133</sup>

Dhënia e një premtimi të tillë konsiderohet se është çështje e drejtësisë elementare kur një masë sigurimi jepet përpara se të përcaktohen të drejtat e palëve në gjykim.<sup>134</sup> Kërkesa për premtimin e shpërblimit të dëmit diktohet nga rëndësia që ka trajtimi i drejtë dhe i barabartë.<sup>135</sup> Mbrojtja e barabartë kërkon që dëmi i shkaktuar nga masa e sigurimit të bjerë mbi kërkuesin në favor të të cilit është marrë një masë e tillë. Kërkuesi që ka marrë një masë siguruese ka siguruar mbrojtjen e të drejtave të tij derisa të mbyllet gjykimi i themelit. Nëse vendimi i themelit është në favor të paditësit, atëherë është radha e tij për të kërkuar mbrojtje të të drejtave.<sup>136</sup> Ky premtim mund të konsiderohet si një masë praktike me anë të të cilës ligji garanton mbrojtjen e të paditurit derisa të jepet vendimi i formës së prerë për themelin e padisë kundrejt mbrojtjes që i është dhënë kërkuesit. Procedura e marrjes së masave të përkohshme nuk është krijuar vetëm në favor të kërkuesit, por kërkon të arrijë një balancë të drejtë ndërmjet palëve me interesa të kundërta dhe u jep mbrojtje të dyve, si paditësit edhe të paditurit.<sup>137</sup>

Dëmi mbulohet vetëm në përputhje me kushtet e premtimit. Nëse nuk është rënë dakord për kushte të veçanta, paditësi do të jetë përgjegjës për të paguar çdo dëm që i padituri do të pësojë dhe që gjykata e çmon se duhet paguar. Nga premtimi mbulohen dëmet vetëm të personave që janë përmendur në të dhe që normalisht janë prekur nga masa e sigurimit. Një person që nuk është palë nuk mund të mbështetet tek premtimi i dhënë për palën e paditur për të kërkuar dëmet që mund të ketë pësuar si rezultat i kufizimit të vendosur ndaj palës për të cilën është dhënë premtimi.<sup>138</sup> Megjithatë, gjykata ka juridiksion të përfshijë në premtim persona që nuk janë palë, por sugjerohet që diçka e tillë të bëhet vetëm në disa rrethana të veçanta që e bëjnë personin jo palë aq shumë të lidhur me mosmarrëveshjen saqë do të ishte e padrejtë t'i mohohet atij dëmshpërblimi nga premtimi.<sup>139</sup> Ose sikurse praktika ka treguar, paditësi duhet të pretojë pagimin e kostove të arsyeshme që një person jo palë ka shpenzuar për të ndihmuar në ekzekutimin e masës së sigurimit, si për shembull kostot e bankës për të zbuluar nëse një person kundër të cilit është marrë masa siguruese ka llogari bankare dhe kostot e bllokimit të kësaj llogarie.<sup>140</sup> Premtimi mund të ekzekutohet gjithashtu edhe ndaj të paditurve të tjerë bashkëndërgjyqës, ndaj të cilëve nuk është marrë masa siguruese, por që janë dëmtuar nga ekzekutimi i saj.<sup>141</sup>

Një çështje që kërkon trajtim kur flasim për instrumentin e garancisë është se ku dhe si gjykohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të ardhur si rezultat i vendosjes padrejtësisht të një mase sigurimi. Neni 211 paragrafi 3 i KPrC shqiptar parashikon se

<sup>132</sup> DPR Futures Ltd [1989] B.C.L.C. 634

<sup>133</sup> Smithkline Beecham Plc kundër Apotex Europe Ltd [2005] EWHC 1655

<sup>134</sup> Kirkless Borough Council kundër Wickers Building Supplies Ld [1991] 4 All ER, fq. 240-248

<sup>135</sup> Zuckerman, op.cit fq 443.

<sup>136</sup> A.A.S. Zuckerman, "Dispensation with Undertaking in Damages- An Elementary Justice", 1993 12 C.J.Q. fq.268; A.S.S. Zuckerman, "Interlocutory injunctions in quest of procedural fairness", 1993, 56 M.L.R. fq. 325.

<sup>137</sup> Zuckerman, op.cit. fq. 444.

<sup>138</sup> Idem, fq. 445, para 10.116

<sup>139</sup> Për shembull, kur një masë sigurimi merret ndaj shoqërisë X duke e penguar atë të shesë një produkt, shoqëria Y, e cila ka një joint venture me shoqërinë X lidhur me produktin, mund të justifikohet në pretendimin e saj për tu përfshirë në premtimin e dhënë shoqërisë X. Shiko: Zuckerman, op.cit. fq. 446.

<sup>140</sup> Customs and Excise Commissioners kundër Barclays Bank Plc [2006] UKHL

<sup>141</sup> Dubai Bani ltd kundër Galadari (nr. 2), The Times, 11 tetor 1989 cituar në O'Hare & Browne, "Civil Litigation", Botimi XV, Sweet & Maxwell, 2011, fq. 424.

garancia e dhënë sipas nenit 202 të këtij Kodi, i kthehet paditësit, në rast se pala tjetër brenda pesëmbëdhjetë ditëve pasi vendimi të ketë marrë formën e prerë, nuk paraqet padi për shpërblimin e dëmit të ardhur për një shkak të tillë.

Nga kjo dispozitë kuptohet se e drejta për tu dëmshpërblyer nuk lind automatikisht, por nga një vendim i gjykatës, e cila duhet të investohet me anë të një kërkesëpadi, ku tashmë i padituri, kundër të cilit ishte marrë një masë sigurimi, e cila ka rënë nga fuqia për shkak se padia e themelit është rrëzuar me vendim të formës së prerë, ose për shkak se gjykimi mund të jetë pushuar, është në pozitën e paditësit. Kërkesëpadi do të ketë si objekt shpërblimin e dëmit të ardhur si rezultat i vendosjes së një mase sigurimi me pa të drejtë dhe si bazë ligjore nenin 211(3) të KPrC.

Neni 211(3) nuk përcakton aspak se cila është gjykata kompetente para së cilës duhet të paraqitet një kërkesëpadi e tillë. Ai kufizohet vetëm në përcaktimin e momentit se kur i padituri i dëmtuar nga masa legjitimohet të kërkojë të drejtën për dëmshpërblim, që është vetëm pasi vendimi ka marrë formë të prerë. Në mungesë të një përcaktimi të shprehur të dispozitës në fjalë, gjykojmë se gjykata kompetente para së cilës duhet të paraqitet kërkesëpadi është gjykata e që ka gjykuar themelin e padisë, me vendimin përfundimtar të të cilës është hequr dhe masa e sigurimit, e cila ishte dhënë kundrejt garancisë për dëmin që mund t'i shkaktohet palës së paditur nga dhënia e kësaj mase sigurimi.

Ndryshe nga Kodi ynë i Procedurës Civile, KPrC italian përsa i përket gjykatës kompetente që shqyrton kërkesën për shpërblim dëmi parashikon qartazi në nenin 96 paragrafi 2 se ajo është gjykata që konfirmon ekzistencën e të drejtës për të cilën është marrë një masë e tillë. Në vendime të Gjykatës italiane të Kasacionit ndeshim këto shpjegime në lidhje me kompetencën:

“Padia për përgjegjësi procedurale të rëndë e ngritur sipas nenit 96 të KPrC kundër palës që ka kërkuar dhe i është dhënë masa e sigurimit e sekuestros është në kompetencë funksionale dhe të paderogueshme të gjykatës që bën vleftësimin e masës dhe gjykon themelin e padisë, dhe prandaj kërkesa për dëmin relativ është e papranueshme në një gjykim të veçantë.”<sup>142</sup>

“Padia për përgjegjësi procedurale të rëndë e ngritur sipas nenit 96 të KPrC, si rregull duhet t'i paraqitet të njëjtit gjyqtar që është investuar për gjykimin e padisë nga e cila rrjedh përgjegjësia, me përjashtim të rastit kur pas dhënies dhe ekzekutimit të masës së sigurimit, procesi gjyqësor nuk ka vazhduar më për shkak të mosveprimit të palës paditëse.”<sup>143</sup>

Edhe më pak e qartë është mënyra se si veprohet proceduralisht për kthimin e shumës së lënë garanci, pasi vendimi me të cilin është hequr masa e sigurimit merr formë të prerë. Në rast se gjykata në vendimin e saj përfundimtar që rrëzon padinë e themelit, kur shprehet për heqjen e masës së sigurimit, ajo urdhëron dhe kthimin e garancisë, por duke e kushtëzuar atë me kalimin e afatit 15 ditor nga marrja formë të prerë e këtij vendimi në rast se nuk është ngritur padi për shpërblim dëmi nga masa e sigurimit e dhënë. Në të kundërt, nëse padia për shpërblim dëmi nga vendosja e një mase sigurimi të padrejtë është ngritur brenda afatit 15 nga marrja e vendimit formë të prerë, garancia nuk mund të kthehet. Por këtu lind një problem praktik, si vërtetohet se padia për shpërblim dëmi është ngritur brenda afatit 15 ditor dhe kush e konstaton atë në mënyrë që të mos lejohet kthimi i garancisë? Kuptohet që ngritja apo jo e

<sup>142</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë nr. 6116, datë 20 mars 2006 cituar në Novelli, Petitti, op.cit. fq. 441.

<sup>143</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë nr. 8223, datë 6 nëntor 1987; Vendim i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë nr. 1861, datë 18 shkurt 2000.

padisë për shpërblim dëmi si rezultat i masës së sigurimit provohet lehtësisht me një vërtetim nga kryesekretari i gjykatës, por a mjafton paraqitja e një vërtetimi të tillë në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kur garancia e dhënë ka qenë një pasuri e paluajtshme, apo në Banka, kur garancia e dhënë ka qenë bllokimi i një shume të caktuar pranë tyre, për të bërë të mundur që këto institucione të kthejnë garancinë apo mos lejojnë kthimin e saj në rast se është ngritur padia për shpërblim dëmi nga masa e sigurimit? Gjykojmë se paraqitja e vendimit të formës së prerë që ka vendosur ndër të tjera për heqjen e masës së sigurimit dhe kthimin e garancisë dhe vërtetimi nga kryesekretari i gjykatës se nuk është ngritur një padi për shpërblim dëmi si rezultat i masës së sigurimit duhet të jenë të mjaftueshme për lirim e garancisë së dhënë. Dhe anasjelltas, vërtetimi i kancelarit se është ngritur brenda 15 ditëve një padi për shpërblim dëmi nga masa e sigurimit duhet të jetë i mjaftueshëm për të mos lejuar kthimin e garancisë.

Cili është dëmi që duhet të mbulohet nga garancia e dhënë dhe mbi kë rëndon barra e provës, është një tjetër pyetje që nuk merr përgjigje të drejtpërdrejtë nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. As praktika gjyqësore shqiptare nuk na ofron diçka specifike lidhur me këtë çështje. Gjithsesi referuar rregullave të përgjithshme të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj.<sup>144</sup> Ndaj i padituri, i cili pretendon për shkaktimin e një dëmi të ardhur nga masa e sigurimit e vendosur padrejtësisht, ka barrën për të provuar se i është shkaktuar një dëm dhe se ky dëm është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e masës së sigurimit, e cila është hequr me vendim të formës së prerë. Pra, dëmi që duhet të mbulohet nga garancia e dhënë duhet të jetë ai që lidhet vetëm me masën e sigurimit dhe jo çdo lloj dëmi tjetër i mundshëm.

Doktrina dhe praktika angleze ofrojnë një trajtim të detajuar të kësaj çështje. Sipas saj rregulli i përgjithshëm është se i padituri ka të drejtë të dëmshpërblehet për çdo dëm që ka pësuar si rezultat i kufizimit në ushtrimin e të drejtave të tij pa faj të tij.<sup>145</sup> Është i padituri ai që ka barrën e provës së dëmit të ardhur nga masa e sigurimit. Sapo i padituri provon dëmin, atëherë barra e provës kalon mbi paditësin për të treguar se dëmi nuk ka ardhur si rezultat i masës së sigurimit. Premtimi për mbulimin e dëmit nuk duhet të ekzekutohet kur dëmi është i parëndësishëm.<sup>146</sup> Për më tepër, i padituri ka detyrimin që të zvogëlojë dëmin e tij dhe nëse ai nuk e ka bërë këtë ose ka kontribuar në rritjen apo përkeqësimin e dëmit të tij atëherë atij mund t'i refuzohet dëmshpërblimi.<sup>147</sup> Përsa i përket dëmit që mund të mbulohet nga premtimi për shpërblimin e dëmit, në të përfshihen kostot që ka pësuar i padituri.<sup>148</sup> Me përjashtim të rrethanave përjashtimore në varësi të rrethanave të çështjes, dëmet për stresin emocional nuk mbulohen nga premtimi për shpërblimin e dëmit.<sup>149</sup> Dëmi mund të shpërblehet kur për shembull, për shkak të masës së sigurimit ka pasur vonesë një kryerjen e një shitje,<sup>150</sup> kur i padituri është penguar në shitjen e një produkti dhe me vendimin përfundimtar rezulton se ai ka pasur të drejtë ta kryejë diçka të tillë,<sup>151</sup> apo kur i padituri ishte penguar në mënyrë të panevojshme nga ushtrimi i të drejtave të tij

---

<sup>144</sup> Neni 12 i KPrC

<sup>145</sup> Zuckerman, op.cit. fq. 448-449.

<sup>146</sup> Hailstone Hopkins kundër Carter (1910) 102 L.T 877.

<sup>147</sup> Modern Transport Co Ltd kundër Duneric Steamship Co [1917] 1 KB 370. CA.; Triodos Bank NV kundër Dobbs [2005] EWHC 108.

<sup>148</sup> Apex Frozen Foods Ltd kundër Ali [2007] EWHC469,(2007) L.T.L., 11 prill 2011.

<sup>149</sup> Al-Rawas kundër Pegasus Energy Ltd [2008] EWHC 617.

<sup>150</sup> Graham kundër Campbell (1878) 7 Ch D 490 CA.

<sup>151</sup> Les Laboratories Servier kundër Apotex [2011] EWCA Civ 593.

si rezultat i masës së sigurimit.<sup>152</sup> Lidhur me këtë çështje Gjykata e Lartë e Australisë<sup>153</sup> është shprehur:

“Në një proces të një natyre të barabartë zakonisht është e përshtatshme të mbahet një qëndrim që është i drejtë dhe i arsyeshëm, sesa të zbatohen rregulla strikte. Megjithatë, pikëpamja se dëmet duhet të jenë ato që rrjedhin direkt nga masa e sigurimit dhe që mund të ishin parashikuar në momentin e dhënies së saj, është ajo pikëpamje që do të ishte e drejtë dhe e arsyeshme në rrethanat e pothuajse të gjitha rasteve dhe sigurisht dhe në rastin në fjalë.”

Ndryshe nga ligji shqiptar, ligj anglez nuk e ka të përcaktuar afatin brenda të cilit duhet të ngrihet kërkesa për shpërblimin e dëmit të ardhur si rezultat i masës së sigurimit. Megjithatë praktika ka treguar se ajo duhet të paraqitet menjëherë, sepse paraqitja me vonesë mund të jetë shkak për mospranimin e saj.<sup>154</sup>

---

<sup>152</sup> Zuckerman, op.cit. fq. 451

<sup>153</sup> Air Expres Ltd kundër Ansett Transport Industries etec (1981) 146 C.L.R. 249 [30]

<sup>154</sup> Zuckerman, op.cit.fq. 464, para. 10.163

## KAPITULLI II

### PROCEDURA DHE LLOJET E MASAVE TË SIGURIMIT TË PADISË

#### 1. Kërkesa për marrjen e masave të sigurimit të padisë

Kodi shqiptar i Procedurës Civile parashikon se mjeti procedural me anë të të cilit mund të vihet në lëvizje gjykata për të marrë një masë sigurimi është kërkesa,<sup>155</sup> por nuk bën ndonjë përcaktim specifik lidhur me formën dhe përmbajtjen e saj. Megjithatë gjykojmë se në rastin e kërkesës për sigurim padie, si një akt procedural që vë në lëvizje gjykatën për tu shprehur lidhur me kërkimin konkret, do të zbatohen të njëjtat rregulla si për paraqitjen e kërkesëpadisë. Referuar dispozitave të përgjithshme të KPrC mbi aktet, mund të evidentojmë një element formal të rëndësishëm të kërkesës, që është hartimi i saj në gjuhën shqipe.<sup>156</sup> Përsa i përket formës së paraqitjes së këtij akti, neni 115 i KPrC parashikon se aktet procedurale, për të cilat ligji nuk kërkon forma të caktuara, mund të kryhen në formën më të dobishme për arritjen e qëllimit të tyre, megjithatë duke e trajtuar kërkesën njësoj si kërkesëpadinë, dhe referuar nenit 153 të KPrC që parashikon se gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim, evidentojmë një tjetër element formal të kërkesës për sigurim padie, atë të të qënurit në formë të shkruar.

Lidhur me elementet e përmbajtjes së kërkesës për sigurim padie gjithashtu nuk gjejmë përcaktim konkret në dispozitat e KPrC,<sup>157</sup> sidoqoftë duke pasur parasysh sa më sipër, pra, që kërkesa duhet të përmbushë po ato kritere që kërkohen edhe për kërkesëpadinë, mund të thuhet se kërkesa për sigurimin e padisë, përveçse duhet të jetë e shkruar dhe në gjuhën shqipe, duhet të përmbajë:

- gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa;
- emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë;
- Objektin e kërkesës (llojin e masës së sigurimit);
- tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese mbi të cilat mbështetet kërkesa (ekzistenca e *fumus boni juris* dhe *periculum in mora*);
- objektin dhe përmbledhjen e fakteve të padisë së themelit që do të paraqitet (*petitum* dhe *causa petendi*), në rastet kur kërkesa bëhet *ante causam*;
- kërkimin përfundimtar.

Gjithashtu, kërkesës për sigurim padie duhet t'i bashkëngjiten dhe aktet që i bashkëngjiten kërkesëpadisë,<sup>158</sup> si prokura, në rast se kërkesëpadia paraqitet në emër të paditësit nga përfaqësuesi i tij dhe kopje të kërkesës dhe të akteve provuese, në numër sa janë të personat kundër të cilëve do të merret masa e sigurimit. Kjo duhet veçanërisht në rastin kur kërkesa paraqitet *ante causam* dhe nuk do të gjykohet *ex parte*.

<sup>155</sup> Neni 202 i KPrC parashikon: “Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë...”

<sup>156</sup> Shiko nenin 116 të KPrC “Aktet procedurale hartohen në gjuhën shqipe”

<sup>157</sup> Neni 117 i KPrC përmend shprehimisht elementet e përmbajtjes së kërkesëpadisë, kundërpadiës dhe thirrjes në gjyq, pa përmendur specifikisht kërkesën, si akt procedural. “Përveç kur ligji parashikon ndryshe, thirrja për në gjyq, kërkesëpadia e kundërpadia, duhet të tregojnë gjykatën, palët, objektin, shkaqet ligjore të kërkesës dhe përfundimet, si dhe datën e hartimit dhe duhet të nënshkruhen prej palës që e paraqet aktin ose nga përfaqësuesi i saj, si në origjinal ashtu dhe në kopjet për njoftim.”

<sup>158</sup> Neni 156 i KPrC

Një interpretim të tillë e gjejmë edhe në doktrinën italiane.<sup>159</sup> Referuar asaj, kërkesa, në mungesë të përcaktimit ligjor të përmbajtjes së saj, përveç elementeve që janë tregues të përmbushjes së kushteve për marrjen e një mase sigurimi (*fumus boni juris* dhe *periculum in mora*) dhe llojit të masës së sigurimit që kërkohet të merret, në thelb duhet të përmbajë edhe kërkesat e përgjithshme të nenit 125,<sup>160</sup> ndër të cilat prokurën, e cila në rast të ngritjes së kërkesës *ante causam*, mund të vlejë edhe për gjykimin e themelit të padisë nëse në të del qartë vullneti edhe për një shtrirje të tillë të saj<sup>161</sup> dhe po në këtë rast edhe elementët që përcaktojnë padinë e themelit që do ngrihet.

Lidhur me përcaktimin e llojit të masës së sigurimit që kërkohet si një nga elementet e kërkesës për sigurim padie gjykojmë se ai është një element i rëndësishëm që nuk duhet të mungojë, sepse kërkuesi duhet të japë argumente dhe prova që mbështesin jo vetëm marrjen e një mase sigurimi, por edhe që justifikojnë llojin e masës së kërkuar, dhe gjykata ka diskrecionin të përcaktojë nëse masa e sigurimit e kërkuar është e përshtatshme, apo jo, duke vendosur respektivisht për pranimin apo rrëzimin e kërkesës për sigurim padie.<sup>162</sup> Praktika gjyqësore shqiptare tregon se në fakt kërkuesi i masës së sigurimit e përcakton llojin e masës së kërkuar (qoftë edhe duke propozuar disa masa, në mënyrë kumulative apo alternative) dhe në varësi të provave dhe argumenteve të paraqitura, si dhe bindjes që krijojnë ato tek gjykata për plotësimin e kushteve për dhënien e masës së sigurimit, kërkesat për sigurim padie, mund të jenë pranuar duke vendosur llojin e masës që ka kërkuar pala,<sup>163</sup> mund të jenë pranuar pjesërisht, duke vendosur një nga llojet e masës së kërkuar, por jo llojin tjetër,<sup>164</sup> ose mund të jenë rrëzuar.<sup>165</sup> Mbi këtë element të kërkesës për sigurim padie, në doktrinën italiane ka disa pikëpamje. Ka autorë që mbajnë qëndrimin se mungesa

---

<sup>159</sup> G. Frus, “Riflessioni sul *petitum cautelare*”, Giur.it. 1988, I, fq. 197; Pisani, op.cit. fq. 643-644; G. Frus, “Commento al art. 74/669 bis”, në “Le riforme del processo civile”, nën kujdesin e Sergio Chiarloni, Zanicheli Editore, Bologna, 1992, fq. 612; Mandrioli, op.cit., fq. 257-258; Biavati, op.cit. fq.688-690; Satta, Punzi, op.cit. fq. 860; Tommaseo, “Commento alla Legge 26 novembre 1990, n. 353 Provvedimenti urgenti per il processo civile”, në Il Corriere giuridico, 1991, fq. 95, 97; Salvaneschi, “La domanda e il procedimento”, në “AA.VV. I procedimenti cautelari”, fq. 198; Consolo në Consolo, Luiso, Sassani, “La riforma del processo civile”, Milano, Giuffrè, 1991, fq. 430; Giacomo Oberto, “Il nuovo processo cautelare, në Teoria e pratica del diritto”, Sez. I-59, Guffrè Editore, Milano 1992, fq. 27.

<sup>160</sup> Neni 125 i KPrC Italian parashikon: “Përveç kur ligji parashikon ndryshe, ...kërkesëpadia...duhet të tregojë gjykatën të cilës i drejtohet, palët, objektin, argumentat që mbështesin pretendimin dhe kërkimin përfundimtar, dhe si origjinali dhe kopjet për palët duhet të nënshkruhen nga vetë paditësi, ose përfaqësuesi i tij me prokurë.”

<sup>161</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nr. 14641, datë 23 qershor 2009, dhe nr. 1609, datë 27 tetor 2003.

<sup>162</sup> Përmendim këtu nenin 206 tëKPrC, i cili parashikon se: “Sigurimi i padisë bëhet: a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit; b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata.”

<sup>163</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 276, datë 13.03.2014 ku është kërkuar si masë sigurimi pezullimi (*bllokimi*) i çdo transferimi të pjesëshëm apo të plotë të kuotave të ortakëve të Shoqërisë dhe pezullimi i çdo mbledhje të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë dhe gjykata ka pranuar vendosjen e të dy llojeve të masave.

<sup>164</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 848, datë 01.11.2013 ku është kërkuar vendosja e sekuestros konservative mbi llogaritë bankare deri në shumën 100 000 Euro dhe sekuestroja e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe gjykata ka pranuar vendosjen e sekuestros mbi llogaritë bankare dhe rrëzuar kërkesën për vendosjen e sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme.

<sup>165</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 339, datë 31.03.2015 ku ishte kërkuar vendosja e sekuestros konservative mbi llogaritë e huamarrëses ose vendosja e një barre mbi ndonjë pasuri të paluajtshme dhe gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se kërkimi mbetet i paprovuar.

e përcaktimit të llojit të masës së sigurimit nuk e bën kërkesën për sigurim padie të papranueshme.<sup>166</sup> Ndërsa autorë të tjerë shprehen se kërkesa për sigurimin e padisë do të ishte e papranueshme nëse ia lë gjyqtarit përcaktimin e masës më të përshtatshme.<sup>167</sup> Veprimtaria dhe vendimi i gjykatës lidhur me kërkesën për sigurimin e padisë kanë si pikë referimi kërkesën e palës dhe kësaj për rrjedhje nuk mund të mos i korrespondojë edhe përmbajtja e masës së sigurimit.<sup>168</sup> Pra, kërkesa duhet të tregojë llojin e masës së kërkuar, duke mos ia lënë gjyqtarit të zgjedhë (dhe kjo edhe në rastin kur kërkohet marrja e një mase atipike)<sup>169</sup> pavarësisht se më pas gjyqtari mund të vendosë për dhënien e një mase të ndryshme nga ajo e kërkuar.<sup>170</sup>

Por diskutime ka pasur edhe përse i përket kësaj të fundit, pra nëse gjykata mund të vendosë për një masë të ndryshme nga ajo që është kërkuar. Një grup autorësh të doktrinës italiane kanë qenë të mendimit se gjykata nuk mund të vendosë për një masë të ndryshme nga ajo që është kërkuar, për shkak se gjykata duhet të shprehet për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Kështu kërkesa që përcakton konkretisht *petitum* dhe konkluzionet e palës, është indikative për gjykatën, e cila duhet të japë një masë të njëjtë me atë të kërkuar, duke pasur diskrecion vetëm për përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit të masës së dhënë.<sup>171</sup> Një grup tjetër autorësh janë të mendimit se detyrimi i gjykatës për tu shprehur për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet nuk zbatohet në rastin e gjykimeve për masa sigurimi atipike. Kodi i procedurës civile ia lë gjykatës të drejtën të vendosë për masën që e konsideron më të përshtatshme, pa u kushtëzuar nga kërkesa për llojin e masës së sigurimit që ka paraqitur kërkuesi.<sup>172</sup> Ndërkohë që ka pasur dhe një grup tjetër autorësh me një qëndrim të ndërmjetëm, të cilët e konsideronin të detyrueshëm zbatimin e parimit sipas të cilit gjykata shprehet vetëm për atë që kërkohet, por veprimtarinë diskrecionale të gjyqtarit nuk e kufizonin vetëm në përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit të masës së sigurimit.<sup>173</sup>

Në kushtet kur Kodi ynë i procedurës civile parashikon se gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet,<sup>174</sup> pavarësisht se në nenin 206 përcaktohet se sigurimi i padisë bëhet me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit dhe me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata, gjykojmë se gjykata duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me kërkesën për sigurim padie në bazë të diskrecionit që i jep neni 206 i KPrC, nuk mund të vendosë për një masë të ndryshme nga ajo e kërkuar nga palët, por vetëm të vlerësojë nëse ajo është e përshtatshme apo jo duke marrë parasysh dhe interesat e palës tjetër dhe duke vendosur respektivisht pranimin, rrëzimin, apo pranimin e pjesshëm të saj. Ndonëse jo shumë e qartazi, një qëndrim i tillë duket se mbështetet edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilët janë shprehur se: “Në rastin në shqyrtim,

<sup>166</sup> E. Merlin, “Procedimenti cautelari ed urgenti in generale”, fq. 402.

<sup>167</sup> L.Lombardo, “Natura e caratteri dell’ intrusione probatoria nel processo cautelare”, Riv. Dir. Proc., 2001, fq. 464; S. Recchioni, “Il processo cautelare uniforme”, fq. 267.

<sup>168</sup> Salvaneschi, në “Il nuovo processo cautelare”, nën kujdesin e Giuseppe Tarzia, Cedam, Padova, 1993, fq. 253.

<sup>169</sup> E cila nuk është parashikuar shprehimisht nga Kodi

<sup>170</sup> Biaviati, op.cit. fq 689.

<sup>171</sup> Tommaseo, “I provvedimenti d’urgenza”, Padova, Cedam, 1983, fq. 283

<sup>172</sup> Arieta, “I provvedimenti d’urgenza”, Padova, Cedam, 1985, fq. 137; Proto Pisani, “I provvedimenti d’urgenza ex art. 700 c.p.c.” në “Appunti sulla giustizia civile”, Bari, Cacucci, 1982, fq. 386.

<sup>173</sup> Carpi, “La tutela d’urgenza, I procedimenti cautelari e l’esecuzione nel disegno di legge per la riforma urgente del c.p.c: la competenza e il procedimento”, në Riv. trim.dir. poc.civ., 1990, fq. 63.

<sup>174</sup> Neni 6 i KPrC shqiptar

duke u ndodhur përpara një mosmarrëveshjeje kontraktore, si masë e përshtatshme e përkohshme për sigurimin e padisë mund të ishte sekuestrimi i llogarive të palës së paditur, bazuar në nenin 206/a të K.Pr.Civile...Gjykata, rast pas rasti, ka diskrecion të vendosë një masë të natyrës së sigurimit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të paditurit.”<sup>175</sup> Po kështu rezulton edhe nga një tjetër vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në të cilin parashikohet se: “Gjykata zgjedh atë masë sigurimi të objektit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të së paditurit.”<sup>176</sup>

Edhe lidhur me kërkesën për përcaktimin e *petitum* dhe *causa petendi* të padisë së themelit në doktrinën italiane ka pasur qëndrime të ndryshme. Disa autorë kanë mbajtur qëndrimin se një kërkesë e tillë nuk mund t'i imponohet kërkuarit ta përcaktojë në kërkesën për sigurim padie,<sup>177</sup> dhe të tjerë, që përbëjnë mendimin prevalues, shprehen se një kërkesë e tillë është e domosdoshme.<sup>178</sup> Në praktikën gjyqësore shqiptare duket se një çështje e tillë nuk përbën objekt diskutimi të paktën që pas nxjerrjes së vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është parashikuar qartazi se: “Përsa u përket masave të tjera të përshtatshme “që merren për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206, pika “b” të K.Pr.Civile, duhet të kemi parasysh gjithashtu se edhe ato duhet të kushtëzohen kurdoherë nga një objekt material i përcaktuar, apo i përcaktueshëm, i padisë. Është kjo arsyeja që gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë. Në rastin në shqyrtim gjykata që në fillim duhej të kish kërkuar nga paditësi që të përcaktonte objektin e padisë përsa i përket kërimit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ndërprerja e lidhjes së rrjetit (*ndërprerja e sinjalit*). Përcaktimi i objektit të padisë shërben si bazë fillestare për të vendosur lidhur me masat e sigurimit.”<sup>179</sup>

Në Itali ndeshim një qëndrim të dyzuar si të doktrinës, ashtu edhe të praktikës edhe lidhur me efektin që sjell mungesa e përcaktimit të *petitum* dhe *causa petendi* të padisë së themelit. Kështu, në disa raste mbahet qëndrimi se mungesa e përcaktimit të saj është shkak për mospranimin e kërkesës për sigurim padie,<sup>180</sup> në disa të tjera, se kërkesa është e pavlefshme,<sup>181</sup> dhe në të tjera se kjo mungesë është shkak për rrëzimin e kërkesës për sigurim padie.<sup>182</sup> Ndërkohë që gjejmë një qëndrim pothuajse të unifikuar përsa i përket faktit që *petitum* dhe *causa petendi* të padisë së themelit, duhet të jenë identike me atë të parashtruar në kërkesën për sigurim padie, pasi në të

<sup>175</sup> Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 10, datë 24.03.2004

<sup>176</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 479, datë 27.10.2011

<sup>177</sup> Arieta, “I provvedimenti d’urgenza”, Padova, Cedam, 1985, fq. 66, 72, 140, 283-284.

<sup>178</sup> Tommaseo, I provvedimenti d’urgenza, Padova, Cedam, 1983 fq.224, Mandrioli, I provvedimenti d’urgenza: deviazioni e proposte, në La tutela d’urgenza, Atti del CV convegno nazionale, Rimini, Maggioli, 1986, fq.20; Carpi, La tutela d’urgenza fra cautela, “senza anticipata” e giudizio di merito në I provvedimenti cautelari e l’esecuzione nel disegno di legge per la riforma urgente del c.p.c. la competenza e il procedimento, në Riv. Trim.dir.poc. civ. 1990, fq. 63.

<sup>179</sup> Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 10, datë 24.03.2004

<sup>180</sup> Vendim i Gjykatës së Katantias, datë 26 gusht 1993, Giur. It. 1994, I, 2, fq. 675; Vendim i Gjykatës së Barit, datë 24 shkurt 2003, Giur. It., 2003, fq. 1607; Vendim i Gjykatës së Parmës, datë 18 dhjetor 2000, Giur. It., 2001, fq. 1163; Vendim i Gjykatës së Torinos, datë 23 gusht 2002, Giur. It., 2003, fq. 1834

<sup>181</sup> C.Consolo, në AA.VV., Commentario, fq. 579; S. Recchioni, “Il Processo cautelare”, fq. 300.

<sup>182</sup> Vivegano, 1 gusht 1995, Foro it. 1996, I, fq. 1864



kundërt kjo mund të jetë shkak për revokimin ose ndryshimin e masës së sigurimit.<sup>183</sup> Në praktikën gjyqësore shqiptare duket se mungesa e përcakimit të objektit të padisë ka pasjellë rrëzimin e kërkesës për sigurim padie.<sup>184</sup>

Në Kodin e Procedurës Civile gjithashtu nuk gjejmë përcaktime se ku depozitohet kërkesa për sigurimin e padisë. Përpara se t'i japim një përgjigje kësaj çështjeje duhet të kemi parasysh se sigurimi i padisë mund të kërkohej përpara, gjatë, ose pas ngritjes së padisë. Është e kuptueshme që kur kjo kërkesë bëhet përpara se të ngrihet padia e themelit, ose njëkohësisht me të, ajo do të depozitohet në sekretarinë e gjykatës kompetente. Gjithashtu, referuar nenit 154/a të KPrC kërkesa për sigurim padie, qoftë kur ngrihet përpara ose bashkë me padinë e themelit, mund të paraqitet në gjykatë me postë. Po në rast se kërkesa ngrihet gjatë gjykimit të padisë së themelit, a mund t'i paraqitet ajo drejtpërdrejt gjyqtarit që është duke gjykuar themelin e padisë, apo duhet të depozitohet në sekretari? Nëse, mund t'i paraqitet gjyqtarit, a mund të bëhet ajo verbalisht me deklaram dhe të fiksohet në procesverbalin e seancës përgatitore apo gjyqësore? Gjykojmë se në rastin kur kërkesa ngrihet pas ngritjes së padisë së themelit, ajo mund t'i paraqitet gjyqtarit që është duke gjykuar themelin e padisë qoftë me shkrim ashtu edhe me deklaram dhe të fiksohet në procesverbalin e seancës gjyqësore, sidoqoftë kjo mund të mos jetë rast i mundshëm kur një nga palët është në mungesë dhe kërkesa për masë sigurimi duhet t'i njoftohet asaj.

Ndryshe nga Kodi ynë i Procedurës Civile, Kodi italian i Procedurës Civile, në nenin 669 parashikon shprehimisht se kërkesa për sigurim padie paraqitet në sekretarinë e gjykatës kompetente. Megjithatë pavarësisht këtij përcaktimi eksplicit, në doktrinën italiane ndeshim qëndrime të ndryshme. Kështu, ka autorë që shprehen se ky përcaktim duket që përjashton tërësisht mundësinë e paraqitjes së një kërkesë të tillë në formë verbale gjatë seancës gjyqësore,<sup>185</sup> madje edhe kur kërkesa paraqitet gjatë gjykimit të themelit të padisë, ajo duhet të depozitohet në sekretari.<sup>186</sup> Dhe ka të tjerë, që shprehen se kërkesa për sigurim padie përveçse mund të paraqitet në sekretarinë e gjykatës kompetente për gjykimin e themelit, mund të paraqitet edhe verbalisht në seancë dhe të transkriptohet në procesverbal.<sup>187</sup>

## 2. Gjykata kompetente për marrjen e masave të sigurimit të padisë

Për të përcaktuar gjykatën kompetente në të cilën mund të paraqitet kërkesa për sigurimin e padisë duhet të kemi parasysh dallimin mes ngritjes së kësaj kërkesë *ante causam* dhe njëkohësisht ose gjatë gjykimit të padisë së themelit. Gjithashtu nevoja për përcaktimin e gjykatës kompetente lind edhe në raste të tjera kur, mosmarrëveshja

<sup>183</sup> Oberto, op.cit. fq. 27; Frus, op.cit. fq. 614; Salvaneschi në "Il nuovo processo cautelare", nën kujdesin e Giuseppe Tarzia, Cedam, Padova, 1993, fq. 247.

<sup>184</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 108, datë 11.03. 2010 "Në konfliktin në gjykim, ashtu siç me të drejtë ka arsyetuar Gjykata e Apelit Gjirokastër në vendimin e saj, padia e paditësit nuk plotëson kushtet që parashikon neni 202/a i K.Pr.Civile, pasi paditësi Viron Papagjika nuk ka vërtetuar pronësinë e tij të ligjshme në truallin në të cilin ka filluar ndërtimin pala e paditur; jo vetëm kaq, por paditësi nuk ka përcaktuar as objektin e padisë për të cilën është kërkuar marrja e masës së përkohshme, ndërprerja e punimeve.

<sup>185</sup> Vendim i Gjykatës së Barit 29 Prill 1994; Vendim i Gjykatës së Trani 28 Korrik 1993; Vendim i Gjykatës së Bolonjas, datë 2 Korrik 1996 cituar në Crisanto Mandrioli, Diritto Processuale Civile, Vol IV, Torino 2011, fq. 257-258.

<sup>186</sup> Pisani, op.cit. fq. 643.

<sup>187</sup> Biavati, op.cit. fq. 689; G. Frus, "Commento al art. 74/699 bis", në "Le riforme del processo civile" nën kujdesin e Sergio Chiarlon, Zanichelli Editore, Bologna 1992, fq. 607-610.

e themelit i takon shkallëve të tjera të gjykimit, është në kompetencë lëndore të gjykatave penale, apo në juridiksion gjyqësor të huaj apo të arbitrazhit.

### **2.1. Kompetenca ante causam dhe gjatë gjykimit të padisë së themelit**

Në rast se kërkesa paraqitet njëkohësisht, ose pas paraqitjes së padisë së themelit, megjithëse KPrC nuk ka bërë ndonjë përcaktim të shprehur është logjike që po kjo gjykatë do të jetë kompetente edhe për shqyrtimin e kërkesës për sigurim padie. Kurse në rast se kërkesa ngrihet *ante causam*, gjykata kompetente mund të jetë ose gjykata e vendit ku ka banimin paditësi ose ajo ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia.<sup>188</sup> Pra, në këtë rast Kodi i Procedurës Civile ka parashikuar për kompetencë tokësore *konkurruese* me zgjedhje duke i dhënë mundësinë kërkuarit, që për efekt të rëndësisë së marrjes së masave të sigurimit dhe shpejtësisë me të cilën duhet të bëhet një gjykim i tillë, të zgjedhë gjykatën ku ai mund të realizojë më shpejt mbrojtjen e përkohshme të të drejtave, sikurse është gjykata e vendbanimit të tij, ose e vendit ku do ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia, pavarësisht se kjo mund të mos jetë gjykata kompetente për gjykimin e themelit të padisë.

Ajo që nuk del e qartë nga Kodi i Procedurës Civile është se si vepron në lidhje me gjykimin e kërkesës për sigurim padie, nëse ajo është ngritur *ante causam* në gjykatën e vendbanimit të paditësit, ose të vendit ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia, por për shkak të vonësave në gjykimin e kësaj kërkesë, ngrihet njëkohësisht dhe padia e themelit në gjykatën kompetente të njëjtë apo të ndryshme nga ajo ku po gjykohet kërkesa për sigurim padie. A mund të vazhdojë gjykimi i kërkesës për sigurim padie në gjykatën ku ka filluar, apo duhet të bëhet bashkimi i gjykimit me gjykimin e padisë së themelit? Në një situatë të tillë referuar nenit 55 të KPrC, i cili përcakton se gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore dhe në këtë rast ajo merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme, gjykimi i kërkesës për sigurim padie duhet t'i kalojë gjykatës kompetente për gjykimin e themelit. Megjithatë rasti në fjalë nuk është ekzakt ai i parashikuar nga neni 55, ku nëse një kërkesë dytësore paraqitet rishtazi në gjykimin e themelit të padisë, atëherë kjo gjykatë, e cila është gjithashtu kompetente edhe për gjykimin e kërkesave dytësore vendos për bashkimin e tyre me gjykimin e themelit. Situata në fjalë është kur kjo kërkesë dytësore (masa e sigurimit) është duke u gjykuar në një gjykatë tjetër, ndaj mbetet e paqartë se si vepron praktikisht për realizimin e një transferimi të tillë. Cila është gjykata që do të vendosë për bashkimin e çështjeve, ajo që po shqyrton kërkesën për sigurimin e padisë, apo ajo që është kompetente për themelin e saj? Mendojmë se zgjidhja më e arsyeshme do të ishte që në rastin e një bashkimi të tillë, vendimi të merrej nga gjykata që gjykon kërkesën për sigurimin e padisë. Dhe në fakt praktika gjyqësore shqiptare është e pasur me raste të bashkimit të gjykimit të kërkesës për sigurim padie me padinë e themelit.<sup>189</sup> Shumica e vendimeve të bashkimit të gjykimit janë tërësisht të paarsyetuara. Ndër të paktat vendime të arsyetuara gjykatat shprehin se: “Nëpërmjet shortit elektronik të datës 30.10.2013 është regjistruar dhe kaluar për

<sup>188</sup> Neni 204 i KPrC

<sup>189</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 395, datë 15.05.2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 745, datë 20.09.2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 843, datë 10.10. 2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 878, datë 25.10.2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 920, datë 12.11.2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 970, datë 06.12.2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 101, 14.01.2014

shqyrtim pranë kësaj Gjykate, kërkesa civile me Nr. 912 Akti, përshkruar sa më lart. Nga ana e gjyqtarës së vetme, është caktuar seanca për marrjen në shqyrtim të kësaj kërkesë për në datën 06.11.2013 ora 15.00. Ndërkohë, në datën 01.11.2013, është kaluar për shqyrtim pranë së njëjtës gjykatë, edhe padia e themelit, regjistruar me Nr. 18932 Akti datë 31.10.2013. Nga sa më sipër,...vihet re qartë se kërkitimi i paraqitur prej palës paditëse në kërkesën e regjistruar si çështje më vete, përbën kërkitim dytësor që lidhet drejtpërdrejt me kërkitimin kryesor të padisë. Në kushtet e nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: *“Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore... Në këtë rast gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme.”* Gjykata konkludon në bashkimin e kërkesës civile Nr. 912 Akti datë 30.10.2013 me çështjen e themelit me Nr. 18932 Akti datë 31.10.2013, duke u bërë pjesë e këtij gjykimi.”;<sup>190</sup> ose *“Gjykata konstaton se pranë saj është paraqitur kërkesa për sigurim padie, e cila është depozituar në gjykatë më datë 26.12.2012 si dhe pranë kësaj gjykate është paraqitur padia e themelit, e cila është depozituar më datë 21.12.2012, gjë e cila do të thotë që kërkesa për sigurim padie nuk plotëson kërkesat e ligjit procedural për tu trajtuar si kërkesë më vete pasi është paraqitur si e tillë mbas ngritjes së padisë së themelit. Në këto kushte kjo kërkesë do i bashkëngjitet padisë së themelit dhe do të gjykohet kur të gjykohet padia e themelit e regjistruar me nr.20719 akti datë 24.12.2012”*<sup>191</sup>

Ndërkohë që për fat të keq në praktikën gjyqësore shqiptare ndeshim edhe raste ku gjykata kur ka qenë në kushtet e një rasti të pastër të bashkimit të gjykimit të kërkesës për sigurim padie me gjykimin e themelit ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sigurim padie dhe jo bashkimin e saj me padinë e themelit. Përkatesisht, në një rast gjykata është shprehur: *“Gjykata, pasi shqyrtoi të gjithë rrethanat e çështjes në tërësinë e saj, vlerëson e çmon se kërkesa në gjykim duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj. Në rastin konkret, rezulton se padia e themelit “Për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore” (e pretenduar nga pala paditëse) është ngritur madje ajo rezulton se është hedhur edhe në short në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë – çka do të thotë se në vështrim të nenit 204 të K.Pr.Civile nuk ka vend më për shqyrtimin e kërkesës në gjykim; porse, kjo masë sigurimi padie si më lart që kërkon pala kërkuese mund të kërkohet prej saj në këtë situatë si më sipër vetëm në vështrim të nenit 202 e vijues të K.Pr.Civile domethënë brenda shqyrtimit gjyqësor të padisë së themelit në fjalë – çka do të thotë se përfundimisht kërkesa në gjykim duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj.”*<sup>192</sup>

## **2.2. Kompetenca në rastin e padisë civile në procesin penal**

Kur flasim për përcaktimin e kompetencës në gjykimin e kërkesave për sigurim padie duhet të kemi parasysh gjithashtu se një padi civile mund të ngrihet edhe në procesin penal.<sup>193</sup> Në këtë rast rregullimin e kompetencës e gjejmë në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, i cili në nenin 63 parashikon se për të siguruar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit, me kërkesën e paditësit civil, organi procedues mund të vendosë sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil. Pra, në një rast të tillë gjykata kompetente për sigurimin e padisë së kërkuar njëkohësisht

<sup>190</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 912, datë 30.10.2013

<sup>191</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 112, datë 14.01.2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 787, datë 28.10.2012

<sup>192</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 436, datë 27.05.2013

<sup>193</sup> Neni 61 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: “1. Ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrejë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.

ose pas ngritjes së padisë së themelit është gjykata penale kompetente për gjykimin e një veprë penale. Ndërkohë që nëse kërkesa për sigurimin e padisë do të ngrihej përpara se të ngrihej padia civile në procesin penal, atëherë zbatohen të njëjtat rregulla për përcaktimin e kompetencës të parashikuara në nenin 204 të KPrC. Kështu në një vendim, Gjykata e Apelit Tiranë është shprehur: “Nga ana tjetër, në këtë proces penal, i dëmtuari kallëzues, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Tot Trading In Oil & Transport” sha, referuar nenit 61 të K.Pr.Penale, paraqet padinë civile me të cilën kërkon “Kthimin e shumës dhe shpërblimin e dëmit. Në të njëjtën kohë, referuar nenit 63 të K.Pr.Penale, paditësi ka kërkuar edhe sigurimin e kësaj padie.” Rezulton nga aktet e dosjes gjyqësore se me vendim të ndërmjetëm dhe pasi ka marrë edhe mendimin e prokurorit të çështjes, gjykata ka vlerësuar të mos e veçojë padinë civile nga procesi penal, ndërkohë që me vendimin nr.1976 akti, dt.20.12.2011, ka pranuar kërkesën e paditësit për sigurimin e padisë duke vendosur: *Urdhërimin e ZQRPP Tiranë, që nëpërmjet ZVRPP nëpër rrethe, të bllokojë pasuritë e paluajtshme nëpër rrethe në emër të shtetasit Arben Naun Petto; dhe/ose sekuestrimin e të gjitha llogarive bankare të shtetasit Arben Naun Petto; Llogaritë bankare të shoqërisë “BI Investment” shpk; dhe/ose Llogaritë bankare të Institutit të Studimeve dhe Projektiveve Pyjore (ISPP) sha, apo kredive të këtyre subjekteve, jo më shume se në shumën prej 79.724.171 leke, deri në përfundim të gjykimit të çështjes penale nr.1976 akti, dt.17.08.2011, në ngarkim të të pandehurit Arben Petto, i akuzuar për veprën penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal”<sup>194</sup>*

### **2.3. Kompetenca në rastin e gjykimit në apel**

Gjithashtu sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Pra, sigurimi i padisë lejohet edhe nga gjykata e apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj.<sup>195</sup> Në këtë rast kompetente do të ishte gjykata e apelit, e cila është kompetente për shqyrtimin e ankimit kundër vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë. Në praktikën gjyqësore shqiptare ndeshim raste kur megjithëse është dhënë një vendim përfundimtar, ndaj të cilit është ushtruar ankim në gjykatën e apelit, kërkesa për sigurim padie i paraqitet gjykatës së shkallës së parë. Lidhur me natyrën e vendimit që duhet të japë gjykata e shkallës së parë në këtë rast ndeshim qëndrime të kundërta. Kështu, në një rast konkret gjykata e shkallës së parë ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e një kërkesë për sigurim padie duke ia kaluar aktet gjykatës së apelit me argumentet se: “Gjykata çmon se nuk ka kompetencë për gjykimin e kësaj çështjeje civile, të kthyer për rigjykim, pasi ka përfunduar themeli i gjykimit të saj dhe dosja është dërguar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata vlerëson se kompetente për këtë gjykim është Gjykata e Apelit Tiranë, si gjykata që ka për shqyrtim kërkesën ankimore ndaj vendimit të themelit të çështjes civile, ndaj vendimit nr.10544 datë 03.11.2014 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë.”<sup>196</sup> Ndërkohë që në një tjetër rast gjykata e shkallës së parë kur ka çmuar se kompetente për marrjen e masës së sigurimit është gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sigurim padie dhe jo shpalljen e moskompetencës. Konkretisht gjykata është shprehur se: “Kërkimi për marrjen e masës së përkohshme, sigurimin e padisë është i pabazuar në nenin 203 të K.Pr.Civile. Neni 203/2 i K.Pr.Civile parashikon veç të tjerash se:

<sup>194</sup> Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 225, datë 06.03.2013

<sup>195</sup> Neni 203 i KPrC

<sup>196</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 378, datë 08.04.2015

*“Sigurimi i padisë lejohet edhe nga gjykata e apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj”*. Sikundër rezultoi e provuar në gjykim, Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka disponuar me vendimin Nr.958, datë 05.02.2013 me pranimin e padisë pa u shprehur për ndonjë masë të përkohshme sigurimi padie. Pala kërkuese është duke kërkuar marrjen e një mase të përkohshme, sigurim të padisë, masë e cila lidhet me procesin gjyqësor civil për të cilin është disponuar me vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë sa më sipër. Kërkimi për marrjen e një mase sigurimi në funksion të atij procesi, në kuptim të nenit 203/2 të K.Pr.Civile është në diskrecion të Gjykatës së Apelit, si Gjykata pranë të cilës ndodhet aktualisht çështja civile për të cilën është disponuar me vendimin Nr. 958, datë 05.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Parë në këtë këndvështrim, gjykata vlerëson se, subjekti kërkues duhet t’i drejtohej Gjykatës së Apelit Tiranë për t’u shprehur në lidhje me kërtime të kësaj natyre. Për sa sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa është e pambështetur në ligj dhe prova dhe si e tillë duhet rrëzuar.<sup>197</sup> Gjykojmë se në një rast të tillë vendimmarrja e duhur nuk duhet të ishte rrëzimi i kërkesës për sigurim padie, pavarësisht se kjo nuk ia mohon të drejtën kërkuesit ta ngrejë sërish në gjykatën kompetente kërkesën për sigurimin e padisë, por shpallja e moskompetencës dhe dërgimi i akteve gjykatës kompetente.

Përcaktimi se masat për sigurimin e padisë mund të merren derisa vendimi të marrë formë të prerë dhe duke pasur parasysh që sipas nenit 451 të KPrC, vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij; b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar; ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimin në shkallë të dytë, lë qartazi të kuptohet se nuk lejohet ngritja e kërkesës për sigurim padie në Gjykatën e Lartë.

#### **2.4. Kompetenca në rastin e gjykimit të themelit nga juridiksioni gjyqësor i huaj**

Ndërkohë, gjykatat shqiptare kanë të drejtë të marrin masa sigurimi edhe në rastet kur gjykimin i themelit të mosmarrëveshjes nuk është në juridiksionin gjyqësor shqiptar, apo nuk i përket juridiksionit gjyqësor. Përkatësisht, në bazë të nenit 81 Ligjit nr.10 428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” gjykatat shqiptare kanë juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimit. Rregulli i përgjithshëm i juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare parashikohet në nenin 71 të ligjit “Për të drejtën ndërkombëtare private”, sipas të cilit gjykatat shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur rregullat e këtij kapitulli parashikojnë ndryshe. Rregullat e posaçme të juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare parashikohen nga nenet 72-81 të këtij ligji. Nga neni 81 si më sipër cituar kuptohet se gjykatat shqiptare do të kenë juridiksion për të marrë masa sigurimi jo vetëm kur ato kanë juridiksion për të gjykuar themelin e padive për mosmarrëveshje me elemente të huaj, por edhe në rastin kur ato nuk kanë juridiksion për gjykimin e themelit, me kushtin që masa e sigurimit të ekzekutohet në Shqipëri. Por në këtë dispozitë nuk gjejmë një përcaktim konkret mbi kompetencën, pra cila do të jetë gjykata shqiptare kompetente për marrjen e masës së sigurimit, në kushtet kur gjykimin i themelit të padisë i përket një juridiksioni të huaj. Megjithatë

<sup>197</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 386, datë 22.05.2013

është mëse logjike, se në një rast të tillë, kompetente për marrjen e një mase sigurimi do të ishte gjykata e vendit ku do të kryhet ekzekutimi i vendimit për sigurimin e padisë.

Edhe përpara miratimit të Ligjit të ri “Për të drejtën ndërkombëtare private”, e drejta e gjykatave shqiptare për të marrë masa sigurimi kur gjykimi i themelit të padisë ishte në juridiksionin e një gjykate të huaj ishte konfirmuar nga praktika gjyqësore. Shohim kështu për shembull vendimin nr. 22, datë 11.01.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në të cilin gjykata arrin në konkluzionin se personi fizik apo juridik i huaj mund t'i drejtohet gjykatës shqiptare me kërkimin për sigurimin e padisë, në rast se pasuria/asetet e të paditurit (debitorit) ndodhet në RSh, edhe pse kompetente për të shqyrtuar çështjen e themelit mund të jetë një gjykatë tjetër e huaj apo arbitrazhi.

## ***2.5. Kompetenca në rastin e gjykimit të themelit nga juridiksioni i arbitrazhit***

Gjykatat shqiptare kanë të drejtë të marrin masa sigurimi edhe në rastet kur gjykimi i themelit të mosmarrëveshjes është në juridiksionin e arbitrazhit, qoftë ky vendor, ndërkombëtar, apo i huaj. Në nenin 418 të KPrC, i cili është i aplikueshëm për arbitrazhin vendor, parashikohet se: “Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njëres prej palëve mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve. Nëse palët nuk kanë vendosur rregulla për një qëllim të tillë, gjykata e arbitrazhit zbaton rregullat e parashikuara në këtë Kod për sigurimin e padisë. Nëse pala tjetër nuk zbaton vullnetarisht këto masa, gjykata e arbitrazhit i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.” Ndonëse nga kjo dispozitë nuk njihet shprehimisht e drejta e gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi në lidhje me një proces arbitrazhi, praktika gjyqësore shqiptare tashmë është e konsoliduar në qëndrimin se gjykatat shqiptare mund të marrin masa për sigurimin e padisë në lidhje me një proces arbitrazhi dhe kjo nuk konsiderohet në mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit. Përsa i përket arbitrazhit ndërkombëtar, megjithëse në Shqipëri ende nuk ka një ligj që ta rregullojë atë në mënyrë të posaçme, Konventa e Gjenevës “Për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar”, e cila është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë që prej vitit 2000, qartazi parashikon në nenin VI(4) se: “Kërkesa për masë sigurimi drejtuar autoriteteve gjyqësore nuk do të konsiderohet në mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit.” Nga një përcaktim i tillë kuptohet që palët mund t'i drejtohen si gjykatës së arbitrazhit dhe asaj shtetërore për marrjen e një mase sigurimi pa shkelur marrëveshjen e tyre të arbitrazhit.<sup>198</sup>

Përsa i përket përcaktimit të gjykatës kompetente në rastin kur gjykata ushtron juridiksionin për dhënien e masave të sigurimit në ndihmë të arbitrazhit, neni 418 i KPrC dhe Konventa e Gjenevës nuk kanë përcaktime, sidoqoftë gjykojmë se në rastin e arbitrazhit të huaj gjykata kompetente do të ishte gjykata e vendit ku do të kryhet ekzekutimi i vendimit për sigurimin e padisë, referuar kjo dhe nenit 81 të Ligjit “Për të drejtën ndërkombëtare private”, kurse në rastin e arbitrazhit të brendshëm do të ishin të vlefshme të njëjtat rregulla për përcaktimin e kompetencës të parashikuara në nenin 203 të KPrC, pra gjykata ku ka banimin paditësi, ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia, kur kërkesa për sigurim padie ngrihet para se të ngrihet padia në arbitrazh dhe gjykata e vendit të arbitrazhit në rast se kërkohet sigurimi i padisë pasi është formuar gjykata e arbitrazhit.

---

<sup>198</sup>Për një trajtim më të detajuar të kësaj çështjeje shih Pjesën II, Kreu IV

Në kushtet kur gjykatat kanë juridiksion për dhënien e masave të sigurimit të ndihmë të një procesi gjyqësor apo arbitrazhit të huaj, natyrshëm mund të lindë pyetja a e pengon gjykatën shqiptare të japë një vendim për sigurim padie kur një gjykatë e huaj ka dhënë një masë sigurimi? Gjykojmë se përgjigjja është jo, referuar jo vetëm nenit 38 të KPrC, i cili parashikon se gjykata shqiptare nuk pushon as pezullon gjykimin e një mosmarrëveshje, kur kjo e fundit ose një tjetër çështje që ka lidhje me të, është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj, por edhe faktit se vendimi për masë sigurimi nuk është një vendim i formës së prerë dhe nuk ka efektin *res judicata*.<sup>199</sup> Megjithatë në arbitrazhin ndërkombëtar qëndrimi prevalues është që gjykatat shtetërore duhet të tregojnë kujdes në ndërhyrjen për marrjen e një mase sigurimi, përsa kohë që vetë gjykata e arbitrazhit është në gjendje të marrë një masë të tillë.<sup>200</sup>

### 3. Procedura e gjykimit të kërkesës për marrjen e masave të sigurimit të padisë

Procesi i marrjes së masave të sigurimit të padisë është rrjedhojë e nevojës për zgjidhjen e shpejtë të llojeve të ndryshme të kërkesave urgjente. Për këtë arsye, ai ka një natyrë të përshpejtuar, i cili realizohet pa respektuar disa nga formalitetet e një procesi të zakonshëm gjyqësor, por gjithmonë në respektim të të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe në funksion të dhënies efektive të drejtësisë. Për të arritur qëllimin e tyre, masat e sigurimit të padisë i nënshtrohen një procedure që karakterizohet nga urgjenca, e cila justifikon përjashtimisht edhe cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe nuk lejon shqyrtimin e themelit të padisë. Gjatë këtij procesi, gjykata pasi heton në mënyrë sipërfaqësore provat e paraqitura dhe në bazë të bindjes së krijuar prej tyre mbi ekzistencën e kushteve për dhënien e masave të sigurimit, merr vendim për pranimin apo rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

#### 3.1. Shpejtësia e gjykimit

Tërësia e procesit të gjykimit të kërkesës për sigurim padie karakterizohet nga urgjenca dhe shpejtësia. Kjo është në funksion të arritjes së qëllimit të masave të sigurimit, ofrimit të mbrojtjes të përkohshme dhe të përshpejtuar të të drejtave të paditësit nga frika se gjatë dhënies së vendimit përfundimtar do të shkaktohet ndonjë dëm i riparueshëm në të drejtën e paditësit apo se ky vendim do të bëhet i vështirë apo i pamundur për tu ekzekutuar. Në përgjigje të këtij karakteri urgjent, Kodi i Procedurës Civile ka parashikuar për mundësinë e ngritjes së kërkesës për sigurim padie edhe para ngritjes së padisë së themelit (*ante causam*). Sikurse shprehet Gjykata e Lartë në një vendim: “Ky gjykim kërkon shpejtësi për të parandaluar pasoja të cilat do të ishin të riparueshme, ose që kërkojnë më shumë kohë dhe kontribut për riparimin e tyre në qoftë se përgjigjja apo vendimmarrja gjyqësore nuk do ishte në kohën e duhur. Jo pa qëllim ligjvënësi lejon sigurimin e padisë edhe përpara se të ngrihet ajo.”<sup>201</sup> Megjithëse neni 204 i KPrC, i cili parashikon se sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia, duket se nuk kërkon plotësimin e ndonjë kushti në mënyrë që të pranohet gjykimi i kërkesës për sigurimin e padisë përpara ngritjes së padisë së themelit, duket se në disa raste, ndonëse në minorancë, gjykatat e kanë interpretuar këtë dispozitë ngushtësisht, duke lejuar masën

<sup>199</sup> Shiko gjithashtu: Vendim i gjykatës së Padova datë 13.02.1996 në Giur. It., 1996, I, 2, 460

<sup>200</sup> Për më shumë shiko Pjesën II të këtij punimi

<sup>201</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 849, datë 29.06.2006



e sigurimit *ante causam*, vetëm në kushtet kur kërkuesi provon se është në pamundësi objektive për hartimin e kërkesëpadisë sipas neneve 31, 32, 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, dhe i provon gjykatës emergjencën imediate për marrjen e kësaj mase përpara paraqitjes së padisë në gjykatë.<sup>202</sup> Gjykojmë se një interpretim i tillë i ngushtë i kësaj dispozite nuk është në përputhje me funksionin e masave të sigurimit të padisë dhe nuk besojmë se ka qenë në qëllimin e legjislatorit.

Gjithashtu, po në përgjigje të nevojës urgjente për marrjen e masave të sigurimit, Kodi i Procedurës ka përcaktuar edhe afate të posaçme dhe të shpejta për gjykimin e kërkesave për sigurim padie. Konkretisht, KPrC parashikon se me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.<sup>203</sup> Nga ky parashikim nuk del qartë se nga cili moment duhet të llogaritet afati 5 ditor. Normalisht ky afat duhet të llogaritet nga data e hedhjes së shortit për caktimin e gjyqtarit, i cili duhet të caktojë seancën për shqyrtimin e kërkesës për sigurim padie brenda 5 ditëve. Sidoqoftë, vendosja e një afati të tillë është më tepër udhëzues, sesa detyrues, pasi në praktikë, pavarësisht nevojës urgjente për marrjen e masës së sigurimit vendosja për masën brenda 5 ditëve është gati e pamundur duke pasur parasysh ngarkesën e gjykatave shqiptare. Nga monitorimi i rasteve pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë të pakta rastet kur vendimi për masë sigurimi është dhënë brenda afatit 5 ditor, përgjithësisht kjo ka ndodhur gjatë muajit gusht, kur gjykata nuk zhvillon gjykime për paditë e themelit, ndërsa në të shumtën e rasteve procesi i marrjes së masës së sigurimit ka zgjatur rreth njëqind ditë.

Kodi i Procedurës Civile, në funksion të shpejtësisë së gjykimit, parashikon se masa për sigurimin e padisë mund të merret edhe në seancë përgatitore. Konkretisht në nenin 158/a përcaktohet se: “Gjyqtari cakton, për çdo çështje, seancën përgatitore, ku thirren palët ose personi i tretë, për të përcaktuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe kërkon prej tyre shpjegimet e nevojshme, si dhe përcaktimin e provave për vërtetimin e pretendimeve e të prapësimeve të tyre. Gjyqtari, me vendim, kryen këto veprime: Kur është rasti, vendos për vënien e sekuestros ose për marrjen e ndonjë mase tjetër për sigurimin e padisë.”

Pavarësisht, qartësisë së kësaj dispozite, në praktikën gjyqësore ndeshim raste kur gjykata shtyn dhënien e vendimit për masën e sigurimit në seancë gjyqësore, duke argumentuar se nuk mund të japë një vendim të tillë në seancë përgatitore. Në fakt një arsyetim i tillë nuk gjen mbështetje askund, ndaj me të drejtë Gjykata e Apelit Tiranë, në një vendim të saj in është shprehur se: “Masa e sigurimit mund të vendoset në seancë përgatitore, pra ligjvënësi ka çmuar që edhe në këtë seancë gjykata mund të shqyrtojë këto kërkitime të ngutshme të palëve.”<sup>204</sup>

Për fat të keq praktika na ofron edhe raste kur gjykata ka shtyrë dhënien e vendimit mbi kërkesën për sigurim padie deri në dhënien e vendimit përfundimtar, duke ia humbur në këtë mënyrë tërësisht qëllimin masës së sigurimit, si një masë e karakterit urgjent. I tillë është rasti ku gjykata, megjithëse kërkesa për sigurimin e padisë është parashtruar së bashku me ngritjen e padisë, me vendimin e saj përfundimtar ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.
- Detyrimin e të paditurve shoqëria “C.A.E” sh.p.k dhe shoqëria “ACMAR” s.c.p.a të përmbushin detyrimin ndaj paditësit shoqërisë “KDK” sh.p.k, në

<sup>202</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 130, datë 18.02.2014; Shiko gjithashtu: Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 471, datë 28.05.2015

<sup>203</sup> Neni 202 i KPrC

<sup>204</sup> Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 48, datë 02.02.2012



shumën 248.032,24 (dyqind e dyzet e tetë mijë e tridhjetë e dy presje njëzet e katër) Euro si dhe fitimin e munguar në masën 2.019.673 (dy milion e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

- Marrjen e masës provizore për sigurimin e padisë duke urdhëruar bllokimin e pasurive të paluajtshme dhe të llogarive bankare të të paditurve shoqëria “C.A.E” sh.p.k dhe shoqëria “ACMAR” s.c.p.a, në masën e detyrimit të cituar më sipër, deri në marrjen formë të prerë të vendimit.
- Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të saj.
- Shpenzimet gjyqësore të përbëra nga 1% i padisë dhe shpenzimet për kryerjen e ekspertimit në ngarkim të të paditurve solidarisht.<sup>205</sup>

### 3.2. Kontradiktoriteti dhe masat ex parte

Në parim procesi i sigurimit të padisë, ashtu si procesi i gjykimit të themelit të padisë, karakterizohet nga respektimi i parimit të kontradiktoritetit, sepse kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, dhe vetëm në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur pala tjetër.<sup>206</sup> Për të garantuar respektimin e parimit të kontradiktoritetit në gjykimin civil është e domosdoshme prania e palëve, si kërkuesit ashtu dhe palës së paditur. Prania e tyre bëhet e mundur nëpërmjet njoftimit, i cili realizohet sipas rregullave të përgjithshme për kryerjen e njoftimeve, sipas KPrC. Por në raste të caktuara, është vetë ligji ai që parashikon mosrespektimin e këtij parimi, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të caktuara, duke ia lënë në diskrecion gjykatës të vendosë rast pas rasti, në kushtet e urgjencës nëse gjykimi mund të bëhet *inaudita altera parte*.

Marrja e vendimit për të zhvilluar një proces *inaudita altera parte* është një çështje shumë delikate, që nuk ka përcaktime precize. Kriteri më i drejtë për një vendimmarrje të tillë do të ishte balancimi i dy interesave të kundërt: e drejta e mbrojtjes së të paditurit dhe rreziku që edhe një vonesë shumë e vogël apo dhe thjesht njoftimi për zhvillimin e procesit mbi sigurimin e padisë mund të sjellin pasoja të tilla sa mund të dëmtojnë përgjithmonë të drejtën objekt konflikti. Prosesi i sigurimit të padisë duhet të jetë në mbrojtje të të drejtës materiale dhe nëse në raste ekstreme respektimi i parimit të kontradiktoritetit do të vinte në rrezik të drejtën materiale duhet të mos merret në konsideratë as e drejta e të paditurit për tu mbrojtur.<sup>207</sup>

Mosrespektimi i parimit të kontradiktoritetit justifikohet në ato raste kur mund të dëmtohet ekzekutimi i masës së sigurimit; nga njëra anë në ato raste kur urgjenca për të vepruar është e tillë sa të mos lejohet as vonesën më minimale për njoftimin e palës tjetër, nga ana tjetër në ato raste kur njoftimi i palës tjetër do t'i jepte asaj mundësi t'i shmangej efekteve të vetë masës së sigurimit.<sup>208</sup> Megjithatë, pavarësisht këtij përjashtimi nga parimi i kontradiktoritetit, garancia e tij nuk eliminohet, sepse edhe në rast se pala e paditur nuk merr pjesë në procesin për sigurimin e padisë, pra është në mungesë, ajo gjithnjë ka mundësinë që të bëjë ankim të veçantë kundër këtij vendimi brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit. Kjo është mënyra që ka parashikuar kodi ynë i procedurës civile për të balancuar pasojat e zhvillimit të procesit në mungesë të respektimit të parimit të kontraktoritetit. Ndërkohë që nëse shohim kodin italian të procedurës civile do të vëmë re një

<sup>205</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1511, datë 27.02.2015

<sup>206</sup> Neni 205 i KPrC

<sup>207</sup> Biavati, op.cit. fq. 692-693

<sup>208</sup> Luiso, “La riforma dei procedimenti cautelari”, në Documenti Giustizia, 1990, fq. 50; Pisani, op.cit. fq. 645

mekanizëm tjetër. Garancia e kontradiktoritetit realizohet në një kohë të mëvonshme nga dhënia e vendimit për sigurimin e padisë. Konkretisht, neni 669-sexies i KPrC italian parashikon se nëse masa e sigurimit është dhënë pa u dëgjuar pala tjetër, atëherë gjyqtari fikson po në këtë vendim dhe datën e një seance në të cilën palët do të paraqiten, e cila duhet të jetë brenda 15 ditëve nga data e dhënies së vendimit. Në këtë seancë, gjyqtari me vendim konfirmon, ndryshon, ose revokon masën e sigurimit të dhënë në procesin *inaudita altera parte*. Pra, vendimi i gjykatës për sigurimin e padisë të marrë *inaudita altera parte* nuk është objekt ankimi, ndërkohë që mund të ankimohet vendimi i dhënë në seancën e mëvonshme në të cilën palët janë prezent dhe gjykata konfirmon, ndryshon, ose revokon masën e sigurimit të dhënë në procesin *inaudita altera parte*.<sup>209</sup>

### **3.3. Mosparagjykimi i themelit të padisë**

Në mungesë të përcaktimeve ligjore lidhur me veprimtarinë procedurale të gjykatës gjatë shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë, doktrina dhe praktika gjyqësore kanë vendosur disa standarde veçanërisht lidhur me raportin me themelin e padisë. Konkretisht, është mbajtur qëndrimi se urgjenca e rastit nuk lejon që të shqyrtohet themeli i pretendimeve, por gjykata në këtë rast bën vetëm një shqyrtim të sipërfaqshëm (*summaria cognito*).<sup>210</sup> Lidhur me këtë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>211</sup> shprehen se: “Gjykata vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesë në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu, shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel, ose nuk është e paanshme në gjykim.”

### **3.4. Ndërhyrja e të tretit**

Në asnjë nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë masat e sigurimit të padisë në procesin civil nuk ndeshim ndonjë përcaktim në lidhje me mundësinë e ndërhyrjes të personave të tretë në gjykimin e kërkesës për sigurim padie. Në fakt në zbatim të rregullave të përgjithshme të KPrC, duket se nuk ka asnjë pengesë për personin e tretë që mund t’i cenohen interesat nga masa e sigurimit të realizojë ndërhyrjen. Një qëndrim i tillë gjën mbështetje edhe nga doktrina italiane.<sup>212</sup>

### **3.5. Natyra e vendimeve për sigurim padie**

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesës për sigurim padie, qoftë para apo pas ngritjes së padisë së themelit mund të marrë vendim për pranimin e masës së sigurimit, ose refuzimin e saj. Ajo që duhet të theksojmë është se ky vendim i gjykatës nuk shprehet për themelin e mosmarrëveshjes, por ai është një vendim i ndërmjetëm.

<sup>209</sup> Shiko gjithashtu, Pisani, op. cit. fq. 645; Biavati, op. cit. fq. 693; Mandrioli, op.cit. fq. 266

<sup>210</sup> F.Kola, A.Vokshi “Procedura Civile” Vëllimi I, Tiranë 2013, fq. 216

<sup>211</sup> Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 10, datë: 24.03.2004

<sup>212</sup> Shiko Biavati, op.cit. fq. 691; Mandrioli, op.cit., fq. 264

### 3.5.1. Vendimi për moskompetencë

Në rastin kur kërkesa për sigurimin e padisë ngrihet *ante causam*, mund të ndodhemi edhe para situatës kur gjykata me vendim mund të shpallë moskompetencën, për shkak se kërkesa nuk është paraqitur as në gjykatën e vendbanimit të paditësit dhe as në gjykatën ku ndodhet pasuria me anë të të cilës do të sigurohet padia. Në një situatë të tillë, gjykata kur konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e kërkesës vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.<sup>213</sup> Në një rast konkret gjykata është shprehur se: “Nga sa më lart Gjykata konstaton se në kushtet kur pala nuk ka identifikuar pasuritë me të cilat kërkon të sigurohet padia, për të përcaktuar më pas Gjykatën kompetente në lidhje me vendosjen e masës së sekuestros, Gjykata kompetente do të jetë gjykata e vendit ku ka selinë pala paditëse, që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. 7. Sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është kompetente, për shkak të mungesës së kompetencës tokësore në shqyrtimin e kërkesës objekt i këtij gjykimi.”<sup>214</sup>

Sikurse u përmend më sipër, në praktikën gjyqësore shqiptare ndeshen raste kur gjykatat kanë vendosur rrëzimin e kërkesës për shkak të moskompetencës së tyre për tu shprehur për masën e sigurimit. Ndonëse kjo nuk është vendimmarrja e duhur, ajo nuk ka ose të paktën nuk duhet të ketë pasoja lidhur me mundësinë për të ngritur sërish një kërkesë të tillë në gjykatën kompetente, qoftë edhe pa pretenduar ndryshim të rrethanave.

Theksojmë se Kodi italian i Procedurës Civile parashikon shprehimisht moskompetencën si shkak për mospranimin e kërkesës për sigurimin e padisë dhe se një vendim i tillë nuk mund të jetë pengesë për kërkuesin që të ngrejë sërish po atë kërkesë në gjykatën kompetente.<sup>215</sup> Në kushtet kur Kodi ynë i Procedurës Civile nuk ka bërë ndonjë parashikim specifik lidhur me këtë situatë, gjykojmë se vendimi më i përshtatshëm që mund të marrë gjykata në një rast të tillë është shpallja e moskompetencës dhe kalimi i akteve gjykatës kompetente për tu shprehur në lidhje me kërkesën për sigurim padie.

### 3.5.2. Vendimi i rrëzimit të kërkesës për masë sigurimi

Shkaqet për të cilat mund të rrëzohet kërkesa për sigurimin e padisë mund të jenë të ndryshme, përmendim këtu si shkaqe procedurale, p.sh. për mungesë të legjitimitetit (*legitimitatio ad processum*),<sup>216</sup> ashtu dhe shkaqe të mosplotësimit të kushteve për dhënien e masave të sigurimit, si p.sh. nuk provohet *periculum in mora*, apo *fumus boni juris etj.*<sup>217</sup>

<sup>213</sup> Neni 61 i KPrC “Gjykata kur konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.”

<sup>214</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. akti 168, datë 04.02.2014

<sup>215</sup> Kodi italian i Procedurës Civile parashikon shprehimisht në nenin 669-septies se vendimi i gjykatës për shpallje moskompetence nuk pengon palën të kërkojë sërish marrjen e masës së sigurimit të padisë.

<sup>216</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. akti. 505, datë 21.05.2014 “Kërkesa e kërkuesit nuk është e mbështetur në prova, nga provat e paraqitura nga ana e tij dhe të cituara më lart, rezulton se kërkuesi nuk legjitimohet në ngritjen e këtij kërkitimi, pasi aktiviteti tregtar ushtrohet nga bashkëshortja e tij.”

<sup>217</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 57, datë 15.01.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 240, datë 07.03.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 403, datë 21.04.2015

Në rast se kërkesa për sigurimin e padisë rrëzohet me vendim të gjykatës, natyrshëm mund të lindë pyetja, a mund të ngrihet ajo sërish? Kodi ynë i procedurës civile nuk jep një përgjigje lidhur me këtë pyetje, por gjykojmë se përgjigjja në një situatë të tillë do të ishte po, nëse verifikohen ndryshime të rrethanave apo do të ketë argumente të reja ligjore ose të faktit. Një rregullim të tillë specifik e gjejmë në kodin italian të procedurës civile.<sup>218</sup> Duket se këtë mangësi të Kodit të procedurës Civile e ka plotësuar drejt ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”,<sup>219</sup> neni 31 (2) i të cilit parashikon se: “Kërkesa për revokim apo ndryshim të masave për sigurimin e padisë nuk pranohet për rrethana dhe fakte që nuk kanë ndryshuar ende. I njëjti kusht vlen edhe për kërkesën e riparaqitur për një masë sigurimi të refuzuar më parë nga gjykata.”

Pra, ringritja e kërkesës për masa sigurimi nuk do të ishte e mundur vetëm nëse ajo do të bazohej në të njëjtat argumente ligjore ose fakti të ngritura edhe në procesin e parë, ndërkohë që nuk ka asnjë pengesë për ringritjen e saj, nëse ajo bazohet në rrethana të reja, ku përfshihen jo vetëm ndodhja e fakteve të reja krijuese të të drejtës apo të *periculum in mora*, por edhe përdorimi i provave të reja (që sidoqoftë bie brenda konceptit të argumenteve të reja të faktit), ose në argumente të reja të faktit ose ligjit, d.m.th. mbi fakte që nuk kanë ndodhur, ose argumente juridikë që nuk janë përdorur nga palët dhe gjykata gjatë gjykimit të parë.<sup>220</sup>

Pavarësisht kësaj mungese të Kodit të Procedurës Civile në këtë drejtim, praktika gjyqësore në disa raste ka bërë interpretimin e duhur duke u shprehur për njohjen e të drejtës së palës për të ringritur kërkesën për sigurim padie, pavarësisht vendimit të gjykatës për rrëzimin e saj. Për shembull në një çështje gjykata është shprehur: “Gjykata sjell në vëmendje të palëve në proces, se një kërkim i tillë mund të ngrihet sërish në të ardhmen gjatë shqyrtimit të pretendimeve të kërkuarit (*paditesit potencial*) në padinë e themelit, nëse do të provohet gjyqësisht se plotësohen kushtet e parashikuara nga nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.”<sup>221</sup>

Në këto kushte sugjerohet një rishikim i dispozitave të KPrC në mënyrë që të parashikohet shprehimisht e drejta për ringritjen e kërkesës për sigurim padie kur ka ndryshime të rrethanave apo argumente të reja ligjore ose të faktit.

### 3.5.3. Vendimi i pranimit të sigurimit të padisë dhe shuarja e masës së sigurimit

Kur gjykata e çmon të bazuar kërkesën për marrjen e masave të sigurimit të padisë, ajo shprehet me vendim për pranimin e saj. Në rastin kur kërkesa për sigurimin e padisë është ngritur *ante causam* gjykata me vendimin e pranimit të kësaj kërkesë cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet në gjykatë padia e themelit. Mos paraqitja e padisë së themelit brenda afatit të përcaktuar me vendim sjell si pasojë rënien e masës së sigurimit.<sup>222</sup>

<sup>218</sup> Shiko nenin 669-septies të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Italisë; Shiko gjithashtu: Mandrioli, op.cit. fq. 268-270; Satta, Punzi, op. cit. fq. 862-864; Biavati, op.cit. fq. 694, Pisani, op. cit. fq. 645-647.

<sup>219</sup> Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”

<sup>220</sup> Shiko Satta, Punzi, op.cit. fq. 863; Pisani, op.cit.fq.646

<sup>221</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. akti 130, datë 16.01.2014; Shiko gjithashtu: Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. akti 107, datë 14.01.2014 “Gjykata sjell në vëmendje, se një kërkim për marrjen e masës së përkohshme mund të ngrihet sërish në të ardhmen gjatë shqyrtimit të pretendimeve të kërkuarit (*paditesit potencial*) në padinë e themelit, në formën e parashikuar në ligj dhe me referencën e duhur ligjore procedurale civile.”

<sup>222</sup> Shiko nenin 211 të KPrC

Pra, në rastin e pranimit të një kërkesë për sigurimin e padisë përpara ngritjes së padisë së themelit, përcaktimi i një afati brenda të cilit duhet të ngrihet padia e themelit është një kusht i detyrueshëm dhe tregon qartazi karakterin e ndërvarur të masave të sigurimit nga gjykimi i themelit apo të qënurit të tyre në funksion të padisë së themelit. Dhënia e masave të sigurimit *ante causam*, pa u kushtëzuar me një afat për ngritjen e padisë jo vetëm që bie ndesh me karakterin e masave të sigurimit, por mund edhe të cenonte rëndë të drejtat e palës kundër të cilës merret masa e sigurimit. Ligjvënësi e lë në diskrecion të gjykatës që në varësi të rrethanave të çështjes të përcaktojë afatin brenda të cilit duhet të ngrihet padia, por duke i vendosur një kufi maksimal prej pesëmbëdhjetë ditësh. Por çfarë do të ndodhte në rast se gjykata nuk do të përcaktonte një afat të tillë në dispozitivin e vendimit të saj për pranimin e masës së sigurimit të ngritur *ante causam*? Dispozita në fjalë e Kodit të Procedurës Civile nuk ofron një zgjidhje për rastin konkret, sidoqoftë, gjykojmë se në një rast të tillë padia e themelit duhet të ngrihet brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga shpallja e vendimit, në të kundërt masa e sigurimit e dhënë *ante causam* do të binte nga fuqia.

E njëjtë do të ishte situata edhe kur gjykata cakton një afat më të gjatë se pesëmbëdhjetë ditë për ngritjen e padisë së themelit. Masa e sigurimit e dhënë *ante causam* do të kishte fuqi vetëm pesëmbëdhjetë ditë, nëse padia e themelit nuk do të ngrihej brenda këtij afati. Por në praktikën gjyqësore shqiptare ndeshim edhe vendime që shprehen për të kundërtën. Konkretisht, në një rast, gjykata ka vendosur: 1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit Avokatura e Shtetit duke ndaluar shkëputjen e energjisë elektrike ndaj çdo autoriteti publik, institucioneve dhe shërbimeve deri në arritjen e një marrëveshje përfundimtare dhe ligjore të mosmarrëveshjeve mes palëve përmes zgjidhjes miqësore apo arbitrazhit sipas rregullave të DHNT. 2. Në çdo rast që CEZ Shpërndarje do të shkelë vendim e gjykatës do të penalizohet me një shumë 100 000 000 lekë /orë për çdo ndërprerje të energjisë.<sup>223</sup> Po kjo gjykatë në bazë të kërkesës së personit kundër të cilit është vënë masa e sigurimit për konstatimin e rënies nga fuqia të masës së sigurimit për shkak të mos ngritjes së padisë së themelit brenda 15 ditëve nga shpallja e vendimit për pranimin e masës ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë duke arsyetuar: “Ashtu siç është theksuar dhe në dispozitivin e vendimit, gjykata ka vendosur se kjo masë siguri do të jetë garantuese e këtyre të drejtave, deri në arritjen e një marrëveshje përfundimtare dhe ligjore të mosmarrëveshjeve mes palëve përmes zgjidhjes miqësore apo arbitrazhit sipas rregullave të DHNT. Ky vendim i gjykatës nuk ka aspak qëllimin e dhënies së një vendimi përfundimtar, por ndër të tjera për shkak të pasojave që vijnë nga veprimet e kërkuarit ajo nuk mund të jetë e lidhur ngushtësisht me afatin procedural të përcaktuar në nenin 204 të K.Pr.Civile për paraqitjen e padisë brenda 15 ditëve në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit ashtu si pretendoi kërkuari në këtë gjykim. Një situatë e tillë e krijuar midis palëve i vendos ato në detyrimin, për arritjen sa më shpejt të një marrëveshje për zgjidhjen e çështjes me pajtim ose të zgjidhjes përmes arbitrazhit. ...

Në seancë gjyqësore personi i tretë në gjykim pohoi se *negociatat midis palëve janë në proces, nuk janë mbyllur jemi në fazë vlerësimi*. Ky pohim i tillë nuk u mohua as nga kërkuari në gjykim. Gjykata çmon se përse kohë në atë vendim, ajo ka vendosur se masa e sigurimit qëndron në fuqi deri në arritjen e një marrëveshje me pajtim midis palëve ose nëpërmjet arbitrazhit dhe pranohet prej palëve, se ato janë në proces negociimi atëherë kësaj mase siguri nuk i ka rënë fuqia ligjore. Ashtu siç u theksua dhe me sipër marrja e masës ka garantuar proporcionalitetin ndërmjet të drejtës

---

<sup>223</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 762, datë 17.11.2012

private të pretenduar nga Cez sh.a dhe interesit publik të cenuar në rastin konkret, deri në zgjidhjen e çështjes midis palëve pa e lidhur këtë me një afat kohor prej 15 ditësh.”<sup>224</sup>

Ndonëse nisur nga rrethanat e çështjes dhe lloji i masës së sigurimit të dhënë duket e drejtë moskushtëzimi i fuqisë së saj me ngritjen e padisë së themelit brenda afatit pesëmbëdhjetë ditor, një zgjidhje e tillë është në kundërshtim të plotë me nenin 211 të KPrC. Theksojmë se KPrC italian, ka parashikuar shprehimisht disa lloje masash sigurimi, fuqia e të cilave, kur janë dhënë *ante causam*, nuk kushtëzohet nga ngritja e padisë së themelit brenda një afati të caktuar. Neni 669-octies paragrafi vi parashikon se këto lloj masash janë masat e urgjencës (sipas nenit 700, të cilat janë masa atipike dhe aplikohen për mbrojtjen e atyre të drejtave që në mungesë të masave tipike do të shkaktohej një dëm i pariparueshëm gjatë kohëzgjatjes së procesit),<sup>225</sup> masa të tjera që kanë po ato efekte si të vendimit përfundimtar, si dhe masat e dhëna për kallëzimin e një punimi të ri.

Në këto kushte, kur në varësi të rrethanave dhe llojit të masës së dhënë është e domosdoshme moskushtëzimi i efekteve të masave të dhëna *ante causam* me ngritjen e padisë së themelit brenda një afati të caktuar, sugjerojmë që neni 211 i KPrC të rregullojë shprehimisht situatën, duke vendosur përjashtime nga rregulli i përgjithshëm i parashikuar në këtë nen, për masat e përkohshme të sigurimit të padisë që synojnë “*ta mbajnë gjendjen ashtu siç është*”, apo “*të ngrirë*”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, që është një nga llojet e masave të sigurimit që mund të jepen në bazë të nenit 206 të KPrC, sikurse është interpretuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.<sup>226</sup>

Një pyetje me interes në lidhje me këtë çështje është a bie automatikisht masa e sigurimit apo gjykata që ka dhënë masën duhet të shprehet me vendim për rënien e saj nga fuqia? Doktrina është e mendimit se rënia e masës së sigurimit të padisë, në rastin e mosparaqitjes së padisë së themelit në gjykatë, brenda afatit të caktuar nga gjykata, bëhet *ipso lege* dhe nuk ka nevojë që gjykata të shprehet rishtazi për të.<sup>227</sup> Një qëndrim i tillë duket se ka gjetur mbështetje edhe nga praktika gjyqësore, ku në një çështje gjykata ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë si të bazuar në ligj.
- Sigurimin e padisë duke vendosur sekuestro konservative (inventarizim, mos tjetërsim dhe *mos largim jashtë territorit shqiptar*) për pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të IONIOS S.A, që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe lënien e tyre në ruajtje të një subjekti të specializuar dhe me licencë për ruajtjen dhe sigurimin fizik, për llogari të shlyerjes së detyrimeve ndaj kërkuarit Shoqërisë “VEGA”-sh.p.k.
- Kjo masë për sigurimin e padisë humbet fuqinë e saj pa qënë nevoja që gjykata të shprehet, po qe se pala kërkuese nuk paraqet padinë e themelit brenda 15 ditëve.<sup>228</sup>

<sup>224</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. akti 834, datë 21.12.2012

<sup>225</sup> Pisani, op.cit. fq. 628 Rikujtojmë që sistemi italian i masave të sigurimit është i ndryshëm nga ai shqiptar. Ai është një sistem tipik, me një masë atipike. Pra rregullon me dispozita të veçanta lloje të ndryshme masash sigurimi, si për shembull, sekuestroja preventive, sekuestroja konservative, kallëzimi i një punimi të ri etj., të cilat cilësohen si masa tipike dhe parashikon një dispozitë, nenin 700 për masa sigurimi urgjente, ku mund të përfshihen disa masa atipike që zbatohen në ato raste ku mbrojtja e një të drejte nuk garantohet nga dhënia e masave tipike të parashikuara në kod.

<sup>226</sup> Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 10, datë 24. 03.2004.

<sup>227</sup> F.Kola, A.Vokshi “Procedura Civile” Vëllimi I, Tiranë 2013, fq. 225

<sup>228</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti.555, datë 27.06.2013

Gjithashtu në një tjetër vendim, ku gjykatës i është kërkuar të shprehet për konstatimin e rënies nga fuqia të masës së sigurimit të padisë, ajo ka arsyetuar se: “Formulimi i dispozitës së mësipërme (neni 211 i K.Pr. Civile) përcakton në mënyrë të qartë se mosrespektimi i afati i caktuar nga gjykata për paraqitjen e padisë në rastet kur masa e sigurimit të saj është dhënë para ngritjes së saj, sjell humbjen e fuqisë së masës së dhënë nga gjykata. Humbja e fuqisë juridike të masës së dhënë nga gjykata është pasojë *ipso jure*, dhe nuk është e nevojshme që një gjë e tillë të shprehet në përmbajtje të vendimit gjyqësor që pranon sigurimin e padisë.

Kjo rezulton nga leximi i thjeshtë i dispozitës neni 211 i K.Pr. Civile, dispozitë kjo që me evoluimin dhe ndryshimin e tij me ligjin nr.122/2013, megjithëse nuk zbatohet në këtë rast pasi nuk kishte hyrë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, saktëson se: “*Mosparaqitja e padisë brenda afatit të caktuar nga gjykata,, e vërtetuar nga kryesekretari , shuan masën e sigurimit të padisë.*” ... ..

Gjykata duke vlerësuar se natyra e këtij gjykimi ka tiparet e një padie vërtetimi dhe jo detyrimi, konkludon në konstatimin e faktit se padia nuk është paraqitur brenda afatit ligjor 15 ditor dhe masa e sigurimit quhet se ka rënë nga fuqia.”<sup>229</sup>

Krahas këtij rasti të rënies së masës së sigurimit kodi i procedurës civile parashikon gjithashtu se masa e sigurimit bie edhe në rastin kur vendoset rrëzimi i padisë ose pushimi i gjykimit të saj. Në këtë rast gjykata së bashku me vendimin përfundimtar ose jo përfundimtar në rastin e dytë shprehet edhe për heqjen e masës së sigurimit të padisë. Megjithatë, në ndryshim nga rasti kur masa bie nga fuqia për shkak të mos ngritjes së padisë në afatin e caktuar nga gjykata, kjo masë vazhdon të jetë në fuqi derisa vendimi mbi themelin apo ai i pushimit të gjykimit të marrin formë të prerë, pavarësisht se është hequr me vendimin e rrëzimit të padisë apo pushimit të gjykimit.<sup>230</sup>

A duhet gjykata që vendos për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, të veprojë njësoj si në rastin e rrëzimit të padisë apo pushimit të gjykimit, duke u shprehur edhe për heqjen e masës së sigurimit të dhënë si para dhe gjatë gjykimit të themelit? Në praktikën gjyqësore shqiptare ndeshim qëndrime të kundërta. Në një rast gjykata me vendimin për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, u shpreh dhe për heqjen e masës së sigurimit,<sup>231</sup> ndërsa në një tjetër rast, gjykata ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit dhe nuk është shprehur masën e sigurimit dhe Gjykata e Lartë, që shqyrtoi ankimin e veçantë kundër vendimit për juridiksionin, refuzoi të shprehet për heqjen e masës së sigurimit.<sup>232</sup>

Duke pasur parasysh që kërkesa për sigurimin e padisë është e lidhur me një marrëdhënie funksionale dhe plotësueshmërie me padinë e ngritur ose që do të ngrihet së shpejti, e cila përcaktohet nga fakti se masa që kërkohet ka për qëllim që të garantojë rezultatit e padisë, d.m.th. që kërkesa për sigurimin e padisë është në funksion të padisë, kur nuk ka mosmarrëveshje në shqyrtim gjyqësor, mbi bazën e së

<sup>229</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 685, datë 20.09.2013

<sup>230</sup> Shiko nenin 211 të KPrC

<sup>231</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr.2127, datë 26.07.2010 ku gjykata ka vendosur: “1. Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykimit nga gjykata shqiptare të çështjes civile nr.41101-01008 (1891), datë 01.04.2010 që i përket palës paditëse Shoqëria “FIRST WOOD”, sh.p.k. me qendër në Bilisht të Korçës, me të paditur Shoqëria Tregtare “MELIDA SHIPPING” Ltd. 2. Heqjen e masës për sigurimin e padisë të marrë me vendimin nr.11-2010-1014 (45), datë 10.03.2010, ndryshuar me vendimin nr.41101-01008 (1891), datë 01.04.2010. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nr. 452, datë 09.12. 2010 shprehet për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Durrësit lidhur me nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykimit nga gjykatat shqiptare. Pra, duket se Gjykata e Lartë nuk është shprehur për pjesën e vendimit që heq masën e sigurimit të padisë.

<sup>232</sup> Shiko Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 255, datë 14.05.2015

cilës është ngritur dhe një kërkim tjetër dytësor, nuk mund të ekzistojë as ky i dyti, sikurse është sigurimi i padisë.<sup>233</sup> Nisur nga ky argument, në rast se gjykata nxjerr çështjen e themelit jashtë juridiksionit gjyqësor, sepse ajo është në juridiksionin e një gjykate të huaj, apo të arbitrazhit, dhe ky vendim lihet në fuqi nga Gjykata e Lartë, përsa kohë që nuk ngrihet një padi në juridiksionin përkatës, masa e sigurimit e dhënë duhet të bjerë nga fuqia, sepse padia, objekti i së cilës është mbrojtur me masën e sigurimit, nuk është në gjykim. Theksojmë se Kodi i Procedurës Civile parashikon që masa e sigurimit e dhënë *ante causam* ka fuqi maksimumi deri në pesëmbëdhjetë ditë nëse nuk ngrihet padia e themelit dhe nuk parashikon ndonjë përjashtim nga zbatimi i këtij rregulli. Situata e krijuar me rastin e nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit është e ngjashme me atë të dhënies së masës së sigurimit *ante causam*, sepse jemi në kushtet e ekzistencës së një mase sigurimi për një padi që nuk po gjykohet ende.

Ndaj në analogji me rastin e masave të dhëna *ante causam*, masa e dhënë nga një gjykatë shqiptare që nxjerr çështjen e themelit jashtë juridiksionit, duhet të bjerë *ipso jure*, pa qenë nevoja që gjykata të shprehet për të, nëse brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga shpallja e vendimit të Gjykatës së Lartë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit nuk ngrihet padia e themelit në juridiksionin përkatës. Në çdo rast pala e interesuar pas shpalljes së vendimit për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit mund t'i drejtohet gjykatës që ka dhënë masën e sigurimit me kërkesë për konstatimin e rënies saj në kushtet kur nuk është investuar juridiksioni përkatës me padinë e themelit.

#### 4. Llojet e masave të sigurimit të padisë

Neni 206 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon si lloje të masave që mund të merren për sigurimin e padisë (a) sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit; dhe (b) masa të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata. Lidhur me pikën (a) të nenit 206 të K.Pr.C., vlen të theksohet se bëhet fjalë për sekuestrimin konservativ. Ky sekuestrim ka për qëllim që të ruajë ato garanci të kredisë, të cilat mund të zvogëlohen, ose tjetërsohen me lehtësi (sende të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë anijet, shumat që i detyrohen personat e tretë debitorit dhe në raport me të cilët ky është kreditor, tokat, shtëpitë e banimit, dyqanet, etj). Kriteri bazë për vendosjen e sekuestros konservative lidhet me dyshimin e arsyeshëm se debitori do t'i shmanget përmbushjes së detyrimit, se mund të zvogëlojë vlerën dhe masën e pasurisë së tij dhe në përgjithësi se ekziston rreziku i humbjes së garancive të kredisë, e cila mund të lidhet edhe me një rrezik thjesht objektiv, që nuk varet nga vullneti apo përgjegjësia e debitorit, ku verifikimi i këtyre rasteve mund të cenohet të drejtat e paditësit nëpërmjet bërjes së pamundur ose të vështirë të ekzekutimit të vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar themelin e çështjes.

Në interpretim të nenit 206 pika (a) të K.Pr.C., Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues Nr.10, datë 24.03.2004 kanë përcaktuar se:

“Masa kryesore e përkohshme e sigurimit të padisë është ajo e parashikuar në pikën “a” të dispozitës së mësipërme: sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe i kredive të debitorit. Kjo quhet sekuestro konservative. Sekuestroja konservative mund të vendoset në qoftë se gjyqtari (gjykata) krijon bindje se kreditori (paditësi) ka motiv për t’u shqetësuar se debitori (i padituri), përpara se të merret një vendim gjyqësor që të vërtetojë të drejtën e tij dhe të

<sup>233</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 148, datë 17.04.2014



urdhërojë rivendosjen e saj apo shpërblimin e dëmit eventual, do të zvogëlojë apo do të fshehë pasurinë e tij.

Sekuestrimi i sendeve të paluajtshme bëhet duke urdhëruar Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që të ndalojë shitjen, dhurimin apo çdo lloj disponimi të tyre. Sekuestrimi i sendeve të luajtshme bëhet duke i dhënë ato në ruajtje një personi të tretë, fizik apo juridik. Sekuestrimi i të hollave apo kredive bëhet duke urdhëruar depozitimin e tyre në një institucion bankar dhe ngrirjen e tyre, apo ngrirjen e depozitave bankare, të llogarive rrjedhëse të debitorit, etj. Pas vendosjes së sekuestros konservative, çdo veprim juridik për disponimin e sendeve apo kredive të sekuestruara është i pavlefshëm dhe ngarkon e përgjegjësi personin e tretë që i janë lënë në ruajtje sendet apo kreditë.

Në përfundim të gjykimit, në qoftë se gjykata provon se sendet e sekuestruara janë në pronësi të kreditorit d.m.th pranon padinë e kërimit të tyre, atëherë ajo urdhëron që ato t'i kalojnë kreditorit. Në rastin e pranimi të një padie detyrimi në të holla apo shpërblim dëmi, atëherë sekuestroja konservative kthehet në sekuestro ekzekutive dhe sendet e sekuestruara i nënshtrohen procesit të ekzekutimit të detyrueshëm.”

Dhe në fakt sikurse me të drejtë është shprehur Gjykata e Lartë në vendimin e mësipërm, sekuestroja konservative qoftë e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme është lloji më i zakonshëm i masës së sigurimit që kanë dhënë gjykatat shqiptare.<sup>234</sup>

Përveç sekuestros të përmendur në pikën (a) të nenit 206 të K.Pr.C., në pikën (b) të këtij neni parashikohet se sigurimi i padisë bëhet edhe me marrjen nga ana e gjykatës të masave të tjera të përshtatshme. Përpara ndryshimeve të KPrC të vitit 2013, parashikohej shprehimisht se në këtë kategori përfshihej dhe masa e pezullimit të ekzekutimit, e cila aktualisht nuk është më e cilësuar si shembull i një mase të përshtatshme që bie brenda përcaktimit të nenit 206 (b) të KPrC. Heqja e togfjalëshit “pezullim ekzekutimi” nga neni 206 (b) i KPrC nuk do të thotë se një masë e tillë nuk mund të merret. Ky ndryshim duhet të jetë bërë me qëllim eliminimin e paqartësive që termi “pezullim ekzekutimi” kishte shkaktuar më parë, por edhe tani në kushtet kur me ndryshimet e vitit 2013 u ndalua sigurimi i padisë për paditë që ngrihen në fazën e ekzekutimit të vendimit, sikurse janë pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, apo kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor.

Lidhur me pezullimin si një nga llojet e masave të përshtatshme që mund të jepen, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 10, datë 24.03.2004 janë shprehur se: “Ndër masat e tjera të përshtatshme për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206/”b” të K.Pr.Civile, përfshihet shprehimisht edhe “*pezullimi i ekzekutimit*”. Kjo dispozitë përmban në vetvete një paqartësi lidhur me aktin apo veprimin, ekzekutimi i të cilit kërkohet të pezullohet. Në këto raste kemi të bëjmë, si rregull, me padi në të cilat paditësi kërkon detyrimin e të paditurit të mos verë në ekzekutim një akt nëpërmjet të cilit tërheq përfitime. Në këto raste marrja e masave të përkohshme të sigurimit të padisë synon “*ta mbajë gjendjen ashtu siç është*”, apo “*të ngrirë*”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila, për vetë natyrën e çështjes, duhet te

<sup>234</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 228, datë 18.02.2015 (sekuestro mbi pasuri të paluajtshme); Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 415, datë 05.05.2015 (sekuestro të llogarive bankare në një shumë të caktuar); Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 224, datë 16.03.2015 (sekuestro të llogarive bankare); Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 929, 29.12.2014 (sekuestro të llogarive bankare) Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 242, datë 06.03.2015 (sekuestro mbi pasuri të luajtshme-makineri industriale)

realizohet nëpërmjet një procedure të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithsesi, që të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor. Masa e përkohshme për pezullimin e ekzekutimit duhet të shoqërohet, si rregull, me detyrimin e palës tjetër për dhënien e një garancie pasurore për të mbuluar dëmet që mund t'i shkaktohen të paditurit nga pezullimi i ekzekutimit.”

Po në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara në interpretim të termit “masa të tjera të përshtatshme” janë shprehur se: “Llojet e tjera të masave të sigurimit të padisë, sipas parashikimit të pikës “b” të nenit 206 të K.Pr.Civile,..., janë të papërcaktuara në mënyrë konkrete. Kjo do të thotë se gjykata, rast pas rasti, ka diskrecion të vendosë një masë të natyrës së sigurimit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të paditurit....

Masa e sigurimit nuk mund të merret për t'u rivendosur gjendja e mëparshme e marrëdhënies kontraktore midis palëve, ashtu siç ka ekzistuar para lindjes së mosmarrëveshjes. Në një këndvështrim më të gjerë, në qoftë se në kontratën e lidhur midis palëve është parashikuar që, për shkaqe të caktuara, njëra palë do të ketë të drejtë ta zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, (sikurse është parashikuar në nenin 13.3 të kontratës), gjykata që shqyrton konfliktin nuk ka të drejtë të urdhërojë paraprakisht rilidhjen e kontratës. Urdhërimi i rilidhjes së kontratës nuk mund të konsiderohet si masë e përkohshme për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206§1/b të K.Pr.C. Rilidhja e kontratës mund të urdhërohet vetëm me vendim përfundimtar të gjykatës për zgjidhjen e çështjes në themel. Përfundimet e mësipërme nuk kanë vlerë vetëm për konfliktet kontraktore, por për të gjitha çështjet gjyqësore në të cilat kërkohet rivendosja e të drejtave civile të cenuara, të shkelura ose të mohuara, si dhe shpërblymi i dëmeve eventuale. Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohshme të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri. E thënë ndryshe, masa e përkohshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërimit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë.”

Sidoqoftë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë theksojnë edhe përjashtime, të cilat justifikojnë marrjen e masave të tilla të sigurimit në raste të veçanta, kur një gjë e tillë justifikohet nga ligji, ose nga natyra e marrëdhënies juridike që ekziston midis palëve. Kështu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehën se: “Një masë e tillë e vendosur nga gjykata, që konsiston në rivendosjen e një lidhjeje të ndërprerë në mënyrë të njëanshme, apo arbitrare do të konsiderohej e ligjshme e do të përfshihej në masat e tjera të përshtatshme të sigurimit të padisë, në qoftë se do të parashikohej në mënyrë taksative në ligj dhe/ose do të rezultonte nga vetë natyra e marrëdhënies juridike (e kontratës së lidhur midis palëve). Të tilla janë p.sh: disa kontrata furnizimi me lëndë të parë apo energji, të ndërvarura nga njëra-tjetra, që sigurojnë funksionimin e vazhdueshëm e të pandërprerë të një veprimtarie industriale, të një procesi teknologjik të caktuar, të një veprimtarie të vendosur për mbrojtjen e jetës e të shëndetit të njerëzve, etj, ndërprerja e të cilave do të shkaktonte dëme të pallogaritshme e të pariparueshme, shkatërrime të mëdha apo katastrofa. Për sa u përket masave të tjera të përshtatshme që merren për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206, pika “b” të K.Pr.C, duhet të kemi parasysh gjithashtu se edhe ato duhet të kushtëzohen kurdoherë nga një objekt material i përcaktuar, apo i përcaktueshëm, i padisë. Është kjo arsyeja që gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme

jo më të madhe se atë të padisë.... Përcaktimi i objektit të padisë shërben si bazë fillestare për të vendosur lidhur me masat e sigurimit.”

Disa nga llojet e masave të tjera të përshtatshme të dhëna në bazë të nenit 206 (b) të KPrC, që ndeshim në praktikën gjyqësore shqiptare janë pezullimi i vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të një shoqate,<sup>235</sup> mosprishje e banesës,<sup>236</sup> ndalim i shitjes së kuotave të ortakëve të një shoqërie tregtare dhe pezullimi i mbledhjes së asamblesë së saj,<sup>237</sup> ndalimi i kryerjes së veprimeve për regjistrimin përfundimtar të një pasurie të paluajtshme,<sup>238</sup> pezullim i depozitimit në Regjistrin Tregtar të vendimeve të një shoqërie tregtare,<sup>239</sup> pezullim i punimeve mbi pronën objekt gjykimi,<sup>240</sup> etj.

---

<sup>235</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 236, datë 04.03.2014

<sup>236</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 556, datë 01.07.2013

<sup>237</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 276, datë 13.03.2014

<sup>238</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 149, datë 26.02.2015

<sup>239</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 1364, datë 21.12.2006

<sup>240</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 334, datë 21.03.2007; Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 108, datë 11.03.2010

## KAPITULLI III

### REVOKIMI, NDRYSHIMI, ANKIMI DHE EKZEKUTIMI I MASAVE TË SIGURIMIT TË PADISË

Pavarësisht natyrës së ndërmjetme të vendimit me të cilin jepen masat e sigurimit të padisë, për shkak të karakterit urgjent dhe qëllimit të tyre, vendimet për sigurimin e padisë ekzekutohen njësoj sikur të ishin vendime gjyqësore të formës së prerë, madje me disa procedura më të përshpejtuara, të cilat bëjnë të mundur ekzekutimin sa më të shpejtë të tyre. Ky trajtim që i bëhet vendimeve për sigurim padie lidhur me ekzekutimin e tyre është shumë i rëndësishëm për realizimin e qëllimit të masave të sigurimit dhe garantimin e efektivitetit të procesit të sigurimit të padisë.

Megjithëse procesi me të cilin jepen masat e sigurimit është një proces i shpejtë, i cili bazohet në një vlerësim sipërfaqësor të provave me qëllim krijimin e bindjes për ekzistencën e një të drejte të mundshme dhe rrezikut të dëmtimit të kësaj të drejte apo pamundësisë së rivendosjes së saj, për shkak të vështirësisë së ekzekutimit të vendimit, ai duhet të garantojë një standard të pranueshëm të një procesi të rregullt ligjor. Mbrojtja e përkohshme e të drejtave nëpërmjet marrjes së masave të sigurimit të padisë mbart rrezikun e cenimit të drejtave të paditësit, ose të të paditurit në varësi të natyrës së vendimit të gjykatës, ndaj gjykatat në dhënien apo refuzimin e masave të sigurimit mundohen të gjejnë një balancë mes interesave të kundërta të palëve, në mënyrë që të pakësohet sa më shumë të jetë e mundur mundësia e shkaktimit të dëmit për të drejtat e palëve. Po për këtë qëllim legjislatori ka parashikuar edhe mekanizma kontrolli ndaj vendimeve për masa sigurimi. Konkretisht, këta mekanizma kontrolli janë revokimi, ose ndryshimi dhe kundërshtimi i masës së sigurimit të padisë.

#### 1. Revokimi dhe ndryshimi i masave të sigurimit të padisë

Vendosja e masës së sigurimit nuk nënkupton se ajo nuk mund të ndryshohet, apo të hiqet më pas. Në nenin 207 të K.Pr.C. parashikohet shprehimisht se gjykata me kërkesën e njëres nga palët mund të zëvendësojë një masë sigurimi me një tjetër, pasi më parë të ketë dëgjuar edhe palën kundërshtare. Në këtë mënyrë veprohet edhe kur gjykata vendos heqjen e masës së sigurimit, kur çmon se është zhdukur shkaku për të cilin ajo është vënë. Siç mund të shihet, zëvendësimi, heqja apo ndryshimi i një mase sigurimi, bëhet vetëm më kërkesë të palëve,<sup>241</sup> dhe jo nga vetë gjykata me nismën e saj, kjo në përputhje me parimin e disponibilitetit. Gjithashtu, në dallim nga vendosja, revokimi apo ndryshimi i masës së sigurimit duhet të bëhet në çdo rast në respektim të parimit të kontradiktoritetit, ku gjykata duhet të dëgjojë jo vetëm palën që bën kërkesën për këtë qëllim, por edhe palën tjetër.

##### 1.1. Shkaqet për të cilat lejohet revokimi dhe ndryshimi

Kodi i Procedurës Civile hesht lidhur me shkaqet për të cilat mund të lejohet ndryshimi i masës së sigurimit. Në të parashikohet vetëm se masa mund të hiqet kur ka rënë shkaku për të cilin është vënë. Por cili është shkaku për të cilin mund të vendoset masa e sigurimit? Sikurse u trajtua gjerësisht më sipër masa e sigurimit

---

<sup>241</sup> Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative” ndryshe nga KPrC, ka parashikuar që revokimi dhe ndryshimi i masës mund të bëhet edhe kryesisht nga gjykata.

vendoset kur ka dyshime se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Atëherë nëse ky dyshim nuk do të ekzistonte më, masa e sigurimit duhet të hiqet. Pra, kemi një ndryshim të tillë të rrethanave të çështjes që bëjnë që dyshimi për rrezikun e mosekzekutimit të vendimit të mos ekzistojë më.

Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative” e ka parashikuar shprehimisht se gjykata, kur ndryshojnë rrethanat, mund të revokojë ose të ndryshojë vendimin për sigurimin e padisë,<sup>242</sup> duke treguar në këtë mënyrë se revokimi apo ndryshimi i masave të sigurimit mund të lejohet vetëm kur ka ndryshim të rrethanave. Edhe kodi italian i procedurës civile ka parashikuar shprehimisht një kusht të tillë.<sup>243</sup>

Revokimi (apo dhe ndryshimi) i masës së sigurimit nënkupton ekzistencën e një fakti të ri, të cilin nëse gjyqtari do ta kishte ditur në kohën e dhënies së masës së sigurimit, do të kishte dhënë një masë të ndryshme nga ajo që ka dhënë. Ai që kërkon revokimin (ndryshimin) e masës së sigurimit nuk pretendon një gabim të gjyqtarit në momentin e dhënies së masës së sigurimit, por pretendon një masë të ndryshme në varësi të rrethanave të mëvonshme.<sup>244</sup>

Lidhur me termin “ndryshime të rrethanave” që përbëjnë shkak për ndryshimin apo revokimin e masës së sigurimit, nuk gjejmë ndonjë shpjegim nga dispozitat ligjore, por doktrina e ka elaboruar atë duke përcaktuar se me të mund të nënkuptohet çdo lloj prove e re, e cila nuk është paraqitur në procesin e marrjes së masës së sigurimit, ashtu sikurse mund të nënkuptohet çdo fakt i ri i dalë gjatë gjykimit të themelit që sjell elementë të rinj në vlerësimin e mundësisë së ekzistencës së të drejtës, apo të *periculum in mora* për të drejtën për të cilën është marrë masa e sigurimit.<sup>245</sup>

Në kushtet kur KPrC nuk ka parashikuar shkaqet për të cilat lejohet revokimi apo ndryshimi i masave të sigurimit të padisë, rekomandohet që neni 207 i tij të plotësohet duke parashikuar shprehimisht për ndryshimin e rrethanave si një kusht të tillë, sikurse ka parashikuar ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.”

## **1.2. Gjykata kompetente për të vendosur mbi revokimin dhe ndryshimin e masës së sigurimit**

Kodi i Procedurës Civile parashikon se gjykata me kërkesën e njëjës nga palët mund të zëvendësojë një masë siguri me një tjetër, pasi më parë të ketë dëgjuar edhe palën kundërshtare. Por cila është gjykata që ka kompetencën për të vendosur mbi një kërkesë të tillë si në rastin kur kërkesa ngrihet gjatë gjykimit të themelit ashtu edhe kur masa është marrë *ante causam*? Nëse masa e sigurimit të padisë është dhënë gjatë gjykimit të padisë së themelit, është e kuptueshme që nëse ka ndryshim të rrethanave, ajo gjykatë që e ka dhënë atë masë dhe që është duke gjykuar themelin e padisë do të jetë kompetente për të vendosur edhe lidhur me kërkesën për revokimin apo ndryshimin e masës së sigurimit. Ndërsa në rastin kur masa e sigurimit është marrë *ante causam*, jo nga gjykata që është duke gjykuar themelin e padisë, cila do të jetë gjykata kompetente që do të vendosë për revokimin apo ndryshimin e masës, gjykata që e ka marrë masën *ante causam* apo ajo që po gjykon themelin e padisë? Në

<sup>242</sup> Neni 21(2) i Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”

<sup>243</sup> Neni 669-decies i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Italisë

<sup>244</sup> Biaviati, op.cit. fq. 704

<sup>245</sup> Pisani, op.cit. fq. 648-649

këtë rast, gjykojmë se kompetente do të jetë gjykata që gjykon themelin e padisë, duke qenë se po asaj i është dhënë e drejta që së bashku me vendimin përfundimtar mbi themelin e padisë të shprehet edhe për rënien apo ligjërimin e masës së sigurimit, pavarësisht se një masë e tillë mund të jetë marrë *ante causam*. Dhe një përcaktim i tillë është mëse i drejtë dhe logjik, sepse do të ishte në dëm të ekonomisë gjyqësore investimi sërish i gjykatës që ka dhënë masën e sigurimit *ante causam*. Theksojmë se kodi italian i procedurës civile ka bërë një rregullim specifik të kësaj situate, duke parashikuar për kompetencën e gjykatës që është duke gjykuar themelin e padisë.<sup>246</sup> Gjykata që e ka dhënë masën e sigurimit *ante causam* do të ishte kompetente për të revokuar apo ndryshuar masën e sigurimit, vetëm nëse në momentin kur kërkohet revokimi i masës së sigurimit të dhënë *ante causam* padia e themelit nuk është ngritur ende.

Po në rastin kur juridiksioni për gjykimin e themelit të padisë i takon një gjykate të huaj apo arbitrazhit të huaj dhe masa e sigurimit të padisë është marrë nga gjykatat shqiptare, cila do të ishte kompetente për revokimin apo ndryshimin e masës, gjykata shqiptare që ka dhënë masën e sigurimit, apo gjykata e huaj apo e arbitrazhit? Në Kodin e Procedurës Civile nuk gjejmë do të një përgjigje të drejtpërdrejtë për këtë çështje, ndërsa neni 81 i Ligjit “Për të Drejtën Ndërkombëtare Private” parashikon se gjykatat shqiptare kanë juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë. Pra, ligji i referohet në terma të përgjithshëm juridiksionit për masa sigurimi, i cili duhet të përfshijë jo vetëm juridiksionin për dhënien e masave të sigurimit, por edhe ndryshimin edhe revokimin e tyre. Ndaj, nëse një masë sigurimi është dhënë nga një gjykatë shqiptare, ndërkohë që themeli i padisë është duke u gjykuar në një gjykatë të huaj, gjykata shqiptare do të ketë juridiksion edhe për ndryshimin apo revokimin e masës së dhënë. Gjithashtu, për shkak të sovranitetit shtetëror do të ishte e pamundur që vendimi i gjykatës shqiptare për masë sigurimi të ndryshohej apo revokohej nga një gjykatë e huaj, që është duke gjykuar themelin e padisë. Ndërsa në doktrinën dhe praktikën e arbitrazhit ndërkombëtar qëndrimi prevalues është që gjykata e arbitrazhit duhet të ketë mundësi të ndryshojë apo revokojë masën e dhënë nga gjykata shtetërore, sepse vendimi i gjykatës për masë sigurimi është i një natyre të përkohshme dhe nuk mund të pengojë gjykatën e arbitrazhit të ushtrojë juridiksionin e saj për të dhënë një tjetër masë. E kundërta, pra që gjykata shtetërore të ndërhyjë me ndryshimin apo revokimin e masës së dhënë nga gjykata e arbitrazhit, nuk duhet të ndodhë, përveç kur gjykata e arbitrazhit nuk mund të veprojë në mënyrë efektive.<sup>247</sup>

Kodi italian i procedurës civile parashikon shprehimisht se në një rast të tillë, kompetente do të jetë gjykata që e ka dhënë masën e sigurimit dhe jo ajo që po gjykon themelin e padisë.<sup>248</sup>

Në rastin kur kundër masës së sigurimit të padisë të marrë nga gjykata e shkallës së parë është bërë ankim në gjykatën e apel, a mund të revokohet masa e sigurimit e lënë në fuqi nga gjykata e apelit, apo e ndryshuar prej saj? Mendohet se në një rast të

---

<sup>246</sup> Neni 669-terdecies i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Italisë.

<sup>247</sup> Për më shumë shiko Pjesën II, Kreu IV, paragrafi 4 të këtij punimi. Shiko gjithashtu: Emanuel Gaillard, “Arbitrage commercial international- Intervention du juge Etatique”, *Juisclasseur Droit International*, Fascicule 586-8-2, no. 142, 1991; Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 54; Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, *Kluwer Law International*, 1999, fq. 723, para. 1330; Julian D.M. Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 625, para. 23-130

<sup>248</sup> Neni 669-decies i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Italisë

tillë, përgjigjja duhet të jetë pozitive, sepse e kundërta do të nënkuptonte se masa e sigurimit të padisë e konfirmuar apo e ndryshuar nga gjykata e apelit është e paprekshme deri në dhënien e vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, gjë që është në kontrast të thellë me kërkesën për përshtatjen e masës së sigurimit me zhvillimet e procesit të themelit.<sup>249</sup>

## **2. Kundërshtimi i vendimit të gjykatës për masat e sigurimit të padisë**

Megjithëse vendimet për sigurimin e padisë janë vendime të ndërmjetme me karakter të përkohshëm që përthithen nga vendimi i themelit, sepse me këtë të fundit ligjërohet ose jo masa e sigurimit, është e nevojshme ushtrimi i një kontrolli jo vetëm nëpërmjet mekanizmit të revokimit dhe ndryshimit, por edhe të ankimit, sepse afatet e gjata të procesit të themelit mund të zgjasin në mënyrë jonormale efektet e masës së sigurimit, që shpesh jepen nën tensionin e urgjencës dhe mund të krijojnë situata që mund të jenë shumë të vështira të rivendosen, ndaj është i nevojshëm një shqyrtim më i peshuar i këtyre masave.<sup>250</sup>

Ankimi kundër masës së sigurimit nënkupton kundërshtimin për shkak të një gabimi në vlerësimin e të drejtës ose faktit nga ana e gjykatës, p.sh. sekuestro e vendosur mbi sende që nuk mund të sekuestrohen,<sup>251</sup> apo vlerësimi i gabuar i rrezikut nga vonesa, apo i mundësisë së ekzistencës së të drejtës. Pra, ankuesi pretendon që gjyqtari, i cili ka dhënë masën e sigurimit ka gabuar, sepse me të dhënat që dispononte mund dhe duhej të kishte vendosur në një mënyrë tjetër, si përsa i përket pranimit së kërkesës për sigurim padie, ashtu dhe përsa i përket llojit të masës së sigurimit.<sup>252</sup>

### **2.1. Vendime ndaj të cilave mund të ushtrohet ankim**

Vendimet e ndërmjetme janë vendime që nuk synojnë t'i japin zgjidhjen përfundimtare lidhur me themelin e padisë, por që jepen nga gjykata, me qëllim që t'u përgjigjet kërkesave të procesit gjyqësor dhe të sigurohet zhvillimi normal dhe korrekt i gjykimit, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.<sup>253</sup> Të tilla janë edhe vendimet e gjykatës për masat e sigurimit të padisë. Referuar Kodit të Procedurës Civile, këto vendime mund të goditen me ankim së bashku me vendimin

<sup>249</sup> Shiko, Pisani, op.cit fq. 649

<sup>250</sup> Mandrioli, op.cit. fq. 285-286

<sup>251</sup> Neni 529 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "Përfshihen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit:

1) sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobilet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;

2) ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;

3) dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;

4) librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;

5) deri 3 dynmë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;

6) ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;

7) frutat natyrore një muaj para se ato të piqen."

<sup>252</sup> Biavati, op.cit. fq. 704

<sup>253</sup> Neni 125 i KPrC shqiptar

përfundimtar. Megjithatë, në rastet e parashikuara shprehimisht në Kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja apo njoftimi i tyre.<sup>254</sup> Afati 5 ditor është afat i prerë dhe fillon të llogaritet nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, ose nga e nesërmja e njoftimit të tij për palën që ka qenë në mungesë. Megjithëse neni 444 i KPrC parashikon se afatet e fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, ndërsa kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>255</sup> me vendimin nr. 2, datë 27.03.2012 kanë interpretuar se: “Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë, afati i ankimit (apel, rekurs) për këtë palë fillon të llogaritet përkatësisht nga e nesërmja e marrjes njoftim të vendimit, sipas rregullave të përcaktuara nga dispozitat e neneve 316 dhe 148 të K.Pr.Civile.”

Neni 209 i KPrC ka parashikuar shprehimisht se kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimeve të sipërme nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të padisë. Pra, sipas kësaj dispozite vendimet të cilat mund të ankimohen në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes apo njoftimit të tyre janë:

- i. vendimi i pranimit të kërkesës për sigurimin e padisë;
- ii. vendimi i ndryshimit të masës së sigurimit të dhënë; dhe
- iii. vendimi i revokimit apo heqjes së masës së sigurimit.

Ajo që konstatohet është se në këtë dispozitë nuk ka një përcaktim të shprehur për ankimin kundër vendimit që rrëzon kërkesën për sigurimin e padisë. A duhet të lejohet ankimi i veçantë kundër këtij vendimi? Edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë, për rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, është një “vendim i ndërmjetëm”, në kuptim të nenit 125 të K.Pr.C.<sup>256</sup> Nga përmbajtja e nenit 209 të K.Pr.Civile nuk rezulton të jetë e parashikuar në mënyrë të shprehur e drejta e palëve të interesuara që, ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që rrëzon kërkesën për sigurimin e padisë, të mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit apo Gjykatën e Lartë, konform parashikimeve të nenit 470/2 të K.Pr.Civile, sipas të cilit në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë Kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankimi i veçantë. Për rrjedhojë, vendimi i ndërmjetëm i gjykatës, për rrëzimin e marrjes së masës së sigurimit të padisë, duke mos u parashikuar shprehimisht në ligj e drejta e ankimit të veçantë të tij, mund të ankimohet vetëm së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar që i jep fund shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Por, pavarësisht se ky është një konkluzion i qartë, i thjeshtë dhe logjik, në praktikën gjyqësore ndeshim qëndrime të ndryshme. Në disa raste gjykatat e kanë njohur të drejtën e ankimit të veçantë në dispozitivin e vendimit të rrëzimit të kërkesës për masë sigurimi<sup>257</sup> dhe në të tjera raste janë shprehur se ndaj atij vendimi nuk lejohet ankimi.<sup>258</sup>

---

<sup>254</sup> Neni 470 i KPrC shqiptar

<sup>255</sup> Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 27.03.2012

<sup>256</sup> Neni 125 i KPrC “Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore, me qëllim që t’i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi”, pasi ai është dhënë nga gjykata në përgjigje të kërkesës së bërë nga pala paditëse.”

<sup>257</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 655, datë 16.07.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 876, datë 05.11.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 334, datë 30.03.2015; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 663, datë



Një qëndrim të tillë të dyzuar nuk e ndeshim vetëm në praktikën e gjykatave të shkallës së parë, por edhe në atë të apelit. Për shembull, në një vendim Gjykata e Apelit Tiranë është shprehur se: “Siç shihet nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, por dhe në kuptim të nenit 125 të K.Pr.Civile, vendimi objekt gjykimi futet në ato vendime të ndërmjetme për të cilat është parashikuar ankimi i veçantë, i cili në kuptim të nenit 443 ky afat është 5 ditor.”<sup>259</sup>

Ndërsa në një tjetër vendim Gjykata e Apelit Tiranë me të drejtë është shprehur: “Në lidhje me ankimin e paraqitur nga ankuesi, pa i hyrë shkaqeve të pretenduara në këtë ankim, nga Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit Tiranë konstatohet, se ankimi i depozituar në kryesekretarinë e gjykatës së shkallës së parë, është paraqitur ndaj një vendimi, që sipas parashikimeve në ligj, nenit 209 të K.Pr.Civile, nuk lejohet ankimi.”<sup>260</sup>

Po këtë qëndrim e ndeshim edhe në një vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: “Përveç të tjerave, sa më sipër është e mjaftueshme për të çmuar se kundër vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që nuk ka pranuar, pra ka rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë, Kodi nuk ka parashikuar shprehimisht se ndaj tij mund të bëhet ankimi i veçantë, por mund të goditet vetëm me ankim së bashku me vendimin përfundimtar.”<sup>261</sup>

Ndërkohë që Gjykata Kushtetuese në një vendim mospranimi kundër një ankimi paraqitur pranë saj ndaj një vendimi të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sigurim padie si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe se kundër vendimit nuk lejohet ankimi është shprehur: “Kolegji vlerëson se ndonëse ndaj vendimeve mbi masën e sigurimit, neni 209 i KPC-së ka parashikuar të drejtën e ankimit, dhe se **gjykata e shkallës së parë ka disponuar në kundërshtim me këtë nen**, nga sa më lart, vendime të këtij lloji, për më tepër kur procesi i themelit është akoma në gjykim, nuk mund të quhen përfundimtare, për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës, dhe se nuk mund të interpretohet se kërkuessit kanë shteruar gjithë mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës”<sup>262</sup>

Kjo praktikë jo e unifikuar e gjykatave shqiptare është e pashpjegueshme për sa kohë neni 209 i KPrC qartazi nuk i ka parashikuar vendimet e rrëzimit të kërkesave për masa sigurimi, si vendime ndaj të cilave mund të ushtrohet ankimi i veçantë. Ndaj, referuar nenit 209 dhe nenit 470 të KPrC këto vendime mund të ankimohen vetëm së bashku e vendimin përfundimtar.

Por a është i drejtë dhe kushtetues një parashikim i tillë ligjor që nuk lejon ankimin e veçantë ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie? Theksojmë se përpara ndryshimeve të vitit 1995, neni 669-terdecies i KPrC italian mbi ankimin ndaj vendimeve për masa sigurimi, njësoj si neni 209 i KPrC shqiptar, nuk lejonte ankim ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për masë sigurimi. Në vitin 1995 kjo dispozitë u ndryshua duke lejuar ankimin edhe ndaj vendimeve për rrëzimin e kërkesës për sigurim padie, njësoj sikurse lejohej edhe për vendimin e pranimit,

---

17.07.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 430, datë 22.04.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 216, datë 27.02.2015

<sup>258</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 838, datë 23.10.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 48, 20.01.2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 240, datë 07.03. 2014; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 249, 02.03. 2015; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 1034, datë 24.12.2014

<sup>259</sup> Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 27, datë 25.02.2013

<sup>260</sup> Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 123, datë 03.04.2013

<sup>261</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 445, datë 17.04.2007

<sup>262</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 145 datë 10.12.2013

ndryshimit apo revokimit. Ky ndryshim u bë për shkak se Gjykata Kushtetuese Italiane e konsideroi antikushtetues nenin 669-terdecies për pjesën që nuk lejonte ankimin ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie me arsyetimin se: “Duke pasur parasysh parimet që duhet domosdoshmërisht të karakterizojnë procesin civil, atë të barazisë së plotë të palëve përpara gjykatës dhe barazisë së armëve mes palëve, mungesa e ankimit kundër vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie për palën që ka kërkuar pa sukses një masë sigurimi, ankim i cili është dhënë vetëm në rastin e pranimit të një kërkesë të tillë, përbën një shkelje të të drejtës për tu mbrojtur, për aq sa i jepet më shumë mundësi për të mbrojtur pozicionin e saj palës që është kundër masës së sigurimit, sesa asaj që e kërkon marrjen e asaj mase, dhe kjo pa asnjë lloj justifikimi, duke pasur parasysh pozitën simetrikisht të barabartë të palëve në sistemin procedural. Në fakt, vendimi për masë sigurimi, qoftë pranimi apo rrëzimi cenon interesat e njëjës apo tjetrës palë në një masë që nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte; ndaj nuk është logjike që vendimi i rrëzimit të konsiderohet *apriori* më i bazuar se ai i pranimit. Gjithashtu, pabarazia e krijuar nga lejimi i ankimit vetëm për vendimin e pranimit nuk mund të kompensohet as me mundësinë për t’i kërkuar të njëjtit gjyqtar zëvendësimin apo heqjen e masës së sigurimit në rast të ndryshimit të rrethanave, për aq sa ankimi dhe revokimi nuk janë ekuivalentë lidhur me garancinë, sepse veprojnë në fusha të ndryshme, dhe nuk janë mbivendosje të njëri-tjetrit, por komplementarë, kështu që disponueshmëria e mjetit të dytë nuk përjashton nevojën për të njohur ribalancimin e të drejtave mes palëve në mjetin e parë.”<sup>263</sup>

Referuar këtij arsyetimi të Gjykatës Kushtetuese italiane dhe me qëllim eliminimin e praktikës së ndryshme që ekziston mes gjykatave shqiptare, e cila është e pajustificuar në kushtet aktuale që ka parashikimi i Kodit të Procedurës Civile dhe në mungesë të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që deklaronte antikushtetutshmërinë e nenit 209, për pjesën që nuk parashikon ankim nda vendimit të rrëzimit, rekomandojmë që legjislatori të ndryshojë nenin 209 të KPrC në mënyrë që të garantohet e drejta e ankimit të veçantë edhe kundër vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie.

## **2.2. Shkaqet për të cilat mund të ushtrohet ankim**

Në kodin e procedurës civile nuk gjejmë shprehimisht shkaqet për të cilat mund të justifikohet ushtrimi i ankimit kundër vendimit të gjykatës lidhur me masat e sigurimit të padisë, megjithatë është e kuptueshme se këto shkaqe mund të jenë:

- a. gabime në procedurë (*errores in procedendo*), p.sh. lidhur me respektimin e parimit të kontradiktoritetit;
- b. gabime në gjykim (*errores in iudicando*), p.sh. gjyqtari ka dhënë masën e sigurimit në bazë të interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe të vlerësimit të gabuar të elementeve provues lidhur me ekzistencën e *fumus boni juris* dhe *periculum in mora*;
- c. rrethana dhe shkaqe (fakte dhe prova) që kanë ngjarë, por që duhet të jenë të ndryshëm nga shkaqet e revokimit.<sup>264</sup>

## **2.3. Gjykata kompetente dhe procedura e shqyrtimit të ankimit**

<sup>263</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane nr. 253, datë 23 qershor 1994.

<sup>264</sup> Pisani, op.cit. fq. 652

Në çdo rast, për shqyrtimin e ankimit kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë mbi masën e sigurimit të padisë kompetente do të jetë gjykata e apelit në kompetencën tokësore të të cilës përfshihet gjykata e rrethit gjyqësor që ka dhënë vendimin. Ankimi, i cili duhet të tregojë a) palët ndërgjyqëse; b) vendimin kundër të cilit bëhet ankimi; c) shkaqet për të cilat bëhet ankimi dhe ç) çfarë kërkohet me ankimin,<sup>265</sup> depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin.<sup>266</sup> Gjykata, kur pranon kërkesën ankimore,<sup>267</sup> i komunikon kopjen e saj palës tjetër,<sup>268</sup> ndërsa aktet e çështjes bashkë me ankimin, ia dërgon gjykatës së apelit të nesërmen e mbarimit të afatit të ankimit për të gjitha palët ose edhe përpara mbarimit të këtij afati, kur nga të gjitha palët janë paraqitur ankimet.

Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në mënyrë kolegjiale. Ajo gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes.<sup>269</sup>

Ajo që konstatojmë është se ndryshe nga procesi i marrjes së masës së sigurimit të padisë, kodi në rastin e ankimit kundër vendimit mbi kërkesën për marrjen e një mase sigurimi nuk ka parashikuar afat për shqyrtimin e ankimit. Në dallim nga Kodi ynë i Procedurës Civile, KPrC italian ka vendosur një afat maksimal jo më shumë se 20 ditë brenda të cilit duhet të shqyrtohet ankimi kundër një vendimi për masë sigurimi.<sup>270</sup> Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë,<sup>271</sup> ku ndër të tjera duhet të respektohet parimi i kontradiktoritetit.

#### **2.4. Efektet e ankimit dhe lloji i vendimeve të gjykatës së apelit**

Sikurse do të trajtohet gjerësisht më poshtë, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për sigurimin e padisë, megjithëse një vendim i ndërmjetëm, përbën titull ekzekutiv dhe ai vihet në ekzekutim, pa pritur që vendimi përfundimtar që ligjëron masën e sigurimit të marrë formë të prerë. Por ndërkohë, fakti që masa e dhënë është ekzekutuar, nuk do të thotë se ajo nuk mund të hiqet, ndryshohet apo të kundërshtohet me kërkesë të palës së interesuar. Në këto raste, Kodi i Procedurës Civile parashikon se ushtrimi i ankimit kundër vendimit që lejon masën e sigurimit, nuk pezullon ekzekutimin e masës së dhënë. Ndërkohë që e kundërta është në rastin e depozitimit të një ankimi kundër vendimit me të cilin zëvendësohet ose hiqet masa e sigurimit. Pra në këtë rast, pezullohet ekzekutimi i masës së sigurimit.

<sup>265</sup> Neni 454 i KPrC

<sup>266</sup> Neni 446 i KPrC

<sup>267</sup> Për shkaqet për të cilat gjykata mund të mos pranojë kërkesën ankimore shiko nenin 450 të KPrC, i cili parashikon se: "Gjykata që ka dhënë vendimin nuk e pranon ankimin kur:

a) është paraqitur jashtë afatit;

b) nuk ndreqen të metat në afatin e caktuar. Në këto raste zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 157 të këtij Kodi;

c) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankimi;

ç) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim;

d) është hequr dorë nga ankimi.

<sup>268</sup> Ankimi u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në nenet 130 dhe 131 të këtij Kodi, për njoftimet e thirrjet në gjykatë- neni 247 i KPrC.

<sup>269</sup> Neni 460 i KPrC

<sup>270</sup> Shiko nenin 669-terdecies, paragrafi (v) të KPrC italian.

<sup>271</sup> Neni 465 i KPrC

Përsa i përket llojeve të vendimeve që mund të marrë gjykata e apelit në fund të gjykimit, nëse i referohemi nenit 466 të KPrC, ato mund të jenë:

- a. Lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- b. Ndryshimi i vendimit;
- c. prishjen e vendimit dhe pushimi i çështjes
- d. prishja e vendimit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë në rastet e parashikuara nga neni 467 i K.Pr.C.<sup>272</sup>

Në rast se gjykata e apelit pasi shqyrton ankimin ndaj një vendimi që pranon kërkesën për sigurim padie çmon se gjykata e shkallës së parë ka bërë një vlerësim të drejtë të rrethanave të faktit dhe provave lidhur me plotësimin e kushteve për marrjen e masës së sigurimit, atëherë ajo vendos lënien në fuqi të këtij vendimi. Në të kundërt, nëse çmon se gjykata ka vlerësuar gabim rrethanat e faktit dhe provat lidhur me plotësimin e kushteve për marrjen e masës së sigurimit, atëherë mund të vendosë ndryshimin e vendimit dhe pranimin pjesërisht të kërkesës për sigurim padie, ose ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës për sigurim padie.

Prishja e vendimit dhe pushimi i gjykimit do të vendosej për shembull në rastin kur është bërë ankim ndaj një vendimi për masë sigurimi të dhënë *ante causam*, dhe nuk është ngritur padia e themelit brenda afatit të caktuar nga gjykata, i cili në çdo rast është jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë.<sup>273</sup>

Ndërkohë përsa i përket vendimit për kthimin e çështjes për rigjykim, gjykojmë se në rastin e ankimit kundër një vendimi për masë sigurimi neni 467 i KPrC që parashikon shkaqet për të cilat çështja mund të kthehet për rigjykim nuk mund të aplikohet në mënyrë strikte. Kjo për shkak se gjykimi i kërkesave për masa sigurimi ka disa veçori në raport me gjykimin e themelit. Për shembull nëse referuar pikës ç) të nenit 467 të KPrC e cila parashikon si shkak për kthimin e çështjes për rigjykim rastin kur çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për ditën e gjykimit, gjykata e apelit do të vendoste kthimin e çështjes për rigjykim kur shqyrton ankimin ndaj një vendimi përfundimtar, ajo nuk mund të vendosë në këtë mënyrë kur shqyrton ankimin ndaj një vendimi për masë sigurimi, i cili referuar nenit 205 të KPrC në raste të veçanta ose ngutshme mund të merret edhe pa u dëgjuar pala tjetër. Në një rast Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është shprehur: “Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur të prishë vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor e t’ia dërgojë përsëri aktet asaj gjykate për rishqyrtim, me arsyetimin se vendimi i ndërmjetëm lidhur me rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nuk është arsyetuar, se gjykata nuk ka pasur parasysh se ka qenë një vendim i mëparshëm sigurimi padie i pa ekzekutuar dhe se gjykata, në kundërshtim me nenin 202 të K.Pr.C., duhet të vinte dhe garanci pasurore në rastin e pezullimit të punimeve. Gjykimi për sigurimin e padisë është një gjykim i veçantë që lidhet me garantimin e të drejtave të kërkuarit, të

---

<sup>272</sup> Neni 467 i KPrC: “Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:

- a) gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën;
- b) përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt apo vendimi nuk është nënshkruar nga anëtarët e tij;
- c) gjykata ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga ky Kod;
- ç) çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për ditën e gjykimit;
- d) nuk është formuar drejt ndërgjyqësia;
- e) kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit.
- ë) kur lind nevoja për marrjen e një prove vendimtare, marrja e së cilës është e vështirë në shkallë të dytë”

<sup>273</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 131, datë 18.03.2010

cilat do të bëheshin të pamundura, ose të vështira për tu ekzekutuar në rastin kur atij do i pranohej padia. Ky gjykim kërkon shpejtësi për të parandaluar pasoja të cilat do ishin të riparueshme, ose që kërkojnë më shumë kohë dhe kontribut për riparimin e tyre në qoftë se përgjigja apo vendimmarrja gjyqësore nuk do ishte në kohën e duhur. Jo pa qëllim ligjvënësi lejon sigurimin e padisë edhe përpara se të ngrihet ajo. Gjykata e apelit ka qenë përpara rastit tipik që të shprehej për pranimin, ose jo të masës provizore të dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe jo të kthente aktet për rigjykim asaj gjykate. Kjo mënyrë gjykimi i kërkesës për sigurimin e padisë nuk i përgjigjet aspak kuptimit të dispozitave të kreut IV të K.Pr.C. dhe e zvarritin gjykimin në kohë, duke e bërë të paefektshme vetë masën e sigurimit.”<sup>274</sup>

Gjithashtu, ndonëse neni 451 i KPrC parashikon se vendimi merr formë të prerë kur është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimin në shkallë të dytë, një vendim për masë sigurimi nuk merr formë të prerë, madje edhe pse ndaj tij mund të jetë ushtruar ankimi, ai mund të ndryshohet ose revokohet.

## **2.5. Kundërshtimi i vendimit të Gjykatës së Apelit mbi ankimin ndaj masës së sigurimit**

Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë për masë sigurimi nuk lejohet ankimi i veçantë drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë.<sup>275</sup> Nuk mund të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj të gjitha vendimeve për të cilat në ligj parashikohet shprehimisht se ndaj tyre nuk mund të bëhet rekurs.<sup>276</sup> Për sa kohë që nuk ka një ndalim të shprehur në ligj, kundër vendimit të gjykatës së apelit për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndryshimit të vendimit, prishjes së vendimit dhe pushimit e çështjes, prishjes së vendimit dhe dërgimit të çështjes për rigjykim lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Megjithatë vendimi i gjykatës së apelit mund të ankimohej me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur:<sup>277</sup>

- a. nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji;
- b. ka shkelje të rënda të normave procedurale;
- c. për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

Kundërshtimi i vendimit të gjykatës së apelit mbi masën e sigurimit në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 30 ditëve nga e nesërmja e dhënies së vendimit. Kur palët janë në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit. Procedura e gjyqimit të këtij rekursi bëhet sipas rregullave të zakonshme për gjykimin e rekursit të parashikuara nga KPrC. Rekursi, i cili duhet të përmbajë) palët ndërgjyqëse; b) vendimin që

<sup>274</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 849, datë 29.06.2006

<sup>275</sup> Shiko Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 130, datë 19.02.2013 “Kolegji Civil vlerëson se, *së pari*, kundër vendimit objekt gjykimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ligji nuk parashikon ndonjë të drejtë për palët në gjykim që t’i drejtohen drejtpërdrejt me ankimi të veçantë Gjykatës së Lartë.

Në nenin 209 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit të sipërm nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të padisë”.

Pra, në interpretim dhe zbatim të drejtë të kësaj dispozite, vërtet ligji parashikon ankimin e veçantë, por ky mjet ankimi pikësisht bëhet për të kundërshtuar vetëm disponimin për masën e sigurimit të dhënë nga gjykata. Së dyti, ky ankimi i veçantë ndjek rrugën e zakonshme dhe duhet t’i paraqitet për shqyrtim gjykatës së apelit.

<sup>276</sup> Për shembull neni 437 i K.Pr.C.-së parashikon se: “Kundër vendimit të gjykatës së apelit, që shqyrton një ankimi ndaj një vendimi arbitrazhi vendor, nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë”.

<sup>277</sup> Neni 472 i KPrC

kundërshtohet; c) paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes; ç) shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet; d) prokurën nëse rekursi është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesi,<sup>278</sup> depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin. Së bashku me rekursin duhet të depozitohet: a) kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar dhe kur është rasti edhe e njoftimit kur ky është bërë; b) prokura e posaçme; c) aktet dhe dokumentet mbi të cilat është bazuar rekursi, në atë masë sa janë palët. Sekretaria e gjykatës, që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, përcjell zyrtarisht në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dosjen përkatëse së bashku me dokumentet e mësipërme dhe kur nuk plotësohen këto kushte, palës i caktohet një afat 10-ditor për të bërë plotësimet dhe, nëse pas këtij afati nuk bëhen plotësimet, rekursi kthehet.<sup>279</sup>

Rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit gjykohet në kolegji me trup gjykues të përbërë nga tre ose pesë gjyqtarë. Në seancë gjyqësore relatori paraqet faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit, përmbajtjen e vendimit të ankimuar dhe shkaqet e rekursit dhe të kundërrekursit. Pas relativitetit kryetari fton avokatët e palëve të paraqesin mbrojtjen e tyre.<sup>280</sup> Gjykata pas diskutimit të çështjes tërhiqet në dhomën e këshillimit dhe merr vendimin për:

- a. lënien në fuqi të vendimit
- b. prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë;
- c. prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, me tjetër trup gjykues;
- d. prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë me tjetër trup gjykues;
- e. ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit;
- f. prishjen e vendimeve dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Në dallim nga KPrC shqiptar, KPrC italian parashikon se vendimi i dhënë në bazë të ankimit kundër një vendimi për masë sigurimi është i paankimueshëm dhe parashikon se ankimi si rregull nuk pezullon ekzekutimin, pa bërë dallim mes llojeve të vendimeve që ankimohen, pra ankim kundër pranimet, heqjes apo ndryshimit të masës, por përjashtimisht mund ta pezullojë kur rrezikohet të shkaktohet ndonjë dëm i rëndë, i cili mund të shoqërohet dhe me dhënien e ndonjë garancie.<sup>281</sup>

### **3. Ekzekutimi i vendimeve për sigurimin e padisë**

Vendimet e gjykatës për dhënien e një mase sigurimi përbëjnë titull ekzekutiv.<sup>282</sup> Si të tillë ato i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm, njësoj si një vendim gjyqësor i formës së prerë. Madje për shkak të karakterit të veçantë të tyre, vendimet për masë sigurimi ekzekutohen me një procedurë më të thjeshtë, kjo për faktin se për vendimet e sigurimit të padisë është parashikuar se nuk lëshohet urdhër ekzekutimi. Ato ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përmbartimit, pas njoftimit të vendimit.<sup>283</sup> Pra, kur gjykata urdhëron Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që të ndalojë

---

<sup>278</sup> Neni 475 i KPrC

<sup>279</sup> Neni 476 i KPrC

<sup>280</sup> Nenet 483-484 të KPrC

<sup>281</sup> Shiko nenin 669-terdecies të KPrC italian

<sup>282</sup> Neni 510 i KPrC

<sup>283</sup> Neni 511 (2) i KPrC

shitjen, dhurimin apo çdo lloj disponimi të tyre, kjo përbën autorizimin për vendosjen e sekuestros konservative, apo një bankë të bllokojë një shumë të caktuar në një llogari bankare, është përmbaruesi gjyqësor ai që ndërmerr veprimet konkrete për realizimin në praktikë të sekuestros së vendosur nga gjykata.

### **3.1. Përmbaruesi kompetent**

Vendimi i gjykatës për masën e sigurimit të padisë duhet të vihet në ekzekutim brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes për ekzekutim.<sup>284</sup> Personi i interesuar për ekzekutimin e një mase sigurimi ka mundësi të zgjedhë mes shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror ose atij privat, për vënien në ekzekutim të një mase sigurimi. Kompetenca tokësore e përmbaruesit gjyqësor shtetëror përcaktohet nga “vendi “ ku ndodhet detyrimi që rëndon mbi debitorin, e përcaktuar nga titulli ekzekutiv. Në bazë të nenit 516 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesa për ekzekutimin e një mase sigurimi do t’i drejtohet përmbaruesit gjyqësor të vendit ku ndodhen:

- a. sendet e luajtshme ose të paluajtshme ose paratë, ndaj të cilave drejtohet ekzekutimi;
- b. banimi i personit të tretë të detyruar kur ekzekutimi drejtohet kundër kredisë që ka për të marrë debitori nga ky person;
- c. vendi i ekzekutimit të detyrimit për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar.

Kur përmbaruesi gjyqësor konstaton se nuk është kompetent për të vënë në ekzekutim kërkesën, ia dërgon këtë përmbaruesit gjyqësor kompetent, pasi vë më parë sekuestër mbi sendin ose mbi kredinë e debitorit. Konflikti për kompetencë nuk lejohet, por përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të parashtrijë moskompetencën e tij në gjykatën e shkallës së parë ku e ushtron veprimtarinë, e cila e shqyrton atë në këshill gjyqësor. Kundër vendimit të tij lejohet ankimi i veçantë.

Ndërsa, nëse kreditori vendos t’i drejtohet shërbimit përmbarimor privat, atëherë ai është i lirë të zgjedhë një përmbarues, i cili është i licencuar për të kryer një veprimtari të tillë sipas rregullave dhe kriterëve që përcakton ligji për shërbimin përmbarimor shtetëror privat. Përmbaruesi gjyqësor privat ose shoqëritë përmbaruese private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale përmbarimore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.<sup>285</sup> Pra, në rastin e përmbaruesit privat ligjvënësi nuk ka dashur të vërë kufizime në ushtrimin e veprimtarisë duke e lidhur me kompetencën e përmbaruesit.

### **3.2. Mënyra e ekzekutimit të masave të sigurimit**

Neni 208 i KPrC ka parashikuar se vendimet për sigurimin e padisë ekzekutohen sipas rregullave të caktuara në K.Pr.C. për ekzekutimin e vendimeve mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme. Rregullat e zbatueshme për ekzekutimin mbi sendet e luajtshme parashikohen nga nenet 540-559 të Kodit të Procedurës civile, ndërsa për sendet e paluajtshme zbatohen rregullat e parashikuara nga nenet 560-580 të këtij Kodi.

#### **3.2.1 Ekzekutimi mbi sende të luajtshme**

---

<sup>284</sup> Neni 515 i KPrC

<sup>285</sup> Neni 7 i ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.

Nenin 540 i K.Pr.C.-së parashikon se sekuestroja mbi sendet e luajtshme të debitorit bëhet me inventarizimin e tyre nga përmbaruesi gjyqësor. Përmbaruesi gjyqësor bën sekuestrimin e pasurive të luajtshme, mbi të cilat vendoset një etiketë e shërbimit të përmbarimit, e cila është një element mjaft i rëndësishëm praktik, pasi shërben për të identifikuar saktë sendet e sekuestruara, në mënyrë që askush të mos mund të ngatërrohet. Por çfarë sendesh mund të sekuestrohen dhe inventarizohen? Sipas nenit 541 të K.Pr.C.-së inventarizimi përfshin vetëm sendet që ndodhen në shtëpinë e debitorit, si dhe ato që ndodhen në një lokal tjetër që është i përbashkët për debitorin dhe personat e tretë, përveç se kur del se ato janë të një personi tjetër. Për inventarizimin mbahet procesverbal.<sup>286</sup> Ky procesverbal për sekuestrimin e sendeve të luajtshme duhet të përmbajë disa elemente të cilët përcaktohen në nenin 542 të KPrC, sipas të cilit:

“Procesverbali i inventarizimit duhet të përmbajë:

- a. shënimin e urdhrin të ekzekutimit, në bazë të të cilit vihet sekuestroja;
  - b. emrin, emrin e atit dhe mbiemrin e përmbaruesit gjyqësor të debitorit, kreditorit dhe të personave të tjerë që janë të pranishëm në inventarizim;
  - c. vendin ku kryhet inventarizimi dhe koha e kryerjes së tij;
  - d. pretendimet e personave të tretë në lidhje me sendet e inventarizuara;
  - e. përshkrimin e hollësishëm të sendeve dhe vlerësimin e tyre;
  - f. kujt i lihen për ruajtje sendet;
- e) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në inventarizim.”

Pjesa më e rëndësishme e procesverbalit të inventarizimit qëndron në faktin se në të përcaktohen sendet e luajtshme të sekuestruara (*të përshkruara në mënyrë të hollësishme*), si dhe vlerësimi i tyre. Përshkrimi i sendeve të sekuestruara është një veprim i domosdoshëm dhe tejet i rëndësishëm, pasi nëpërmjet këtij veprimi individualizohen ato duke i veçuar nga sende të tjera të ngjashme. Për këtë qëllim, përmbaruesi gjyqësor duhet të shënojë çdo karakteristikë apo veçori të sendit, duke e bërë në këtë mënyrë individualisht të përcaktuar. Normalisht, përmbaruesi gjyqësor, përveç inventarizimit të sendeve, vendos në trupin e tyre apo në pjesë të tjera të përshtatshme, një etiketë me shkrim që përcakton se sendi është i sekuestruar për llogari të kryerjes së veprimeve të ekzekutimit të detyrueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. Sendet e përcaktuara në gjini individualizohen nëpërmjet peshimit, matjes apo numërimit të tyre, përshkrimit të karakteristikave individualizuese të tyre dhe veçimit nëpërmjet paketimit apo vendosjes së shenjave të tjera të përshtatshme. Po ashtu, një pjesë e rëndësishme e procesverbalit të inventarizimit lidhet edhe me përcaktimin e personit të cilit i lihen në ruajtje sendet.

Inventarizimi bëhet në prani të debitorit. Në mungesë të debitorit, inventarizimi bëhet në prani të një personi madhor të familjes së tij dhe, kur nuk ndodhet një person i tillë, në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, inventarizimi bëhet duke qenë të pranishëm edhe dy dëshmitarë.<sup>287</sup> Në inventarizimin e sendeve të luajtshme marrin pjesë edhe ekspertë vlerësues, të cilët bëjnë vlerësimin e tyre sipas kërkesës së përmbaruesit gjyqësor. Në nenin 544 të K.Pr.C.-së përcaktohet se sendet e inventarizuara vlerësohen nga përmbaruesi gjyqësor në bazë

---

<sup>286</sup> Këtu duhet mbajtur parasysh edhe neni 524 i K.Pr.C.-së, i cili parashikon se përmbaruesi gjyqësor, për çdo veprim të kryer prej tij, është i detyruar të mbajë procesverbal, në të cilin përmenden dita dhe vendi i kryerjes së veprimit, kërkesat dhe deklaratimet e bëra nga palët, sendet e marra, shumata e nxjerrjeve dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin.

<sup>287</sup> Neni 543 i KPrC



të vlerësimeve të ekspertëve, në bazë të çmimeve të tregut, duke u zbritur përqindja përkatëse e konsumimit ose e vjetërsisë së tyre.

Sendet e inventarizuara mund t'i lihen në ruajtje debitorit, i cili ka të drejtë edhe t'i përdorë, por me kusht që të mos pakësohet vlefja e tyre. Kur debitori refuzon t'i pranojë për ruajtje, përmbaruesi gjyqësor emëron në këtë detyrë një person tjetër, duke i caktuar këtë një shpërblim. Debitori ose personi i tretë, të cilëve u janë lënë në ruajtje sendet e inventarizuara, duhet të japin llogari për të ardhurat dhe shpenzimet e bëra për sendin. Këta janë përgjegjës, sipas dispozitave të Kodit Penal, për disponimin, dëmtimin ose shkatërrimin e tyre.<sup>288</sup>

Kur ekzekutimi bëhet mbi sendet që janë në bashkëpronësi të debitorit dhe të personave të tjerë, përmbaruesi gjyqësor, pasi bën inventarizimin e të gjithë pasurisë së përbashkët, i bën kërkesë gjykatës kompetente të vendit të ekzekutimit, e cila cakton dhe ndan pjesën që i takon debitorit, sipas rregullave të parashikuara nga nenet 369-374 të këtij Kodi. Mbi këtë pjesë bëhet pastaj ekzekutimi nga përmbaruesi gjyqësor (neni 546 i K.Pr.C.-së).

Në nenin 547 të KPrC përcaktohen kufizime të të drejtave të debitorit mbi sendet e luajtshme që janë vënë në sekuestro. Konkretisht, sipas këtij neni çdo disponim i sendit të luajtshëm nga ana e debitorit pas vënies së sekuestros është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin, përveç kur me disponimin sendi ka kaluar në pronësi të një tjetri që ka qenë në mirëbesim. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se debitori i cili ka vepruar në kundërshtim me ligjin, përjashtohet nga përgjegjësia penale për veprimet e tij.

### 3.2.2. Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme

Në nenin 560 të K.Pr.C.-së përcaktohet se ekzekutimi i vendimit të gjykatës apo i titujve të tjerë ekzekutivë mbi sendet e paluajtshme të debitorit bëhet me vendosjen e sekuestros mbi to. Sekuestroja vihet me regjistrimin e saj në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të aktit të përmbaruesit gjyqësor, në të cilin shënohet lloji, natyra dhe të paktën tre kufij të sendit të paluajtshëm, vendi i ndodhjes së tij, si dhe hipotekat dhe të drejtat reale që mund të jenë vënë mbi të. Akti i përmbaruesit gjyqësor regjistrohet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tij. Një kopje e aktit të përmbaruesit gjyqësor i komunikohet debitorit.

Përpara vendosjes së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor sigurohet nëse sendi i paluajtshëm është në pronësi të debitorit. Për këtë, përmbaruesit gjyqësor duhet t'i paraqiten dokumente pronësie ose edhe vetë ai kërkon informata nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, nga organet financiare dhe të pushtetit lokal.<sup>289</sup> Marrja e këtyre të dhënave ndihmon që të mos cenohen të drejtat apo interesat e personave të tretë, si rrjedhojë e sekuestrimit të sendeve të ndryshme të paluajtshme. Me sekuestrimin e sendit të paluajtshëm debitorit i pezullohet e drejta e disponimit të tyre. Lidhur me këtë në nenin 566 të K.Pr.C.-së parashikohet se çdo veprim i debitorit, që përbën disponim të sendit të paluajtshëm pas regjistrimit të sekuestros në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin.

Referuar nenit 565 të KPrC sendi që sekuestrohet i lihet në ruajtje debitorit derisa të bëhet shitja e tij, duke qenë i detyruar debitori të kujdeset për të, si për sendin e tij.

<sup>288</sup> Neni 545 i KPrC

<sup>289</sup> Shihni nenin 563 të Kodit të Procedurës Civile.

Në rast se debitori nuk kujdeset si duhet për sendin e lënë në ruajtje, përmbaruesi gjyqësor emëron një person tjetër për ruajtjen e tij, duke i caktuar një shpërblim. Emërimi dhe caktimi i shpërblimit bëhen me marrëveshje midis përmbaruesit dhe personit tjetër. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar, pas shitjes së tij. Debitori ose personi tjetër, të cilëve u është lënë në ruajtje sendi i paluajtshëm i sekuestruar, duhet të japë llogari për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra për sendin. Ata përgjigjen sipas nenit 320 të Kodit Penal për veprime që bëhen pengesë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

## PJESA II

### MASAT E SIGURIMIT TË PADISË NË PROCESIT E ARBITRAZHIT

#### HYRJJE

Arbitrazhi është një nga format më të përdorura për zgjidhjen jashtëgjyqësive të mosmarrëveshjeve, veçanërisht atyre tregtare ndërkombëtare. Megjithëse ka autorë që mendojnë se ai është një fenomen i kohëve të fundit,<sup>290</sup> ashtu sikurse mund të quhet në Shqipëri,<sup>291</sup> gjurmët e tij gjenden që në fillimet e njerëzimit.<sup>292</sup> Për shumë vite arbitrazhi ka qenë metoda e preferuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare dhe duket se popullariteti i tij po rritet.<sup>293</sup> Gjatë njëzet apo tridhjetë viteve të fundit ka pasur një rritje të jashtëzakonshme në numrin e proceseve të arbitrazhit ndërkombëtar.<sup>294</sup> Kjo tendencë në rritje mund të shpjegohet falë avantazheve që ofron arbitrazhi si metodë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në raport me sistemin gjyqësor, ndër të cilat mund të përmendim shpejtësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, kosto më e ulët, privatësia dhe neutraliteti.<sup>295</sup> Kompetencat e arbitrave gjatë proceseve të arbitrazhit gjithmonë kanë qenë objekt diskutimi, p.sh. e drejta për tu shprehur vetë për juridiksionin e tyre (*kompeteze-kompetenze*), kompetenca për marrjen e masave të përkohshme etj. dhe kanë qenë në zhvillim të vazhdueshëm. Aktualisht, ka autorë që mendojnë se tashmë arbitrat kanë fituar statusin e vendimmarrësve ndërkombëtarë dhe pritet që ata të mund të ushtrojnë të njëjtat kompetenca si ato të gjyqtarëve.<sup>296</sup>

Një ndër kompetencat më të diskutuara ka qenë dhe e drejta e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa të përkohshme apo sigurimi. Dhënia e masave të përkohshme dhe të sigurimit është shumë e rëndësishme për të realizuar mbrojtjen efektive të të drejtave,<sup>297</sup> sepse nëse mbrojtja përfundimtare e të drejtave realizohet me vendimin përfundimtar, mund të ndodhë që gjatë kohëzgjatjes së procesit, derisa të merret vendimi përfundimtar këto të drejta të dëmtohen në mënyrë të

---

<sup>290</sup> Shalakany, "Arbitration and the Third world: A Plea for Reassessing Bias under the Specter of Neo-Liberalism" 41 Harv. Int'l L.J. 419, 430 (2000)

<sup>291</sup> Shiko F. Kola & S. Cinari, "Historia e zhvillimit të arbitrazhit në Shqipëri në 100 vjet shtet", artikull i prezantuar në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Sistemi ligjor në konsolidim" organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë UT në bashkëpunim me Albanian University (2012)

<sup>292</sup> G. Born, "International Arbitration, Cases and Materials" 9-26 (2011).

<sup>293</sup> Carren Halverson Cross, "Arbitration as a means of resolving sovereign debt disputes", 17 Am. Rev. Int'l Arbitration, fq. 335, 337-338 (2008); Thomas E. Carbonneau, "The Ballad of Transborder Arbitration", 56 U.MIAMI L.REV. 773, 778 (2002)

<sup>294</sup> Alan Redfern, "Interim measures", në "The Leading Arbitrators' guide to international arbitration", Second Edition, redaktuar nga Lawrence W. Newman dhe Richard D. Hill, Juris Publishing ,Inc. fq. 203.

<sup>295</sup> Stephen M. Ferguson, "Interim measures of protection in international commercial arbitration: Problems, proposed solutions and anticipated results", 12 Currents: Int'l Trade L.J. fq. 55 (2003)

<sup>296</sup> Alan Redfern, "Interim measures, në The Leading Arbitrators' guide to international arbitration", Second Edition, redaktuar nga Lawrence W. Newman dhe Richard D. Hill, Juris Publishing ,Inc. fq. 204.

<sup>297</sup> Sikurse është shprehur Avokati i Përgjithshëm para Gjykatës Europiane të Drejtësisë në çështjen The Queen kundër Secretary of State for Transp., ex parte Factoratame Ltd Case no. C-213/89[1990] E.C.R. I-02433 para 18. "Mbrojtja e ndërmjetme ka pikërisht për qëllim të sigurojë që koha që nevojitet për konfirmuar ekzistencën e të drejtës nuk sjell si efekt dëmtrimin e pariparueshëm të të drejtës duke shmangur çdo mundësi për ushtrimin e saj; shkurtimisht, qëllimi i mbrojtjes së ndërmjetme është arritja e atij objektivi thelbësor të çdo sistemi ligjor, efektiviteti i mbrojtjes gjyqësore."

pariparueshme. Për rrjedhojë me qëllim mbrojtjen e të drejtave të palëve nga dëmet që mund të shkaktohen nga vonesat e procesit, legjislatorët kanë parashikuar mekanizmin e mbrojtjes së përkohshme të të drejtave, e cila është konsideruar si një nga pengesat me të cilat po përballet zhvillimi i arbitrazhit në dekadën e fundit të shekullit të njëzet.<sup>298</sup>

Dhe vështirësitë e para i ndeshim që në terminologjinë e përdorur në këtë kontekst, e cila është disi konfuze, sepse disa herë përdoret termi masa sigurimi, disa të tjera masa të përkohshme dhe të tjera herë masa të ndërmjetme. Shumë autorë nuk bëjnë ndonjë diferencë mes termave të përdorur,<sup>299</sup> kurse të tjerë bëjnë dallim mes tyre.<sup>300</sup> Përmendim këtu, Fouchard, Gaillard, Goldman, të cilët e analizojnë më gjerë dallimin mes koncepteve duke u shprehur se duhet të kemi parasysh që koncepti i masave të përkohshme i referohet më tepër natyrës së vendimit të dhënë, kurse koncepti tjetër, ai masave të sigurimit i referohet qëllimit të vendimit.<sup>301</sup> Në këtë punim, termat do të përdoren si sinonime të njëra tjetrës.

Pavarësisht sa më sipër, masat e ndërmjetme (përfshi këtu masat e sigurimit dhe ato të përkohshme) janë përkufizuar si vendime, ose urdhra të dhëna me qëllim mbrojtjen e njëres apo të dyja palëve nga dëmi që mund të vijë gjatë kohëzgjatjes së procesit të arbitrazhit. Më shpesh masat e sigurimit kanë për qëllim të ruajnë situatën faktike ose ligjore në mënyrë që të mbrohen të drejtat, njohja e të cilave është kërkuar nga gjykata (e arbitrazhit) që ka juridiksion për themelin e mosmarrëveshjes.<sup>302</sup> Ato janë përcaktuar si masa që një palë mund të kërkojë për mbrojtjen e të drejtave të tij në mënyrë të përkohshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit të themelit, apo edhe përpara fillimit të këtij procesi.<sup>303</sup> Pra, masat e përkohshme synojnë mbrojtjen e të drejtave të palëve deri në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes.<sup>304</sup> Ato kanë për qëllim të shpërndajnë ndërmjet palëve rrezikun e kohëzgjatjes së gjykimit të padisë së themelit, duke e kaluar nga pala që bën kërkesën për sigurimin e padisë tek

---

<sup>298</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional and protective measures under Austrian arbitration law", *Arbitration International*, Vol. 23, No. 4, © LCIA, 2007, fq. 593

<sup>299</sup> Shiko Lew, Mistlis, Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", *Kluwer Law International*, 2003 fq. 586 ku përcaktohet se masat e ndërmjetme ose të sigurimit shpesh referohen dhe si masa të përkohshme; ose Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 519, para. 604 ku shprehen se terminologjia e përdorur varion dhe ndeshen terma të tillë si masa të përkohshme, masa sigurimi, masa të ndërmjetme, por autorët nuk bëjnë dallim dhe përdoin termin masa të përkohshme.

<sup>300</sup> Shiko David E. Wagoner, "Interim relief in international arbitration: Enforcement is a substantial problem", 51 *Disp. Resol. J.* fq. 68, 69 (1996), në të cilin bëhet dallimi ndërmjet masave të sigurimit dhe atyre të përkohshme. John Charles Thomas, "Selected Issues: Interim Measures in International Arbitration: Finding the Best Answer", 12 *CROATIAN ARB.Y.B.* 213, 213-14 (2005), në të cilin dallohen vendimet e ndërmjetme (si veprime të përkohshme të gjykatës së arbitrazhit që kushtëzohen nga vendimi përfundimtar) nga vendimet e përkohshme.

<sup>301</sup> Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, *Kluwer Law International*, 1999, fq. 709-710. Shiko gjithashtu, Stephen R. Bond, "The nature of conservatory and provisional measures", në "Conservatory and provisional measures in international arbitration", *Botim i ICC* nr. 519, datë 1993, fq. 8; Sebastien Besson, "Arbitrage international et mesures provisoires-Etude de droit compare", 1998, para. 38-39.

<sup>302</sup> Lawrence Collins, "Provisional and protective measures in international litigation", 234 *Recueil des Cours* 9, fq. 19-24 (1992); Vendim i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në çështjen Van Uden Maritime BV kundër Kommanditgesellschaft in Firma Deco-Line, Case no. C-391/95 [1998] *E.C.R.* I-7091, 7133; Vendim i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në çështjen Reichert & Klockner kundër Dresner Bank, Case no. C-261/90 [1992] *E.C.R.* I-20149 para.34.

<sup>303</sup> Vendim i Gjykatës Federale Zvicerane datë 13 Prill 2010, DTF 4°-582/2009 Para. 2.3.2.

<sup>304</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 7; shiko gjithashtu, Kessedjian, "Measures provisoires et conservatoires. A propos d'une resolution adopte par l'Association de droit international", *JDI* 1997, fq. 103-114.

pala tjetër.<sup>305</sup> Shumë sisteme ligjore njohin nevojën procedurale për masa të përkohshme, si komplementare të vendimeve përfundimtare.<sup>306</sup> Shpesh efikasiteti i gjithë procesit të arbitrazhit varet nga masat e përkohshme, të cilat mund të pengojnë palët nga shkatërrimi apo fshehja e aseteve me qëllim për ta bërë vendimin përfundimtar të arbitrazhit të pakuptimtë.<sup>307</sup> Vendimi për dhënien e një mase sigurimi është konsideruar se është në përputhje me parimin e përgjithshëm të të drejtës sipas të cilit palët duhet të heqin dorë nga çdo masë që mund të dëmtojë ekzekutimin vendimit të dhënë.<sup>308</sup>

Megjithëse është e pamundur të përcaktohen të gjitha llojet e masave të sigurimit apo të përkohshme që mund të merren gjatë procesit të arbitrazhit, doktrina e arbitrazhit ndërkombëtar i ka grupuar ato në disa kategori. Kështu, kemi:

- i. masa që synojnë të ndihmojnë në zhvillimin e procesit të arbitrazhit, si p.sh. urdhrat për sigurimin e provës;
- ii. masa që synojnë të ruajnë *status quo*, si p.sh. urdhrat për të vazhduar zbatimin e kontratës deri sa të zgjidhet themeli i mosmarrëveshjes me vendim përfundimtar të gjykatës së arbitrazhit;
- iii. masa që synojnë të ndihmojnë në ekzekutimin e vendimit përfundimtar të arbitrazhit, si p.sh. sekuestroja;
- iv. masa që synojnë të japin garanci për kostot e procesit.<sup>309</sup>

Të tjerë autorë e bëjnë kategorizimin në masa që synojnë të pakësojnë humbjet, apo dëmin gjatë kohëzgjatjes së procesit të arbitrazhit, ose masa që synojnë që lehtësojnë ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të arbitrazhit.<sup>310</sup> Një kategorizim tjetër është ai në masa që synojnë të ruajnë provat, masa që synojnë të ruajnë *status quo*, ose masa që synojnë të garantojnë ekzekutimin e vendimit përfundimtar.<sup>311</sup>

Në praktikën dhe doktrinën e arbitrazhit ndërkombëtar, jo pak diskutime ka pasur lidhur me kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa të përkohshme, standardet mbi bazë të të cilave jepen masat e përkohshme, ekzekutimin e këtyre masave, kompetencën e gjykatave shtetërore për të dhënë masa në ndihmë të arbitrazhit dhe raportin ndërmjet kompetencës së gjykatave shtetërore dhe atyre të

---

<sup>305</sup> Besson, "Arbitrage International et mesures provisoires", fq. 23, para 8 ; UNCITRAL Secretariat Report, "Analytical commentary on draft text of a Model Law on Commercial Arbitration" UN Doc A/CN.9/264 botuar në Holtzman & Neuhaus, Model Law, fq. 542.

<sup>306</sup> Tucker, Lee Anna. "Interim Measures under Revised UNCITRAL Arbitration Rules: Comparison to Model Law Reflects both Greater Flexibility and Remaining Uncertainty." International Commercial Arbitration Brief 1, no. 2 (2011), fq. 16; Shiko gjithashtu: Gary B. Born, "International Commercial Arbitration: Commentary and Materials", (2d ed. 2001), fq. 920; "The UNCITRAL Arbitration Rules: A Commentary", Philip Alston & Vaughan Lowe eds., 2006, fq. 53

<sup>307</sup> Dana Renee Bucy, "Comment, How to Best Protect Party Rights: The Future of Interim Relief in International Commercial Arbitration Under the Amended UNCITRAL Model Law", 25 Am. U. Int'l L. Rev. 2010, fq.584

<sup>308</sup> Electricity Company of Sofia and Bulgaria, Ser A/B, no. 79, 1939, fq. 194, 199; Chester Brown, A commo law of international adjudication, OUP 2007, fq. 126-127

<sup>309</sup> Alan Redfern, "Interim measures, në The Leading Arbitrators' guide to international arbitration", Second Edition, redaktuar nga Lawrence W. Newman dhe Richard D. Hill, Juris Publishing, Inc. fq. 208. Për një kategorizim të ngjashëm shiko Lew, Mistlis, Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", Kluwer Law International, 2003, fq. 595

<sup>310</sup> Dana Renee Bucy, "Comment, How to Best Protect Party Rights: The Future of Interim Relief in International Commercial Arbitration under the Amended UNCITRAL Model Law", 25 Am. U. Int'l L. Rev. 2010, fq. 595.

<sup>311</sup> Kieran Robert Hieckie, The enforceability of interim measures of protection granted by arbitral tribunal outside the seat of arbitration: A new approach, 12 VINDOBONA J. INT.L COM. L. & ARB, 2008, fq. 225

arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi. Në fokus të kësaj pjese të punimit do të gjejnë trajtim të gjitha këto çështje.

## KAPITULLI I

### KOMPETENCA E ARBITRAVE PËR TË DHËNË MASA SIGURIMI

#### 1. E drejta e gjykatës së arbitrazhit për dhënien e masave të sigurimit. Burimet e kësaj të drejte

Për shumë vite në shumë juridiksione, gjykatat e arbitrazhit nuk kanë pasur kompetencë për të marrë masa të përkohshme apo sigurimi.<sup>312</sup> Përmendim këtu ligjin italian,<sup>313</sup> austriak,<sup>314</sup> grek,<sup>315</sup> zviceran,<sup>316</sup> të cilët parashikonin se dhënia e masave të sigurimit ishte në kompetencë ekskluzive të gjykatave. Arsyeja për një qëndrim të tillë duket se ka qenë për shkak të perceptimit se arbitrat, në dallim nga gjykatat kombëtare, nuk mund të japin masa shtrënguese, e shoqëruar kjo me pikëpamjen se masat e përkohshme janë masa shtrënguese.<sup>317</sup> Ndonjëherë si shkak për ndalimin e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi është sugjeruar edhe “rendi publik”.<sup>318</sup> Por sipas Lew<sup>319</sup> ka pak prova që justifikojnë përdorimin e rendit publik kundër masave të dhëna nga arbitrat, sepse nëse arbitrat kanë kompetencë për të dhënë vendime për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pse të mos kenë kompetencë të japin masa të përkohshme. Këto argumente jo shumë bindëse kundër kompetencës së arbitrave për të marrë masa sigurimi në fakt u braktisën pothuajse universalisht.<sup>320</sup> Megjithatë ende ka disa shtete të cilat vazhdojnë të mos e njohin kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi. Përmendim këtu për shembull Italinë, Kinën, Tailandën dhe Argjentinën.<sup>321</sup>

Ndër argumentet kryesore që mbështesin kompetencën e arbitrave për të marrë masa sigurimi mund të përmendim:<sup>322</sup>

- ndalimi i gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa të përkohshme apo sigurimi bie ndesh me kushtet e shumicës së marrëveshjeve të arbitrazhit dhe qëllimet themelore të procesit të arbitrazhit. Palët duke rënë dakord për të zgjidhur mosmarrëveshjet me arbitrazh, prezumohet se duan që mosmarrëveshjet e tyre të gjykojnë nga një gjykatë arbitrazhi neutrale, përfshi këtu edhe kërkesat për sigurimin e padisë.

<sup>312</sup> Redfern and Hunter on International Arbitration, 5<sup>th</sup> ed., 2009. para 7.16; Lew, Mistlis, Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, Kluwer Law International, 2003, fq. 588, para 23-10.

<sup>313</sup> Shiko nenin 818 të KPrC Italian, i cili edhe aktualisht ndalon gjykatën e arbitrazhit të marrë masa sigurimi.

<sup>314</sup> C. Hausmaninger, M. Herzer, “Austria Arbitration”, GAR 2012 Vetëm gjykatat shtetërore kanë kompetencë për të marrë masa sigurimi.

<sup>315</sup> Shiko nenin 685 të KPrC Grek, që ka qenë në fuqi deri më 1999

<sup>316</sup> Shiko nenin 26 (1) (2) të Konkordatit Kantonal Zviceran sipas të cilit vetëm autoritetet gjyqësore publike kishin juridiksion për të marrë masa sigurimi. (aktualisht i shfuqizuar)

<sup>317</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2432.

<sup>318</sup> Idem, footnote 37

<sup>319</sup> Lew, “Commentary on interim and conservatory measures in ICC arbitration cases”, 11(1) ICC Ct. Bull. 2000, fq. 23, 24.

<sup>320</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2432.

<sup>321</sup> Idem fq. 2440; Neni 818 i KPrC Italian parashikon se arbitrat nuk mund të vendosin sekuestro apo masa të tjera për sigurimin e padisë; Neni 68 i ligjit kinez të arbitrazhit; Neni 16 i Ligjit tajlandez të arbitrazhit; Neni 753 i kodit të procedurës civile dhe tregtare të Argjentinës.

<sup>322</sup> Idem, fq. 2433

- Palët e një marrëveshje arbitrazhi dëshirojnë që mosmarrëveshjet e tyre të zgjidhen në një mënyrë praktike, efektive dhe përfundimtare, dhe në shumë raste dhënia e masave të sigurimit është thelbësore në arritjen e një objekti të tillë;
- Me dhënien e kompetencës ekskluzive gjykatës shtetërore për marrjen e masave të sigurimit ekziston rreziku që vendimi i gjykatës shtetërore të paragjykojë vendimin përfundimtar të gjykatës së arbitrazhit dhe kjo bie ndesh me objektivat e arbitrazhit ndërkombëtar;
- Gjykata e arbitrazhit, nëse është formuar në mënyrë të rregullt, mund të marrë masa sigurimi më shpejt dhe në mënyrë më efektive.
- Arbitrat janë në një pozitë më të mirë se sa autoritetet gjyqësore për të identifikuar nëse kërkesa për sigurim padie përdoret si një taktikë për të shkaktuar vonesa, apo si një armë abuzive, apo nëse është një nevojë e vërtetë. Kjo, sepse arbitrat i njohin shumë më mirë faktet e çështjes sesa autoritetet gjyqësore dhe se arbitrat e ndjekin çështjen nga fillimi në fund. Ata kanë kompetencat dhe eksperiencën e nevojshme për të marrë masat e nevojshme me qëllim minimizimin e efekteve negative që mund të kenë kërkesa të tilla abuzuese.<sup>323</sup>
- Gjithashtu argumentohet se ekspertiza e arbitrave në një çështje të caktuar, i bën ata forumin më të përshtatshëm për të kërkuar masa sigurimi.<sup>324</sup>
- Arbitrazhi zakonisht ka një efekt më pak përçarës në marrëdhënien e përgjithshme tregtare mes palëve.<sup>325</sup> Paraqitja e kërkesës për sigurim padie pranë autoriteteve gjyqësore mund të ketë një efekt dëmtes në procesin e gjykimit të padisë dhe për rrjedhojë edhe në marrëdhënien e palëve.<sup>326</sup>
- Ka shumë gjasa që kur kërkesat për sigurimin e padisë paraqiten para arbitrave, argumentet e palëve, objekti i mosmarrëveshjes dhe në disa raste dhe vetë ekzistenca e procesit të arbitrazhit mbeten konfidenciale. Ndërkohë që nëse masat e sigurimit merren nga gjykatat shtetërore konfidencialiteti nuk mund të sigurohet gjithmonë, sepse proceset gjyqësore janë publike. Ndaj masat e sigurimit të marra nga autoritet gjyqësore zakonisht nuk do të jenë konfidenciale.<sup>327</sup>
- Llojet dhe format e masave të sigurimit që mund të japin arbitrat zakonisht janë më fleksibël dhe të përshtatura sipas specifikave të çështjes, për rrjedhojë arbitrat, ndryshe nga autoritet gjyqësore mund të japin masa sigurimi më të përshtatshme duke marrë në konsideratë aspekte të ndryshme të një çështjeje.<sup>328</sup>
- Masat e sigurimit të dhëna nga arbitrat kanë një kosto më të ulët se masat e dhëna nga autoritetet gjyqësore. Një shkak për këtë është mungesa e ankimit kundër vendimit të arbitrave mbi masën e sigurimit, megjithëse për shkak të ndryshimit të rrethanave, sikurse do të trajtohet më poshtë, ato mund të rishikohen.<sup>329</sup>

<sup>323</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", (2005), fq. 50

<sup>324</sup> Idem, fq. 52

<sup>325</sup> Bosch, Introduction in: Bosch (ed.) 3

<sup>326</sup> Hausmaninger, Ch., "The ICC rules for a pre-arbitral referee procedure: A step towards solving the problem of provisional relief in international arbitration?", 7(1) ICSII Rev. FILJ, 1992, fq. 86

<sup>327</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", (2005), fq. 53

<sup>328</sup> Idem

<sup>329</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", (2005), fq. 53



Aktualisht, shumica e legjislacioneve moderne parashikojnë shprehimisht kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi. Shembulli më tipik drejt kësaj tendence është Ligji Model i UNCITRAL, neni 17 i të cilit si në versionin origjinal ashtu dhe pas rishikimeve të vitit 2006 parashikon se përveç kur palët parashikojnë ndryshe, arbitrat kanë kompetencë për të dhënë masa sigurimi. Sikurse shumë autorë kanë komentuar, sipas këtij neni nuk kërkohet ndonjë marrëveshje e palëve për t'i dhënë arbitrave kompetencën për të urdhëruar masa sigurimi, por e kundërta, duhet një marrëveshje e palëve për t'ia hequr arbitrave një kompetencë të tillë. Në mungesë të një ndalimi të tillë me marrëveshje të palëve, gjykata e arbitrazhit ka kompetencë për të dhënë masa sigurimi.<sup>330</sup> Të njëjtin parashikim e gjejmë jo vetëm në ligjet kombëtare që janë bazuar në Ligjin Model si ligji gjerman, austriak, kanadez, australian,<sup>331</sup> por edhe në ligje të tjera që nuk janë bazuar në Ligjin Model, të tillë si ligji suedez, zviceran, francez, holandez etj.<sup>332</sup>

Megjithatë pavarësisht se kompetenca e arbitrave për marrjen e masave të sigurimit është njohur gjerësisht nga legjislacionet kombëtare, mes tyre ka diferenca lidhur me mënyrën e ushtrimit të një kompetence të tillë. Kështu, mund të ndeshen tre qëndrime të ndryshme.<sup>333</sup>

Së pari, janë ato ligje arbitrazhi ku ligji shprehimisht ua jep të drejtën arbitrave që të vendosin masa sigurimi, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe. Këtë përfaqëse e ndeshim në Ligjin Model të UNCITRAL, të gjitha ato ligje që janë bërë në bazë të tij, por edhe në disa ligje që nuk janë në bazë të Ligjit Model.<sup>334</sup> Në këtë grup hyn dhe Shqipëria, ku Kodi i Procedurës Civile, i cili përmban dispozita mbi arbitrazhin e brendshëm, parashikon në nenin 418 se Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njëjës prej palëve mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve. I njëjti parashikim ndeshet edhe në projektligjin “Për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë”, i cili është hartuar në bazë të Ligjit Model të UNCITRAL.

Së dyti, janë ato ligje arbitrazhi, të cilat u japin arbitrave të drejtën të japin disa lloj masash sigurimi, ndërsa për disa lloje të tjera masash kërkon marrëveshje të shprehur mes palëve. Një ligj i tillë është ligji anglez i arbitrazhit, i cili i jep gjykatës së arbitrazhit të drejtën për të dhënë disa masa sigurimi,<sup>335</sup> ndërsa për disa masa të

---

<sup>330</sup> Baker & Davis, “Arbitral proceedings under the UNCITRAL Rules: The experience of the Iran-United States Claims Tribunal”, 23 Geo. Wash. J Int’l. Econ. , 1989, fq. 267, 335, 336; H. Holtzman & J. Neuhaus, “A guide to the UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration: Legislative history and commentary”, 1989, fq. 530; Huntley, The scope of article 17: Interim measures under the UNCITRAL Model Law, 740 PLI/Lit.1181, 2005, fq. 72.

<sup>331</sup> Neni 1141 (1) i KPrC gjerman, neni 593 (1) i KPrC austriak, Akti i arbitrazhit tregtar kanadez 2013, neni 17; Ligji Australian për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, 2011, neni 17.

<sup>332</sup> Neni 25 (4) i Ligjit suedez mbi arbitrazhin (Përveç kur palët parashikojnë ndryshe, arbitrat mund të marrin masa për sigurimin e padisë që do të gjykohen nga arbitrat); neni 183 (1) i Ligjit Zviceran për të Drejtën Ndërkombëtare Private. (përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, gjykata e arbitrazhit mund të marrë masa sigurimi me kërkesë të palës); Neni 1468 i Kodit të Procedurës Civile franceze (gjykata e arbitrazhit mund të urdhërojë kundrejt palëve çdo masë të përkohshme apo sigurimi që i konsideron të përshtatshme...); neni 1043b i Kodit Holandez të Procedurës Civile (gjatë gjykimit të padisë së themelit, gjykata e arbitrazhit mund të marrë masa të përkohshme...)

<sup>333</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 589, para. 23-15\_23-22.

<sup>334</sup> Përmendim këtu për shembull ligjin zviceran Për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

<sup>335</sup> Seksioni 38 parashikon që: “(4) Gjykata e arbitrazhit mund të japë udhëzime në lidhje me çdo pasuri që është objekt gjykimi në arbitrazh apo në lidhje me të cilën mund të lidhet një çështje në arbitrazh dhe e cila është në pronësi apo në posedim të palëve në arbitrazh për (a) inspektimin, fotografimin, ruajtjen, kujdestarinë ose mbajtjen e pasurisë nga gjykata e arbitrazhit, eksperti ose pala; ose (b) të

tjera, si p.sh. masat për sigurimin e kostove, për kryerje pagesash apo për disponim të pasurisë kërkohet marrëveshje e shprehur e palëve, në të kundërt gjykata e arbitrazhit nuk e ka këtë të drejtë.

Së treti, janë ato ligje që nuk parashikojnë shprehimisht mundësinë e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi. Një ligj i tillë është ai i Shteteve të Bashkuara dhe dikur edhe ligji francez dhe belg, por që pas ndryshimeve kanë ndjekur përjasjen e parë. Kështu, Akti Federal i Arbitrazhit i SHBA nuk i jep gjykatës së arbitrazhit të drejtë të vendosë masa sigurimi në mënyrë të shprehur, megjithatë gjykatat amerikane kanë njohur gjerësisht kompetencën e arbitrave për të marrë masa sigurimi, në mungesë të marrëveshjes së kundërt të palëve.<sup>336</sup> Gjykatat amerikane, por edhe shumica e doktrinës<sup>337</sup> mbajnë qëndrimin se në mungesë të një parashikimi të kundërt në marrëveshjen e arbitrazhit, do të nënkuptohet e palët kanë rënë dakord që gjykata e arbitrazhit të marrë masa sigurimi.<sup>338</sup> Kështu, nën çështjen *Charles Constr. Co. v. Derderian*<sup>339</sup> gjykata u shpreh se:

“Në përgjithësi, ...në mungesë të një përcaktimi të kundërt në marrëveshjen e palëve apo në ligj, arbitri ka kompetencë të urdhërojë një palë të japë garanci ndërkohë që procesi i arbitrazhit është duke u zhvilluar. Është e arsyeshme të prezumohet se palët duke rënë dakord për arbitrazhin, në mënyrë të nënkuptuar kanë pasur për qëllim që arbitrazhi të jetë efektiv dhe se urdhrat për ruajtjen e *status quo* apo për të bërë efektiv vendimin përfundimtar do të ishin të përshtatshëm. Në rrethana të tilla, kompetenca e arbitrave për të vepruar do të nënkuptohet nga vetë ekzistenca e marrëveshjes së arbitrazhit.”

Ndërkohë edhe ligji francez, njësoj si ai amerikan, nuk parashikonte shprehimisht për kompetencën e arbitrave për të marrë masa sigurimi deri në vitin 2011, kurse aktualisht neni 1468 parashikon se gjykata e arbitrazhit mund të marrë masa sigurimi që ajo i konsideron të përshtatshme, të vendosë kushtet për këto masa dhe nëse është e nevojshme dhe penalitete për moszbatimin e tyre. Megjithatë shumica e praktikës dhe doktrinës franceze edhe para ndryshimeve të 2011 të kodit të procedurës civile, kanë mbajtur qëndrimin se arbitrat në proceset e arbitrazhit ndërkombëtar në Francë kishin kompetencë për të marrë masa sigurimi.<sup>340</sup> Ndërkohë që ka pasur edhe qëndrime të

---

urdhërojë që të mund të merren mostra, ose të bëhen këqyrje apo të eksperimentohet në këtë pasuri... (6) Gjykata e arbitrazhit mund të japë dreksione palës që të ruajë në kujdestari ose kontroll për qëllim të procedurës çdo provë.”

<sup>336</sup> *Toyo Tire Holdings of Ams. Inc. kundër Cont'l Tire N. Am. Inc.*, 609 F.3d, fq. 975 (3<sup>rd</sup> Cir. 1972); *Arrowhead Global Solutions, Inc. kundër Datapath, Inc.*, 166 F.Appx, fq. 39, 44, (4<sup>th</sup> Cir. 2006); *Banko de Seguros del Estado kundër Mut. Marine Office, Inc.*, 344 F. 3d 255 (2<sup>nd</sup> Cir. 2003); *Island Greek Coal Sales Co. kundër City of Gainseville*, 729 F. 2d, 1046, 1049 (6<sup>th</sup> Cir. 1984); *Sperry Int'l Trade, Inc. kundër Gov't of Israel*, 689 F 2d, 301, 306 (2<sup>nd</sup> Cir. 1982). Për më shumë shiko G. Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2436-2438.

<sup>337</sup> Shiko Higgins, “Interim measures in transnational maritime arbitration”, 65 *Tulane L. Rev.* 1991, fq. 1519, 1535-1536 (Duke rënë dakord shprehimisht për zgjidhjen me arbitrazh të mosmarrëveshjes së tyre, palët në mënyrë të nënkuptuar bien dakord tu japin arbitrave kompetencën për të ushtruar çdo autoritet të nevojshëm për gjetjen e një zgjidhjeje për themelin e mosmarrëveshjes.); Hoellering, *The practices and experience of the American Arbitration Association*, botuar në ICC, *Conservatory and provisional measures in international arbitration 1993*, fq. 31 (Kompetenca e arbitrave për të dhënë masa sigurimi buron nga kompetencat e tyre për të zhvilluar procesin e arbitrazhit dhe më saktësisht, nga çdo kompetencë e dhënë atyre në marrëveshjen mes palëve.)

<sup>338</sup> *Idem*

<sup>339</sup> *Charles Constr. Co. v. Derderian*, 586 N.E.2d 992 (Mass. 1992)

<sup>340</sup> *Vendim i Gjykatës së Apelit Paris në çështjen Societe Otor Participations kundër Carlyle Holdings*, datë 7 tetor 2004, *Rev. Arb. Fq. 737*; Fouchard, Gaillard, Goldman on “International Commercial

kundërta, përmendim këtu Poudret dhe Besson,<sup>341</sup> sipas të cilëve kompetenca për të dhënë masa sigurimi nuk është çështje “procedure”, por “juridiksioni” dhe si e tillë ajo nuk mund të prezumohet në mungesë të një përcaktimi specifik në *lex arbitrin* e vendit të arbitrazhit.

Aktualisht në Shqipëri nuk është miratuar ende një ligj që rregullon arbitrazhin ndërkombëtar. Në këto kushte lind pyetja: a mundet një gjykatë arbitrazhi në një proces arbitrazhi ndërkombëtar me vend arbitrazhi Shqipërinë të marrë masa për sigurimin e padisë? Pavarësisht se mungon një ligj i mirëfilltë për arbitrazhin ndërkombëtar, dhe Konventat ndërkombëtare të cilat ka ratifikuar Shqipëria nuk parashikojnë shprehimisht të drejtën e arbitrave për të marrë masa sigurimi në arbitrazhin ndërkombëtar, njësoj si Shtetet e Bashkuara, Franca, Belgjika edhe praktika e arbitrazhit shqiptar duhet ta njohë të drejtën e arbitrave për të marrë masa të tilla, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe me marrëveshje. Gëzimi i kësaj të drejte duhet të konsiderohet në përmbushje të misionit që kanë arbitrat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve në një mënyrë të drejtë, të arsyeshme dhe të përshtatshme.

Kompetenca e arbitrave për të dhënë masa sigurimi përveçse përcaktohet nga ligji, varet gjithashtu edhe nga përcaktimet e palëve në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit. Palët mund të autorizojnë shprehimisht gjykatën e arbitrazhit të marrë masa sigurimi, ose mund ta bëjnë këtë në mënyrë të nënkuptuar duke zgjedhur rregulla arbitrazhi, të cilat e lejojnë gjykatën e arbitrazhit të marrë masa sigurimi. Dhe në fakt shumica Rregulloreve të Arbitrazhit të Institucioneve më të rëndësishme të arbitrazhit përbajnë rregulla për dhënien e masave të sigurimit të padisë.<sup>342</sup> Pjesa më e madhe e tyre parashikojnë shprehimisht kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi.<sup>343</sup>

Konkretisht nëse shohim Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL, do të vëmë re se në to parashikohet shprehimisht e drejta e gjykatës së arbitrazhit, që me kërkesë të secilës nga palët, të vendosë masa sigurimi.<sup>344</sup> Nëse palët ia referojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes tyre Rregullores së UNCITRAL, ato iu kanë dhënë arbitrave të drejtën për të vendosur masa sigurimi dhe nuk kërkohet një përcaktim i shprehur në marrëveshjen e arbitrazhit për një kompetencë të tillë të gjykatës së arbitrazhit. Nëse palët duan t’ia heqin këtë të drejtë gjykatës së arbitrazhit, atëherë ato duhen të shprehen për këtë në momentin e hartimit të marrëveshjes së arbitrazhit.<sup>345</sup> Sikurse Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL edhe ato të ICC parashikojnë shprehimisht të drejtën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi që ajo i konsideron të përshtatshme, në mungesë të marrëveshjes së kundërt të palëve.<sup>346</sup> Rregullorja e arbitrazhit të Gjykatës Londineze të Arbitrazhit Ndërkombëtar (LCIA),<sup>347</sup> gjithashtu

---

Arbitration”, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, Kluwer Law International, 1999, fq. 716-717.

<sup>341</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 552.

<sup>342</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, « Comparative International Commercial Arbitration », 2003, fq. 591

<sup>343</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2440

<sup>344</sup> Neni 26 (1) i Rregullores së Arbitrazhit të UNCITRAL

<sup>345</sup> “Institutional Arbitration Article by Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules” edituar nga Schutze (2013), para. 486, fq. 1154.

<sup>346</sup> Neni 28 i Rregullave të Arbitrazhit të International Chamber of Commerce (ICC) të vitit 2012

<sup>347</sup> Neni 25 i Rregullave të Arbitrazhit të London Court of International Arbitration (LCIA)

parashikon shprehimisht jo vetëm të drejtën e gjykatës së arbitrazhit për të vendosur masa sigurimi, por në mënyrë të detajuar edhe llojin e këtyre masave që mund të marrë gjykata e arbitrazhit. Në të njëjtën linjë janë dhe Rregulloret e Arbitrazhit të pothuajse shumicës së institucioneve të arbitrazhit kudo nëpër botë, megjithëse kjo ka ndodhur vetëm në vitet e fundit, sepse kohë më parë ka pasur Rregullore Arbitrazhi të cilat e kufizonin kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi, ose nuk kishin asnjë përcaktim lidhur me të. Kështu përmendim për shembull Rregullat e Arbitrazhit të CIETAC,<sup>348</sup> të cilat para ndryshimeve të vitit 2012 parashikonin se vetëm gjykatat shtetërore mund të marrin masa për sigurimin e padisë.<sup>349</sup> Kurse aktualisht, versioni i vitit 2012 të këtyre rregullave e njeh kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi që ajo i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme.<sup>350</sup> Po kështu ka ndodhur edhe me Rregullat e Arbitrazhit të ICDR, Zvicerane, JCAA, SIAC, të Dhomës së Arbitrazhit të Milanit<sup>351</sup> etj.

## **2. Përcaktimi i ligjit që i jep gjykatës së arbitrazhit kompetencën për të marrë masa sigurimi**

Sikurse u shprehëm më sipër kompetenca e gjykatës së arbitrazhit përcaktohet nga ligji dhe vullneti i palëve. Është e rëndësishme të diskutohet në këtë pikë dhe raporti që ka parashikimi ligjor me vullnetin e palëve lidhur me këtë çështje. Pyetja e parë që natyrshëm mund të lindë është në bazë të cilit ligj përcaktohet nëse gjykata e arbitrazhit ka apo jo kompetencë për të marrë masa për sigurimin e padisë. Përpara se t'i jepet përgjigje një pyetje të tillë duhet të kemi parasysh se ligji që përcakton kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi është i ndryshëm nga ligji që përcakton standardet në bazë të të cilave mund të merren këto masa,<sup>352</sup> megjithëse shumë autorë nuk e bëjnë një dallim të tillë. Kompetenca për të marrë masa sigurimi zakonisht klasifikohet si çështje procedure<sup>353</sup> dhe për rrjedhojë rregullohet kryesisht nga ligji që rregullon procesin e arbitrazhit, që zakonisht është ligji i vendit të arbitrazhit.<sup>354</sup> Një qëndrim i tillë ka gjetur mbështetje jo vetëm nga

---

<sup>348</sup> China International Economic and Trade Arbitration Commission

<sup>349</sup> Shiko nenin 17 dhe 18 të Rregullave të Arbitrazhit të CIETAC të vitit 2005.

<sup>350</sup> Shiko nenin 21 të Rregullave të Arbitrazhit të CIETAC të vitit 2012.

<sup>351</sup> Neni 21 i Rregullave të International Centre for Dispute Resolution (ICDR); neni 26 i Rregullave të Swiss Chambers' Arbitration Institution të vitit 2012, Neni 66 (1) i Rregullave të Japan Commercial Arbitration Association (JCAA) të vitit 2014; Neni 26 i Rregullave të Singapore International Arbitration Centre (SIAC) të vitit 2013; Neni 22 (2) i Rregullave të Arbitration Chamber of Milan të vitit 2010.

<sup>352</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, para. 17.02. [F], 17.02. [G][2].

<sup>353</sup> Për një qëndrim të kundërt, shiko Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 521-522 para. 606, sipas të cilëve juridiksioni i arbitrave për të dhënë masa sigurimi duhet të dallohet nga kompetenca e tyre për të vendosur për çështje procedurale...kompetenca për të dhënë masa sigurimi nuk është çështje "procedure", por juridiksioni.

<sup>354</sup> Idem, fq. 2458; Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", 2003, fq. 588. para. 23-9; Schwartz, "The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration", 1993, fq. 45, 58 (masat e përkohshme apo sigurimi zakonisht konsiderohen si çështje të rregulluara nga ligji i procedurës). Thuhet se ligji që rregullon procesin e arbitrazhit është zakonisht ai i vendit të arbitrazhit, sepse mund të ketë raste (ndonëse të rralla) që palët parashikojnë se ligji që rregullon procedurën e arbitrazhit do të jetë një ligj i ndryshëm nga ai i vendit të arbitrazhit.

praktika e gjykatave të arbitrazhit<sup>355</sup> dhe e gjykatave shtetërore,<sup>356</sup> por edhe nga doktrina e arbitrazhit ndërkombëtar.<sup>357</sup> Ndërkohë që në dallim nga kjo, për përcaktimin e standardeve në bazë të të cilave duhet të jepen masat e sigurimit të padisë ekzistojnë praktikisht tre mundësi: i) ligji i vendit të arbitrazhit; ii) ligji që rregullon kontratën kryesore; iii) standardet ndërkombëtare. Kjo çështje do të trajtohet më gjerësisht më poshtë.

Por si duhet të veprojnë gjykata e arbitrazhit në rast se ligji i vendit të arbitrazhit, pra *lex arbitri*, e ndalon gjykatën e arbitrazhit të marrë masa sigurimi, ndërkohë që palët në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit ia kanë njohur asaj një kompetencë të tillë?

Në një situatë të tillë konsiderohet se gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masa sigurimi, pavarësisht se palët mund t'ia kenë njohur shprehimisht këtë të drejtë gjykatës së arbitrazhit.<sup>358</sup> Megjithatë ka autorë që argumentojnë të kundërtën. Kështu, Born,<sup>359</sup> argumenton se kur palët ia kanë njohur shprehimisht gjykatës së arbitrazhit kompetencën për të marrë masa sigurimi, ligji i vendit të arbitrazhit që ia ndalon asaj një kompetencë të tillë duhet të konsiderohet se bie në kundërshtim me nenin 2 të Konventës së New York-ut,<sup>360</sup> i cili duhet të interpretohet se në mënyrë të nënkuptuar i kërkon Shteteve Kontraktuese të njohin marrëveshjet e arbitrazhit që i japin arbitrave kompetencën për të marrë masa sigurimi.<sup>361</sup> Si e tillë, Konventa duhet të prevalojë dhe gjykatat e arbitrazhit mund të vendosin vetë për kompetencën e tyre nëse palët janë shprehur qartazi për tu dhënë atyre të drejtën për të vendosur masa për sigurimin e padisë. Ky qëndrim bazohet dhe në argumentin se marrëveshja e palëve lidhur me kompetencën për marrjen e masave të sigurimit nuk shfuqizohet nga marrëveshja e

---

<sup>355</sup> ICC Case no. 7895, ICC Bulletin 64 (2000) 65; ICC Case no. 8113, ICC Bulletin 65 (2000) 67; ICC Case no. 8786, ICC Bulletin 81 (2000) 82.

<sup>356</sup> Pac. Reins. Mtg Corp. kundër Ohio Reins. Corp., 935, F.2d 1019,1022-23 (9<sup>th</sup> Cir. 1991); Island Creek Coal Sales Co. kundër City of Gainesville, 729 F.2d, 1046, 1049 (6<sup>th</sup> Cir. 1984); Konkar Maritime Enter., SA kundër Compagnie Belge d’Affretement, 668 F. Supp. 267, 271 (S.D.N.Y 1987)

<sup>357</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, para. 17.02. [F]; Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 588. para. 23-9; Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 45, 58; S. Besson, “Arbitrage International et mesures provisoires”, 1998, fq. 92; Boog, “The laws governing interim measures in international arbitration”, në F. Ferrari & S. Kroll (eds). Conflict of laws in international arbitration, 2010, fq. 409, 419, sipas të cilit “Kur marrëveshja e arbitrazhit nuk shprehet lidhur me çështjen e masave të sigurimit dhe palët nuk kanë lidhur ndonjë marrëveshje tjetër lidhur me këtë çështje, gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar kur kërkojnë të përcaktojnë nëse kanë kompetencë për të marrë masa sigurimi dhe deri në çfarë mase do t’i drejtohen natyrshëm ligjit që rregullon procesin e arbitrazhit, d.m.th. *lex arbitri*.”

<sup>358</sup> Interim award in ICC Case no. 8879,11(1) ICC Ct. Bull 84 (2000); Partial award in ICC Case no. 8113, 11 (1), ICC Ct. Bull 65 (2000); Shiko gjithashtu G. Petrochilos, “Procedural law in international arbitration”, 2004, fq. 209.

<sup>359</sup> Gary B. Born “International Commercial Arbitration” 2009, Volume II, faqe 1948, para. 1 dhe 2.

<sup>360</sup> Neni II i Konventës së New York-ut: “1. Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t’ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jokontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi. 2. Termi “marrëveshje e shkruar” do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh. 3. Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jooperative ose e pamundur për t’u zbatuar”.

<sup>361</sup> Për të njëjtin qëndrim shiko gjithashtu Boog, “The laws governing interim measures in international arbitration”, në F. Ferrari & S. Kroll (eds). Conflict of laws in international arbitration, 2010, fq. 409, 414.

tyre për përcaktimin e vendit të arbitrazhit, në të cilin kjo kompetencë ndalohet.<sup>362</sup> Po kështu edhe Bernardini,<sup>363</sup> duke iu referuar ligjit italian, i cili i njeh të drejtën për të marrë masa sigurimi vetëm gjykatave shtetërore, shprehet se pavarësisht kësaj, arbitrat mund të marrin masa sigurimi lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi me qëllim shmangien e një dëmi të pariparueshëm. Por një qëndrim i tillë duket se nuk mbështetet aspak nga Poudret dhe Besson,<sup>364</sup> sipas të cilëve neni 818 i Kodit të Procedurës Civile Italian është i detyrueshëm, ndaj gjykatat e arbitrazhit nuk do të kishin kompetencë për të marrë masa sigurimi në një rast të tillë. Dhe në fakt, edhe autorët që janë pro kompetencës së gjykatës së arbitrazhit në një situatë të tillë shprehen se kjo praktikë është shumë e rrallë, sepse palët nuk rrezikojnë vijueshmërinë e procesit me devijime të guximshme në interpretimin e ligjit.<sup>365</sup>

Shumë më e qartë do të ishte situata kur palët kanë rënë dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh në një juridiksion që ia ndalon arbitrave kompetencën për të marrë masa sigurimi dhe nuk ia kanë njohur shprehimisht arbitrave një kompetencë të tillë në marrëveshjen e tyre. Në këtë rast gjykata e arbitrazhit nuk do të ketë kompetencë për të marrë masa sigurimi, sepse kjo zgjedhje e vendit të arbitrazhit zakonisht interpretohet si përjashtim i kësaj kompetence.<sup>366</sup>

Ndërkohë që kur ligji i arbitrazhit dhe Rregullat e Institucionit të arbitrazhit as nuk ia njohin shprehimisht të drejtën gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi dhe as nuk ia ndalojnë asaj një kompetencë të tillë, do të prezumohet se gjykata e arbitrazhit është kompetente për të marrë masa sigurimi.<sup>367</sup> Arsyeja është se palët me marrëveshjen e arbitrazhit i japin gjykatës së arbitrazhit kompetencat e nevojshme për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre, të cilat përfshijnë gjithashtu dhe kompetencën për të dhënë çdo masë sigurimi që është e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e palëve dhe eficientë e vendimmarrjes së arbitrave.<sup>368</sup>

Pra, nga sa më sipër, pothuajse të gjitha regjimet e arbitrazhit lejojnë gjykatën e arbitrazhit të marrë masa sigurimi, përveç kur palët parashikojnë ndryshe me marrëveshje mes tyre. Ç'ka do të thotë se në përputhje me parimin e autonomisë së vullnetit të palëve, palët kanë të drejtë të parashikojnë në marrëveshjen e tyre se gjykata e arbitrazhit nuk do të ketë kompetencë të vendosë për masa sigurimi, ose do të ketë një kompetencë të kufizuar. E vetmja marrëveshje që do të konsiderohej e mjaftueshme për të përjashtuar kompetencën e arbitrave për të dhënë masa sigurimi do të ishte një klauzolë e shkruar që mohon shprehimisht një kompetencë të tillë, ose sikurse u tha më sipër edhe një marrëveshje arbitrazhi *ad hoc* në një vend arbitrazhi që ndalon dhënien e masave të sigurimit nga gjykata e arbitrazhit. Nuk do të konsiderohej si përjashtim i kompetencës së gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi as rasti kur marrëveshja e arbitrazhit referon në zbatimin e rregullave të

<sup>362</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2460

<sup>363</sup> Bernardini, Piero, Italy, in "ICCA International Handbook of Commercial Arbitration", Ch. IV.5

<sup>364</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 522

<sup>365</sup> Gary B. Born "International Commercial arbitration" 2009, Volume II, fq. 1964, para. 2.

<sup>366</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2460

<sup>367</sup> Julian DM Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll "Comparative International Commercial Arbitration", 2003, para. 23-30; Donald Francis Donovan "Powers of the arbitrators to issue procedural orders, including interim measures of protection, and the obligation of parties to abide by such orders", ICC Bulletin Vol. 10/Nr. 1 Pranverë 1999, fq. 60; Yesilirmak "Interim and conservatory measures in ICC Arbitral Practice", 11(1) ICC Bulletin 31 (2000), fq. 32.

<sup>368</sup> Berger, International Economic Arbitration, fq. 331; Mendez, "Arbitrage international et mesures conservatoires", Rev. Arb. 51, 1985, fq. 56.

arbitrazhit që nuk ia njohin shprehimisht gjykatës së arbitrazhit një kompetencë të tillë dhe as rasti kur palët me marrëveshjen e arbitrazhit kanë parashikuar se një gjykatë e caktuar shtetërore do të ketë kompetencë për të marrë masa sigurimi.<sup>369</sup>

Arsyeja që shpjegon këtë të fundit është se tashmë është i njohur gjerësisht parimi se arbitrat nuk kanë juridiksion ekskluziv për marrjen e masave të sigurimit, por me disa përjashtime, kjo kompetencë e tyre është konkurruese me atë të gjykatave shtetërore.<sup>370</sup> Kompetenca e gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi do të trajtohet më gjerësisht në vijim të këtij punimi.<sup>371</sup>

### 3. Kufizime të kompetencës së arbitrave për të dhënë masa sigurimi

Pavarësisht se kompetenca e arbitrave për të dhënë masa sigurimi është njohur gjerësisht, ekzistojnë disa kufizime, të cilat lindin jo vetëm nga natyra kontraktuale e procesit të arbitrazhit, por edhe nga dispozitat e disa legjislacioneve kombëtare të arbitrazhit.

*Së pari*, gjykata e arbitrazhit nuk ka kompetencë të marrë masa sigurimi kundër palëve të treta, që nuk janë palë në procesin e arbitrazhit.<sup>372</sup> Si rregull gjykata e arbitrazhit mund të marrë masa sigurimi vetëm ndaj palëve të procesit të arbitrazhit dhe nuk mund të vendosë për shembull sekuestrimin e një sendi që mbahet nga një palë e tretë.<sup>373</sup> Një kufizim i tillë, nuk del vetëm nga natyra e arbitrazhit, por një numër i konsiderueshëm legjislacionesh e parashikojnë shprehimisht. Përmendim këtu Ligjin Model të UNCITRAL<sup>374</sup>, sipas cilit: “Masë sigurimi është çdo masë e përkohshme, .....nëpërmjet të cilës,..... gjykata e arbitrazhit urdhëron palën që.....” Kjo është parashikuar shprehimisht edhe në kodin gjyqësor belg,<sup>375</sup> i cili parashikon se: “...gjykata e arbitrazhit mund të urdhërojë masa masa sigurimi që ajo i konsideron të nevojshme. Megjithatë, gjykata e arbitrazhit nuk mund të japë urdhra sekuestrore.”

Edhe kur nuk ka ndonjë kufizim të shprehur ligjor lidhur me kompetencën për të dhënë masa sigurimi kundër palëve të treta, kjo nënkuptohet nga karakteri kontraktual i procesit të arbitrazhit. Kështu, sipas ligjit anglez, palët nuk kanë ndonjë ndalim ligjor të shprehur që të mund të marrin masa sigurimi ndaj të tretëve, por duke qenë se

---

<sup>369</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2456

<sup>370</sup> Idem, 17.02 [E]; Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 710, para. 1350; Boog, “The laws governing interim measures in international arbitration”, në F. Ferrari & S. Kroll (eds). Conflict of laws in international arbitration, 2010, fq. 409, 445.

<sup>371</sup> Shiko Kreun IV

<sup>372</sup> Huntley, “The scope of Article 17: Interim measures under UNICTRAL Model Law”, 740 PLI/Lit. 1181, 86 (2005); Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 45, 59; Sebastien Besson, “Arbitrage international et mesures provisoires-Etude de droit compare”, 1998, fq. 68; Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2445; D. Caron & L. Caplan, “The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary” 517 (2<sup>nd</sup> ed. 2013).

<sup>373</sup> ICC award no. 7828 cituar në Lew, “Commentary on interim and conservatory measures in ICC Arbitration Cases”, 11(1), ICC Bulletin 23 (2000), fq. 25

<sup>374</sup> Neni 17 i Ligjit Model të UNCITRAL; Shiko gjithashtu nenin 593 (1) të KPrC austriak; nenin 25 (4) të Aktit suedez të Arbitrazhit

<sup>375</sup> Neni 1691 i Kodit gjyqësor belg

gjykata e arbitrazhit nuk ka juridiksion mbi palët e treta, këto vendime mbeten jo efektive.<sup>376</sup>

*Së dyti*, gjykatës së arbitrazhit i mungon forca për të ekzekutuar drejtpërdrejt masat e sigurimit të dhëna prej saj.<sup>377</sup> Ajo nuk mund të vendosë penalitete në rast të mosekzekutimit të masave të sigurimit të dhëna prej saj.<sup>378</sup> Ekzekutimi i masave të sigurimit bëhet nga gjykatat shtetërore në bazë të kërkesës së palës së interesuar apo të vetë gjykatës së arbitrazhit në varësi të *lex arbitrit*. Kështu Ligji zviceran për të drejtën ndërkombëtare private,<sup>379</sup> parashikon se nëse pala kundër të cilës është marrë masa e sigurimit nuk e përmbush atë vullnetarisht, gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë ndihmën e gjykatës kompetente shtetërore. Megjithatë ka dhe disa pikëpamje se gjykata e arbitrazhit mund të vendosë penalitete financiare të një natyre kontraktuale me qëllim detyrimin e një pale për të zbatuar masën e sigurimit të marrë kundër saj.<sup>380</sup> Ashtu sikurse ka disa pikëpamje të tjera që gjykata e arbitrazhit mundet që të sigurojë indirekt ekzekutimin e vendimit të saj për masa sigurimi nëpërmjet nxjerrjes së konkluzioneve të kundërta kundër palës që nuk ekzekuton masën. Kështu, Lew<sup>381</sup> është shprehur se: “Fakti që gjykata e arbitrazhit mund të nxjerrë konkluzione të kundërta nga moszbatimi i masës së sigurimit nxit ekzekutimin vullnetar të saj.” Kurse Schwartz<sup>382</sup> shprehet se: “Së fundmi, sigurisht që burimi më i madh i forcës shtrënguese të arbitrave mbështetet në pozicionin e tyre si arbitra që do të gjykojnë themelin e mosmarrëveshjes. Palët që duan që të shfaqen para arbitrave si qytetarë të mirë që janë paditur padrejtësisht nga kundërshtari i tyre zakonisht nuk do të kundërshtonin masat e dhëna nga ata, të cilët duan të bindin për qëndrueshmërinë e pretendimeve të tyre. Edhe autorë të tjerë janë të mendimit se gjykata e arbitrazhit mund të nxjerrë konkluzione të kundërta kundër palës që nuk bashkëpunon.<sup>383</sup> Megjithatë të tjerë e konsiderojnë një qëndrim të tillë të gabuar, duke u shprehur se nxjerrja e konkluzioneve të kundërta duhet të kufizohet vetëm në lidhje me provat. Nëse një palë nuk i bindet urdhrave të gjykatës së arbitrazhit, ajo nuk mund ta vlerësojë atë negativisht kur gjykon themelin e padisë.<sup>384</sup> Detyrimi i gjykatës për të

---

<sup>376</sup> “Practitioner’s Handbook on International Commercial Arbitration”, Edicioni II, Edituar nga Frank-Vernd Weigand 2009, para. 5.164.

<sup>377</sup> Julian DM Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, 23-31, 23-32; Sebastian Besson, “Arbitrage international et mesures provisoire, Etude de droit compare”, fq. 57-67, para. 64-80; Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2446-2448; Bhasin, “The grant of interim relief under the Indian Arbitration Act of 1996”, A. van den Berg ed., “International Arbitration and National Courts: The never ending story”, ICCA Congress Series no. 10, 2000, fq. 93, 96.

<sup>378</sup> Esko, “The Arbitral Proceedings, M. Savola ed., Law and Practice of Arbitration in Finland”, 2004, fq. 43-44.

<sup>379</sup> Neni 183(2) i Ligjit zviceran për të drejtën ndërkombëtare private

<sup>380</sup> Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration,” 1993, fq. 49, 59.

<sup>381</sup> Lew, “Commentary on interim and conservatory measures in ICC arbitration cases”, 11(1) ICC Ct. Bull. 2000, fq. 23, 24.

<sup>382</sup> Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 45, 59.

<sup>383</sup> G. Walter, W. Bosch, J. Bronnimann, “Internationale Schiedsgerichtsbarkeit in der Schweiz”, Berne, 1991, fq. 129; W.L. Park, J. Paulsson, “International Chamber of Commerce Arbitration”, New York, London, Rome, 1990, fq. 416, para. 26.05.

<sup>384</sup> F. Knoepfler, “Les mesures provisoires de l’arbitrage international”, Schiedsgerichtsbarkeit, Zurich, 1997, fq. 324



vepruar me drejtësi kundrejt palëve shtrihet edhe ndaj palëve që janë “të vështira”.<sup>385</sup> Pra, gjykata në çdo rast duhet të vendosë në mënyrë të paanshme për zgjidhjen e themelit të mosmarrëveshjes bazuar në të drejtën e aplikueshme dhe provat e paraqitura.

Së treti, ndonjëherë *lex arbitri* kufizon kompetencën e gjykatës për të dhënë masa sigurimi vetëm lidhur me objektin e mosmarrëveshjes. Kështu Ligji Model i UNCITRAL, përpara ndryshimeve të vitit 2006 parashikonte mundësinë e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë “masa sigurimi që kanë lidhje me çështjen në gjykim”.<sup>386</sup> Kjo dispozitë është interpretuar se kufizon të drejtën e gjykatës së arbitrazhit në dhënien e vetëm atyre masave që sigurojnë *status quo* dhe ndalojnë fshehjen e aseteve.<sup>387</sup> Një interpretim i tillë është justifikuar me arsyen se interpretimi i gjerë mund të bëjë që gjykatat e arbitrazhit ta përcaktojnë termin “që lidhet me objektin e mosmarrëveshjes” sikur përfshin çdo gjë.<sup>388</sup> Por këto pikëpamje janë kritikuar duke përcaktuar se një parashikim i tillë i Ligjit Model të UNCITRAL nuk ka pse të kufizojë kompetencën e gjykatës së arbitrazhit vetëm në ato sende që janë objekt i mosmarrëveshjes. “Objekti i mosmarrëveshjes” nuk është një send specifik.<sup>389</sup> Në ndryshimet e vitit 2006 që iu bënë Ligjit Model të UNCITRAL u hoq shprehja “masa sigurimi që lidhen me çështjen në gjykim”.<sup>390</sup> Ky ndryshim i dispozitës, në kuptimin e vërtetë, ka qartësuar thelbin e dispozitës së mëparshme dhe nuk ka bërë zgjerim të të drejtave të gjykatës së arbitrazhit në lidhje me masat e sigurimit.<sup>391</sup>

Aktualisht ka ende legjislacione që kanë përcaktuar kufizime të tilla lidhur me kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi. Një nga shembujt është ligji gjerman,<sup>392</sup> sipas të cilit masa e sigurimit duhet të lidhet me objektin e mosmarrëveshjes.<sup>393</sup> Po kështu edhe ligji anglez, i cili vendos kufizime të tilla që gjykata e arbitrazhit mund të marrë masa sigurimi në lidhje me çdo pasuri që është objekt gjykimi në arbitrazh apo me çdo pasuri me të cilën mund të ketë lidhje një çështje në arbitrazh dhe e cila është në pronësi apo në posedim të palëve në arbitrazh për (a) inspektimin, fotografimin, ruajtjen, kujdestarinë ose mbajtjen e pasurisë nga gjykata e arbitrazhit, eksperti ose pala; ose (b) të urdhërojë që të mund të merren mostra, ose të bëhen këqyrje apo të eksperimentohet në këtë pasuri”<sup>394</sup>

---

<sup>385</sup> Pierre A. Karrer, “Interim measures issues by arbitral tribunals and the courts: Less theory, please”, in A. van den Berg ed. “International Arbitration and National Courts: The never ending story”, 2001, fq. 103.

<sup>386</sup> Neni 17 i Ligjit Model të UNCITRAL

<sup>387</sup> A. Redfern, M. Hunter, “Law and practice of international commercial law”, 2009, para. 7.23.

<sup>388</sup> Huntley, Huntley, “The scope of article 17: Interim measures under the UNCITRAL Model Law”, 740 PLI/Lit.1181, 2005, fq. 78.

<sup>389</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2450; D. Caron & L. Caplan, “The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary”, 517-518 (2<sup>nd</sup> ed. 2013).

<sup>390</sup> Neni 17(1) të Ligjit Model (2006): “Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, gjykata e arbitrazhit mundet, me kërkesë të palës, të vendosi masa sigurimi.”

<sup>391</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2450;

<sup>392</sup> Neni 1041 (1) i Kodit të Procedurës Civile gjerman; Practitioner’s Handbook on International Commercial Arbitration, Edicioni II, Edituar nga Frank-Vernd Weigand 2009, para. 7.138

<sup>393</sup> Shiko gjithashtu Aktin japonez të Arbitrazhit, neni 24 (1); Aktin Indian të Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit

<sup>394</sup> Neni 38 (4) i Aktit anglez të arbitrazhit

Së katërti, gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masa sigurimi derisa të formohet.<sup>395</sup> Është e kuptueshme se nëse gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende nuk ka se si të marrë masa për sigurimin e padisë. Megjithatë shpesh masat e sigurimit të padisë mund të nevojiten në mënyrë aq urgjente sa do të ishte e pamundur të pritej formimi i gjykatës së arbitrazhit. Kjo është arsyeja që pothuajse të gjitha legjislacionet dhe rregulloret e arbitrazhit e parashikojnë mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës shtetërore për marrjen e masave të sigurimit kur gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende. Ndërkohë që institucione të ndryshme arbitrazhi kanë krijuar mekanizma të tjerë për të eliminuar vështirësitë që lindin nga një kufizim i tillë, sikurse është formimi i gjykatës së arbitrazhit në një kohë të përshpejtuar, ose “Arbitri i Urgjencës”, të cilët do të trajtohen në vijim.

Së pesti, shumë legjislacione dhe rregullore arbitrazhi parashikojnë se gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masa sigurimi *ex parte*. Respektimi i parimit të kontradiktoritetit, pra i të drejtës për tu dëgjuar dhe ai i barazisë së palëve parashikohen nga shumica e ligjeve dhe rregulloreve të arbitrazhit. Dhënia e masave të sigurimit të padisë *ex parte*, do të ishte një përjashtim nga këto parime themelore, ndaj shumë legjislacione dhe rregullore arbitrazhi nuk lejojnë që gjykata e arbitrazhit të marrë masa sigurimi *ex parte*, ose mund ta lejojnë vetëm në raste shumë të kufizuara. Edhe një pjesë e doktrinës mban qëndrimin se dhënia e masave të sigurimit është përtej kompetencës së gjykatave të arbitrazhit,<sup>396</sup> apo se edhe nëse gjykata e arbitrazhit jep masa *ex parte*, ato nuk mund të kenë efektin e këtyre masave, përsa kohë që urdhrat e gjykatës së arbitrazhit nuk janë të detyrueshme.<sup>397</sup> Megjithëse Ligji Model i UNCITRAL, pas ndryshimeve të vitit 2006 lejoi shprehimisht marrjen e masave të sigurimit *ex parte* nga gjykata e arbitrazhit, në rrethana të kufizuara,<sup>398</sup> vetëm pak legjislacione e kanë adoptuar një përjasje të tillë,<sup>399</sup> kurse pjesa më e madhe nuk e lejojnë, ose të paktën nuk e parashikojnë shprehimisht.<sup>400</sup>

<sup>395</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 594, para.23-32; Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2450

<sup>396</sup> D. Caron & L.Caplan, “The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary”, 2<sup>nd</sup> ed. 2013, fq. 543; Munch, J. në T. Raucher, P. Wax dhe J.Wenzel eds. Munchener Kommentar zur Zivilprozessordnung, 3<sup>rd</sup> ed..CHBck, 2008, fq.1041, para. 25 cituar në Practitioner’s Handbook on International Commercial Arbitration, Edicioni II, Edituar nga Frank-Vernd Weigand 2009, para. 7.139.

<sup>397</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2510

<sup>398</sup> Neni 17 B dhe C i Ligjit Model të UNCITRAL, i cili parashikon për dhënien e “urdhrave paraprakë” pa u dëgjuar pala tjetër në ato raste kur arbitrat gjykojnë se njoftimi i kërkesës për marrjen e masave të sigurimit të padisë palës kundër të cilës do të jepet një masë e tillë mund të dëmtojë qëllimin e masës.

<sup>399</sup> Ligji i arbitrazhit i Hong Kongut dhe Zvicrës, shiko Gary Born, International Commercial Arbitration, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2510. Ndërkohë që në Gjermani ndonëse ligji nuk e parashikon shprehimisht, doktrina ka interpretuar se gjykata e arbitrazhit mund të marrë masa sigurimi *ex parte* pasi neni 1063 (3) i KPrC lejon kryetarin e gjykatës të ekzekutojë, pa dëgjuar më parë palën tjetër, masat e sigurimit të dhëna nga arbitrat. Por në çdo rast gjykata e arbitrazhit duhet t’i japë *ex post* mundësi palës tjetër të parashtojë argumentet e saj. Shiko: Practitioner’s Handbook on International Commercial Arbitration, Edicioni II, Edituar nga Frank-Vernd Weigand 2009, para. 7.139.

<sup>400</sup> Shiko nenin 593 (1) të KPrC Austri sipas të cilit nuk lejohet që gjykata e arbitrazhit të marrë masa *ex parte*; Shiko “Practitioner’s Handbook on International Commercial Arbitration”, Edicioni II, Edituar nga Frank-Vernd Weigand 2009, para. 5.164 ku përcaktohet se në Angli gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masa për sigurimin e padisë pa dëgjuar palën tjetër. Shiko gjithashtu nenin 39(4) të Rregullave të Arbitrazhit të ICSID, i cili parashikon se Gjykata e Arbitrazhit do të rekomandojë, modifikojë ose revokojë masa sigurimi vetëm pasi t’i ketë dhënë secilës palë mundësi për të parashtruar vërejtjet e saj.

Së gjashti, disa masa sigurimi janë në kompetencë ekskluzive të gjykatave shtetërore dhe gjykatat e arbitrazhit nuk kanë kompetencë për të dhënë masa të tilla. Një ndër masat më të diskutuara është pikërisht sekuestroja. Legjislacione të ndryshme kanë përcaktime të ndryshme në lidhje me kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të vendosur sekuestro si masë për sigurimin e padisë. Kështu nëse i referohemi ligjit belg<sup>401</sup> do të konstatojmë se arbitrave iu është ndaluar shprehimisht vendosja e sekuestros. Në Francë gjithashtu gjykatat e arbitrazhit nuk mund të vendosin sekuestro konservative.<sup>402</sup> Doktrina franceze është e mendimit se masat që synojnë lehtësimin e ekzekutimit të vendimit përfundimtar janë në juridiksionin e gjykatave shtetërore edhe nëse ato merren me qëllim sigurimi. Palët nuk mund t'ia japin arbitrave kompetencën për të vendosur sekuestro apo urdhra të tjerë që lidhen me ekzekutimin e vendimit përfundimtar, sepse gjykatat kanë monopol mbi këto lloj masash.<sup>403</sup> Kurse në Holandë, ligji nuk parashikon në mënyrë të shprehur llojin e masave të sigurimit që mund apo nuk mund të marrë gjykata e arbitrazhit. Qëndrimi prevalues në doktrinën holandeze është se gjykatat e arbitrazhit nuk mund të vendosin sekuestro konservative.<sup>404</sup> Sipas të drejtës angleze,<sup>405</sup> gjykata e arbitrazhit mund të vendosë sekuestro preventive mbi astete kur një të drejtë të tillë palët ia kanë dhënë asaj në mënyrë të shprehur. Në mungesë të një marrëveshje midis palëve për t'i dhënë arbitrave një të drejtë të tillë, arbitrat nuk kanë të drejtë të vendosin një masë sekuestro në një fazë të ndërmjetme përpara dhënies së vendimit përfundimtar.<sup>406</sup> Pra, në mungesë të një marrëveshje me shkrim në mënyrë specifike për sekuestron, gjykatat e arbitrazhit nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë. Vetë ligji nuk ia jep gjykatës së arbitrazhit një të drejtë të tillë automatikisht.<sup>407</sup>

Në çështjen *Pacific Maritime (Asia) Ltd and Holystone Overseas Ltd* gjykata angleze arsyeton: "Gjykata e zakonshme mund të veprojë vetëm në rast se gjykata e arbitrazhit ose një arbitër apo institucion arbitrazhi, të cilit palët i kanë dhënë të drejta në këtë kuadër, nuk ka të drejta apo është e pamundur të veprojë efektivisht. Në kushtet e rastit në fjalë, Gjykata e arbitrazhit nuk ka të drejtë për të vepruar efektivisht në lidhje me vendosjen e sekuestros konservative. Kjo sepse çdo urdhër që gjykata e

---

<sup>401</sup> Neni 1696.1 i kodit gjyqësor belg.

<sup>402</sup> "Practitioner's Handbook on International Commercial Arbitration", Edicioni II, Edituar nga Frank-Vernd Weigand 2009, para. 6.124

<sup>403</sup> Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, Kluwer Law International, 1999, fq. 720, para. 1322

<sup>404</sup> Idem, para. 9.201 dhe 9.211.

<sup>405</sup> Neni 38 (1) i Aktit anglez të arbitrazhit; shiko gjithashtu Neni 44: "(1) Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, gjykata për qëllim dhe në funksion të procedurës së arbitrazhit, ka të njëjtat të drejta për të marrë vendime lidhur me çështjet e listuara më poshtë sikurse edhe në rastin e procedurave gjyqësore.

(2) Këto çështje janë: (a) marrja e dëshmimeve të dëshmitarëve; (b) ruajtja e provave;

(c) të urdhërojë që në pasurinë objekt gjykimi ose për të cilën lind ndonjë pyetje gjatë gjykimit, të bëhet: (i) inspektim, fotografim, ruajtje, mbikëqyrje apo sekuestrim të pasurisë, ose: (ii) të merren mostra, të bëhen këqyrje apo eksperimente mbi pasurinë, dhe për këtë qëllim të autorizojë hyrjen e personave në ambientet të cilat janë në posedim apo nën kontrollin e një pale në arbitrazh; (d) shitja e çdo malli që i nënshtrohet procedurave; (e) dhënien e një urdhri sigurimi apo caktimi i një person si ruajtës i pasurisë.

<sup>406</sup> *Kastner v Jason* [2004] APP.L.R. 12/02, faqe 2, paragrafi 15,

<http://www.nadr.co.uk/articles/published/ArbitLawReports/Kastner%20v%20Jason%20No2%202004.pdf>

<sup>407</sup> "Practitioner's Handbook on International Commercial Arbitration", Edicioni II, Edituar nga Frank-Vernd Weigand 2009, para. 5.167

arbitrazhit mund të marrë nuk do të ketë efekt tek palët e treta dhe nuk do të mbështetet me sanksione të mjaftueshme”.<sup>408</sup>

Sipas ligjit të arbitrazhit gjerman, gjykatat e arbitrazhit mund të japin çdo lloj mase sigurimi, që e konsiderojnë të nevojshme në lidhje me çështjen në gjykim, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe.<sup>409</sup> Gjykatat e arbitrazhit mund të japin urdhra kundër palëve të arbitrazhit për të mos tjetërsuar sendin objekt konflikti dhe në raste përjashtimore mund të sekuestrojnë pronën e të paditurit.<sup>410</sup>

#### **4. Arbitri i urgjencës, formimi i përshpejtuar i gjykatës së arbitrazhit dhe mekanizma të tjerë për dhënien e masave të sigurimit para formimit të gjykatës së arbitrazhit**

Sikurse u tha më sipër një nga kufizimet e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi ishte se ajo nuk mund të ushtronte atë kompetencë pa u formuar ende. Por ndonjëherë palët që kanë rënë dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre me arbitrazh kanë nevojë urgjente për marrjen e një mase sigurimi dhe nuk mund të presin formimin e gjykatës së arbitrazhit. Kuptohet që në një rast të tillë palët kanë mundësi t’i drejtohen gjykatës shtetërore për marrjen e masës, sepse sikurse u tha aktualisht shumica e legjislacioneve parashikojnë për juridiksionin konkurrues të arbitrave dhe gjykatave shtetërore lidhur me marrjen e masave të sigurimit.<sup>411</sup> Mirëpo, palët që kanë zgjedhur arbitrazhin si mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre nuk do të donin që t’i drejtoheshin gjykatës shtetërore. Atëherë në përgjigje të një situate të tillë shumë institucione arbitrazhi kanë parashikuar për disa mekanizma që do të veprojnë në kushtet e një nevoje urgjente për marrjen e masave të sigurimit të padisë, të tillë si Arbitri i Urgjencës, formimi i përshpejtuar i gjykatës së arbitrazhit, etj.

##### **4.1. Arbitri i urgjencës**

Ndër institucionet e para të arbitrazhit që kanë parashikuar për mekanizmin e Arbitrit të Urgjencës ka qenë Gjykata Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), e cila miratoi rregullat për procedurën e arbitrit të urgjencës, të cilësuar si arbitri para procesit të arbitrazhit (*pre arbitral referee*) në vitin 1990.<sup>412</sup> Këto rregulla parashikojnë për një procedurë të posaçme për dhënien e masave të sigurimit të padisë nga një arbitër “referee” i emëruar vetëm për dhënien e masës së sigurimit përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit. Por në mënyrë që këto rregulla të zbatoheshin, ato kërkonin që

<sup>408</sup> Pacific Maritime (Asia) Ltd. dhe Holystone Overseas Ltd. [2007] EWHC 2319. Gjykata e Lartë e Drejtësisë, QUEEN'S BENCH DIVISION COMMERCIAL COURT, para. 77 dhe 80.  
<http://www.bailii.org/ew/cases/EWHC/Comm/2007/2319.html>

<sup>409</sup> Neni 1041 (1) i KPrC gjerman.

<sup>410</sup> “Practitioner’s Handbook on International Commercial Arbitration”, Edicioni II, Edituar nga Frank-Vernd Weigand 2009, paragraph 7.141; Shiko gjithashtu: Raeschke-Kessler, H., Berger K.P., “Recht und praxis des schiedsverfahrens”, 3<sup>rd</sup> ed. Cologne, 1999, fq. 141, para. 593; Schwab K.H. and Walter G. Schiedsgerichtsbarkeit, Basel, 2005, fq. 160 (të cilët sqarojnë se kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të vendosur sekuestro shtrihet vetëm në atë që quhet “dinglichr Arrest” d.m.th. sekuestro *in rem* dhe jo në “personlichr Arest” një masë *in personam* shumë e veçantë dhe e përdorur shumë rrallë) cituar në Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq.523, footnote 364.

<sup>411</sup> Për më gjerë lidhur me këtë çështje shiko kreun IV

<sup>412</sup> Emmanuel Gaillard and Philippe Pinsolle, “The ICC Pre-Arbitral Referee: First Practical Experiences, Arbitration International”, vol. 20, no. 1, 2004, fq. 13.

palët ta kishin parashikuar shprehimisht me marrëveshje zbatimin e tyre, pra në mungesë të një përcaktimi të shprehur në marrëveshjen e arbitrazhit këto rregulla nuk mund të zbatoheshin dhe kjo është një nga arsyet që ato dispozita janë zbatuar shumë pak.<sup>413</sup>

Një nga Institucionet që e përmirësoi më tej përjasjen e rregullave të ICC lidhur me arbitrin e urgjencës ishte ICDR,<sup>414</sup> e cila miratoi rregullat e procedurës së arbitrit të urgjencës si pjesë e rregullave të saj të arbitrazhit të vitit 2006. Përmirësimi konsistonte pikërisht në parashikimin se, ndryshe nga Rregullat e ICC, palët mund t'i kërkonin institucionit të emëronte një arbitër urgjence përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit, me kusht që të mos e kishin ndaluar një gjë të tillë në marrëveshjen e arbitrazhit. Pra, sipas këtyre rregullave nuk nevojitej një marrëveshje e shprehur për të lejuar caktimin e arbitrit të urgjencës, por mjaftonte që palët të kishin rënë dakord në marrëveshjen e arbitrazhit për Rregulloren e ICDR. E kundërta do të ishte (pra do të duhej një marrëveshje) në rastin kur palët kërkojnë të përjashtojnë zbatimin e dispozitave për arbitrin e urgjencës. Arbitri i urgjencës caktohej vetëm me qëllimin për të vendosur lidhur me kërkesën për sigurimin e padisë, vendim i cili do të ishte subjekt rishikimi nga gjykata e arbitrazhit pas formimit të saj.<sup>415</sup> Sipas këtyre rregullave, administratori i ICDR cakton arbitrin brenda një dite. Masa e sigurimit mund të jepet në formën e vendimi arbitrazhi ose në formën e një urdhri, në varësi të vlerësimit që i bën çështjes Arbitri i Urgjencës. Pasi të formohet gjykata e arbitrazhit ajo mundet ta ndryshojë, rrëzojë, pushojë etj. urdhrin/vendimin e Arbitrit të Urgjencës. Dispozitat e Arbitrit të Urgjencës nuk i heqin të drejtën palës së interesuar që t'i drejtohet autoritetit gjyqësor kompetent për të marrë masa sigurimi.<sup>416</sup>

Aktualisht shumica e institucioneve më të njohura të arbitrazhit kanë bërë parashikime të ngjashme lidhur me marrjen e masave të sigurimit para formimit të gjykatës së arbitrazhit që do të gjykojë themelin e padisë. Përmendim këtu rregullat e vitit 2010 të SCC,<sup>417</sup> të cilat parashikojnë të drejtën e një pale për të bërë kërkesë për emërimin e Arbitri të Urgjencës derisa çështja nuk i ka kaluar një gjykatë arbitrazhi. Bordi duhet të kërkojë emërimin e një Arbitri Urgjence brenda 24 orëve nga marrja e kërkesës për emërimin e një arbitri të tillë. Çdo vendim urgjent për masa sigurimi do të merret jo më vonë se pesë ditë nga data kur kërkesa iu referua arbitrit të urgjencës dhe do të jetë detyrues për palët sapo shpallet. Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, Arbitri i Urgjencës nuk mund të veprojë si arbitër në proceset e ardhshme të arbitrazhit që lidhen me mosmarrëveshjen. Gjykata e arbitrazhit nuk është e detyruar nga një vendim i Arbitrit të Urgjencës.

Gjithashtu edhe Rregullorja e Arbitrazhit e ICC e vitit 2012,<sup>418</sup> ndoqi të njëjtën përjasje. Sipas saj pala që ka nevojë për masa sigurimi urgjente, të cilat nuk mund të

---

<sup>413</sup> Hausmaninger, "The ICC Rules for a Pre arbitral referee procedure: A step towards solving the problem of provisional relief in international commercial arbitration", 7 ICSID Review, Foreign Investment Law Journal, 1992, fq. 82; Paulson, "A better mousetrap: 1990 ICC Rules for a pre arbitral referee procedure", International Business Law, nr.18, 1990, fq.214.

<sup>414</sup> Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve (International Center for Dispute Resolution)

<sup>415</sup> Për më tepër shiko: Dunning, Quirk, Gleghorn, Simpson, Pinto, Using article 37 of the ICDR International Arbitration Rules: Obtaining emergency relief, Dispute Resolution Journal Vol. 62 Issue 2, fq. 68-72; Lemenez, Quigley, The ICDR's Emergency Arbitrator Procedure in Action, Part I, A look at the empirical data, Dispute Resolution Journal Vol. 63, 2008, fq. 60; Schwartz, Interim and emergency relief in arbitration proceedings, Dispute Resolution Journal Vol. 63, 2008, fq. 56.

<sup>416</sup> Shiko nenin 37 të Rregullave të ICDR

<sup>417</sup> Dhoma Kombëtare e Stokholmit

<sup>418</sup> Gjykata Tregtare Ndërkombëtare Paris

presin formimin e gjykatës së arbitrazhit, mund të aplikojë për këto masa tek Presidenti i ICC dhe një aplikimi i tillë do të pranohet për shqyrtim nëse:

- a. merret nga Sekretariati përpara se ky i fundit t'i ketë dërguar dosjen gjykatës së arbitrazhit;
- b. marrëveshja e arbitrazhit të jetë lidhur pas datës 1 Janar 2012; si edhe
- c. palët të mos kenë parashikuar në mënyrë të shprehur heqjen dorë nga procedura për Arbitrin e Urgjencës.

Gjykata e arbitrazhit mund të modifikojë, anulojë, pushojë efektet e urdhrin të Arbitrit të Urgjencës si dhe ka të drejtë të vendosë me kërkesë të secilës nga palët apo ankim lidhur me procedurat e ndjekura nga ky arbitër. Dispozitat e Arbitrit të Urgjencës nuk i heqin të drejtën palës së interesuar që t'i drejtohet autoritetit gjyqësor kompetent për marrje masash sigurimi në çdo kohë përpara bërjes së këtij aplikimi. Çdo aplikim i tillë dhe çdo masë e marrë nga autoriteti gjyqësor duhet t'i njoftohet menjëherë Sekretariatit të ICC-së. Vendimi i Arbitrit të urgjencës duhet dhënë brenda 15 ditëve nga aplikimi, përveç kur ky afat zgjatet nga presidenti i ICC, duhet të jetë i arsyetuar dhe ndryshe nga vendimi final i arbitrazhit u dërgohet palëve nga Arbitri i Urgjencës dhe jo nga instituti i ICC. Në çdo rast, pala kërkuese e masës së sigurimit, brenda 10 ditëve (përveç kur afati zgjatet nga Presidenti i ICC) duhet të paraqesë Kërkesën për Arbitrazh. Përsa i përket kriterëve që duhet të merren parasysh nga Arbitri i Urgjencës për vendosjen e masave të sigurimit, rregulloret e ndryshme të arbitrazhit, zakonisht mjaftohen me parashikime të tilla si: (a) kur nuk mund të pritet formimi i gjykatës së arbitrazhit<sup>419</sup> apo (b) kur gjykata e arbitrazhit e konsideron të përshtatshme.<sup>420</sup> Rregullorja e AAA dhe ACICA<sup>421</sup> parashikojnë disa kushte të cilat janë ngjashme me kushtet që duhet të plotësohen për marrjen e masës së sigurimit në gjykatat shtetërore kur padia nuk është ngritur akoma. Pavarësisht se rregulloret mund të mos shprehen për kushtet specifike, Arbitri i Urgjencës kur shqyrton vendosjen ose jo të një mase sigurimi, duhet të marrë në konsideratë aq sa mundet, përveç dy kriterëve të sipërsënuara edhe të gjitha kriteret që merren parasysh për vendosjen e masave të sigurimit të zakonshme nga gjykata e arbitrazhit.<sup>422</sup>

Një rregullim të ngjashëm e ndeshim dhe në rregulloren e arbitrazhit të vitit 2011 të ACICA, apo atë të vitit 2010 të NAI<sup>423</sup> etj. Për shkak se shumica e këtyre rregulloreve nuk kërkojnë ekzistencën e një marrëveshjeje të veçantë të palëve për zbatimin e mekanizmit të arbitrit të urgjencës, ato po përdoren shumë më shumë se më përpara dhe ka mundësi që kjo të jetë një tendencë gjithnjë në rritje.<sup>424</sup>

#### **4.2. Formimi i përsheptuar i gjykatës së arbitrazhit**

Krahas mekanizmit të Arbitrit të Urgjencës, për marrjen e masave të sigurimit para formimit të gjykatës së arbitrazhit ka edhe mekanizma të tjerë. Kështu Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar në Londër (LCIA) e vitit 2014,<sup>425</sup> parashikon në nenin 9A (9.1-9.3) të Rregullores së saj, një procedurë të përsheptuar të formimit të gjykatës së

<sup>419</sup> ICC(n.29.1)

<sup>420</sup> SCC(n.32), SCAI (n. 26), AAA(n.O-4),

<sup>421</sup> Qendra Australiane për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar (anex 2, seks. 1.1).

<sup>422</sup> AAA (n. O-1 dhe O-4).

<sup>423</sup> Instituti i arbitrazhit Hollandë; Rregullat e NAI 2010 shiko nenet 42a-42o.

<sup>424</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2453

<sup>425</sup> Kjo rregullore ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2014

arbitrazhit me qëllim marrjen e masës së sigurimit në rastet kur kërkohet në mënyrë të ngutshme. Konkretisht parashikohet se në raste të urgjencës së jashtëzakonshme secila nga palët mund t'i kërkojë Gjykatës së LCIA formimin e përshpejtuar të gjykatës së arbitrazhit. Gjykata e LCIA duhet të vendosë mbi këtë kërkesë sa më shpejt të jetë e mundur. Para ndryshimeve të vitit 2014 LCIA parashikonte vetëm për mekanizmin e formimit të përshpejtuar të gjykatës së arbitrazhit, ndërkohë që aktualisht ajo ka parashikuar edhe mekanizmin e arbitrit të urgjencës, me pothuajse të njëjtat rregullime si ato të institucioneve të tjera të sipërpërmendura.<sup>426</sup>

#### ***4.3. Mekanizma të tjerë për marrjen e masave të sigurimit para formimit të gjykatës së arbitrazhit***

Ndërkohë që ka disa institucione arbitrazhi sikurse është për shembull ICSID, apo Gjykata e Arbitrazhit për Sportet dhe Shoqata Italiane e Arbitrazhit që parashikojnë për mekanizma të ndryshëm nga sa më sipër. Kështu, sipas Rregullores së Arbitrazhit të ICSID nëse një palë kërkon masë për sigurimin e padisë përpara se të jetë formuar gjykata e arbitrazhit, Sekretari i Përgjithshëm fikson afatet brenda të cilëve palët duhet të paraqesin shpjegimet e tyre lidhur me kërkesën në mënyrë që kërkesa dhe shpjegimet rreth saj të shqyrtohen menjëherë nga gjykata e arbitrazhit sapo ajo të formohet.<sup>427</sup>

Ndërsa Gjykata e Arbitrazhit për Sportet dhe Shoqata Italiane e Arbitrazhit parashikojnë se do të jetë institucioni i arbitrazhit ai që do të marrë masa sigurimi kur gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende.<sup>428</sup> Një parashikim i tillë, ndonëse mund të jetë shumë efektiv, krijon paqartësi lidhur me natyrën e vendimit për sigurimin e padisë, pasi institucioni i arbitrazhit nuk është gjykatë arbitrazhi, dhe me ekzekutimin e këtij e këtij vendimi.

#### ***4.4. Përparësitë dhe të metat e arbitrit të urgjencës***

Disa nga arsyet për të cilat arbitri i urgjencës konsiderohet si një zgjidhje mjaft efektive për marrjen e masave të sigurimit në kushtet kur gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende janë: (i) masa është jashtëzakonisht urgjente dhe nuk mund të pritët formimi i gjykatës së arbitrazhit apo edhe procedurat e gjykatës shtetërore; (ii) Gjykatat shtetërore janë të pabesueshme ose jo eficiente,<sup>429</sup> apo nuk kanë ekspertizën e duhur për të bërë vlerësim të drejtë;<sup>430</sup> (iii) Në shumë raste gjykatat shtetërore procedojnë më ngadalë se Arbitri i Urgjencës;<sup>431</sup> (iv) Palët nuk e njohin sistemin gjyqësor, ligjin e vendit<sup>432</sup> apo duhet të marrin avokatë vendas dhe të procedojnë në

<sup>426</sup> Shiko nenin 9 B (nenet 9.4- 9.14) të Rregullave të LCIA.

<sup>427</sup> Shiko nenin 39(5) të Rregullave të Arbitrazhit të ICSID

<sup>428</sup> Neni 37 i Rregullave të Gjykatës së Arbitrazhit të Sporteve dhe neni 8 i Rregullave të Shoqatës Italiane të Arbitrazhit

<sup>429</sup> Raja Bose, Ian Meredith, "Emergency Arbitration Procedures: A comparative analysis", 2012, gjendet <http://www.klgates.com/files/Publication>, fq 193.

<sup>430</sup> Barbara Helene Steindl, "The Emergency Arbitrator in International Construction Arbitration", 2013, botuar nga "Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation" The Fordham Papers 2012, editor Arthur W. Rovine, fq. 260, para. 1.2.

<sup>431</sup> Chester Brown, "The Enforcement of Interim Measures Ordered by Tribunals and Emergency Arbitrators in International Arbitration", botuar në International Arbitration The Coming of a New Age ICCA Congress Series No. 17, Editor i përgjithshëm Albert Jan Van Den Berg, fq. 283, para. 4.

<sup>432</sup> Jue Jun Lu, "The emergency arbitrator procedure: effective tool or enforcement headache?", gjendet në, gjendet në <http://www.blplaw.com/expert-legal-insights/articles>.

gjuhën e vendit, të cilën shpesh nuk e njohin;<sup>433</sup> (v) Palët nuk duan që mosmarrëveshja e tyre të bëhet publike apo e njohur nëpër gazeta;<sup>434</sup> (vi) Në varësi të shtetit ku mund të kërkohet masa e sigurimit nga gjykatat shtetërore, palët nuk janë të sigurta për mundësinë e ekzekutimit të vendimit të gjykatës shtetërore për masa sigurimi në një shtet të ndryshëm nga ai ku është dhënë një masë e tillë.<sup>435</sup>

Ndërkohë që marrja e masave të sigurimit nga Arbitri i Urgjencës mbart në vetvete edhe një mori disavantazhesh në raport me sigurimin e tyre nga autoritetet gjyqësore dhe jo pak problematika gjithashtu. Ndër të metat më të mëdha të arbitrit të urgjencës në raport me autoritetet gjyqësore është kostoja e lartë e tij.<sup>436</sup> Gjithashtu vendimi i dhënë nga Arbitri i Urgjencës i shtrin efektet vetëm mbi palët që kanë nënshkruar marrëveshjen e arbitrazhit ose trashëgimtarët e tyre dhe nuk mund t'i shtrijë mbi të tretë (p.sh. mbi bankën ku duhet të bllokohet një shumë parash) ndërkohë që gjykata shtetërore mund të vendosë masa sigurimi edhe mbi të tretët.<sup>437</sup> Procesi për vendosjen e masave të sigurimit nga Arbitri i Urgjencës nuk mund të bëhet *ex parte*, ndërkohë që gjykatat shtetërore e mundësojnë në gjë të tillë<sup>438</sup> (përrjashtimisht rregullat e SCAI<sup>439</sup>(2012) parashikojnë mundësinë e procesit *ex parte*). Arbitri i Urgjencës nuk zgjidhet asnjëherë nga palët, por caktohet nga Instituti. Disa Institute kanë një regjistër me emra arbitrash që mund të përdoren si Arbitër Urgjence dhe zgjedhin prej tyre (ICC, AAA). Kjo metodë, nga njëra anë, krijon një bërthamë arbitrash me eksperiencë në këtë procedurë, por nga ana tjetër kritikohet për transparencën e zgjedhjes së arbitrave në këtë regjistër, dhe numrit të kufizuar, që mund të passjellë dhe dyshime për pavarësinë e tyre.<sup>440</sup> Një nga pikat më të dobëta lidhur me arbitrat e urgjencës është ekzekutueshmëria e masave të dhëna prej tyre. Përgjithësisht, me disa përjashtime, vendimi i Arbitrit të Urgjencës nuk është i ekzekutueshëm forcërisht.<sup>441</sup> Çështja e ekzekutueshmërisë së masave të sigurimit të dhëna nga arbitrat e urgjencës është trajtuar nga gjykatat amerikane, të cilat kanë çmuar se masat e sigurimit të padisë të dhëna nga arbitrat, megjithëse në fakt janë të përkohshme, janë përfundimtare përse i përket qëllimit të ekzekutimit sipas Aktit Federal të Arbitrazhit dhe Konventës së New Yorkut. Arsyeimi që i çon gjykatat amerikane të ekzekutojnë masat e sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit që do të gjykojnë themelin e padisë duhet të zbatohet edhe për masat e sigurimit të padisë të

<sup>433</sup> Barbara Helene Steindl, "The Emergency Arbitrator in International Construction Arbitration", 2013, botuar nga "Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation" The Fordham Papers 2012, editor Arthur W. Rovine, fq. 260, para. 1.2.

<sup>434</sup> N. Vivekananda, "The SIAC Emergency Arbitrator Experience, gjendet në: <http://www.siac.org.sg/>

<sup>435</sup> Barbara Helene Steindl, "The Emergency Arbitrator in International Construction Arbitration", 2013, botuar nga "Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation" The Fordham Papers 2012, editor Arthur W. Rovine, fq. 260, para. 1.2.

<sup>436</sup> Kostoja e investimit të Arbitrit të Urgjencës sipas SIAC është \$5000, ndërsa tarifa për arbitrin e urgjencës nuk mund të jetë më pak se 20,000 \$, ndërsa sipas Rregullores së ICC është 40,000 US \$ nga të cilat 10,000 \$ shkojnë për shpenzime logjistike të ICC dhe 30,000 \$ shkojnë për Arbitrin; Tarifa e aplikimit për arbitrin e urgjencës sipas SCC është 3000 Euro, ndërsa tarifa e Arbitrit të Urgjencës është 12,000 Euro (neni 10 Anex II i Rregullores SCC(2012));

<sup>437</sup> Jue Jun Lu, "The emergency arbitrator procedure: effective tool or enforcement headache?", gjendet në, <http://www.blplaw.com/expert-legal-insights/articles>.

<sup>438</sup> Raja Bose, Ian Meredith, "Emergency Arbitration Procedures: A comparative analysis", 2012, gjendet <http://www.klgates.com/files/Publication>, fq 193.

<sup>439</sup> Instituti i Arbitrazhit të Dhomës Zviceriane

<sup>440</sup> Barbara Helene Steindl, "The Emergency Arbitrator in International Construction Arbitration", 2013 botuar në "Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation", The Fordham Papers 2012, editor Arthur W. Rovine, fq. 275, para. 5.3.6.

<sup>441</sup> Jue Jun Lu, "The emergency arbitrator procedure: effective tool or enforcement headache?" gjendet në <http://www.blplaw.com/expert-legal-insights/articles>



dhëna nga arbitri i urgjencës, pavarësisht formës në të cilën janë dhënë.<sup>442</sup> Kështu në çështjen *Publicis Communication v. True North Communications* gjykata amerikane e apelit u shpreh se: “Një vendim për një çështje diskrete dhe urgjente, mund të jetë i formës së prerë dhe i gatshëm për tu ekzekutuar edhe pse pretendimet e tjera mbeten për tu trajtuar nga arbitrat. Pavarësisht disa të metave të mundshme sipërfaqësore teknike, dhe pavarësisht përcaktimit të tij si “urdhër” apo “vendim”, vendimi i gjykatës së arbitrazhit – si në këtë rast - ishte përfundimtar”.<sup>443</sup> Megjithatë deri më tani Shtetet e Bashkuara dhe Singapori e kanë zgjidhur këtë çështje duke i konsideruar ata të ekzekutueshëm njësoj si vendimi përfundimtar i arbitrazhit,<sup>444</sup> ndërkohë që në vende të tjera çështja është ende e diskutueshme.

Gjithashtu, në disa vende (si p.sh. Argjentina, Kina, Italia, Tajlanda) ku gjykatat e arbitrazhit nuk kanë tagër të vendosin masa sigurimi, përdorimi i arbitrit të urgjencës është shumë i diskutueshëm. Diskutimi për dhënien e masave të ekzekutueshme nuk ka lindur vetëm në rastet kur legjislacionet nuk ia njohin të drejtën arbitrave për të marrë masa sigurimi, por edhe kur këto ligje ia njohin shprehimisht një të drejtë të tillë arbitrave. Kështu, duke pasur parasysh që shumica e legjislacioneve nuk parashikojnë për mundësinë e dhënies së masave të sigurimit nga arbitrat para formimit të gjykatës së arbitrazhit lind pyetja a është e mundur që arbitri i urgjencës të marrë një masë sigurimi që është në formën e një vendimi përfundimtar dhe të ekzekutueshëm?<sup>445</sup> Sipas një autori të njohur suedez<sup>446</sup> palët nuk kanë mundësi që t’i japin një “arbitri të ndërmjetëm” kompetencën për të marrë masa sigurimi që mund të ekzekutohen nga autoritetet suedeze, duke qenë se në mënyrë që ato të jenë të ekzekutueshme duhet të gjejnë mbështetje në ligj. Gjithsesi palët mund të autorizojnë një person të tretë që të marrë vendime si “arbitër i ndërmjetëm”, por ky person nuk mund të jetë arbitër në kuptim të ligjit suedez për arbitrazhin. Ndaj vendimi i këtij “arbitri të ndërmjetëm” do të ishte i ekzekutueshëm vetëm nëse gjykata e arbitrazhit e përfshin vendimin e “arbitrit të ndërmjetëm” në vendimin e saj përfundimtar. Megjithatë ka autorë të tjerë që argumentojnë se kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi buron nga marrëveshja e arbitrazhit ose ligji i zbatueshëm. Ndaj nëse një arbitër mund të marrë një masë sigurimi bazuar vetëm në marrëveshjen e palëve (qoftë të parashikuar shprehimisht apo të nënkuptuar duke zgjedhur rregullat e arbitrazhit që e njohin një kompetencë të tillë), atëherë është arsyeshme që kjo e drejtë të shtrihet edhe tek arbitrat e urgjencës.<sup>447</sup>

Megjithë popullaritetin në rritje të institutit të Arbitrit të Urgjencës në institucionet e arbitrazhit, sipas statistikave të SCC dhe ICC, rastet e aplikimit në praktikë janë të

---

<sup>442</sup> Guillaume Lemenez and Paul Quigley, *The ICDR’s emergency arbitrator: Procedure in action Part II: Enforcing Emergency Arbitrator Decisions*, *Dispute Resolution Journal*, November 2008, January 2009, fq. 69.

<sup>443</sup> *Public Communication, Plaintiff-Counterclaim Defendant-Appellant and Publicis S.A., a French corporation, Counterclaim Defendant-Appellant, v. True North Communications INC.*, Nos. 99-1199 & 99-3424 in the United States Court of Appeals for the Seventh Circuit, 14 Mars 2000, para. 12 dhe 17

<sup>444</sup> Raja Bose dhe Ian Meredith, *Emergency Arbitration Procedures: A comparative analysis*, 2012 gjendet <http://www.klgates.com/files/Publication>, fq. 193

<sup>445</sup> Patricia Shaughnessy, “Pre-arbitral urgent relief: The new SCC Emergency Arbitrator Rules”, *Journal of International Arbitration* 27(4), 2010, fq. 356

<sup>446</sup> Peter Westberg, *Skilforfarande och Avtal on Civilprocessulla och Sakerhetsatgardar*, *Festkrift Till Lars Gorton, Eva Lindell-Frantz ed.* 2008, fq. 617-36, 630-32, cituar në Patricia Shaughnessy, *Pre-arbitral urgent relief: The new SCC Emergency Arbitrator Rules*, *Journal of International Arbitration* 27(4), 2010, fq. 356.

<sup>447</sup> Nigel Blackaby, *Redfern and Hunter on International Arbitration*, 5<sup>th</sup> ed. 2009, fq. 520; Patricia Shaughnessy, “Pre-arbitral urgent relief: The new SCC Emergency Arbitrator Rules”, *Journal of International Arbitration* 27(4), 2010, fq. 357

rralla. Sipas një raporti të SCC të 20 janarit 2014, për një periudhë 4 vjetore duke filluar nga 1 Janar 2010 deri në 31 Dhjetor 2013, ka pasur vetëm 9 aplikime, dhe vetëm për 2 prej tyre është vendosur masë sigurimi.<sup>448</sup> ICC gjithashtu ka publikuar statistika lidhur me kërkesat për Arbitër Urgjence dhe rezulton se nga viti 2012, (viti i parë kur këto dispozita ishin në fuqi) deri në 2014 ka pasur 14 kërkesa.<sup>449</sup>

---

<sup>448</sup> Kate Wilford, Emergency Arbitrator: a passing trend?, Janar 2014, gjendet në <http://www.hlarbitrationlaw.com>

<sup>449</sup> <http://www.iccwbo.org/Products-and-Services/Arbitration-and-ADR/Arbitration/Introduction-to-ICC-Arbitration/Statistics/>

## KAPITULLI II

### PROCEDURA DHE STANDARDET PËR DHËNIEN E MASAVE TË SIGURIMIT

#### 1. Fillimi i procedurës për masë sigurimi para gjykatës së arbitrazhit

Lidhur me fillimin e procedurës për marrjen e një mase sigurimi nga gjykata e arbitrazhit, dy janë çështjet kryesore që shtrohen për diskutim; *së pari*, kush e inicion një procedurë të tillë dhe *së dyti*, çfarë elementesh duhet të përmbajë kërkesa për masë sigurimi.

##### 1.1. Subjektet që mund të iniciojnë procedurën për marrjen e masës së sigurimit

Në përgjithësi procedura për marrjen e një mase sigurimi nga gjykata e arbitrazhit fillohet me kërkesë të palës. Shumica e ligjeve apo rregulloreve të arbitrazhit parashikojnë shprehimisht vendosjen e masës së sigurimit nga gjykata e arbitrazhit vetëm me kërkesë të palës.<sup>450</sup> Megjithatë ka edhe shembuj të rregulloreve të arbitrazhit të disa institucioneve që u japin kompetencë arbitrave të japin masa sigurimi me nismën e tyre (*sua sponte*). Mund të përmendim Rregulloren e Arbitrazhit të ICSID,<sup>451</sup> apo Rregullat e Arbitrazhit të SIAC të vitit 1997,<sup>452</sup> apo nenin 1134 të NAFTA. Sidoqoftë, gjykatat e arbitrazhit pranë ICSID nuk e kanë ushtruar ndonjëherë këtë të drejtë, të paktën në çështjet që janë publikuar deri më sot. Në të gjitha çështjet e publikuara, masa e sigurimit është vendosur me kërkesë të palës.<sup>453</sup> Vetëm në një çështje *Vaccum Salt v. Ghana*, gjykata e arbitrazhit u shpreh se rezervon të drejtën që nëse është e nevojshme të rekomandojë ndonjë masë me iniciativën e saj.<sup>454</sup>

Njohja e të drejtës së palëve për të kërkuar masa sigurimi, nëse ata kanë nevojë për të, është çështje e autonomisë së vullnetit të palëve. Ndërkohë që qëllimi kryesor për pajisjen e gjykatës së arbitrazhit me kompetencën për të dhënë masa sigurimi me iniciativën e saj në arbitrazhin tregtar ndërkombëtar është të ndalojë përkeqësimin e mëtejshëm të mosmarrëveshjes.<sup>455</sup>

Krahas rregulloreve të arbitrazhit që parashikojnë shprehimisht vendosjen e masës së sigurimit nga gjykata e arbitrazhit vetëm me kërkesë të palës dhe atyre që lejojnë vendosjen e masave të tilla edhe me nismën e vetë gjykatës së arbitrazhit, ka edhe disa

<sup>450</sup> Shiko për shembull: Ligji Model i UNCITRAL, neni 17; Ligji Zvicëran për të Drejtën Ndërkombëtare Private, neni 183(1); Rregullorja e Arbitrazhit e UNCITRAL, neni 26.1: “Gjykata e arbitrazhit mundet, me kërkesë të palës, të vendosë masa sigurimi”. Rregullorja e LCIA parashikon se: “Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, gjykata e arbitrazhit, me kërkesë të palës, ka të drejtë...” (n.25.1). Rregullorja e DIS: “Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, gjykata e arbitrazhit mundet, me kërkesë të palës, të vendosi masa sigurimi.....” (n. 20.1). Rregullorja e ICC: “Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, sapo dosja i dërgohet gjykatës së arbitrazhit, gjykata e arbitrazhit, me kërkesë të palës, vendos masa sigurimi që asaj i duken të përshtatshme. (n.28.1)

<sup>451</sup> Rregullat e Arbitrazhit të ICSID neni 39.3

<sup>452</sup> Rregullat e Arbitrazhit të SIAC të vitit 1997, neni 25.

<sup>453</sup> Institutional Arbitration, Article by Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules” (2013) edituar nga Rolf A. Schultze, 218

<sup>454</sup> *Vaccum Salt v. Ghana*, Decision 3 of the Tribunal, 14 June 1993, 4 ICSID Rep 328.

<sup>455</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 167, para 5-11.

rregullore arbitrazhi të cilat nuk e rregullojnë shprehimisht çështjen se kush mund të iniciojë një procedurë për dhënien e masave të sigurimit. Në raste të tilla qëndrimi është që gjykata e arbitrazhit nuk duhet të japë masa sigurimi *sua sponte*, sepse një veprim i tillë do t'i mohonte të paditurit (po ashtu edhe paditësit) të drejtën për tu dëgjuar, ndërkohë që masa e dhënë mund të rezultojë qoftë e padëshiruar, por edhe e dëmshme për palët.<sup>456</sup> Pra, duhet të jenë palët ato që bëjnë kërkesën për masë sigurimi, duke qenë se parimi i autonomisë së vullnetit të palëve është një nga parimet më të rëndësishme të arbitrazhit tregtar ndërkombëtar.<sup>457</sup>

## **1.2. Elementet e kërkesës për masë sigurimi**

Kërkesa për marrjen e një mase sigurimi si rregull duhet të ketë disa elemente thelbësorë në përmbajtjen e saj. Megjithatë janë të pakta Rregullat e Arbitrazhit që parashikojnë se cilët duhet të jenë këta elemente. Të tillë janë për shembull Rregullat e Arbitrazhi të ICSID, të cilët parashikojnë në nenin 39(1) se kërkesa duhet të tregojë të drejtën për të cilën kërkohet mbrojtja, masën që kërkohet të rekomandohet dhe rrethanat që tregojnë se marrja e kësaj mase është e nevojshme. Kërkesa duhet të përmbajë një arsytim të mjaftueshëm në mënyrë që t'i japë mundësi palës tjetër për të komentuar rreth tyre dhe arbitrave për të shqyrtuar kërkesën.<sup>458</sup>

Nëse kërkesa për masë sigurimi nuk përmban elementet e nevojshëm, gjykata e arbitrazhit mund t'i kërkojë palës të japë informacion shtesë përpara se të shprehet për kërkesën.

Lidhur me formën e kësaj kërkesë praktika ka treguar se nuk duhet të jetë domosdoshmërisht e shkruar. Ajo mund të paraqitet edhe verbalisht gjatë një seance dëgjimore.<sup>459</sup>

## **2. Ligji që përcakton procedurën dhe standardet e marrjes së masave të sigurimit nga gjykata e arbitrazhit**

Sikurse u përmend edhe më sipër kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi përcaktohet nga *lex arbitri* i vendit të arbitrazhit. Megjithatë duhet të kemi parasysh se ligji i aplikueshëm për përcaktimin e kompetencës së gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi është i ndryshëm nga ligji i aplikueshëm që rregullon standardet për dhënien e këtyre masave siguroese. Shumica e autorëve janë të mendimit që ligji që përcakton standardet në bazë të të cilave gjykata e arbitrazhit vlerëson nëse do të japë, ose jo një masë sigurimi përcaktohet nga një sistem ligjor i ndryshëm nga ai i vendit të arbitrazhit.<sup>460</sup> Përcaktimi i ligjit të

---

<sup>456</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq.2508, footnote 447.

<sup>457</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 167, para 5-12.

<sup>458</sup> David D. Caron. "Interim Measures of Protection: Theory and Practice in Light of the Iran United States Claims Tribunal" *ZEITSCHRIFT FÜR AUSLÄNDISCHES ÖFFENTLICHES RECHT UND VÖLKERRECHT* 46 (1986) fq.48o. gjendet në: [http://works.bepress.com/david\\_caron/135](http://works.bepress.com/david_caron/135)

<sup>459</sup> Idem, footnote 45; Ali Yesilirmak, në "Pervasive Problems in international Arbitration", Edituar nga Loukas A Mistelis, D.M. Lew, 2006, fq. 190, para. 9-14.

<sup>460</sup> Boog, "The laws governing interim measures in international arbitration", në F. Ferrari & S. Kroll (eds). *Conflict of laws in international arbitration*, 2010, fq. 409, 424. ("Një çështje e ndryshme nga ligji që rregullon kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi lidhet me ligjin që përcakton kushtet për dhënien e këtyre masave"; "Qëndrime të ndryshme janë mbajtur nga gjykata arbitrazhi dhe shumë opinione janë shprehur në doktrinën ligjore lidhur me ligjin e aplikueshëm për

aplikueshëm për standardet e dhënies së masave të sigurimit nuk është trajtuar shumë gjerësisht në doktrinën e arbitrazhit ndërkombëtar dhe ajo paraqet jo pak vështirësi për arbitrat.

Praktika e arbitrazhit ndërkombëtar ka treguar se ka qëndrime të ndryshme lidhur me përcaktimin e ligjit të aplikueshëm për standardet e dhënies së masave të sigurimit. Kështu, ekzistojnë tre mundësi për përcaktimin e ligjit aplikueshëm për standardet e dhënies së masave të sigurimit. *Së pari*, ai mund të jetë ligji i vendit të arbitrazhit,<sup>461</sup> *së dyti*, ligji që rregullon marrëdhënien (kontratën) e palëve<sup>462</sup> dhe *së treti*, standardet ndërkombëtare.<sup>463</sup>

Edhe doktrina e arbitrazhit ndërkombëtar është e ndarë lidhur me këtë çështje. Disa autorë mbajnë qëndrimin se kushtet për dhënien e masave të sigurimit rezultojnë nga rregullat procedurale që kanë zgjedhur palët me marrëveshje, dhe në mungesë të një marrëveshje të tillë, të përcaktuara nga gjykata e arbitrazhit, ose nga *lex causae*. Dhe zgjedhja varet nga mënyra se si arbitrat e cilësojnë kërkesën për masë sigurimi që u është paraqitur.<sup>464</sup> Ndërkohë që autorë të tjerë, mbajnë qëndrimin se standardet për dhënien e masave të sigurimit në arbitrazhin ndërkombëtar duhet të përcaktohen në bazë të burimeve sipas radhës së mëposhtme: i) dispozitat e detyrueshme ligjore; ii) ligji i zgjedhur nga palët; iii) standardet e arbitrazhit ndërkombëtar; iv) në raste përjashtimore, *lex causae* në masën që përcakton standardet për dhënien e masave të sigurimit,<sup>465</sup> ose se gjykatat e arbitrazhit duhet të japin apo refuzojnë masat siguruese në bazë të metodës së krahasimit të ligjeve, duke u udhëhequr nga: i) praktika e arbitrazhit; ii) analiza krahasimore e rregulloreve të arbitrazhit; iii) mendimet e doktrinës.<sup>466</sup>

Pikërisht për shkak të kompleksitetit të kësaj çështje, ajo që konstatohet në praktikën e arbitrazhit ndërkombëtar është se shumica e vendimeve të gjykatave shtetërore dhe të arbitrazhit nuk ndalen në përcaktimin e ligjit të aplikueshëm për

---

standardet e dhënies së masave të sigurimit.); Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 535; Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, para.17.02 [F].

<sup>461</sup> Shiko Interim Award in ICC case no. 8879, 11(1) ICC Ct. Bull. 84 (2000) ku gjykata e arbitrazhit u bazua në *lex contractus* dhe *lex fori*; Interim Award in ICC Case no. 7886, 11(1) ICC Ct. Bull. 81, 82, (2000) ku gjykata e arbitrazhit u referua nën 183 të të drejtës ndërkombëtare private zviceriane si bazë për dhënien e masës së sigurimit të padisë; Award in summary Arbitral proceedings in NAI Case no. 2212 dated 28 July 1999, XXVI Y.B. Comm. Arb. 198(2001) ku gjykata e arbitrazhit mori në konsideratë standardet e brendshme holandeze.

<sup>462</sup> Shiko Interim award in ICC Case no. 8879 ICC Ct. Bull. 84, 89, (2000) ku krahas ligjeve të Ontarios (si *lex fori*) u morën në konsideratë dhe ligjet e Meksikës (si *lex contractus*); gjithashtu Award in summary Arbitral proceedings in NAI Case no. 2212 dated 28 July 1999, XXVI Y.B. Comm. Arb. 198(2001) ku gjykata e arbitrazhit mori në konsideratë standardet e brendshme holandeze.

<sup>463</sup> Shiko Partial award in ICC Case no. 8113, 11(1) ICC Ct. Bull. 65 (2000) ku gjykata e arbitrazhit shqyrtoi kërkesat e urgjencës, dëmit të pariparueshëm dhe mosparagjykimin të themelit të çështjes pa iu referuar ndonjë ligji kombëtar; ose Decision of Geneva Chamber of Commerce, 25 September 1997, 19 ASA Bull. 745 (2001) ku gjykata e arbitrazhit shqyrtoi praktikën ndërkombëtare për të vendosur nëse kërkesa për masë sigurimi duhej të pranohej apo jo.

<sup>464</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 535

<sup>465</sup> Boog, “The laws governing interim measures in international arbitration”, në F. Ferrari & S. Kroll (eds). Conflict of laws in international arbitration, 2010, fq. 409, 427.

<sup>466</sup> Pierre A. Karrer, “Interim measures issues by arbitral tribunals and the courts: Less theory, please”, in A. van den Berg ed. International Arbitration and National Courts: The never ending story, 2001, fq.104.

standardet e dhënies së masave të sigurimit.<sup>467</sup> Kjo do të thotë që gjykatat për të vendosur lidhur me dhënien apo jo të një mase sigurimi nisen nga standarde ndërkombëtare. Dhe në fakt janë të shumta rastet e praktikës së arbitrazhit që bëjnë referim në standardet ndërkombëtare kur kanë shqyrtuar kërkesa për masa sigurimi.<sup>468</sup> Dhe sipas Born,<sup>469</sup> standardet ndërkombëtare janë mënyra më e përshtatshme për të vlerësuar dhënien e masave të sigurimit në arbitrazhin ndërkombëtar. Këto standarde ndërkombëtare vendosen nga vendime arbitrazhi, në të cilat gjykatat e arbitrazhit kanë gjykuar çështje të ngjashme duke nxjerrë parime të përbashkëta të së drejtës në vende të zhvilluara. Argumentet ku mbështetet një qëndrim i tillë është se zbatimi i standardeve ndërkombëtare për dhënien e masave të sigurimit të padisë është në përputhje me pritshmërinë e palëve, sepse ato garantojnë që do të zbatohet një standard i vetëm dhe uniform si për masat e sigurimit të padisë dhe për kërkesa të tjera të njëjta pavarësisht vendit të arbitrazhit dhe i përshtaten procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar. Gjithashtu, ndjekja e një përqsajeje të tillë ul rëndësinë e çështjes së ligjit të aplikueshëm dhe nxit rezultate uniforme.

### 3. Standardet për dhënien e masave të sigurimit në arbitrazhin ndërkombëtar

Përcaktimi i standardeve për dhënien e masave të sigurimit të padisë varet gjithashtu edhe nga vullneti i palëve. Mund të ndodhë që palët të parashikojnë shprehimisht në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit standardet në bazë të të cilave do të vlerësohet kërkesa për sigurimin e padisë dhe në raste të tilla nuk arsyen se përse të mos merret në konsideratë ky parashikim i palëve,<sup>470</sup> ose tu referohen rregullave të arbitrazhit të ndonjë institucioni arbitrazhi, të cilat vendosin standarde për dhënien e masave të sigurimit të padisë. Megjithatë, në praktikë rregulloret e institucioneve të arbitrazhit, ashtu si një pjesë e mirë e ligjeve kombëtare të arbitrazhit, zakonisht nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur se çfarë kriteresh duhet të merren në konsideratë nga gjykata e arbitrazhit për vendosjen e masave të sigurimit. Terminologjia që përdoret më së shumti është që masa duhet të jetë “e përshtatshme” apo “e nevojshme”.<sup>471</sup> Megjithatë këto përcaktime nuk kanë për qëllim që të lenë marrjen e masave të sigurimit të padisë tërësisht në diskrecionin e arbitrave.

Ligji Model i UNCITRAL, i ndryshuar në vitin 2006, parashikoi disa kriteret që duhet të merren parasysh nga gjykatat e arbitrazhit për vendosjen e masave të sigurimit, të tilla si dëm i pariparueshëm, dëmi që mund t'i shkaktohet palës tjetër nga

<sup>467</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 535; Lew, “Commentary on interim and conservatory measures in ICC arbitration cases”, 11(1) ICC Ct. Bull. 2000, fq. 23, 27

<sup>468</sup> Interim award in ICC Case no. 8894, 11(1) ICC Ct. Bull. 94 (2000); Final Award in ICC Case no. 7589, 11(1) ICC Ct. Bull., 60 (2000); Final Award in ICC case no. 7210, 11(1), ICC Ct. Bull. 49, (2000)

<sup>469</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2465.

<sup>470</sup> G. Born, “International Arbitration and Forum Selection Agreements: Drafting and Enforcing”, 4<sup>th</sup> ed., 2014, fq. 112-114.

<sup>471</sup> Rregullat e Arbitrazhit të ICC, neni 28(1): “Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, sapo çështja t'i dërgohet gjykatës së arbitrazhit, me kërkesë të palës, gjykata e arbitrazhit mund të urdhërojë masa sigurimi që i duken të përshtatshme”; Shiko gjithashtu: Rregulloren e CIETAC, neni 21(3): “Me kërkesë të palës, gjykata e arbitrazhit mund të urdhërojë masa sigurimi që i duken të nevojshme dhe të përshtatshme”; apo Rregulloren e LCIA, neni 25: “Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, gjykata e arbitrazhit ka tagër , që me kërkesë të palëve të urdhërojë masë sigurimi.....sipas kushteve që gjykata e arbitrazhit i konsideron të përshtatshme”; Ose Ligjin gjerman të arbitrazhit , seksioni 1041(1): “Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, gjykata e arbitrazhit, me kërkesë të palës mund të urdhërojë masa sigurimi që ajo i konsideron të nevojshme në lidhje me çështjen në gjykim” etj.

marrja e masës, mundësia e suksesit mbi themelin e padisë.<sup>472</sup> Për autorët që ishin të qëndrimit se mënyra më e mirë për të përcaktuar standardet në bazë të të cilave vlerësohet kërkesa për sigurim padie është referimi në standardet ndërkombëtare, ky parashikim i ri në ligjin Model të UNCITRAL është i panevojshëm. Madje ky parashikim është edhe i dëmshëm, sepse cenon krijimin e vazhdueshëm të standardeve ndërkombëtare, të cilat i përshtaten nevojave të një çështje specifike, ndërkohë që imponimi i standardeve kombëtare injoron veçoritë e çështjeve të veçanta.<sup>473</sup> Ndër kritikantët e tjera që i bëhen këtij parashikimi të ri të Ligjit Model të UNCITRAL janë se neni 17A nuk referon në marrëveshjen e palëve lidhur me standardin e provës, nuk bën referencë në standardin e urgjencës, gabimisht referon dëmin e “pariparueshëm” në dëmin monetar (si i ndryshëm nga dëmi jopasuror), vendos një standard të vetëm për disa lloje të ndryshme masash sigurimi dhe nuk bën referim në garancinë për kostot.<sup>474</sup> Autorët tjerë shprehin se neni 17A i Ligjit Model të UNCITRAL synon të reflektojë një praktikë uniforme të arbitrazhit tregtar ndërkombëtar lidhur me kushtet për dhënien e masave të sigurimit të padisë.<sup>475</sup>

Ndërkohë që disa Rregullore Arbitrazhi gjithashtu bëjnë përcaktim lidhur me standardet për marrjen e masave të sigurimit të padisë. Shembulli më tipik do të ishin Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL të 2010 të cilat parashikojnë se: “Pala që kërkon marrjen e një mase sigurimi sipas paragrafit 2(a)-(c) duhet t’i provojë gjykatës së arbitrazhit se: (a) një dëm që nuk mund të riparohet në mënyrën e duhur nga një vendim arbitrazhi që njeh dëmshpërblimin ka mundësi të ndodhë nëse nuk jepet masa siguruese dhe se një dëm i tillë e tejkalon dëmin që mund t’i shkaktohet palës tjetër nga marrja e masës siguruese; dhe (b) ka një mundësi të arsyeshme që pala kërkuese do të ketë sukses lidhur me themelin e padisë. Përcaktimi i kësaj mundësie nuk do të prekë diskrecionin e gjykatës së arbitrazhit për të bërë një vlerësim tjetër.”<sup>476</sup>

Në ditët e sotme, shumica e gjykatave të arbitrazhit, kërkojnë plotësimin e disa standardeve apo kriterëve që janë thujtë gjithëpranuar edhe nga doktrina juridike mbi arbitrazhin ndërkombëtar, të tilla si dëmi serioz ose i pariparueshëm, urgjenca, mosparagjykim i themelit të çështjes, juridiksion *prima facie* i gjykatës së arbitrazhit; sukcesi *prima facie* i palës kërkuese në padinë e themelit, balanca e interesave të palëve.<sup>477</sup> Në doktrinën juridike ndeshim gjithashtu një klasifikim të tyre në: (i) kriteret pozitive dhe (ii) negative.<sup>478</sup>

### 3.1. Kriteret pozitive

Kriteret për dhënien e masave të sigurimit, të cilat cilësohen si pozitive janë:

- i. juridiksioni *prima facie* i gjykatës së arbitrazhit;

<sup>472</sup> Shiko nenin 17A të Ligjit Model të UNCITRAL mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar

<sup>473</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2466.

<sup>474</sup> Idem, footnote 231.

<sup>475</sup> Boog, “The laws governing interim measures in international arbitration”, në F. Ferrari & S. Kroll (eds). Conflict of laws in international arbitration, 2010, fq. 409, 429.

<sup>476</sup> Neni 26(3) i Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL 2010

<sup>477</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2468

<sup>478</sup> Pierre A. Karrer, “Interim measures issues by arbitral tribunals and the courts: Less theory, please”, in A. van den Berg ed. International Arbitration and National Courts: The never ending story, 2001, fq.104; Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 174; Ali Yesilirmak, në Pervasive Problems in international Arbitration, Edituar nga Loukas A Mistelis, D.M. Lew, 2006, fq. 190, para. 9-15.

- ii. sukcesi *prima facie* mbi themelin e padisë;
- iii. urgjenca;
- iv. dëmi serioz dhe i pariparueshëm;
- v. proporcionaliteti, apo balanca e interesave.

### 3.1.1. Juridiksioni *prima facie* i gjykatës së arbitrazhit

Në parim, gjykata e arbitrazhit duhet të ketë juridiksion për të urdhëruar masa sigurimi. Por ndodh shpesh që në një proces arbitrazhi masat e sigurimit të kërkohen përpara se palët të kenë paraqitur parashtrimet e tyre që është edhe momenti ku zakonisht palët ngrenë pretendimet e tyre mbi kundërshtimin e juridiksionit. Pra, gjykata e arbitrazhit mund të përballet me kërkesën për sigurimin e padisë përpara se ajo të jetë shprehur mbi juridiksionin e saj, ose ndërkohë që juridiksioni i saj është duke u kundërshtuar. Në këto kushte edhe vetë gjykata e arbitrazhit nuk mund të ketë një opinion të saktë mbi bazueshmërinë e kundërshtimeve të juridiksionit, ndaj në këto kushte konsiderohet se është e mjaftueshme vetëm verifikimi *prima facie* i ekzistencës së juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit.<sup>479</sup>

Një qëndrim i tillë ka gjetur mbështetje jo vetëm nga doktrina e arbitrazhit ndërkombëtar,<sup>480</sup> por gjithashtu edhe në praktikën e arbitrazhit. Për shembull në çështjen *Perenco Ecuador Ltd. kundër Republic of Ecuador*<sup>481</sup> gjykata e arbitrazhit u shpreh se: “Ndërkohë që gjykata e arbitrazhit nuk është e detyruar të konfirmojë që ajo ka juridiksion për të vendosur mbi themelin e padisë me qëllim që të shprehet për kërkesën për sigurimin e padisë, ajo nuk mund të pranojë një kërkesë të tillë nëse nuk ka juridiksion të paktën *prima facie*.”

Po ashtu në çështjen *Quiborax SA kundër Plurinat’l State of Bolivia*<sup>482</sup> gjykata e arbitrazhit u shpreh se: “Është e pakundërshtuar nga palët që gjykata e arbitrazhit ka të drejtë të japë masë për sigurimin e padisë përpara se ajo të shprehet për juridiksionin. Megjithatë gjykata e arbitrazhit nuk mund të ushtrojë një kompetencë të tillë nëse nuk ka juridiksion *prima facie*.”

Fakti që njëra nga palët ka kundërshtuar juridiksionin e arbitrazhit nuk e pengon gjykatën e arbitrazhit për vendosjen e masës së sigurimit. Vlerësimi për plotësimin e këtij kriteri është i pavarur nga mendimi i gjykatës së arbitrazhit për juridiksionin e saj në lidhje me padinë e themelit. Kjo shprehet qartazi në çështjen *Tokios Tokelés vs. Ukraina*,<sup>483</sup> ku gjykata e arbitrazhit arsyeton, ndër të tjera, se: ““Rekomandimi” i masave të sigurimit, nuk paragjykon në asnjë mënyrë çështjen e juridiksionit. Prandaj, kjo gjykatë arbitrazhi do të duhet të vendosë mbi kundërshtimet e të paditurit mbi juridiksionin, në mënyrë të pavarur nga vendimi lidhur me masën e sigurimit.”

<sup>479</sup> D.Caron & L.Caplan, “The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary”, 2<sup>nd</sup> ed., 2013, fq. 523

<sup>480</sup> Julian D.M.Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 606, para. 23-68; Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 536 para. 626; Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2481; Shihata & Parra, “The experience of the International Center for the Settlement of Investments Disputes”, 14 ICSID Rrev. For. Inv. L.J. 1999, fq. 299, 326. D.Caron & L.Caplan, “The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary”, 2<sup>nd</sup> ed., 2013, fq. 523

<sup>481</sup> *Perenco Ecuador Ltd. kundër Republic of Ecuador*, Decision on Provisional Measures in ICSID Case no. ARB/08/6 of 8 May 2009, para. 39.

<sup>482</sup> *Quiborax SA kundër Plurinat’l State of Bolivia*, Decision on Provisional Measures in ICSID Case no. ARB/06/2 of 26 February 2010, para 108.

<sup>483</sup> “*Tokios Tokelés v. Ukraina*”, Çështja Nr. ARB/02/18, Urdhër Nr. 1, datë 1 Korrik 2003, fq. 4 para. 6.



Nëse gjykata e arbitrazhit gjykon *prima facie* që çështja e themelit nuk hyn në juridiksionin e saj nuk duhet të shprehet me vendim për masë sigurimi. Nëse gjykata e arbitrazhit gjykon *prima facie* se padia e themelit hyn në juridiksionin e saj, atëherë ajo mund të shprehet me vendim për masën e sigurimit. Nëse më vonë, pas shqyrtimit të çështjes së juridiksionit, gjykata e arbitrazhit konstaton se ajo nuk ka juridiksion për themelin e çështjes, atëherë bie dhe fuqia e vendimit për masë sigurimi e dhënë prej saj.

### 3.1.2. *Suksesi prima facie mbi themelin e padisë*

Ky kriter është i ngjashëm me kriterin *fumus boni juris*. Ai ka për qëllim të provojë se pala kërkuese ka me një probabilitet të arsyeshëm një çështje, ose në mënyrë alternative, të përcaktojë që padia nuk është e pabazë. Pra, gjykata e arbitrazhit duhet të shqyrtojë nëse kërkuesi ka një interes të ligjshëm në kërkesën e tij duke u kufizuar në shqyrtimin e themelit të padisë. Në një vendim të ICC gjykata e arbitrazhit është shprehur se: “Kërkuesi duhet të tregojë se ai ka *prima facie* një të drejtë kontraktuale apo ligjore për mbrojtjen e të cilës ka ngritur padinë.”<sup>484</sup> Pra, me sa duket kriteri për suksesin *prima facie* mbi themelin e padisë është ekzistenca e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje.

Qëndrimi i doktrinës dhe praktikës së arbitrazhit lidhur me aplikimin e këtij kriteri është i ndryshëm. Praktika e disa gjykatave ndërkombëtare të arbitrazhit ka qenë që sukcesi *prima facie* në themelin e çështjes në gjykim nuk ishte i nevojshëm të konsiderohej kur gjykata vendoste masën e sigurimit, për shkak se edhe një vlerësim paraprak i themelit të çështjes mund të rrezikonte paragjykimin e çështjes.<sup>485</sup> Edhe një pjesë e doktrinës ka mbështetur këtë qëndrim.<sup>486</sup> Disa autorë janë shprehur se mundësia e suksesit të themelit të çështjes qoftë dhe *prima facie* shumë rrallë luan rol në vendosjen ose jo të masave të sigurimit, sepse për të shmangur çdo paragjykim, arbitrat nuk preferojnë të shprehin pikëpamjet e tyre për themelin e çështjes përpara se ata të shqyrtojnë të paktën një sasi të konsiderueshme provash të paraqitura nga palët.<sup>487</sup>

Ndërkohë që një pjesë tjetër e praktikës<sup>488</sup> dhe e doktrinës<sup>489</sup> së arbitrazhit ndërkombëtar janë pro zbatimit të një kriteri të tillë për dhënien e masave të sigurimit. Me ndryshimet e 2006 edhe Ligji Model i UNCITRAL, neni 17A(1)(b), parashikon shprehimisht se pala që kërkon një masë sigurimi sipas nenit 17(2)(a)(b) duhet t’i provojë gjykatës së arbitrazhit që ekziston një mundësi e arsyeshme që pala kërkuese

<sup>484</sup> ICC Interlocutory award 10596, 2000 cituar në Ali Yesilirmak, *Provisional Measures in International Commercial Arbitration*, 2005, fq. 177, footnote 76.

<sup>485</sup> Donald Francis Donovan, “Provisional Measures in the ICJ and ICSID: Further dialogue and development”, botuar në *Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation*, The Fordham Papers, 2012, fq. 106, para. 2.

<sup>486</sup> Merills, *Interim measures of protection in the recent jurisprudence of the International Court of Justice*, 44 *Int’l Comp.L.Q.*, 1995, fq. 90, 114.; J. Lew, L. Mistelis & S. Kroll, *Comparative “International Commercial Arbitration”*, 2003 fq. 604, para. 23-62

<sup>487</sup> J. Lew, L. Mistelis & S. Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003 fq. 604, para. 23-62

<sup>488</sup> ICC Interim award 10937, YCA 2005, fq.83; ICC Interlocutory Award 10596, YCA 2005, fq. 69

<sup>489</sup> Blessing, “State Arbitrations: Predictably unpredictable solutions?” 22 *J. Int’l. Arb.*, 1993, q. 435; D.Caron & L. Caplan, “The Uncitral Arbitration Rules: A commentary”, 2<sup>nd</sup> ed., 2013, fq. 523; Yesilirmak, *Interim and Conservatory measures in ICC Arbitral Practice*, 11(1) *ICC Ct. Bull.*, 2000, fq. 31, 34; Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: *International Arbitral Procedures*, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2479; Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 536.

do të fitojë padinë e themelit. Përcaktimi i gjykatës së arbitrazhit në favor të kësaj mundësie, nuk do të prekë diskrecionin e gjykatës së arbitrazhit për të mbajtur qëndrimet e mëpasshme.

Born, një nga autorët që mbështet zbatimin e këtij kriteri shprehet se gjykatat e arbitrazhit duhet të konsiderojnë *prima facie* themelin e padisë, kur vendosin masa sigurimi. Një vlerësim *prima facie* i themelit të padisë nuk e paragjykon zgjidhjen e themelit të çështjes. Është një vlerësim i përkohshëm bazuar në prova të paplota. Nga ana tjetër, është thelbësore për gjykatën e arbitrazhit që të bëjë një vlerësim *prima facie* të çështjes me qëllim që vendimi për masën e sigurimit të jetë racional edhe nga pikëpamja tregtare.<sup>490</sup>

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit në lidhje me vlerësimin e çështjes *prima facie* nuk ka efekt *res judicata* dhe nuk e pengon gjykatën e arbitrazhit që të arrijë në një konkluzion të ndryshëm në vendimin përfundimtar të arbitrazhit mbi themelin e çështjes.<sup>491</sup> E thënë ndryshe, gjykata e arbitrazhit mund të vendosë një masë sigurimi në favor të palës paditëse dhe në fund të gjykimit të rrëzojë kërkesën e palës paditëse për themelin e padisë. Dhe nga ana tjetër mund të rrëzojë një kërkesë të paditësit për vendosje mase sigurimi dhe në fund të procesit të arbitrazhit të vendosi pranimin e padisë.

Edhe qëndrimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë deri vonë ka qenë i tillë që nuk vlerësonte suksesin *prima facie* të çështjes si një nga kriteret për vendosjen e masës së sigurimit. Në një opinion të ndarë në çështjen *Pulp Mills*<sup>492</sup> të kësaj Gjykate në vitin 2006, Gjyqtari Abraham i rekomandoi Gjykatës t'i kërkojë palës që kërkonte vendosjen e masës së sigurimit, që kjo e fundit të tregonte se kishte një "çështje bindëse". Për Gjyqtarin Abraham "pikëpamja e përhapur" që ka një "vizë të qartë ndarëse" mes ekzistencës dhe shtrirjes së të drejtave të mosmarrëveshjes - një çështje që nuk mund të konsiderohet edhe në baza *prima facie* përpara fazës së themelit të çështjes dhe nevojës për masa sigurimi, që duhet të vlerësojë gjykata "pa ndonjë mendim mbi themelin e argumenteve të parashtruara në procedurën kryesore" ishte vetëm virtuale. Gjyqtari Abraham arsyetoi se gjykata shtetërore ose gjykata e arbitrazhit nuk duhet të vendosin detyrime ndonjëherë nga palët, pa pasur një ide që ka "disa arsye për tu besuar" që pala kërkuese ka një ngritur një padi të vlefshme.<sup>493</sup>

Së fundmi, referuar propozimit të gjyqtarit Abraham, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (ICJ) ka pranuar si kriter për vlerësimin në vendosjen e masës së sigurimit edhe një sukses *prima facie* të çështjes. Kështu, në çështjen *Belgium vs. Senegal* në vitin 2009, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në vendimin e saj, ndër të tjera arsyetoi se: "Tagri i Gjykatës për të vendosur masa sigurimi do të ushtrohet vetëm nëse gjykata do të krijojë bindjen se të drejtat e pretenduara nga pala janë të paktën të besueshme."<sup>494</sup> Gjykata mund të vendosë dhënien e masave të sigurimit nëse dispozitat në të cilat mbështetet pala kërkuese duken, *prima facie*, se përbëjnë bazën ku do të

<sup>490</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2479

<sup>491</sup> Institutional Arbitration, Article-by-Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules. Edituar nga Rolf A. Schutz, 2013, fq. 1161, para. 501.

<sup>492</sup> <http://www.icj-cij.org/docket/files/135/11240.pdf>

<sup>493</sup> Donald Francis Donovan, "Provisional Measures in the ICJ and ICSID: Further dialogue and development", Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation, The Fordham Papers 2012, fq. 106, para 4.

<sup>494</sup> *Belgium vs. Senegal*, International Court of Justice, Request for the indication of provisional measures, datë 28 Maj 2009, fq. 12, para. 40, <http://www.icj-cij.org/docket/files/144/15149.pdf>

mbështetet juridiksioni i gjykatës” Ndërsa në çështjen *Costa Rica vs Nicaragua*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë u shpreh se: “Tagri i Gjykatës për të vendosur masa sigurimi do të ushtrohet vetëm nëse Gjykata do të krijojë bindjen se të drejtat e pretenduara nga pala janë të paktën të besueshme/bindëse dhe se ekziston një lidhje midis të drejtave objekt gjykimi dhe masave të sigurimit të kërkuara.”<sup>495</sup>

### 3.1.3. Urgjenca

Shumë autorë dhe gjykata arbitrazhi kanë deklaruar se marrja e masave të sigurimit kërkon që të përmbushet kriteri “urgjencë”.<sup>496</sup> Urgjenca është një kriter *sine qua non* për masat e sigurimit.<sup>497</sup> Ky kriter është ngushtësisht i lidhur me kriterin tjetër, atë të dëmit të pariparueshëm dhe thelbësor. Termi urgjencë, lidhur me vendosjen e masave të sigurimit në arbitrazh do të thotë që masa duhet marrë menjëherë me qëllim që t’i parandalojë një dëm të pariparueshëm paditësit nëse masa nuk vendoset në kohë. Ai është formuluar si nevoja për të dhënë një masë sigurimi sa më shpejt të jetë e mundur pa pritur vendimin e themelit.<sup>498</sup> Pra, gjykimi i nivelit të dëmit të pariparueshëm apo thelbësor bëhet gjithmonë duke përlllogaritur dëmin që mund t’i shkaktohet palës deri në dhënien e vendimit përfundimtar të arbitrazhit. Një nivel urgjence është i kërkueshëm me qëllim që të jepet masa e sigurimit. Por pavarësisht parashikimeve të ndryshme, ajo që duhet të marrë në konsideratë nga gjykata e arbitrazhit është urgjenca krahasuar me përfundimin e procedurës dhe dhënien e vendimit përfundimtar.<sup>499</sup>

Masa e saktë e urgjencës që kërkohet për dhënien e një mase sigurimi është e ndryshme në varësi të çështjes konkrete. Urgjenca është një kërkesë që nuk mund të interpretohet literalisht apo mekanikisht, por duhet të bazohet në vlerësimet pragmatike të mundësisë dhe rrezikut.

Në lidhje me këtë kuptim të “urgjencës” në dhënien e masave të sigurimit në arbitrazh, është konsoliduar edhe qëndrimi i gjykatave të arbitrazhit. Në çështjen *Tokios Tokelès vs. Ukraine*, gjykata e arbitrazhit (ICSID) ka pranuar kërkesën e Tokios Tokelës për caktimin e masave të sigurimit, duke arsyetuar se: “Për vendosjen e masave të sigurimit kërkohet që masa të jetë e nevojshme për mbrojtjen e të drejtës së palës dhe kjo nevojë të jetë urgjente. Masa e sigurimit është e nevojshme kur veprimet e palës “shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë dëm të pariparueshëm të të drejtave përkatëse”. Një masë sigurimi është urgjente kur “ka të ngjarë të ndërmerren veprime të dëmshme për të drejtat e palës përpara marrjes së vendimit përfundimtar të gjykatës.”<sup>500</sup>

<sup>495</sup> *Costa Rica v. Nicaragua*, Request for the indication of provisional measures, international court of justice, date 8 Mars 2011, faqe 2, paragrafi 5, <http://www.wicj-cij.org/docket/files/150/16322.pdf>

<sup>496</sup> Lew, Commentary on Interim and Conservatory measures in ICC Arbitration cases, 11(1) ICC Ct.Bull., 2000, fq. 23, 27; Yesilirmak, Interim and Conservatory measures in ICC Arbitral Practice, 11(1), ICC Ct. Bull. 2000, fq. 31, 34; Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, Comparative Law of International Arbitration, 2007, fq. 536; ICC award 8113, ICC Bul.2000, vol 11/1, fq.67; ICC Award 8766 ICC Bul. 2000, vol 11/1, fq. 83; ICC Interim Award 10973, YA 2005, fq. 82; ICC Interlocutory Award 10596, YA 2005, fq.72-73.

<sup>497</sup> Kaj Hober, “Interim Measures by Arbitrators” publikuar në “International Arbitration 2006 Back to Basics?” Botim i ICCA, Edituar nga Albert Jan Van Den Berg, fq. 736, para. 5.

<sup>498</sup> Schwartz, The practices and experiences of the ICC Court in ICC, Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration, 1993, fq. 45, 60.

<sup>499</sup> Institutional Arbitration, Article-by-Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules, edituar nga Rolf A. Schutz, 2013, fq. 141, para. 576

<sup>500</sup> “*Tokios Tokelès v. Ukraine*”, Case No. ARB/02/18, Order No. 3, date 18 Janar 2005, fq. 5, para. 8.

Në çështjen *City Oriente Limited vs. Ecuador and Empresa Estatal Petroleos Del Ecuador (PetroEcuador)*, në të cilën, gjykata e arbitrazhit (ICSID) në vendimin e saj, pranoi kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit duke analizuar se: “është e dukshme që masa e sigurimit është e përshtatshme, sepse është e pamundur për të pritur dhënien e vendimit përfundimtar të arbitrazhit.”<sup>501</sup>

Po ashtu në çështjen *Quiborax S.A., Non Metallic Minerals S.A. and Fosk Kaplun vs. Plurinational State of Bolivia*, gjykata e arbitrazhit vendosi të pranojë kërkesën e paditësave dhe të marrë masën e sigurimit duke arsyetuar ndër të tjera se: “kriteri i urgjencës është i plotësuar kur një çështje nuk mund të presë vendimin përfundimtar të arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.”<sup>502</sup>

Në çështjen *Occidental Petroleum kundër The Republic of Ecuador*, gjykata e arbitrazhit (ICSID) vendosi të mos e pranojë kërkesën e paditësit për vendosjen e masës së sigurimit duke arsyetuar se: “Është e përcaktuar qartë se masat e sigurimit duhet të jepen vetëm në situatat e nevojës dhe urgjencës në mënyrë që të mbrohen ato të drejta, që në mungesë të masave të tilla, mund të humbasin. Me fjalë të tjera rrethanat në të cilat kërkohen masat e sigurimit sipas nenit 47 të Konventës së ICSID janë ato në të cilat masat e sigurimit janë të nevojshme për të ruajtur të drejtat e një pale dhe kur ekziston nevoja urgjente për të shmangur një dëm të pariparueshëm.”<sup>503</sup>

Ndërkohë, pavarësisht se kriteri i urgjencës është i gjithëpranuar nga praktika dhe doktrina e arbitrazhit ndërkombëtar, Ligji Model i UNCITRAL, edhe në ndryshimet e vitit 2006 nuk shprehet për kriterin “urgjencë” në vendosjen e masave të sigurimit. Në hartimin e Ligjit Model, në grupet e punës është propozuar dhe diskutuar futja e kriterit “urgjencë”, krahas kriterëve të tjera për vendosjen e masave të sigurimit, megjithatë pas diskutimeve të shumta është rënë dakord që të pranohet ideja e shumicës, sipas së cilës, urgjenca është më shumë e lidhur me dëmin e pariparueshëm dhe thelbësor, sesa me kohën. Nëse gjykata bindet se një dëm i pariparueshëm mund t'i ndodhë një palë, atëherë me urgjencë urdhëron masën e duhur të sigurimit.<sup>504</sup> Në mungesë të një parashikimi të shprehur të kriterit të urgjencës lidhur me marrjen e masave siguroese në Ligjin Model të UNCITRAL, autorë të ndryshëm kanë interpretuar se: “Vetë termi “e nevojshme” ka brenda tij nocionin që pala që kërkon masën siguroese pëson një dëm të tillë të të drejtës, mbrojtjen e së cilës e ka kërkuar me proces arbitrazhi, që është aq i shpejtë sa pala kërkuese nuk mund të presë vendimin përfundimtar të arbitrazhit,”<sup>505</sup> apo “kriteri i urgjencës duhet gjithsesi të nënkuptohet në kërkesën e Ligjit Model të UNCITRAL për dëm serioz, sepse në fakt vetë koncepti i masave të sigurimit kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një mase të caktuar urgjence.”<sup>506</sup>

---

<http://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0865.pdf>

<sup>501</sup> *City Oriente Limited v Ecuador and Empresa Estatal Petróleos del Ecuador (Petroecuador)*, ICSID Case No. ARB/06/21, IIC 308 (2007), 24th October 2007, Decision on Provisional Measures, fq. 14, para. 67, <http://italaw.com/documents/CityOrient-ProvisionalMeasures-EN.pdf>.

<sup>502</sup> *Guiborax s.a., Non Metallic Minerals s.a. and Allan Fosk Kaplun v. Plurinational State of Bolivia*, ICSID Case No. ARB/06/2, Decision on Provisional Measures, date 26 Janar 2010, fq. 42, para. 150; <http://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0698.pdf>

<sup>503</sup> “*Occidental Petroleum Corporation Occidental Exploration and Production Company v. The Republic of Ecuador*”, ICSID Case No. ARB/06/11, DECISION ON PROVISIONAL MEASURES, datë 17 Gusht 2007 fq. 27, para.59; <http://italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0576.pdf>.

<sup>504</sup> *Arbitration International. LCIA, Volume 29, No.1.*” A guide to Interim Measures in Investor-State Arbitration, Caline Mouawad & Elizabeth Silbert, faqe 387, footnote 30.

<sup>505</sup> Huntley, “The Scope of Article 17: Interim measures under the UNCITRAL Model Law”, 740 *PLI/Lit.* 1181,75, 2005.

<sup>506</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2475.

### 3.1.4. Dëm i pariparueshëm ose thelbësor

Në mënyrë që gjykata e arbitrazhit të urdhërojë një masë sigurimi duhet që të ekzistojë një rrezik i menjëhershëm për dëmtimin e të drejtës nëse masa nuk merret para se të jepet vendimi përfundimtar që zgjidh themelin e mosmarrëveshjes. Ky kriter është i ngjashëm me “*periculum in mora*”.<sup>507</sup> Interpretimi i këtij kriteri ndryshon nga njëri sistem në tjetrin. Kështu në praktikën e arbitrazhit ndërkombëtar ndeshim raste ku gjykatat e arbitrazhit kërkojnë nga pala që kërkon marrjen e masës së sigurimit të provojë se ekziston rreziku i shkakimit të një dëmi “pariparueshëm” dhe raste të tjera një dëmi “serioz”, apo “thelbësor”, nëse masa e sigurimit nuk merret.<sup>508</sup>

Konceptet “dëmi i pariparueshëm” apo “dëm thelbësor” ndryshojnë nga njëri-tjetri. Zakonisht një dëm “i pariparueshëm”, sipas traditës së *common law* është ai dëm që nuk mund të kompensohet me një vendim për dëmshpërblim monetar. Ndërkohë që një dëm “serioz”, apo “thelbësor” nuk kërkon domosdoshmërisht që dëmi të jetë i pariparueshëm. Gjykatat e arbitrazhit në përgjithësi kërkojnë që të tregohet vetëm rreziku i një dëmi “serioz” ose “thelbësor”, pa kërkuar që ky dëm të jetë domosdoshmërisht “i pariparueshëm” duke interpretuar se në të drejtën ndërkombëtare koncepti “dëmi i pariparueshëm” është më i gjerë se koncepti Anglo-Amerikan, ndaj nuk është e nevojshme që pala e dëmtuar të provojë që dëmi i saj nuk është i riparueshëm me dhënien e vendimit përfundimtar të arbitrazhit.<sup>509</sup> Kjo për faktin se është shumë e vështirë të provosh që një dëm të mund të jetë i pariparueshëm në vlerë monetare me dhënien e vendimit përfundimtar të arbitrazhit. Disa shembuj se kur mund të ndodhë një dëm i pariparueshëm janë rastet në të cilat një biznes mund të falimentonte, kur mund të humbiste ndonjë provë thelbësore, kur mund të humbej ndonjë mundësi për lidhjen e një kontrate me vlerë të madhe, apo kur mund të dëmtohej reputacioni i biznesit për shkak të shkeljes së të drejtave që rrjedhin nga marka tregtare.<sup>510</sup> Nëse do të pranohej interpretimi i ngushtë i termit dëm i “pariparueshëm” dhënia e masave të sigurimit do të kufizohej vetëm në rastet e sipërpërmendura. Ndaj disa autorë sugjerojnë që termi “dëm i pariparueshëm” duhet kuptuar në sensin ekonomik dhe jo literal të fjalës.<sup>511</sup>

Një interpretim të gjerë të termit dëm i “pariparueshëm” e ndeshim edhe në çështjen *Sergei Paushok vs. The Government of Mongolia*, ku gjykata e arbitrazhit (UNCITRAL) vendosi të pranojë kërkesën e paditësit për marrjen e masës së sigurimit me arsyetimin se: “Mundësia e kompensimit monetar jo domosdoshmërisht eliminon nevojën e mundshme për vendosjen e masave të sigurimit. Në të drejtën ndërkombëtare, koncepti “dëme të pariparueshme” nuk kërkon domosdoshmërisht që dëmi për të cilin është paraqitur ankesa, të mos jetë i riparueshëm nëpërmjet dëmshpërblimit. Vlen të përmendet në këtë drejtim se Ligji Model i UNCITRAL në Nenin 17<sup>512</sup> të tij nuk kërkon nga pala kërkuuese të tregojë dëm të pariparueshëm, por

<sup>507</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 180, footnote 89.

<sup>508</sup> Idem, fq. 2469

<sup>509</sup> Behring Int. l, Inc. v. Islamic Republic of Iran, Interim and Interlocutory Award in IUCST case no. ITM/ITL 52382-3 of 21 June 1985

<sup>510</sup> D. Caron & L. Caplan, *The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary* 521 n.45 (2<sup>nd</sup> ed. 2013).

<sup>511</sup> Julian D.M. Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, para. 23-65.

<sup>512</sup> Ligji Model i UNCITRAL, nuk kërkon domosdoshmërisht një dëm të pariparueshëm. Sipas nenit 17A(1)(a) të tij: “Pala që kërkon një masë sigurimi sipas nenit 17(2)(a)(b) duhet t’i provojë gjykatës së arbitrazhit që, dëmi nuk mund të riparohet në mënyrën e duhur me dhënien e vendimit final të

thjesht se “dëmi i pariparueshëm” në mënyrën e duhur nëpërmjet kompensimit ka të ngjarë të rezultojë në rast se masa e sigurimit nuk është urdhëruar, dhe një dëm i tillë substancialisht tejkalon dëmin që ka të ngjarë t’i shkaktohet palës kundër të cilës është drejtuar masa, nëse një masë e tillë është dhënë.”<sup>513</sup>

Ndërkohë që në realitet shumica e vendimeve që thonë se dëmi duhet të jetë “i pariparueshëm” nuk duket se aplikojnë këtë formulë, por në vend të saj, kërkojnë që të ketë një rrezik të dëmit serioz të palës që e kërkon atë.<sup>514</sup> Megjithatë ka dhe shumë çështje në të cilat gjykatat e arbitrazhit kanë zbatuar standardin e dëmit të “pariparueshëm” në mënyrë literale. Kështu, në çështjen *Plama Consortium Limited vs. Bulgaria*,<sup>515</sup> gjykata e arbitrazhit (ICSID) pasi shqyrtoi çështjen vendosi të mos e pranojë kërkesën për masë sigurimi nga Plama duke arsyetuar se: “Gjykata e gjen të pabazuar si nevojën urgjente për masë sigurimi, ashtu edhe faktin që përmendet natyra “e pariparueshme” e dëmit për të justifikuar këto masa. Ajo çka paditësi kërkon në këtë gjykim arbitrazhi janë dëmet monetare për shkeljet e detyrimeve të të paditurit ...Gjykata pranon argumentin e të paditurit se dëmi nuk është i pariparueshëm në qoftë se mund të kompensohet me dëmshpërblim, siç është rasti në këtë gjykim arbitrazhi...”

Gjithashtu në çështjen *Victor Pey Casado y Fundacion Presidente Allende v. Republica de Chile*,<sup>516</sup> gjykata e arbitrazhit u shpreh se paditësi nuk tregoi dëm të pariparueshëm kur asetet objekt konflikti mund të riktheheshin ose të kompensoheshin me para. Po të njëjtin qëndrim e ndeshim edhe në çështjen *Islamic Republic of Iran v. USA*<sup>517</sup> ku gjykata e arbitrazhit u shpreh se dëmi që mund të dëmshpërblehet monetarisht në tërësi me vendimin përfundimtar nuk është dëm i pariparueshëm.

Nga sa më sipër duket që standardi tradicional i gjykatave të arbitrazhit pranë ICSID është që të mos vendosin masa sigurimi kur dëmi mund të kompensohet me vendimin përfundimtar të arbitrazhit, ndryshe nga standardi që ka vendosur Ligji Model i UCITRAL, pra standardin e një dëmi që nuk mund të riparohet në mënyrën e duhur. Edhe jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) bën një dallim mes:

- (a) Kërkesave që mund të pranohen, sepse efektet e tyre, nëpërmjet kompensimit financiar, janë të tilla që kompensimi nuk mundet të rikuperojë dëmin e shkaktuar; dhe
- (b) Kërkesave që mund të provojnë shumë mirë që u është shkelur një e drejtë dhe i është shkaktuar një dëm, por në lidhje me to, vendimi përfundimtar i

---

arbitrazhit, nëse masa e sigurimit nuk merret dhe ky dëm substancial është më i madh se dëmi që mund t’i shkaktohet palës kundër së cilës drejtohet masa, nëse masa e përkohshme do të vendoset” Fjala “e duhur” në këtë dispozitë merr vlerë të veçantë dhe do të thotë se nuk duhet domosdoshmërisht që dëmi të mos mund të riparohet, por do të thotë që dëmi të mos mund të riparohet në mënyrën e duhur.

<sup>513</sup> *Sergei Paushok, CJSC Golden East Company and CJSC Vostokneftegaz Company v. The Government of Mongolia*, UNCITRAL, ORDER ON INTERIM MEASURES, datë 2 Shtator 2008, fq. 12, par. 68,69; <http://italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0621.pdf>

<sup>514</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2471

<sup>515</sup> *Plama Consortium Limited v. Republic of Bulgaria*, ORDER (ICSID Case No. ARB/03/24), datë 27 Gusht 2008, fq. 15, paragrafi 46, <http://italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0670.pdf>.

<sup>516</sup> *Victor Pey Casado y Fundacion Presidente Allende v. Republica de Chile*, Decision on provisional measures in ICSID case no. ARB/98/2 of 25 Septemebr 2001

<sup>517</sup> *Islamic Republic of Iran v. USA*, Decision in IUCST Case no. DEC 85 BI-FT of 18 May 1989, para. 10.

arbitrazhit për dëmet është i mjaftueshëm dhe nuk është nevoja për masa sigurimi.<sup>518</sup>

### 3.1.5. Proporcionaliteti ose “balanca e interesave”

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë, gjykata e arbitrazhit në konstatimin e ekzistencës së dëmit serioz apo të pariparueshëm duhet të konsiderojë:<sup>519</sup>

- a. Sa serioz është dëmi që do t'i shkaktohet paditësit gjatë procedurës së arbitrazhit nëse nuk merret masa e sigurimit;
- b. Sa mund të kompensohet ky dëm me dhënien e vendimit përfundimtar;
- c. Sa e drejtë është barra apo rreziku i dëmit gjatë procesit të arbitrazhit që i vendoset apo shkaktohet njëerës apo tjetrës palë.

Pikërisht kjo konsideratë e fundit njihet ndryshe si balanca e dëmeve mes palëve, ose “balanca e interesave”. Pra, për të konsideruar dëmin e pariparueshëm ose serioz, duhet marrë në konsideratë edhe dëmi që i shkaktohet palës tjetër nga vendosja e kësaj mase sigurimi. Pavarësisht provueshmërisë shumë të mirë që mund të bëjë pala paditëse për dëmin që asaj mund t'i shkaktohet, nëse dëmi që i shkaktohet palës kundër së cilës drejtohet masa është më i madh, atëherë kjo masë sigurimi nuk mund të merret. Gjykatat e arbitrazhit duhet të bëjnë një vlerësim të masave të dëmeve që mund t'u shkaktohen të dyja palëve. Dëmi që mund të shkaktohet nga vendosja e masës sigurore duhet të jetë proporcionale me avantazhet që paditësi synon të ketë prej saj.<sup>520</sup>

Një kriter i tillë parashikohet shprehimisht nga ligji Model i UNCITRAL, sipas të cilit: “Pala që kërkon një masë sigurimi sipas nenit 17(2)(a)(b) duhet t'i provojë gjykatës së arbitrazhit që, dëmi nuk mund të riparohet në mënyrën e duhur me dhënien e vendimit përfundimtar të arbitrazhit, nëse masa e sigurimit nuk merret dhe ky dëm substancial është më i madh se dëmi që mund t'i shkaktohet palës kundër së cilës drejtohet masa, nëse masa e sigurimit do të vendoset”<sup>521</sup> Neni 26(3) i Rregullave të UNCITRAL është njësoj si neni 17A(1)(a) të Ligjit Model të UNCITRAL.

Në çështjen *Sergei Paushok vs. The Government of Mongolia*, gjykata e arbitrazhit vendosi të pranojë kërkesën e paditësit për marrjen e masës së sigurimit me arsyetimin se:

“Ligji Model i UNCITRAL në Nenin 17 të tij nuk kërkon nga pala kërkuese të demonstrojë dëm të pariparueshëm, por thjesht se “dëmi i pariparueshëm në mënyrën e duhur nëpërmjet kompensimit ka të ngjarë të rezultojë në rast se masa e sigurimit nuk është urdhëruar, dhe një dëm i tillë substancialisht tejkalon dëmin që ka të ngjarë t'i shkaktohet palës kundër të cilës është drejtuar masa, nëse një masë e tillë është dhënë”

<sup>518</sup> Donald Francis Donovan, “Provisional Measures in the ICJ and ICSID Further Dialogue and Development”, *Contemporary issues in International Arbitration and Mediation*, The Fordham Papers 2012, fq. 105 para. 3.

<sup>519</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: *International Arbitral Procedures*, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2471

<sup>520</sup> Berger, “International Economic Arbitration”, Kluwer Law and Taxation Publishers, 1993, fq. 336-337; Julian D.M.Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, para. 23-65; Shiko gjithashtu *MAT Cie d'Electricite de Sofia et de Bulgarie (Belgium v Bulgaria)*, 1922, 2 TAM fq. 924, 926-927.

<sup>521</sup> Neni 17A(1)(a) i Ligjit Model të UNCITRAL.

Në zbatimin e këtij kriteri gjykata e arbitrazhit duhet të shqyrtojë me kujdes ndarjen e riskut ndërmjet palëve në momentin e nënshkrimit të kontratës, ose nëse ky risk ka ndryshuar gjatë zbatimit të kontratës, në kohën kur lind mosmarrëveshja. Për të përcaktuar ndarjen e një risku të tillë, gjykata e arbitrazhit duhet të shohë kushtet e kontratës, dhe nëse ato heshtin, ka shumë mundësi që ajo të bëjë një interpretim të përgjithshëm të kontratës.<sup>522</sup> Një interpretim i tillë i përgjithshëm i kontratës mund të tregojë për shembull se palët kishin prezumuar dhe pranuar në kontratën mes tyre një risk të konsiderueshëm dhe të pambuluar dhe nëse gjykata arrin në një konkluzion të tillë, do të ishte shumë e vështirë të justifikohesh dhënia e një mase sigurimi që mund të ketë efekte të mëdha. Në të kundërt, nëse interpretimi i frymës së përgjithshme të kontratës tregon që palët ishin përpjekur të kufizojnë riskun e tyre dhe kishin parashikuar vetë një sërë mjetesh mbrojtëse, atëherë gjykata e arbitrazhit ka mundësi që të urdhërojë një masë sigurimi, nëse rrethanat kanë bërë që risku të shkojë përtej kufijve që janë pranuar në kontratë.<sup>523</sup>

### 3.2. *Kriteret negative*

Përveç mungesës së kriterëve pozitive të diskutuara më sipër, ekzistenca e ndonjë prej gjashtë kriterëve negative që do të trajtohen më poshtë mund të çojë në refuzimin e kërkesës për sigurim padie.

- i. Shqyrtimi i kërkesës për sigurim padie nuk duhet të kërkojë shqyrtimin e themelit të padisë (mosparagjykimi i themelit të çështjes);
- ii. Gjykata e arbitrazhit nuk mund të japë si masë sigurimi atë që kërkohet me padinë e themelit;
- iii. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur pala kërkuese nuk i ka “duart e pastra” (vepron në keqbesim);
- iv. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa nuk mund të zbatohet;
- v. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa e kërkuar nuk mund të parandalojë dëmin e pretenduar;
- vi. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa që kërkohet nuk ka më vlerë.<sup>524</sup>

#### 3.2.1. *Mosparagjykimi i themelit të padisë*

Masat e sigurimit nuk duhet të paragjykojnë themelin e padisë objekt gjykimi. Ky është një kriter që duket se aplikohet gjerësisht, megjithëse lidhur me kuptimin e drejtë të tij është e paqartë nëse ky kusht nënkupton që gjykata e arbitrazhit duke vendosur një masë sigurimi nuk duhet të paragjykojë vendimin përfundimtar të arbitrazhit për themelin e padisë apo që gjykata e arbitrazhit nuk duhet të vendosë me masën e sigurimit atë që kërkohet nëpërmjet padisë së themelit.<sup>525</sup> Ka autorë që kuptimin e këtij kriteri e lidhin me rastin e dytë, pra, mosdhënien e një mase sigurimi të njëjtë me atë që kërkohet nëpërmjet padisë,<sup>526</sup> dhe të tjerë që e lidhin me rastin e

---

<sup>522</sup> Bin Cheng, “General Principles of Law as Applied by International Courts and Tribunals”, London: Stevens, 1953, fq. 273

<sup>523</sup> Blessing, “Introduction to Arbitration”, Swiss and International Perspectives, 1999, para. 859

<sup>524</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 182-183

<sup>525</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2477

<sup>526</sup> Julian D.M.Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, para. 23-64



parë, pra që gjykata e arbitrazhit duhet të kujdeset që mos paragjykojë themelin e padisë kur vendos për dhënien e një mase sigurimi.<sup>527</sup>

Ndërkohë sipas Born, kriteri i mosparagjykimit të padisë qëndron në propozimet që:<sup>528</sup>

- a. vendosja e një mase sigurimi, nuk e pengon gjykatën e arbitrazhit që në vendimin përfundimtar të arbitrazhit të marrë çdo lloj vendimi që i duket i drejtë, pa marrë fare parasysh se si ka vendosur në lidhje me masën e sigurimit;
- b. masat e sigurimit nuk kanë efekt *res judicata* në lidhje me vendimin e themelit;
- c. gjykata e arbitrazhit duhet të bëjë kujdes, kur vendos masa sigurimi duhet të marrë në konsideratë parashtresat e të dyja palëve dhe të mos i mohojë asnjërës nga palët mundësinë për t'u dëgjuar në procedurën e arbitrazhit të mëposhme;
- d. nëpërmjet një mase sigurimi mund të vendoset edhe ajo që kërkohet me padinë e themelit, duke mos mohuar mundësinë që kjo masë të mund të ndryshohet gjatë procedurës së arbitrazhit.

### 3.2.2. *Gjykata e arbitrazhit nuk mund të japë si masë sigurimi atë që kërkohet me padinë e themelit*

Gjykata e arbitrazhit nuk mund të japë si masë sigurimi atë që kërkohet me padinë e themelit. Edhe në lidhje me këtë kriter doktrina dhe praktika e arbitrazhit ndërkombëtar është e ndarë. Disa autorë dhe gjykata arbitrazhi kanë mbajtur qëndrimin që nuk mund të jepet një masë sigurimi që është identike me atë që kërkohet të vendoset me vendimin përfundimtar.<sup>529</sup> Për shembull në çështjen *Behring International, Inc vrs Iranian Air Force*, gjykata e arbitrazhit refuzoi dhënien e masës së sigurimit të kërkuar nga i padituri, përkatësisht transferimin e posedimit, kujdestarisë dhe kontrollit të mallrave të magazinuar..., sepse kjo do të ishte e barazvlefshme me pranimin e kërimit të të paditurit në kundërpadinë e tij.

Të tjerë autorë, pranojnë që në parim gjykata e arbitrazhit nuk mund të japë si masë sigurimi atë që kërkohet me padinë e themelit, megjithatë pranojnë se ka raste kur masa e sigurimit është e pamundur të mos urdhërohet për një pjesë të asaj që kërkohet me vendimin përfundimtar të arbitrazhit. P.sh. kur masa ka për qëllim që të ndalojë kryerjen e një shitje kuotash një pale të tretë derisa të jepet vendimi përfundimtar i arbitrazhit, dëmi që mund të shkaktohet mund të jetë i pariparueshëm në mënyrën e duhur, sepse një palë tjetër merr nën kontroll kompaninë.<sup>530</sup>

Ndërsa Born lidhur me këtë kriter shprehet se ai është shumë i ekzagjuar. Mund të ketë raste ku masa e sigurimit kërkon të arrijë, në mënyrë të përkohshme, derisa të jepet vendimi përfundimtar, të njëjtën gjë që kërkohet me vendimin përfundimtar, si p.sh. vazhdimi i një kontrate afatgjatë, pavarësisht pretendimit për përfundimin e saj, ruajtjen e kontrollit mbi një pasuri etj. Këto lloj masash që synojnë të ruajnë *status*

<sup>527</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq.183

<sup>528</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2477-2478

<sup>529</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 184-185; *Behring International, Inc vrs Iranian Air Force*, Case no 382, Interim Award no. ITM 46-382-3, 22 shkurt 1985.

<sup>530</sup> Julian D.M. Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", 2003, 23-64, footnote 78.

quo, i japin palës që i kërkon gati të njëjtën gjë që kërkohet me vendimin përfundimtar. Gjithsesi kjo nuk duhet të pengojë dhënien e masës siguruese.<sup>531</sup>

### 3.2.3. *Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur pala kërkuese nuk i ka “duart e pastra” (vepron në keqbesim)*

Ky kriter është i qartë dhe është përdorur në disa raste për të refuzuar dhënien e një mase sigurimi. Kështu në një çështje të ICC<sup>532</sup> kërkesa e paditësit për masë sigurimi u refuzua nga gjykata e arbitrazhit, e cila argumentoi se: “vendimi nëse do të jepet apo jo një masë siguruese është në diskrecion të gjykatës së arbitrazhit para së cilës një masë e tillë kërkohet. Zakonisht, gjykata e arbitrazhit nuk jep një masë sigurimi nëse zbulon që kërkuesi nuk po vepron me mirëbesim. (nuk i ka duart e pastra). Ne pamë se paditësi e kishte zbuluar prodhimin dhe shitjen e produkteve nga i padituri në vitin 1991. Paditësi, duke pasur dijeni për këtë, për më shumë se dy vjet, vetëm në 1993 pretendoi shkelje të kontratës së distribucionit dhe njoftoi zgjidhjen e saj. Ndërkohë paditësi aktivisht kërkoi dhe siguroi në 1991 një investim shtesë prej 5.000.000 US \$ nga i padituri. Në këto rrethana, ne vendosim që tani paditësi nuk mund të pretendojë që ai ka të drejtën e një mase sigurimi që e ndalon të paditurin të prodhojë dhe shesë produktet e paditësit.”

### 3.2.4. *Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa nuk mund të zbatohet*

Në përgjithësi, arbitrat tregojnë kujdes për të siguruar që masa e sigurimit e dhënë prej tyre të jetë e mundshme për tu zbatuar.<sup>533</sup> Gjithashtu, arbitrat nuk duan të humbasin kohë dhe të vonojnë procesin e arbitrazhit kur ka gjasa që masa që ata do të japin nuk do të mund të zbatohet.<sup>534</sup> Për shembull në një çështje të ICC,<sup>535</sup> paditësit pasi i revokuan licencat mbi të drejtat minerare nga shteti X, aplikoi për masë sigurimi duke kërkuar ndalimin e shtetit X të transferojë të drejta minerare në çdo pjesë të territorit që mbulohej nga licencat përkatëse. Pavarësisht paraqitjes së kësaj kërkesë për masë sigurimi, gjykata e arbitrazhit nuk u shpreh për të deri në vendimin përfundimtar duke arsyetuar se ajo nuk mund të shprehej për një kërkesë të tillë, sepse po të kishte dhënë masën siguruese ajo nuk do të kishte mundur të monitoronte asnjë urdhër të dhënë.”

### 3.2.5. *Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa e kërkuar nuk mund të parandalojë dëmin e pretenduar*

Për aq kohë sa masat e sigurimit kanë për qëllim të mbrojnë përkohësisht të drejtën objekt konflikti, apo të shmangin ndonjë dëm të mundshëm të kësaj të drejte, ato duhet që të paktën në pamje të parë të jenë të afta t’i shërbejnë këtij qëllimi.<sup>536</sup>

---

<sup>531</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2477

<sup>532</sup> ICC Partial Award 7972 i 1997 cituar në Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 186

<sup>533</sup> Schwartz, “The practices and experiences of the ICC Court in ICC, Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 62

<sup>534</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 186

<sup>535</sup> ICC Final Award 7210 i 1994, ICC 11(1), Int’l Ct Arb 2000, fq. 49-52

<sup>536</sup> Schwartz, “The practices and experiences of the ICC Court in ICC, Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 62

### 3.2.6 *Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa që kërkohet nuk ka më vlerë*

Është e kuptueshme që kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa që kërkohet nuk ka më vlerë. I tillë ka qenë rasti në çështjen *Iran v. United States*<sup>537</sup> ku paditësi i kërkoi gjykatës së arbitrazhit të ndalojë shitjen publike të naftës nukleare që pretendon se i përket. Megjithatë nafta ishte shitur përpara se gjykata e arbitrazhit të shqyrtonte kërkesën për masën e sigurimit ndaj kjo kërkesë nuk u pranua.

### 3.3. *Garancia*

Ndonjëherë dhënia e masave të sigurimit kushtëzohet nga vendosja e një garancie nga pala që kërkon një masë të tillë me qëllim për të dëmshtëpërblyer palën tjetër në rast se rezulton që vendosja e masës siguroese ishte e padrejtë. Kjo për shkak se masa e sigurimit bazohet në një shqyrtim të përmbledhur të fakteve dhe ligjit, për efekt të shqyrtimit *prima facie* të juridiksionit dhe suksesit të çështjes. Por ka mundësi që rezultati i këtij rishikimi të ndryshojë gjatë apo në fund të procesit.<sup>538</sup>

Shumica e rregulloreve të arbitrazhit dhe ligjeve të arbitrazhit parashikojnë mundësinë e gjykatës së arbitrazhit që të mund t'i kërkojë palës që kërkon vendosjen e masës së sigurimit të ofrojë një garanci me qëllim që nëse në një kohë të mëvonshme, masa e sigurimit konsiderohet nga gjykata e arbitrazhit se është vënë në mënyrë të padrejtë, të mund të dëmshtëpërblehet pala kundër së cilës është vënë masa e sigurimit. Për shembull Ligji Model i UNCITRAL parashikon në neni 17E se: "(1) Gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë nga pala që kërkon një masë sigurimi dhënien e garancisë së duhur në lidhje me masën."

Ligji gjerman i arbitrazhit, në nenin 1041 (1)(4) i njuh të drejtën gjykatës së arbitrazhit, që nëse nuk është parashikuar ndryshe nga palët, me kërkesë të palës, (1) ajo mund të vendosi ato masa sigurimi që gjykata e arbitrazhit i konsideron të nevojshme në lidhje me çështjen objekt gjykimi. Gjykata e arbitrazhit mund t'i kërkojë secilës palë të japë garanci në lidhje me këtë masë. Nëse provohet që masa e sigurimit ka qenë e pajustificuar, pala në favor të së cilës është ekzekutuar masa, është e detyruar të kompensojë palën tjetër për dëmin që i është shkaktuar asaj nga ekzekutimi i kësaj mase ose për dhënien e garancisë me qëllim shmangien e ekzekutimit.

Rregullorja e DIS parashikon në nenin 20.2. se "...gjykata e arbitrazhit mundet, me kërkesë të palës, të urdhërojë masa sigurimi ..... Gjykata e arbitrazhit mund t'i kërkojë secilës palë që të japë një garanci të përshtatshme në lidhje me këtë masë."

Rregullorja e LCIA parashikon në nenin 25.2 se: "...gjykata e arbitrazhit ka kompetencë që me kërkesë të cilësdo palë (a) të urdhërojë çdo palë të paditur sipas një padie apo kundërpadie të japë garanci për të gjithë ose një pjesë të vlerës së padisë, nëpërmjet një depozite apo garancie bankare ose në çdo mënyrë tjetër dhe sipas kushteve që gjykata e arbitrazhit mund t'i konsiderojë të përshtatshme. Kushte të tilla mund të përfshijnë dhënien nga pala paditëse ose kundërpaditëse të një garancie, në atë mënyrë që gjykata e arbitrazhit e konsideron të përshtatshme, për shpërblimin e dëmit që mund t'i vijë të paditurit nga vendosja e një mase të tillë sigurimi. Vlera e

<sup>537</sup> *Iran v. United States of America*, Case A-15, No. Dec 52-A/15-FT, 24 nëntor 1986

<sup>538</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2507; Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 187-188.

dëmit që do të paguhet nëpërmjet kësaj garancie mund të përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit në një ose më shumë vendime.”

Rregullorja e ICC parashikon në nenin 28 (1) se: “(1) Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, sapo dosja t’i dërgohet gjykatës së arbitrazhit, kjo e fundit mundet, me kërkesë të palës të urdhërojë masa të përkohshme ose masa konservative që i duken të përshtatshme. Gjykata e arbitrazhit mund t’i kërkojë palës tjetër vendosjen e një garancie në varësi të llojit të masës së sigurimit. Çdo masë e tillë duhet të jepet në formën e një urdhri, të arsyetuar, ose të një vendimi përfundimtar arbitrazhi si ta konsiderojë të përshtatshme gjykata e arbitrazhit”

Rregullorja e Qendrës shqiptare të Arbitrazhit MEDART parashikon në nenin 22(b) se: “Trupi Arbitral ka të drejtë të kërkojë siguri për koston e masave të tilla.” Mendojmë që termi siguri për koston e masave, nënkupton edhe garancinë për dëmet që mund të shkaktohen nga vendosja e një mase të padrejtë dhe jo vetëm sigurimi i kostove të vendosjes së kësaj mase.

Pavarësisht se gati në unanimitet ligjet dhe rregulloret e arbitrazhit e lënë në diskrecion të gjykatës së arbitrazhit vënien ose jo të një garancie të tillë (duke përdorur shprehjen “mund” dhe jo “duhet” apo “do të”), thuajse të gjithë arbitrat vlerësojnë se duhet aplikuar një normë e tillë. Nga rezultatet e një pyetësori<sup>539</sup> figuroi që një kërkesë për dhënien e një garancie të tillë nga pala kërkuese e masës së sigurimit është tejet e zakonshme. Madje nëse pala nuk e jep një garanci të tillë, arbitrat janë të prirur të mos e japin masën edhe kur plotësohen kushtet e tjera për vënien e masës së sigurimit.

Ndërkohë që ka qëndrime që gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë dhënien e një garancie të tillë pavarësisht nëse *lex arbitri* apo rregullorja e arbitrazhit nuk e parashikojnë shprehimisht diçka të tillë, sepse e drejta e arbitrit për të dhënë masa siguroese përfshin edhe të drejtën e tij për të kërkuar dhënien e një garancie.<sup>540</sup>

Përsa i përket shumës së garancisë, duhet që ajo të mbulojë shpenzimet aktuale dhe dëmet që mund t’i shkaktohen palës tjetër, por duke marrë në konsideratë edhe gjendjen financiare të palës që kërkon masën siguroese.<sup>541</sup>

Në rast se rezulton që dhënia e masës së sigurimit ishte e pabazuar, pala kundër të cilës ishte dhënë një masë e tillë ka të drejtë të kërkojë të dëmshpërblehet për dëmin që mund t’i jetë shkaktuar nga ajo masë. Ky dëmshpërblim merret nga garancia e vënë për këtë qëllim. Dëmshpërblimi mund të jepet vetëm me kërkesë së palës që pretendon se është dëmtuar nga masa siguroese dhe po mbi këtë palë rëndon edhe barra e provës. Gjykata e arbitrazhit ka kompetencë për të vendosur lidhur me kërkesën për dëmshpërblim si rezultat i vendosjes së një mase sigurimi të padrejtë. Një kompetencë e tillë e gjykatës së arbitrazhit parashikohet shprehimisht nga Ligji Model i UNCITRAL, në nenin 17G të tij, ku thuhet se: “Pala që kërkon një masë sigurimi, apo një urdhër paraprak do të jetë përgjegjëse për çdo kosto dhe dëm që mund të shkaktohet nga një masë apo urdhër i tillë ndaj çdo pale, në rast se gjykata e arbitrazhit vendos më vonë që, në bazë të rrethanave, masa apo urdhri nuk duhet të ishin dhënë. Gjykata e arbitrazhit mund t’i ngarkojë këto kosto dhe shpenzime në çdo moment gjatë procesit të arbitrazhit.

---

<sup>539</sup> Kaj Hober, “Interim Measures by Arbitrators” publikuar në “International Arbitration 2006 Back to Basics?” Botim i Këshillit Ndërkombëtar të Arbitrazhit Tregtar (ICCA), Edituar nga Albert Jan Van Den Berg, III. Fq. 737. Para. 4

<sup>540</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2508

<sup>541</sup> Berger, “International Economic Arbitration”, fq. 342

Sidoqoftë edhe në rastet kur ligjet apo rregulloret e arbitrazhit, nuk parashikojnë shprehimisht një kompetencë të tillë të gjykatës së arbitrazhit, prezumohet se ajo buron nga interpretimi i gjerë i marrëveshjes së arbitrazhit, ose mund të nënkuptohet nga kompetenca për të dhënë masë sigurimi, si aksesore e saj.<sup>542</sup> Ndërsa në rastin kur masa e sigurimit është dhënë nga gjykata shtetërore, disa autorë<sup>543</sup> shprehen se kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të shqyrtuar kërkesën për dëmshpërblim të ardhur nga masa e sigurimit është e diskutueshme, megjithëse ka autorë të tjerë<sup>544</sup> që ia njohin pa hezitim një kompetencë të tillë gjykatës së arbitrazhit, ashtu sikurse ka pasur dhe raste praktike që kanë bërë një njohje të tillë. Përmendim për shembull një vendim të ICC<sup>545</sup> ku gjykata e arbitrazhit është shprehur se: “Vetëm gjykata e arbitrazhit, dhe asnjë autoritet tjetër gjyqësor, duhet të ketë kompetencën për të vendosur mbi një padi që rrjedh nga pretendimi për vendosjen e një mase të padrejtë sigurimi edhe nëse ajo është urdhëruar nga një gjykatë shtetërore, megjithatë kjo me kushtin që masa e dhënë të jetë bazuar ekskluzivisht në shkeljen *prima facie* të një kontrate që referon zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në arbitrazh.”

Për të vlerësuar nëse masa e sigurimit ka qenë e padrejtë, gjykata e arbitrazhit duhet të përdorë diskrecionin e saj dhe të shqyrtojë nëse:

- i. kishte apo jo në fakt një urgjencë reale;
- ii. kërkesa për marrjen e masës kishte pasur si qëllim shkaktimin e vonesës apo pengimin e procesit të arbitrazhit; dhe
- iii. pretendimet e paditësit ishin përfundimisht të pabazuara.<sup>546</sup>

#### 4. Forma e masave të sigurimit: Urdhër apo Vendim?

Masat e sigurimit që jepen nga gjykata e arbitrazhit mund të jenë në formën e urdhrit ose vendimit. Disa legjislacione dhe rregullore arbitrazhi i japin të drejtën gjykatës së arbitrazhit të japë masa në formën e urdhrit,<sup>547</sup> disa të tjerë në formën e vendimit<sup>548</sup> dhe të tjerë ia lënë gjykatës së arbitrazhit të zgjedhë mes formës së urdhrit apo vendimit.<sup>549</sup> Ndërkohë krahas këtyre dy formave kryesore ndeshen edhe forma të tjera si p.sh. propozim apo rekomandim.<sup>550</sup> Por megjithëse Rregullorja e Arbitrazhit e ICSID parashikon se gjykata e arbitrazhit mund të “rekomandojë” masa sigurimi, praktika dhe doktrina e arbitrazhit ka interpretuar që termi “rekomandon” të lexohet si

<sup>542</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 230; Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 539, para. 629

<sup>543</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 539, para. 629

<sup>544</sup> Vischer, in D. Girsberger et.al. (eds.) Zurcher Kommentar zum IPRG Art. 183 2<sup>nd</sup> ed., 2004, para. 18.

<sup>545</sup> Partial Award in the ICC Case no. 12363 cituar në Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, Comparative Law of International Arbitration, 2007, fq. 539, para. 629

<sup>546</sup> Schwartz, The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration, 1993, fq.53.

<sup>547</sup> Nga një studim i 70 rregulloreve të arbitrazhit, rezultoi që 27 parashikojnë për urdhrin si formën në të cilën mund jepet masa e sigurimit. Shiko: Ali Yesilirmak, Provisional Measures in International Commercial Arbitration, 2005, fq.90 dhe note 118.

<sup>548</sup> Neni 22 (b) i Rregullave të Arbitrazhit të MEDART “Këto masa për sigurimin e padisë mund të merren në formën e një vendimi të përkohshëm.”; Kodi i Procedurës Civile Holandez neni 1043b

<sup>549</sup> Neni 28(1) i Rregullave të Arbitrazhit të ICC; Ligji Model i UNCITRAL neni 17; Nga një studim i 70 rregulloreve të arbitrazhit, rezultoi që 15 parashikojnë krahas urdhrit edhe vendimin si formën në të cilën mund jepet masa e sigurimit. Shiko: Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 190 dhe note 119.

<sup>550</sup> Shiko nenin 39 të Rregullave të Arbitrazhit të ICSID;

“urdhëron” dhe masat e rekomanduara të konsiderohen të detyrueshme njësoj si një urdhër.<sup>551</sup> Disa autorë arsyetojnë se masat e rekomanduara nga gjykatat e arbitrazhit të ICSID kanë të njëjtin efekt me urdhrin për shkak të mundësisë për të nxjerrë konkluzione negative nga moszbatimi i masës së sigurimit dhe presionit ekonomik që ushtron Banka Botërore si institucion sponsorizues.<sup>552</sup> Ndërkohë që gjykata e arbitrazhit pranë ICSID në çështjen *Maffezini v. The Kingdom of Spain*,<sup>553</sup> arsyetoi se: “Ndërkohë që ka një dallim kuptimor ndërmjet fjalës “rekomandoj” që është përdorur në nenin 39 dhe fjalës “urdhëroj” që është përdorur diku tjetër në Rregullat e Arbitrazhit të ICSID për të treguar kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për t’i kërkuar një pale të kryejë një veprim të caktuar, ky dallim është më tepër në dukje sesa real. Duhet të theksohet se teksti në spanjisht i këtyre Rregullave përdor gjithashtu termin “dictation”. Gjykata e arbitrazhit nuk beson se palët e Konventës kishin pasur për qëllim të krijonin një dallim thelbësor mes këtyre dy fjalëve. Kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi nuk është më pak detyruese se kompetenca e saj për të dhënë vendimin përfundimtar. Prandaj, gjykata konsideron se fjala “rekomandoj” ka një vlerë ekuivalente me fjalën “urdhëroj”.

Ndërmjet “vendimit” dhe “urdhrit” ka disa dallime. Kështu nëse vendimi është ai që synon të zgjidhë përfundimisht një apo disa çështje objekt mosmarrëveshjeje dhe është i detyrueshëm, urdhri synon të trajtojë më tepër çështje teknike dhe procedurale dhe jepet pa ndonjë formalitet dhe arsyetim.<sup>554</sup> Avantazhet dhe disavantazhet e njërës formë apo tjetrës mund të përmbliidhen si më poshtë:<sup>555</sup>

- i. Një vendim është formal, ndërsa një urdhër jo. Marrja e një vendimi kërkon një kohë më të gjatë se marrja e një urdhri. Kjo edhe për shkak se në disa raste, sikurse parashikon Rregullorja e Arbitrazhit e ICC<sup>556</sup> vendimi, ndryshe nga urdhri, duhet të kontrollohet.
- ii. Një urdhër nuk ka efektin *res judicata* dhe mund të rishikohet në çdo kohë, kurse një vendim në parim ka efektin *res judicata*.
- iii. Një vendim mund të ekzekutohet në bazë të Konventës së New Yorkut, ndërkohë që një urdhër nuk mundet. Megjithëse ka disa ligje arbitrazhi dhe raste të praktikës gjyqësore që tregojnë se urdhrat për masa sigurimi janë të ekzekutueshëm në të njëjtën mënyrë si vendimet e ndërmjetme për masa sigurimi, ose se vendimet e ndërmjetme për masat e sigurimit nuk janë të ekzekutueshme.
- iv. Një urdhër mund të jepet edhe *ex parte*, ndërkohë që dhënia e një vendimi *ex parte* mund të shkaktojë probleme për shkak të së drejtës për një proces të rregullt ligjor parashikuar në ligjet kombëtare apo në Konventën e New Yorkut, neni V(1)(b).

<sup>551</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2506, note 431; Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 63.

<sup>552</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 593, para. 23-29.

<sup>553</sup> *Maffezini v. The Kingdom of Spain*, Procedural Order no. 2 of 28 Octobe 1999, XXVII YCA, 2002, fq. 13, 18

<sup>554</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, *Comparative International Commercial Arbitration*, 2003, para. 24-05.

<sup>555</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 192-193; Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2506

<sup>556</sup> Neni 27 i Rregullave të Arbitrazhit të ICC

Në doktrinën e arbitrazhit ndërkombëtar ka pikëpamje kontradiktore nëse masa e sigurimit duhet të jepet në formën e një vendimi apo urdhri. Një qëndrim është se masat e sigurimit nuk kanë statusin *res judicata* dhe ato mund të rishikohen në çdo kohë, ndaj nuk është e përshtatshme që ato të jepen në formën e një vendimi.<sup>557</sup> Qëndrimi i kundërt është që gjykata e arbitrazhit duhet të ketë mundësi për të dhënë masa sigurimi në formën e vendimit të pjesshëm apo të ndërmjetëm, por jo përfundimtar. Megjithëse ky qëndrim bie ndesh me përqsasjen tradicionale për vendimet, për shkak se masa e sigurimit nuk ka efekt *res judicata* si vendimi. Megjithatë interpretohet se vendimi për masë sigurimi konsiderohet si përfundimtar dhe i detyrueshëm përkohësisht, derisa nuk është ndryshuar, revokuar apo konfirmuar me vendimin përfundimtar të arbitrazhit.<sup>558</sup>

Zakonisht gjykata e arbitrazhit ka diskrecion për të vendosur lidhur me formën në të cilën do e japë masën e sigurimit.<sup>559</sup> Ka autorë që janë të mendimit se kur masa e sigurimit i është kërkuar gjykatës së arbitrazhit që të jepet në një formë të caktuar, ajo nuk ka diskrecion në përzgjedhjen e formës.<sup>560</sup> Por praktika ka treguar se ka edhe raste kur pavarësisht se palët e kanë kërkuar dhënien e masës në një formë të caktuar, p.sh. urdhër apo vendim, gjykata e arbitrazhit e ka dhënë në një formë tjetër, të ndryshme nga ajo e kërkuara.<sup>561</sup>

Gjykata e arbitrazhit në ushtrimin e diskrecionit të saj lidhur me formën në të cilën do e japë masën e sigurimit duhet të udhëhiqet nga objektivi për të arritur qëllimin e masës së sigurimit.<sup>562</sup> Gjithashtu ajo duhet të udhëhiqet nga mundësia për të kursyer kohë dhe para për palët, për të zhvilluar një proces efektiv dhe eficient dhe nevoja për të siguruar që vendimi do të jetë i ekzekutueshëm.<sup>563</sup> Rëndësi i duhet kushtuar edhe dëshirave të palëve dhe avantazheve apo disavantazheve të njëjës apo tjetrës formë. Në çdo rast, zgjedhja e formës së masës së sigurimit nga gjykata e arbitrazhit i nënshtrohet ligjit të aplikueshëm.

## **5. Ndryshimi ose revokimi i masave të sigurimit dhe efekti i masave të dhëna më parë nga gjykatat shtetërore**

Masat e sigurimit kanë një karakter të përkohshëm. Në parim ato nuk kanë efekt *res judicata* dhe për rrjedhojë mund të ndryshohen apo revokohen para apo me dhënien e vendimit përfundimtar. Nëse ka ndryshim të rrethanave apo fakte të reja mund të lindë nevoja e rishikimit të masës së dhënë apo të revokimit të saj. Disa rregullore arbitrazhi e parashikojnë shprehimisht mundësinë e ndryshimit apo revokimit të masës së dhënë.<sup>564</sup> Pas ndryshimeve të vitit 2006 edhe Ligji Model i

<sup>557</sup> Pierre A. Karrer, "Interim measures issues by arbitral tribunals and the courts: Less theory, please", in A. van den Berg ed. *International Arbitration and National Courts: The never ending story*, 2001, fq. 109.

<sup>558</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 194.

<sup>559</sup> Berger, "International Economic Arbitration", Kluwer Law and Taxation Publishers, 1993, fq. 343

<sup>560</sup> Lew, *Commentary on interim and conservatory measures in ICC arbitration cases*, 11(1) ICC Ct. Bull. 2000, fq. 28.

<sup>561</sup> Shiko për shembull ICC Final Award no. 5804, 1989, ICC Int'l Ct. Arb. Bull. 1993, fq. 76; ICC Final award 7489, 1993, ICC Int'l Ct. Arb. Bull. 1997, fq. 68.

<sup>562</sup> Beechey & Kenny, "How to control the impact of time running between the occurrence of the damage and its full compensation: compensatory and alternative remedies in interim relief proceedings", në L. Levy & F. De Ly (eds.) *Interest, auxiliary and alternative remedies in international arbitration*, 2008, fq. 115.

<sup>563</sup> Raport Përfundimtar mbi "Interim and Partial Awards" i një grupi pune të Komisionit të ICC për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, 1990, Int'l Ct. Arb. Bull., para.37.3.

<sup>564</sup> Neni 39 i Rregullave të Arbitrazhit të ICSID.

UNCITRAL parashikon shprehimisht në nenin 17D që: “Gjykata e arbitrazhit mund të ndryshojë, pezullojë ose revokojë një masë sigurimi, ose urdhër paraprak që ka dhënë me kërkesë të secilës palë dhe në rrethana përjashtimore dhe pas njoftimit paraprak të palëve, edhe me vetë iniciativën e saj.” Dhe një numër gjykatash arbitrazhi kanë ndryshuar apo revokuar masat e sigurimit të dhëna ose kanë pranuar mundësinë për të bërë diçka të tillë. Përmendim për shembull çështjen *Iran v United States*, ku gjykata e arbitrazhit u shpreh: “Gjykata çmon se rrethanat sikurse janë paraqitur nuk janë të tilla që të kërkojnë ushtrimin nga gjykata të kompetencës për vendosjen e masës së sigurimit të kërkuar. Gjykata thekson se ky vendim për të mos pranuar ushtrimin e kësaj kompetence, nuk e pengon palën që ka bërë kërkesën, të bëjë një kërkesë të re bazuar në fakte të reja.” Dhe në fakt pas trembëdhjetë ditësh paditësi bëri një kërkesë të re bazuar në fakte të reja, e cila u pranua nga gjykata.<sup>565</sup>

Në rast se masa e sigurimit e dhënë ndryshohet apo revokohet për shembull për shkak të ndryshimit të rrethanave, efekti i masës së mëparshme të sigurimit pushon që nga momenti i ndryshimit apo revokimit të saj.

Një çështje që ka ngjallur diskutim është a mundet gjykata e arbitrazhit të ndryshojë apo revokojë një masë të dhënë nga gjykata shtetërore përpara formimit të saj? Apo a mundet ajo të japë një masë sigurimi mbi një kërkesë që gjykata shtetërore e ka rrëzuar më parë? Disa gjykata arbitrazhi kanë konkluduar se vendimi i gjykatës shtetërore për pranimin apo refuzimin e një mase e sigurimi është i detyrueshëm për gjykatën e arbitrazhit që shqyrton të njëjtën kërkesë. Një gjykatë arbitrazhi është shprehur se do të ishte “shumë e rëndë” që ajo të urdhëronte palët të ndryshonin një masë sigurimi të dhënë më parë nga një gjykatë shtetërore, prandaj ajo e rrëzoi kërkesën e palës.<sup>566</sup> Ndërkohë që një tjetër gjykatë u shpreh prerazi se ajo nuk ishte kompetente të hiqte një sekuestro që e kishte vendosur një gjykatë shtetërore.<sup>567</sup> Në një tjetër çështje të ICC gjykata e arbitrazhit u shpreh: “Nëse gjykata shtetërore urdhëron apo refuzon dhënien e një mase sigurimi, palët nuk mund t’i drejtohen gjykatës së arbitrazhit për të marrë një vendim më të favorshëm, dhe anasjelltas. Edhe nëse gjykata u investua e para për shkak se gjykata e arbitrazhit nuk ishte formuar ende, gjykata e arbitrazhit nuk mundet që më vonë pas formimit të saj të ndryshojë apo revokojë masën e dhënë nga gjykata shtetërore. Por si veprohet në rast se kërkesa për ndryshimin apo revokimin e masës bazohet në rrethana të reja? Mendojmë që një kërkesë e tillë duhet të shqyrtohet nga gjykata e arbitrazhit pas formimit të saj.”<sup>568</sup>

Sipas disa autorëve vendimi i gjykatës shtetërore lidhur me masën e sigurimit nuk duhet të ketë efektin *res judicata* në procesin e arbitrazhit për shkak se gjykata e arbitrazhit në shqyrtimin e kërkesës zbaton standardet e saj kombëtare dhe jo ato ndërkombëtare, për rrjedhojë vendimi i saj nuk ka pse të jetë domosdoshmërisht i detyrueshëm për gjykatën e arbitrazhit para së cilës paraqitet kërkesa për një masë të njëjtë apo të ngjashme. Megjithatë, sigurisht që gjykata e arbitrazhit duhet ta marrë në konsideratë analizën e gjykatës shtetërore dhe ajo mund të arrijë në të njëjtin konkluzion si gjykata shtetërore, apo të konkludojë se pala që ka dështuar në marrjen e një mase siguruuese nga gjykata shtetërore nuk mund të kërkojë të njëjtën masë nga gjykata e arbitrazhit. Por kur gjykata e arbitrazhit çmon se është (ose nuk është) e

<sup>565</sup> Interlocutory award No. ITL. 33-A-4/A-15(III)-2, 1 Shkurt 1984

<sup>566</sup> Partial Award in ICC Case no. 4998, 113 J.D. I. (Clunet), 1986 fq. 1139

<sup>567</sup> Vendim i cituar në Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 45, 57.

<sup>568</sup> Order no.5 in ICC Case, 2 April 2002, 21 ASA Bull. 2003, fq. 810, 816.



nevojshme marrja e një mase e sigurimi, një vendim i kundërt i gjykatës shtetërore nuk duhet ta bëjë gjykatën e arbitrazhit që të ndryshojë qëndrimin e saj.<sup>569</sup>

## 6. Llojet e masave të sigurimit

Përcaktimi i llojeve të masave të sigurimit që mund të marrë gjykata e arbitrazhit së pari varet nga vullneti i palëve (rregullorja e arbitrazhit që kanë zgjedhur), i cili i jep tagër gjykatës së arbitrazhit për të vendosur ose jo masa sigurimi dhe llojin e masës së sigurimit që mund të vendosë dhe së dyti nga *lex arbitri* i vendit të arbitrazhit, i cili mund të parashikojë ndalime ligjore, qoftë për të drejtën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi,<sup>570</sup> qoftë për disa lloj masash sigurimi të cilat ligji i konsideron si ekskluzivitetet i gjykatës shtetërore.<sup>571</sup>

Përtej kufizimeve të mësipërme, shumica e legjislacioneve dhe rregulloreve të arbitrazhit nuk parashikojnë shprehimisht llojet e masave të sigurimit që mund të marrë gjykata e arbitrazhit. Pjesa më e madhe e tyre autorizojnë gjykatën e arbitrazhit të vendosë çdo lloj mase që ajo e konsideron të përshtatshme. Përdorimi i termit “çdo lloj” i jep gjykatës së arbitrazhit diskrecion të gjerë për të vendosur lidhur llojin e masës së përshtatshme, kuptohet brenda kufizimeve të vendosura nga *lex arbitri* i aplikueshëm.

Ndërkohë që disa ndryshe është Ligji Model i UNCITRAL, i cili në nenin 17(2) parashikon se: “Masë sigurimi është çdo masë e përkohshme, qoftë në formën e një vendimi, qoftë në ndonjë formë tjetër, nëpërmjet të cilës, në çdo kohë, përpara dhënies së vendimit të arbitrazhit që zgjidh përfundimisht mosmarrëveshjen, gjykata e arbitrazhit urdhëron palën që:

- (a) Të ruajë ose të rivendosë *status quo*-n deri në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes; ose
- (b) Të kryejë veprime që parandalojnë ose të pushojë së kryeri veprime, që mund të shkaktojnë dëm aktual ose të mundshëm në të ardhmen ose që dëmtojnë procesin e arbitrazhit;
- (c) Të sigurojë mjetet për ruajtjen e pasurisë nga e cila, mund të garantohej zbatimi i vendimit përfundimtar të arbitrazhit; ose
- (d) Të ruajë prova që mund të jenë të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Ndaj parashikimit të nenit 17(2) të Ligjit Model të UNCITRAL janë shprehur kritikata se ai duhet të ishte më i hapur dhe të mos parashikonte një listë masash sigurimi në mënyrë *quasi* shteruese, por të linte të hapur mundësinë e gjykatës së arbitrazhit që të mund të marrë çdo lloj mase sigurimi që ajo e konsideron të përshtatshme.<sup>572</sup> Ndërkohë që autorë të tjerë shprehen se në fakt qëllimi i dispozitës së Ligjit Model në lidhje me llojin e masave të sigurimit është që të shërbejë si një udhërrëfyes për gjykatat e arbitrazhit dhe nuk duhet konsideruar si kufizues.<sup>573</sup>

<sup>569</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2504-2505.

<sup>570</sup> Si p.sh. Italia, Kina, Kebeku apo Argjentina

<sup>571</sup> Si p.sh. pamundësia e gjykatës së arbitrazhit për të vënë sekuestro konservative sipas kodit të procedurës civile francez, neni 1468.

<sup>572</sup> Catherine Kessedjian, “Definition et condition de l’octroi de mesures provisoire”, publikuar në “Les mesures provisoires dans l’arbitrage commercial international, Evolution et innovations” (2007), fq. 78, para. 2.

<sup>573</sup> Clyde Croft, Christopher Kee, Jeff Waincymer, “A Guide to the UNCITRAL Arbitration Rules”, (2013), 26.23. fq 284; Sanders, “Commentary on the UNCITRAL Arbitration Rules”, II YB Com Arb.,

Qëllimi i Ligjit Model që neni 17(2) të mos jetë shterues del qartazi nëse, *së pari*, analizohet fakti se në Ligjin Model (2006), neni 17 i tij u ndryshua nga: “Gjykata e arbitrazhit mundet, me kërkesë të palës, të marrë masa sigurimi në lidhje me çështjen në gjykim”, në “gjykata e arbitrazhit mundet, me kërkesë të palës, të marrë masa sigurimi” duke zgjeruar llojin e masave të sigurimit që mund të vendosë gjykata e arbitrazhit me heqjen e kufizimit “lidhur me çështjen në gjykim” dhe *së dyti*, duke iu referuar, Rregullores së UNCITRAL, neni 26 i saj që është thujse identik me Ligjin Model, konstatojmë një shtesë në nenin 26(2) duke shtuar shprehjen “për shembull dhe pa u kufizuar”. Kjo shtesë është bërë me qëllim që llojet e masave të sigurimit sipas Rregullores të mos kuptohen në mënyrë shteruese, por përkundrazi dispozita është e hapur dhe për masa të tjera që konsiderohen të përshtatshme nga gjykata e arbitrazhit. Pra, lista e llojeve të masave siguruese nuk është shteruese.<sup>574</sup>

Sekretariati i UNCITRAL-it ka përshkruar se qëllimi i masave të sigurimit është ruajtja e pozicionit të palëve deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes tyre, funksion ky, që shpesh njihet si “ruajtje e *status quo*-s” dhe ruajtja e aseteve, pasurive, të cilat mund të përdoren për të ekzekutuar vendimin përfundimtar të arbitrazhit, në juridiksionin në të cilin do të kërkohet ekzekutimi.<sup>575</sup>

Në të njëjtën linjë është edhe qëndrimi i doktrinës apo praktikës së arbitrazhit. Kështu, disa autorë shprehen se masa e sigurimit mund të jetë e nevojshme për të ruajtur *status quo*-n, objektin e mosmarrëveshjes, ose të drejtat dhe interesat e një pale në arbitrazh ose të një pale të tretë. Në raste të tjera, masa siguruese mund të përdoret nga njëra palë si armë për të ushtruar presion ndaj palës tjetër në arbitrazh.<sup>576</sup> Të tjerë autorë, shprehen se gjykatat e arbitrazhit urdhërojnë masa sigurimi në bazë të disa parimeve të mirënjohura të tilla si (a) ruajtja e *status quo*-s, (b) parandalimi i përkeqësimit të mosmarrëveshjes; dhe (c) ruajtja e integritetit të procedurës së arbitrazhit.<sup>577</sup> Në çështjen e ICC nr. 10681<sup>578</sup> (2001), gjykata e arbitrazhit, konfirmon parimet e mësipërme dhe shprehet se: “Masat e sigurimit synojnë:

- a. Të ruajnë *status quo*-n e çështjes në arbitrazh;
- b. Të ruajnë provat;
- c. Të ofrojnë garanci për shpenzimet;
- d. Të urdhërojnë palët që të heqin dorë nga një veprim apo të bëjnë një veprim të caktuar”.

Tërësia e llojeve të masave të sigurimit që mund të jepen nga një gjykatë arbitrazhi referuar kryesisht qëllimit të masave të sigurimit dhe doktrinës së arbitrazhit ndërkombëtar mund të grupohen në disa kategori:<sup>579</sup>

---

1977, fq. 172, 196; D. Caron & L. Caplan, *The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary* 518 (2<sup>nd</sup> ed. 2013).

<sup>574</sup> Institutional Arbitration, Article by Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules” (2013) edituar nga Rolf A. Schultze, 484.

<sup>575</sup> Caline Mouawad & Elizabeth Silbert, “A guide to Interim Measures in Investor-State Arbitration, Arbitration International, LCIA, Volume 29, No.1, fq. 386, para. 3.

<sup>576</sup> Julian D.M. Lew “Commentary on Interim and Coservatory Measures in ICC Arbitration Cases”, ICC Buletin Vol. 11/Nr. 1- 2000, fq. 23, para. 1.

<sup>577</sup> Caline Mouawad & Elizabeth Silbert, “A guide to Interim Measures in Investor-State Arbitration, Arbitration International, LCIA, Volume 29, No.1, fq. 396, para. 2.

<sup>578</sup> Çështja ICC 10681 (2001) botuar në Buletinin e ICC, Vol. 22/Special Supplement – 2011, para.10, fq. 7.

<sup>579</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2484-2503; Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 538-539, para. 628; Julian D M Lew,

1. Masa për sigurimin e provës;
2. Masa që synojnë të ruajnë *status quo*;
3. Masa që synojnë të garantojnë ekzekutimin e vendimit përfundimtar;
4. Masa për garantimin e kostove;
5. Masa për pagesa të përkohshme.
6. Masa që synojnë të urdhërojnë palët të mos kryejnë veprime që dëmtojnë procesin e arbitrazhit. (Masa anti-padi).

### **6.1. Masa për sigurimin e provës**

Prova është një element shumë i rëndësishëm në procesin e arbitrazhit. Mund të ndodhë që një provë që është thelbësore të nevojitet të ruhet apo të merret në fazat e para të procesit të arbitrazhit, sepse ka rrezik që ajo të dëmtohet apo prishet. Lloji i masave të sigurimit që mund të vendosë gjykata e arbitrazhit për sigurimin e provës mund të jenë: lënia në ruajtje tek një i tretë, marrja në ruajtje nga gjykata e arbitrazhit kur kjo është e mundur, caktimi një eksperti për të përcaktuar vlerën e një malli që mund të prishet deri në fund të procesit, pyetja e një dëshmitari që mund të jetë shumë sëmure etj.

Mundësia e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa për sigurimin e provës zakonisht parashikohet shprehimisht nga ligjet e arbitrazhit apo nga rregulloret e institucioneve të arbitrazhit. I tillë është ligji anglez i arbitrazhit, ku parashikohet në dispozita të veçanta jo vetëm mundësia e marrjes së masave për sigurimin e provës, por dhe lloji i këtyre masave. Sipas nenit 38 të këtij ligji:

“38.4. Gjykata e arbitrazhit mund të japë udhëzime në lidhje me çdo pasuri që është objekt gjykimi në arbitrazh apo në lidhje me të cilën mund të lidhet një çështje në arbitrazh dhe e cila është në pronësi apo në posedim të palëve në arbitrazh për (a) inspektimin, fotografimin, ruajtjen, kujdestarinë ose mbajtjen e pasurisë nga gjykata e arbitrazhit, eksperti ose pala; ose (b) të urdhërojë që të mund të merren mostra, ose të bëhen këqyrje apo të eksperimentohet në këtë pasuri”

38.5. Gjykata arbitrazhit mund të udhëzojë që pala ose dëshmitari do të ekzaminohen me betim dhe afirmim dhe munden që për këtë qëllim të administrojnë çdo betim ose të marrin çdo afirmim të nevojshëm

38.6. Gjykata e arbitrazhit mund të japë dreksione palës që të ruajë në kujdestari ose kontroll për qëllim të procedurës çdo provë.

Megjithatë edhe kur këto ligje apo rregullore nuk e parashikojnë në mënyrë të shprehur një mundësi të tillë, këto lloj masash konsiderohen se bien brenda kompetencës së arbitrave për të marrë masa që “i konsideron të përshtatshme”, sepse qëllimi i tyre është të lehtësojë mbarëvajtjen e procesit të arbitrazhit. I tillë është për shembull, kodi gjerman i procedurës civile (1998), i cili ka adoptuar Ligjin Model të UNCITRAL pa amendimet e vitit 2006. Sipas nenit 1041 (1) të tij, nëse nuk është parashikuar ndryshe nga palët, me kërkesë të palës, gjykata e arbitrazhit mund të vendosë ato masa sigurimi që i konsideron të nevojshme në lidhje me çështjen objekt gjykimi. Doktrina<sup>580</sup> dhe praktika gjermane pranon se masat për sigurimin e provës kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi, ndaj dhe aplikohen gjerësisht.

---

Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 595, para. 23-35.

<sup>580</sup> International Handbook on Commercial Arbitration, ICCA, Volume II, Germany, fq. 35

Edhe praktika e arbitrazhit është e të njëjtit qëndrim. Kështu, në çështjen *Biwater Gauff (BGT) v. Tanzania*,<sup>581</sup> gjykata e arbitrazhit ka arsyetuar se: “Llojet e të drejtave të cilat mund të mbrohen nëpërmjet masave të sigurimit nuk janë vetëm të drejtat materiale, por edhe të drejtat procedurale. SCHREUER në këtë kuadër thekson se “të drejtat, për të cilat kërkohet më shpesh mbrojtje në kërkesat për masa sigurimi lidhen me aspekte procedurale” të tilla si “e drejta e marrjes së provës”.

Kur gjykatës së arbitrazhit i duhet të çmojë nëse është e nevojshme marrja e një mase për sigurimin e provës nuk ka kuptim që ajo të vlerësojë standarde të tilla si urgjenca, dëmi i riparueshëm apo thelbësor etj. Ajo që duhet të merret në konsideratë është nëse prova që kërkohet të sigurohet është e rëndësishme për çështjen objekt gjykimi.<sup>582</sup>

## 6.2. Masa për ruajtjen e status-quo

Si rregull masat e sigurimit kanë për qëllim të shmangin apo të parandalojnë ndryshimin e gjendjes së faktit apo të ligjit të objektit të mosmarrëveshjes, i cili do e bënte më të vështirë apo të pamundur përbushjen e mëvonshme të detyrimeve. Pra, ruajtja e *status quo* ndërmjet palëve, apo thënë ndryshe ruajtja e marrëdhënieve specifike kontraktuale apo ligjore, ose ruajtja e rrethanave të faktit duke u konsideruar si vetë qëllimi i masave të sigurimit është një nga masat më të zakonshme të sigurimit. Nëpërmjet këtyre masave gjykata e arbitrazhit urdhëron një palë të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar me qëllim ruajtjen e *status quo* derisa të jepet vendimi përfundimtar mbi themelin e mosmarrëveshjes.

Kjo masë zbatohet gjerësisht në praktikën e arbitrazhit dhe është parashikuar shprehimisht nga një numër i madh rregulloresh arbitrazhi. Kështu, Rregullorja e Arbitrazhit e LCIA në nenin 25(1)(b) parashikon të drejtën e gjykatës së arbitrazhit që të urdhërojë ruajtjen, depozitimin, shitjen ose çdo disponim tjetër të ndonjë prone ose sendi nën kontrollin e secilës palë, dhe lidhur me objektin e padisë në arbitrazh. Këto janë masa që, sipas rastit, i shërbejnë ruajtjes së *status quo*-s. Po kështu Rregullorja e Arbitrazhit e UNCITRAL parashikon në nenin 26 (1) të drejtën e gjykatës për ruajtjen e mallit që përbën objekt gjykimi në mosmarrëveshje, si dhe të drejtën për të urdhëruar depozitimin e këtij malli tek një person i tretë ose shitjen e mallrave që prishen.

Por edhe në rastet kur kjo masë nuk parashikohet shprehimisht, prezumohet se marrja e masave të tilla është në kompetencë të gjykatës së arbitrazhit, si pjesë e pandarë e kompetencës së përgjithshme e saj për të marrë çdo masë sigurimi që e konsideron të përshtatshme.<sup>583</sup>

Në shumicën e rasteve të ICC, masat e sigurimit të vendosura nga gjykatat e arbitrazhit kanë për qëllim të ruajnë *status quo*.<sup>584</sup> Masa të tilla merren zakonisht kur dëmi nuk do të mund të kompensohet totalisht pas zhvillimit të procedurës së arbitrazhit, nëse pala tjetër do të lejohet të vazhdojë të kryejë ose të mos kryejë

<sup>581</sup> “*Biwater Gauff (Tanzania) Ltd. Vs. United Republic of Tanzania*” ICSID çështja nr. ARB/05/22, Urdhër Procedural Nr. 1, datë 31 Mars 2006, fq. 21, para. 71, <http://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0087.pdf>

<sup>582</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2498

<sup>583</sup> Sebastian Besson “Arbitrage international et mesures provisoires” Etude de droit compare (1998), 128, fq. 100.

<sup>584</sup> “Institutional Arbitration, Article by Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules” (2013) edituar nga Rolf A. Schultze, 580.

veprimet e tij. P.sh. refuzimi i një pale nënkontraktore në një kompani të madhe ndërtimi për të vazhduar punën, për shkak të mosmarrëveshjes mund të passjellë një dëm të jashtëzakonshëm kompanisë së ndërtimit.<sup>585</sup> Llojet e masave që synojnë të ruajnë *status quo* të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit janë të larmishme. Mund të përmendim masa të tilla si: urdhri për vazhdimin e ekzekutimit të një kontrate mes palësh derisa gjykata e arbitrazhit të shprehet me vendimin përfundimtar, për mos shitjen e aksioneve, për t'i ulur palët në negociim,<sup>586</sup> për të mos nxjerrë sekretet tregtare, për të mos hapur një letër krediti, apo për të mos përdorur pronësinë intelektuale objekt konflikti,<sup>587</sup> etj.

Po brenda kësaj kategorie masash përfshihen edhe masat që vendosen nga gjykata për të parandaluar përkeqësimin e mosmarrëveshjes mes palëve. Nuk kanë qenë të rralla rastet kur gjykatat kanë dhënë masa të kësaj natyre. Veçanërisht praktika e arbitrazhit të ICSID është shumë e pasur në këtë drejtim.<sup>588</sup> Përmendim për shembull çështjen *Amco Asia Corporation (AMCO) v. Republic of Indonesia*, ku Gjykata e arbitrazhit refuzoi të rekomandonte masën e sigurimit për mospërkeqësimin e mosmarrëveshjes, duke argumentuar se: “Nuk ka asnjë provë se publikimi i informacionit në lidhje me çështjen, mund apo ka për qëllim të përkeqësojë apo të rëndojë mosmarrëveshjen, duke e bërë zgjidhjen e saj më të vështirë”<sup>589</sup> Ndërsa, në çështjen *Electricity Company of Sofia and Bulgaria*, Gjykata Ndërkombëtare Permanente e Drejtësisë, është shprehur se: “Palët në një çështje duhet të heqin dorë nga çdo masë që mund të shkaktojë një efekt paragjykes në lidhje me ekzekutimin e vendimit që do të jepet dhe në përgjithësi nuk duhet të lejojnë të ndërmerret asnjë hap i çfarëdo lloji që mund të shkaktojë përkeqësimin ose zgjatjen e mosmarrëveshjes”<sup>590</sup>

Edhe vendimet për ruajtjen e konfidencialitetit nëse kjo do t'i shkaktoje shumë dëm palës, përfshihen në këtë grup masash sigurimi. Kështu për shembull në çështjen *Biwater Gauff (BGT) v. Tanzania*,<sup>591</sup> Biwater Gauff paraqiti përpara gjykatës së arbitrazhit një kërkesë për marrjen e masës siguruese në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit duke kërkuar të ndalohen palët në këtë gjykim arbitrazhi të bëjnë publike dokumentet e përgatitura ose të paraqitura në arbitrazh, deri në dhënien e vendimit përfundimtar të arbitrazhit. Fillimisht gjykata u shpreh se: “Vendimi për dhënien e kësaj mase sigurimi kërkon kujdes në balancimin e dy interesave

<sup>585</sup> Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan M Kroll “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, 23-39.

<sup>586</sup> Craig, Park, Paulsson “International Chamber of Commerce Arbitration” Botim i 3. (2000), 26.05. iv. Fq. 463, footnote 30/ Çështja ICC 6503/1990

<sup>587</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2485.

<sup>588</sup> Shiko Churchill Mining plc v. Republic of Indonesia, Urdhwr procedural nr. 3, në çështjen e ICSID nr. ARB/12/14, 4 Mars 2013, para. 46-57; *Quiborax SA kundër Plurinat'l State of Bolivia*, Decision on Provisional Measures in ICSID Case no. ARB/06/2 of 26 February 2010, para 117; *City Oriente Limited v Ecuador and Empresa Estatal Petróleos del Ecuador (Petroecuador)*, ICSID Case No. ARB/06/21, IIC 308 (2007), 24th October 2007, Decision on Provisional Measures, para. 57 <http://italaw.com/documents/CityOrient-ProvisionalMeasures-EN.pdf>.

<sup>589</sup> *Amco Asia Corporation (AMCO) v. Republic of Indonesia*, 23 ILM 351 (1984), 30 Shtator 1983, faqe 405, paragrafi 2 gjendet:

<http://www.justis.com/document.aspx?doc=f7jsrUrxAOLxsKjIo4Ktn5mdm1WIivLerIOJij5evmns5KdmJqJnZmco5mYm2yJiSiIs1jxAZrëAJrxAV5ësKjIoW0ha&relpos=0#page402>

<sup>590</sup> The Electricity Company of Sofia and Bulgaria (masa sigurimi), Gjykata Ndërkombëtare Permanente e Drejtësisë, Vendimi datë 5 Dhjetor 1939, fq. 9, para. 199; gjendet në: [http://www.icj-cij.org/pcij/serie\\_AB/AB\\_79/Compagnie\\_d\\_electricite\\_de\\_Sofia\\_ordonnance\\_19391205.pdf](http://www.icj-cij.org/pcij/serie_AB/AB_79/Compagnie_d_electricite_de_Sofia_ordonnance_19391205.pdf)

<sup>591</sup> “*Biwater Gauff (Tanzania) Ltd. vs. United Republic of Tanzania*”, ICSID Nr. ARB/05/22, Urdhwr procedural Nr 3, date 29 Shtator 2006, fq. 28, para.112, <http://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0089.pdf>

konkurrues: (i) nevoja për transparencë në procedime të tilla, dhe (ii) nevoja për të mbrojtur integritetin procedural të arbitrazhit”. Për këtë arsye gjykata morri një lloj vendimi të ndryshëm nga ai i kërkuar nga paditësi. Për këtë vendim të saj gjykata u shpreh se: “Në veçanti, është një vendim i cili për efekt të drejtësisë, barazisë në trajtim dhe mospërkeqësimit të mosmarrëveshjes midis palëve duhet të aplikohet në mënyrë të barabartë për të dyja palët”. Si konkluzion, gjykata urdhëroi që në mungesë të një marrëveshje midis palëve të ruhej konfidencialiteti vetëm për një pjesë të gjykimit dhe dokumentacionit.

Megjithëse masat që kanë për qëllim ruajtjen e *status quo* janë ndër më të përdorurat në praktikën e arbitrazhit, ende ka diskutime lidhur me kuptimin e konceptit të *status quo*, përkatësisht nëse me të duhet kuptuar *status quo* në kohën (a) kur jepet masa e sigurimit, (b) kur kërkohet masa e sigurimit, (c) kur fillon procedura e arbitrazhit, apo (d) kur ka lindur mosmarrëveshja. Praktika e arbitrazhit ka interpretuar *status quo* si gjendjen e fundit paqësore mes palëve që i ka paraprirë mosmarrëveshjes aktuale. Përmendim për shembull çështjen SafeKids<sup>592</sup> ku një gjykatë shtetërore në Zelandën e Re në vendimin e saj ndër të tjera ka arsyetuar se: “Neni 17(2)(a) ka për qëllim që të ruajë ose të rivendosë gjendjen deri në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes dhe nuk ka për qëllim të krijojë një kërkesë për prag kufizues. Termi *status quo* nënkupton “gjendjen e fundit paqtuese mes palëve”.

Edhe doktrina ka mbajtur një qëndrim të tillë. Kështu sugjerohet se për të analizuar momentin e duhur të *status quo* nuk duhet t’i vendoset ndonjë rëndësi e madhe gjendjes së faktit qoftë kur bëhet kërkesa për arbitrazh ashtu dhe kërkesa për masë sigurimi. Por gjykata e arbitrazhit duhet të vlerësojë dëmin që mund të pësojnë të dyja palët gjatë procesit të arbitrazhit si dhe të konsiderojë ekzistencën *prima facie* të suksesit mbi themelin e çështjes. Nëse paditësi arrin të tregojë suksesin *prima facie* të padisë dhe se ka rrezikun e një dëmi thelbësor gjatë kohëzgjatjes së procesit të arbitrazhit, gjykata e arbitrazhit duhet të urdhërojë një masë që synon të ruajë gjendjen (*status quo*) që i ka paraprirë lindjes së mosmarrëveshjes mes palëve. Nuk ka baza serioze për të pretenduar se gjykata e arbitrazhit nuk ka juridiksion t’iu kërkojë palëve të kthejnë një gjendje fakti që ka ekzistuar përpara fillimit të procedurës së arbitrazhit.<sup>593</sup>

### **6.3. Masa që synojnë të garantojnë ekzekutimin e vendimit përfundimtar**

Ndërkohë që zhvillohet procedura e arbitrazhit, një palë me qëllim shmangien e ekzekutimit të vendimit përfundimtar të arbitrazhit, mund të tentojë të lëvizë asetet e saj në një vend ku procedurat e ekzekutimit janë të komplikuar apo t’i transferojnë ato tek të tretët. Në një rast të tillë, pala tjetër përligjet në kërkesën e saj për të kërkuar nga gjykata e ndalimin e veprimeve të tilla. Ajo mund të kërkojë vendosjen e sekuestros mbi pasurinë objekt konflikti, ose sekuestrimin e aseteve të palës tjetër. Por si shkak për të kërkuar një masë të tillë mund të jetë edhe rasti kur situata financiare e palës tjetër është e tillë sa ngre dyshime të arsyeshme se ajo mund të jetë në gjendje që të përmbushë detyrimet monetare që mund të urdhërohen me vendimin përfundimtar. Masat të tilla konsiderohen (por jo vetëm) ndalimi i palës për të shitur pasurinë që është objekt gjykimi, qoftë kjo e luajtshme apo e paluajtshme deri në përfundim të procesit, vënia e pasurisë në ruajtje tek një i tretë, vënia e sekuestros

<sup>592</sup>Çështja SafeKids referuar në Digest of UNCITRAL Model Law (2012), fq. 87, gjendet në: <http://www.uncitral.org/pdf/english/clout/MAL-digest-2012-e.pdf>

<sup>593</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2488

konservative mbi pasurinë në ato vende ku kjo masë është e lejueshme të jepet nga gjykata e arbitrazhit, depozitimi i një garancie bankare, në një vlerë që konsiderohet e përshtatshme nga gjykata etj.

Disa ligje<sup>594</sup> dhe rregullore arbitrazhi<sup>595</sup> e parashikojnë në mënyrë të shprehur mundësinë e gjykatës së arbitrazhit, që të vendosin masa që synojnë garantimin e ekzekutimit të vendimit përfundimtar të arbitrazhit. Megjithatë edhe kur rregullat e aplikueshme nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur këtë lloj mase sigurimi, kompetenca e përgjithshme e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi i përfshin edhe këto masa që synojnë të garantojnë ekzekutimin e vendimit përfundimtar të arbitrazhit.<sup>596</sup> Kjo është konfirmuar edhe nga praktika gjyqësore, si p.sh. në çështjen *Time Staffing v. National Union Fire*,<sup>597</sup> gjykata u shpreh: “Në mungesë të një parashikimi të kundërt në marrëveshjen e arbitrazhit, gjykata e arbitrazhit ka kompetencë të nënkuptuar për të ruajtur integritetin e procesit të arbitrazhit për të cilin kanë rënë dakord palët duke kërkuar vendosjen e një garancie ... Në të kundërt, gjykata e arbitrazhit që ka një shqetësim të bazuar se një palë nuk është financiarisht e aftë për të ekzekutuar vendimin e saj nuk do të kishte asnjë mjet për të mbrojtur veten nga rreziku që shpenzimi i saj i konsiderueshëm i kohës dhe i mundit do shkonte kot.”

Ndërkohë ka disa legjislacione që e ndalojnë shprehimisht të drejtën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë disa lloje masash të tilla, përkatësisht për të vendosur sekuestro ekzekutive.<sup>598</sup> Argumentet kryesore të vendosjes së një kufizimi të tillë janë se këto masa vendosen mbi asetete që nuk lidhen me objektin e mosmarrëveshjes dhe se ato masa nuk mund të ekzekutohen. Gjithsesi këto argumente nuk qëndrojnë aspak, sepse dhënia e masave të sigurimit nuk duhet të kufizohet vetëm në asetet objekt mosmarrëveshjeje dhe çështja e ekzekutimit të tyre është e ndarë nga kompetenca për të dhënë masa të tilla.<sup>599</sup>

Edhe në ato raste kur nuk ka një ndalim të shprehur të kompetencës së arbitrave për të dhënë masa që sigurojnë ekzekutimin e vendimit, ka pasur raste ku gjykatat e

---

<sup>594</sup> Akti Suedez i Arbitrazhit neni 25(4): “Ligji i arbitrazhit suedez, parashikon gjithashtu se, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, arbitrat, me kërkesë të njërës palë, mund të vendosin që pala tjetër kundërshtarë të vendosë një garanci me qëllim garantimin e ekzekutimit të padisë që po gjykohet nga arbitrat. Arbitrat mund të kërkojnë që pala që kërkon masën e përkohshme të japë edhe ajo garanci për dëmin që mund t’i shkaktohet palës kundërshtarë si rezultat i masës së përkohshme”; Shiko gjithashtu: Ligji Model i UNCITRAL neni 17 (2)(c); Akti Anglez i Arbitrazhit neni 39; Akti Kanadez i Arbitrazhit Tregtar neni 17; Akti Australian i Arbitrazhit Ndërkombëtar neni 23; Akti i Arbitrazhit Ndërkombëtar të Singaporit neni 12(1)(a); Akti i Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit në Indi neni 17.

<sup>595</sup> LCIA Rules of Arbitration neni 25(1)(a): “Gjykata e arbitrazhit ka të drejtë që të urdhërojë çdo palë të paditur sipas një padie apo kundërpadie të japë garanci për të gjithë ose një pjesë të vlerës së padisë, nëpërmjet një depozite apo garancie bankare ose në çdo mënyrë tjetër sipas kushteve që gjykata e arbitrazhit mund t’i konsiderojë të përshtatshme. Kushte të tilla mund të përfshijnë dhënien nga pala paditëse ose kundërpaditëse të një garancie, në atë mënyrë që gjykata e arbitrazhit e konsideron të përshtatshme, për shpërblimin e dëmit që mund t’i vijë të paditurit nga vendosja e një mase të tillë sigurimi. Vlera e dëmit që do të paguhet nëpërmjet kësaj garancie mund të përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit në një ose më shumë vendime”; Shiko gjithashtu: CEPANI Rules neni 27; NAI Rules neni 38 (1).

<sup>596</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 598, para. 23-44.

<sup>597</sup> *Time Staffing v. National Union Fire*, 2011 U.S. Dist LEXIS 50689(S.D.N.Y.)

<sup>598</sup> Shiko nenin 1691 të Kodit të Procedurës Belg, apo nenin 1468 të Kodi të Procedurës Civile Francez.

<sup>599</sup> Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan M Kroll “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 599, para. 23-47 - 23-48.

arbitrazhit kanë hezituar të japin masa të tilla. Disa ia treguar edhe drastike duke u shprehur se dhënia e masave të tilla bie jashtë qëllimit të masave të sigurimit.<sup>600</sup>

Sidoqoftë një arsytim i tillë nuk qëndron aspak, pasi këto masa janë format më të pastra të masave të sigurimit të padisë që synojnë të ndajnë riskun e vonesave të procedurës së arbitrazhit. Gjykatat e arbitrazhit janë absolutisht të justifikuara në vendosjen e këtyre masave, sigurisht duke marrë në konsideratë edhe kriteret e tjera të vendosjes së masave të sigurimit që janë urgjenca, juridiksioni *prima facie*, sukcesi i çështjes *prima facie*, proporcionaliteti etj.<sup>601</sup> Praktika e arbitrazhit ka pranuar gjerësisht dhënien e masave që i kërkojnë një pale të mos t'i shesë apo transferojë asetet e tij jashtë shtetit.<sup>602</sup>

#### **6.4. Masa sigurimi për garantimin e kostove**

Garancia për kostot mund të përkufizohet si para apo pronë e dhënë gjykatës nga i padituri me qëllim për të garantuar pagimin e shpenzimeve të procesit në rast se ajo palë humbet. Në disa juridiksione këto lloj masash njihen si *cautio judicatum solvi* si dhe synojnë të mbrojnë të paditurin nga padi të pabazuara apo paditës të cilët nuk do të mund të paguajnë kostot e procesit të palës së paditur në rast sukcesi të kësaj të fundit.<sup>603</sup>

Disa legjislacione<sup>604</sup> dhe rregullore arbitrazhi<sup>605</sup> e parashikojnë shprehimisht të drejtën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa të tilla. Megjithëse edhe në rastet kur rregullat e aplikueshme nuk e parashikojnë shprehimisht një të drejtë të tillë gjykatat e arbitrazhit kanë të drejtë të japin masa të tilla, sepse ajo konsiderohet si pjesë përbërëse e kompetencës së tyre për të dhënë masa sigurimi.<sup>606</sup> Dhe në fakt shembulli më i mirë është praktika e arbitrazhit e ICC ku megjithëse Rregullat e ICC nuk e parashikojnë shprehimisht një të drejtë të tillë, gjykatat e arbitrazhit kanë dhënë masa për sigurimin e kostove bazuar në nenin 23(1) të Rregullave të Arbitrazhit të ICC.

---

<sup>600</sup> Partial award ICC case cituar në Schwartz, *The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration*, 1993, fq. 45, 61.

<sup>601</sup> Gary Born, *“International Commercial Arbitration”*, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: *International Arbitral Procedures*, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2494.

<sup>602</sup> Berger, *International Economic Arbitration*, 1993, fq. 341.

<sup>603</sup> Craig, Park, Paulsson *“International Chamber of Commerce Arbitration”* Botim i 3. (2000), 26.05. iv, fq. 467, footnote 40.

<sup>604</sup> Akit Anglez i Arbitrazhit neni 38, Akti i Arbitrazhit Ndërkombëtar i Singaporit neni 12(1).

<sup>605</sup> LCIA Arbitration Rules neni 25(2): “Në bazë të kërkesës së një pale, gjykata e arbitrazhit ka kompetencë të urdhërojë çdo palë paditëse apo kundërpaditëse të japë garanci për shpenzimet ligjore dhe kosto të tjera të çdo pale tjetër nëpërmjet një depozite apo garancie bankare ose në çdo mënyrë tjetër dhe sipas kushteve që gjykata e arbitrazhit mund t'i konsiderojë të përshtatshme. Kushte të tilla mund të përfshijnë dhënien nga pala tjetër të një garancie, në atë mënyrë që gjykata e arbitrazhit e konsideron të përshtatshme, për shpërblimin e dëmit që mund t'i vijë paditësit apo kundërpaditësit nga vendosja e një mase të tillë sigurimi. Vlera e dëmit që do të paguhet nëpërmjet kësaj garancie mund të përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit në një ose më shumë vendime. Në rast se pala paditëse ose kundërpaditëse nuk zbaton ndonjë urdhër për dhënie garancie, gjykata e arbitrazhit mund të pezullojë gjykimin e padisë ose kundërpadisë, ose mund të vendosë mosshqyrtimin e tyre.

<sup>606</sup> Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan M Kroll *“Comparative International Commercial Arbitration”*, 2003, fq. 601, para. 23-53.



Megjithatë pavarësisht njohjes së kompetencës së gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa për sigurimin e kostove, gjykatat e arbitrazhit hezitojnë në dhënien e tyre dhe këto masa nuk janë vendosur shumë shpesh.<sup>607</sup>

Përsa i përket kritereve ku duhet të bazohet gjykata e arbitrazhit në lidhje me vendosjen e kësaj mase, (përveç vlerësimit të pamundësisë së ekzekutimit të vendimit për shkak të gjendjes ekonomike të palës kundër së cilës kërkohet vendosja e masës), gjykatat e arbitrazhit pranë ICC kanë kërkuar që pala që kërkon vendosjen e kësaj mase të mos ketë qenë në dijeni të kësaj gjendje në kohën kur ka nënshkruar marrëveshjen e arbitrazhit. Në të kundërt (kur gjendja ekonomike e palës ka qenë e njëjtë dhe pala kërkuese ka pasur dijeni), gjykatat e arbitrazhit nuk kanë dhënë masa sigurimi për garantimin e kostove.<sup>608</sup> Ndërkohë që doktrina është shprehur se arbitrat kur shqyrtojnë kërkesa për sigurimin e kostove duhet të tregojnë kujdes të mos pengojnë aksesin në gjykatë dhe të respektojnë parimin e barazisë së palëve duke kërkuar edhe vendosjen e një kundër-garancie.<sup>609</sup>

### **6.5. Masa për pagesa të përkohshme**

Masat për pagesa të përkohshme janë masa që jepen nga gjykata e arbitrazhit për pagimin e një shume që nuk është e diskutueshme mes palëve përpara se të jepet vendimi për themelin e mosmarrëveshjes. Kjo lloj mase nuk konsiderohet si një masë tipike sigurimi, sepse gjykatës së arbitrazhit i duhet të vendosë përpara se të bëjë një gjykim të plotë se palës kërkuese i takon një shumë e caktuar parash.<sup>610</sup> Nga disa autorë masat për pagesa të përkohshme konsiderohen si një lloj *sui generis* “mase sigurimi” që kanë të bëjnë me urdhra apo vendime për të paguar përkohësisht shumat e pretenduara me padinë. Ato dallojnë nga masat e tjera të sigurimit, sepse urdhërojnë pagimin e shumave për të cilat palët nuk kanë kundërshtime dhe që do të urdhëroheshin me një vendim të pjesshëm apo përfundimtar.<sup>611</sup>

Disa legjislacione ia njohin shprehimisht të drejtën gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa për pagesa të përkohshme. Ligji i arbitrazhit anglez e parashikon shprehimisht një mundësi të tillë në nenin 39(2). Megjithatë praktika ka treguar se nuk ka asnjë pengesë për gjykatën arbitrazhit që të japë masa të tilla edhe në rastet kur rregullat e aplikueshme nuk parashikojnë shprehimisht për një të drejtë të tillë.<sup>612</sup>

Përsa i përket kritereve që gjykata e arbitrazhit duhet të marrë në konsideratë për dhënien e masave për pagesa të përkohshme rekomandohet që ajo duhet të tregojë kujdes të mos paragjykojë themelin e çështjes dhe të kërkojë garanci për dëmin që mund të shkaktohet në rast se rezulton që masa nuk duhet të ishte dhënë.<sup>613</sup> Edhe Gjykata Evropiane të Drejtësisë në çështjen *Van Uden Maritime* është shprehur se

---

<sup>607</sup> Craig, Park, Paulsson “International Chamber of Commerce Arbitration” Botim i 3. (2000), fq. 467; Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan M Kroll “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 601, para. 23-54.

<sup>608</sup> Institutional Arbitration, Article by Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules” (2013) edituar nga Rolf A. Schultze, 581.

<sup>609</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 217, para.5-85.

<sup>610</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 218, para.5-86.

<sup>611</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2499.

<sup>612</sup> ICC Second Interim Award 7544 i 1996, 11(1) ICC Int’l Ct. Arb. Bull., 2000, fq. 56-60

<sup>613</sup> Idem.

masa për pagesë të pjeshme nuk konsiderohet si masë sigurimi sipas kuptimit të Konventës së Brukselit, përveç kur ndër të tjera, garantohet ripagimi i shumës së dhënë të paditurit në rast se rezulton që kjo masë nuk duhet të ishte dhënë.<sup>614</sup>

#### **6.6. Masa që kanë për qëllim të parandalojnë ose të pushojnë se kryeri veprime që mund të dëmtojnë procesin e arbitrazhit (Masa anti-padi)**

Një lloj shumë i veçantë i masave siguroese është ajo që quhet masa “anti-padi”, e cila synon të ndalojë njërin palë të fillojë apo të vazhdojë një proces në një juridiksion tjetër. Kjo masë nuk i kundërvet juridiksionit tjetër, që zakonisht është juridiksioni gjyqësor shtetëror, por i drejtohet palës duke e urdhëruar atë që të pushojë veprimet procedurale të ndërrmarra në juridiksionin gjyqësor. Kjo masë mund të merret si nga gjykata e arbitrazhit, ashtu dhe nga gjykata shtetërore dhe zakonisht përdoret nga palët qoftë kur kanë vërtet kundërshti për juridiksionin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, qoftë edhe për të tejzgjatur procesin e arbitrazhit. Grupi i punës për Ligjin Model, megjithëse mes debatesh të shumta, i konsideroi të përfshira masat “anti-padi” në shprehjen “që dëmtojnë procesin e arbitrazhit”.<sup>615</sup> Një masë e tillë shprehet qartë qoftë në Ligjin Model të UNCITRAL (n.17.2.b), qoftë në Rregulloren e UNCITRAL (n.26.2.b).

Megjithatë çështja nëse arbitrat mund të marrin apo jo masa anti-padi është e diskutueshme. Sikurse është shprehur një autor, ka shumë dyshime nëse një gjykatë arbitrazhi duhet të lejohet t’i tregojë një gjykatë tjetër arbitrazhi apo shtetërore çfarë duhet të bëjë, apo nëse ajo duhet të lejohet të ndërhyjë indirekt në punët e një gjykate tjetër duke urdhëruar një nga palët se çfarë duhet të bëjë me procesin tjetër të arbitrazhit apo gjyqësor.<sup>616</sup> Disa autorë të tjerë janë shprehur se gjykatat e arbitrazhit kanë dhe duhet të jenë të gatshme për të ushtruar kompetencën për të urdhëruar një palë të mos ndjekë një proces gjyqësor në shkëlqje të marrëveshjes së arbitrazhit.<sup>617</sup> Dhe në fakt gjykatat e arbitrazhit kanë dhënë disa herë masa sigurimi nëpërmjet të cilave urdhërojnë palët që të heqin dorë nga procesi gjyqësor i filluar pranë gjykatave shtetërore.<sup>618</sup> Në çështjen *Paul Dinin de Rosier vs. Islamic Republic of Iran*,<sup>619</sup> gjykata e arbitrazhit është shprehur se: “Gjykata e arbitrazhit ka kompetencë të nënkuptuar për të mbrojtur juridiksionin e saj në rastet ku rreziku për dhënien e vendimeve të kundërta në procese paralele të filluara në një vend tjetër e bën këtë të nevojshme.” Në praktikën e ICSID dhe të Gjykatës së Arbitrazhit për çështjet Iran-

<sup>614</sup> Vendim i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në çështjen Van Uden Maritime BV kundër Kommanditgesellschaft in Firma Deco-Line, Case no. C-391/95 [1998] E.C.R. I-7091, 7136-37, para 45-47.

<sup>615</sup> Clyde Croft, Christopher Kee, Jeff Waincymer “A Guide to the UNCITRAL Arbitration Rules” (2013), 26.38. fq 290.

<sup>616</sup> Pierre A. Karrer, “Interim measures issues by arbitral tribunals and the courts: Less theory, please”, in A. van den Berg ed. *International Arbitration and National Courts: The never ending story*, 2001, fq. 106.

<sup>617</sup> Huntley, “The scope of Article 17: Interim measures under UNCITRAL Model Law”, 740 PLI/Lit. 1181, 2005, fq. 86; D. Jasper, *Forum shopping in England and Deutschland*, 1991, fq. 126

<sup>618</sup> “Institutional Arbitration, Article by Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules” (2013) edituar nga Rolf A. Schultze, 578; David D. Caron. “Interim Measures of Protection: Theory and Practice in Light of the Iran United States Claims Tribunal” *ZEITSCHRIFT FÜR AUSLÄNDISCHES ÖFFENLICHES RECHT UND VÖLKERRECHT* 46 (1986) fq.465, 486. gjendet në: [http://works.bepress.com/david\\_caron/135](http://works.bepress.com/david_caron/135)

<sup>619</sup> *Paul Dinin de Rosier vs. Islamic Republic of Iran*, Award in IUSCT Case no. ITM 64-498-1, 4 Dhjetor 1986, 13 Iran-US C.T.R. 1986, fq. 193, 194.

SHBA dhënia e masave anti-padi, që synojnë të ndalojnë një palë të ndjekë procesin e filluar në gjykatë shtetërore, është lloji më i zakonshëm i masave siguroese.<sup>620</sup> Sidoqoftë dhënia e masave anti-padi, pavarësisht se mund të jetë e rëndësishme për mbrojtjen e juridiksionit të arbitrazhit, mbetet një masë shumë delikate që duhet ushtruar me kujdes të veçantë.<sup>621</sup>

Masat anti-padi në fakt nuk janë problematike vetëm në arbitrazh, por edhe në juridiksionin gjyqësor shtetëror. Gjykatat angleze kanë qenë pro marrjes së masave të tilla. Përmendim kështu çështjen *Donohoe v. Armco*, ku gjykata angleze u shpreh se: “Nëse palët kontraktuese bien dakord për t’i dhënë një gjykatë të caktuar juridiksion ekskluziv për të vendosur në lidhje me mosmarrëveshjet midis palëve, dhe një padi që përfshihet në kuadrin e kësaj marrëveshje është ngritur në një gjykatë tjetër e ndryshme nga ajo që kanë rënë dakord palët, gjykata angleze do të ushtrojë rregullisht juridiksionin e saj (qoftë duke dhënë një masë për zhvillimin e procedurave në Angli ose një masë për ndalimin e zhvillimit të procedimit në një gjykatë për të cilën palët nuk kanë rënë dakord – antisuit injunction ose duke ndërmarrë ndonjë masë tjetër të përshtatshme në varësi të rrethanave të çështjes) për të siguruar respektimin e marrëdhënies kontraktore, përveç nëse pala që ka ngritur padi në gjykatën e ndryshme nga ajo për të cilën palët kanë rënë dakord provon se ka arsye të forta për të ngritur padinë në këtë gjykatë”,<sup>622</sup> apo çështjen *Aggeliki Charis Compania Maritima SA v. Pagnan SpA* ku gjykata angleze u shpreh se: “Nuk ka asnjë arsye të fortë për të hezitur në dhënien e një mase sigurimi për të penguar procedimet përpara gjykatave të huaja kur i padituri në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë ka premtuar se nuk do të fillojë këto procedime. Justifikimi për dhënien e masës së sigurimit në çdo rast është se pa këtë masë paditësi do të privohet nga të drejtat e tij kontraktuale në një situatë kur kompensimi monetar është haptazi i papërshtatshëm. Juridiksioni është sigurisht diskrecional dhe nuk ushtrohet në mënyrë të natyrshme, por gjithashtu duhet të provohen arsye të forta pse ky juridiksion nuk duhet të ushtrohet në një çështje të caktuar”.<sup>623</sup>

Ndërkohë që sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë masat anti-padi janë konsideruar se bien në kundërshtim me frymën e Konventës së Brukselit. Në çështjen *Allianz SpA, formerly Riunione Adriatica di Sicurita SpA v. West Tankers Inc.*, përpara Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, u shtrua për zgjidhje çështja: “Nëse është në përputhje me Rregulloren No. 44/2001<sup>624</sup> që një gjykatë e një shteti anëtar të ndërmarrë një masë për të penguar një person për fillimin apo vazhdimin e procesit gjyqësor në një shtet tjetër anëtar, me arsyetimin se këto procedime janë në kundërshtim me një marrëveshje arbitrazhi?” Gjykata u shpreh se: “Është në kundërshtim me Rregulloren No. 44/2001 dhënia nga gjykata e një Shteti Anëtar e një masë për të penguar një person për fillimin apo vazhdimin e procesit gjyqësor në një shtet tjetër anëtar (anti-suit injunction), me arsyetimin se këto procedime janë në

<sup>620</sup> C. Schreuer, “The ICSID Convention: A commentary”, 2<sup>nd</sup> ed. 2009, Art 47, para. 99; C. Brower, & J. Brueschke, “The Iran-United States Claims Tribunal”, 1998, fq.229.

<sup>621</sup> Gary Born, *International Commercial Arbitration*, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: *International Arbitral Procedures*, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2503.

<sup>622</sup> *Donohoe v. Armco, Inc*, HOUSE OF LORDS, [2001] UKHL 64, 13 DECEMBER 2001, para. 24, <http://www.bailii.org/uk/cases/UKHL/2001/64.html>

<sup>623</sup> *AggelikiCharisCompaniaMaritima SA v. Pagnan SpA*, QBCMF 93/1650/B, Royal Courts of Justice, fq. 24-26,

<http://www.justis.com/document.aspx?doc=f7jsrUrxA0LxsKjIo4Gdn3idnZWivLerIOJiujLvdnsm5KdnJmuqdz1ikbtnXctIXaJiSiIs1jxAZrWAJrxAV5ësKjIoW0ha&relpos=0>

<sup>624</sup> COUNCIL REGULATION (EC) No 44/2001 of 22 December 2000, “On jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters”.

kundërshtim me një marrëveshje arbitrazhi. Masa anti-padi vjen në kundërshtim me parimin e përgjithshëm se çdo gjykatë e përcakton vetë, bazuar në rregullat ligjore, nëse ka apo jo juridiksion për të gjykuar një mosmarrëveshje”.<sup>625</sup>

## 7. Masat e sigurimit *ex parte*

Masat *ex parte* janë masa që vendosen nga gjykata në mungesë dhe pa përfaqësues apo njoftim të palës kundër së cilës drejtohen. Këto masa që parashikohen në disa legjislacione, merren në kushte të një urgjencë të madhe dhe kanë për qëllim që të shmangin një dëm të madh dhe të riparueshëm që mund t'i vijë palës që e kërkon nëse pala tjetër do të vihet në dijeni të masës. Juridiksionet gjyqësore shtetërore jo rrallë aplikojnë vendosjen e masave të sigurimit pa iu dhënë mundësia njëerës nga palët për tu dëgjuar, sidomos kur bëhet fjalë për masa që kërkohen para ngritjes së padisë së themelit.<sup>626</sup>

Në arbitrazh dhënia e masave të sigurimit mbi baza *ex parte* është një çështje shumë e diskutueshme. Në parim, në arbitrazhin vendor dhe ndërkombëtar, masat e sigurimit vendosen vetëm pasi t'i jetë dhënë mundësia të dyja palëve për tu dëgjuar. Po a munden gjykatat e arbitrazhit që përjashtimisht të japin masa sigurimi *ex parte*? Shumica e legjislacioneve dhe rregullave të arbitrazhit nuk shprehen lidhur me këtë çështje. Megjithatë ka disa rregullore arbitrazhi që parashikojnë shprehimisht detyrimin e gjykatës së arbitrazhit për të dëgjuar të dyja palët kur shqyrton kërkesa për marrje mase sigurimi.<sup>627</sup> Përmendim për shembull Rregullat e Arbitrazhit të ICSID, neni 39 (4) i të cilave parashikon se gjykata e arbitrazhit do të rekomandojë masa sigurimi, ndryshojë apo revokojë ato vetëm pasi t'i ketë dhënë secilës palë mundësinë për të parashtruar vërejtjet e tyre.

Jo vetëm në rastet kur rregullat e aplikueshme nuk e lejojnë dhënien e masave të sigurimit *ex parte*, por edhe kur ato nuk kanë ndonjë parashikim specifik lidhur me këtë çështje, praktika e arbitrazhit ka treguar që gjykatat e arbitrazhit kanë refuzuar të japin masa të tilla. E tillë është praktika e ICC, rregullat e arbitrazhit të të cilës nuk kanë ndonjë parashikim specifik dhe sipas të cilës lejimi i dhënies së masave të sigurimit *ex parte* do të binte ndesh me parimet që udhëheqin arbitrazhin.<sup>628</sup>

Edhe një pjesë e doktrinës është e këtij qëndrimi. Ka autorë që janë të mendimit se dhënia e masave të sigurimit *ex parte* është përtej kompetencës së gjykatës së arbitrazhit,<sup>629</sup> apo se dhënia e masave të tilla nga gjykata e arbitrazhit do të ishte e papërshtatshme.<sup>630</sup> Argumentet kryesore lidhen me faktin se dhënia e masave të sigurimit mbi baza *ex parte* bie ndesh me dy parime thelbësore të arbitrazhit, që janë përkatësisht, parimi i kontradiktoritetit (i së drejtës për tu dëgjuar), i cili merr edhe një

---

<sup>625</sup> Allianz SpA, formerly Riunione Adriatica di Sicurita SpA v. West Tankers Inc., ICJ CASE C-185/07, para. 29, 32, 36.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/HTML/?isOldUri=true&uri=CELEX:62007CJ0185>

<sup>626</sup> Neni 204 K.Pr.C. i Republikës së Shqipërisë.

<sup>627</sup> LCIA Arbitration Rules neni 22; Neni 17(2) i Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar në Kopenhagen etj.

<sup>628</sup> Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, 59

<sup>629</sup> D. Caron & L.Caplan & M.Pellonpaa, “The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary”, 2006, fq. 543

<sup>630</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 607, para. 23-71; Jose Maria Abascal “The art of Interim Measures” publikuar në “International Arbitration 2006: Back to Basics? Botim i International Council for Commercial Arbitration (ICCA), edituar nga Albert Jan Van Den Berg, para. 7, fq. 763.

rëndësi më të madhe në arbitrazh në raport me sistemin gjyqësor, duke pasur parasysh që kundër masës së sigurimit të dhënë *ex parte* nuk lejohet ankim sikurse ndodh në sistemin gjyqësor,<sup>631</sup> dhe parimi i paanshmërisë së gjykatës së arbitrazhit, pasi gjykata e arbitrazhit nuk duhet të angazhohet në komunikime *ex parte* me palët dhe kjo vlen edhe në rastin e dhënies së masave të sigurimit.<sup>632</sup>

Megjithatë ka një grup autorësh<sup>633</sup> që janë pro dhënies së masave siguruese *ex parte* nga gjykatat e arbitrazhit, duke argumentuar se parimi i së drejtës për tu dëgjuar nuk duhet të shtrihet në procedurën e dhënies së masave të sigurimit. Gjithashtu parimi i drejtësisë e justifikon një përjashtim të tillë në rastet e një urgjence maksimale dhe komunikimi *ex parte* i arbitrave me palën për dhënien e masës siguruese nuk duhet të konsiderohet se bie ndesh me parimin e paanshmërisë.

Berger<sup>634</sup> argumenton se zbatimi i ngurtë i të drejtës për tu dëgjuar vështirë se mund të pajtohet me funksionin e masave siguruese, të cilat shpesh kërkojnë efektin surprizë të masave *ex parte* për të qenë efektive. Gjithashtu, arbitrat më vonë mund të ndryshojnë ose të revokojnë masën e dhënë me kërkesë të palës tjetër në seancën vijuese dëgjimore.

Sidoqoftë në dhënien e këtyre masave arbitrat duhet të tregohen shumë të kujdesshëm dhe të analizojnë nëse përmbushen të gjitha kriteret që duhen për dhënien e masave të tjera të sigurimit. Veçanërisht duhet të jepen prova që justifikojnë dhënien e masës *ex parte* dhe gjykata e arbitrazhit duhet të arsyetojë në vendimin e saj shkaqet që çuan në dhënien e masës *ex parte*. Sugjerohet që masa të jepet në formën e urdhrit, të parashikojë që mund të ndryshohet apo revokohet me kërkesë të palës në seancën më të parë dëgjimore dhe të jepet kundrejt garancisë për shpërblim dëmi në rast se rezulton që masa nuk duhej të ishte dhënë.<sup>635</sup>

Debati i doktrinës është nxitur edhe më tej me ndryshimet e fundit që i janë bërë Ligjit Model të UNCITRAL në lidhje me masat e sigurimit në vitin 2006, në të cilat është parashikuar shprehimisht dhënia e masave të sigurimit *ex parte*, duke i cilësuar ato si urdhra paraprakë.<sup>636</sup> Pavarësisht se Ligji Model UNCITRAL i parashikoi masat

---

<sup>631</sup> Schwartz, "The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration", 1993, fq. 27; Bernardini, "The powers of arbitrators", botuar në Conservatory and provisional measures in International Arbitration, botim i ICC, 1993, fq. 21; Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", 2003, fq. 607, para. 23-72; Stalev, "Interim measures of protection in the context of arbitration", në van den Beg (ed.) International Arbitration in a Changing World, Kluwer, 1994, fq. 111.

<sup>632</sup> DERAIS, Arbitral *Ex Parte* Interim Relief, Dis Res Jo 61

<sup>633</sup> Berger, "International Economic Arbitration", Kluwer Law and Taxation Publishers, 1993, fq.337; Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 220-227.

<sup>634</sup> Idem.

<sup>635</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 226-227.

<sup>636</sup> Sipas nenit 17B (1) të Ligjit Model të UNCITRAL përveç kur është parashikuar ndryshe nga palët, njëra palë mundet, pa njoftuar palën tjetër, të bëjë një kërkesë për masë sigurimi së bashku me një kërkesë për urdhër paraprak sigurimi me qëllim që pala tjetër të mos ndërmarrë veprime që pengojnë qëllimin e masës së sigurimit të kërkuar. (2) Gjykata e arbitrazhit mund të lëshojë një urdhër paraprak sigurimi nëse ajo çmon se zbulimi paraprak i kërkesës për masë sigurimi nga pala kundër të cilës ajo është drejtuar, rrezikon të pengojë qëllimin e masës së sigurimit.(3) Kushtet e parashikuara për dhënien e masës së sigurimit (neni 17A) aplikohen për çdo urdhër paraprak sigurimi, me kusht që dëmi i përcaktuar dem që ka të ngjarë të rezultojë nga fakti nëse urdhri jepet ose jo dhe jo nga masa e sigurimit. Pasi gjykata e arbitrazhit bën një vlerësim të kërkesës për urdhër paraprak sigurimi, gjykata e arbitrazhit duhet të njoftojë palët për kërkesën për masë sigurimi, aplikimin për urdhrin paraprak të sigurimit, urdhrin paraprak të sigurimit nëse ka vendosur të japë një të tillë dhe të gjitha komunikimet, duke përfshirë çdo komunikim me gojë midis secilës nga palët dhe gjykatës së arbitrazhit në lidhje me to. (2) Në të njëjtën kohë, gjykata e arbitrazhit duhet t'i japë mundësinë palës kundër të cilës është vendosur një urdhër paraprak sigurimi që të paraqesë qëndrimin e saj sa më shpejt të jetë e mundur. (3)

e sigurimit *ex parte*, shumë pak nga shtetet që kanë adoptuar Ligjin Model të UNCITRAL kanë adoptuar dispozitat në fjalë.<sup>637</sup> Për disa autorë bërja e një ndryshimi të tillë në Ligjin Model ishte i keqmenduar, ose të paktën para kohe duke pasur parasysh faktin që në shumicën e juridiksioneve gjykata e arbitrazhi nuk mund të japë masa forcërisht të ekzekutueshme dhe urgjenca për vendosjen e masës së sigurimit pa njoftuar palën tjetër me arsyen se po të njoftohet pala tjetër ajo mund të fshehë pasurinë nuk ka shumë kuptim, sepse pala tjetër nëse e ka këtë qëllim mund ta realizojë edhe gjatë kohës që merr procedura e ekzekutimit të masës së sigurimit e cila është e konsiderueshme.<sup>638</sup>

Në fakt, ky ndryshim i Ligjit Model ka ngjallur jo pak debate në doktrinën e arbitrazhit dhe është bërë shkak për shkrime të shumta nga autorë që e mbështesin këtë ndryshim dhe nga ata që kanë qëndrim të kundërt. Shkurtimisht argumentet pro që renditen janë:<sup>639</sup>

- Kur nevoja dhe zbatimi i masave *ex parte* ekzistojnë, pse të mos i jepet një e drejtë e tillë e shprehur edhe gjykatave të arbitrazhit?
- Kur arbitrat përgjithësisht mund të japin të gjitha masat e sigurimit ashtu si gjykatat shtetërore pse të mos japin dhe këto lloje masash?
- Dhënia e masave të sigurimit *ex parte* në arbitrazh parashikon disa mjete mbrojtëse për palën kundër së cilës jepen, të tilla si: (i) koha e kufizuar, sepse kjo masë parashikohet të jetë në fuqi jo më shumë se 20 ditë dhe ndërkohë duke qenë se pala tjetër informohet menjëherë, kjo e fundit brenda një kohe edhe më të shkurtër mund të kërkojë të dëgjohet *inter partes*; (ii) Përveç dëmit të riparueshëm gjykata e arbitrazhit i kërkon palës të provojë urgjencën e masës, e cila duhet të jetë e tillë që nuk mund të presë masën e rregullt të sigurimit, sepse do t'i shkaktonte një dëm të jashtëzakonshëm; (iii) Pala kërkuese e masës *ex parte* do të jetë përgjegjëse për dëmin dhe kostot që i shkaktohen palës kundër së cilës drejtohet masa; (iv) Palët kanë të drejtë të *opt-out* nga kjo e drejtë; (v) Sipas propozimit, gjykatës shtetërore t'i jepet mundësia të bëjë një rishikim shkaqeve për të cilat masa është dhënë *ex parte*.
- Nëpërmjet masave *ex parte* palëve u jepet mundësia që të zgjidhin gjithë mosmarrëveshjen mes tyre në arbitrazh, pa ndërhyrë me juridiksionin gjyqësor shtetëror dhe në një proces të ndershëm dhe efektiv.
- Palët shpesh nuk kuptojnë gjuhën zyrtare të gjykatave shtetërore dhe nuk ndihem komod në një sistem gjyqësor të huaj, në të cilin duhet të marrin avokatë që nuk flasin gjuhën e tyre, apo të familjarizohen me një sistem juridik që nuk e kanë zgjedhur për aplikim. Për më tepër, palët mund të jenë

---

Gjykata e arbitrazhit duhet të vendosë aty për aty për çdo kundërshtim ndaj urdhrin paraprak të sigurimit. (4) Një urdhër paraprak siguri e humbet fuqinë pas 20 ditësh duke filluar nga dita në të cilën është lëshuar nga gjykata e arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit mund të japë një masë siguri duke ndryshuar apo modifikuar urdhrin paraprak të sigurimit, pasi i është dhënë mundësia palës kundër të cilës është lëshuar masa e përkohshme që të paraqesë qëndrimin e saj. (5) Urdhri paraprak i sigurimit është i detyrueshëm për palët, por nuk mund të jetë objekt i zbatimit nga gjykata. Ky urdhër paraprak nuk përbën vendim gjyqësor.

<sup>637</sup> Hong Kong Arbitration Ordinance 2013. Gjithashtu projektligji shqiptar “Mbi Arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë” ka adoptuar nenin 17B të Ligjit Model.

<sup>638</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2510.

<sup>639</sup> Shiko James E. Castello, “Arbitral *Ex parte* Interim Relief, The View in Favour” prezantuar në 28 Maj 2003 në një konferencë ndërkombëtare arbitrazhi. Artikulli i plotë gjendet në:

<http://web.a.ebscohost.com/ehost/pdfviewer/pdfviewer?vid=3&sid=1f0d744f-3b0a-45f8-ba3f-1748b0cce200%40sessionmgr4002&hid=41091>.

skeptikë për nivelin e ekspertizës së gjykatave shtetërore apo për anshmërinë e tyre.

- Fakti që nëse aplikohen masat *ex parte* kërkohet medoemos ndërhyrja e sistemit gjyqësor shtetëror për ekzekutimin e tyre, nuk është arsye e mjaftueshme për të mohuar një mundësi të tillë në arbitrazh, sepse ka shumë raste në praktike që palët i zbatojnë vullnetarisht masat e ekzekutimit.
- Parimet e procesit të rregullt ligjor, barazisë së armëve etj. janë parime që i takojë më së shumti juridiksionit gjyqësor dhe përsëri gjykatat shtetërore vendosin masa të përkohshme *ex parte*.
- Në mungesë të së drejtës së apelimit të vendimit për masë sigurimi *ex parte* në arbitrazh, gjykata e arbitrazhit duhet të dëgjojë palët *infra partes* në momentin më të parë të mundshëm pas dhënies së masës *ex parte*.

Ndërsa përmbledhtazi ndër argumentet kundër renditen:<sup>640</sup>

- Për aq kohë sa shumë përfaqësues shtetesh kanë kundërshti ndaj masave të sigurimit (për më të tepër disa shtete nuk parashikojnë fare të drejtën e gjykatës së arbitrazhit për të vendosur masa sigurimi) do të rrezikohet adoptimi i Ligjit Model nga vende të ndryshme, adoptim që deri tani ka qenë i suksesshëm.
- Qëllimi që kërkohet të arrihet me masat *ex parte* nuk ndryshon nga qëllimi që kërkohet të arrihet me masat e zakonshme të sigurimit. Edhe shpejtësia më e madhe e procesit është e vështirë për t'u garantuar;
- Masat *ex parte* janë të papajtueshme me natyrën kontraktuale të arbitrazhit. Në asnjë rast të vetëm palët në një marrëveshje arbitrazhi nuk do të binin dakord për vendosje masash *ex parte*.
- Masat *ex parte* janë të papajtueshme me të drejtën e mbrojtjes së palës në proces dhe të parimit të kontradiktoritetit;
- Masat *ex parte* rrezikojnë të mbeten të pa ekzekutueshme në vendet nënshkruese të Konventës së Brukselit;
- Masat *ex parte* krijojnë rrethana për paragjykimin e arbitrave;
- Masat *ex parte* krijojnë rrethana për të dëmtuar procesin e arbitrazhit duke vënë në pozitë arbitrin e caktuar nga pala kundër së cilës drejtohet masa e sigurimit;
- Masat *ex parte* mund të krijojnë dëm të riparueshëm; E drejta e apelimit që ekziston në gjykatat shtetërore ndaj masës së sigurimit *ex parte* nuk ekziston në arbitrazh.
- Shkelja e kodit të etikës nga arbitrat në vendosjen e masave të sigurimit *ex parte* mund të sjelli dëme për palët të pakrahasueshme me dëmin që mund t'u shkaktohet arbitrave nga shkelja e kodit të etikës;
- Ligji Model nuk e adreson përgjegjësinë e arbitrave si jashtë fushës së saj, por në fakt masa të tilla mund të bëhen shkak për përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe për arbitrat, çfarë i bën këta të fundit që tu rrinë larg këtyre lloj masash.

Me sa duket argumentet pro ishin ato që prevaluan në grupin e punës dhe Ligji Model parashikoi mundësinë e gjykatës së arbitrazhit për të vënë masa sigurimi *ex parte*, ndërkohë që në praktikë duket se favorizohen më shumë argumentet kundër.

---

<sup>640</sup> Shiko: Hans Van Houtte, "Ten reasons against a proposal for *ex parte* Interim Measures of Protection in arbitration". Artikulli i prezantuar në Konferencën mbi Masat e sigurimit organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Institucioneve të Arbitrazhit Tregtar (IFCAI) në vitin 2003.

## KAPITULLI III

### EKZEKUTIMI I MASAVE TË SIGURIMIT TË DHËNA NGA GJYKATAT E ARBITRAZHIT

Dhënia e një mase sigurimi nuk do të ishte efektive nëse ajo nuk do të mund të ekzekutohej. Për fat të keq masat e sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit nuk janë të vetë-ekzekutueshme, sepse arbitrave u mungon autoriteti shtrëngues që kanë gjykatat shtetërore.<sup>641</sup> Megjithatë edhe masat e sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit kanë një lloj peshe dhe shpesh janë ekzekutuar vullnetarisht.<sup>642</sup> Por ka dhe mjaft raste kur ato nuk ekzekutohen vullnetarisht. Dhe në raste të tilla gjykata e arbitrazhit mund të vendosë sanksione për moszbatimin e tyre. Ndërkohë që zgjidhja më e mirë mbetet ekzekutimi gjyqësor i tyre.

#### 1. Sanksionet për moszbatimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit

Duke pasur parasysh që gjykatës së arbitrazhit i mungon forca shtrënguese për të detyruar palët të zbatojnë masat e sigurimit të dhëna prej saj, natyrshëm lind pyetja nëse ato mundën apo jo të vendosin sanksione kundër palës që refuzon zbatimin. Dhe në fakt përgjigjja është po. Disa nga sanksionet që mund të vijnë si rezultat i moszbatimit të masës siguruese janë (i) nxjerrja e konkluzioneve të pafavorshme për palën që refuzon zbatimin dhe (ii) ngarkimi me përgjegjësi për dëmet dhe kostot si rezultat i moszbatimit të masës. Gjithashtu mundet që gjykata e arbitrazhit të vendosë edhe gjoba, por kjo është e mundur vetëm nëse palët shprehimisht kanë rënë dakord për diçka të tillë ose nëse ligji i zbatueshëm e parashikon shprehimisht.<sup>643</sup>

##### 1.1. Konkluzion i pafavorshëm për palën që refuzon zbatimin

Në parim nëse pala nuk zbaton masën e sigurimit të dhënë, gjykata e arbitrazhit mund të nxjerrë nga kjo sjellje e palës konkluzione të pafavorshme për të. Por në fakt kjo mundësi është shumë e kufizuar. Doktrina pranon pothuajse në unison që një sanksion i tillë është i kuptueshëm vetëm në rastin e moszbatimit të masave për sigurimin e provës dhe në asnjë rast tjetër. Sipas Poudret dhe Besson,<sup>644</sup> është e papranueshme që arbitrat të sanksionojnë një nga palët për moszbatimin e masës së dhënë prej tyre me vendimin e saj përfundimtar, përveç kur ka një lidhje shkakësore ndërmjet moszbatimit të masës dhe rezultatit përfundimtar mbi themelin e

---

<sup>641</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", 2003, fq. 610, para. 23-82; Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, para. 3-24.

<sup>642</sup> Sipas një sondazhi të bërë nga AAA rezulton se në 90% të çështjeve të arbitrazhit vendor dhe ndërkombëtar (45 nga 50 çështje) palët në arbitrazh i kanë zbatuar vullnetarisht vendimet për masa sigurimi. Cituar në Ali Yesilirmak, "Provisional measures" publikuar në Pervasive problems in International Arbitration, edituar nga Loukas A. Mistelis dhe Julian DM Leë. (2006), footnote 53.

<sup>643</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", 2003, fq. 610, para. 23-82; Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 242, para. 6-5; E Allan Farnsworth, "Punitive damages in arbitration", 7(1) Arb. Int'l, 1991, fq.3.

<sup>644</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 540, para. 630.



mosmarrëveshjes. Dhe shembulli klasik do të ishte refuzimi i një pale për të paraqitur një dokument, gjë që mund të merret si provë e fakteve të pretenduara nga pala tjetër.

Të tjerë autorë argumentojnë se gjykata e arbitrazhit nuk mund të bëjë një palë përgjegjëse për themelin e padisë, vetëm sepse ajo nuk ishte bashkëpunuese në lidhje me vendimin e gjykatës së arbitrazhit për masën e sigurimit. Kjo sepse detyrimi i gjykatës së arbitrazhit për të vepruar me drejtësi kundrejt palëve shtrihet edhe në rastin kur palët janë “të vështira”.<sup>645</sup>

## **1.2. Dëmet dhe kostot nga moszbatimi i masës së dhënë**

Gjykata e arbitrazhit mund ta ngarkojë me përgjegjësi një palë që refuzon të zbatojë masën siguruuese të dhënë prej saj për dëmin dhe kostot që mund të shkaktohen nga kjo mospërbushje. Kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë një sanksion të tillë bazohet ose në interpretimin e gjerë që i bëhet vetë marrëveshjes së arbitrazhit, meqenëse detyrimi për dëmshpërblim rrjedh nga kontrata, ose më saktë ka lidhje me dispozitën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që parashikohet në kontratë, ose nënkuptohet se rrjedh nga kompetenca për të dhënë masa sigurimi.<sup>646</sup> Shuma e kostos që mund të ngarkohet lidhet vetëm me masën e sigurimit, pra shpenzimet e kryera për shkak të veprimeve që bën pala tjetër duke i bërë seancat për marrjen e masës më të gjata apo të kushtueshme.

## **2. Ekzekutimi i masave të sigurimit në vendin e arbitrazhit**

Sikurse u shprehëm më sipër gjykatës së arbitrazhit i mungon autoriteti shtrëngues për të garantuar ekzekutimin forcërisht të masave të sigurimit të dhëna prej saj. Pavarësisht se në parim ajo mund të vendosë sanksione për palën që nuk zbaton masën siguruuese, sikurse u trajtuan më sipër, ato nuk janë të mjaftueshme për të garantuar ekzekutimin e masave të sigurimit. Duke qenë që ekzekutueshmëria e masave të sigurimit është shumë e rëndësishme jo vetëm për të arritur qëllimin e tyre, por edhe për të garantuar efektivitetin e arbitrazhit në përgjithësi, ligjet kombëtare të shumë shteteve parashikojnë mundësinë e ekzekutimit të masave të sigurimit nëpërmjet juridiksionit gjyqësor. Megjithatë një pjesë e legjislacioneve nuk parashikojnë shprehimisht ekzekutimin e masave të sigurimit të urdhëruara nga gjykatat e arbitrazhit duke ia lënë ekzekutimin e tyre dispozitave të përgjithshme për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të arbitrazhit, ndërsa disa juridiksione të tjera kanë parashikuar në dispozita të veçanta mënyrën e ekzekutimit të masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit.<sup>647</sup> Edhe Ligji Model i UNCITRAL pas ndryshimeve të vitit 2006, parashikon dispozita të posaçme për ekzekutimin e këtyre masave.<sup>648</sup>

Por përgjithësisht dispozitat e legjislacioneve kombëtare parashikojnë për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit me seli në shtetin ku kërkohet ekzekutimi i tyre. Ndaj, kur gjykata e arbitrazhit ka selinë në një shtet tjetër këto dispozita nuk zbatohen dhe nuk e mbulojnë ekzekutimin e masave të

---

<sup>645</sup> Pierre A. Karrer, “Interim measures issues by arbitral tribunals and the courts: Less theory, please”, in A. van den Berg ed. *International Arbitration and National Courts: The never ending story*, 2001, fq. 103.

<sup>646</sup> Idem, fq. 103.

<sup>647</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: *International Arbitral Procedures*, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2511-2512.

<sup>648</sup> Neni 17H i Ligjit Model të UNCITRAL

dhëna jashtë shtetit. Në këto raste ekzekutimi varet nga rregullat e ekzekutimit të vendit ku kërkohet ekzekutimi, ose nga marrëveshje bilaterale apo multilaterale.<sup>649</sup>

Ligjet kombëtare që parashikojnë për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit nëpërmjet autoriteteve gjyqësore në vendin e arbitrazhit ndjekin dy përjasje kryesore: (i) duke lejuar ekzekutimin e këtyre masave njësoj si vendimi përfundimtar i arbitrazhit dhe (ii) duke parashikuar për ndihmën e gjykatave shtetërore në ekzekutimin e tyre.

### ***2.1. Ekzekutimi i masave të sigurimit si vendime përfundimtare të arbitrazhit***

Legjislacionet e disa shteteve i barazojnë masat e sigurimit të padisë të urdhëruara nga gjykata e arbitrazhit me vendimet përfundimtare të gjykatës së arbitrazhit dhe për ekzekutimin e tyre zbatohen të njëjtat dispozita që zbatohen edhe për vendimet përfundimtare. I tillë është për shembull Kodi i Procedurës Civile holandez, i cili në nenin 1043b(4) parashikon shprehimisht se: “Përveç kur gjykata e arbitrazhit parashikon ndryshe, vendimi i gjykatës së arbitrazhit mbi një kërkesë për të dhënë masë sigurimi do të përbëjë një vendim përfundimtar arbitrazhi (award) për të cilin do të zbatohen dispozitat e seksioneve tre deri në pesë”. Këto seksione kanë ndër të tjera dispozitat për vendimin përfundimtar dhe mënyrën e ekzekutimit të tij. Sipas nenit 1062 të KPrC Holandez parashikohet se vendimet e arbitrazhit, (përfshi këtu edhe vendimet për masat e sigurimit nëse i referohemi nenit 1043b(4)) [shtesë e autorit] mund të ekzekutohet në Holandë vetëm në bazë të një urdhri ekzekutimi të lëshuar nga gjykata e distriktit të vendit të arbitrazhit. I vetmi shkak për të cilin gjykata mund të refuzojë lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është kur pas një hetimi të përsheptuar çmon se vendimi bie ndesh me rendin publik.<sup>650</sup>

Legjislacioni holandez nuk është i vetmi që ka një parashikim të tillë. Shtete të tjera ku ndeshim të njëjtën përjasje janë: Australia, Skocia, Malta, Kalifornia, Ontario etj.<sup>651</sup> Madje megjithëse Akti Federal i Arbitrazhit në Shtetet e Bashkuara nuk ka parashikuar shprehimisht trajtimin e masave të sigurimit të padisë njësoj si vendimet përfundimtare të arbitrazhit për efekt të ekzekutimit të tyre, praktika<sup>652</sup> dhe doktrina<sup>653</sup> kanë mbajtur qëndrimin se masat e sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit duhet të ekzekutohen në Sh.B.A njësoj si çdo vendim tjetër i gjykatës së arbitrazhit.

---

<sup>649</sup> Julian D.M. Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 612, para. 23-88.

<sup>650</sup> Shiko nenin 1063(2) të KPrC hollandez

<sup>651</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 540-541, footnote 471.

<sup>652</sup> Shiko për shembull: *Arowhead Global Solutions, Inc. v. Datapath, Inc.* 166 F.Appx. (4<sup>th</sup> Cir.2006), fq. 39-41 “Gjykatat e arbitrazhit duhet të kenë kompetencë për të dhënë vendime të një natyre të përkohshme në formën e masave të sigurimit dhe gjykatat shtetërore duhet të kenë kompetencë për të konfirmuar dhe ekzekutuar sikur të ishte një vendim përfundimtar”; *CE Int’l Res. Holdings LLC v. SA Minerals Ltd.*, 2012 US Dist. LEXIS 176158 (S.D.N.Y.): “urdhri që sekuestron asetet për sigurimin e padisë në arbitrazh është një vendim përfundimtar për qëllim të ekzekutimit.”; *Century Indem. Co. v. Certain Underwriters in Lloyd’s London*, 2012 WL 102773 (S.D.N.Y.): “vendimi i ndërmjetëm është përfundimtar dhe mund të njihet, nëse ai vendos përfundimisht për një pretendim të pavarur edhe pse nuk vendos për të gjitha pretendimet, urdhrat për sigurimin e asetëve janë përfundimtarë.”

<sup>653</sup> Gaitis, *The Federal Arbitration Act: Risks and Incongruities relating to the issuance of interim and partial awards in domestic and international arbitration*, 16 *Am. Rev. Int’l Arb.* 2005, fq.1; von Mehren, *The enforcement of arbitral awards under conventions and United States Law*, 9 *Yale J. World Pub. Order*, 1983, fq. 343, 262-263.

## 2.2. Ndhimja e gjykatës shtetërore në ekzekutimin e masës

Disa legjislacione parashikojnë për një procedurë të veçantë për ekzekutimin e masave të sigurimit duke mos ua lënë ekzekutimin e tyre dispozitave që zbatohen për ekzekutimin e vendimit përfundimtar të arbitrazhit. Këto legjislacione parashikojnë për ndërhyrjen e gjykatës shtetërore për të vënë në ekzekutim masat e dhëna nga gjykata e arbitrazhit. Kjo ndërhyrje e gjykatës shtetërore për të garantuar efikasitetin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit është e ndryshme nga kompetenca e gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi drejtpërdrejt me kërkesë të palëve.<sup>654</sup>

Kodi i procedurës civile gjerman është një nga shembujt tipikë të këtyre legjislacioneve. Neni 1041(2) i tij parashikon që, me kërkesë të palës, gjykata shtetërore, lejon ekzekutimin e një mase të dhënë nga gjykata e arbitrazhit, përveç kur aplikimi për këtë masë është bërë tashmë në gjykatën shtetërore. Gjykata shtetërore në Gjermani, kur ligji procedural shtetëror nuk e parashikon masën e dhënë nga gjykata e arbitrazhit dhe me qëllim që ta bëjë atë të ekzekutueshme, mundet gjithashtu ta rishikojë këtë masë duke e përshtatur me një nga format më të ngjashme që parashikon ligji procedural shtetëror. Me kërkesë të palës, gjykata shtetërore gjithashtu mund të heqë ose të ndryshojë vendimin e dhënë. Është disi konfuzë nëse kjo kompetencë e gjykatës shtetërore për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit shtrihet edhe në rastin e masave të dhëna nga një gjykatë arbitrazhi me vend arbitrazhi jashtë Gjermanisë. Referuar nenit 1025(1) i cili parashikon se “dispozitat e këtij ligji aplikohen vetëm nëse vendi i arbitrazhit është në Gjermani, dhe neni 1025(2), i cili nuk e përfshin nenin 1041 të cituar më sipër, tek dispozitat e aplikueshme edhe në arbitrazhin e zhvilluar jashtë Gjermanisë, duket se ligji gjerman nuk rregullon procedurën e ekzekutimit të vendimit për masë sigurimi të dhënë nga një gjykatë arbitrazhi e vendosur në një vend jashtë Gjermanisë. Por ndërkohë neni 1062(2) parashikon për kompetencën e gjykatave gjermane sipas nenit 1041 edhe kur vendi i arbitrazhit është jashtë Gjermanie. Pra, sipas nenit 1062 (1) pika 3 përcaktohet se gjykata kompetente për të asistuar në ekzekutimin e masës së dhënë nga gjykata e arbitrazhit në një proces me vend arbitrazhi në Gjermani është Gjykata e Lartë Rajonale që kanë zgjedhur palët me marrëveshjen e arbitrazhit, ose në mungesë të një përcaktimi të tillë, ajo e vendit të arbitrazhit, kurse sipas nenit 1062 (2) parashikon se për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit, në rastet kur vendi i arbitrazhit ka qenë jashtë Gjermanie, kompetente do të jetë Gjykata e Lartë Rajonale vendbanimit apo selisë së personit kundër të cilit do të vendoset masa apo e vendit ku ndodhet pasuria mbi të cilën do të ekzekutohet kjo masë. Në rast se këto nuk dihen, atëherë kompetente do të jetë Gjykata e Lartë Rajonale e Berlinit. Duket që mes nenit 1025(2) dhe nenit 1062(2) ka një kundërshti, megjithatë doktrina është e mendimit se neni 1062(2) prevalon mbi nenin 1025(2) ndaj kompetenca e gjykatave gjermane për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit shtrihet edhe në rastin e masave të dhëna në një arbitrazh me vend jashtë Gjermanie.<sup>655</sup>

Edhe Zvicra ka një parashikim të ngjashëm lidhur me ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit, por ka gjithashtu disa veçori që e bëjnë atë të dallojë nga rregullimi ligjor gjerman. Përkatesisht, neni 183(2) i së Drejtës Ndërkombëtare Private Zvicerane parashikon se nëse pala nuk e zbaton vullnetarisht

<sup>654</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 543, para. 635.

<sup>655</sup> Idem, fq. 544, para. 636

masën e sigurimit të dhënë nga gjykata e arbitrazhit, kjo e fundit ka të drejtë të kërkojë mbështetjen e gjykatës shtetërore, e cila zbaton ligjin e saj. Ky parashikim ligjor nuk specifikon se çfarë lloj “mbështetjeje” jep gjykata shtetërore, pra ajo jep një urdhër të ri apo thjesht “ekzekuton” masën e dhënë nga arbitrat. Nëse doktrina është e mendimit që gjykata në këtë rast jep një urdhër të saj, edhe duke e përshtatur masën e dhënë nga arbitri kur ajo nuk parashikohet nga legjislacioni zviceran; praktika ka treguar gjithashtu se në disa kantone të Zvicrës masa e dhënë nga arbitrat thjesht është deklaruar e ekzekutueshme nga gjykata.<sup>656</sup> Veçoria e ligjit zviceran është fakti që ai autorizon gjykatën e arbitrazhit për t’iu drejtuar gjykatës shtetërore për mbështetje në ekzekutimin e masës së sigurimit dhe nuk ia njeh, të paktën shprehimisht këtë të drejtë palëve. Sipas disa autorëve nuk është e përshtatshme që e drejta për të investuar gjykatën në një rast të tillë të kufizohet vetëm tek arbitrat.<sup>657</sup> Ashtu si ligji gjerman edhe ligji zviceran nuk e ka shumë të qartë nëse mbështetja e autoriteteve gjyqësore zvicerane shtrihet vetëm për masat e sigurimit të dhëna në procese arbitrazhi me vend arbitrazhi në Zvicër, apo edhe jashtë saj. Opinioni dominant i doktrinës është që gjykatat zvicerane të cilat kanë juridiksion ndërkombëtar, mund të shqyrtojnë një kërkesë sipas nenit 183(2) edhe kur vendi i arbitrazhit nuk është Zvicra, megjithatë në këtë rast duhet që legjislacioni i vendit të arbitrazhit të lejojë arbitrat të kërkojnë ndërhyrjen e gjykatës shtetërore.<sup>658</sup>

Nëse do të shohim Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, lehtësisht konstatohet se ai ka një rregullim pothuajse identik me ligjin zviceran lidhur me ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga arbitrat. Konkretisht neni 418 paragrafi 2 parashikon se: “Nëse pala tjetër nuk zbaton vullnetarisht këto masa, gjykata e arbitrazhit i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”. Për fat të keq praktika dhe doktrina shqiptare nuk na ofrojnë shumë për të kontribuar në diskutimet për çështjet e mësipërme të ngritura gjatë analizës së ligjit zviceran. E vetmja gjë që mund të thuhet pa diskutim është që neni 418 i KPrC shqiptar nuk zbatohet për masat e sigurimit të dhënë nga arbitrat në një proces me vend arbitrazhi të ndryshëm nga Shqipëria, sepse neni 400 i KPrC qartazi parashikon se: “Dispozitat e këtij kreu vlejné për procedurën e gjykimeve të arbitrazhit, kur pjesëmarrësit në proces janë me banim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë dhe kur vendi i procedurës së arbitrazhit ndodhet në territorin e saj.” Ndërkohë që sipas nenit 439 arbitrazhi ndërkombëtar rregullohet me ligj të veçantë. Për fat të keq ende nuk ka një ligj të tillë të posaçëm për arbitrazhin ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë. Sidoqoftë, aktualisht janë ndërmarrë disa hapa pozitivë në këtë drejtim dhe është hartuar një projektligj për arbitrazhin ndërkombëtar, i cili është ende në proces diskutimi me grupet e interesit dhe strukturat përkatëse dhe është pothuajse në përputhje të plotë me Ligjin Model të UNCITRAL, veçoritë e të cilit lidhur me këtë çështje do i trajtojmë më poshtë.

I ngjashëm është edhe Akti anglez i Arbitrazhit, cili parashikon në nenin 42.1. se përveç kur palët parashikojné ndryshe, gjykata shtetërore mund të urdhërojé palén që të përmbushi urdhrat e preré të dhënë nga gjykata e arbitrazhit. Veçori e ligjit anglez është se ai parashikon që gjykata shtetërore mund të investohet si nga gjykata e arbitrazhit, ashtu dhe nga palët me leje të gjykatës së arbitrazhit. Për disa autoré një

---

<sup>656</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 545, para. 637.

<sup>657</sup> Idem, fq.544, para 637.

<sup>658</sup> Idem

parashikim i tillë është zgjedhja më e mirë, sepse shmang mundësinë që të veprojë vetë gjykata e arbitrazhit, gjë e cila mund të perceptohet si njëanshmëri e saj.<sup>659</sup>

Ndryshimet e vitit 2006 në Ligjin Model të UNCITRAL, parashikuan gjithashtu për një mekanizëm të veçantë për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit. Neni 17H i tij përcakton se një masë sigurimi e dhënë nga gjykata e arbitrazhit do të njihet si e detyrueshme dhe, përveç kur parashikohet ndryshe nga gjykata e arbitrazhit, do të ekzekutohet pas kërkesës në gjykatën kompetente, pavarësisht në cilin shtet është dhënë, sipas kushteve të nenit 17I.<sup>660</sup> Siç shihet Ligji Model i UNCITRAL, parashikon shprehimisht mundësinë e gjykatave shtetërore për të ekzekutuar vendime për masa të sigurimi të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit që ndodhen në një vend të ndryshëm nga ai ku ndodhet gjykata shtetërore së cilës i kërkohet ekzekutimi. Ky amendim i ligjit në vitin 2006 është një hap përpara, dhe për vendet që e kanë adaptuar këtë ndryshim i ka dhënë përgjigje problematikës së ekzekutimit të masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit në një shtet tjetër, jashtë vendit të arbitrazhit.

### **3. Ekzekutimi i masave të sigurimi në një shtet të ndryshëm nga vendi i arbitrazhit**

Në shumicën e rasteve të arbitrazhit ndërkombëtar, vendi i arbitrazhit nuk ka asnjë lidhje me palët apo me mosmarrëveshjen. Zakonisht arbitrazhi zhvillohet në një vend që është neutral për palët dhe objektin e marrëdhënies juridike mes palëve. Ndaj shpesh palët nuk kanë asnjë pasuri në vendin e arbitrazhit dhe për rrjedhojë ekzekutimi i masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit në vendin e arbitrazhit nuk bën kuptim. Në këto kushte palët janë të interesuara për të ekzekutuar masat e sigurimit jashtë vendit të arbitrazhit. E vetmja mënyrë se si mund të bëhet e mundur kjo është nëpërmjet procesit të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve ose në bazë të ligjit të shtetit të huaj, ose në bazë të ndonjë marrëveshjeje bilaterale apo multilaterale.

---

<sup>659</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 544-545, para. 637-638.

<sup>660</sup> Neni 17 I: "1. Njohja ose ekzekutimi i një mase të sigurimit të padisë mund të refuzohet vetëm:

a) Me kërkesë të palës kundër të cilës drejtohet, nëse gjykata bindet se:

i. Ky refuzim kërkohet në bazë të shkaqeve të përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1, gërma "a", nënparagrafët "i", "ii", "iii" ose "iv"; ose

ii. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit në lidhje me vendosjen e garancisë mbi masën e sigurimit të padisë të lëshuar nga gjykata e arbitrazhit, nuk është respektuar; ose

iii. Masa e sigurimit të padisë është revokuar ose pezulluar nga gjykata e arbitrazhit, ose nga gjykata e Shtetit në të cilin zhvillohet arbitrazhi kur është autorizuar për këtë, ose sipas ligjit mbi të cilin është lëshuar kjo masë; ose

b) Nëse gjykata konstaton se:

(i) Masa e sigurimit të padisë është e papajtueshme me kompetencat e dhëna gjykatës, përveç kur gjykata vendos të riformulojë masën e sigurimit, në masën e nevojshme, për ta përshtatur atë me kompetencat dhe procedurat e veta, për qëllimet e ekzekutimit të asaj mase dhe pa ndryshuar thelbin e saj; ose

(ii) Secila prej shkaqeve të përcaktuara në nenin 36(1)(b)(i) ose (ii), zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e masës së sigurimit të padisë.

2. Çdo vendim i marrë nga gjykata në bazë të ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në paragrafin parë të këtij neni, do të ketë efekt vetëm për qëllimet e kërkesës për njohjen dhe ekzekutimit të masës së sigurimit të padisë. Në marrjen e një vendimi të tillë, gjykata ku kërkohet njohja ose ekzekutimi, nuk do të kryejë një rishikim të themelit të masës së sigurimit".

### 3.1. Ekzekutimi nëpërmjet legjislacionit të brendshëm

Masat e sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit mund të ekzekutohen jashtë nëse ligji i vendit të ekzekutimit e lejon diçka të tillë. Sikurse u tha më sipër shumica e legjislacioneve nuk e parashikojnë shprehimisht mundësinë e ekzekutimit të masave të sigurimit të huaja. Sipas ligjit gjerman dhe zviceran ishte e diskutueshme nëse dispozitat e tyre për njohjen e masave të sigurimit të dhëna nga arbitrat mund të zbatoheshin edhe për masat e dhëna jashtë shtetit, megjithëse doktrina ishte e mendimit që po.<sup>661</sup> Ligji Anglez në nenin 2(1) të Pjesës së I<sup>662</sup> parashikon se këto dispozita aplikohen kur vendi i arbitrazhit është në Angli dhe Uells ose Irlandën e Veriut, Pra neni 42 që parashikon për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit nuk rregullon rastet e ekzekutimit të masave të sigurimit të dhëna nga një gjykatë arbitrazhi jashtë Anglisë, Uellsit apo Irlandës së Veriut. Edhe paragrafët (2)(3)(4)(5) të nenit 2,<sup>663</sup> të cilët parashikojnë rastet përjashtimore kur këto dispozita zbatohen edhe kur vendi i arbitrazhit është jashtë Anglisë, Uellsit apo Irlandës së Veriut, nuk e përmban nenin 42 në rastet përjashtimore.

Ndryshe nga ligjet e përmendura më sipër, ligji i Hong Kong-ut parashikon qartazi të drejtën e gjykatës shtetërore për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për masa sigurimi të dhëna dhe nga gjykata arbitrazhi që e kanë vendit e arbitrazhit jashtë Hong Kong-ut. Konkretisht neni 2GG i Aktit të Arbitrazhit parashikon se: (1) një vendim përfundimtar, urdhër, ose direktivë e bërë ose e dhënë në ose në lidhje me një procedurë arbitrazhi nga një gjykatë arbitrazhi është i ekzekutueshëm në të njëjtën mënyrë si një vendim gjyqësor, urdhër ose direktive e gjykatës shtetërore që ka të njëjtin efekt, por vetëm me leje të gjykatës. ... (2) Pavarësisht nga çdo gjë në këtë ligj, ky seksion aplikohet edhe për vendime formale, urdhra dhe direktiva të bëra ose të dhëna në ose jashtë Hong Kong-ut”. Po kështu është dhe Ligji Australian i Arbitrazhit.<sup>664</sup>

Megjithëse Ligji Model i UNCITRAL, me ndryshimet e vitit 2006 ka parashikuar shprehimisht mundësinë e gjykatave shtetërore për të ekzekutuar vendime për masa të sigurimi të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit pavarësisht vendit se ku janë dhënë, të pakët janë legjislacionet që i kanë adoptuar këto ndryshime. Përmendim kështu Kodin e Procedurës Civile të Belgjikës, i cili parashikon në nenin 1696§1 se: “Një masë

<sup>661</sup> Shiko paragrafin 2.2 më sipër.

<sup>662</sup> Ligji i arbitrazhit anglez është i ndarë në dy pjesë kryesore. Pjesa e I rregullon arbitrazhin jo-vendor (ndërkombëtar) dhe Pjesa II rregullon arbitrazhin vendor.

<sup>663</sup> Neni 2. Seksionet e mëposhtme aplikohen edhe kur vendi i arbitrazhit ndodhet jashtë Anglisë dhe Uellsit ose Irlandës së Veriut ose kur gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ose kur ajo nuk është përcaktuar akoma. (a) seksioni 9 deri në 11 (pezullimi i procedurave gjyqësore);

(b) section 66 (ekzekutimi i vendimit final të arbitrazhit);

3. Kompetencat e gjykatës shtetërore që i jepen nga seksionet e mëposhtme aplikohen edhe kur vendi i arbitrazhit është jashtë Anglisë dhe Uellsit ose Irlandës së Veriut

(a) seksioni 43 (sigurimi i prezencës së dëshmitarit) dhe

(b) seksioni 44 (kompetenca e gjykatës për të vendosur në favor të procedurës së arbitrazhit)

Por, gjykata mund të refuzojë të ushtrojë këtë kompetencë, nëse sipas opinionit të gjykatës, fakti që vendi i arbitrazhit është jashtë Anglisë dhe Uellsit ose Irlandës së Veriut ose kur vendi nuk është përcaktuar, por mund të jetë jashtë Anglisë dhe Uellsit ose Irlandës së Veriut, e bën të papërshtatshme për ta bërë këtë;

4. Gjykata shtetërore mund të ushtrojë kompetencat e saj sipas paragrafi (2) dhe (3) më sipër me qëllim suportin e arbitrazhit edhe kur

(a) nuk është përcaktuar vendi i zhvillimit të arbitrazhit;

(b) ka arsye që e lidhin me Anglinë dhe Uellsin ose Irlandën e Veriut dhe gjykata e shikon të përshtatshme ta bëjë një gjë të tillë.

<sup>664</sup> Neni 22 dhe 23 i Aktit të Arbitrazhit Ndërkombëtar në Australi i vitit 1974, i ndyshuar.

sigurimi e dhënë nga gjykata e arbitrazhit do të njihet si e detyrueshme dhe përveç kur gjykata e arbitrazhit parashikon ndryshe, ekzekutohet nga gjykata e shkallës së parë, pavarësisht vendit se ku është dhënë, sipas dispozitave të nenit 1697”. Gjithashtu neni 1(4) i Ligjit Slloven i arbitrazhit parashikon se: “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve përfundimtare dhe i masave të sigurimit të dhënë nga arbitrat e huaj rregullohen sipas nenit 42 dhe 43 të këtij ligji.” Neni 43 rregullon në mënyrë të posaçme njohjen dhe ekzekutimin e masave të sigurimit qoftë të arbitrazhit të brendshëm dhe atij të huaj në po ato kushte të parashikuara nga Ligji Model i UNCITRAL. Të tjerë shtete që kanë adoptuar këto ndryshime janë Irlanda,<sup>665</sup> Zelanda e Re<sup>666</sup> etj.

### 3.2. Ekzekutimi nëpërmjet akteve ndërkombëtare

Nëse legjislacioni i brendshëm nuk parashikon dispozita mbi ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga arbitrat në një vend të huaj, atëherë e vetmja mundësi për ekzekutimin e këtyre masave mbeten marrëveshjet bilaterale apo multilaterale. Por në fakt ka shumë pak marrëveshje bilaterale që lejojnë ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga arbitrat<sup>667</sup> dhe nuk ka asnjë marrëveshje multilaterale që të rregullojë këtë çështje. As Konventa e New Yorkut “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj” nuk parashikon shprehimisht mundësinë e zbatimit të saj për njohjen dhe ekzekutimin e masave të sigurimit të padisë. Neni 1(1) i saj parashikon se: “Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit (“awards”), që janë dhënë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve, dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizike ose juridikë. Ajo zbatohet gjithashtu për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të arbitrazhit të shtetit ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i tyre.” Dhe pyetja që lind është a konsiderohen vendimet për masa sigurimi, si vendime (“awards”) për efekt të Konventës së New Yorkut? Në praktikë dhe doktrinë nuk është arritur të vendoset një standard për interpretimin e konventës në këtë aspekt.

Për disa autorë të së drejtës së arbitrazhit vendimet për masa sigurimi nuk mund të konsiderohen vendime përfundimtare arbitrazhi. Sipas Besson dhe Poudret,<sup>668</sup> koncepti i vendimit sipas Konventës së New Yorkut nënkupton një vendim të formës së prerë, i cili vendos në mënyrë përfundimtare çështjet që ai trajton, tipar që nuk e ka masa e sigurimit edhe sikur të jetë dhënë në formën e një vendimi dhe jo urdhri. Për rrjedhojë Konventa e New Yorkut nuk zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit. Sipas të tjerë autorëve,<sup>669</sup> masa e sigurimit nuk vendos në mënyrë përfundimtare dhe të detyrueshme pretendimet ngritura nga palët, ato kanë vetëm një funksion të përkohshëm.

Edhe praktika gjyqësore, kryesisht ajo evropiane ka mbajtur këtë qëndrim. Në çështjen *Resort Condominiums vs. Bolwell* gjykata e Queensland, ndër të tjera është shprehur se: “[32]...Nuk ka referencë për “interim award” as në Ligj dhe as në Konventë....[33] Për thujt një shekull, rregulli i përgjithshëm ka qenë që duhet të

<sup>665</sup> Shiko nenin 17H të Aktit Irlandez të Arbitrazhit;

<sup>666</sup> Neni 17L i Ligjit të Arbitrazhit të Zelandës së Re.

<sup>667</sup> Sebastian Besson, “Arbitrage International et Measures Provisoires, Etude de droit Compare”, Zurich: Schulthess, 1998, fq. 351-352.

<sup>668</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 546, para. 639

<sup>669</sup> Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan M Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, 23-90; W. Laurence Craig, Williaam W. Park, Jan Paulsson: “International Chamber of Commerce Arbitration” Edicioni 3 (2000), 26.05, iii.

ketë një vendim përfundimtar që të përcaktojë të gjitha çështjet e parashtruara në padi.....Fakti që disa përjashtime parashikohen në Ligjin e Queensland dhe të Mbretërisë së Bashkuar dhe që të tilla vendime merren pa asnjë dyshim në Shtetet e Bashkuara nuk i jep përgjigje pyetjes nëse ato bien në fushën e Ligjit (Arbitraton Act) apo të Konventës ndërkohë që në këto nuk duket asnjë referencë lidhur me këto “interim award”. [39] nuk duket se Ligji apo Konventa e New York-ut parashikojnë ndonjë tip “vendimi” apo “urdhër” përveç vendimit që i jep zgjidhje të gjithave ose të paktën disa nga çështjeve që i janë referuar për zgjidhje arbitrave. Ndërkohë, që është e vërtetë se një urdhër i ndërmjetëm i vlefshëm është në një kuptim “detyruës” për palët që kanë hyrë në një marrëveshje arbitrazhi, të paktën derisa ai nuk është ndryshuar ose revokuar nga gjykata e arbitrazhit që e dha atë.... Një vendim që mund të ekzekutohet duhet të jetë një vendim përfundimtar dhe detyruës për palët. Një urdhër i ndërmjetëm, i cili mund të ndryshohet, pezullohet, revokohet, nga gjykata e arbitrazhit që e ka dhënë atë, nuk është “përfundimtar” dhe detyruës për palët për arsyet e mësipërme. [40] Si përfundim, unë konkludoj se, “Urdhri i ndërmjetëm i arbitrazhit” i bërë nga arbitrat në 16 Korrik 1993, nuk është një “vendim arbitrazhi përfundimtar” në kuptim të Konventës së New York-ut....Ai nuk e merr këtë karakter vetëm sepse thuhet apo titullohet në këtë formë.”

Kohë më parë ky qëndrim është mbajtur edhe jurisprudenca amerikane. Për shembull, në çështjen *MobilOil Indonesia Inc. vs. Asamera oil (Indonesia) Ltd*, gjykata e apelit e New York, në vitin 1977, shprehet se: “Vendimet e arbitrave, të cilat janë subjekt i shqyrtimit gjyqësor sipas statutit, janë vendimet përfundimtare të marra në përfundim të procedurave të arbitrazhit. Vendimi për masën e sigurimit, që kërkohet të rishikohet në këtë çështje, është “i ndërmjetëm”, dhe përfshin vetëm një çështje procedurale të kufizuar. Ky vendim në asnjë mënyrë nuk përbën një vendim përfundimtar mbi çështjet e paraqitura.”<sup>670</sup> Ndërsa në çështjen *Hyman-Michaels Company, Charterer v. Mariforum Shipping, S.A*, në vitin 1980, gjykata e apelit e Shteteve të Bashkuara shprehet se: “Vendimi për dhënien e masës së sigurimit nuk është një vendim përfundimtar, por është thjesht hapi i parë për të vendosur mbi të gjitha pretendimet e paraqitura në arbitrazh. Për të qenë “përfundimtar” një vendim arbitrazhi duhet t’i japë zgjidhje plotësisht të gjitha pretendimeve të paraqitura në arbitrazh”.<sup>671</sup> Megjithatë, situata ka ndryshuar krejtësisht. Sikurse u përmend edhe më sipër doktrina dhe jurisprudenca amerikane gjithnjë e më tepër po mbajnë qëndrimin se masat e sigurimit duhet të ekzekutohen njësoj si vendimet përfundimtare të gjykatës së arbitrazhit. Një seri vendimesh të gjykatave shtetërore në Shtetet e Bashkuara e tregojnë qartazi këtë tendencë.

Në çështjen *Metallgesellschaft A.G., v. M/V Capitan Constante and Yacimientos Petroliferos Fiscales*, në vitin 1986, gjykata e apelit e Shteteve të Bashkuara është shprehur: “...Një vendim i cili në mënyrë përfundimtare dhe definitive disponon mbi një kërkesë të pavarur mund të ekzekutohet edhe pse ai nuk disponon mbi të gjitha pretendimet e parashtruara në arbitrazh.”<sup>672</sup>

---

<sup>670</sup> *MobilOil Indonesia Inc. vs. Asamera oil (Indonesia) Ltd*, 43 N.Y.2d 276 (1977), Court of Appeals of the State of New York, 19 Dhjetor 1977, paragrafi 281, [http://www.leagle.com/decision/197731943NY2d276\\_1290.xml/MOBIL%20OIL%20v.%20ASAMER A%20OIL](http://www.leagle.com/decision/197731943NY2d276_1290.xml/MOBIL%20OIL%20v.%20ASAMER A%20OIL)

<sup>671</sup> *Hyman-Michaels Company, Charterer v. MARIFORUM SHIPPING, S.A*, No. 1001, Docket 80-7096, United States Court of Appeals, Second Circuit, 27 Qershor 1980, paragrafi 5, <http://openjurist.org/624/f2d/411>.

<sup>672</sup> *METALLGESELLSCHAFT A.G., v. M/V CAPITAN CONSTANTE and Y acimientos Petroliferos Fiscales*, 790 F.2d 280 (1986), United States Court of Appeal, Second Circuit, 9 Maj 1986, Para. 283,



Në çështjen *Publicis Communication vs. True North Communications* në vitin 2000, gjykata e apelit e Shteteve të Bashkuara, shprehet se: “Një vendim për një çështje diskrete dhe urgjente, mund të jetë i formës së prerë dhe i gatshëm për tu ekzekutuar edhe pse pretendimet e tjera mbeten për tu trajtuar nga arbitrat. Pavarësisht disa të metave të mundshme sipërfaqësore teknike, dhe pavarësisht përcaktimit të tij si “urdhër” apo “vendim”, vendimi i gjykatës së arbitrazhit – si në këtë rast- ishte përfundimtar”.<sup>673</sup>

Në çështjen *Sperry Intern. Trade, Inc. v. Government of Israel*, Gjykata e Rrethit New York është shprehur se: “Vendimi për disponimin mbi një pretendim të ndarë nga pretendimet e tjera ende në gjykim arbitrazhi, mund të konsiderohet përfundimtar dhe i mundshëm për t’u ekzekutuar.”<sup>674</sup>

Në çështjen *Banco De Seguros Del Estado v. Mutual Marine Office Inc*, Gjykata e Rrethit New York ka pranuar se vendimi për dhënien e një mase sigurimi është një vendim përfundimtar. Kjo gjykatë është shprehur se: “Një vendim për dhënien e masës së sigurimit është mjaftueshmërisht përfundimtar nëse ai ”në mënyrë përfundimtare disponon mbi një kërkesë të pavarur dhe të veçantë” edhe pse “nuk disponon për të gjitha pretendimet e paraqitura në arbitrazh.”<sup>675</sup>

Pavarësisht ekzistencës së disa ligjeve që kanë rregulluar ekzekutimin e masave të sigurimit të arbitrazhit të huaj dhe tendencës veçanërisht në jurisprudencën amerikane për të shtrirë zbatimin e Konventës së New Yorkut edhe në vendimet e arbitrazhit për masa sigurimi, mbetet ende problematik fakti që nuk ka një konventë ndërkombëtare që të rregullojë ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga një gjykatë arbitrazhi, e cila e ka vendin e zhvillimit të arbitrazhit në një shtet tjetër.

Qëndrimi i doktrinës është që vendimet për masa sigurimi duhen trajtuar njësoj si vendimet përfundimtare të arbitrazhit (award) dhe duhen ekzekutuar në bazë të rregullave dhe dispozitave të përgjithshme për vendimet përfundimtare të parashikuara në konventa apo ligje kombëtare. Vendimet për masa sigurimi kanë qëllim që të ekzekutohen dhe janë të ndryshme nga urdhrat e ndërmjetëm proceduralë që zgjidhin çështje të ndryshme si p.sh. përcaktimi i ligjit të aplikueshëm, apo vendosja e kalendarit të çështjes. Është e rëndësishme për procesin e arbitrazhit që gjykatat shtetërore të kenë mundësi të ekzekutojnë masat e sigurimit të arbitrazhit të huaj. Nëse kjo mundësi nuk do të ekzistojë palët nuk do të kenë asnjë arsye që t’i zbatojnë masat e sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit.<sup>676</sup>

---

[http://jenner.com/system/assets/assets/2551/original/Metallgesellschaft\\_v.\\_MV\\_Capitan.pdf?1319128063](http://jenner.com/system/assets/assets/2551/original/Metallgesellschaft_v._MV_Capitan.pdf?1319128063)

<sup>673</sup> *Publicis Communication, Plaintiff-Counterclaim Defendant-Appellant and PUBLICIS S.A., a French corporation, Counterclaim Defendant-Appellant, v. True North Communications Inc.*, Nos. 99-1199 & 99-3424 In the United States Court of Appeals For the Seventh Circuit, Datë 14 Mars 2000, para. 12 dhe 17

<sup>674</sup> *Sperry International Trade, Inc. v. Government of Israel*, 532 F.Supp. 901 (1982), United States District Court, S. D. New York, 24 Shkurt 1982, Para. 906, [http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=340786164838849707&q=+Sperry+International+Trade,+Inc.+v.+Government+of+Israel&hl=en&as\\_sdt=2006&as\\_vis=1](http://scholar.google.com/scholar_case?case=340786164838849707&q=+Sperry+International+Trade,+Inc.+v.+Government+of+Israel&hl=en&as_sdt=2006&as_vis=1)

<sup>675</sup> *Banco De Seguros Del Estado v. Mutual Marine Office Inc*, 230 F.Supp.2d 362 (2002), United States District Court, S.D. New York, August 6, 2002, Para.368 [http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=3979444938931260288&q=banco+de+seguros+del+estado+v.+mutual+marine+office+inc&hl=en&as\\_sdt=2006&as\\_vis=1](http://scholar.google.com/scholar_case?case=3979444938931260288&q=banco+de+seguros+del+estado+v.+mutual+marine+office+inc&hl=en&as_sdt=2006&as_vis=1)

<sup>676</sup> Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan M Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 614-615, para. 23-96; Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2515

## KAPITULLI IV

### MASAT E SIGURIMIT TË DHËNA NGA GJYKATA SHTETËRORE NË NDIHMË TË PROCESIT TË ARBITRAZHIT

#### 1. E drejta e gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit

Sikurse u trajtua në kapitujt paraardhës gjykata e arbitrazhit gëzon kompetencën për të dhënë masa sigurimi. Megjithatë në disa raste gjykata e arbitrazhit dukej se nuk ishte forumi i përshtatshëm për të kërkuar masa të tilla, për shkak të një sërë kufizimesh që kishte kjo kompetencë e saj. Kështu mjafton të kujtojmë që arbitrat nuk mund të marrin masa siguroese përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit. Dhe një gjë e tillë mund të kërkojë muaj të tërë. Megjithëse Rregulloret e Arbitrazhit të disa Institucioneve parashikojnë për arbitrin e urgjencës, i cili autorizohet të marrë masa sigurimi në raste urgjente, kur nuk mund të pritet formimi i gjykatës së arbitrazhit, edhe kjo zgjidhje kishte problematikat e saj.<sup>677</sup> Gjithashtu, për shkak të karakterit kontraktual të arbitrazhit, arbitrat nuk kanë juridiksion ndaj palëve të treta. Shpesh nevoja për të përfshirë palë të treta në arbitrazh, si për shembull përfshirja e një banke që ka lëshuar një letër krediti, është e pashmangshme, por duke qenë se kompetencat e arbitrave burojnë nga marrëveshja e arbitrazhit ajo nuk mund të ushtrojë kompetencat e saj ndaj personave të tretë, jo palë të marrëveshjes së arbitrazhit. Një tjetër mangësi e gjykatës së arbitrazhit lidhur me masat e sigurimit ishte mungesa e autoritetit shtrëngues për të ekzekutuar masat e dhëna prej saj, megjithëse një pjesë e mirë e tyre ekzekutohen vullnetarisht dhe ka një tendencë në rritje në parashikimin e këtyre masave si të ekzekutueshme në legjislacionet kombëtare.<sup>678</sup> Disa legjislacione e kufizojnë tërësisht të drejtën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi, e të tjerë ia kufizojnë të drejtën për të marrë disa lloje specifike masash (si për shembull vendosja e sekuestros ekzekutive), etj.

Në këto kushte lind e nevojshme që palët t'i drejtohen gjykatës shtetërore për marrjen e një mase sigurimi. Shumica e legjislacioneve, rregulloreve të arbitrazhit, doktrina dhe praktika e pranojnë ekzistencën e juridiksionit konkurrues të gjykatës së arbitrazhit dhe asaj shtetërore në lidhje me masat e sigurimit, si thelbësor për efikasitetin e procesit të arbitrazhit. Ekzistenca e këtij juridiksioni konkurrues është përjashtim nga parimi i përgjithshëm i ekskluzivitetit të juridiksionit të arbitrazhit dhe mos ndërhyrjes së gjyqësorit në procesin e arbitrazhit.<sup>679</sup> Qëllimi i njohjes së kompetencës gjykatës shtetërore për dhënien e masave të sigurimit nuk është të shkelë kompetencat procedurale të arbitrave, por t'i përforcojë ato dhe të bëjë më efektive vendimin përfundimtar që do të marrë gjykata e arbitrazhit në fund të procesit,<sup>680</sup> si dhe të jetë komplementar dhe ndihmës i arbitrazhit.<sup>681</sup>

Burimet e kësaj kompetence janë: i) marrëveshjet ndërkombëtare; ii) ligjet kombëtare të arbitrazhi; iii) Rregullat e Arbitrazhit të aplikueshme, përfshi ndonjë parashikim specifik të palëve në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit.

<sup>677</sup> Shiko kapitullin II të Pjesës II të këtij punimi.

<sup>678</sup> Shiko kapitullin III të Pjesës II të këtij punimi

<sup>679</sup> Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2523.

<sup>680</sup> *Front Carriers Ltd v. Atl. & Orient Shipping Corp.*, 2006, SGHC fq. 127; *Pathak v. Tourism Transport Ltd.*, 2002, 3 NZLR fq. 861.

<sup>681</sup> *Sensation Yachts Ltd. v. Darby Mariime Ltd*, case no. CIV 2005-404-1908

### 1.1. Kompetenca e gjykatave shtetërore sipas Konventave Ndërkombëtare

Konventat ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit kanë parashikime të ndryshme lidhur me kompetencën e gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të procesit të arbitrazhit. Disa e njohin shprehimisht një të drejtë të tillë, të tjera ose nuk shprehen ose e ndalojnë.

Konventa Evropiane mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar, e njohur ndryshe si Konventa e Gjenevës parashikon në nenin VI(4) se: “Kërkesa për masë sigurimi drejtuar autoriteteve gjyqësore nuk do të konsiderohet në mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit.” Nga një përcaktim i tillë kuptohet që palët mund t’i drejtohen si gjykatës së arbitrazhit dhe asaj shtetërore për marrjen e një mase sigurimi pa shkelur marrëveshjen e tyre të arbitrazhit.<sup>682</sup> Kjo dispozitë ka gjetur zbatim në disa raste të praktikës së arbitrazhit dhe gjyqësore.<sup>683</sup>

Ky përcaktim i Konventës së Gjenevës, i cili konsideron se kërkesa drejtuar gjykatës shtetërore për marrjen e një mase sigurimi është në përputhje me marrëveshjen e arbitrazhit njihet si doktrina e përputhshmërisë. Një aspekt i kësaj doktrine reflekton dy parime, që janë në fakt konkluzion logjik i pranimit të juridiksionit konkurrues mes atij gjyqësor dhe të arbitrazhit për dhënien e masave të sigurimit: i) kërkesa nuk është heqje dorë nga marrëveshja e arbitrazhit; ii) dhe ekzistenca e marrëveshjes së arbitrazhit nuk pengon autoritetet gjyqësore të japin masa sigurimi. Nga ky parim i fundit rrjedh që pavarësisht bërjes së një kërkesë të tillë, themeli i padisë mbetet në juridiksionin ekskluziv të gjykatës së arbitrazhit.<sup>684</sup>

Konventa e New Yorkut për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj nuk ka asnjë dispozitë që rregullon shprehimisht masat e sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit apo gjykata shtetërore. Kjo ka bërë që Konventës t’i bëhen interpretime të ndryshme veçanërisht nenit II (3) të saj, i cili parashikon se: “Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e investuar me një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje arbitrazhi sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jooperative ose e pamundur për t’u zbatuar.”

Disa gjykata shtetërore kanë interpretuar se neni II (3) i Konventës ndalon gjykatat shtetërore të japin masa sigurimi në lidhje me arbitrazhin ndërkombëtar. Kështu, në çështjen *Mccreary Tire & Rubber Company v. CEAT s.p.a*, në vitin 1974, Gjykata e Apelit e Rrethit të Tretë të Shteteve të Bashkuara u shpreh se: “Neni II(3) i Konventës së New York parashikon se një gjykatë e një shteti kontraktues duhet të “referojë palët drejt arbitrazhit” në vend që të “marrë masën e sigurimit për pezullimin e gjykimit”. Konventa ndalon gjykatat e një shteti kontraktues të shqyrtojë një padi që shkel një marrëveshje arbitrazhi. Kështu pretendimi se arbitrazhi është thjesht një tjetër mënyrë gjykimi, në të cilin masat e sigurimit të gjykatave shtetërore duhet të aplikohen në mënyrë të njëjtë, është i pazbatueshëm.”<sup>685</sup> Gjithashtu në çështjen *Cooper v. Ateliers de la Motobecane*, në vitin 1982, gjykata e apelit e shtetit të New York, është shprehur: “Konventa e New York përjashton juridiksionin e

<sup>682</sup> Hascher, “European Convention on International Commercial Arbitration of 1961-Commentary”, XX Y.B. Comm. Arb., 1995, fq 1006.

<sup>683</sup> Shiko për shembull: Audiencia provincial of Cadiz, June 12, 1991, Bahia Industrial, S.A. v. Eintacar –Eimar, S.A. XVIII, Y.B. COM. Arb. 1993, fq. 616

<sup>684</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 75-76, para.3-25.

<sup>685</sup> *McCREARY TIRE & RUBBER COMPANY v. CEAT S.p.A, v. MELLON BANK, N.A. Garnishee*, 501 F.2d 1032, United States Court of Appeals, Third Circuit, 8 Korrik 1974, Para. 31, <https://law.resource.org/pub/us/case/reporter/F2/501/501.F2d.1032.73-2020.html>

gjykatës për të dhënë një masë sigurimi.....Thelbi i arbitrazhit qëndron në zgjidhjen e mosmarrëveshjes pa përfshirjen e procesit gjyqësor dhe kufizimeve të tij. Konventa e New York ka gjetur zgjidhje për këtë problem duke mos parashikuar ndërhyrje të rëndësishme gjyqësore deri pas dhënies së një vendimi arbitrazhi. Qëllimi dhe fryma e Konventës së New Yorkut do të përmbushet më së miri duke i kufizuar veprimet para-arbitrazh të gjykatave për të përcaktuar nëse arbitrazhi është i detyrueshëm apo jo.”<sup>686</sup>

Por këto vendime dhe disa të tjerë që u mbështetën tek ta,<sup>687</sup> patën shumë kritika.<sup>688</sup> Doktrina është shprehur se është plotësisht e gabuar të interpretohet se neni II(3) i Konventës së New Yorkut ndalon gjykatat shtetërore të japin çdo masë sigurimi në mbështetje të arbitrazhit,<sup>689</sup> sepse edhe historia e Konventës së New Yorkut dhe *travaux preparatoires* të saj bëjnë të qartë që Konventa duhet të interpretohet në mënyrë që të lejojë gjykatat të japin masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit.<sup>690</sup> Dhe në fakt kjo praktikë e gjykatave amerikane u braktis dhe madje u shoqërua më vonë edhe me ndryshime legjislative në Ligjin e Procedurës Civile të New Yorkut.<sup>691</sup>

Në çështjen *Carolina Power & Light Company v. Uranex*, Gjykata e Shteteve të Bashkuara, ka hedhur poshtë arsyetimin në vendimin *McCreary Tire* duke u shprehur se: “Disponibiliteti i masave të sigurimit inkurajon dhe nuk pengon përdorimin e marrëveshjeve të arbitrazhit. Si konkluzion kjo gjykatë nuk do të ndjekë arsyetimin e përdorur në çështjen *McCreary Tire & Rubber Company v. CEAT S.p.A.* Nuk ka asnjë tregues qoftë në tekstin apo në frymën e konventës se New York që të përjashtojë dhënien e masave paraprake të sigurimit për pezullimin e gjykimit.”<sup>692</sup>

Në çështjen *Bahrain Telecomm. Co vs. Discoverytel*, Gjykata e New York ka arsyetuar se: “Gjykata nuk arrin të konstatojë asnjë parashikim në Konventën e New York, që përjashton juridiksionin e gjykatave shtetërore për dhënien e masave të sigurimit apo urdhrave të tjerë të përkohshëm (*pendent lite orders*), kur është e

---

<sup>686</sup> Robert R. Cooper, v. Ateliers De La Motobecane, S. A., 57 N.Y.2d 408 (1982), Court of Appeals of the State of New York, 18 Nëntor 1982, para. 411/416.

[http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=12322625295919705600&q=cooper+v.+ateliers+de+la+motobecane&hl=en&as\\_sdt=2006&as\\_vis=1](http://scholar.google.com/scholar_case?case=12322625295919705600&q=cooper+v.+ateliers+de+la+motobecane&hl=en&as_sdt=2006&as_vis=1)

<sup>687</sup> Drexhel Burnham Lambert Inc. v. Ruebsamen, 531 N.Y.S. 2<sup>nd</sup> 547(N.Y. Div.1988)

<sup>688</sup> Becker, “Attachments in aid of international arbitration-The American position”, 1 Arb. Int’l. 40 (1985); Bower & Tupman, Court ordered provisional measures under the New York Convention, 80 Am. J. Int’l. L. 24, (1986); McDonell, The availability of provisional relief in international commercial arbitration, 22 Colum. J. Transnat’l L.273 (1983-1984).

<sup>689</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2525; Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, “Comparative Law of International Arbitration”, 2007, fq. 525, para. 611; Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, Kluwer Law International, 1999, fq. 712, para. 1307; Julian DM Lew, Loukas A Mistelis, Stefan M Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 619-620, para. 23-113.

<sup>690</sup> Charles H. Brower, II, “What I tell you three times is true: U.S. courts and pre award interim measure under the New York Convention”, 35, Va. J. Int’l L. 1995, fq. 971, para 1004-10221.

<sup>691</sup> Neni 7502 i Ligjit të Procedurave Civile i New Yorkut u ndryshua duke shtuar paragrafin c), i cili parashikonte se: “Në lidhje me një arbitrazh i cili ka filluar apo do të fillojë jashtë apo brenda këtij shteti, Gjykata Supreme mund të pranojë një kërkesë për masë sigurimi, pavarësisht nëse është apo jo subjekt i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj.”

<sup>692</sup> *Carolina Power & Light Company v. Uranex*, 451 F. Supp. 1044 (1977), United States District Court, N. D. California, 26 Shtator 1977, Para. 1052, gjendet në:

<file:///C:/Users/staffAS/Desktop/Carolina%20Poëer%20&%20Light%20Co.%20v.%20Uranex,%20451%20F.%20Supp.%201044%20-%20Dist.%20Court,%20ND%20California%201977%20-%20Google%20Scholar.htm>

përshtatshme në arbitrazhin ndërkombëtar, dhe sigurisht asnjë arsye për të bërë diferencime midis arbitrazhit vendas dhe atij ndërkombëtar në këtë drejtim.”<sup>693</sup>

Në çështjen *Borden, Inc. v. Meiji Milk*, Gjykata e Apelit e Shteteve të Bashkuara është shprehur: “Gjykata konstaton se trajtimi i një kërkesë për masë sigurimi në mbështetje të arbitrazhit, është në përputhje me kompetencat e gjykatës sipas Konventës së New York”<sup>694</sup>.

Në çështjen *Stephen Blumenthal and Les Fein v. Merrill Lynch, Pierce, Fenner & Smith, Inc.*, në vitin 1990, gjykata e apelit e Shteteve të Bashkuara është shprehur se: “Gjykatat shtetërore amerikane kanë juridiksion të mjaftueshëm për të dhënë një masë sigurimi për pezullimin e procedurave të arbitrazhit edhe kur ka një marrëveshje arbitrazhi... Arbitrazhi do të ishte një “formalitet i rremë” në qoftë se palët do të ishin në gjendje të ndryshonin në mënyrë të pakthyeshme *status quo*-në përpara se arbitrat të mund të marrin një vendim mbi mosmarrëveshjen. Dhënia e një mase sigurimi për të pezulluar procedurat e arbitrazhit përmbush detyrimin e gjykatës për të zbatuar një marrëveshje të vlefshme arbitrazhi.”<sup>695</sup>

Qëndrimi i mësipërm i gjykatave amerikane është mbështetur edhe nga gjykata të tjera jashtë SHBA. Kështu çështja që referohet më shumë është *Channel Tunnel Group v Balfour Beatty Construction*.<sup>696</sup> Paditësit Channel Group Ltd, lidhi me Balfour Beatty Construction Ltd, (bashkim midis një shoqërie Angleze dhe një shoqërie Franceze), kontratën e ndërtimit të datës 13 Gusht 1986, për të ndërtuar një tunel nën Kanalin Anglez që lidh Anglinë dhe Francën. Kontrata përmbante një klauzolë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh në Bruksel, Belgjikë. Me një ndryshim të mëvonshëm në kontratë u parashikua që të paditurit do të ndërtonin edhe një sistem ftohje. Mosmarrëveshja midis palëve lindi në momentin kur ato nuk arritën të bien dakord lidhur me pagesat për ndërtimin e sistemit të ftohjes. Në këto kushte të paditurit njoftuan Channel Tunnel Group se do të pezullonin çdo veprim të mëtejshëm për ndërtimin e sistemit të ftohjes. Më 14 Tetor 1991 Channel Tunnel i drejtuan Gjykatës Angleze kërkesën për marrjen e një mase sigurimi për t’i penguar të paditurit të pezullonin punimet lidhur me sistemin e ftohjes deri në momentin që mosmarrëveshja do të zgjidhej me arbitrazh. Ndërkohë të paditurit i kërkuan gjykatës pezullimin e të gjitha procedurave të gjyqimit, me arsyetimin se Gjykata Angleze nuk ka juridiksion pasi ekziston një marrëveshje arbitrazhi midis palëve, në të cilën është përcaktuar se të gjitha mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen me arbitrazh në Bruksel. Dhoma e Lordëve para të cilës u paraqit për shqyrtim çështja në fjalë u shpreh: “Qëllimi i masave të sigurimit nga gjykatat shtetërore... nuk është të shkelë kompetencat procedurale të arbitrave, por t’i përforcojë ato dhe për ta bërë më efektiv vendimin përfundimtar të cilin do të marrin arbitrat lidhur me themelin e

<sup>693</sup> Bahrain Telecomm. Co vs. Discoverytel, 476 F.Supp.2d 176 (2007), United States District Court, 9 Mars 2007, Para. 181,

[http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=14511834639798215679&hl=en&as\\_sdt=6&as\\_vis=1&oi=scholar](http://scholar.google.com/scholar_case?case=14511834639798215679&hl=en&as_sdt=6&as_vis=1&oi=scholar)

<sup>694</sup> Borden, Inc. v. Meiji Milk, No. 793, Docket 90-7840, United States Court of Appeals, Second Circuit, 21 Nentor 1990, para. 826,

[http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=5270018098514872190&hl=en&as\\_sdt=6&as\\_vis=1&oi=scholar](http://scholar.google.com/scholar_case?case=5270018098514872190&hl=en&as_sdt=6&as_vis=1&oi=scholar)

<sup>695</sup> Stephen BLUMENTHAL and Les Fein v. MERRILL LYNCH, PIERCE, FENNER & SMITH, INC, 910 F.2d 1049 (1990), United States Court of Appeals, Second Circuit, 8 Gusht 1990, paragrafi 1053-1054, [http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=12704478085939402410](http://scholar.google.com/scholar_case?case=12704478085939402410)

<sup>696</sup> Channel Tunnel Group v Balfour Beatty Ltd, House of Lords England, [1993] Adj.L.R. 01/21, 21 Janar 1993

<http://www.nadr.co.uk/articles/published/AdjudicationLawReports/Channel%20Tunnel%20v%20Balfour%20Beatty%201993.pdf>

mosmarrëveshjes. Në rast se kjo, dhe asgjë tjetër, është ajo se çfarë kanë për qëllim këto masa, ato nuk kanë asgjë kundër frymës së arbitrazhit ndërkombëtar.”

Pavarësisht qëndrimit të konsoliduar tashmë se neni II(3) i Konventës së New Yorkut nuk ndalon gjykatat shtetërore të vendosin masa sigurimi në mbështetje të arbitrazhit ndërkombëtar, ka autorë që shprehen se ky qëndrim nuk duhet të jetë absolut. Çfarë do të thotë që në disa raste neni II(3) i KNY i ndalon gjykatat shtetërore të japin masa sigurimi, veçanërisht kur ato kanë për qëllim të shmangin apo pengojnë detyrimin e palës për të arbitruar, gjë që është kundër marrëveshjes së arbitrazhit të palëve. Kjo analizë i jep vlerën e duhur qëllimit të palëve dhe lejon zbatimin e nenit II(3) si një mjet për të siguruar ekzekutimin e marrëveshjes së arbitrazhit të palëve.<sup>697</sup> Parimi i përputhshmërisë i parashikuar në Konventën e Gjenevës, si më sipër përmendur, duhet të pranohet edhe në kuadër të Konventës së New Yorkut. Pra, gjykatat shtetërore duhet të kenë kompetencë për të dhënë masa sigurimi, por ata duhet të ushtrojnë atë me kujdesin më të madh dhe të refuzojnë kërkesa që shkelin marrëveshjen e arbitrazhit.<sup>698</sup>

Një tjetër konventë në fushën e arbitrazhit është Konventa “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimit mes shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera kontraktore”, e njohur ndryshe dhe si Konventa e ICSID apo e Uashingtonit.<sup>699</sup> Kjo konventë ka një përjasje të ndryshme nga Konventa e Gjenevës dhe ajo e New Yorkut, jo vetëm në lidhje me masat e sigurimit, por edhe në aspekte të tjera të procesit të arbitrazhit. Neni 26 i saj parashikon se pëlqimi i palëve për juridiksionin e ICSID prezumohet se është pëlqim për këtë lloj arbitrazhi duke përjashtuar çdo lloj mjeti tjetër. Historikisht neni 26 ishte interpretuar se përjashtonte masat e sigurimit të dhëna nga gjykatat shtetërore.<sup>700</sup> Kjo është konfirmuar tashmë nga Rregullat e Arbitrazhit të ICSID, neni 39(6) i të cilave parashikon se palët mund të kërkojnë masa sigurimi në gjykatën shtetërore vetëm nëse e kanë parashikuar shprehimisht në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit.

Gjithashtu Konventa e Brukselit për Juridiksionin dhe Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve për Çështjet Civile dhe Tregtare e datës 27 Shtator 1968 (tani Rregullorja 44/2001 e zëvendësuar nga Rregullorja Nr. 1215/2012, e cila është në fuqi nga 10 Janari 2015), megjithëse përjashton arbitrazhin nga fusha e zbatimit të saj, parashikon juridiksionin e autoritetit gjyqësor në lidhje me marrjen e masave të sigurimit edhe kur themeli i çështjes i takon një juridiksioni tjetër. Konkretisht, neni 35 i Rregullores 1215/2012 (ish neni 24 Konventës së Brukselit) parashikon se në gjykatën e një shteti kontraktues mund të kërkohet marrja e masave të sigurimit që parashikohen nga ligji i atij shteti, edhe nëse sipas kësaj Konvente juridiksionin për të zgjidhur çështjen në themel e ka gjykata e një shteti tjetër.

Kompetenca e autoritetit gjyqësor për marrjen e masave të sigurimit dhe arsyet se përse, janë konfirmuar dhe arsyetuar më së miri nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në vendimin për çështjen *Van Uden Maritime BV v. Kommanditgesellschaft in Firma Deco-Line*,<sup>701</sup> ku ndër të tjera thuhet:

---

<sup>697</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2525, 2537.

<sup>698</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 80, para. 3-31

<sup>699</sup> Shqipëria e ka ratifikuar Konventën “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimit mes shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera kontraktore” që në vitin 1991.

<sup>700</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2537

<sup>701</sup> *Van Uden Maritime BV v. Kommanditgesellschaft in Firma Deco-Line*, C-391/95

“Megjithatë, kur palët e kanë përjashtuar juridiksionin e gjykatave dhe kanë parashikuar arbitrazhin për zgjidhjen e konfliktit, gjykata mund të urdhërojë masa të tilla bazuar në nenin 24 të Konventës, megjithëse ajo nuk ka juridiksion për zgjidhjen në themel të çështjes. Në këtë kuadër, kur thelbi i kërkesës për masa sigurimi bie brenda qëllimit të Konventës, kjo konventë është e zbatueshme dhe neni 24 i saj i jep juridiksion gjykatës para së cilës është paraqitur kërkesa për masë sigurimi, si kur procesi për themelin e çështjes ka filluar ose mund të fillojë, ashtu dhe kur ky proces duhet të kryhet para arbitrave. Dhënia e masave të sigurimit në bazë të nenit 24 të Konventës kushtëzohet nga ekzistenca e një lidhjeje të vërtetë midis thelbit të masave të kërkuara dhe juridiksionit territorial të gjykatës së shtetit kontraktues para së cilës janë kërkuar këto masa.

Nëse një gjykatë arbitrazhi do të mund të jepte në mënyrë të ngjashme dhe efektive të gjitha masat e sigurimit që jep gjykata, atëherë vështirë se do të kishte nevojë apo shkaqe për t’iu drejtuar gjykatës nga palët e arbitrazhit. Por duke qenë se juridiksioni i gjykatës së arbitrazhit është i kufizuar, ndihma e gjykatës është e nevojshme. *Së pari*, kufizimi i juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit është i pandarë nga procesi arbitrazhit. Arbitrit i burojnë kompetencat nga marrëveshja e arbitrazhit, e cila është një kontratë që detyron vetëm palët që e kanë lidhur. Ajo nuk ka efekt mbi personat e tretë. Kështu që, për shembull, një vendim i gjykatës së arbitrazhit për sekuestrimin e parave në një llogari bankare është i detyrueshëm vetëm për palët e arbitrazhit dhe jo për bankën ku gjendet llogaria. *Së dyti*, gjykatës së arbitrazhit i mungojnë kompetencat për ta bërë të detyrueshëm ekzekutimin e një vendimi. Për pasojë, një vendim për sekuestrimin e parave në një llogari bankare të dhënë nga kjo gjykatë, nuk shoqërohet nga frika e pasojave të moszekutimit, por ka vetëm pasojë kontraktuale midis palëve. *Së treti*, nëse procedura e arbitrazhit nuk ka nisur ende gjykata e arbitrazhit nuk mund të investohet për marrjen e një mase sigurimi. Duke marrë parasysh këto kufizime është qartë se sa i rëndësishme është aksesin në gjykatë për të kërkuar marrjen e masave të sigurimit të padisë nga palët e arbitrazhit”.

## ***1.2. Kompetenca e gjykatave shtetërore sipas Ligjeve Kombëtare***

Juridiksioni konkurrent i gjykatave shtetërore dhe të arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi është parashikuar shprehimisht në shumë legjislatore të arbitrazhit. Vetëm një numër shumë i vogël shtetesh, të tilla si Italia, Tajlanda, Argjentina dhe Kina, kanë parashikuar për juridiksionin ekskluziv të gjykatës shtetërore në dhënien e masave të sigurimit. Pjesa më e madhe parashikojnë se si gjykata e arbitrazhit dhe gjykata shtetërore mund të japin masa sigurimi në lidhje me arbitrazhin, nëse nuk ka një marrëveshje të kundërt të palëve.

Ligji Model i UNCITRAL parashikon shprehimisht për juridiksionin konkurrent të gjykatave të arbitrazhit dhe atyre gjyqësore për dhënien e masave të sigurimit. Neni 17 i tij parashikon për kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi, kurse neni 9 i tij parashikon se palët nuk shkelin marrëveshjen e tyre të arbitrazhit në rast se i drejtohen gjykatës shtetërore për marrjen e një mase sigurimi. Më tej në nenin 17J parashikohet se: “Gjykata shtetërore do të ketë të njëjtën kompetencë për të dhënë masa sigurimi në lidhje me një proces arbitrazhi, pavarësisht vendit se ku zhvillohet, sikurse ka për dhënien e masave të sigurimit në lidhje me një proces gjyqësor. Gjykata do ta ushtrojë një kompetencë të tillë në përputhje me procedurat e saj duke marrë në konsideratë dhe tiparet specifike të arbitrazhit ndërkombëtar.” Gjykatat kombëtare në shume shtete që kanë adoptuar Ligjin Model

në legjislacionet e tyre kanë zbatuar këto dispozita për dhënien e masave të sigurimit.<sup>702</sup>

Shumë legjislacione kombëtare, jo vetëm ato që kanë adoptuar Ligjin Model, e njohin shprehimisht kompetencën e gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi lidhur me një proces arbitrazhi. Përmendim këtu, ligjin gjerman, ku sipas nenit 1033 të Kodit të Procedurës Civile, marrja nga gjykata shtetërore me kërkesë të një pale, përpara apo gjatë procesit të arbitrazhit, e masave të sigurimit në lidhje me një padi, themeli i së cilës zgjidhet me arbitrazh, nuk është e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit. Po ashtu ligji Belg ka një parashikim të ngjashëm. Neni 1683 i tij parashikon se kërkesa drejtuar gjykatës shtetërore për masë sigurimi para apo gjatë procesit të arbitrazhit, nuk është e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit dhe nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga marrëveshja e arbitrazhit. Ndërkohë ligji francez parashikon, në nenin 1449 të KPrC<sup>703</sup> se ekzistenca e një marrëveshjeje arbitrazhi, për aq kohë sa gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende, nuk e pengon një palë t'i drejtohet gjykatës shtetërore për marrjen e një mase lidhur me marrjen e një prove apo mase tjetër sigurimi. Legjislacione të tjera me parashikime të ngjashme janë ai holandez,<sup>704</sup> austriak,<sup>705</sup> anglez,<sup>706</sup> japonez,<sup>707</sup> indian,<sup>708</sup> peruan,<sup>709</sup> australian,<sup>710</sup> etj.

Por jo të gjithë legjislacionet kanë një parashikim të shprehur të kompetencës së gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi. I tillë ishte para ndryshimeve të vitit 2011 Kodi i Procedurës Civile francez. Megjithatë gjykatat franceze në mënyrë të vazhdueshme kanë mbajtur qëndrimin se marrëveshja e arbitrazhit nuk i pengonte gjykatat shtetërore për të dhënë masa sigurimi.<sup>711</sup> Sipas një gjykate: “Është parim i të drejtës pozitive franceze se palët e një marrëveshjeje me një klauzolë arbitrazhi që i jep juridiksion gjykatës së arbitrazhit të ICC mund t'i drejtohen gjykatave shtetërore për të marrë një masë sigurimi që ka veçanërisht për qëllim ruajtjen e situatës, të drejtave apo provave dhe veçanërisht ekzistenca e një klauzole arbitrazhi nuk i pengon gjyqtarët të shqyrtojnë kërkesa të tilla për çështje urgjente.”<sup>712</sup>

Edhe teksti i Aktit Federal të Arbitrazhit në SHBA nuk ka një parashikim të shprehur të kësaj kompetence të gjykatave shtetërore, gjithsesi, ashtu si praktika franceze, edhe gjykatat amerikane kanë konkluduar se gjykatat federale kanë

---

<sup>702</sup> Shiko për shembull: *Amican Navigation Inc. v. Densan Shipping Co.*, 1997, CanLII 845, (B.C.S. Ct.); *Silver Standard Res. Inc. v. Geolog*, 1998, 168 D.L.R. 4<sup>th</sup> 309(B.C.Ct. App); *Lady Murriel v. Transorient shipping Ltd.*, 1995, HKCA 615 (H.K. Ct. App.)

<sup>703</sup> Ndryshuar me Dekretin Nr. 2011-48 i 13 Janarit 2011 “Mbi reformimin e ligjit që rregullon arbitrazhin”

<sup>704</sup> Seksioni Një A- Marrëveshja e arbitrazhit dhe juridiksioni i gjykatave, nenet 1022, 1022a-1022c i Kodit të Procedurës Civile Holandez, rishikimet më të fundit të të cilit janë bërë në 1 Janar 2015.

<sup>705</sup> Neni 585 i KPrC austriak,

<sup>706</sup> Neni 44 i Akit Anglez të Arbitrazhit

<sup>707</sup> Neni 15 i Ligjit të Arbitrazhit Japonez

<sup>708</sup> Neni 9 i Ligjit të Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit

<sup>709</sup> Neni 47(4) i Ligjit Peruan të Arbitrazhit

<sup>710</sup> Apendiksi 2 neni 17J i Aktit të Arbitrazhit Ndërkombëtar Australian

<sup>711</sup> Vendim i Gjykatës së Kasacionit i 20 Dhjetor 1982, *SCI Le Panorama v. Societe Immobiliere et mobilieire du Tertre (SIMT)*, Rev Arb, 1986, fq. 233

<sup>712</sup> Vendim i Gjykatës së Apelit të Versajës, i datës 8 tetor 1998, *Societe Akzo Nobel et autres v. SA Elf Atochem*, 1999 Rev Arb, fq. 56-57.



juridiksion për të dhënë masa sigurimi, përveç kur ka një marrëveshje të kundërt të palëve, me qëllim mbrojtjen e palëve dhe të procesit të arbitrazhit.<sup>713</sup>

Ligji zviceran mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, i cili përmban dispozita mbi arbitrazhin është interpretuar se, ndonëse nuk e parashikon në mënyrë aq të qartë sa Ligji Model, njeh juridiksionin konkurrues të gjykatave shtetërore dhe të arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi.<sup>714</sup>

Pothuajse identik me legjislacionin zviceran është edhe Kodi ynë i Procedurës Civile. Ai parashikon në nenin 418 se: “Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njëres prej palëve mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve. Nëse palët nuk kanë vendosur rregulla për një qëllim të tillë, gjykata e arbitrazhit zbaton rregullat e parashikuara në këtë Kod për sigurimin e padisë. Nëse pala tjetër nuk zbaton vullnetarisht këto masa, gjykata e arbitrazhit i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.”

Pra, nga kjo dispozitë konstatojmë se nuk njihet shprehimisht e drejta e gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi në lidhje me një proces arbitrazhi. Paragrafi i fundit i referohet ndërhyrjes së gjykatës shtetërore vetëm lidhur me ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit dhe jo investimit të saj për dhënien e një mase sigurimi.

Fillimisht praktika e gjykatave të rretheve gjyqësore të shkallës së parë, në mënyrë të gabuar, ka mbajtur qëndrimin se gjykatat nuk kanë kompetencë për të marrë masa sigurimi në lidhje me një proces arbitrazhi. Kështu për shembull, në çështjen *Colliers kundër City Park*, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>715</sup> shpalli moskompetencën për shqyrtimin e një kërkesë për masë sigurimi duke arsyetuar se: “Referuar kontratës së shërbimit dt. 05 janar 2008, të lidhur mes palëve ndërgjyqëse, të dy shoqëritë kanë parashikuar edhe mënyrën konkrete të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që do të lindnin nga kjo kontratë. Neni 16 i kësaj kontrate e cila ka fuqinë e ligjit për palët pjesëmarrëse në të, parashikon se: “ 1. Të gjitha mosmarrëveshjet të cilat mund të lindin në lidhje me këtë kontratë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve, do të vendoset të zgjidhen nga Grupi i Mediacionit Tregtar Shqiptar dhe Qendra e Arbitrimit në Tiranë, Shqipëri, nga tre arbitra. Vendimi i tyre do të jetë përfundimtar për palët. Ligji aplikues i kësaj kontrate, në të gjitha rastet është ligji shqiptar..... ” ...Sipas këtij neni, të gjitha mosmarrëveshjet që kanë lidhje me këtë kontratë, është vendosur të zgjidhen nga grupi i Mediacionit Tregtar Shqiptar dhe Qendra e Arbitrimit në Tiranë, Shqipëri, nga tre arbitra. Në këtë kuptim, edhe kërkesa që i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me sigurimin e padisë mbështetur në këtë kontratë dhe detyrimet juridiko-civile të rrjedhura prej saj, nuk mund të gjykohet nga gjykata civile, por nga gjykata e arbitrazhit e zgjedhur me vullnetin e përbashkët të të dy palëve ndërgjyqëse, referuar edhe nenit 414/2 i K.Pr.Civile që parashikon se: “Kur procedura e arbitrazhit për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ende nuk ka filluar, juridiksioni tjetër duhet gjithashtu të deklarojë moskompetencën përveç kur marrëveshja e arbitrazhit është haptazi e pavlefshme”. ...Për sa kohë që palët me marrëveshje kanë parashikuar se mosmarrëveshjet që kanë lidhje me kontratën e lidhur mes tyre në dt. 05.01.2008 do t’i nënshtrohen një

<sup>713</sup> Janvey v. Alguire, 647 F3d (5<sup>th</sup> Cir.2011), fq. 585, 595; Toyo Tire Holdings of Am., Inc. v. Cont’l Tire N. Am. Inc., 609 F3d (9<sup>th</sup> Cir. 2010), fq. 975, 981. Karaha Bodas Co. v. Perusahaan Pertambangan Minyak Dan Gas Bumi Negara, 335 F3d, (5<sup>th</sup> Cir. 2003), fq. 357, 365.

<sup>714</sup> B. Berger & F. Kellerhals, “International and Domestic Arbitration in Switzerland”, 2<sup>nd</sup> ed. 2010, para. 1166; S. Besson, “Arbitrage International et mesures provisoires”, 1998, fq. 192.

<sup>715</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr.akti. 564, datë 23.12.2009

procedure arbitrazhi, edhe kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë për këtë kontratë, do t'i nënshtrohet të njëjtës procedurë, me të njëjtat rregulla procedurale, të cilat i njihen nga ligji gjykatës së arbitrazhit.”

Gjykata e Lartë<sup>716</sup> me të drejtë e konsideroi të gabuar këtë vendim të gjykatës së shkallës së parë Tiranë dhe e prishi vendimin duke u shprehur se:

“Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arrin në konkluzionin se një marrëveshje e vlefshme arbitrazhi nuk i pengon palët t'i drejtohen një autoriteti tjetër gjyqësor, siç është në rastin konkret, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (e cila është gjykatë kompetente), për kërkimin “marrje e masës së sigurimit të padisë”. Paraqitja e një kërkesë të tillë nuk mund të konsiderohet si e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit, apo si një shqyrtim i themelit të çështjes. Ky trajtim që i bëhet masës së sigurimit ka si qëllim kryesor faktin që palët të kenë mundësi të realizojnë sa më shpejt, dhe në mënyrë sa më efektive të drejtat e tyre. Një nga arsyet kryesore pse palët zgjedhin procedurën e arbitrazhit është pikërisht se ato vlerësojnë tek procedura e arbitrazhit zgjidhjen sa më të shpejtë të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre. Në aktet ndërkombëtare të cituara më sipër, si dhe në legjislacionin tonë të zbatueshëm, sundon pikërisht kjo frymë (zgjidhja sa më shpejt e mosmarrëveshjes, me sa më pak kosto dhe ekzekutimi i shpejtë i vendimit, në mënyrë që pala e dëmtuar të ketë mundësi të rikuperojë dëmin që i është shkaktuar). Në vazhdim të kësaj fryme nuk ka se si çështja për marrjen e një mase sigurimi të ndërlikohet dhe të vështirësohet më shumë se sa zgjidhja e vetë themelit të çështjes.”

Pas këtij vendimi praktika gjyqësore shqiptare tashmë është e konsoliduar në qëndrimin se gjykatat shqiptare mund të marrin masa për sigurimin e padisë në lidhje me një proces arbitrazhi dhe kjo nuk konsiderohet në mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit.<sup>717</sup>

### ***1.3. Kompetenca e gjykatave shtetërore sipas Rregullave të Institucioneve të Arbitrazhit***

Pothuajse si shumica e legjislacioneve të arbitrazhit, rregullat e institucioneve më të mirënjohura të arbitrazhit në mbarë botën konfirmojnë të drejtën e gjykatave për të marrë masa sigurimi në lidhje me një proces arbitrazhi.

Rregullorja e UNCITRAL<sup>718</sup> parashikon mundësinë që çdo palë e interesuar pavarësisht ekzistencës së një marrëveshje arbitrazhi, t'i drejtohet autoritetit gjyqësor për marrjen e një mase sigurimi dhe kjo nuk do të konsiderohet si e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit apo si një heqje dorë prej saj. Sipas kësaj dispozite, palët janë të lira që t'i drejtohen, qoftë gjykatës së vendit ku zhvillohet procedura e arbitrazhit, qoftë një gjykatë tjetër për të vendosur masa sigurimi dhe qoftë para apo pas formimit të gjykatës së arbitrazhit.<sup>719</sup>

Rregullorja e ICC,<sup>720</sup> parashikon të drejtën e palëve për të kërkuar vendosjen e masave të sigurimit tek gjykata shtetërore, përpara se dosja e arbitrazhit t'i dërgohet

<sup>716</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 92, datë 02.03.2010

<sup>717</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.549 akti, datë 23.08.2013; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 762 akti, datë 17.11.2012; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 609 akti, datë 27.07.2013

<sup>718</sup> Neni 26.9 i Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL

<sup>719</sup> D. Caron & L.Caplan & M.Pellonpaa, “The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary”, 2006, fq. 544; Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 45, 61-62; J. Fry, S. Greenberg, F. Mazza, “Secretariat’s Guide to ICC Arbitration”, 2012, fq. 289.

<sup>720</sup> Neni 28.2 i Rregullave të Arbitrazhit të ICC

gjykatës së arbitrazhit dhe në rrethana të përshtatshme edhe pas dorëzimit të dosjes në gjykatën e arbitrazhit. Kërkesa e palës për marrjen e masave të sigurimit apo për zbatimin e masave të urdhëruara nga gjykata e arbitrazhit në gjykatën shtetërore nuk do të konsiderohet si shkelje apo heqje dorë nga marrëveshja e arbitrazhit dhe nuk do të ndikojë mbi pushtetin e dhënë nga palët, gjykatës së arbitrazhit për të zgjidhur mosmarrëveshjen mes tyre. Ndryshe nga Rregullat e UNCITRAL, në Rregullat e ICC konstatohet se ka një lloj kufizimi të të drejtës së gjykatës për të marrë masa sigurimi pas formimit të gjykatës së arbitrazhit. Kjo është e mundur vetëm në rrethana të përshtatshme, të cilat janë në diskrecion të gjykatës për t'i vlerësuar.<sup>721</sup>

Rregullorja e LCIA,<sup>722</sup> parashikon të drejtën e çdo pale, pavarësisht ekzistencës së një marrëveshje të vlefshme arbitrazhi, për të kërkuar marrjen e një mase sigurimi në ndonjë gjykatë shtetërore ose në çdo autoritet tjetër gjyqësor, përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit dhe në raste përjashtimore, edhe pas formimit të saj. Çdo kërkesë dhe çdo urdhër për masa të tilla pas formimit të gjykatës së arbitrazhit do t'i njoftohet menjëherë gjykatës së arbitrazhit dhe palëve të tjera nga kërkuuesi. Megjithatë, nëse palët bien dakord që të referojnë mosmarrëveshjen e tyre për zgjidhje sipas rregullores së LCIA, do të konsiderohet se palët kanë rënë dakord të mos kërkojnë në ndonjë gjykatë shtetërore ose në çdo autoritet tjetër gjyqësor masa sigurimi për shpenzimet gjyqësore dhe çdo shpenzim tjetër, që është në kompetencë të gjykatës së arbitrazhit.

## **2. Raporti ndërmjet juridiksionit gjyqësor dhe të arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi**

Sikurse u trajtua më sipër, ekzistenca e juridiksionit konkurrues mes gjykatave të arbitrazhit dhe atyre shtetërore në dhënien e masave të sigurimit është njohur gjerësisht. Kjo bashkë-ekzistencë e juridiksioneve kërkon një koordinim të mirë kompetencave të arbitrave dhe të gjyqtarëve, i cili duhet të përcaktohet, ose të paktën të udhëzohet në ligjet dhe rregulloret e arbitrazhit,<sup>723</sup> për shkak të mbivendosjes dhe mundësisë për konflikt mes këtyre dy juridiksioneve. Një koordinim i tillë kontribuon në efektivitetin e arbitrazhit dhe në shpërndarjen efektive të drejtësisë. Pjesa më e madhe e legjislacioneve dhe rregulloreve të ndryshme të arbitrazhit<sup>724</sup> nuk e rregullojnë mënyrën e koordinimit mes këtyre dy juridiksioneve konkurruese duke i lënë liri zgjedhjeje palëve lidhur me autoritetin që ato duan të investojnë për marrjen e një mase sigurimi. Kjo mënyrë e rregullimit të juridiksionit konkurrues mes gjykatave të arbitrazhit dhe atyre shtetërore në dhënien e masave të sigurimit njihet modeli i zgjedhjes së lirë. (*free choice model*) Ndërkohë që një pjesë e vogël legjislacionesh dhe rregulloresh arbitrazhi e kufizojnë mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës shtetërore vetëm në rast se ekzistojnë rrethana të përshtatshme. Sipas këtij modeli ndërhyrja e gjykatës shtetërore konsiderohet plotësuese përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit ndihmuese pas formimit të saj.

---

<sup>721</sup> Y. Derains & E. Schwartz, "A guide to ICC Rules of Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. 2005, fq. 299-302;

<sup>722</sup> Neni 25.3 i Rregullave të Arbitrazhit të LCIA

<sup>723</sup> Donald Francis Donovan, "The allocation of authority between courts and arbitral tribunals to order interim measures: A survey of jurisdictions, the work of UNICTRAL and a Model Proposal", botuar në Congress Series no. 12 i International Council for Commercial Arbitration, New horizons in international commercial arbitration and beyond, edituar nga Albert Jan Van Den Berg, 2005, fq. 205.

<sup>724</sup> Shiko: Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 85, footnote 167

## 2.1. Modeli i zgjedhjes së lirë

Përjasja e përgjithshme në shumë shtete që pranojnë juridiksionin konkurrues për dhënien e masave të sigurimit është që palët, përveç kur kanë parashikuar ndryshe, janë të lirë të zgjedhin njërin apo tjetrin juridiksion si para edhe pas formimit të gjykatës së arbitrazhit. Një shembull tipik i këtij modeli është Ligji Model i UNCITRAL, i cili thjesht parashikon për juridiksionin konkurrues, por nuk tregon rolin që luajnë gjykatat shtetërore në dhënien e masave të sigurimit, nëse ai është apo jo subsidiar ndaj gjykatës së arbitrazhit. Kjo lë të kuptohet që Ligji Model i jep liri palëve të zgjedhin lirisht nëse duan të investojnë gjykatën e arbitrazhit apo atë shtetërore për marrjen e masës së sigurimit. Ligje të tjera që kanë ndjekur këtë model janë pothuaj të gjithë legjislacionet që kanë adoptuar Ligjin Model, si për shembull Gjermania, Belgjika, Australia etj.

Këto legjislacione nuk i kërkojnë palëve që përpara se të bëjnë kërkesë për masë sigurimi në gjykatën shtetërore t'i drejtohen asaj të arbitrazhit kur është e mundur dhe as nuk u kërkon atyre të marrin lejë nga gjykata e arbitrazhit përpara se t'i drejtohen gjykatës shtetërore për masë sigurimi. Megjithatë doktrina gjermane ka mbajtur disa qëndrime lidhur me raportin e këtyre dy juridiksione konkurruese. Disa autorë shprehen se duke qenë se sipas nenit 1041(2) të KPrC gjerman, gjykata shtetërore nuk mund të ekzekutojë një masë të dhënë nga gjykata e arbitrazhit nëse një kërkesë për një masë të tillë është bërë para gjykatës shtetërore, atëherë palët duhet të aplikojnë direkt në gjykatën shtetërore për marrjen e një mase sigurimi.<sup>725</sup> Kurse disa autorë të tjerë kanë diskutuar se gjykatat shtetërore duhet t'ia lenë gjykatës së arbitrazhit dhënien e masës së sigurimit nëse një kërkesë e tillë është paraqitur para gjykatës së arbitrazhit dhe kërkesa për mbrojtje ligjore efektive nuk kërkon ndërhyrjen e gjykatës shtetërore për të shmangur dëmin në një situatë të veçantë.<sup>726</sup>

Legjislacioni zviceran, me të cilin është shumë i ngjashëm dhe neni 418 i kodit tonë të procedurës civile, nuk e ka shumë qartazi të përcaktuar kompetencën e gjykatës shtetërore për të marrë masa sigurimi, por sikurse u trajtua më sipër doktrina dhe praktika e njohin juridiksionin konkurrues mes gjyqësorit dhe arbitrazhit në dhënien e masave të sigurimit dhe mendimi prevalues është se ky juridiksion është paralel.<sup>727</sup>

Doktrina është shprehur se ky model i zgjedhjes së lirë duhet të zbatohet me kujdes të madh për shkak të mundësisë për të abuzuar me të drejtën. Ndaj gjykatat e arbitrazhit duhet të identifikojnë rastet e mundshme të abuzimit dhe nuk duhet të pranojnë kërkesat në raste kur mungon urgjenca dhe kur qëllimi i tyre është vetëm të krijojnë një avantazh kundër të paditurit. Ndërhyrja e gjykatës duhet të pranohet vetëm në rastet kur ushtrimi i kompetencës së gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi është jo efektiv apo kur një kompetencë e tillë nuk ekziston fare. Edhe palët gjithashtu nuk duhet të abuzojnë me lirinë e zgjedhjes.<sup>728</sup>

---

<sup>725</sup> Voit in Musielak, ZPO 4<sup>th</sup> ed. 2004, cituar në Donald Francis Donovan, "The allocation of authority between courts and arbitral tribunals to order interim measures: A survey of jurisdictions, the work of UNICTRAL and a Model Proposal", botuar në Congress Series no. 12 i International Council for Commercial Arbitration, New horizons in international commercial arbitration and beyond, edituar nga Albert Jan Van Den Berg, 2005, fq. 210.

<sup>726</sup> Kroll, "Das neue deutsche Schiedsrecht vor staatlichen Gerichten", NJW 2001, fq. 1173-1179.

<sup>727</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 532, para. 618

<sup>728</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 87-88, para.3-44/3-45

## 2.2. Modeli i juridiksionit plotësues dhe ndihmues

Një numër i kufizuar legjislacionesh dhe rregullash arbitrazhi rregullojnë raportin e juridiksioneve konkurruese në dhënien e masave të sigurimit, duke i vendosur disa kufizime kompetencës së gjykatës për të dhënë masa sigurimi dhe duke i dhënë prioritet juridiksionit të arbitrazhit në një rast të tillë. Ky prioritet i gjykatës së arbitrazhit në dhënien e masave të sigurimit humbet vetëm në rastin kur në rrethana të caktuara marrja e masës nga gjykata e arbitrazhit nuk është e mundur apo e përshtatshme. Pra në këto legjislacione roli i gjykatës shtetërore është plotësues në rast se gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende dhe ndihmues në rastin kur ajo është formuar.

Disa nga legjislacionet që parashikojnë këtë model janë Anglia, Franca, Singapori, etj. Kështu Akti Anglez i Arbitrazhit i vitit 1996 qartazi parashikon se kompetenca e gjykatës për të dhënë masa sigurimi do të jetë në ndihmë të arbitrazhit. Qëllimi për një përcaktim të tillë është që të lihet kontrolli i procesit të arbitrazhit në duar të gjykatës së arbitrazhit aq sa është e mundur.<sup>729</sup> Sipas nenit 44 paragrafët (3), (4), (5) të këtij akti gjykata mund të japë masa sigurimi vetëm nëse: i) kërkohet në mënyrë urgjente ruajtja e aseteve dhe provave; ii) gjykata e arbitrazhit e lejon atë; ose iii) gjykata e arbitrazhit nuk ka kompetencën për të vepruar në mënyrë efektive.

Ndërkohë ligji francez parashikon, në nenin 1449 të KPrC<sup>730</sup> se ekzistenca e një marrëveshjeje arbitrazhi, për aq kohë sa gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende, nuk e pengon një palë t'i drejtohet gjykatës shtetërore për marrjen e një mase lidhur me marrjen e një prove apo mase tjetër sigurimi. Nga ky parashikim qartazi kuptohet se gjykata shtetërore nuk mund të marrë masa sigurimi nëse gjykata e arbitrazhit është formuar. I vetmi rast kur ato mund të marrin një masë të tillë është kur gjykata e arbitrazhit nuk do të ketë kompetencë për marrjen e një lloji të caktuar mase sigurimi, sikurse është p.sh. sekuestroja konservative sipas nenit 1468 të KPrC francez. Pra, roli i gjykatës shtetërore është plotësues përpara formimit të gjykatës shtetërore dhe pas formimit të gjykatës së arbitrazhit është të ndihmojë gjykatën e arbitrazhit vetëm në rrethana përjashtimore.

Situata me ligjin holandez<sup>731</sup> është disi e ndryshme. Në nenin 1022a njihet shprehimisht e drejta për t'iu drejtuar gjykatës shtetërore për marrjen e një mase sigurimi pavarësisht ekzistencës së një marrëveshjeje arbitrazhi. Pra, pranohet juridiksioni konkurrues i gjykatës shtetërore dhe asaj të arbitrazhit për dhënien e masave të sigurimit. Ndërkohë që përsa i përket raportit mes këtyre dy juridiksioneve, neni 1022 c parashikon se nëse një nga palët kundërshton juridiksionin e gjykatës shtetërore, ajo do të shprehet mbi kërkesën për masë sigurimi vetëm nëse masa e kërkuar nuk mund të merret, ose nuk mund të merret në mënyrë të shpejtë nga gjykata e arbitrazhit. Kështu, gjykata shtetërore mund të marrë masë sigurimi: i) në çdo rast që palët nuk e kundërshtojnë juridiksionin e saj për të dhënë masë sigurimi ii) edhe nëse juridiksioni i saj kundërshtohet, por vetëm kur: a) gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masa sigurimi, ose b) gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masën e sigurimi në mënyrë të shpejtë.

<sup>729</sup> Bruce Harris, et al., « Th Arbitration Act 1996: A commentary », 2<sup>nd</sup> ed., 2000, fq. 218

<sup>730</sup> Ndryshuar me Dekretin Nr. 2011-48 i 13 Janarit 2011 "Mbi reformimin e ligjit që rregullon arbitrazhin"

<sup>731</sup> Kodi i Procedurës Civile holandez. Amendimet e fundit të tij lidhur me dispozitat mbi arbitrazhin janë bërë në janar të 2015.

Ligji i Singaporit<sup>732</sup> shprehet se në çdo rast gjykata do të marrë një masë sigurimi vetëm nëse gjykata e arbitrazhit, apo çdo person apo institucion tjetër arbitrazhi, të cilët palët i kanë autorizuar për të marrë masa sigurimi, nuk mund ta ushtrojnë këtë kompetencë në mënyrë efektive.

Krahas legjislacioneve të arbitrazhit edhe disa Rregullore të Institucioneve të Arbitrazhit parashikojnë për juridiksionin konkurrent të gjyqësorit dhe arbitrazhit për dhënien e masave të sigurimit, dhe njohin prioritetin e gjykatës së arbitrazhit për dhënien e këtyre masave. Shembujt më tipikë janë Rregullorja e Arbitrazhit e ICC dhe ajo e LCIA. Konkretisht neni 28(2) i Rregullores së ICC parashikon se palët mund t'i kërkojnë gjykatës shtetërore marrjen e një mase sigurimi përpara se dosja e çështjes t'i kalohet gjykatës së arbitrazhit dhe në rrethana të përshtatshme edhe pas saj. Kurse neni 25(3) i Rregullave të Arbitrazhit të LCIA parashikon se palët mund të kërkojnë masa sigurimi në gjykatat shtetërore përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit dhe në raste përjashtimore pas formimit të saj. Pra, këto rregulla e bëjnë të qartë që gjykata e arbitrazhit është forumi i preferuar për marrjen e masave të sigurimit.

Të gjitha ligjet dhe rregullat e trajtuara në këtë pjesë njohin parimin që favorizon arbitrat ndaj autoriteteve gjyqësore si forumi për të kërkuar masa sigurimi pas formimit të gjykatës së arbitrazhit. Ky parim referohet si parimi i prioritetit, në bazë të të cilit gjykatat shtetërore, pas formimit të gjykatës së arbitrazhit do të mund të marrin masa sigurimi vetëm në raste në përshtatshme apo përjashtimore.

Por cilat janë ato rrethana që do të konsiderohen si të përshtatshme apo përjashtimore për të lejuar ushtrimin e kompetencës të gjykatës shtetërore për marrjen e masave siguroese? Përcaktimi i këtyre rrethanave zakonisht duhet të bëhet nga gjykatat e arbitrazhit, apo nga gjykatat shtetërore në përputhje me ligjin e tyre. Sipas Goldman,<sup>733</sup> sigurisht që i takon gjykatës shtetërore të përcaktojë rrethanat përjashtimore në të cilat ajo mund të veprojë, por e tillë do të ishte një rast i urgjencës ekstreme dhe ku ka një rrezik të qartë për një dëm të mundshëm, si për shembull, shmangia e prishjes së mallrave, ruajtja apo marrja e dokumenteve apo sendeve që mund të rrezikohen nga shkatërrimi në situata të katastrofave natyrore, ku gjykata e arbitrazhit nuk do të ishte në gjendje të ndërhynte në kohën e duhur. Calvo,<sup>734</sup> është shprehur se një rrethanë e përshtatshme do të ishte një situatë urgjence, dhe/ose parandalimi i një dëmi të mëtejshëm. Shembujt të rrethanave të përshtatshme mund të jenë vendosja e një mase sigurimi kundër një personi të tretë apo vendosja e një sekuestroje për ruajtjen apo shitjen e mallrave që prishen. Sipas të tjerë autorëve, rrethana të përshtatshme që justifikojnë kërkesën drejtuar gjykatës shtetërore, pasi gjykata e arbitrazhit është formuar, mund të konsiderohen:<sup>735</sup>

- a. Kur ligji i arbitrazhit të vendit ku po zhvillohet arbitrazhi ndalon gjykatën e arbitrazhit të vendosi masa sigurimi (si p.sh. Itali, Argjentinë, Kinë, Tajlandë);
- b. Kur kërkohet që masa të merret kundër një pale të tretë (p.sh. kërkohet dëshmia e një pale për tu pyetur në proces);
- c. Kur nga natyra e masës kërkohet ekzekutimi i saj në kushtet e urgjencës, si p.sh. rasti i urdhrave për vënien e sekuestros etj.

<sup>732</sup> Neni 12A i Aktit të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Singaporit

<sup>733</sup> Berthold Goldman, "Arbitrage Commercial International", *Jurisclesseur Droit International*, Fascicule 586-5-2, No. 77, 1991

<sup>734</sup> M.A. Calvo, "The new ICC Rules of Arbitration-Substantial and procedural changes", 14 (4), *J. Int'l Arb.*, 1997, fq. 41, 50

<sup>735</sup> Jacob Grierson dhe Annet Van Hooft, "Arbitrating under the 2012 ICC Rules: An Introductory User's Guide" 2012, fq. 158.

Gjithashtu, janë cilësuar si rrethana të përshtatshme, të cilat lejojnë përfshirjen e gjykatës shtetërore në dhënien e masës siguroese, rrethanat kur nevojitet marrja e një mase në mënyrë urgjente ose mbi baza *ex parte*.<sup>736</sup>

Pra, nëse do të shohim të gjithë shembujt e ofruar nga autorë të ndryshëm, qartazi kuptohet që rrethanat e përshtatshme apo përjashtimore që lejojnë investimin e gjykatës shtetërore për marrjen e një mase sigurimi edhe pas formimit të gjykatës së arbitrazhit do të ishin: i) rrethanat e urgjencës, të cilat duhet të konsiderohen së bashku me kërkesën e rrezikut të një dëmi të pariparueshëm; ii) rastet e kufizimeve të kompetencës së gjykatave të arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi, p.sh. kur gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë një masë ndaj një personi të tretë, nuk mund të marrë llojin e masës së kërkuar, apo nuk ka kompetencë për të marrë masa sigurimi; iii) rastet kur gjykata e arbitrazhit mund të jetë e paralizuar, për shembull, për shkak të dorëheqjes, përjashtimit apo vdekjes së një arbitri.

### **3. Autonomia e palëve për të përjashtuar juridiksionin gjyqësor për dhënien e masave të sigurimit**

Parimi i juridiksionit konkurrues në dhënien e masave të sigurimit nuk është çështje e rendit publik, ndaj palët kanë plotësisht të drejtë të kufizojnë kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi.<sup>737</sup> Kjo është në përputhje me parimin e autonomisë së vullnetit të palëve për të përcaktuar lirisht objektin e marrëveshjes së tyre të arbitrazhit. Por nëse palët mundën apo jo të përjashtojnë kompetencën e gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi kjo nuk është aq e qartë. Në parim palët që dëshirojnë të përjashtojnë juridiksionin e gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi duhet të lejohen ta bëjnë diçka të tillë. Dëshira për një proces eficient, të centralizuar, konfidencial dhe neutral i bën palët që shpesh të përjashtojnë kompetencën e gjykatës për të marra masa sigurimi.<sup>738</sup> Sikurse është shprehur një gjykatë franceze: “kompetenca e gjykatave për të dhënë masa sigurimi mund të përjashtohet vetëm me marrëveshje të palëve në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar duke zgjedhur rregulla arbitrazhi që mbajnë një përjashtim të tillë.”<sup>739</sup> Në fakt i vetmi akt që parashikon shprehimisht përjashtimin e kompetencës së gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi është Konventa e ICSID dhe Rregullat e saj të arbitrazhit. Sipas tyre gjykatat shtetërore do të kishin juridiksion për të dhënë masa sigurimi vetëm nëse palët do e parashikonin shprehimisht në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit, në të kundërt prezumohet se palët duke zgjedhur arbitrazhin pranë ICSID kanë përjashtuar juridiksionin e gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi. Ndërkohë që pjesa më e madhe e legjislacioneve që e njohin juridiksionin konkurrues për dhënien e masave të sigurimit nuk shprehen lidhur me mundësinë e përjashtimit me marrëveshje të palëve të kompetencës së gjykatës shtetërore. Ndër të paktët që përbën përjashtim është Akti Anglez i Arbitrazhit, i cili parashikon qartazi në nenin 44 (1) se përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe, gjykata shtetërore ka

<sup>736</sup> Thomas H. Webster, Michael W. Buhler, “Handbook of ICC Arbitration, Commentary, Precedents, Materials”, 3<sup>rd</sup> ed., 2014, fq. 439, para 28-49.

<sup>737</sup> Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, Kluwer Law International, 1999, fq. 718, para. 1319.

<sup>738</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2548; Schwartz, The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration, 1993, fq. 45; Mills, State international arbitration statutes and the US Arbitration Act: Unifying the availability of interim relief, 13 Ford. Int’l L.J., 1989-1990, fq. 604

<sup>739</sup> Atlantic Triton, Cass. 1 e civ. 18 November 1986

kompetencën për të dhënë urdhrat e listuar më poshtë, për qëllim dhe në lidhje me procesin e arbitrazhit, njësoj si e ka këtë kompetencë për qëllime dhe në lidhje me proceset gjyqësore. Pra, duket qartësisht se palët mund ta përjashtojnë me marrëveshje të drejtën gjykatës shtetërore për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit.

Në mungesë të parashikimit shprehimisht të mundësisë së palëve për të përjashtuar juridiksionin gjyqësor në dhënien e masave të sigurimit, tendenca e shumicës së doktrinës është që ta njohin këtë përjashtim si të mundshëm.<sup>740</sup> Ndërsa një pjesë tjetër e konsiderojnë marrëveshjen për përjashtimin e kompetencës së gjyqësorit për dhënien e masave të sigurimit si të pazbatueshme, veçanërisht në rastet kur nuk është e mundur marrja e një mase sigurimi nga gjykata e arbitrazhit.<sup>741</sup>

Ekzistojnë një sërë argumentesh pro dhe kundër përjashtimit të kompetencës së gjykatës për dhënien e masave të sigurimit. Argumentet pro përgjithësisht bazohen tek parimi i autonomisë së vullnetit të palëve.<sup>742</sup> Palët në tregtinë ndërkombëtare janë aq të sofistikuar sa për të kuptuar pasojat e përjashtimit të juridiksionit gjyqësor në dhënien e masave të sigurimit, ndaj ato duhet të lejohen të marrin përsipër riskun duke i dhënë kompetencë ekskluzive për marrjen e masave të sigurimit gjykatës së arbitrazhit.<sup>743</sup> Gjithashtu argumentohet se përsa kohë marrëveshjet që kufizojnë të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar të arbitrazhit janë njohur si të vlefshme, nuk ka pse të mos njihet një marrëveshje që përjashton juridiksionin gjyqësor lidhur me masat e sigurimit.<sup>744</sup>

Ndërsa përsa i përket argumenteve kundër mendohet se një marrëveshje që përjashton juridiksionin gjyqësor lidhur me masat e sigurimit mund të çojë në mohim të drejtësisë,<sup>745</sup> pasi duke përjashtuar juridiksionin gjyqësor mund të eliminohet tërësisht dhënia efektive e masave të sigurimit. Dhënia e masave nga arbitrat mund të mos jetë aq efciente apo ekzekutueshme sa mund të jetë një masë e dhënë nga gjyqësori.<sup>746</sup>

Diskutime gjithashtu ka ngjallur edhe mënyra e përjashtimit të kompetencës së gjyqësorit për dhënien e masave të sigurimit. Është e kuptueshme që situata është e qartë dhe nuk lë hapësirë për diskutime në rastin kur palët e kanë parashikuar shprehimisht në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit diçka të tillë. Ndryshe do të ishte në rastin e një marrëveshjeje të nënkuptuar. Kështu, referimi i përgjithshëm që bëhet në marrëveshjen e arbitrazhit se mosmarrëveshjet do të zgjidhen me arbitrazh duke përjashtuar juridiksionin e çdo gjykate nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar

---

<sup>740</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 529, para. 615.

<sup>741</sup> Hausmaninger, Ch., "The ICC rules for a pre-arbitral referee procedure: A step towards solving the problem of provisional relief in international arbitration?", 7(1) ICSII Rev. FILJ, 1992, fq. 82, 97; Berger, Die Rechtstellung des Pre-Arbitral Referee, 2006 SchiedsVZ, fq.176; Lachmann, Handbuch der Schiedsgerichtsbarkeit, 3<sup>rd</sup> ed. 2008, para. 2853.

<sup>742</sup> Për këtë argument shiko: Gary Born, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2548

<sup>743</sup> Ali Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 104, para.3-78.

<sup>744</sup> Konstantinos Adamontopoulos, "Greece" in Bosch ed. Fq. 305, 324.

<sup>745</sup> Pluyette, "The role of the courts and problems related to the execution of conservatory and provisional measures, në Conservatory and Interim measures in International Arbitration", Botim i ICC no. 519, 1993, fq. 75; Yesilirmak, "Provisional Measures in International Commercial Arbitration", 2005, fq. 104, para.3-77.

<sup>746</sup> Bosch, "Germany" in Bosch ed. fq. 295



juridiksionin gjyqësor lidhur me masat e sigurimit.<sup>747</sup> Ndërkohë nëse disa autorë<sup>748</sup> kanë cilësuar se fakti që palët kanë zgjedhur në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit zbatimin e rregullave të ICC për arbitrin para-arbitrazh,<sup>749</sup> në bazë të të cilave caktohet një arbitër që mund të marrë masa sigurimi përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit, mund të shihet si një përjashtim i juridiksionit gjyqësor për të dhënë masa sigurimi, të tjerë autorë<sup>750</sup> shprehen se ky nuk është një rast i mjaftueshëm për të përjashtuar juridiksionin gjyqësor në dhënien e masave të sigurimit. Nuk është konsideruar si një përjashtim i juridiksionit gjyqësor për dhënien e masave të sigurimit as zgjedhja e rregullave për arbitrazh të përshpejtuar.<sup>751</sup>

Në këto kushte, për të shmangur interpretimet e ndryshme lidhur me qëllimin e palëve, rekomandohet që palët të parashikojnë në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit me terma të qartë përjashtimin e juridiksionit gjyqësor për dhënien e masave të sigurimit.

#### 4. Konflikti i juridiksioneve

Në rastet ku pranohet juridiksioni konkurrues për dhënien e masave të sigurimit ekziston edhe mundësia e një konflikti pozitiv apo negativ juridiksioni. Jemi para rastit të konfliktit negativ të juridiksionit kur si arbitrat dhe gjykata shprehen se nuk kanë juridiksion për dhënien e masës së kërkuar. Ndërsa do të ishim para konfliktit pozitiv të juridiksionit kur si arbitrat dhe gjykata shprehen se kanë juridiksion për dhënien e një mase sigurimi. Në praktikë ekzistenca e juridiksionit konkurrues mund të krijojë qartazi situatë të papëlqyeshme dhe konfuzion.<sup>752</sup> Ai mund të çojë dhe në dhënien e vendimeve kontradiktore.<sup>753</sup>

Shumica e legjislacioneve nuk rregullojnë çështjen e konflikti të juridiksionit që mund të krijohet. Një përjashtim e ndeshim për shembull në legjislacionin gjerman, ku neni 1041(2) i KPrC parashikon se gjykata shtetërore nuk do të ndihmojë në ekzekutimin e një mase të dhënë nga arbitrat në rast se e njëjta kërkesë për masë sigurimi është paraqitur përpara gjykatës.

Disa autorë për shmangien e një konflikti të mundshëm juridiksioni argumentojnë se ndoshta për efekt të shpejtësisë së gjykimit, autoriteti që është investuari pari duhet të ketë prioritet në dhënien e masës së kërkuar.<sup>754</sup> Disa raste të praktikës gjithashtu duket se kanë ndjekur të njëjtin qëndrim duke u shprehur se kur një palë aplikon para gjykatës së arbitrazhit për marrjen e një mase sigurimi dhe pastaj para gjykatës

---

<sup>747</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", 2003, fq. 621, para. 23-117; Wessel and North Cohen, In tune with Mantovani: the "Novel" case of damages for breach of an arbitration agreement", 4 Int. ALR 65, 2001, fq. 68.

<sup>748</sup> Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, Kluwer Law International, 1999, fq. 719, para. 1321; Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, "Comparative International Commercial Arbitration", 2003, fq. 621, para. 23-115

<sup>749</sup> Pre-arbitral *referee* i parashikuar nga ICC.

<sup>750</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 530, para. 615.

<sup>751</sup> Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, Kluwer Law International, 1999, fq. 720, para. 1321

<sup>752</sup> Mauro Rubino-Samartanno, "International Arbitration, Law and Practice", 3<sup>rd</sup> ed., 2014, para.23-10.

<sup>753</sup> Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "Comparative Law of International Arbitration", 2007, fq. 532, para. 621.

<sup>754</sup> Hausmaninger, "The ICC Rules for a Pre arbitral referee procedure: A step towards solving the problem of provisional relief in international commercial arbitration", 7 ICSID Review, Foreign Investment Law Journal, 1992, fq. 98.

shtetërore (ose anasjelltas) me qëllim për të siguruar një vendim në favor të saj, gjykata e investuar e dyta duhet të mos e pranojë kërkesën në rast se nuk ka një ndryshim në rrethanat për të cilat kërkohet masa.<sup>755</sup> Për shembull në një vendim të ICC<sup>756</sup> arsyetohet se megjithëse rregulli i *ne bis in idem* nuk zbatohet në këtë rast, për hir të një procesi të rregullt ligjor, një palë nuk duhet të lejohet të aplikojë dy herë për të njëjtën masë, nëse nuk ka ndryshim të rrethanave.

Disa autorë të tjerë, me të drejtë kanë argumentuar që në rast të një konflikti juridiksioni ai duhet të zgjidhet në favor të arbitrazhit, me përjashtim të rasteve kur gjykata e arbitrazhit nuk mund të veprojë në mënyrë efektive.<sup>757</sup> Ose sikurse shprehen të tjerë autorë,<sup>758</sup> në rast të një konflikti mes masës së dhënë nga arbitrat dhe asaj të dhënë nga gjykata, e para duhet të prevalojë.

Një konflikt i mundshëm juridiksioni ndeshet në rastet kur gjykatës shtetërore i kërkohet ndryshimi apo revokimi i një mase të dhënë nga gjykata e arbitrazhit, ose anasjelltas. Qëndrimi prevalues është që gjykata shtetërore nuk duhet të ndërhyjë me ndryshimin apo revokimin e masës së dhënë nga gjykata e arbitrazhit, përveç kur gjykata e arbitrazhit nuk mund të veprojë në mënyrë efektive, ndërsa gjykata e arbitrazhit duhet të ketë mundësi të ndryshojë apo revokojë masën e dhënë nga gjykata shtetërore, sepse vendimi i gjykatës për masë sigurimi është i një natyre të përkohshme dhe nuk mund të pengojë gjykatën e arbitrazhit të ushtrojë juridiksionin e saj për të dhënë një tjetër masë.<sup>759</sup>

Dhe në fakt ligji anglez i arbitrazhit është ndër të paktët që parashikon shprehimisht mundësinë e gjykatës së arbitrazhit për të revokuar apo ndryshuar masën e dhënë nga gjykata shtetërore në nenin 44(6). Ndërkohë që dhe praktika e ka mbështetur këtë qëndrim. Në çështjen *Amco*,<sup>760</sup> gjykata e arbitrazhit është shprehur se:

“Një gjykatë arbitrazhi ndërkombëtar nuk është e detyruar të zbatojë rezultatin e gjykatës kombëtare. Një nga arsyet se pse palët i drejtohen arbitrazhit ndërkombëtar është pikërisht sepse ndihen më të sigurt me një institucion ligjor që nuk është aspak i lidhur me asnjë nga palët. Nëse vendimi i gjykatës shtetërore do të ishte i detyrueshëm për gjykatën e arbitrazhit, procesi i arbitrazhit do të humbiste kuptimin e tij. Prandaj, pavarësisht se si është përshkruar pozita juridike e një pale në vendimin gjyqësor, gjykata e arbitrazhit ka të drejtë të vlerësojë dhe shqyrtojë këtë pozitë pa pranuar asnjë efekt *res judicata* të vendimit gjyqësor. Në vlerësimin e saj, vendimi gjyqësor mund të pranohet si një nga faktorët që duhet të merret në konsideratë nga gjykata e arbitrazhit.”

---

<sup>755</sup> Vendim i Gjykatës së Drejtësisë së Gjenevës, RSPI, 1993, fq. 286, c.3

<sup>756</sup> ICC award 4126 JDI 1984, fq. 934, 936

<sup>757</sup> Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 106, para.3-83.

<sup>758</sup> Julian D M Lew, Loukas A Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration, 2003”, fq. 625, para. 23-130.

<sup>759</sup> Emanuel Gaillard, “Arbitrage commercial international- Intervention du juge Etatique”, *Juisclesseur Droit International*, Fascicule 586-8-2, no. 142, 1991; Schwartz, “The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration”, 1993, fq. 54; Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration, redaktuar nga Emmanuel Gaillard dhe John Savage, Kluwer Law International, 1999, fq. 723, para. 1330; Julian D.M. Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan Kroll, “Comparative International Commercial Arbitration”, 2003, fq. 625, para. 23-130

<sup>760</sup> *Amco Asia Corp. v. Republic of Indonesia*, Vendim i 20 nëntor 1984, 1 ICSID Rep 413, 1993

## 5. Ligji që aplikon gjykata shtetërore në dhënien e masave të sigurimit

Nëse gjykatat shtetërore do të investoheshin me një kërkesë për marrjen e një mase sigurimi, natyrshëm lind pyetja se çfarë ligji do të aplikojnë ato në shqyrtimin e kësaj kërkesë. Pothuajse gjithmonë gjykatat do të zbatojnë ligjin e tyre të brendshëm lidhur me mundësinë për të dhënë një mase dhe llojin e masës që mund të japin. Ato mund të japin vetëm masa që i parashikon legjislacioni i tyre i brendshëm.

Ligji Model i UNCITRAL parashikon shprehimisht në nenin 17J se gjykata do të zbatojë procedurat e saj gjatë ushtrimit të kompetencës për dhënien e një mase sigurimi në ndihmë të arbitrazhit. Një parashikim të tillë e kanë një pjesë e mirë e ligjeve kombëtare të arbitrazhit që kanë adoptuar ndryshimet e Ligjit Model të 2006, si p.sh. Belgjika,<sup>761</sup> por edhe legjislacione të hartuara jo sipas Ligjit Model, p.sh. Franca,<sup>762</sup> Anglia<sup>763</sup> etj. Edhe legjislacioni zviceran, duke interpretuar në analogji me nenin 183(2) të së Drejtës Ndërkombëtare Private Zvicerane, i cili parashikon se nëse pala nuk e zbaton vullnetarisht masën e sigurimit të dhënë nga gjykata e arbitrazhit, kjo e fundit ka të drejtë të kërkojë mbështetjen e gjykatës shtetërore, e cila zbaton ligjin e saj, kërkon që gjykata të zbatojë ligjin e saj të brendshëm.<sup>764</sup> Të njëjtin interpretim mund të bëjmë edhe për KPrC shqiptar, neni 418 i të cilit është identik me dispozitën e mësipërme të së drejtës zvicerane. Dhe në fakt praktika gjyqësore ka treguar qartazi që gjykatat shqiptare kanë zbatuar dispozitat e KPrC kur kanë shqyrtuar kërkesa për marrjen e masave të sigurimit.<sup>765</sup> Për shembull në Vendimin nr. 609 Akti, datë 24.07.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendos marrjen e masës së sigurimit pezullimin e ekzekutimit të garancisë bankare duke arsyetuar: “Nga çmimi në tërësi i provave të administruara në gjykim konkludohet se plotësohen kriteret procedurale për sigurimin e padisë sipas kërimit objekt gjykimi. *Së pari*, kërkesa për sigurimin e padisë mbështetet në një sërë provash shkresore që provojnë ekzistencën e mundshme të së drejtës që do të pretendohet nga kërkuesi në gjykimin e themelit. *Së dyti*, provohet ekzistenca e vështirësisë së ekzekutimit të vendimit të ardhshëm për të drejtat e paditësit. *Së treti*, paraqitja e kërkesës për sigurimin e padisë përpara ngritjes së padisë së themelit justifikohet me emergjencën e marrjes së kësaj mase.”

Edhe në ato raste ku legjislacionet heshtin lidhur me këtë çështje, doktrina ka argumentuar se si rregull i përgjithshëm kushtet për dhënien e masave të sigurimit nga gjykatat shtetërore përcaktohen nga *lex fori* i saj.<sup>766</sup>

Megjithatë ashtu sikurse Ligji Model parashikon, disa gjykata kanë sugjeruar që lidhur me kërkesat për marrjen e masave të sigurimit duhet të zbatohen disa kriteret të veçanta duke marrë parasysh karakteristikat specifike të arbitrazhit ndërkombëtar dhe mundësinë e gjykatës së arbitrazhit për t'i dhënë masat e kërkuara. Gjykata duhet të fokusohet në ruajtjen e integritetit të procesit të arbitrazhit.<sup>767</sup>

<sup>761</sup> Neni 1698 i Kodit Belg të Procedurës Civile

<sup>762</sup> Neni 1449 i Kodit të Procedurës Civile Francez

<sup>763</sup> Neni 44 i Aktit të Arbitrazhit Anglez

<sup>764</sup> B. Berger & F. Kellerhals, “International and Domestic Arbitration in Switzerland”, 2<sup>nd</sup> ed. 2010, para. 1163,1175

<sup>765</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 549 akti, datë 23.08.2012

<sup>766</sup> Boog, “The laws governing interim measures in international arbitration”, në F. Ferrari & S. Kroll (eds). Conflict of laws in international arbitration, 2010, fq. 409, 452.

<sup>767</sup> Ortho Pharm. Corp. v. Amgen Inc. 882 F.2<sup>nd</sup> (3<sup>rd</sup> Cir. 1989), fq. 806, 813-814.

## 6. Ndhimja e gjykatave ndaj arbitrazhit të huaj

Zakonisht gjykatat japin ndihmën e tyre lidhur me masat e sigurimit për proceset e arbitrazhit që zhvillohen në vendin ku ndodhet gjykata. Megjithatë shpesh herë prova të rëndësishme apo asetet e palëve mbi të cilat do të ekzekutohej vendimi përfundimtar i arbitrazhit nuk ndodhen në vendin e arbitrazhit, sepse sikurse është e mirënjohur tashmë, përgjithësisht vendi i arbitrazhit është një vend neutral dhe i përshtatshëm gjeografikisht për palët, por pa ndonjë lidhje me to apo me mosmarrëveshjen. Në këto kushte jo rrallë herë është e nevojshme që gjykatat shtetërore të ushtrojnë kompetencat e tyre për dhënien e masave të sigurimit në ndihmë të arbitrazhit të huaj. Kjo për arsye se vendimet për masa sigurimi të gjykatave të vendit të arbitrazhit do ishin shumë të vështira apo të pamundura për tu ekzekutuar në territorin e një shteti tjetër për shkak të karakterit të tyre si vendim jo i formës së prerë.<sup>768</sup> Duhet të kemi parasysh që vendimi i një gjykate të huaj për masa sigurimi në mënyrë që të ekzekutohet në një shtet tjetër duhet t'i jepet fuqi fillimisht nëpërmjet procedurës së njohjes së vendimit të huaj. Por a është e mundur diçka e tillë?

Konventat ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit nuk kanë ndonjë parashikim specifik lidhur mundësinë e dhënies së ndihmës arbitrazhit të huaj nga gjykatat shtetërore. Shumica e legjislacioneve, sikurse u trajtuan më sipër, u njohin të drejtën gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit, por pa bërë ndonjë parashikim specifik nëse kjo kompetencë mund të ushtrohej pavarësisht vendit të arbitrazhit. Përjashtim bën Ligji Model i UNCITRAL, i cili në nenin 17J qartazi parashikon se: “Gjykata shtetërore do të ketë të njëjtën kompetencë për të dhënë masa sigurimi në lidhje me një proces arbitrazhi, pavarësisht vendit se ku zhvillohet ai, sikurse ka për dhënien e masave të sigurimit në lidhje me një proces gjyqësor.” Disa nga shtetet që lejojnë shprehimisht gjykatat shtetërore të ushtrojnë kompetencat e tyre lidhur me masat e sigurimit në ndihmë të arbitrazhit të huaj janë Gjermania,<sup>769</sup> Belgjika,<sup>770</sup> Sllovenia,<sup>771</sup> Anglia,<sup>772</sup> Singaporit<sup>773</sup> etj.

Në shtetet kur ligji kombëtar nuk e parashikon shprehimisht mundësinë e gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi edhe në ndihmë të arbitrazhit të huaj jo rrallë ndeshen qëndrime kontradiktore. Shembulli tipik është India, ku gjykatat shtetërore herë e kanë njohur<sup>774</sup> e herë jo<sup>775</sup> të drejtën për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit të huaj. Ndërkohë që në SHBA<sup>776</sup> një numër gjykatash kanë njohur të drejtën për të dhënë masa sigurimi edhe në ndihmë të arbitrazhit të huaj, ashtu sikurse kanë bërë dhe disa gjykata në Zvicër.<sup>777</sup>

Në Shqipëri, neni 400 i Kodit të Procedurës Civile parashikon qartazi se dispozitat e kodit që rregullojnë arbitrazhin zbatohen vetëm në arbitrazhin e brendshëm, duke

<sup>768</sup> G. Born, P. Rutledge, “International civil litigation in United States courts”, 5<sup>th</sup> ed. 2011, fq. 1077-1078

<sup>769</sup> Shiko nenin 1025(2) dhe 1033 të Kodit të Procedurës Civile Gjerman.

<sup>770</sup> Neni 1698 i Kodit të Procedurës Civile të Belgjikës

<sup>771</sup> Neni 12 i Ligjit të Arbitrazhit Slloven i vitit 2008.

<sup>772</sup> Neni 2(3)(b) i Aktit të Arbitrazhit Anglez

<sup>773</sup> Neni 12(a) i Aktit të Arbitrazhit Ndërkombëtar në Singapor

<sup>774</sup> *Bhatia Int'l v. Bulk Trading SA*. 2002

<sup>775</sup> *Bharat Aluminium v. Kaiser Aluminium*, C.A. no. 7019/2005

<sup>776</sup> *Bahrain Telecomms. Co. v. Discovery Tel. Inc* 476 F.Supp.2d (D. Con. 2008), fq. 176, 180; *Tampimex Oil Ltd. v. Latina Trading Corp.* 558 F.Supp. 1201 (S.D.N.Y. 1983); *Beluga Chartering GmbH v. Korea Logistics Sys. Inc.* 589 F. Supp. 2d, 325 (S.D.N.Y 2008)

<sup>777</sup> Vendim i Gjykatës së Distriktit të Zyrihut, 20 tetor 1989, botuar në RSDIE, 1991, fq. 368

përfunduar kështu arbitrazhin ndërkombëtar, i cili sipas nenit 439 rregullohet me ligj të veçantë. Aktualisht ende nuk ka një ligj që të rregullojë arbitrazhin ndërkombëtar. Megjithatë Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Gjenevës,<sup>778</sup> në bazë të nenit 6(4) të të cilës gjykatat shqiptare janë shprehur se kanë juridiksion në dhënien e masave të sigurimit në ndihmë të arbitrazhit të huaj. Kështu në çështjen, *Profil BSA kundër A&V Gas*, Gjykata e Lartë me vendimin nr. 22, dt 19.01.2011<sup>779</sup> konfirmoi këtë qëndrim duke konkluduar se: “Në analizë dhe në referim të të gjitha argumenteve të cituara më lart si dhe akteve dhe normativave kombëtare dhe ndërkombëtare, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arrin në konkluzionin se personi fizik ose juridik i huaj mund t’i drejtohet gjykatës shqiptare me kërkimin për sigurimin e padisë në rast se pasuria/asetet e debitorit ndodhen në RSH edhe pse kompetente për të shqyrtuar çështjen e themelit mund të jetë një gjykatë tjetër e huaj apo arbitrazhi.....Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon gjithashtu se pavarësisht se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës mund të mos jetë kompetente për shqyrtimin e çështjes së themelit në rast se kjo e fundit pranon kërkimin e kërkuarit për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të caktojë dhe afatin brenda së cilës pala kërkuar duhet të paraqesë padinë e themelit pranë gjykatës në juridiksionin e së cilës do të shqyrtohet kjo padi”

Theksosjmë se ky vendim i Gjykatës së Lartë është marrë përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, i cili shprehimisht parashikon në nenin 81 se gjykatat shqiptare kanë juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimit.

Gjithashtu në vendimin nr. 762 akti, datë 17.11.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur: “Gjykata çmon se gjykimi i kësaj kërkesë për marrjen e një mase provizore, përpara se palët të zgjidhin çështjen me pajtim ose nëpërmjet një procedure arbitrazhi, bën pjese në juridiksionin e Gjykatave të Republikës së Shqipërisë. Gjykimi i kësaj kërkesë nuk është e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit si dhe nuk ka lidhje me zgjidhjen e çështjes në themel, për të cilën palët kanë parashikuar si gjykatë kompetente Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.”

Në një tjetër vendim,<sup>780</sup> gjykata ka arsyetuar: “Fillimisht çmohet e nevojshme të nënvizohet se kjo gjykatë gëzon juridiksionin gjyqësor për gjykimin e kërkesës për sigurimin e padisë pavarësisht faktit se zgjidhja e themelit të mosmarrëveshjes kontraktore mes palëve ndërgjyqëse i takon gjykatës ndërkombëtare të arbitrazhit.

Neni 439 i KPrC sanksionon: “*Arbitrazhi ndërkombëtar rregullohet me ligj të veçantë.*” Në kushtet e mungesës së miratimit të një ligji specifik në lidhje me arbitrazhin ndërkombëtar, aspektet procedurale mbi gjykimin e mosmarrëveshjeve nga gjykata ndërkombëtare e arbitrazhit rregullohen nga Konventa Evropiane mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar, Gjenevë 21 prill 1961, aprovuar me ligjin nr 8687, datë 20.11.2000 “Për aderimin e RSH në Konventën Evropiane të Arbitrazhit”. Neni 6/4 i kësaj Konvente parashikon: “4. *Një kërkesë për masa të përkohshme ose masa sigurimi që i është drejtuar një autoriteti gjyqësor nuk mund të konsiderohet si e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit, as edhe si shtrim i thelbit të çështjes në gjykatë*”.

Parashikimi i mësipërm i Konventës nuk pengon palët e përfshira në mosmarrëveshje, të cilat kanë lidhur një marrëveshje arbitrazhi për zgjidhjen e themelit të çështjes, t’i drejtohen autoritetit gjyqësor shtetëror për marrjen e masave

<sup>778</sup> Miratuar me Ligjin nr. 8687, datë 9.11.2000

<sup>779</sup> Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 22, datë 19.01.2011 (në këtë çështje palët kishin parashikuar me marrëveshje për juridiksionin e Gjykatës së Lartë të Londrës)

<sup>780</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 609, datë 11.07. 2013

për sigurimin e padisë edhe pse kjo gjykatë nuk gëzon juridiksion për gjykimin e themelit të çështjes.

Ky konceptim i Konventës, i cili nuk përjashton juridiksionin shtetëror për gjykimin e kërkesave për marrjen e masave për sigurimin e padisë është në kohezion me natyrën emergjente të këtyre masave që synojnë të sigurojnë zbatimin e vendimmarrjes së ardhshme mbi themelin e mosmarrëveshjes, edhe pse ky gjykim i përket arbitrazhit ndërkombëtar. Paraqitja dhe përgatitja e çështjes përpara gjykatës së arbitrazhit, përfshirë dhe kohëzgjatjet procedurale për fillimin e gjykimit do të cenonin shpejtësinë e vendimmarrjes në lidhje me masat e sigurimit të padisë, të cilat të gjykuara nga juridiksioni gjyqësor, në kushtet edhe të një gjykimi jo kontencioz (*ex parte*)(*pa palë kundërshtare*) do të garantonin efektivitetin e zbatimit të tyre.

Nevoja e ndërmarrjes së masave të menjëhershme për sigurimin e padisë dhe mbi të gjitha ekzekutimi i tyre, që në të shumtën e rasteve diktohet nga vendndodhja e pasurisë së debitorit apo vendi ku duhet të ndërmerret veprimi që siguron objektin e padisë, është ngushtësisht i lidhur me hapësirën ku ushtron juridiksionin gjykata shtetërore.”

Në rast se gjykatave shtetërore iu njihet juridiksioni për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit të huaj, pyetja që lind është a ka kufizime në lidhje me përcaktimin e gjykatës ku duhet të parashtrohet një kërkesë e tillë? Në disa raste palët e përcaktojnë në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit gjykatën kompetente para të cilës mund të paraqitet një kërkesë për marrjen e masës së sigurimit. Një përzgjedhje e tillë e forumit gjyqësor interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjin për të drejtën ndërkombëtare private që është e zbatueshme për gjykatën që kanë zgjedhur palët me marrëveshje. Nëse i referohemi të drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë duket qartazi se në bazë të nenit 81 gjykatat shqiptare do të kishin juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimit.

Praktika e huaj ka treguar se në mënyrë që një gjykatë të shprehet mbi një kërkesë për masë sigurimi në ndihmë të arbitrazhit të huaj duhet që të paktën të ketë një lidhje ndërmjet çështjes në fjalë dhe gjykatës së zgjedhur. Kështu për gjykatat franceze lidhja mund të ekzistojë ose kur vendi i ekzekutimit të masës është Franca, ose kur masa e sigurimit kërkohet kundër një shtetasi francez.<sup>781</sup> Në ato raste kur nuk ka një lidhje me gjykatën ku paraqitet kërkesa për dhënien e një mase sigurimi, gjykatat shtetërore zakonisht ngurrojnë ta pranojnë një kërkesë të tillë.<sup>782</sup>

Gjykatat shtetërore gjithashtu kur kanë kompetencën për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit të huaj duhet të tregojnë një kujdes të madh në ushtrimin e saj për shkak se rrezikon të ndërhyjë jo vetëm në juridiksionin e arbitrazhit, por edhe në juridiksionin gjyqësor të vendit të arbitrazhit. Rasti më i referuar si shembull i kujdesit që duhet të tregojnë gjykatat është çështja *Channel Tunnel Group Ltd. kundër Balfour Beatty Construction Ltd.*<sup>783</sup> Palë në këtë çështje ishin një konsorcium ndërkombëtar ndërmjet një shoqërie franceze dhe një angleze, të cilët kishin parashikuar për

<sup>781</sup> Pluyette, “The role of the courts and problems related to the execution of conservatory and provisional measures, në *Conservatory and Interim measures in International Arbitration*”, Botim i ICC no. 519, 1993, fq. 76.

<sup>782</sup> Shiko p.sh. Ali Yesilirmak, “Provisional Measures in International Commercial Arbitration”, 2005, fq. 82, para.3-34

<sup>783</sup> *Channel Tunnel Group v Balfour Beatty Ltd*, House of Lords England, [1993] Adj.L.R. 01/21, 21.01.1993

<http://www.nadr.co.uk/articles/published/AdjudicationLawReports/Channel%20Tunnel%20v%20Balfour%20Beatty%201993.pdf>

arbitrazh sipas rregullave të ICC me vend arbitrazhi Brukselin. Channel Tunnel kërkoi para gjykatave angleze marrjen e një mase sigurimi. Dhoma e Lordëve rishikoi vendimin e gjykatës së ulët angleze, e cila shprehej se gjykata nuk kishte juridiksion për dhënien e masës, duke u shprehur se juridiksioni ekzistonte, por gjithsesi nuk ishte e përshtatshme që gjykata angleze të jepte një masë në ndihmë të një arbitrazhi që po zhvillohej në Belgjikë. Për të arritur në këtë konkluzion Dhoma e Lordëve mori në konsideratë: i) vendin e arbitrazhit, ii) palët në mosmarrëveshje, iii) ndërhyrjen e rastësishme të gjykatës angleze, vetëm se i padituri ishte shoqëri angleze, iv) faktin që masa e sigurimit mund të zgjidhte shumicën e asaj që kërkohet me themelin e padisë, v) faktin që gjykatat zakonisht duhet të hezitojnë në dhënien e masave të sigurimit në ndihmë të arbitrazhit, vi) faktin që gjykata belge duhet të ishte “gjykata natyrale” në dhënien e masës duke qenë se vendi i arbitrazhit ishte Brukseli.<sup>784</sup>

## **7. Ekzekutimi i masave të sigurimit të dhëna nga gjykatat shtetërore në ndihmë të arbitrazhit të huaj**

Nëse një gjykatë shtetërore e vendit të arbitrazhit, apo e një shteti tjetër ka dhënë një masë sigurimi, mund të lindë nevoja që ajo masë të ekzekutohet jashtë. Ekzekutimi i masës së dhënë nga gjykata e huaj, duke qenë një vendim i gjykatës së huaj, kërkon fillimisht të kalojë procedurën e njohjes së këtij vendimi me qëllim që t'i jepet fuqi në shtetin ku kërkohet njohja. Përgjithësisht vendimi për sigurim padie është shumë e vështirë të ekzekutohet në një shtet të ndryshëm nga ai i gjykatës që e ka dhënë për shkak se shpesh ato nuk janë vendime me detyrime monetare dhe nuk kanë formën e prerë për qëllim të njohjes dhe ekzekutimit sipas shumë regjimeve kombëtare.<sup>785</sup>

Praktika gjyqësore ka treguar raste të refuzimit të njohjes dhe ekzekutimit të masave të sigurimit të dhëna nga një gjykatë e huaj.<sup>786</sup> Ndër to mund të përmendim edhe një rast të praktikës shqiptare.<sup>787</sup> Kërkuesi Sky Petroleum Inc. një shoqëri e të drejtës amerikane, ka lidhur një Marrëveshje Hidrokarbure për Ndarjen, Prodhimin Zbulimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), e cila përmban një klauzolë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh në Zyrih, Zvicër sipas Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL. Si rrjedhojë e një mosmarrëveshje që ka lindur në lidhje me pretendimin e mospërmbushjes së disa detyrimeve kontraktore, AKBN i ka njoftuar shoqërisë Sky Petroleum, zgjidhjen e kontratës së sipërpërmendur. Sky Petroleum paraqet në Gjykatën e Teksasit SHBA, kërkesë me objekt marrjen e masës për sigurimin e padisë, e cila pranohet me vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Teksasit. Me qëllim ekzekutimin e këtij vendimi në Shqipëri, shoqëria Sky Petroleum paraqet kërkesë për njohjen e tij në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit referuar nenit 396(b) të KPrC, sipas të cilit kërkesës për njohje i bashkëngjitet vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, dhe nenit 394 (dh), i cili parashikon se vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar, ka vendosur refuzimin e

<sup>784</sup> Gary Born, “International Commercial Arbitration”, 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014, fq. 2560

<sup>785</sup> Dicey, Morris, Collins, On the conflict of law, 15<sup>th</sup> ed. 2012, para. 16-108 e vijues; G. Born, P. Rutledge, “International civil litigation in United States courts, 5<sup>th</sup> ed. 2011, fq. 1077 e vijues

<sup>786</sup> City Water Service Ltd. v. Dar es Salaam Water & Sewerage Auth., Misc.Civ. case no. 20 of 8 June 2005

<sup>787</sup> Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 32/1010, datë 01.03.2012

njohjes së vendimit të Gjykatës së Teksasit SHBA, sepse nuk ka marrë formë të prerë sipas parimeve bazë të legjislacionit shqiptar, i parashikuar ne nenin 394/dh të K.Pr.Civile.

Mungesa e konventave ndërkombëtare që parashikojnë edhe mundësinë e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të huaja për masa sigurimi e bën edhe më të vështirë situatën. Theksojmë këtu se Konventa e Hagës “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare” e datës 1 Shkurt 1971 i përjashton shprehimisht nga fusha e saj e zbatimit vendimet për masa sigurimi.<sup>788</sup>

Për fat të keq situata nuk është më e mirë as në vendet e Bashkimit Evropian. Konventa e Brukselit, tashmë Rregullorja 1215/2012 “Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”, megjithëse në bazë të nenit 35 e njeh kompetencën e gjykatave shtetërore të vendeve të BE të marrin masa sigurimi, edhe pse kompetente për gjykimin e themelit mund të jetë një gjykatë e një shteti tjetër anëtar, ose arbitrazhi, sikurse është konfirmuar me çështjen Van Uden, e kufizon efektin e këtyre masave vetëm në territorin e atij shteti anëtar.<sup>789</sup> Në Preambulën e Rregullores paragrafi 33, përcaktohet qartë se kur masat e sigurimit janë të urdhëruar nga një gjykatë që ka juridiksion edhe për themelin e çështjes, qarkullimi i tyre i lirë duhet të jetë i garantuar sipas kësaj Rregulloreje. Kur masat e sigurimit janë të urdhëruara nga një gjykatë e një Shteti Anëtar që nuk ka juridiksion për themelin e çështjes, efekti i masave të tilla duhet të kufizohet, sipas kësaj Rregulloreje, në territorin e atij shteti anëtar. Pra, e thënë ndryshe një masë sigurimi e dhënë nga një gjykatë e një shteti anëtar në ndihmë të arbitrazhit të huaj mund të ekzekutohet vetëm në atë shtet ku është dhënë kjo masë dhe jo në shtetet e tjera anëtare të BE.

---

<sup>788</sup> Shiko nenin 2 të Konventës së Hagës “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare”.

<sup>789</sup> Shiko nenin 2(a), 42 (2) të Rregullores 1215/2012 “Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”



## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Pas analizës gjithëpërfshirëse të institutit të sigurimit të padisë në proceset gjyqësore civile dhe të arbitrazhit kemi arritur në disa konkluzione që kanë për qëllim të evidentojnë jo vetëm çështje problematike lidhur me këtë institut në procesin gjyqësor civil dhe të arbitrazhit, por edhe të shërbejnë si burim për dhënien e rekomandimeve përkatëse për zgjidhjen e tyre.

### ➤ *Mbi masat e sigurimit në procesin gjyqësor civil*

Mbrojtja e përkohshme e të drejtave është padyshim një nga parimet e përgjithshme të së drejtës në të gjitha sistemet e zhvilluara ligjore, qëllimi i së cilës është të realizojë objektivin thelbësor të çdo sistemi ligjor, efektivitetin e mbrojtjes gjyqësore, e cila realizohet nëpërmjet masave të sigurimit të padisë dhe sigurimit të provës.

Funksionet kryesore të mbrojtjes së përkohshme të të drejtave nëpërmjet masave të sigurimit të padisë janë: i) Ruajtja e *status quo* deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes me vendim të formës së prerë; dhe ii) Sigurimi i aseteve me të cilat do të realizohet ekzekutimi i vendimit përfundimtar.

Kurse tiparet karakteristike të mbrojtjes së përkohshme të të drejtave janë *përkohshmëria*, domethënë pamundësia për të garantuar në mënyrë përfundimtare njohjen e të drejtës objekt mosmarrëveshje dhe *të qënurit në dobi apo funksion* të vendimit përfundimtar të dhënë sipas një procesi të zakonshëm, që nënkupton se ajo nuk synon të arrijë të njëjtin rezultat si gjykimi i themelit, por të garantojë që rezultati i këtij gjykimi të mos dëmtohet ndërkohë, dhe se është gjithmonë e lidhur me padinë e themelit në kuptimin që masat e sigurimit janë gjithmonë të destinuara të humbasin efektin në rast se rrëzohet padia e themelit, ose të bëhet pjesë e vendimit që pranon padinë.

Në Evropën kontinentale mendohet se ka dy sisteme të mbrojtjes së përkohshme të të drejtave: *i pari*, sistemi tërësisht atipik, dhe *i dyti*, sistemi tipik, por i zbutur nga një masë sigurimi atipike me karakter dytësor.

Sistemi *tërësisht atipik* parashikon një proces të vetëm të mbrojtjes së përkohshme të të drejtave për të gjitha llojet e rrezikut (*periculum in mora*) që arrijnë në ekstremet e dëmit të riparueshëm të të drejtës, proces, i cili është i destinuar të përfundojë me dhënien e masave të sigurimit që nuk janë përcaktuar nga legjislatori, por që individualizohen rast pas rasti nga gjyqtari në bazë të rrezikut që kërkohet të shmanget. Gjykojmë se sistemi shqiptar bën pjesë pikërisht në këtë kategori, sepse parashikon një proces të vetëm për të gjitha rastet ku mund të jetë e nevojshme marrja një mase sigurimi dhe e lë në diskrecion të gjykatës të japë çdo masë që e konsideron të përshtatshme.

Në *sistemin tipik* të zbutur nga një masë sigurimi atipike me karakter dytësor, legjislatori përcakton nëpërmjet normave të përgjithshme dhe abstrakte lloje të veçanta të rrezikut (*periculum in mora*) dhe të masave të sigurimit dhe si rrjedhojë gjyqtari do të japë masën e sigurimit vetëm nëse bindet për ekzistencën e rrezikut (*periculum*) të parashikuar shprehimisht nga legjislatori, pa u varur aspak nga vlerësimi nëse ky rrezik arrin në ekstremet e dëmit të riparueshëm.

Vlerësimi i rrethanave të rastit për dhënien apo jo të një mase sigurimi, është në diskrecion të gjykatës, i cili ndonëse jo i kufizuar nga rregulla strikte kushtëzohet nga përmbushja e disa kushteve thelbësore, të cilat janë ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje (*fumus boni juris*) dhe ekzistenca e frikës që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë, apo një dëmi të pariparueshëm që mund t'i shkaktohet të drejtës nga kohëzgjatja e gjykimit të themelit (*periculum in mora*).

Ekzistenca e mundshme e të drejtës, është një kusht i parashikuar në të gjitha sistemet ligjore, megjithëse ka dallime në mënyrën e vlerësimit të saj. Përgjithësisht në vendet e *civil law*, sikurse është dhe Shqipëria, vlerësimi i *fumus boni juris* nuk kërkon provimin e ekzistencës konkrete të të drejtës, kjo i takon themelit të padisë, por vetëm mundësinë e ekzistencës së saj dhe gjykatës i kërkohet vetëm verifikimi i një probabiliteti të arsyeshëm. Vlerësimi i këtij kushti mund të bëhet vetëm në bazë të provave, të cilat duhet të paraqiten nga kërkuesi dhe duhet të vlerësohen në mënyrë sipërfaqësore nga gjykata, sepse vlerësimi përfundimtar i tyre duhet t'i lihet gjykimit të themelit. Ndërsa në vendet e *common law*, ky kriter i referuar edhe si “çështja *prima facie*” kërkon që kërkuesi i masës së sigurimit të provojë jo vetëm se ka një çështje për tu gjykuar, por dhe mundësinë e paditësit për të fituar padinë e themelit.

Lidhur me *periculum in mora*, si kushti i dytë për marrjen e masave të sigurimit, doktrina italiane bën dallimin e tij në dy kategori: (i) Rreziku i mosekzekutimit të vendimit të themelit; (ii) Rreziku nga vonesa në dhënien e vendimit të themelit.

Me *rrezikun e mosekzekutimit* të vendimit të themelit nënkuptohet rreziku që gjatë kohës së nevojshme për zhvillimin e procesit të themelit, mund të ndodhin fakte të tilla që e bëjnë të pamundur ose të vështirë mundësinë e ekzekutimit konkret të vendimit të themelit. Masa tipike për këtë lloj rreziku është sekuestroja.

Me *rrezikun nga vonesa* e vendimit të themelit nënkuptohet rreziku që mund t'i vijë rivendosjes së të drejtës thjesht nga zgjatja e procesit. Në këto raste, masa e sigurimit synon rivendosjen e parakohshme të të drejtës në mënyrë të përkohshme, për shkak se *periculum in mora* nuk vjen nga ndryshimi i rrethanave të faktit apo të të drejtës në të cilat do të bazohet vendimi i themelit, por pikërisht nga zgjatja e gjendjes së mospërmbushjes së të drejtës, e cila pretendohet gjatë gjykimit të themelit në një proces të zakonshëm. Masat tipike për këtë lloj rreziku janë pezullimi, ndalimi i shitjes së kuotave, ndalimi i kryerjes së punimeve etj.

Në Shqipëri, referuar nenit 202 të KPrC, i cili parashikon se gjykata lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë, duket se i vetmi *periculum* për të cilin mund të lejohet masa e sigurimit është ai që përfshihet në kategorinë e parë, pra rreziku i mosekzekutimit të vendimit të themelit, por në fakt praktika ka treguar se pranohet dhënia e masave të sigurimit edhe për rrezikun nga vonesa e vendimit të themelit.

Për vlerësimin e rrezikut nga mosekzekutimi, duhet të kemi parasysh që ai nuk duhet të konsistojë vetëm në frikën subjektive të kreditorit se do të humbasë kredinë e tij, por duhet t'i korrespondojë një situatë rreziku konkret dhe objektiv, ku konkretizohet mundësia që pasuria e debitorit të zhduket apo të pakësohet dhe jo domosdoshmërisht në një situatë aktuale të humbjes së pasurisë së debitorit. Vlerësimi mund të realizohet duke iu referuar qëndrueshmërisë së pasurisë së debitorit, ose duke iu referuar

elementeve subjektivë, të tilla si sjellja gjyqësore dhe jashtëgjyqësore e debitorit, e cila krijon tek kreditori dyshimin e arsyeshëm se pretendimi i tij nuk do të përmbushet.

Për rrezikun nga vonesa në dhënien e vendimit mbi themelin, gjykata justifikohet në dhënien e një mase sigurimi vetëm nëse është e nevojshme për të shmangur një dëm të pariparueshëm. Si dëm i tillë konsiderohet rasti kur pala e ekspozuar ndaj tij nuk do të ketë mundësi të dëmshpërblehet nga pala tjetër, pasi nuk ka asete të mjaftueshme, kur dëmi nuk do të mund të llogaritej, kur kompensimi, megjithëse është praktikisht i mundshëm, gjykohet se nuk është i përshtatshëm etj.

Për të mbuluar dëmet që mund t'i shkaktohen të paditurit nga marrja e një mase sigurimi që pas vendimit të formës së prerë rezulton që ishte e padrejtë, legjislatori ka parashikuar vendosjen e garancisë, si një masë kundërsiguruese. Por neni 202 i KPrC është i paqartë në drejtim të faktit nëse garancia është apo jo, një kusht kumulativ me dy kushtet e tjera *fumus boni juris* dhe *periculum in mora* dhe ka bërë që praktika gjyqësore shqiptare të jetë e dyzuar. Megjithatë qëndrimi prevalues dhe me të drejtë është që vendosja e garancisë nuk është një kusht kumulativ, por është në diskrecion të gjykatës për të çmuar vendosjen e saj rast pas rasti. Gjithashtu nuk del e qartë nëse mund të jepet një masë sigurimi vetëm nëse jepet garanci edhe nëse nuk ka prova mjaftueshëm që tregojnë për ekzistencën e *fumus boni juri* dhe *periculum in mora*. Ndonëse mënyra e formulimit të nenit 202 lë të kuptohet se kjo është e mundur, (një parashikim të tillë, por shumë të qartë e ka KPrC Gjerman) praktika gjyqësore tregon se në asnjë rast neni 202 i KPrC nuk është interpretuar në atë mënyrë që do të lejonte marrjen e masës së sigurimit duke u mjaftuar vetëm me garancinë.

Në këto kushte për të shmangur keqinterpretimet sugjerojmë që neni 202 i KPrC të riformulohet duke parashikuar se: “Sigurimi i padisë lejohet kur padia është e bazuar në prova me shkresë. Gjykata mund të kërkojë dhënien e një garancie, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.”

E drejta për tu dëmshpërblyer nga vendosja e një mase sigurimi të padrejtë nuk lind automatikisht, por nga një vendim i gjykatës, e cila duhet të investohet me anë të një kërkesëpadie, ku tashmë i padituri, kundër të cilit ishte marrë një masë sigurimi, e cila ka rënë nga fuqia për shkak se padia e themelit është rrëzuar me vendim të formës së prerë, ose për shkak se gjykimi mund të jetë pushuar, është në pozitën e paditësit. Në mungesë të rregullimit specifik nga KPrC gjykojmë se gjykata kompetente para së cilës duhet të paraqitet kërkesëpadia është gjykata e që ka gjykuar themelin e padisë, me vendimin përfundimtar të të cilës është hequr dhe masa e sigurimit. I padituri, i cili pretendon për shkaktimin e një dëmi të ardhur nga masa e sigurimit e vendosur padrejtësisht, ka barrën për të provuar se i është shkaktuar një dëm dhe se ky dëm është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e masës së sigurimit, e cila është hequr me vendim të formës së prerë.

Akti procedural me anë të të cilit investohet gjykata për marrjen e një mase sigurimi është kërkesa, për të cilën në mungesë të përcaktimeve në KPrC lidhur me përmbajtjen e saj, gjykojmë se duhet të zbatohen të njëjtat rregulla si për paraqitjen e kërkesëpadisë dhe ajo duhet të tregojë: i) gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa; ii) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë; iii) Objektin e

kërkesës (llojin e masës së sigurimit); iv) tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese mbi të cilat mbështetet kërkesa (ekzistenca e *fumus boni juris* dhe *periculum in mora*); v) objektin dhe përmbledhjen e fakteve të padisë së themelit që do të paraqitet (*petitum* dhe *causa petendi*), në rastet kur kërkesa bëhet *ante causam*; v) kërkimin përfundimtar.

Në doktrinën italiane ka pasur diskutime lidhur me përcaktimin apo jo të llojit të masës së sigurimit dhe të *petitum* dhe *causa petendi* të padisë së themelit si elemente të kërkesës për sigurim padie. Sidoqoftë qëndrimi prevalues është që të dy këta elemente duhet të tregohen në kërkesën për masë sigurimi. Lidhur me elementin *petitum* dhe *causa petendi* Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë qartësuar se përcaktimi i objektit të padisë shërben si bazë fillestare për të vendosur lidhur me masat e sigurimit. Në praktikën gjyqësore shqiptare mungesa e përcaktimit të objektit të padisë ka passjellë rrëzimin e kërkesës për sigurim padie.

Diskutime ka pasur edhe nëse gjykata mund të vendosë një masë të ndryshme nga ajo që është kërkuar dhe qëndrimi i doktrinës italiane është i përçarë në drejtime të ndryshme. Në kushtet kur Kodi ynë i procedurës civile parashikon se gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, pavarësisht se në nenin 206 përcaktohet se sigurimi i padisë bëhet me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit dhe me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata, gjykojmë se gjykata duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me kërkesën për sigurim padie në bazë të diskrecionit që i jep neni 206 i KPrC, nuk mund të vendosë për një masë të ndryshme nga ajo e kërkuar nga palët, por vetëm të vlerësojë nëse masa e kërkuar është e përshtatshme apo jo duke marrë parasysh dhe interesat e palës tjetër dhe duke vendosur respektivisht pranimin, rrëzimin, apo pranimin e pjesëshëm të saj.

Në rast se kërkesa paraqitet njëkohësisht, ose pas paraqitjes së padisë së themelit, megjithëse KPrC nuk ka bërë ndonjë përcaktim të shprehur është logjike që po kjo gjykatë do të jetë kompetente edhe për shqyrtimin e kërkesës për sigurim padie. Kurse në rast se kërkesa ngrihet *ante causam*, gjykata kompetente mund të jetë, ose gjykata e vendit ku ka banimin paditësi, ose ajo ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia. Në rast se pa u shqyrtuar ende kërkesa për marrjen e masës së sigurimit e ngritur *ante causam*, ngrihet padia e themelit objekti i së cilës kërkohet të sigurohet, duhet që të vendoset bashkimi i gjykimeve pranë gjykatës që është kompetente për gjykimin e themelit të padisë dhe jo sikur ka ndodhur në disa raste të praktikës gjyqësore që është rrëzuar kërkesa për sigurim padie.

Në rastin e ngritjes së padisë civile në procesin penal, gjykata kompetente për sigurimin e padisë së kërkuar njëkohësisht, ose pas ngritjes së padisë së themelit është gjykata penale kompetente për gjykimin e një vepre penale. Ndërkohë që nëse kërkesa për sigurimin e padisë do të ngrihej përpara se të ngrihej padia civile në procesin penal, atëherë zbatohen të njëjtat rregulla për përcaktimin e kompetencës të parashikuara në nenin 204 të KPrC.

Sigurimi i padisë lejohet edhe nga gjykata e apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj. Në këtë rast kompetente do të ishte gjykata e apelit, e cila është kompetente për shqyrtimin e ankimit kundër vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë.

Në praktikën gjyqësore shqiptare ndeshim raste kur megjithëse është dhënë një vendim përfundimtar, ndaj të cilit është ushtruar ankim në gjykatën e apelit, kërkesa për sigurim padie i paraqitet gjykatës së shkallës së parë. Gjykojmë se në një rast të tillë vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kërkesën për sigurim padie nuk duhet të jetë rrëzimi i kërkesës, sikurse e ndeshim në disa raste, pavarësisht se kjo nuk ia mohon të drejtën kërkuarit ta ngrejë sërish në gjykatën kompetente kërkesën për sigurimin e padisë, por shpallja e moskompetencës dhe dërgimi i akteve gjykatës kompetente, gjykatës së apelit që po shqyrton ankimin kundër vendimit përfundimtar.

Përcaktimi se masat për sigurimin e padisë mund të merren derisa vendimi të marrë formë të prerë dhe duke pasur parasysh që sipas nenit 451 të KPrC, vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij; b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar; ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë, lë qartazi të kuptohet se nuk lejohet ngritja e kërkesës për sigurim padie në Gjykatën e Lartë.

Referuar Ligjit “Për të drejtën ndërkombëtare private” gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të marrë masa sigurimi jo vetëm kur ato kanë juridiksion për të gjykuar themelin e padive për mosmarrëveshje me elemente të huaj, por edhe në rastin kur ato nuk kanë juridiksion për gjykimin e themelit, me kushtin që masa e sigurimit të ekzekutohet në Shqipëri. Në kushtet kur ligji nuk shprehet për mënyrën e përcaktimit të gjykatës kompetente në një rast të tillë, çojmë se ajo do të ishte gjykata e vendit ku do të kryhet ekzekutimi i vendimit për sigurimin e padisë.

Ndonëse neni 418 i KPrC, i cili rregullon masat e sigurimit të padisë në arbitrazhin e brendshëm nuk e parashikon shprehimisht dhe në Shqipëri ende nuk ka një ligj të posaçëm që rregullon arbitrazhin ndërkombëtar, gjykatat shqiptare kanë të drejtë të marrin masa sigurimi edhe në rastet kur gjykimi i themelit të mosmarrëveshjes është në juridiksionin e arbitrazhit, qoftë ky vendor, apo ndërkombëtar me vend arbitrazhi në Shqipëri apo dhe jashtë saj.

Për të arritur qëllimin e tyre, masat e sigurimit të padisë i nënshtrohen një procedure që karakterizohet nga urgjenca, e cila justifikon përjashtimisht edhe cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe nuk lejon shqyrtimin e themelit të padisë. Në përgjigje të këtij karakteri urgjent, Kodi i Procedurës Civile ka parashikuar për mundësinë e ngritjes së kërkesës për sigurim padie edhe para ngritjes së padisë së themelit (*ante causam*). Megjithëse neni 204 i KPrC, i cili parashikon se sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia, duket se nuk kërkon plotësimin e ndonjë kushti në mënyrë që të pranohet gjykimi i kërkesës për sigurimin e padisë përpara ngritjes së padisë së themelit, duket se në disa raste, ndonëse në minorancë, gjykatat e kanë interpretuar këtë dispozitë ngushtësisht, duke lejuar masën e sigurimit *ante causam*, vetëm në kushtet kur kërkuari provon se është në pamundësi objektive për hartimin e kërkesëpadisë sipas neneve 31, 32, 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe i provon gjykatës emergjencën imediate për marrjen e kësaj mase përpara paraqitjes së padisë në gjykatë. Gjykojmë se një interpretim i tillë i ngushtë i kësaj dispozite nuk është në përputhje me funksionin e masave të sigurimit të padisë dhe nuk besojmë se ka qenë në qëllimin e legjislatorit.

Referuar nenit 158/a të KPrC, në funksion të shpejtësisë së gjykimit, masa për sigurimin e padisë mund të merret edhe në seancë përgatitore. Pavarësisht, qartësisë së kësaj dispozite, në praktikën gjyqësore ndeshim raste kur gjykata shtyn dhënien e vendimit për masën e sigurimit në seancë gjyqësore, duke argumentuar se nuk mund të japë një vendim të tillë në seancë përgatitore. Për fat të keq praktika na ofron edhe raste kur gjykata ka shtyrë dhënien e vendimit mbi kërkesën për sigurim padie deri në dhënien e vendimit përfundimtar, duke ia humbur në këtë mënyrë tërësisht qëllimin masës së sigurimit, si një masë e karakterit urgjent.

Marrja e vendimit për të zhvilluar një proces *inaudita altera parte* është një çështje shumë delikate, që nuk ka përcaktime precize. Kriteri më i drejtë për një vendimmarrje të tillë do të ishte balancimi i dy interesave të kundërt: e drejta e mbrojtjes së të paditurit dhe rreziku që edhe një vonesë shumë e vogël apo dhe thjesht njoftimi për zhvillimin e procesit mbi sigurimin e padisë mund të sjellin pasoja të tilla sa mund të dëmtojnë përgjithmonë të drejtën objekt konflikti. Mosrespektimi i parimit të kontradiktoritetit justifikohet në ato raste kur mund të dëmtohet ekzekutimi i masës së sigurimit; nga njëra anë në ato raste kur urgjenca për të vepruar është e tillë sa të mos lejojë as vonesën më minimale për njoftimin e palës tjetër, nga ana tjetër në ato raste kur njoftimi i palës tjetër do t'i jepte asaj mundësi t'i shmangej efekteve të vetë masës së sigurimit.

Në mungesë të përcaktimeve ligjore lidhur me veprimtarinë procedurale të gjykatës gjatë shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë, doktrina dhe praktika gjyqësore kanë vendosur disa standarde veçanërisht lidhur me raportin me themelin e padisë. Konkretisht, është mbajtur qëndrimi se urgjenca e rastit nuk lejon që të shqyrtohet themeli i pretendimeve, por gjykata në këtë rast bën vetëm një shqyrtim të sipërfaqshëm (*summaria cognito*).

Në asnjë nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë masat e sigurimit të padisë në procesin civil nuk ndeshim ndonjë përcaktim në lidhje me mundësinë e ndërhyrjes së personave të tretë në gjykimin e kërkesës për sigurim padie. Në fakt në zbatim të rregullave të përgjithshme të KPrC, duket se nuk ka asnjë pengesë për personin e tretë që mund t'i cenohen interesat nga masa e sigurimit të realizojë ndërhyrjen.

Shkaqet për të cilat mund të rrëzohet kërkesa për sigurimin e padisë mund të jenë të ndryshme, përmendim këtu si shkaqe procedurale, p.sh. për mungesë të legjitimitetit (*legitimitatio ad processum*), ashtu dhe shkaqe të mosplotësimin të kushteve për dhënien e masave të sigurimit, si p.sh. nuk provohet *periculum in mora*, apo *fumus boni juris etj.*

Megjithëse KPrC nuk e ka rregulluar shprehimisht, në rast se kërkesa për sigurimin e padisë rrëzohet me vendim të gjykatës, gjykojmë se nëse verifikohen ndryshime të rrethanave ku përfshihen jo vetëm ndodhja e fakteve të reja krijuese të të drejtës apo të *periculum in mora*, por edhe përdorimi i provave të reja (që sidoqoftë bie brenda konceptit të argumenteve të reja të faktit), ose në argumente të reja të faktit ose ligjit, d.m.th. mbi fakte që nuk kanë ndodhur, ose argumente juridikë që nuk janë përdorur nga palët dhe gjykata gjatë gjykimit të parë, kërkesa për masë sigurimi mund të ringrihet. Theksojmë se ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative” e ka plotësuar këtë

mangësi të KPrC duke parashikuar shprehimisht të drejtën për ringritjen e kërkesës për sigurim padie kur ka ndryshime të rrethanave. Sugjerohet që një parashikim i tillë të bëhet edhe në dispozitat e KPrC.

Kur kërkesa për sigurimin e padisë ngrihet *ante causam* gjykata me vendimin e pranimit të kësaj kërkesë cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet në gjykatë padia e themelit. Mos paraqitja e padisë së themelit brenda afatit të përcaktuar me vendim sjell si pasojë rënien e masës së sigurimit. Dhënia e masave të sigurimit *ante causam*, pa u kushtëzuar me një afat për ngritjen e padisë jo vetëm që bie ndesh me karakterin e masave të sigurimit, por mund edhe të cenonte rëndë të drejtat e palës kundër të cilës merret masa e sigurimit. Në rast se gjykata nuk do të përcaktonte një afat të tillë në dispozitivin e vendimit të saj për pranimin e masës së sigurimit të ngritur *ante causam*, gjykojmë se në çdo rast padia e themelit duhet të ngrihet brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga shpallja e vendimit, në të kundërt masa e sigurimit e dhënë *ante causam* do të binte nga fuqia. E njëjtë do të ishte situata edhe kur gjykata cakton një afat më të gjatë se pesëmbëdhjetë ditë për ngritjen e padisë së themelit. Masa e sigurimit e dhënë *ante causam* do të kishte fuqi vetëm pesëmbëdhjetë ditë, nëse padia e themelit nuk do të ngrihej brenda këtij afati. Dispozita e KPrC që parashikon afatin maksimal prej pesëmbëdhjetë ditësh për ngritjen e padisë së themelit është një normë e detyrueshme, mosrespektimi i së cilës pasohet me shuarjen e masës së sigurimit.

Megjithatë në disa raste, p.sh. kur cenohet rëndë interesi publik, në varësi të rrethanave dhe llojit të masës së dhënë është e domosdoshme moskushtëzimi i efekteve të masave të dhëna *ante causam* me ngritjen e padisë së themelit brenda një afati të caktuar. Në këto kushte sugjerohet që neni 211 i KPrC të rregullojë shprehimisht situatën, duke vendosur përjashtime nga rregulli i përgjithshëm i parashikuar në këtë nen, për masat e përkohshme të sigurimit të padisë që synojnë “*ta mbajnë gjendjen ashtu siç është*”, apo “*të ngrirë*”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, që është një nga llojet e masave të sigurimit që mund të jepen në bazë të nenit 206 të KPrC, sikurse është interpretuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Rënia e masës së sigurimit të padisë, në rastin e mosparaqitjes së padisë së themelit në gjykatë, brenda afatit të caktuar nga gjykata, bëhet *ipso jure* dhe nuk ka nevojë që gjykata të shprehet rishtazi për të.

Masa e sigurimit bie edhe në rastin kur vendoset rrëzimi i padisë ose pushimi i gjykimit të saj, ku gjykata së bashku me vendimin përfundimtar shprehet edhe për heqjen e masës së sigurimit të padisë, e cila në ndryshim nga rasti kur masa bie nga fuqia për shkak të mos ngritjes së padisë në afatin e caktuar nga gjykata vazhdon të jetë në fuqi derisa vendimi mbi themelin apo ai i pushimit të gjykimit të marrin formë të prerë, pavarësisht se është hequr me vendimin e rrëzimit të padisë apo pushimit të gjykimit.

Në analogji me rastin e masave të dhëna *ante causam*, masa e dhënë nga një gjykatë shqiptare që nxjerr çështjen e themelit jashtë juridiksionit, duhet të bjerë *ipso jure*, pa qenë nevoja që gjykata të shprehet për të, nëse brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga shpallja e vendimit të Gjykatës së Lartë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit nuk ngrihet padia e themelit në juridiksionin përkatës. Në çdo rast pala e interesuar

pas shpalljes së vendimit për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit mund t'i drejtohet gjykatës që ka dhënë masën e sigurimit me kërkesë për konstatimin e rënies saj në kushtet kur nuk është investuar juridiksioni përkatës me padinë e themelit.

Sekuestroja është e vetmja masë sigurimi që parashikohet shprehimisht nga KPrC dhe është lloji më i zakonshëm i masës së sigurimit që kanë dhënë gjykatat shqiptare. Kur flet për llojet e tjera të masave të sigurimit, KPrC përdor termin masa të tjetra të përshtatshme që vlerësohen nga gjykata. Disa nga llojet e masave të tjera të përshtatshme të dhëna në bazë të nenit 206 (b) të KPrC, që ndeshim në praktikën gjyqësore shqiptare janë pezullimi i vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të një shoqate, mosprishje e banesës, ndalim i shitjes së kuotave të ortakëve të një shoqërie tregtare dhe pezullimi i mbledhjes së asamblesë së saj, ndalimi i kryerjes së veprimeve për regjistrimin përfundimtar të një pasurie të paluajtshme, pezullim i depozitimit në Regjistrin Tregtar të vendimeve të një shoqërie tregtare, pezullim i punimeve mbi pronën objekt gjykimi, etj.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë interpretuar se si masë e përshtatshme është dhe marrja e masave të përkohshme të sigurimit të padisë synon “*ta mbajë gjendjen ashtu siç është*”, apo “*të ngrirë*”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit dhe se masa e përkohshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk mund të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërimit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë, si për shembull rilidhja e kontratës, e cila përjashtimisht do të konsiderohej e ligjshme e do të përfshihej në masat e tjera të përshtatshme të sigurimit të padisë, në qoftë se do të parashikohej në mënyrë taksative në ligj dhe/ose do të rezultonte nga vetë natyra e marrëdhënies juridike (e kontratës së lidhur midis palëve). Të tilla janë p.sh: disa kontrata furnizimi me lëndë të parë apo energji, të ndërvarura nga njëra-tjetra, që sigurojnë funksionimin e vazhdueshëm e të pandërprerë të një veprimtarie industriale, të një procesi teknologjik të caktuar, të një veprimtarie të vendosur për mbrojtjen e jetës e të shëndetit të njerëzve, etj, ndërprerja e të cilave do të shkaktonte dëme të pallogaritshme e të pariparueshme, shkatërrime të mëdha apo katastrofa.

Vendosja e masës së sigurimit nuk nënkupton se ajo nuk mund të ndryshohet, apo të hiqet më pas. Gjykata me kërkesën e njëres nga palët mund të zëvendësojë një masë sigurimi me një tjetër, pasi më parë të ketë dëgjuar edhe palën kundërshtare. Revokimi (apo dhe ndryshimi) i masës së sigurimit nënkupton ekzistencën e një fakti të ri, të cilin nëse gjyqtari do ta kishte ditur në kohën e dhënies së masës së sigurimit, do të kishte dhënë një masë të ndryshme nga ajo që ka dhënë. Ai që kërkon revokimin (ndryshimin) e masës së sigurimit nuk pretendon një gabim të gjyqtarit në momentin e dhënies së masës së sigurimit, por pretendon një masë të ndryshme në varësi të rrethanave të mëvonshme. Kodi i Procedurës Civile hesht lidhur me shkaqet për të cilat mund të lejohet ndryshimi i masës së sigurimit. Lidhur me termin “ndryshime të rrethanave” që përbëjnë shkak për ndryshimin apo revokimin e masës së sigurimit, nuk gjejmë ndonjë shpjegim nga dispozitat ligjore, por doktrina e ka elaboruar atë duke përcaktuar se me të mund të nënkuptohet çdo lloj prove e re, e cila nuk është paraqitur në procesin e marrjes së masës së sigurimit, ashtu sikurse mund të nënkuptohet çdo fakt i ri i dalë gjatë gjykimit të themelit që sjell elementë të rinj në vlerësimin e mundësisë së ekzistencës së të drejtës, apo të *periculum in mora* për të drejtën për të cilën është marrë masa e sigurimit.



Në kushtet kur KPrC nuk ka parashikuar shkaqet për të cilat lejohet revokimi apo ndryshimi i masave të sigurimit të padisë, rekomandohet që neni 207 i tij të plotësohet duke parashikuar shprehimisht për ndryshimin e rrethanave si një kusht të tillë, sikurse ka parashikuar ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.”

Nëse masa e sigurimit të padisë është dhënë gjatë gjykimit të padisë së themelit, është e kuptueshme që nëse ka ndryshim të rrethanave, ajo gjykatë që e ka dhënë atë masë dhe që është duke gjykuar themelin e padisë do të jetë kompetente për të vendosur edhe lidhur me kërkesën për revokimin apo ndryshimin e masës së sigurimit. Ndërsa në rastin kur masa e sigurimit është marrë *ante causam*, gjykojmë se kompetente do të jetë gjykata që gjykon themelin e padisë. Gjykata që e ka dhënë masën e sigurimit *ante causam* do të ishte kompetente për të revokuar apo ndryshuar masën e sigurimit, vetëm nëse në momentin kur kërkohet revokimi i masës së sigurimit të dhënë *ante causam* padia e themelit nuk është ngritur ende.

Nëse një masë sigurimi është dhënë nga një gjykatë shqiptare, ndërkohë që themeli i padisë është duke u gjykuar në një gjykatë të huaj, gjykata shqiptare do të ketë juridiksion edhe për ndryshimin apo revokimin e masës së dhënë.

Në rastin kur kundër masës së sigurimit të padisë të marrë nga gjykata e shkallës së parë është bërë ankimi në gjykatën e apel, masa e sigurimit e lënë në fuqi nga gjykata e apelit, apo e ndryshuar prej saj mund të revokohet.

Ankimi kundër masës së sigurimit nënkupton kundërshtimin për shkak të një gabimi në vlerësimin e të drejtës ose faktit nga ana e gjykatës, p.sh. sekuestro e vendosur mbi sende që nuk mund të sekuestrohen, apo vlerësimi i gabuar i rrezikut nga vonesa, apo i mundësisë së ekzistencës së të drejtës.

Neni 209 i KPrC ka parashikuar shprehimisht se kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankimi i veçantë. Në këtë dispozitë nuk ka një përcaktim të shprehur për ankimin kundër vendimit që rrëzon kërkesën për sigurimin e padisë. Vendimi i ndërmjetëm i gjykatës, për rrëzimin e marrjes së masës së sigurimit të padisë, duke mos u parashikuar shprehimisht në ligj e drejta e ankimit të veçantë të tij, mund të ankimohet vetëm së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar që i jep fund shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Praktika e gjykatave shqiptare është e paunifikuar në drejtim të lejimit apo jo të ankimit të veçantë kundër vendimit të rrëzimit të kërkesës për masë sigurimi.

Një parashikim të ngjashëm me nenin 209 ka pasur dhe KPrC italian, dispozita përkatëse e të cilit u shfuqizua me vendim të Gjykatës Kushtetuese, e cila arsyetoi se duke pasur parasysh parimet që duhet domosdoshmërisht të karakterizojnë procesin civil, atë të barazisë së plotë të palëve përpara gjykatës dhe barazisë së armëve mes palëve, mungesa e ankimit kundër vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie për palën që ka kërkuar pa sukses një masë sigurimi, ankimi i cili është dhënë vetëm në rastin e pranimit të një kërkesë të tillë, përbën një shkelje të të drejtës për tu mbrojtur, për aq sa i jepet më shumë mundësi për të mbrojtur pozicionin e saj palës që është kundër masës së sigurimit, sesa asaj që e kërkon marrjen e asaj mase, dhe kjo pa

asnjë lloj justifikimi, duke pasur parasysh pozitën simetrikisht të barabartë të palëve në sistemin procedural.

Referuar këtij arsytimi të Gjykatës Kushtetuese italiane dhe me qëllim eliminimin e praktikës së ndryshme që ekziston mes gjykatave shqiptare, e cila është e pajustificuar në kushtet aktuale që ka parashikimi i Kodit të Procedurës Civile dhe në mungesë të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që deklaronte antikushtetutshmërinë e nenit 209, për pjesën që nuk parashikon ankim ndaj vendimit të rrëzimit, rekomandojmë që legjislatori të ndryshojë nenin 209 të KPrC në mënyrë që të garantohet e drejta e ankimit të veçantë edhe kundër vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie.

Gjykata e Apelit që shqyrton ankimin kundër një vendimi për masë sigurimi, mund të marrë po ato vendime që merr në rastin e shqyrtimit të ankimit kundër një vendimi themeli, të parashikuara në nenin 466 të KPrC. Prishja e vendimit dhe pushimi i gjykimit mund të vendoset në rastin kur është bërë ankim ndaj një vendimi për masë sigurimi të dhënë *ante causam*, dhe nuk është ngritur padia e themelit brenda afatit të caktuar nga gjykata, i cili në çdo rast është jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë. Ndërkohë përse i përket vendimit për kthimin e çështjes për rigjykim, gjykojmë se në rastin e ankimit kundër një vendimi për masë sigurimi neni 467 i KPrC që parashikon shkaqet për të cilat çështja mund të kthehet për rigjykim nuk mund të aplikohet në mënyrë strikte. Kjo për shkak se gjykimi i kërkesave për masë sigurimi ka disa veçori në raport me gjykimin e themelit. Për shembull nëse referuar pikës ç) të nenit 467 të KPrC e cila parashikon si shkak për kthimin e çështjes për rigjykim rastin kur çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për ditën e gjykimit, gjykata e apelit do të vendoste kthimin e çështjes për rigjykim kur shqyrton ankimin ndaj një vendimi përfundimtar, ajo nuk mund të vendosë në këtë mënyrë kur shqyrton ankimin ndaj një vendimi për masë sigurimi, i cili referuar nenit 205 të KPrC në raste të veçanta ose ngutshme mund të merret edhe pa u dëgjuar pala tjetër

Ndonëse neni 451 i KPrC parashikon se vendimi merr formë të prerë kur është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë, një vendim për masë sigurimi nuk merr formë të prerë, madje edhe pse ndaj tij mund të jetë ushtruar ankim, ai mund të ndryshohet ose revokohet.

Për sa kohë që nuk ka një ndalim të shprehur në ligj, kundër vendimit të gjykatës së apelit për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndryshimit të vendimit, prishjes së vendimit dhe pushimit e çështjes, prishjes së vendimit dhe dërgimit të çështjes për rigjykim lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Vendimet e gjykatës për dhënien e një mase sigurimi përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përmbarimit, pas njoftimit të vendimit pa u lëshuar urdhër ekzekutivi.

#### ➤ *Mbi masat e sigurimit në procesin e arbitrazhit*

Për shumë vite në shumë juridiksione, gjykatat e arbitrazhit nuk kanë pasur kompetencë për të marrë masa të përkohshme apo sigurimi. Aktualisht, shumica e legjislacioneve moderne parashikojnë shprehimisht kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi. Pavarësisht se kompetenca e arbitrave për marrjen e masave të sigurimit është njohur gjerësisht nga legjislacionet kombëtare,

mes tyre ka diferenca lidhur me mënyrën e ushtrimit të një kompetence të tillë. Së pari, janë ato ligje arbitrazhi ku ligji shprehimisht ua jep të drejtën arbitrave që të vendosin masa sigurimi, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe. Në këtë grup hyn dhe Shqipëria. Së dyti, janë ato ligje arbitrazhi, të cilat u japin arbitrave të drejtën të japin disa lloj masash sigurimi, ndërsa për disa lloje të tjera masash kërkon marrëveshje të shprehur mes palëve. Së treti, janë ato ligje që nuk parashikojnë shprehimisht mundësinë e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi.

Aktualisht në Shqipëri nuk është miratuar ende një ligj që rregullon arbitrazhin ndërkombëtar. Në këto kushte a mundet një gjykatë arbitrazhi në një proces arbitrazhi ndërkombëtar me vend arbitrazhi Shqipërinë të marrë masa për sigurimin e padisë? Pavarësisht se mungon një ligj i mirëfilltë për arbitrazhin ndërkombëtar, dhe Konventat ndërkombëtare të cilat ka ratifikuar Shqipëria nuk parashikojnë shprehimisht të drejtën e arbitrave për të marrë masa sigurimi në arbitrazhin ndërkombëtar, njësoj si Shtetet e Bashkuara, Franca, Belgjika edhe praktika e arbitrazhit shqiptar duhet ta njohë të drejtën e arbitrave për të marrë masa të tilla, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe me marrëveshje. Gëzimi i kësaj të drejte duhet të konsiderohet në përmbushje të misionit që kanë arbitrat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve në një mënyrë të drejtë, të arsyeshme dhe të përshtatshme.

Kompetenca e arbitrave për të dhënë masa sigurimi përveçse përcaktohet nga ligji, varet gjithashtu edhe nga përcaktimet e palëve në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit. Palët mund të autorizojnë shprehimisht gjykatën e arbitrazhit të marrë masa sigurimi, ose mund ta bëjnë këtë në mënyrë të nënkuptuar duke zgjedhur rregulla arbitrazhi, të cilat e lejojnë gjykatën e arbitrazhit të marrë masa sigurimi. Dhe në fakt shumica Rregulloreve të Arbitrazhit të Institucioneve më të rëndësishme të arbitrazhit përmbajnë rregulla për dhënien e masave të sigurimit të padisë. Pjesa më e madhe e tyre parashikojnë shprehimisht kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi.

Kompetenca për të marrë masa sigurimi zakonisht klasifikohet si çështje procedure dhe për rrjedhojë rregullohet kryesisht nga ligji që rregullon procesin e arbitrazhit, që zakonisht është ligji i vendit të arbitrazhit.

Në rast se ligji i vendit të arbitrazhit, pra *lex arbitri*, e ndalon gjykatën e arbitrazhit të marrë masa sigurimi, ndërkohë që palët në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit ia kanë njohur asaj një kompetencë të tillë konsiderohet se gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masa sigurimi, pavarësisht se palët mund t'ia kenë njohur shprehimisht këtë të drejtë gjykatës së arbitrazhit. Interpretimi i kundërt se gjykata e arbitrazhit mund të marrë masa sigurimi edhe në këtë rast, pasi ligji i vendit të arbitrazhit që ia ndalon asaj një kompetencë të tillë duhet të konsiderohet se bie në kundërshtim me nenin 2 të Konventës së New York-ut, i cili duhet të interpretohet se në mënyrë të nënkuptuar i kërkon Shteteve Kontraktuese të njohin marrëveshjet e arbitrazhit që i japin arbitrave kompetencën për të marrë masa sigurimi, do të ishte shumë i rrallë të zbatohet në praktikë.

Kur palët kanë rënë dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh në një juridiksion që ia ndalon arbitrave kompetencën për të marrë masa sigurimi dhe nuk ia kanë njohur shprehimisht arbitrave një kompetencë të tillë në marrëveshjen e tyre,

gjkata e arbitrazhit nuk do të ketë kompetencë për të marrë masa sigurimi, sepse kjo zgjedhje e vendit të arbitrazhit zakonisht interpretohet si përjashtim i kësaj kompetence.

Kur ligji i arbitrazhit dhe Rregullat e Institucionit të arbitrazhit as nuk ia njohin shprehimisht të drejtën gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi dhe as nuk ia ndalojnë asaj një kompetencë të tillë, do të prezumohet se gjykata e arbitrazhit është kompetente për të marrë masa sigurimi.

E drejta e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi ka disa kufizime. Gjykata e arbitrazhit nuk ka kompetencë të marrë masa sigurimi kundër palëve të treta, që nuk janë palë në procesin e arbitrazhit. Asaj i mungon forca për të ekzekutuar drejtpërdrejt masat e sigurimit të dhëna prej saj. Ndonjëherë *lex arbitri* kufizon kompetencën e gjykatës për të dhënë masa sigurimi vetëm lidhur me objektin e mosmarrëveshjes. Gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masa sigurimi derisa të formohet. Shumë legjislacione dhe rregullore arbitrazhi parashikojnë se gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë masa sigurimi *ex parte*. Disa masa sigurimi janë në kompetencë ekskluzive të gjykatave shtetërore dhe gjykatat e arbitrazhit nuk kanë kompetencë për të dhënë masa të tilla.

Për të kompensuar një nga kufizimet e kompetencës së gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi përpara formimit të saj shumë rregullore arbitrazhi parashikojnë për mekanizma të tillë si arbitri i urgjencës, apo formimi i përsheptuar i gjykatës së arbitrazhit. Arbitri i urgjencës caktohet vetëm me qëllimin për të vendosur lidhur me kërkesën për sigurimin e padisë, vendim i cili është subjekt rishikimi nga gjykata e arbitrazhit pas formimit të saj. Dispozitat e Arbitrit të Urgjencës nuk i heqin të drejtën palës së interesuar që t'i drejtohet autoritetit gjyqësor kompetent për të marrë masa sigurimi. Një nga problemet më të mëdha lidhur me arbitrin e urgjencës është ekzekutueshmëria e vendimeve të tij.

Shumica e ligjeve apo rregulloreve të arbitrazhit parashikojnë shprehimisht vendosjen e masës së sigurimit nga gjykata e arbitrazhit vetëm me kërkesë të palës. Megjithatë ka edhe shembuj të rregulloreve të arbitrazhit të disa institucioneve që u japin kompetencë arbitrave të japin masa sigurimi me nismën e tyre (*sua sponte*). Nëse rregulloret e arbitrazhit nuk e rregullojnë shprehimisht çështjen se kush mund të iniciojë një procedurë për dhënien e masave të sigurimit gjykata e arbitrazhit nuk duhet të japë masa sigurimi *sua sponte*.

Përcaktimi i ligjit të aplikueshëm lidhur me standardet për marrjen e masave të sigurimit është një çështje shumë komplekse, ndaj në praktikën e arbitrazhit ndërkombëtar shumica e vendimeve të gjykatave shtetërore dhe të arbitrazhit nuk ndalen në përcaktimin e ligjit të aplikueshëm për standardet e dhënies së masave të sigurimit, por bazohen në standarde ndërkombëtare.

Ekzaminimi i ligjeve dhe rregullave të arbitrazhit, praktikës dhe doktrinës tregon se kriteret për dhënien e masave të sigurimit, janë pozitive dhe negative:

Kriteret pozitive janë:

- i. juridiksioni *prima facie* i gjykatës së arbitrazhit;
- ii. sukcesi *prima facie* mbi themelin e padisë;
- iii. urgjenca;

- iv. dëmi serioz dhe i pariparueshëm;
- v. proporcionaliteti, apo balanca e interesave.

Kriteret negative janë:

- i. Shqyrtimi i kërkesës për sigurim padie nuk duhet të kërkojë shqyrtimin e themelit të padisë (mosparagjykimi i themelit të çështjes);
- ii. Gjykata e arbitrazhit nuk mund të japë si masë sigurimi atë që kërkohet me padinë e themelit;
- iii. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur pala kërkuese nuk i ka “duart e pastra” (vepron në keqbesim);
- iv. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa nuk mund të zbatohet;
- v. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa e kërkuar nuk mund të parandalojë dëmin e pretenduar;
- vi. Kërkesa për masë sigurimi mund të refuzohet kur masa që kërkohet nuk ka më vlerë.

Gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë dhënien e një garancie për dëmet që mund të shkaktohen si rezultat i vendosjes së masës së sigurimit padrejtësisht, pavarësisht nëse *lex arbitri* apo rregullorja e arbitrazhit nuk e parashikojnë shprehimisht diçka të tillë, sepse e drejta e arbitrit për të dhënë masa siguroese përfshin edhe të drejtën e tij për të kërkuar dhënien e një garancie.

Në rast se rezultojnë që dhënia e masës së sigurimit ishte e pabazuar, pala kundër të cilës ishte dhënë një masë e tillë ka të drejtë të kërkojë të dëmshpërblehet për dëmin që mund t'i jetë shkaktuar nga ajo masë. Ky dëmshpërblim merret nga garancia e vënë për këtë qëllim. Dëmshpërblimi mund të jepet vetëm me kërkesë së palës që pretendon se është dëmtuar nga masa siguroese dhe po mbi këtë palë rëndon edhe barra e provës. Gjykata e arbitrazhit ka kompetencë për të vendosur lidhur me kërkesën për dëmshpërblim si rezultat i vendosjes së një mase sigurimi të padrejtë. Kjo kompetencë parashikohet shprehimisht nga shumica e rregulloreve të arbitrazhit, megjithatë edhe kur nuk parashikohet prezumohet se ajo buron nga interpretimi i gjerë i marrëveshjes së arbitrazhit, ose mund të nënkuptohet nga kompetenca për të dhënë masë sigurimi, si aksesore e saj.

Masat e sigurimit që jepen nga gjykata e arbitrazhit mund të jenë në formën e urdhrit ose vendimit. Disa legjislacione dhe rregullore arbitrazhi i japin të drejtën gjykatës së arbitrazhit të japë masa në formën e urdhrit, disa të tjerë në formën e vendimit dhe të tjerë ia lënë gjykatës së arbitrazhit të zgjedhë mes formës së urdhrit apo vendimit. Ndërkohë krahas këtyre dy formave kryesore ndeshen edhe forma të tjera si p.sh. propozim apo rekomandim, të cilat janë interpretuar se kanë të njëjtën fuqi si një urdhër apo vendim. Zakonisht gjykata e arbitrazhit ka diskrecion për të vendosur lidhur me formën në të cilën do e japë masën e sigurimit. Gjykata e arbitrazhit në ushtrimin e diskrecionit të saj lidhur me formën në të cilën do e japë masën e sigurimit duhet të udhëhiqet nga objektivi për të arritur qëllimin e masës së sigurimit. Gjithashtu ajo duhet të udhëhiqet nga mundësia për të kursyer kohë dhe para për palët, për të zhvilluar një proces efektiv dhe eficient dhe nevoja për të siguruar që vendimi do të jetë i ekzekutueshëm. Rëndësi i duhet kushtuar edhe dëshirave të palëve dhe avantazheve apo disavantazheve të njëjës apo tjetrës formë. Në çdo rast, zgjedhja e formës së masës së sigurimit nga gjykata e arbitrazhit i nënshtrohet ligjit të aplikueshëm.

Vendimi i gjykatës shtetërore lidhur me masën e sigurimit nuk duhet të ketë efektin *res judicata* për rrjedhojë vendimi i saj nuk ka pse të jetë domosdoshmërisht i detyrueshëm për gjykatën e arbitrazhit para së cilës paraqitet kërkesa për një masë të njëjtë apo të ngjashme. Megjithatë, sigurisht që gjykata e arbitrazhit duhet ta marrë në konsideratë analizën e gjykatës shtetërore dhe ajo mund të arrijë në të njëjtin konkluzion si gjykata shtetërore, por kur gjykata e arbitrazhit çmon se është (ose nuk është) e nevojshme marrja e një mase e sigurimi, një vendim i kundërt i gjykatës shtetërore nuk duhet ta bëjë gjykatën e arbitrazhit që të ndryshojë qëndrimin e saj.

Përcaktimi i llojeve të masave të sigurimit që mund të marrë gjykata e arbitrazhit së pari varet nga vullneti i palëve (rregullorja e arbitrazhit që kanë zgjedhur) dhe së dyti nga *lex arbitri* i vendit të arbitrazhit. Shumica e legjislacioneve dhe rregulloreve të arbitrazhit nuk parashikojnë shprehimisht llojet e masave të sigurimit që mund të marrë gjykata e arbitrazhit. Pjesa më e madhe e tyre autorizojnë gjykatën e arbitrazhit të vendosë çdo lloj mase që ajo e konsideron të përshtatshme. Përdorimi i termit “çdo lloj” i jep gjykatës së arbitrazhit diskrecion të gjerë për të vendosur lidhur llojin e masës së përshtatshme, kuptohet brenda kufizimeve të vendosura nga *lex arbitri* i aplikueshëm.

Tërësia e llojeve të masave të sigurimit që mund të jepen nga një gjykatë arbitrazhi referuar kryesisht qëllimit të masave të sigurimit dhe doktrinës së arbitrazhit ndërkombëtar mund të grupohen në disa kategori:

1. Masa për sigurimin e provës;
2. Masa që synojnë të ruajnë *status quo*;
3. Masa që synojnë të garantojnë ekzekutimin e vendimit përfundimtar;
4. Masa për garantimin e kostove;
5. Masa për pagesa të përkohshme.
6. Masa që synojnë të urdhërojnë palët të mos kryejnë veprime që dëmtojnë procesin e arbitrazhit. (Masa anti-padi).

Në parim, në arbitrazhin vendor dhe ndërkombëtar, masat e sigurimit vendosen vetëm pasi t’iu jetë dhënë mundësia të dyja palëve për tu dëgjuar, por përjashtimisht parimi i drejtësisë e justifikon një përjashtim të tillë në rastet e një urgjence maksimale. Sidoqoftë në dhënien e këtyre masave arbitrat duhet të tregohen shumë të kujdesshëm dhe të analizojnë nëse përmbushen të gjitha kriteret që duhen për dhënien e masave të tjera të sigurimit. Veçanërisht duhet të jepen prova që justifikojnë dhënien e masës *ex parte* dhe gjykata e arbitrazhit duhet të arsyetojë në vendimin e saj shkaqet që çuan në dhënien e masës *ex parte*. Sugjerohet që masa të jepet në formën e urdhrit, të parashikojë që mund të ndryshohet apo revokohet me kërkesë të palës në seancën më të parë dëgjimore dhe të jepet kundrejt garancisë për shpërblim dëmi në rast se rezulton që masa nuk duhej të ishte dhënë. Ligji Model ka parashikuar shprehimisht mundësinë e dhënies së masave *ex parte*, por shumë pak legjislacione e kanë adoptuar këto dispozita. Theksojmë se projekt-ligji shqiptar mbi arbitrazhin ndërkombëtar është një nga këta shembuj.

Masat e sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit nuk janë të vetë-ekzekutueshme, sepse arbitrave u mungon autoriteti shtrëngues që kanë gjykatat shtetërore. Megjithatë edhe masat e sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit kanë një lloj peshe dhe shpesh janë ekzekutuar vullnetarisht. Por ka dhe mjaft raste kur ato nuk ekzekutohen vullnetarisht. Dhe në raste të tilla gjykata e arbitrazhit mund të vendosë sanksione për

moszbatimin e tyre. Disa nga sanksionet që mund të vijnë si rezultat i mos zbatimit të masës siguroese janë (i) nxjerrja e konkluzioneve të pafavorshme për palën që refuzon zbatimin dhe (ii) ngarkimi me përgjegjësi për dëmet dhe kostot si rezultat i moszbatimit të masës. Sidoqoftë sanksioni i parë është i mundshëm vetëm në rastin e moszbatimit të masave për sigurimin e provës dhe në asnjë rast tjetër.

Duke qenë që ekzekutueshmëria e masave të sigurimit është shumë e rëndësishme jo vetëm për të arritur qëllimin e tyre, por edhe për të garantuar efektivitetin e arbitrazhit në përgjithësi, ligjet kombëtare të shumë shteteve parashikojnë mundësinë e ekzekutimit të masave të sigurimit nëpërmjet juridiksionit gjyqësor.

Ligjet kombëtare që parashikojnë për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit nëpërmjet autoriteteve gjyqësore në vendin e arbitrazhit ndjekin dy përfaqje kryesore: (i) duke lejuar ekzekutimin e këtyre masave njësoj si vendimi përfundimtar i arbitrazhit dhe (ii) duke parashikuar për ndihmën e gjykatave shtetërore në ekzekutimin e tyre. Dispozitat e KPrC që rregullojnë arbitrazhin e brendshëm bëjnë pjesë në këtë kategori të dytë.

Masat e sigurimit të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit mund të ekzekutohen jashtë nëse ligji i vendit të ekzekutimit e lejon diçka të tillë. Shumica e legjislacioneve nuk e parashikojnë shprehimisht mundësinë e ekzekutimit të masave të sigurimit të huaja. Megjithëse Ligji Model i UNCITRAL, me ndryshimet e vitit 2006 ka parashikuar shprehimisht mundësinë e gjykatave shtetërore për të ekzekutuar vendime për masa të sigurimi të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit pavarësisht vendit se ku janë dhënë, të pakët janë legjislacionet që i kanë adoptuar këto ndryshime. Theksojmë se projekt-ligji shqiptar mbi arbitrazhin ndërkombëtar është një nga këta shembuj.

Nëse legjislacioni i brendshëm nuk parashikon dispozita mbi ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga arbitrat në një vend të huaj, atëherë e vetmja mundësi për ekzekutimin e këtyre masave mbeten marrëveshjet bilaterale apo multilaterale. Por në fakt ka shumë pak marrëveshje bilaterale që lejojnë ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna nga arbitrat dhe nuk ka asnjë marrëveshje multilaterale që të rregullojë këtë çështje. As Konventa e New Jorkut “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj” nuk parashikon shprehimisht mundësinë e zbatimit të saj për njohjen dhe ekzekutimin e masave të sigurimit të padisë.

Ky problem i ekzekutimit të masave të sigurimit të dhëna nga gjykata e arbitrazhit mund të zgjidhet nëse shumica e legjislacioneve kombëtare do të adoptonin dispozitat e Ligjit Model të UNCITRAL për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve për sigurim padie dhe/ose hartimi i një Protokolli të Konventës së New York që shtrin fushën e saj të zbatimit edhe për vendimet e sigurimit të padisë.

Shumica e legjislacioneve, rregulloreve të arbitrazhit, doktrina dhe praktika e pranojnë ekzistencën e juridiksionit konkurrues të gjykatës së arbitrazhit dhe asaj shtetërore në lidhje me masat e sigurimit, si thelbësor për efikasitetin e procesit të arbitrazhit. Ekzistenca e këtij juridiksioni konkurrues është përjashtim nga parimi i përgjithshëm i ekskluzivitetit të juridiksionit të arbitrazhit dhe mos ndërhyrjes së gjyqësorit në procesin e arbitrazhit. Qëllimi i njohjes së kompetencës gjykatës shtetërore për dhënien e masave të sigurimit nuk është të shkelë kompetencat procedurale të arbitrave, por t'i përforcojë ato dhe të bëjë më efektive vendimin

përfundimtar që do të marrë gjykata e arbitrazhit në fund të procesit, si dhe të jetë komplementar dhe ndihmës i arbitrazhit.

Konkluzion logjik i pranimit të juridiksionit konkurrues mes atij gjyqësor dhe të arbitrazhit për dhënien e masave të sigurimit është se kërkesa drejtuar gjykatës shtetërore për marrjen e një mase sigurimi është në përputhje me marrëveshjen e arbitrazhit. Kjo njihet si doktrina e përputhshmërisë, e cila reflekton dy parime: i) kërkesa nuk është heqje dorë nga marrëveshja e arbitrazhit; ii) dhe ekzistenca e marrëveshjes së arbitrazhit nuk pengon autoritetet gjyqësore të japin masa sigurimi. Nga ky parim i fundit rrjedh që pavarësisht bërjes së një kërkesë të tillë, themeli i padisë mbetet në juridiksionin ekskluziv të gjykatës së arbitrazhit.

Në Shqipëri, fillimisht praktika e gjykatave të rretheve gjyqësore të shkallës së parë, në mënyrë të gabuar, ka mbajtur qëndrimin se gjykatat nuk kanë kompetencë për të marrë masa sigurimi në lidhje me një proces arbitrazhi. Megjithatë duket se aktualisht praktika është e konsoliduar në qëndrimin se gjykatat shqiptare mund të marrin masa për sigurimin e padisë në lidhje me një proces arbitrazhi dhe kjo nuk konsiderohet në mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit.

Pjesa më e madhe e legjislacioneve dhe rregulloreve të ndryshme të arbitrazhit nuk e rregullojnë mënyrën e koordinimit mes këtyre dy juridiksioneve konkurruese duke i lënë liri zgjedhjeje palëve lidhur me autoritetin që ato duan të investojnë për marrjen e një mase sigurimi. Kjo mënyrë e rregullimit të juridiksionit konkurrues mes gjykatave të arbitrazhit dhe atyre shtetërore në dhënien e masave të sigurimit njihet mënyra e zgjedhjes së lirë. (*free choice model*) Ndërkohë që një pjesë e vogël legjislacionesh dhe rregulloresh arbitrazhi e kufizojnë mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës shtetërore vetëm në rast se ekzistojnë rrethana të përshtatshme. Sipas këtij modeli ndërhyrja e gjykatës shtetërore konsiderohet plotësuese përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit ndihmuese pas formimit të saj.

Modeli i zgjedhjes së lirë duhet të zbatohet me kujdes të madh për shkak të mundësisë për të abuzuar me të drejtën. Ndaj gjykatat e arbitrazhit duhet të identifikojnë rastet e mundshme të abuzimit dhe nuk duhet të pranojnë kërkesat në raste kur mungon urgjenca dhe kur qëllimi i tyre është vetëm të krijojnë një avantazh kundër të paditurit. Ndërhyrja e gjykatës duhet të pranohet vetëm në rastet kur ushtrimi i kompetencës së gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi është jo efektiv apo kur një kompetencë e tillë nuk ekziston fare. Edhe palët gjithashtu nuk duhet të abuzojnë me lirinë e zgjedhjes.

Modeli i dytë bazohet në parimin që favorizon arbitrat ndaj autoriteteve gjyqësore si forumi për të kërkuar masa sigurimi pas formimit të gjykatës së arbitrazhit. Ky parim referohet si parimi i prioritetit, në bazë të të cilit gjykatat shtetërore, pas formimit të gjykatës së arbitrazhit do të mund të marrin masa sigurimi vetëm në raste në përshtatshme apo përjashtimore. Përcaktimi i këtyre rrethanave zakonisht duhet të bëhet nga gjykatat e arbitrazhit, apo nga gjykatat shtetërore në përputhje me ligjin e tyre. Rrethana të përshtatshme që justifikojnë kërkesën drejtuar gjykatës shtetërore, pasi gjykata e arbitrazhit është formuar, mund të konsiderohen: i) rrethanat e urgjencës, të cilat duhet të konsiderohen së bashku me kërkesën e rrezikut të një dëmi të riparueshëm; ii) rastet e kufizimeve të kompetencës së gjykatave të arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi, p.sh. kur gjykata e arbitrazhit nuk mund të marrë një masë ndaj një personi të tretë, nuk mund të marrë llojin e masës së kërkuar, apo nuk ka



kompetencë për të marrë masa sigurimi; iii) rastet kur gjykata e arbitrazhit mund të jetë e paralizuar, për shembull, për shkak të dorëheqjes, përjashtimit apo vdekjes së një arbitri.

Palët, në përputhje me parimin e autonomisë së vullnetit, kanë plotësisht të drejtë të kufizojnë kompetencën e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masa sigurimi. Por nëse palët mundën apo jo të përjashtojnë kompetencën e gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi kjo nuk është aq e qartë. Në parim palët që dëshirojnë të përjashtojnë juridiksionin e gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi duhet të lejohen ta bëjnë diçka të tillë. Dëshira për një proces eficient, të centralizuar, konfidencial dhe neutral i bën palët që shpesh të përjashtojnë kompetencën e gjykatës për të marra masa sigurimi. Në mungesë të parashikimit shprehimisht të mundësisë së palëve për të përjashtuar juridiksionin gjyqësor në dhënien e masave të sigurimit, tendenca e shumicës së doktrinës është që ta njohin këtë përjashtim si të mundshëm. Ndërsa një pjesë tjetër e konsiderojnë marrëveshjen për përjashtimin e kompetencës së gjyqësorit për dhënien e masave të sigurimit si të pazbatueshme, veçanërisht në rastet kur nuk është e mundur marrja e një mase sigurimi nga gjykata e arbitrazhit.

Referimi i përgjithshëm që bëhet në marrëveshjen e arbitrazhit se mosmarrëveshjet do të zgjidhen me arbitrazh duke përjashtuar juridiksionin e çdo gjykate nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar juridiksionin gjyqësor lidhur me masat e sigurimit.

Për të shmangur interpretimet e ndryshme lidhur me qëllimin e palëve, rekomandohet që palët të parashikojnë në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit me terma të qartë përjashtimin e juridiksionit gjyqësor për dhënien e masave të sigurimit.

Në rastet ku pranohet juridiksioni konkurrues për dhënien e masave të sigurimit ekziston edhe mundësia e një konflikti pozitiv apo negativ juridiksioni. Jemi para rastit të konfliktit negativ të juridiksionit kur si arbitrat dhe gjykata shprehen se nuk kanë juridiksion për dhënien e masës së kërkuar. Ndërsa do të ishim para konfliktit pozitiv të juridiksionit kur si arbitrat dhe gjykata shprehen se kanë juridiksion për dhënien e një mase sigurimi. Në rast të një konflikti juridiksioni ai duhet të zgjidhet në favor të arbitrazhit, me përjashtim të rasteve kur gjykata e arbitrazhit nuk mund të veprojë në mënyrë efektive.

Gjykata shtetërore nuk duhet të ndërhyjë me ndryshimin apo revokimin e masës së dhënë nga gjykata e arbitrazhit, përveç kur gjykata e arbitrazhit nuk mund të veprojë në mënyrë efektive, ndërsa gjykata e arbitrazhit duhet të ketë mundësi të ndryshojë apo revokojë masën e dhënë nga gjykata shtetërore, sepse vendimi i gjykatës për masë sigurimi është i një natyre të përkohshme dhe nuk mund të pengojë gjykatën e arbitrazhit të ushtrojë juridiksionin e saj për të dhënë një tjetër masë.

Pothuajse gjithmonë gjykatat do të zbatojnë ligjin e tyre të brendshëm lidhur me mundësinë për të dhënë një mase dhe llojin e masës që mund të japin. Ato mund të japin vetëm masa që i parashikon legjislacioni i tyre i brendshëm. Megjithatë ashtu sikurse Ligji Model parashikon, disa gjykata kanë sugjeruar që lidhur me kërkesat për marrjen e masave të sigurimit duhet të zbatohen disa kritere të veçanta duke marrë parasysh karakteristikat specifike të arbitrazhit ndërkombëtar dhe mundësinë e gjykatës së arbitrazhit për t'i dhënë masat e kërkuara. Gjykata duhet të fokusohet në ruajtjen e integritetit të procesit të arbitrazhit.

Zakonisht gjykatat japin ndihmën e tyre lidhur me masat e sigurimit për proceset e arbitrazhit që zhvillohen në vendin ku ndodhet gjykata. Megjithatë shpesh herë prova të rëndësishme apo asetet e palëve mbi të cilat do të ekzekutohej vendimi përfundimtar i arbitrazhit nuk ndodhen në vendin e arbitrazhit, sepse sikurse është e mirënjohur tashmë, përgjithësisht vendi i arbitrazhit është një vend neutral dhe i përshtatshëm gjeografikisht për palët, por pa ndonjë lidhje me to apo me mosmarrëveshjen. Në këto kushte jo rrallë herë është e nevojshme që gjykatat shtetërore të ushtrojnë kompetencat e tyre për dhënien e masave të sigurimit në ndihmë të arbitrazhit të huaj.

Konventat ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit nuk kanë ndonjë parashikim specifik lidhur mundësinë e dhënies së ndihmës arbitrazhit të huaj nga gjykatat shtetërore. Shumica e legjislacioneve u njohin të drejtën gjykatave shtetërore për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit, por pa bërë ndonjë parashikim specifik nëse kjo kompetencë mund të ushtrohet pavarësisht vendit të arbitrazhit. Përfundimisht bën Ligji Model i UNCITRAL, i cili në nenin 17J qartazi parashikon për një mundësi të tillë.

Në Shqipëri, neni 400 i Kodit të Procedurës Civile parashikon qartazi se dispozitat e kodit që rregullojnë arbitrazhin zbatohen vetëm në arbitrazhin e brendshëm, duke përjashtuar kështu arbitrazhin ndërkombëtar, i cili sipas nenit 439 rregullohet me ligj të veçantë. Aktualisht ende nuk ka një ligj që të rregullojë arbitrazhin ndërkombëtar. Megjithatë Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Gjenevës, në bazë të nenit 6(4) të të cilës gjykatat shqiptare janë shprehur se kanë juridiksion në dhënien e masave të sigurimit në ndihmë të arbitrazhit të huaj. Gjithashtu Ligji Nr.10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, shprehimisht parashikon në nenin 81 se gjykatat shqiptare kanë juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimit.

Në rast se gjykatave shtetërore iu njihet juridiksioni për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit të huaj, pyetja që lind është a ka kufizime në lidhje me përcaktimin e gjykatës ku duhet të parashirohet një kërkesë e tillë? Në disa raste palët e përcaktojnë në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit gjykatën kompetente para të cilës mund të paraqitet një kërkesë për marrjen e masës së sigurimit. Një përzgjedhje e tillë e forumit gjyqësor interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjin për të drejtën ndërkombëtare private që është e zbatueshme për gjykatën që kanë zgjedhur palët me marrëveshje. Nëse i referohemi të drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë duket qartazi se në bazë të nenit 81 gjykatat shqiptare do të kishin juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimit.

Praktika e huaj ka treguar se në mënyrë që një gjykatë të shprehet mbi një kërkesë për masë sigurimi në ndihmë të arbitrazhit të huaj duhet që të paktën të ketë një lidhje ndërmjet çështjes në fjalë dhe gjykatës së zgjedhur.

Gjykatat shtetërore kur kanë kompetencën për të dhënë masa sigurimi në ndihmë të arbitrazhit të huaj duhet të tregojnë një kujdes të madh në ushtrimin e saj për shkak se rrezikon të ndërhyjë jo vetëm në juridiksionin e arbitrazhit, por edhe në juridiksionin gjyqësor të vendit të arbitrazhit.

Nëse një gjykatë shtetërore e vendit të arbitrazhit, apo e një shteti tjetër ka dhënë një masë sigurimi, mund të lindë nevoja që ajo masë të ekzekutohet jashtë. Ekzekutimi i masës së dhënë nga gjykata e huaj, duke qenë një vendim i gjykatës së huaj, kërkon fillimisht të kalojë procedurën e njohjes së këtij vendimi me qëllim që t'i jepet fuqi në shtetin ku kërkohet njohja. Përgjithësisht vendimi për sigurim padie është shumë e vështirë të ekzekutohet në një shtet të ndryshëm nga ai i gjykatës që e ka dhënë për shkak se shpesh ato nuk janë vendime me detyrime monetare dhe nuk kanë formën e prerë për qëllim të njohjes dhe ekzekutimit sipas shumë regjimeve kombëtare.

Mungesa e konventave ndërkombëtare që parashikojnë edhe mundësinë e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të huaja për masa sigurimi e bën edhe më të vështirë situatën. Theksojmë këtu se Konventa e Hagës “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare” e datës 1 Shkurt 1971 i përjashton shprehimisht nga fusha e saj e zbatimit vendimet për masa sigurimi.

Situata nuk është më e mirë as në vendet e Bashkimit Evropian. Konventa e Brukselit, tashmë Rregullorja 1215/2012 “Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”, megjithëse në bazë të nenit 35 e njuh kompetencën e gjykatave shtetërore të vendeve të BE të marrin masa sigurimi, edhe pse kompetente për gjykimin e themelit mund të jetë një gjykatë e një shteti tjetër anëtar, ose arbitrazhi, sikurse është konfirmuar me çështjen Van Uden, e kufizon efektin e këtyre masave vetëm në territorin e atij shteti anëtar. Në Preambulën e Rregullores paragrafi 33, përcaktohet qartë se kur masat e sigurimit janë të urdhëruar nga një gjykatë që ka juridiksion edhe për themelin e çështjes, qarkullimi i tyre i lirë duhet të jetë i garantuar sipas kësaj Rregulloreje. Kur masat e sigurimit janë të urdhëruara nga një gjykatë e një Shteti Anëtar që nuk ka juridiksion për themelin e çështjes, efekti i masave të tilla duhet të kufizohet, sipas kësaj Rregulloreje, në territorin e atij shteti anëtar. Pra, e thënë ndryshe një masë sigurimi e dhënë nga një gjykatë e një shteti anëtar në ndihmë të arbitrazhit të huaj mund të ekzekutohet vetëm në atë shtet ku është dhënë kjo masë dhe jo në shtetet e tjera anëtare të BE.

Në Shqipëri, ku arbitrazhi mund të quhet ende në hapat e tij të parë, së pari është nevojë imediate miratimi i ligjit që rregullon arbitrazhin ndërkombëtar, jo sepse mungesa e tij është pengesë për marrjen e masave të sigurimit të padisë qoftë nga gjykatat e arbitrazhit vendor apo ndërkombëtar, ashtu dhe gjykatat shtetërore në ndihmë të arbitrazhit, por mbi të gjitha, sepse do të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e efektivitetit dhe promovimin e arbitrazhit. Sidoqoftë hapa pozitivë janë ndërmarrë ndërkohë me hartimin e një projektligj për arbitrazhin ndërkombëtar bazuar në Ligjin Model të UNCITRAL, i cili njuh të drejtën e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi, juridiksionin konkurrent të gjykatave shtetërore për dhënien e masave të sigurimit dhe parimin e përputhshmërisë së kërkesës për masë sigurimi drejtuar gjykatës shtetërore me marrëveshjen e arbitrazhit, njohjen e së drejtës së gjykatave për të vepruar edhe në ndihmë të arbitrazhit të huaj dhe procedura të veçanta për njohjen dhe ekzekutimin e vendime të arbitrazhit të huaj për masa sigurimi.

Për zbatimin efektiv të dispozitave për marrjen e masave të sigurimit në procesin e arbitrazhit, sigurisht që një rol të rëndësishëm luan dhe komuniteti i biznesit, detyra kryesore e të cilit është të mos abuzojë me të drejtat që kanë në një proces arbitrazhi.

## BIBLIOGRAFI

### LIBRA

1. Alston Philip & Lowe Vaughan eds., "The UNCITRAL Arbitration Rules: A Commentary", 2006.
2. Andrews Neil, "The Modern Civil Process, Judicial and Alternative forms of Dispute Resolution in England", Mohr Siebeck 2008.
3. Andrews Neil, "Andrews on Civil Processes", Volumi I, Court Proceedings, Intersitia, 2013.
4. Arieta G., "I provvedimenti d'urgenza", Padova, Cedam, 1985.
5. Barona Vilar, "Medidas cautelares en el Arbitraje", Cizus Menor, Civitas, 2006.
6. Baviati Paolo, "Argomenti di diritto processuale civile", Bologna University Press, 2011.
7. Berger Peter Klaus, "International Economic Arbitration", Kluwer Law International, 1993.
8. Berger B. & Kellerhals F., International and Domestic Arbitration in Switzerland, 2<sup>nd</sup> ed. 2010
9. Besson Sebastien, "Arbitrage international et mesures provisoires-Etude de droit compare", Schulthess Polygraph. Verlag, 1998.
10. Blackaby Nigel, "Redfern and Hunter on International Arbitration", 5<sup>th</sup> ed. 2009.
11. Blesssing Marc, "Introduction to Arbitration, Swiss and International Perspectives", Helbing & Lichtenhahn, 1999.
12. Boog, "The laws governing interim measures in international arbitration", në F. Ferrari & S. Kroll (eds). Conflict of laws in international arbitration, 2010
13. Born Gary, "International Arbitration, Cases and Materials", Wolters Kluwer, 9-26 (2011).
14. Born Gary, "International Commercial Arbitration", 2<sup>nd</sup> ed. Vol. II: International Arbitral Procedures, Wolters Kluwer, 2014.
15. Born B. Gary, "International Commercial Arbitration", Volume II, 2009.
16. Born G., "International Arbitration and Forum Selection Agreements: Drafting and Enforcing", 4<sup>th</sup> ed., 2014.
17. Born G., Rutledge P., "International civil litigation in United States courts, 5<sup>th</sup> ed. 2011
18. Brown Chester, "A common law of international adjudication", OUP 2007.
19. Bruce Harris, et al., The Arbitration Act 1996: A commentary , 2<sup>nd</sup> ed., 2000.
20. Calamandrei P., "Introduzione allo studio sistematico dei provvedimenti cautelari", Padova 1936 dhe në Opere giuridiche, IX, Napoli 1983.
21. Caron D. & Caplan L., "The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary", 2006.
22. Caron D. & Caplan L., "The UNCITRAL Arbitration Rules: A commentary", 2<sup>nd</sup> ed., 2013.
23. Collins L., "Provisional and Protective Measures in International Litigation", Recueil des Cours 234 (1992-III).
24. Croft Clyde, Kee Christopher, Waincymer Jeff, "A Guide to the UNCITRAL Arbitration Rules", (2013).
25. Cheng Bin, "General Principles of Law as Applied by International Courts and Tribunals", London: Stevens, 1953.

26. Dicey, Morris, Collins, *On the conflict of law*, 15<sup>th</sup> ed. 2012
27. Esko, "The Arbitral Proceedings", M. Savola ed., *Law and Practice of Arbitration in Finland*, 2004.
28. Ferrari F. & Kroll S. (eds), "Conflict of laws in international arbitration", 2010.
29. Frus G., "Riflessioni sul *petitum cautelare*", *Giur.it.* 1988, I
30. Frus G., "Commento al art. 74/669 bis", në *Le riforme del processo civile, nën kujdesin e Sergio Chiarloni*, Zanicheli Editore, Bologna, 1992.
31. Fry, S. Greenberg, F. Mazza, *Secretariat's Guide to ICC Arbitration*, 2012.
32. Gaillard Emmanuel, John Svage *red.*, "Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration", Kluwer Law International, 1999.
33. Grierson Jacob dhe Hooff Von Annet, "Arbitrating under the 2012 ICC Rules: An Introductory User's Guide" 2012
34. Holtzman H. & Neuhaus J., "A guide to the UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration: Legislative history and commentary", 1989.
35. Hausmaninger C., Herzer M., "Austria Arbitration", *GAR* 2012.
36. Kessler-Raesche H., Berger K.P., "Recht und praxis des schiedsverfahrens", 3<sup>rd</sup> ed. Cologne, 1999.
37. Kawano Masanori, "Provisional Measures for prohibition of actions-New tendencies in Japan", botuar në *Current Topics of International Litigation*, Vëllimi I.
38. Knoepfler F., "Les mesures provisoires de l'arbitrage international, Zchiedsgerichtsbarkeit, Zurich, 1997.
39. Kola Flutura, Vokshi Asim, "Procedurë Civile" Pjesa I, Botimi i I, Maj 2013.
40. Lamani Alqiviadh, "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë", Tiranë 1962.
41. Lew D.M Julian, Mistelis A. Loukas, Kroll Stefanl, "Comparative International Commercial Arbitration", Kluwer Law International, 2003.
42. Layton & Mercer, "European Civil Practice", Botimi i II, Vëllimi 3, Thomson Sweet & Maxwell, Londër 2004.
43. Leipold Dieter, "Grundlagen des einstweiligen Rechtsschutzes", C.H. Beck, 1971.
44. Lombardo L., "Natura e caratteri dell' intruzione probatoria nel processo cautelare", *Riv. Dir. Proc.*, 2001.
45. Luiso Francesco, Sassani Bruno, "La riforma del processo civile", Milano, Giuffre, 1991.
46. Mandrioli Crisanto, "Diritto Processuale Civile", Vol IV, Torino 2011.
47. Merlin E., "Procedimenti cautelari ed urgenti in generale"
48. Montesano Luigi, "La tutela giurisdizionale dei diritti", botuar në *Trattato di diritto civile Italiano*, da Vassalli, XI, Vëllimi 4, Torino 1985
49. Montesano Luigi, "Relazione sulle misure provvisorie in Italia", botuar në *Atti del Colloquio internazionale su "Les mesures provisoires en procedure civile*, Milano 12-13 Ottobre 1984.
50. Munch, J. nw T. Raucher, P. Wax dhe J.Wenzel eds. *Munchener Kommentar zur Zivilprozessordnung*, 3<sup>rd</sup> ed..CHBck, 2008.
51. Murray L. Peter, Sturner Rolf, "German Civil Justice", Carolina Academic Press, 2004.
52. Oberto Giacomo, "Il nuovo processo cautelare", në *Teoria e pratica del diritto*, Sez. I-59, Guffre Editore, Milano 1992.

53. O'Hare & Browne, Civil Litigation, Botimi XV, Sweet & Maxwell, 2011
54. Park W.L., Paulsson J., "International Chamber of Commerce Arbitration", New York, London, Rome, 1990.
55. Paulsson Craig Park, "International Chamber of Commerce Arbitration" Botim i 3, 2000.
56. Petrochilos G., Procedural law in international arbitration, 2004
57. Proto Pisani Andrea, "Lezioni di diritto processuale civile", Botimi i V, Jovene Editore, Napoli 2006.
58. "Procedura Civile" botim i Ministrisë së Drejtësisë, shypur në Shtypshkronjën "Mbrothësija" Kristo P. Luarasi 1923.
59. Poudret Jean-Francoist, Besson Sebastien, "Comparative Law of International Arbitration", 2007.
60. Recchioni S., "Il processo cautelare uniforme", në Trattato sui processi speciali, nën kujdesin e Chiarloni e Consolo, Torino, 2005.
61. Redfern A., Hunter M., "Law and practice of international commercial law", 2009.
62. Redfern Alan, "Interim measures", në The Leading Arbitrators' guide to international arbitration, Second Edition, redaktuar nga Lawrence W. Newman dhe Richard D. Hill, Juris Publishing, Inc.
63. Rubino-Samartanno Mauro, International Arbitration, Law and Practice, 3<sup>rd</sup> ed., 2014
64. Salvaneschi, "Il nuovo processo cautelare", nën kujdesin e Giuseppe Tarzia, Cedam, Padova, 1993.
65. Satta S., Punzi C., "Diritto Processuale Civile", Botimi i XI, Cedam 1992.
66. Storme Marcel, "Procedural Laws in Europe: Towards harmonisation", Malku, 2003.
67. Sturmer Rolf, Kawano Masanori, "Problems of Transnational Civil Procedure", 2009.
68. "Shqipëria më 1937, Veprimi Shtetnor gjat njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverimit", Botimet e Komisionit të Krentimeve të 25 vjetorit të vetqeverimit 1912-1937, Vëllimi i I, Tiranë 1937.
69. Shtëpia Botuese Luarasi, "Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri", Tiranë 2007.
70. Schütze Rolf A. (Hrsg.), "Institutional Arbitration Article by Article Commentary on AAA, CIEDAC, DIAC, DIS, ICC, ICSID, KLRCA, LCIA, MKAS, SCC, SIAC, Swiss Rules, Uncitral Rules, Vienna Rules", 2013.
71. Schwartz, "The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration", 1993.
72. Tommaseo, "I provvedimenti d'urgenza", Padova, 1983.
73. Walter G., Bosch W., Bronnimann J., "Internationale Schiedsgerichtsbarkeit in der Schweiz", Berne, 1991.
74. Webster H.Thomas, Buhler W. Michael, "Handbook of ICC Arbitration, Commentary, Precedents, Materials, 3<sup>rd</sup> ed., 2014
75. Weigand Vernd-Frank, "Practitioner's Handbook on International Commercial Arbitration", Edizioni II, 2009.
76. Yesilirmak Ali, Provisional Measures in International Commercial Arbitration, (2005).
77. "The nature of conservatory and provisional measures", në Conservatory and provisional measures in international arbitration, Botim i ICC nr. 519, 1993.

78. Zuckerman Adrian, "Zuckerman on Civil Procedure, Principles of Practice", Botimi i III, Sweet & Maxwell 2013.

## ARTIKUJ

1. Andrews H. Neil, "Accelerated Justice: Protective, Interim and Summary Procedures in English Law", botuar në Current Topics of International Litigation, redaktuar nga Rolf Sturmer dhe Masanori Kawano, Vëllimi I, Mohr Siebeck, 2009.
2. Adamontopoulos Konstantinos, "Greece" in Bosch ed.
3. Baker & Davis, "Arbitral proceedings under the UNCTRAL Rules: The experience of fthe Iran-United States Claims Tribunal", 23 Geo. Wash. J Int'l Econ. , 1989.
4. Becker, "Attachments in aid of international arbitration-The American position", 1 Arb. Int'l. 40, 1985
5. Beechey & Kenny, "How to control the impact of time running between the occurrence of the damage and its full compensation: compensatoy and alternative remedies in interim relief proceedings", në L. Levy & F. De Ly (eds.) Interest, auxilary and alternative remedies in international arbitration, 2008.
6. Bernardini Piero, "Italy", in ICCA International Hanbook of Commercial Arbitration, Ch. IV.5.
7. Bhasin, "The grant of interim relief under the Indian Arbitration Act of 1996", A. van den Berg ed., International Arbitration and National Courts: The never ending story, ICCA Congress Series no. 10, 2000.
8. Bosch, "Germany" in Bosch ed.
9. Bose Raja dhe Meredith Ian, "Emergency Arbitration Procedures: A comparative analysis", 2012, gjendet <http://www.klgates.com/files/Publication>.
10. Brower H. Charles II, "What I tell you three times is true: U.S. courts and pre award interim measure under the New York Convention", 35, Va. J. Int'l L. 1995
11. Brown Chester, "The Enforcement of Interim Measures Ordered by Tribunals and Emergency Arbitrators in International Arbitration", botuar në International Arbitration The Coming of a New Age ICCA Congress Series No. 17, Editor i përgjithshëm Albert Jan Van Den Berg.
12. Bucy Renee Dana, "How to Best Protect Party Rights: The Future of Interim Relief in International Commercial Arbitration Under the Amended UNCITRAL Model Law", 25 Am. U. Int'l L. Rev. 2010.
13. Calvo M.A, "The new ICC Rules of Arbitration-Substantial and procedural changes, 14 (4), J. Int'l Arb., 1997.
14. Carpi, "La tutela d'urgenza, I procedimenti cautelari e l'esecuzione nel disegno di legge per la riforma urgente del c.p.c: la competenza e il procedimento", në Riv. trim.dir. poc.civ., 1990.
15. Caron D. David, "Interim Measures of Protection: Theory and Practice in Light of the Iran United States Claims Tribunal", ZEITSCHRIFT FÜR AUSLÄNDISCHES ÖFFENLICHES RECHT UND VÖLKERRECHT 46, 1986;
16. Castello E. James, "Arbitral Ex parte Interim Relief, The View in Favour", prezantuar në 28 Maj 2003 në një konferencë ndërkombëtare arbitrazhi.

17. Collins Lawrence, "Provisional and protective measures in international litigation", 234 *Recueil des Cours* 9, (1992).
18. DERAINS, *Arbitral Ex Parte Interim Relief*, Dis Res Jo 61
19. Donald Francis Donovan "Powers of the arbitrators to issue procedural orders, including interim measures of protection, and the obligation of parties to abide by such orders", ICC Bulletin Vol. 10/Nr. 1 Pranverë 1999
20. Donovan Francis Donald, "Provisioanl Measures in the ICJ and ICSID Further Dialogue and Development", *Contemporary issues in International Arbitration and Mediation*, The Fordham Papers 2012.
21. Elias P., "Pickets and Inerlocutory Injunctions", (1975) C.L.J. 191.
22. Ferguson M. Stephen, "Interim measures of protection in international commercial arbitration: Problems, proposed solutions and anticipated results", 12 *Currents: Int'l Trade L.J.* fq. 55 (2003).
23. Gaillard Emmanuel and Pinsolle Philippe, "The ICC Pre-Arbitral Referee: First Practical Experiences", *Arbitration International*, vol. 20, no. 1, 2004.
24. Gaillard Emanuel, "Arbitrage commercial international- Intervention du juge Etatique, Juisclasseur Droit International", Fascicule 586-8-2, no. 142, 1991.
25. Gaitis, "The Federal Arbitration Act: Risks and Incongruities relating to the issuance of inerim and partial awards in domesstic and international arbitration", 16 *Am. Rev. Int'l Arb.* 2005.
26. Gore, "Interlocutory Injunctions – A final judgement" (1975) 38 M.L.R.
27. Grey C., "Interlocutory Injunctions since Cyanamid", (1981) 40 C.L.J.
28. Hausmaninger, Ch., "The ICC rules for a pre-arbitral referee procedure: A step towards solving the problem of provisional relief in international arbitration?", 7(1) *ICSII Rev. FILJ*, 1992.
29. Hieckie Robert Kieran, "The enforceability of interim measures of protection granted by arbitral tribual outside the seat of arbitration: A new approach", 12 *VINDOBONA J. INT.L COM. L. & ARB*, 2008.
30. Higgins, "Interim measures in transnational maritime arbitration", 65 *Tulane L. Rev.* 1991.
31. Hober Kaj, "Interim Measures by Arbitrators" publikuar në "International Arbitration 2006 Back to Basics?" Botim i Këshillit Ndërkombëtar të Arbitrazhit Tregtar (ICCA), Edituar nga Albert Jan Van Den Berg, III.
32. Hoellering, "The practices and experience of the American Arbitration Association", botuar në ICC, *Conservatory and provisional measures in international arbitration* 1993.
33. Houtte Van Hans, "Ten reasons against a proposal for *ex parte* Interim Measures of Protection in arbitration". Artikull i prezantuar në Konferencën mbi Masat e sigurimit organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Institucioneve të Arbitrazhit Tregtar (IFCAI) në vitin 2003.
34. Huntley, "The scope of article 17: Interim measures under the UNCITRAL Model Law", 740 *PLI/Lit.* 1181, 2005.
35. Karrer A. Pier, "Interim measuers issues by arbitral tribunals and the courts: Less theory, please", in A. van den Berg ed. *International Arbitration and National Courts: The never ending story*, 2001.
36. Kessedjian, "Mesures provisoires et conservatorires. A propos d'une resolution adopte par l'Association de droit international", *JDI* 1997.
37. Kessedjian Catherine, "Definition et condition de l'octroi de mesures provisoire", publikuar në "Les mesures provisoires dans l'arbitrage commercial international, Evolution et innovations", 2007.



38. Kola Flutura, Çinari Silvana, “Historia e zhvillimit të arbitrazhit në Shqipëri në 100 vjet shtet”, artikull i prezantuar në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Sistemi ligjor në konsolidim” organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë UT në bashkëpunim me Albanian University (2012).
39. Kroll, “Das neue deutsche Schiedsrecht vor staatlichen Gerichten”, NJW 2001.
40. Lew D.M Lew, “Commentary on Interim and Conservatory Measures in ICC Arbitration Cases”, ICC Bulletin Vol. 11/Nr. 1- 2000.
41. Lemenez, Quigley, “The ICDR’s Emergency Arbitrator Procedure in Action”, Part I, A look at the empirical data, *Dispute Resolution Journal* Vol. 63, 2008.
42. Lemenez Guillaume and Quigley Paul, “The ICDR’s emergency arbitrator: Procedure in action Part II: Enforcing Emergency Arbitrator Decisions”, *Dispute Resolution Journal*, November 2008, January 2009
43. Lew, “Commentary on interim and conservatory measures in ICC arbitration cases”, 11(1) ICC Ct. Bull. 2000.
44. Lu Jun Jue, “The emergency arbitrator procedure: effective tool or enforcement headache?”
45. Luiso, “La riforma dei procedimenti cautelari”, në *Documenti Giustizia*, 1990.
46. Mandrioli, “I provvedimenti d’urgenza: deviazioni e proposte”, në *La tutela d’urgenza*, Atti del CV convegno nazionale, Rimini, Maggioli, 1986.
47. Mehren von, “The enforcement of arbitral awards under conventions and United States Law”, 9 *Yale J. World Pub. Order*, 198.
48. Mendez, “Arbitrage international et mesures conservatoires”, *Rev. Arb.* 51, 1985.
49. Merills, Interim measures of protection in the recent jurisprudence of the International Court of Justice, 44 *Int’l Comp.L.Q.*, 1995
50. Mills, “State international arbitration statutes and the US Arbitration Act: Unifying the availability of interim relief”, 13 *Ford. Int’l L.J.*, 1989-1990.
51. Mouawad Caline & Silbert Elizabeth, “A guide to Interim Measures in Investor-State Arbitration”, *Arbitration International, LCIA*, Volume 29.
52. Metzger, Friedlander, “The preliminary injunction: Injury without remedy?” [1974] 29, *The Business Lawyer* 913; Spry, *Equitable remedies*, (6<sup>th</sup> edn. 2001).
53. Paulson, “A better mousetrap: 1990 ICC Rules for a pre arbitral referee procedure”, *International Business Law*, nr.18, 1990.
54. Pluyette, The role of the courts and problems related to the execution of conservatory and provisional measures, në *Conservatory and Interim measures in International Arbitration*, Botim i ICC no. 519, 1993
55. Proto Pisani, “I provvedimenti d’urgenza ex art. 700 c.p.c”, në *Appunti sulla giustizia civile*, Bari, Cacucci, 1982.
56. Raport Përfundimtar mbi “Interim and Partial Awards” i një grupi pune të Komisionit të ICC për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, 1990.
57. Salvaneschi Laura, “La domanda e il procedimento”, në *AA.VV. I procedimenti cautelari*”.
58. Shalakany, “Arbitration and the Third world: A Plea for Reassessing Bias under the Specter of Neo-Liberalism” 41 *Harv. Int’l L.J.* 419, 430 (2000).
59. Shaughnessy Patricia, “Pre-arbitral urgent relief: The new SCC Emergency Arbitrator Rules”, *Journal of International Arbitration* 27(4), 2010.
60. Shihata & Parra, “The experience of the International Center for the Settlement of Investments Disputes”, 14 *ICSID Rev. For. Inv. L.J.* 1999.

61. Steindl Helene Barbara, "The Emergency Arbitrator in International Construction Arbitration", 2013 botuar në "Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation", The Fordham Papers, editor Arthur W. Rovine, 2012.
62. Thomas Charles John, "Selected Issues: Interim Measures in International Arbitration: Finding the Best Answer", 12 CROATIAN ARB.Y.B. (2005).
63. Tommaseo, "Commento alla Legge 26 novembre 1990, n. 353 Provvedimenti urgenti per il processo civile", në Il Corriere giuridico, 1991.
64. Tucker, Lee Anna, "Interim Measures under Revised UNCITRAL Arbitration Rules: Comparison to Model Law Reflects both Greater Flexibility and Remaining Uncertainty", International Commercial Arbitration Brief 1, no. 2 (2011).
65. UNCITRAL Secretariat Report, "Analytical commentary on draft text of a Model Law on Commercial Arbitration" UN Doc A/CN.9/264 botuar në Holtzman & Neuhaus, Model Law.
66. Vivekananda N., "The SIAC Emergency Arbitrator Experience", gjendet në: <http://www.siac.org.sg/>.
67. Xandra Kramer E., "Harmonization of provisional and protective measures in Europe", botuar në Procedural laws in Europe.
68. Wagoner E. David, "Interim relief in international arbitration: Enforcement is a substantial problem", Resol. J. (1996).
69. Wallington, "Injunctions and the right to demonstrate", (1976) 35 C.L.J.
70. Wessel and North Cohen, In tune with Mantovani: the "Novel" case of damages for breach of an arbitration agreement", 4 Int. ALR 65, 2001
71. Westberg Peter, Skileforfarande och Avtal om Civilprocessulla och Sakerhetsatgardar, Festkrift Till Lars Gorton, Eva Lindell-Frantz ed. 2008
72. Wilford Kate, "Emergency Arbitrator: a passing trend?" Janar 2014.
73. Yesilirmak Ali, "Provisional and protective measures under Austrian arbitration law", Arbitration International, Vol. 23, No. 4, © LCIA, 2007.
74. Yesilirmak, "Interim and conservatory measures in ICC Arbitral Practice", 11(1) ICC Bulletin 31 (2000).
75. Zuckerman A.A.S., "Dispensation with Undertaking in Damages- An Elementary Justice", 1993 12 C.J.Q.
76. Zuckerman A.S.S., "Interlocutory injunctions in quest of procedural fairness", 1993, 56 M.L.R.

## **AKTE LIGJORE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE**

1. "Konventa Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit" e datës 7 Qershor 1959 ratifikuar me ligjin Nr. 8688, datë 09.11.2000
2. Konventa Europiane e Arbitrazhit Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21 prill 1961, ratifikuar Ligjin nr. 8687, të datës 09.11.2000
3. "Konventa për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet Shteteve dhe shtetasve të Shteteve të kontraktore" ratifikuar me ligjin nr. 7515 datë 02.10.1991
4. Ligji Model i UNCITRAL mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar
5. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë
6. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
7. Ligji Nr.10 428, datë 2.6.2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private"

8. Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
9. Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 për “Pronësinë Industriale në Republikën e Shqipërisë”
10. Ligji nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”
11. Shtojca e dytë e Procedurës Civile
12. Kodi i Procedurës Civile i vitit 1958
13. Konventa e Hagës “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare”
14. Rregullore 1215/2012 “Për juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”
15. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Italisë
16. Ligji Zviceran për të Drejtën Ndërkombëtare Private.
17. Kodi i Procedurës Civile franceze
18. Kodi Holandez të Procedurës Civile
19. Kodi i Procedurës Civile gjerman
20. Kodi i Procedurës Civile austriak
21. Kodi i Pocedurës Civile të Greqisë
22. Kodi i Procedurës Belg
23. Akti anglez i arbitrazhit
24. Akti Suedez i Arbitrazhit
25. Akti Irlandez të Arbitrazhit
26. Ligji kinez i arbitrazhit
27. Ligji tajlandez i arbitrazhit
28. Kodi i procedurës civile dhe tregtare të Argjentinës.
29. Akti Kanadez i Arbitrazhit Tregtar
30. Ligji Australian për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar
31. Akti Indian i Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit
32. Akti i Arbitrazhit Ndërkombëtar i Singaporit
33. Hong Kong Arbitration Ordinance 2013
34. Ligji i Arbitrazhit të Zelandës së Re.
35. Ligji i Procedurave Civile i New Yorkut
36. Ligji i Arbitrazhit Slloven i vitit 2008
37. Ligji i Arbitrazhit Japonez
38. Ligji Peruan i Arbitrazhit

## **RREGULLORE ARBITRAZHI**

1. Rregullat e Arbitrazhit të International Chamber of Commerce (ICC) 2012
2. Rregullat e Arbitrazhit të London Court of International Arbitration (LCIA) 2014
3. Rregullat e Arbitrazhit të China International Economic and Trade Arbitration Commission (CIETAC)
4. Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL
5. Rregullat e Arbitrazhit të ICSID
6. Rregullat e Arbitrazhit të International Centre for Dispute Resolution (ICDR)
7. Rregullat e Arbitrazhit të Swiss Chambers’ Arbitration Institution 2012
8. Rregullat e Arbitrazhit të Japan Commercial Arbitration Association (JCAA) 2014

9. Rregullat e Arbitrazhit të Singapore International Arbitration Centre (SIAC) 2013
10. Rregullat e Arbitrazhit të SIAC 1997
11. Rregullat e Arbitrazhit të Arbitration Chamber of Milan 2010.
12. Rregullat e Arbitrazhit të Gjykatës së Arbitrazhit të Sporteve
13. Rregullat e Arbitrazhit të Shoqatës Italiane të Arbitrazhit
14. Rregullat e Arbitrazhit të DIS (German Arbitration Institution)
15. Rregullat e Arbitrazhit të CEPANI (Belgian Centre for Arbitration and Mediation)
16. Rregullat e Arbitrazhit të NAI (Netherlands Arbitration Institute)
17. Rregullat e Arbitrazhit të MEDART (Qendra Shqiptare e Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar)

## **VENDIME TË GJYKATAVE SHQIPTARE**

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 145 datë 10.12.2013
2. Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.10, datë 24.10.2004
3. Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 27.03.2012
4. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 255, datë 14.05.2015
5. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 148, datë 17.04.2014
6. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 534, datë 22.10.2014
7. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 130, datë 19.02.2013
8. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 479 datë 27.10.2011
9. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 475, datë 27.10.2011
10. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 22, datë 19.01.2011
11. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 370, datë 05.10.2010
12. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 131, datë 18.03.2010
13. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 92, datë 02.03.2010
14. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 108, datë 11.03.2010
15. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 334, datë 21.03.2007
16. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 445, datë 17.04.2007
17. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 849, datë 29.06.2006
18. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 1364, datë 21.12.2006
19. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 27, datë 25.02.2013
20. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.123, datë 03.04.2013
21. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 225, datë 06.03.2013
22. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 32/1010, datë 01.03.2012
23. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 48, datë 02.02.2012
24. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 339, datë 31.03.2015
25. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 334, datë 30.03.2015
26. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 224, datë 16.03.2015
27. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 242, datë 06.03.2015
28. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti. 249, datë 02.03.2015
29. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 1511, datë 27.02.2015
30. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 216, datë 27.02.2015
31. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 149, datë 26.02.2015
32. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 228, datë 18.02.2015
33. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti. 929, datë 29.12.2014
34. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 1034, datë 24.12.2014
35. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 876, datë 05.11.2014

36. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 838, datë 23.10.2014
37. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 663, datë 17.07.2014
38. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 655, datë 16.07.2014
39. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 556, datë 01.07.2013
40. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti, 559, datë 16.06.2014
41. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti. 505, datë 21.05.2014
42. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 430, datë 22.04.2014
43. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 276, datë 13.03.2014
44. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 240, datë 07.03.2014
45. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 236, datë 04.03.2014
46. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 130, datë 18.02.2014
47. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 168, datë 04.02.2014
48. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 48, datë 20.01.2014
49. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 130, datë 16.01.2014
50. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 57, datë 15.01.2014
51. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 107, datë 14.01.2014
52. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 101, datë 14.01.2014
53. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti, 106, datë 06.01.2014
54. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 970, datë 06.12.2013
55. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 955, datë 26.11.2013
56. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 920, datë 12.11.2013
57. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 848, datë 01.11.2013
58. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 912, datë 30.10.2013
59. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 878, datë 25.10.2013
60. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 843, datë 10.10. 2013
61. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 745, datë 20.09.2013
62. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 685, datë 20.09.2013
63. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. Akti 549, datë 23.08.2013
64. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 609 akti, datë 27.07.2013
65. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 609, datë 11.07. 2013
66. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti 509, datë 09. 07. 2013
67. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti.555, datë 27.06.2013
68. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 436, datë 27.05.2013
69. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 386, datë 22.05.2013
70. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 395, datë 15.05.2013
71. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 283, datë 03.04. 2013
72. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 112, datë 14.01.2013
73. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 834, datë 21.12.2012
74. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 762, datë 17.11.2012
75. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 787, datë 28.10.2012
76. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 549 akti, datë 23.08. 2012
77. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. Akti 2127, datë 26.07.2010
78. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.akti. 564, datë 23.12.2009

## **VENDIME GJYQËSORE DHE TË ARBITRAZHIT TË HUAJ**

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane nr. 253, datë 23 qershor 1994
2. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane, nr. 190, datë 28 qershor 1985
3. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali, nr. 14641, datë 23 qershor 2009

4. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 6116, datë 20 mars 2006
5. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali, nr. 1609, datë 27 tetor 2003
6. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 1861, datë 18 shkurt 2000
7. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 4906, datë 10 gusht 1998
8. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 2251, datë 22 maj 1987
9. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 69, datë 9 janar 1987
10. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 8223, datë 6 nëntor 1987
11. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 2672, datë 19 prill 1983
12. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 2172, datë 8 prill 1982
13. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 200, datë 22 janar 1976
14. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 1448, datë 15 shtator 1970
15. Vendim i Gjykatës së Kasacionit Itali nr. 1973, datë 30 maj 1969
16. Vendim i Gjykatës së Barit, datë 24 shkurt 2003, Giur. It., 2003
17. Vendim i Gjykatës së Torinos, datë 23 gusht 2002, Giur. It., 2003
18. Vendim i Gjykatës së Parmës, datë 18 dhjetor 2000, Giur. It., 2001
19. Vendim i Gjykatës së Bolonjas, datë 2 Korrik 1996
20. Vendim i Gjykatës së Katantias, datë 26 gusht 1993, Giur. It. 1994
21. Vendim i Gjykatës së Barit 29 Prill 1994
22. Vendim i Gjykatës së Trani 28 Korrik 1993
23. Vendim i Gjykatës së Kasacionit i 20 Dhjetor 1982, SCI Le Panorama v. Societe Immobiliere et mobileire du Tertre (SIMT), Rev Arb, 1986
24. Vendim i Gjykatës së Apelit të Versajës, i datës 8 tetor 1998, Societe Akzo Nobel et autres v. SA Elf Atochem, 1999 Rev Arb
25. Vendim i Gjykatës së Distriktit të Zyhrihut, 20 tetor 1989, botuar në RSDIE, 1991
26. Vendim i Gjykatës së Drejtësisë së Gjenevës, RSPI, 1993
27. Vendim i Gjykatës Federale Zvicerane datë 13 Prill 2010, DTF 4°-582/2009
28. Vendim i Gjykatës së Apelit Paris në çështjen Societe Otor Participations kundër Carlyle Holdings, datë 7 tetor 2004, Rev. Arb.
29. Vendim i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në çështjen Van Uden Maritime BV kundër Kommanditgesellschaft in Firma Deco-Line, Case no. C-391/95 [1998] E.C.R. I-7091, 7133;
30. Vendim i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në çështjen Reichert & Klockner kundër Dresner Bank, Case no. C-261/90 [1992] E.C.R. I-20149
31. Vendim i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në çështjen Aegean Sea Continental Shelf, ICJ Reports 1976
32. Vendimi i GJND në çështjen United States Diplomatic and Consular Staff in Tehran, datë 15 dhejtor 1979, ICJ Reports 1979
33. Vendimi i GJND në çështjen Frontier Dispute (Burkina Faso c. Mali) datë 10 janar 1986, ICJ Reports 1986
34. Vendimi i GJND në çështjen Passage Through the Great Belt (Finland v. Denmark) botuar në ICJ Reports 1991
35. ICC Case no. 7895, ICC Bulletin 64 (2000) 65
36. ICC Case no. 8113, ICC Bulletin 65 (2000) 67
37. ICC Case no. 8786, ICC Bulletin 81 (2000) 82
38. Interim award in ICC Case no. 8879, 11(1) ICC Ct. Bull 84 (2000)
39. Partial award in ICC Case no. 8113, 11 (1), ICC Ct. Bull 65 (2000)
40. ICC award no. 7828
41. Interim Award in ICC case no. 8879, 11(1) ICC Ct. Bull. 84 (2000)
42. Interim Award in ICC Case no. 7886, 11(1) ICC Ct. Bull 81, 82, (2000)

43. Partial award in ICC Case no. 8113, 11(1) ICC Ct. Bull. 65 (2000)
44. Interim award in ICC Case no. 8894, 11(1) ICC Ct. Bull. 94 (2000)
45. Final Award in ICC Case no. 7589, 11(1) ICC Ct. Bull., 60 (2000)
46. Final Award in ICC case no. 7210, 11(1), ICC Ct. Bull. 49, (2000)
47. ICC Interlocutory award 10596, 2000
48. ICC Interim award 10937, YCA 2005
49. ICC Interlocutory Award 10596, YCA 2005
50. ICC Final Award no. 5804, 1989, ICC Int'l Ct. Arb Bull. 1993
51. ICC Final award 7489, 1993, ICC Int'l Ct. Arb. Bull. 1997
52. ICC Partial Award 7972 i 1997
53. ICC Final Award 7210 i 1994, ICC 11(1), Int'l Ct Arb 2000
54. Interim award in ICC Case no. 8879 ICC Ct. Bull. 84, 89, (2000)
55. Partial Award in the ICC Case no. 12363
56. Partial Award in ICC Case no. 4998, 113 J.D. I. (Clunet), 1986
57. Order no.5 in ICC Case, 2 April 2002, 21 ASA Bull. 2003,
58. ICC Second Interim Award 7544 i 1996, 11(1) ICC Int'l Ct. Arb. Bull., 2000
59. ICC award 4126 JDI 1984
60. Reichert v Dresdner Bank, ECJ 26 March 1992, Case C-261/90, ECR I-2149
61. Munro kundër Wivehoe and Brightlingsea Rly Co (1865) 46 ER 1100, 4 De G.J.& S
62. R kundër Secretary of State or Transport Ex. P. Factortame Ltd (no.2) [1991] 1 All ER 70
63. Managment Publications Ltd. k. Blenheim Exhibitions Group Plc. [1991] 1 All ER 70
64. Sander kundër Smith (1838) 3 My. & Cr 711, 40 ER 1100
65. Hubard kundër Vosper (1972) 2 QB 84;
66. Hill kundër C A Parsons & Co Ltd (1972) Ch 305
67. Evans Marshall & Co Ltd kundër Distos Cia Naviera SA, The Siskina (1973) 1 All ER 992
68. Jones kundër Pacaya Rubber and Produce Co Ltd [1911] 1 KB
69. Preston v Luck (1884) 27 Ch D fq. 497-506.
70. Smith kundër Grigg ltd [1924]1 KB
71. Canvedish House (Cheltnham) Ltd kundër Cavendish –Woodhouse Ld [1970] RPC
72. Challender kundër Royle (1887) 36 CH D
73. Donmar Productions kundwr Bart [1967] 2 All ER 324
74. Hubbard kundër Vosper [1972] 2 QB 84
75. American Cyanamid ltd k. Ethicon Ltd [1975] AC 396, [1975] 1 All ER 504 HL
76. Fellowes kundër Fisher [1976] QB
77. Hubbard kundër Pitt [1976] QB
78. Series 5 Software Ltd kundër Clarke
79. National Commercial Bank Jamaica kundwr Olin Corp, [2009] UKPC
80. Belgium vs. Senegal, International Court of Justice, Request for the indication of provisional measures, datë 28 Maj 2009
81. Costa Rica v. Nicaragua, Request for the indication of provisional measures, international court of justice, date 8 Mars 2011
82. Laemthong International Lines Co Ld kundër ARTIS [2005]1 Lloyd's Rep 100.
83. Irish Response Ltd kundër Direct Beauty Products [2011] EWHC 37 (QB)

84. Linsen International kundër Humpuss Sea Transport PTE LTD [2010] EWHC 303 (Com)
85. Kay kundër Robertson[1991] F.S.R 62
86. Entec (Pollution Control)Ltd kundër Abacus Mouldings [1992] F.S.R. 332
87. Waterlow Directoies Ltd kundër Reed Information Services Ltd [1992] F.S.R
88. Cayne kundër Global Natural Resources Plc [1984] 1 All ER 225 CA
89. Cambridge Nutrition kundër BBC [1990] 3 All ER 523 CA
90. Ninemia Maritime Corp kundër Trave Schiffahrtsgesellschaft mbH & Co KG (The Niedersachsen) [1984] 1 All ER 398
91. Merceddes-Benz AG kundër Leiduck [1996] AC 284
92. Antonio Gramsci Shipping Corporation kundër Recoletos Ltd [2011] EWCH2242 (Comm)
93. Bhimji kundër Chatwant (no.2) [1992] 4 All ER 912
94. Harley Street Capital ltd kundër Tchigirinski (no. 1) [2005] EWHC 2471 (Ch.)
95. DPR Futures Ltd[1989] B.C.L.C.
96. Smith kundër Day (1882) 21 Ch D 421-423.
97. F. Hoffman –La Roche & Co AG kundër Secretary of State for Trade and Industry [1974] 2 All ER 1128, 1150
98. Smithkline Beecham Plc kundër Apotex Europe Ltd [2006] EWCACiv 658.
99. DPR Futures Ltd [1989] B.C.L.C. 634
100. Smithkline Beecham Plc kundër Apotex Europe Ltd [2005] EWHC 1655
101. Kirkless Borough Council kundër Wickers Building Supplies Ld [1991] 4 All ER
102. Customs and Excise Commissioners kundër Barclays Bank Plc [2006] UKHL
103. Dubai Bani ltd kundër Galadari (nr. 2), The Times, 11 tetor 1989
104. Hailstone Hopkins kundër Carter (1910) 102 L.T 877.
105. Modern Transport Co Ltd kundër Duneric Steamship Co [1917] 1 KB 370. CA.; Triodos Bank NV kundwr Dobbs [2005] EWHC 108.
106. Apex Frozen Foods Ltd kundër Ali [2007] EWHC469,(2007) L.T.L., 11 prill 2011.
107. Al-Rawas kundër Pegasus Energy Ltd [2008] EWHC 617.
108. Graham kundër Campbell (1878) 7 Ch D 490 CA.
109. Les Laboratoires Servier kundër Apotex [2011] EWCA Civ 593.
110. Air Expres Ltd kundër Ansett Transport Industries etec (1981) 146 C.L.R 249 [30]
111. The Queen kundër Secretary of State for Transp., ex parte Factoratame Ltd Case no. C-213/89[1990] E.C.R. I-02433
112. Electricity Company of Sofia and Bulgaria, Ser A/B, no. 79, 1939
113. Vendim të gjykatës së Padova datë 13.02.1996 në Giur. It., 1996, I, 2, 460
114. Pac. Reins. Mtg Corp. kundër Ohio Reins. Corp., 935, F.2d 1019,1022-23 (9<sup>th</sup> Cir. 1991);
115. Island Creek Coal Sales Co. kundër City of Gainesville, 729 F.2d, 1046, 1049 (6<sup>th</sup> Cir. 1984);
116. Konkar Maritime Enter., SA kundër Compagnie Belge d’Affretement , 668 F. Supp. 267, 271 (S.D.N.Y 1987)
117. Toyo Tire Holdings of Ams. Inc. kundër Cont’l Tire N. Am. Inc., 609 F.3d, fq. 975 (3<sup>rd</sup> Cir. 1972);
118. Arrowhead Global Solutions, Inc. kundër Datapath, Inc., 166 F.Appx, fq. 39, 44, (4<sup>th</sup> Cir. 2006);



119. *Banko de Seguros del Estado kundwr Mut. Marine Office, Inc.*, 344 F. 3d 255 (2<sup>nd</sup> Cir. 2003);
120. *Island Greek Coal Sales Co. kundër City of Gainseville*, 729 F. 2d, 1046, 1049 (6<sup>th</sup> Cir. 1984);
121. *Sperry Int'l Trade, Inc. kundwr Gov't of Israel*, 689 F 2d, 301, 306 (2<sup>nd</sup> Cir. 1982).
122. *Charles Constr. Co. v. Derderian*, 586 N.E.2d 992 (Mass. 1992)
123. *Kastner v Jason* [2004] APP.L.R. 12/02
124. *Pacific Maritime (Asia) Ltd. dhe Holystone Overseas Ltd.* [2007] EWHC 2319 <http://www.bailii.org/ew/cases/EWHC/Comm/2007/2319.html>
125. Public Communication, Plaintiff-Counterclaim Defendant-Appellant and Publucis S.A., a French corporation, Counterclaim Defendant-Appellant, v. True North Communications INC., Nos. 99-1199 & 99-3424 in the United States Court of Appeals for the Seventh Circuit, 14 Mars 2000,
126. Award in summary Arbitral proceedings in NAI Case no. 2212 dated 28 July 1999, XXVI Y.B. Comm. Arb. 198(2001)
127. Award in summary Arbitral proceedings in NAI Case no. 2212 dated 28 July 1999, XXVI Y.B. Comm. Arb. 198(2001)
128. Decision of Geneva Chamber of Commerce, 25 September 1997, 19 ASA Bull. 745 (2001)
129. *Perenco Ecuador Ltd. kundër Republic of Ecuador*, Decision on Provisional Measures in ICSID Case no. ARB/08/6 of 8 May 2009, para. 39.
130. *Quiborax SA kundër Plurinatl State of Bolivia*, Decision on Provisional Measures in ICSID Case no. ARB/06/2 of 26 February 2010, para 108. "*Tokios Tokelès v. Ukraine*", Cështja Nr. ARB/02/18, Urdhër Nr. 1, datë 1 Korrik 2003, fq. 4 para. 6.
131. *Belgium vs. Senegal*, International Court of Justice, Request for the indication of provisional measures, datë 28 Maj 2009, <http://www.icj-cij.org/docket/files/144/15149.pdf>
132. *Costa Rica v. Nicaragua*, Request for the indication of provisional measures, international court of justice, date 8 Mars 2011, <http://www.icj-cij.org/docket/files/150/16322.pdf>
133. "*Tokios Tokelès v. Ukraine*", Case No. ARB/02/18, Order No. 3, date 18 Janar 2005, <http://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0865.pdf>
134. *City Oriente Limited v Ecuador and Empresa Estatal Petróleos del Ecuador (Petroecuador)*, ICSID Case No. ARB/06/21, IIC 308 (2007), 24th October 2007, Decision on Provisional Measures, <http://italaw.com/documents/CityOrient-ProvisionalMeasures-EN.pdf>
135. *Guiborax s.a., Non Metallic Minerals s.a. and Allan Fosk Kaplún v. Plurinational State of Bolivia*, ICSID Case No. ARB/06/2, Decision on Provisional Measures, date 26 Janar 2010 <http://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0698.pdf>
136. "*Occidental Petroleum Corporation Occidental Exploration and Production Company v. The Republic of Ecuador*", ICSID Case No. ARB/06/11, DECISION ON PROVISIONAL MEASURES, datë 17 Gusht 2007 <http://italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0576.pdf>
137. *Behring Int.'l, Inc. v. Islamic Republic of Iran*, Interim and Interlocutory Award in IUCST case no. ITM/ITL 52382-3 of 21 June 1985
138. *Behring International, Inc vrs Iranian Air Force*, Case no 382, Interim Award no. ITM 46-382-3, 22 shkurt 1985.

139. *CJSC Vostokneftegaz Company v. The Government of Mongolia*, UNCITRAL, ORDER ON INTERIM MEASURES, datë 2 Shtator 2008,  
<http://italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0621.pdf>
140. *Plama Consortium Limited v. Republic of Bulgaria*, ORDER (ICSID Case No. ARB/03/24), datë 27 Gusht 2008,  
<http://italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0670.pdf>.
141. Victor Pey Casado y Fundacion Presidente Allende v. Republica de Chile, Decision on provisional measures in ICSID case no. ARB/98/2 of 25 Septemebr 2001
142. Islamic Republic of Iran v. USA, Decision in IUCST Case no. DEC 85 BI-FT of 18 May 1989,
143. MAT Cie d'Electricite de Sofia et de Bulgarie (Belgium v Bulgaria), 1922, 2 TAM
144. Iran v. United States of America, Case A-15, No. Dec 52-A/15-FT, 24 nëntor 1986
145. Maffezini v. The Kingdom of Spain, Procedural Order no. 2 of 28 Octobe 1999, XXVII YCA, 2002
146. Interlocutory award No. ITL. 33-A-4/A-15(III)-2, 1 Shkurt 1984
147. Çështja ICC 10681 (2001) botuar në Buletinin e ICC, Vol. 22/Special Supplement – 2011
148. “*Biwater Gauff (Tanzania) Ltd. Vs. United Republic of Tanzania*” ICSID çështja nr. ARB/05/22, Urdhër Procedural Nr. 1, datë 31 Mars 2006,  
<http://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0087.pdf>
149. Churchill Mining plc v. Republic of Indonesia, Urdhwr procedural nr. 3, në çështjen e ICSID nr. ARB/12/14, 4 Mars 2013
150. *Quiborax SA kundër Plurinat'l State of Bolivia*, Decision on Provisional Measures in ICSID Case no. ARB/06/2 of 26 February 2010
151. *City Oriente Limited v Ecuador and Empresa Estatal Petróleos del Ecuador (Petroecuador)*, ICSID Case No. ARB/06/21, IIC 308 (2007), 24th October 2007, Decision on Provisional Measures
152. Amco Asia Corporation (AMCO) v. Republic of Indonesia, 23 ILM 351 (1984), 30 Shtator 1983  
<http://www.justis.com/document.aspx?doc=f7jsrUrxA0LxsKjlo4Ktn5mdm1W IivLerIOJij5evmns5KdmJqJnZmco5mYm2yJiSiIs1jxAZrëAJrxAV5ësKjIo W0ha&relpos=0#page402>
153. The Electricity Company of Sofia and Bulgaria (masa sigurimi), Gjykata Ndërkombëtare Permanente e Drejtësisë, Vendimi datë 5 Dhjetor 1939; gjendet në: [http://www.icj-cij.org/pcij/serie\\_AB/AB\\_79/Compagnie\\_d\\_electricite\\_de\\_Sofia\\_ordonnance\\_19391205.pdf](http://www.icj-cij.org/pcij/serie_AB/AB_79/Compagnie_d_electricite_de_Sofia_ordonnance_19391205.pdf)
154. “*Biwater Gauff (Tanzania) Ltd. vs. United Republic of Tanzania*”, ICSID Nr. ARB/05/22, Urdhër procedural Nr 3, date 29 Shtator 2006  
<http://www.italaw.com/sites/default/files/case-documents/ita0089.pdf>
155. Çështja SafeKids referuar në Digest of UNCITRAL Model Law (2012)  
<http://www.uncitral.org/pdf/english/clout/MAL-digest-2012-e.pdf>
156. Time Staffing v. National Union Fire, 2011 U.S. Dist LEXIS 50689(S.D.N.Y.)
157. Partial award ICC case cituar në Schwartz, The practices and Experiences of the ICC Court in ICC Conservatory and Provisional Measures in International Arbitration, 1993.

158. Paul Dinin de Rosier vs. Islamic Republic of Iran, Award in IUSCT Case no. ITM 64-498-1, 4 Dhjetor 1986, 13 Iran-US C.T.R. 1986
159. *Donohoe v. Armco, Inc.*, HOUSE OF LORDS, [2001] UKHL 64, 13 DECEMBER 2001, <http://www.bailii.org/uk/cases/UKHL/2001/64.html>
160. AggelikiCharisCompaniaMaritima SA v. Pagnan SpA, QBCMF 93/1650/B, Royal Courts of Justice
161. Allianz SpA, formerly Riunione Adriatica di Sicurita SpA v. West Tankers Inc., ICJ CASE C-185/07
162. Arowhead Global Solutions, In. v. Datapath, Inc. 166 F.Appx. (4<sup>th</sup> Cir.2006)
163. MobilOil Indonesia Inc. vs. Asamera oil (Indonesia) Ltd, 43 N.Y.2d 276 (1977), Court of Appeals of the State of New York, 19 Dhjetor 1977, [http://www.leagle.com/decision/197731943NY2d276\\_1290.xml/MOBIL%20OIL%20v.%20ASAMERA%20OIL](http://www.leagle.com/decision/197731943NY2d276_1290.xml/MOBIL%20OIL%20v.%20ASAMERA%20OIL)
164. Hyman-Michaels Company, Charterer v. MARIFORUM SHIPPING, S.A, No. 1001, Docket 80-7096, United States Court of Appeals, Second Circuit, 27 Qershor 1980, <http://openjurist.org/624/f2d/411>
165. METALLGESELLSCHAFT A.G., v. M/V CAPITAN CONSTANTE and Y acimientos Petroliferos Fiscales, 790 F.2d 280 (1986), United States Court of Appeal, Second Circuit, 9 Maj 1986, [http://jenner.com/system/assets/assets/2551/original/Metallgesellschaft\\_v.\\_MV\\_Capitan.pdf?1319128063](http://jenner.com/system/assets/assets/2551/original/Metallgesellschaft_v._MV_Capitan.pdf?1319128063)
166. Publics Communication, Plaintiff-Counterclaim Defendant-Appellant and PUBLICIS S.A., a French corporation, Counterclaim Defendant-Appellant, v. True North Communications Inc., Nos. 99-1199 & 99-3424 In the United States Court of Appeals For the Seventh Circuit, Datë 14 Mars 2000
167. Sperry International Trade, Inc. v. Government of Israel, 532 F.Supp. 901 (1982), United States District Court, S. D. New York, 24 Shkurt 1982, [http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=340786164838849707&q=+Sperry+International+Trade,+Inc.+v.+Government+of+Israel&hl=en&as\\_sdt=2006&as\\_vis=1](http://scholar.google.com/scholar_case?case=340786164838849707&q=+Sperry+International+Trade,+Inc.+v.+Government+of+Israel&hl=en&as_sdt=2006&as_vis=1)
168. Banco De Seguros Del Estado v. Mutual Marine Office Inc, 230 F.Supp.2d 362 (2002), United States District Court, S.D. New York, August 6, 2002, [http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=3979444938931260288&q=banco+de+seguros+del+estado+v.+mutual+marine+office+inc&hl=en&as\\_sdt=2006&as\\_vis=1](http://scholar.google.com/scholar_case?case=3979444938931260288&q=banco+de+seguros+del+estado+v.+mutual+marine+office+inc&hl=en&as_sdt=2006&as_vis=1)
169. Front Carriers Ltd v. Atl. & Orient Shipping Corp., 2006, SGHC fq. 127; Pathak v. Tourism Transport Ltd., 2002, 3 NZLR
170. Sensation Yachts Ltd. v. Darby Mariime Ltd, case no. CIV 2005-404-1908
171. Hascher, European Convention on International Commercial Arbitration of 1961-Commentary, XX Y.B. Comm. Arb., 1995
172. Audiencia provincial of Cadiz, June 12, 1991, Bahia Industrial, S.A. v. Eintacar –Eimar, S.A. XVIII, Y.B. COM. Arb. 1993
173. McCREARY TIRE & RUBBER COMPANY v. CEAT S.p.A, v. MELLON BANK, N.A. Garnishee, 501 F.2d 1032, United States Court of Appeals, Third Circuit, 8 Korrik 1974, Para. 31, <https://law.resource.org/pub/us/case/reporter/F2/501/501.F2d.1032.73-2020.html>
174. Robert R. Cooper, v. Ateliers De La Motobecane, S. A., 57 N.Y.2d 408 (1982), Court of Appeals of the State of New York, 18 Nëntor 1982

- [http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=12322625295919705600&q=cooper+v.+ateliers+de+la+motobecane&hl=en&as\\_sdt=2006&as\\_vis=1](http://scholar.google.com/scholar_case?case=12322625295919705600&q=cooper+v.+ateliers+de+la+motobecane&hl=en&as_sdt=2006&as_vis=1)
175. Drexhel Burnham Lambert Inc. v. Ruebsamen, 531 N.Y.S. 2<sup>nd</sup> 547(N.Y. Div.1988)
  176. Carolina Power & Light Company v. Uranex, 451 F. Supp. 1044 (1977), United States District Court, N. D. California, 26 Shtator 1977, Para. 1052, gjendet në:  
<file:///C:/Users/staffAS/Desktop/Carolina%20Poëer%20&%20Light%20Co.%20v.%20Uranex,%20451%20F.%20Supp.%201044%20-%20Dist.%20Court,%20ND%20California%201977%20-%20Google%20Scholar.htm>
  177. Bahrain Telecomm. Co vs. Discoverytel, 476 F.Supp.2d 176 (2007), United States District Court, 9 Mars 2007,  
[http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=14511834639798215679&hl=en&as\\_sdt=6&as\\_vis=1&oi=scholarr](http://scholar.google.com/scholar_case?case=14511834639798215679&hl=en&as_sdt=6&as_vis=1&oi=scholarr)
  178. Borden, Inc. v. Meiji Milk, No. 793, Docket 90-7840, United States Court of Appeals, Second Circuit, 21 Nentor 1990  
[http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=5270018098514872190&hl=en&as\\_sdt=6&as\\_vis=1&oi=scholarr](http://scholar.google.com/scholar_case?case=5270018098514872190&hl=en&as_sdt=6&as_vis=1&oi=scholarr)
  179. Stephen BLUMENTHAL and Les Fein v. MERRILL LYNCH, PIERCE, FENNER & SMITH, INC, 910 F.2d 1049 (1990), United States Court of Appeals, Second Circuit, 8 Gusht 1990,  
[http://scholar.google.com/scholar\\_case?case=12704478085939402410](http://scholar.google.com/scholar_case?case=12704478085939402410)
  180. Channel Tunnel Group v Balfour Beatty Ltd, House of Lords England, [1993] Adj.L.R. 01/21, 21 Janar 1993  
<http://www.nadr.co.uk/articles/published/AdjudicationLawReports/Channel%20Tunnel%20v%20Balfour%20Beatty%201993.pdf>
  181. Amican Navigation Inc. v. Densan Shipping Co., 1997, CanLil 845, (B.C.S. Ct.);
  182. Silver Standard Res. Inc. v. Geolog, 1998, 168 D.L.R. 4<sup>th</sup> 309(B.C.Ct. App);
  183. Lady Murriel v. Transorient shipping Ltd., 1995, HKCA 615 (H.K. Ct. App.)
  184. Janvey v. Alguire, 647 F3d (5<sup>th</sup> Cir.2011)
  185. Toyo Tire Holdings of Am., Inc. v. Cont'l Tire N. Am. Inc., 609 F3d (9<sup>th</sup> Cir. 2010),
  186. Karaha Bodas Co. v. Perusahaan Pertambangan Minyak Dan Gas Bumi Negara, 335 F3d, (5<sup>th</sup> Cir. 2003)
  187. Atlantic Triton, Cass. 1 e civ. 18 November 1986
  188. Ortho Pharm. Corp. v. Amgen Inc. 882 F.2<sup>nd</sup> (3<sup>rd</sup> Cir. 1989), fq. 806, 813-814.
  189. Bhatia Int'l v. Bulk Trading SA. 2002
  190. Bharat Aluminium v. Kaiser Aluminium, C.A. no. 7019/2005
  191. Tampimex Oil Ltd. v. Latina Trading Corp. 558 F.Supp. 1201 (S.D.N.Y. 1983);
  192. Beluga Chartering GmbH v. Korea Logistics Sys. Inc. 589 F. Supp. 2d, 325 (S.D.N.Y 2008)
  193. City Water Service Ltd. v. Dar es Salaam Water & Sewerage Auth., Misc.Civ. case no. 20 of 8 June 2005

## **Abstrakt**

Objekt i trajtimit të këtij punimi është instituti procedural i sigurimit të padisë si në proceset gjyqësore civile ashtu dhe në ato të arbitrazhit. Punimi është strukturuar në dy pjesë, pjesa e parë e të cilit i kushtohet sigurimit të padisë në procesin civil dhe në të cilën analizohet dhe interpretohet legjislacioni shqiptar mbi masat e sigurimit të padisë në procesin civil, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë praktikës gjyqësore shqiptare, por edhe legjislacionit, doktrinës dhe praktikës gjyqësore ndërkombëtare, me qëllimin e vetëm për t'i dhënë përgjigje një sërë problemesh që lindin nga rregullimi aktual i institutit të sigurimit të padisë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile shqiptar.

Pjesa e dytë e punimit i është dedikuar masave të sigurimit të padisë në proceset e arbitrazhit, në të cilën analizohet kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të marrë masa sigurimi dhe ekzistenca e juridiksionit konkurrues me gjykatat shtetërore duke iu referuar akteve ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit, legjislacioneve kombëtare dhe rregulloreve të arbitrazhit të institucioneve të ndryshme, por veçanërisht doktrinës juridike dhe jurisprudencës së arbitrazhit tregtar ndërkombëtar. Qëllimi i kësaj analize të gjerë nuk është krahasimi në vetvete i instrumenteve të marrë në shqyrtim, por paraqitja e një tabloje të gjerë dhe të plotë e rregullimit të institutit të sigurimit të padisë në arbitrazhin ndërkombëtar, për të evidentuar problematikat dhe praktikatat më të mira, të cilat duhet të adoptohen nga legjislacionet kombëtare dhe për të përcaktuar çështjet për të cilat nevojitet harmonizim.

***Fjalë kyçe:** masa sigurimi, proces civil, arbitrazh, juridiksion konkurrues*

## **Abstract**

The object of this study is the procedural institute of interim measures in both civil litigation and arbitration. The thesis is structured in two parts, the first of which is dedicated to interim measures in civil proceedings, in which is analyzed and interpreted the Albanian legislation on interim measures in civil proceedings, paying special attention not only to the Albanian judicial practice, but also to the international legislation, doctrine and jurisprudence, with the only purpose to find a solution for a series of problems arising from the current regulation of the interim measures institute under the provisions of the Civil Procedure Code of Albania.

The second part of this study is devoted to interim measures in arbitration, in which is analyzed the competence of the arbitral tribunal to order interim measures and the existence of concurrent jurisdiction with national courts, by referring to international arbitration instruments, national laws and regulations of various arbitration institutions, but especially to the international commercial arbitration legal doctrine and jurisprudence. The purpose of this extensive analysis is not the comparison itself of the analyzed instruments, but to outline a broad and comprehensive framework on the regulation of the interim measures institute in international arbitration, in order to identify the problems and the best practices to be adopted by national legislation and to determine the issues that need harmonization.

***Keywords:** interim measures, civil litigation, arbitration, concurrent jurisdiction*